

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

DOKUMENTA KRYESORE
TË PARTISË
SË PUNËS TË SHQIPËRISË

TIRANË, 1970

PROLETARË TË TË GJITHË VENDEVE, BASHKOHUNI!

DOKUMENTA KRYESORE TË PPSH

VËLLIMI III

1957 - 1961

BIBLIOTEKA
E
SHKOLLËS SE PARTISE

PARATHËNJE

Vëllimi III i dokumentave kryesore të PPSH botohet në vazhdim të dy vëllimeve të para, të botuara më 1960 dhe 1961. Në këtë vëllim përfshihen dokumenta të periudhës pas Kongresit III të PPSH deri në Kongresin IV të PPSH, shkurt 1957 — shkurt 1961. Një numër i mirë dokumentash botohen për herë të parë.

Në dokumenta e kësaj periudhe pasqyrohet lufta për zbatimin e detyrave të Kongresit III të PPSH lidhur me përfundimin e bazës ekonomike të socializmit.

Dokumentat flasin për vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë si në lëmin e brendshëm, ashtu edhe në lëmin e jashtëm.

Në lëmin e brendshëm spikat lufta revolucionare për kryerjen në masë të kolektivizimit të fshatit mbi themele socialiste, për zhvillimin e forcave prodhuese, për forcimin e fuqisë mbrojtëse të atdheut dhe për rritjen e mirëqenjes së masave popullore mbi bazën e industrializimit të mëtejshëm të vendit dhe të përparimit të gjithanshëm të bujqësisë.

Në lëmin e jashtëm del në pah qëndrimi konsekuent internacionalist i Partisë dhe lufta parimore politike dhe ideologjike kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Periudha kur janë krijuar dokumentat e këtij vëllimi ka qenë më e ndërlikuar për lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Një ndërlikim i tillë ishte pasojë e vendimeve dhe e tezave revizioniste të Kongresit XX të PKBS. Një çoroditje e thellë ideologjike kishte përfshirë pjesën më të madhe të partive komuniste e punëtore e në radhë të parë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Si rrjedhim, në Bashkimin Sovjetik dhe në një varg vendesh socialiste diktatura e proletariatit dhe rendi ekonomik-shoqëror socialist kishin hyrë në rrugën e degjenerimit borgjezo-revizionist. Grupi i Hrushovit, që kishte rrëmbyer pushtetin në parti dhe në shtet, duke shfrytëzuar autoritetin e madh ndërkombëtar të PKBS dhe të shtetit sovjetik, bënte një presion shumë të fortë e të vazhdueshëm mbi udhëheqjet e partive të tjera për të zëvendësuar kursin marksist-leninist me kursin revizionist të Kongresit XX. Klika hrushoviane bënte çmos që t'i largonte nga udhëheqja të gjithë ata që kundërshtonin të përfaqonin kursin revizionist.

Një presion shumë i madh ushtrohej nga grupi i Hrushovit edhe mbi Partinë e Punës të Shqipërisë. Dokumentat e Partisë tregojnë se PPSH me Komitetin e saj Qendror në krye të udhëhequr nga shoku Enver Hoxha nuk u gjunjëzua përpara presionit të revizionistëve. Ajo ndiqte me vazhdimësi dhe me vendosmëri rrugën e vet revolucionare të mëparshme, duke kapërcyer me guxim dhe zgjuarësi pengesat e vështirësitë dhe duke u orientuar drejt në situatën jashtëzakonisht të ndërlikuar që shkaktoi revizionizmi në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Në këtë situatë PPSH e drejtoi vëmendjen e saj më të madhe në dy drejtime kryesore: së pari, në ruajtjen e karakterit revolucionar proletar të Partisë dhe të vijës së saj; së dyti, në ruajtjen e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare e në radhë të parë të kampit socialist, në mbrojtjen e marksizëm-leninizmit në shkallë ndërkombëtare.

Por në fillim PPSH nuk ngrihej dot hapur kundër udhëheqjes sovjetike dhe tezave revizioniste të Kongresit XX të PKBS. Dalja hapur në atë kohë kundër Kongresit XX do t'u shërbente vetëm armiqve të komunizmit, të cilët kishin shpërthyer një sulm të tërbuar kundër marksizëm-leninizmit, kundër kampit socialist dhe sidomos kundër Bashkimit Sovjetik, si shteti i parë dhe më i fuqishëm socialist, i krijuar nga V.I. Lenini dhe J.V. Stalini. Veç kësaj, PPSH s'kishte krijuar ende përfundimisht bindjen se Hrushovi me grupin e tij kishin tradhëtuar marksizëm-leninizmin. Ajo shpresonte se një ditë udhëheqja sovjetike do të kuptonte gabimet e veta dhe do t'i ndreqte. Për këto arsye PPSH e mbronte Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në atë kohë, duke e konsideruar këtë si një luftë për mbrojtjen e socializmit, të marksizëm-leninizmit, të unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Luftën kundër tezave revizioniste të Kongresit XX, PPSH në fillim e bënte në mënyrë të tërthortë. Për problemet kryesore ndërkombëtare, për çështjet themelore të revolucionit e të ndërtimit socialist ajo mbante qëndrime që ndryshonin në thelb nga qëndrimet e udhëheqjes sovjetike. Tezës mbi ndryshimin e natyrës së imperializmit në epokën e sotme ajo i kundërvinte pikëpamjen mbi pandryshueshmërinë e karakterit agresiv të tij. Tezës mbi sigurimin e paqes botërore kryesisht me anë të bisedimeve midis kryetarëve të fuqive të mëdha i kundërvinte pikëpamjen mbi sigurimin e paqes nëpërmjet bashkimit të vendeve socialiste dhe të gjithë popujve liridashës në një front të vetëm antiimperialist, me anë të luftës së popujve kundër armikut kryesor — imperializmit amerikan, nëpërmjet revolucioneve nacional-çlirimtare dhe socialiste. Tezës mbi rrugën paqësore, si rrugë kryesore për kalimin në socializëm, i kundërvinte pikëpamjen mbi përgatitjen për të dyja rrugët, sidomos për rrugën e luftës së armatosur, si rrugë kryesore

për të kaluar në socializëm. Tezës mbi shuarjen e luftës së klasave në socializëm i kundërvinte pikëpamjen mbi vazhdimin e luftës së klasave, si një fenomen objektiv dhe i pashmangshëm, për gjithë periudhën e kalimit nga kapitalizmi në komunizëm etj.

Një mënyrë kryesore për të luftuar revizionizmin ndërkombëtar, ishte lufta parimore e papajtueshme dhe e vazhdueshme që PPSH zhvillonte kundër revizionizmit jugosllav, në një kohë kur shumica e partive komuniste e punëtore, të ndikuara nga Bashkimi Sovjetik, e kishin pushuar një luftë të tillë. PPSH nuk e ndërpriste luftën kundër revizionizmit jugosllav dhe hidhte poshtë çdo presion që i bëhej për ta ndërprerë këtë luftë, jo vetëm se shikonte që titizmi vazhdonte të ishte armik i marksizëm-leninizmit dhe një rrezik për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, por edhe sepse lufta kundër tij ndihmonte shumë në luftën kundër çdo lloj revizionizmi e sidomos kundër tezave antimarksiste të Kongresit XX, kundër pikëpamjeve revizioniste, të ngjashme me ato jugosllave, që vëreheshin në fjalimet e Hrushovit dhe në materialet e ndryshme të PKBS, si edhe në materialet e një numri partish të vendeve të tjera. Në raportin e shokut Enver Hoxha mbajtur në Plenumin e KQ të PPSH në shkurt 1957, për shembull, tehu kryesor drejtohej kundër revizionizmit jugosllav. Por nuk është vështirë të nënkuptohet që goditja drejtohet kundër revizionizmit në çdo vend e në çdo parti, që tezat e raportit u kundërvihen tezave të Kongresit XX të PKBS.

Megjithëse në vjetët e parë pas Kongresit XX, PPSH luftën kundër pikëpamjeve dhe veprimtarisë revizioniste të udhëheqjes sovjetike nuk e zhvillonte drejtpërdrejt dhe hapur, të gjitha rezervat dhe kundërshtimet e veta ajo ja kishte vënë në dukje Komitetit Qendror të PKBS në rrugë partie. Nga ana tjetër, Komiteti Qendror i PPSH, kur po vërente se udhëheqja sovjetike po shkonte larg në rrugën e revizionizmit dhe po ndërhynte në mënyrë të paligjshme, krejt antimarksiste, në punët e brendshme të PPSH, vuri në dijeni me anë letrash të posaçme gjithë organizatat e Partisë, duke kritikuar pikëpamjet dhe qëndrimet revizioniste të grupit të Hrushovit. Të tilla janë letra e 9 gushtit 1960 dhe letra e 31 dhjetorit 1960.

Pikërisht të tilla letra të brendshme si edhe letra të KQ të PPSH dërguar Komitetit Qendror të PKBS janë ato që përbëjnë shumicën e dokumentave që botohen për herë të parë në këtë vëllim. PPSH përpiqej me çdo mënyrë që mosmarrëveshjet me PKBS të mos i nxirrte në shesh e të mos u jepte kështu armë armiqve të komunizmit. Ajo mendohej t'i zgjidhte mosmarrëveshjet me anë të bisedimeve e konsultimeve në frymë shoqërore, si duhet të veprohet gjithnjë në mes partive motra të klasës punëtore. Prandaj në atë kohë nuk botohej asgjë që mund të linte të kuptohej

se PPSH kishte kundërshtime ndaj tezave të Kongresit XX, ndaj qëndrimeve dhe veprimtarisë së udhëheqjes sovjetike.

Njohja e fytyrës së vërtetë tradhëtare të revizionistëve sovjetikë nga ana e PPSH erdhi gjithnjë duke u thelluar, sa më thellë e më larg shkonin Hrushovi dhe krerët e tjerë revizionistë në rrugën e rivendosjes së kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik, në rrugën e bashkëpunimit me imperializmin amerikan e me reaksionin ndërkombëtar kundër komunizmit dhe lëvizjes revolucionare botërore. Në dokumentat e këtij vëllimi vërehet se sa më tepër dilte në shesh tradhëtia e revizionistëve sovjetikë, aq më e ashpër dhe e papajtueshme bëhej lufta e PPSH kundër revizionizmit hrushovian për demaskimin dhe shkatërrimin e tij ideologjik e politik.

Në Mbledhjen e partive komuniste e punëtore që u mbajt në Moskë më 1960, delegacioni i PPSH që kryesohej nga shoku Enver Hoxha, duke zbatuar direktivën e Komitetit Qendror, i kritikoi drejtpërdrejt tezat revizioniste të Kongresit XX si edhe udhëheqjen sovjetike me Hrushovin në krye për mbrojtjen dhe përhapjen e një vargu pikëpamjesh antimarksiste, për zhvillimin e një veprimtarie fund e krye antisocialiste, antikomuniste. Njëkohësisht shoku Enver Hoxha parashtroi pikëpamjen parimore të PPSH mbi problemet kryesore që shqetësonin komunistët dhe gjithë forcat revolucionare botërore, duke mbrojtur me vendosmëri marksizëm-leninizmin, interesat e socializmit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Ky fjalim, i cili botohet gjithashtu për herë të parë, në atë kohë nuk u botua, sepse PPSH nuk donte të bëhej shkaktare që mosmarrëveshjet të dilnin jashtë lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Po për këtë arsye, Komiteti Qendror i PPSH, duke aprovuar njëzëri e plotësisht qëndrimin e delegacionit të vet në Mbledhjen e Moskës, në rezolutën e vet për këtë çështje nuk i përmendi as kritikën drejtuar në mbledhje kundër tezave revizioniste të Kongresit XX dhe kundër qëndrimeve antimarksiste të udhëheqjes sovjetike, as rezervat e kundërshtimet që shfaqti delegacioni për disa vlerësime të gabuara që hynë në Deklaratën e mbledhjes.

Dokumentat e kësaj periudhe pasqyrojnë ndeshjen midis vijës së drejtë revolucionare të PPSH dhe vijës regresive të udhëheqjes revizioniste të PKBS e të një vargu partish të tjera, ndeshjen midis ideologjisë marksiste-leniniste dhe ideologjisë borgjezo-revizioniste.

Megjithatë, kjo ndeshje në atë kohë porsa kishte filluar e s'mund të kishte atë ashpërsi dhe atë thellësi që mori më vonë, si rrjedhim logjik i ashpërsimit të luftës midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit modern në shkallë ndërkombëtare. Prandaj dokumentat e botuara duhen gërkujtuar gjithnjë me syrin e kohës dhe të rrethanave, në të cilat janë krijuar. Kjo ngjyrë e kohës në dokumentat është ruajtur e paprekur.

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

PLENUMI III I KQ TË PPSH

Tiranë, 13-16 shkurt 1957

KOMUNIKATË

Më datën 13-16 shkurt të vitit 1957 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Plenumi dëgjoi raportet:

1. — Mbi gjendjen ndërkombëtare dhe detyrat e Partisë, paraqitur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

2. — Mbi disa çështje të bujqësisë: zhvillimin e pambukut, përmirësimin e deles dhe zgjerimin e kulturës së agrumeve, paraqitur nga sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Hysni Kapo.

Plenumi, pasi diskutoi raportet e mësipërme, i aprovoi njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

PLENUMI I KQ TË PPSH

Nr. 100

NGA RAPORTI I MBAJTUR NGA SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH SHOKU ENVER HOXHA «MBI GJENDJEN NDËRKOMBËTARE DHE DETYRAT E PARTISË»

13 shkurt 1957

Shokë,

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë e çmoi të nevojshme të paraqesë në këtë plenum një raport mbi gjendjen ndërkombëtare, për arsye se kohët e fundit janë zhvilluar ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen e paqes dhe të socializmit, me luftën për forcimin dhe

mbrojtjen e unitetit të kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye dhe me mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Këto kohët e fundit forcat agresive imperialiste, reaksioni ndërkombëtar dhe elementët antimarksistë dhe revizionistë u hodhën në sulm të hapët kundër kampit të socializmit, kundër partive komuniste dhe punëtorë të vendeve kapitaliste dhe kundër popujve të Lindjes së Afërme e të Mesme. Qëllimi i imperialistëve ishte dhe është të përçajjnë kampin e socializmit dhe të mposhtin forcat kryesore që u rezistojnë planeve të tyre të luftës e të agresionit. Përppjekjet e imperialistëve pësuan disfatë kudo, por ato nuk mbetën pa influencuar në gjendjen ndërkombëtare dhe kanë shkaktuar një ngritje të re të tensionit në marrëdhënjet midis shteteve.

Duke analizuar aspektet kryesore të zhvillimit të gjendjes ndërkombëtare, ne duhet të shqyrtojmë në radhë të parë çështjet që janë të lidhura me forcimin e unitetit të kampit tonë dhe të nxjerrim konkluzionet e duhura për Partinë tonë, për të forcuar më tej unitetin e radhëve të saj, për të rritur më tej veprimtarinë e saj në luftën për mbrojtjen e interesave të popullit tonë dhe të të gjithë kampit të socializmit, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Një nga veçoritë dalluese të ngjarjeve në këto vitet e fundit është se gjendja ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe ka shënuar ecje përpara, drejt uljes së tensionit ndërkombëtar, por edhe kthesa të përkohshme, që janë refleksi i kontradiktave në shkallë ndërkombëtare midis forcave të paqes e të luftës, midis forcave të socializmit dhe të imperializmit.

Ndryshimet e mëdha në raportin e forcave midis socializmit dhe imperializmit, në dobi të socializmit, dalja e socializmit nga kuadri i një shteti të vetëm në një sistem botëror e kanë tronditur nga themelet sistemin kapitalist botëror. Realizimet madhështore të Bashkimit Sovjetik, sukseset e rëndësishme dhe të shpejta të Republikës Popullore të Kinës dhe të vendeve të tjera të kampit të socializmit kanë treguar epërsinë e pamohueshme të sistemit socialist mbi atë kapitalist.

Politika leniniste e paqes dhe e miqësisë midis popujve, politika e bashkëjetesës paqësore, e ndjekur me këmbëngulje nga vendet e kampit socialist dhe që u përgjigjet interesave jetike të të gjithë popujve, gjeti përkrahjen e shteteve dhe të forcave paqedashëse të botës. Ajo ushtroi një influencë vendimtare në luftën e popujve për paqë, kundër luftës, kundër garës së armatimeve, kundër bloqeve agresive ushtarake, kundër politikës luftënxitëse të imperialistëve, për çarmatimin, për sigurimin kolektiv, për bashkëpunimin ndërkombëtar. Në të kundërtën, politika e monopoleve imperialiste, me ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në krye, ka hyrë në kriza: politika e «luftës së ftohtë» dhe e «pozitave të

forcës» pësoi dështime të rënda. Lufta nacional-çlirimtare e popujve të shtypur i dha grushte të rënda sundimit kolonial. Brenda sistemit kapitalist u thelluan kontradiktat midis shteteve kapitaliste dhe me dobësimin e pozitave të imperializmit e me keqësimin e gjendjes ekonomike u thellua edhe lufta e klasave brenda çdo shteti kapitalist.

Kuptohet se kjo situatë nuk u pëlqente imperialistëve. Ulja e tensionit ndërkombëtar nuk pajtohet me interesat e qarqeve agresive imperialiste, të cilat bazohen në politikën e forcës dhe nxjerrin fitime kolosale nga gara e armatimeve dhe nga lufta. Në fakt ulja e tensionit ndërkombëtar nuk arrihet me dëshirën e kampit imperialist, por duhet t'i imponohet atij nga raporti i forcave, i ndryshuar në dobi të socializmit, nga forcat e kampit të socializmit, nga përppjekjet e Bashkimit Sovjetik, të Kinës dhe të vendeve të tjera të kampit të socializmit, si edhe nga përppjekjet e vendeve të pavarura kombëtare, si India, Indonezia, Egjipti, Siria etj., nga vullneti i popujve për paqen.

Qarqet më agresive të imperializmit përgjojnë për të gjetur vendin dhe çastin oportun për të kundërvepruar, me qëllim që të ndalojnë këtë proces të rrezikshëm për ta, dhe punojnë në mënyrë shumë aktive për përgatitjen e luftës kundër kampit të socializmit, kundër popujve liridashës.

Në çastin që kujtuan se ishte i përshtatshëm shtetet perëndimore filluan një ofensivë të gjerë kundër kampit të socializmit dhe me agresionin kundër Egjiptit¹ e me kundërrevolucionin në Hungari² ato kaluan në veprime të hapëta agresive. Në të njëjtën kohë forcat imperialiste dhe ato të reaksionit ndërkombëtar shpërthyen sulme të egra fashiste kundër partive komuniste e punëtorë të vendeve kapitaliste. Të tëra këto goditje ishin pjesë e një komploti të përgjithshëm të fuqive imperialiste për të çarë kampin e socializmit, për të izoluar Bashkimin Sovjetik, për të mposhtur luftën e popujve të shtypur, për të shkatërruar forcat punëtorë, me qëllim që, duke asgjësuar pengesat kryesore të politikës së tyre të luftës, t'u hapnin rrugën forcave të reaksionit e të fashizmit, të rivendosnin në këto vende regjimet koloniale dhe antipopullore, të rifitonin pozitën dhe privilegjet e humbura.

Kampit të socializmit ju desh të përballonte sulme të gjithanshme. Në këtë përppjekje forcat e imperializmit dhe të reaksionit ndërkombëtar dështuan. Ky dështim i imperializmit tregoi edhe një herë se sistemi imperialist është i dënuar nga historia, se e ardhmja i përket lirisë së popujve dhe socializmit. Por nga ana tjetër këto ngjarje dëshmojnë se imperializmi nuk heq dorë nga lufta kundër socializmit, se ai do të bëjë të gjitha përppjekjet për të zgjatur jetën e tij. Kampi i socializmit, partitë komuniste dhe punëtorë, popujt paqedashës dhe forcat përparimtare të botës do të nxjerrin mësimet të mëdha nga ngjarjet e fundit.

1. — AGRESIONI IMPERIALIST KUNDËR EGJIPTIT

Një nga karakteristikat e gjendjes së sotme ndërkombëtare është ashpërsimi i kontradiktave midis imperializmit dhe vendeve që quhen asnjësi. Siç dihet, fitorja e Bashkimit Sovjetik kundër fashizmit dhe fitorja e socializmit në Kinë, krijimi i sistemit botëror të socializmit kanë pasur një influencë shumë të madhe dhe të drejtpërdrejtë në zgjimin e popujve të shtypur e kolonialë, në ngritjen e tyre në luftë për të fituar lirinë dhe pavarësinë, kundër kolonizatorëve imperialistë. Shtetet e vendeve që janë çliruar nga zgjedha imperialiste si India, Indonezia, Birmania, Egjipti, Siria etj. janë shtete borgjeze, por nuk janë shtete imperialiste; ato ndjekin politikën e ruajtjes së pavarësisë kombëtare dhe të luftës kundër imperializmit e kolonializmit. Lufta kundër kolonializmit e imperializmit i afron këto shtete me Bashkimin Sovjetik dhe me kampin e socializmit përgjithësisht, por këto shtete s'janë socialiste, s'bëjnë pjesë në kampin socialist. Prandaj këto shtete quhen shtete të pavarura, asnjësi.

Konferenca e Bandungut e vendeve të Azisë e të Afrikës përcaktoi orientimin e tyre të përgjithshëm në marrëdhënjet ndërkombëtare: kundër kolonializmit, për ruajtjen e paqes, për bashkëjetesën paqësore dhe për bashkëpunimin midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore. Objektivist qëndrimi i tyre është kundër imperializmit. Popujt e Lindjes së Afërme e të Mesme po zgjerojnë luftën e tyre për të fituar dhe për të përforcuar pavarësinë. Kjo luftë u ka shkaktuar dëme shumë të mëdha kolonizatorëve. Shumë vende arabe janë çliruar dhe të tjerët po luftojnë për të fituar lirinë. Sistemi kolonial është në shturrje të plotë. Kolonializmi francez po jep shpirt. Tunizia dhe Maroku fituan pavarësinë e tyre, kurse Algjeria ka kohë që është në «jarr e në flakë». Populli algjerian lufton me heroizëm për të hequr qafe zgjedhën e urryer të kolonizatorëve francezë, të cilët, duke përdorur liderët e djathtë të partive socialiste franceze me Gi Molenë në krye, kanë shpërthyer atje një terror të pashembullt. Gati gjysma e ushtrisë franceze është angazhuar në Algjeri. Socialistët francezë u demaskuan plotësisht si vegla qorre të imperializmit dhe tradhëtarë të klasës punëtore franceze.

Me vendosmëri luftojnë për forcimin e pavarësisë së tyre vendet më të mëdha arabe. Duke dashur të përforcojë pavarësinë e tij, Egjipti kohët e fundit shtetëzoi shoqërinë e kanalit të Suezit, e cila përdorej nga fuqitë imperialiste si një mjet shfrytëzimi e shtypjeje kundër popullit egjiptian.

Lufta e Egjiptit dhe e popujve arabë për pavarësi u shkaktonte dëme të rënda sidomos dy prej fuqive më të mëdha kolonialiste, Anglisë dhe Francës, monopolet e të cilave po humbasin superfitimet kolosale që nxjerrin nga grabitja e pasurive të mëdha të këtyre vendeve. Mjafton të përmendim se vendet e Lindjes së

Mesme kanë tre të katërtat e sasisë së vajgurit të njohura në botën kapitaliste. Njëkohësisht duhet theksuar se vendet e Lindjes së Afërme e të Mesme kanë një rëndësi të madhe strategjike në planet e përgjithshme agresive të imperializmit. Për të gjitha këto arsye, shtetëzimi i shoqërisë së kanalit të Suezit u gjet prej imperialistëve si shkas për të filluar sulmin kundër të gjitha vendeve arabe. Dihet se sulmi i Izraelit kundër Egjiptit nuk qe gjë tjetër veçse një provokacion për të arësytuar ndërhyrjen imperialiste. Në të vërtetë janë imperialistët anglezë e francezë ata që organizuan dhe shpërthyen agresionin kundër Egjiptit, ndërsa Izraeli s'është veçse koburja në duart e imperialistëve anglo-francezë dhe, dhe në dorën e imperialistëve amerikanë sot.

Duke sulmuar Egjiptin, imperialistët anglo-francezë donin t'i hiqnin atij zotërimin e kanalit të Suezit, të mposhtnin rezistencën e Egjiptit dhe, duke mposhtur rezistencën e njërit prej popujve më të mëdhenj arabë, të demoralizonin shtetet e tjera arabe, të çelnin kështu rrugën për të zhdukur pavarësinë e tyre kombëtare dhe të rivendosnin sundimin kolonial. Sulmi kundër Egjiptit ishte hapi i parë i këtij plani.

Siç dihet, agresioni anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit dështoi.

Por imperialistët nuk heqin dorë nga planet e tyre për të rivendosur sistemin kolonialist në këto vende. Në realizimin e këtij plani, rolin kryesor, pas dështimit të Anglisë dhe të Francës, e luajnë imperialistët amerikanë. Për këtë flet qartë e ashtuquajtura «Doktrinë Ajzenhauer».³

Presidenti Ajzenhauer, në mesazhin drejtuar Kongresit, paraqiti planin e tij, me të cilin u ofron vendeve të Lindjes së Afërme e të Mesme «ndihmë ekonomike», «ndihmë ushtarake» dhe «përdorimin e forcave të armatosura amerikane» në këto vende, për t'i mbrojtur gjoja nga rreziku i «komunizmit ndërkombëtar». Në të vërtetë ky është një plan i ri për skllavërimin e popujve arabë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kohën kur me të vërtetë ishte në rrezik ekzistenca e këtyre vendeve, kur u sulmua Egjipti nga ushtritë imperialiste anglo-franko-izraelite, nuk ndërmuarën asnjë masë në mbrojtje të popullit egjiptian.

Sot, kur pozitave të dy vendeve kryesore kolonialiste: të Anglisë dhe të Francës, u dobësuan, imperializmi amerikan nuk vonoi të shkojë deri atje sa, nën maskën e ndihmës kundër një rreziku që nuk ekziston, të përgatitë ndërhyrjen ushtarake amerikane në vendet arabe. Kuptohet se qëllimi i vërtetë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk është mbrojtja e popujve arabë nga «komunizmi ndërkombëtar», por marrja nga ana e tij e pozitave sunduese ekonomike e politike në këto vende, pasi u dëbuan andej Anglia dhe Franca. Kjo politikë përbën një rrezik të madh për paqen në Lindjen e Afërme dhe në botë.

Agresioni anglo-franko-izraelit kundër Egjiptit dhe fitorja e këtij të fundit ashpërsuan kontradiktat midis popujve afrikano-aziatikë dhe imperializmit. Ata e dënuan agresionin dhe përkrahën Egjiptin. Kjo fitore rriti besimin në forcat e tyre, në çështjen e tyre të drejtë; ajo shtoi urrejtjen e tyre kundër imperializmit.

Me qëndrimin demagogjik që mbajtën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara kundër agresionit anglo-franko-izraelit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës synonin të rritnin influencën e tyre në këto vende. Por shpallja e «Doktrinës Ajzenhauer» do ta acarojë luftën e këtyre popujve kundër imperializmit, do t'i ngrejë ata edhe kundër imperializmit amerikan dhe do të shpejtojë procesin e çlirimit të tyre. Popujt arabë nuk do të lejojnë të futen nën një zgjedhë të re, sado që të mundohen imperialistët ta fshehin atë nën maskën e demagogjisë.

Rezistenca e popujve të pavarur afrikano-aziatikë kundër imperializmit gëzon përkrahjen e Bashkimit Sovjetik, të Kinës e të të gjitha vendeve të kampit socialist, si dhe të forcave paqedashëse të botës. Faktet po tregojnë gjithnjë më shumë se situata në këto vende nuk mori kursin që dëshëronin të impononin imperialistët. Lufta e tyre kundër imperializmit do të acarohet deri në asgjësimin e plotë të kolonializmit.

Miqësia në mes të popujve arabë dhe vendeve të kampit të socializmit me Bashkimin Sovjetik në krye është një fitore e shkëlqyer, që është arritur në saje të politikës paqedashëse të vendeve të kampit të socializmit.

Janë vendosur marrëdhënje miqësore në mes të shtetit tonë dhe Republikës së Indisë, të Egjiptit, të Sudanit si edhe me Sirinë, Libanin, Tunizinë etj. Më përpara, vendin tonë s'e peshonte njeri, sepse ai ishte një koloni në duart e ujqërve imperialistë. Sot opinionin i shumë vendeve afrikano-aziatike dhe udhëheqës të shquar të këtyre vendeve janë shprehur me simpati për popullin tonë. Ne mendojmë se Shqipëria u intereson në mënyrë të veçantë popujve arabë për disa arsye të posaçme, por të një rëndësie të dorës së parë, siç janë: 1) Çështja e çlirimit të popullit tonë të vogël nga zgjedha e kolonizatorëve me luftë të armatosur dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, çështje që imperialistët dhe kolonizatorët kërkojnë ta errësojnë. 2) Çështja e afirmimit të shtetit tonë të demokracisë popullore si një shtet i pavarur, sovran, shtet që tregoi qëndrueshmëri të madhe, që u rezistoi me heroizëm dhe me sukses të gjitha orvatjeve të panumërta të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre, të cilët brenda këtyre 12 vjetëve u përpoqën t'i mirrnin popullit fuqinë nga duart, por dështuan në çdo përpjekje të tyre, sepse populli luftoi me heroizëm, pse ishte vigjilent dhe pse shteti ynë kishte mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik. 3) Përparimet e mëdha të popullit tonë në ekonomi, në kulturë, në arësim, në çështjet sociale, përmirësimi i jetës së popullit dhe vrulli i pa-

ndalshëm i tij për ndërtimin e socializmit, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, Parti marksiste-leniniste, kundër së cilës janë përqëndruar bateri të mëdha të imperialistëve, të antimarksistëve, të revizionistëve, të trockistëve e të tjerë. 4) Për opinionin e vendeve arabe është interesant fakti se si në demokracinë popullore të Shqipërisë, ku popullsia në shumicën dërmuese ka qenë e besimit musliman dhe ku shumë zakone e mënyra jetese kanë qenë të ngjashme me të atyre (pse si ne dhe ata kemi vuajtur nën zgjedhën e egër të osmanllinjve shekuj me radhë), është bërë ky përparim i madh, janë zhdukur mbeturinat e këqia të së kaluarës së hidhur, është zhdukur analfabetizmi, është krijuar një industri moderne socialiste, po ndërtohet rendi socialist në fshat dhe gratë kanë hequr perçen dhe shteti, duke qenë afetar i vendosur, toleron dhe nuk prek fenë dhe ndjenjat e besimit të popullit. Të gjitha këto dhe të tjera krijojnë në opinionin përparimtar arab interesim për vendin tonë dhe njëkohësisht një dashuri e simpati të madhe për popullin tonë. Ne i kemi të gjitha mundësitë ta bëjmë tani të njohur edhe më shumë realitetin tonë shqiptar në vendet arabe etj., dhe sigurisht me forcat tona të japim dhe ne kontributin tonë modest, në çelnikosjen e miqësisë së këtyre popujve me popujt e kampit socialist. Shembulli i Shqipërisë u shërben këtyre vendeve që ta shohin se marksizëm-leninizmi është fanari ndriçues i jetës së begatshme e të lirë të popujve. Shembull për këtë është vetë ekzistenca dhe jeta e lumtur dhe e begatshme e një populli të vogël, siç është populli i vogël shqiptar, që rron i lirë, sovran, i nderuar, i respektuar dhe me të gjitha të drejtat, ashtu si edhe një shtet i madh.

2. — DËSHTIMI I KUNDËRREVOLUCIONIT FASHIST NË HUNGARI

Karakteristika kryesore e gjendjes së sotme ndërkombëtare është lufta e ashpër që po zhvillohet midis të dy kampeve, midis kampit të socializmit dhe kampit imperialist, që po humbet vazhdimisht terren, por që mban akoma pozita të forta.

Forca e kampit të socializmit është faktor kryesor dhe vendimtar për ruajtjen e paqes, pengesë kryesore për planet agresive imperialiste dhe bazë, mbështetje e patundur, e luftës së të gjithë popujve që luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e tyre, për ruajtjen e paqes e për zhvillimin paqësor të marrëdhënjëve midis shteteve. Për këto arsye qarqet sunduese të shteteve imperialiste ndjekin një politikë lufte kundër kampit socialist dhe në radhë të parë kundër Bashkimit Sovjetik.

Bloku ushtarak i Atlantikut Verior⁴, bazat ushtarake që imperialistët dhe në radhë të parë Shtetet e Bashkuara të Amerikës

kanë krijuar rreth Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera të kampit socialist, fondet prej 100 milion dollarësh që Kongresi amerikan ka caktuar çdo vit për akte diversioni në vendet tona, propaganda e shfrenuar e ndezjes së luftës kundër vendeve tona, përkrahja dhe mobilizimi i të gjithë renegatëve e tradhëtarëve të socializmit, të gjitha këto e të tjera janë shfaqje të qarta të politikës së luftës kundër kampit të socializmit.

Në mbledhjen e fundit të Këshillit të NATO-s, si metoda kryesore më e mirë dhe më e mundshme e kësaj lufte u konsiderua organizimi i punës së kundërrevolucioneve në vendet socialiste për të përçarë këto vende e për të minuar nga brenda pushtetin popullor.

Në planin e komplotit të tyre të përgjithshëm kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve socialiste, një rol të dorës së parë zinte kundërrevolucioni në Hungari, i cili kishte për qëllim të përmbyste pushtetin popullor dhe ta zëvendësonte atë me pushtetin e çifligarëve dhe të kapitalistëve, me diktaturën hortiste-fashiste.

Duke shpërthyer kundërrevolucionin në Hungari, imperialistët njëkohësisht kishin për qëllim të krijonin një vatër lufte dhe agresioni në mes të vendeve të kampit të socializmit, në kufitë e Bashkimit Sovjetik, të Çekoslovakisë e të Rumanisë dhe të përçanin vendet e kampit të socializmit, t'i shkëpusnin ato nga Bashkimi Sovjetik për t'i shkatërruar pastaj një e nga një, të përçanin lëvizjen komuniste botërore.

Ndërhyrja e imperialistëve në Hungari është faktor kryesor i kundërrevolucionit. Ata kishin organizuar me kohë banda kriminelësh, hortistësh e fashistësh të regjur, që i futën në tokën e Republikës Popullore të Hungarisë gjatë përgatitjes së kundërrevolucionit. Ata organizuan një propagandë të shfrenuar kundër Bashkimit Sovjetik, kundër kampit socialist, kundër Partisë së Punonjësve Hungarezë, kundër pushtetit popullor në Hungari. Fakte të shumta flasin shumë qartë tani për këtë ndërhyrje të tyre të hapët në Hungari.

Veprimtaria e imperialistëve gjeti mbështetje te armiqtë e brendshëm, te armiqtë e pushtetit popullor, te armiku i klasës. Forcat hortiste në Hungari kanë qenë të shumta. Armiku i klasës, i shpronësuar, por jo i zhdukur gjatë këtyre 12 vjetëve të pushtetit popullor, nuk flinte, por punonte dhe priste çastin oportun që, duke patur ndihmën e imperialistëve, të hidhej në sulm kundër Republikës Popullore të Hungarisë, për të përmbysur pushtetin e popullit dhe për të rivendosur pushtetin e tij kapitalist. Reaksioni i brendshëm mundi të ruajë forcat e tij e të organizohet edhe në konditat e ekzistencës së pushtetit popullor në Hungari, dhe pastaj të kalojë në sulme të hapëta, deri në kryengritje të armatosur, për arësye të dobësive e të mungesës së vigjilencës së udhëheqjes së mëparshme të partisë dhe të shtetit hungarez. Dihet se në fazën e

kalimit nga kapitalizmi në socializëm klasat antagonistë nuk zhduken, se armiku i klasës punon dhe përdor çdo mënyrë për të luftuar kundër pushtetit popullor. Që të shtypet armiku duhet të forcohet diktatura e proletariatit, të forcohet vigjilenca revolucionare.


Një rol të rëndësishëm në ngjarjet hungareze, në përgatitjen e shpërthimit të kundërrevolucionit luajtën elementët antimarksistë, oportunistë, tradhëtarë brenda e jashtë radhëve të Partisë së Punonjësve Hungarezë, me Imre Nagin në krye. S'është e para herë që imperializmi përdor forcat e djathta, oportunistët, deviatorët e tradhëtarët në luftën e tij kundër lëvizjes punëtore, kundër lëvizjes komuniste. Rasti i Hungarisë është një provë e re e mobilizimit të të gjitha forcave armike të socializmit në shërbim të imperializmit.

Njëkohësisht duhet theksuar se gabimet e udhëheqjes së mëparshme të partisë e të shtetit hungarez, të cilat krijuan situata jo të mira, ngjallën pakënaqësi në masat punonjëse dhe u shfrytëzuan nga kundërrevolucionarët. Mosnjohja e forcave të reaksionit dhe lëshimet që u bënë lejuan armiqtë që, nën maskën e luftës kundër gabimeve, të cilat mund dhe duhej të rregulloheshin brenda kuadrit të pushtetit popullor, të mashtrojnë masat punonjëse dhe të shpërthejnë kundërrevolucionin e përgjakshëm dhe të egër.

Por me gjithë këto, planet e armiqve dështuan. Kundërrevolucioni në Hungari u asgjësua. Duke ju përgjegjur thirrjes së qeverisë së punëtorëve dhe të fshatarëve hungarezë, Bashkimi Sovjetik e ndihmoi popullin hungarez për të dërmuar armiqtë e tij, për të shpëtuar lirinë, pavarësinë, pushtetin popullor dhe socializmin. Duke ndihmuar popullin hungarez në luftën e tij kundër armiqve imperialistë dhe armiqve të brendshëm, Bashkimi Sovjetik plotësoi një detyrë të lartë internacionaliste dhe i bëri njëkohësisht një shërbim shumë të madh gjithë çështjes së socializmit, gjithë lëvizjes komuniste botërore.

Duke i cilësuar ngjarjet hungareze ashtu siç ishin, si një kundërrevolucion të shpërthyer nga imperialistët, në bashkëpunim me armikun e klasës dhe me elementët antimarksistë e tradhëtarë të klasës punëtore, si Imre Nagi me shokë, Partia jonë mbajti një qëndrim të vendosur dhe të drejtë marksist-leninist. Vlerësimi i Partisë sonë u vërtetua plotësisht i drejtë.

Çdo vlerësim i ngjarjeve hungareze, që nuk bëhet nën prizmin e luftës së klasës, është i padrejtë, antimarksist, dëmton rëndë çështjen e socializmit, ndihmon armiqtë e socializmit, është një qëndrim armiqësor edhe kundër interesave të klasës punëtore dhe të socializmit. Përpjekjet e udhëheqjes së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe gjithë propaganda e tyre për të shpjeguar ngjarjet hungareze si një «revolucion popullor të të gjitha masave punonjëse», i shkaktuar jo nga armiqtë, por nga «sistemi politik burokratik dhe nga gabimet e klikës Rakoshi-Gero», jo vetëm nuk kanë asnjë bazë, por janë një orvatje armiqësore për të errësuar



gjendjen, për të fshehur e për të mënjanuar luftën e klasave, për të goditur sistemin e demokracisë popullore, për të mbjellë konfuzion në radhët e partive komuniste e punëtorë, për të vënë në gjumë vigjilencën e tyre kundër armiqve.

Faktet që shpjen në konkluzionin se udhëheqësit jugosllavë nuk janë të larë në kundërrevolucionin hungarez, por përkundrazi kanë përgjegjësi të madhe për zhvillimin e ngjarjeve në Hungari, janë të shumta:

a) Pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nën flamurin e luftës kundër «gabimeve të Stalinit» dhe për përhapjen e «rrugës jugosllave» si «e vetmja rrugë e drejtë për ndërtimin e socializmit», oportunistët dhe armiqtë e marksizëm-leninizmit në Hungari shpërthyen një propagandë të madhe për diskreditimin e Partisë së Punonjësve Hungarezë dhe për përçarjen e organizatave të partisë e të shtetit hungarez. Krahas kësaj u bë një fushatë e gjerë për rehabilitimin dhe për ardhjen në krye të partisë e të shtetit hungarez të Imre Nagit si një njeri i persekutuar pa të drejtë, si njeriu që duhej të udhëhiqte Hungarinë në situatën e re. Gjithë kjo fushatë u mbështet fuqimisht nga shtypi jugosllav dhe nga njerëzit jugosllavë. Shtypi jugosllav para shpërthimit të kundërrevolucionit ishte i mbushur me lajme e artikuj që bënë fjalë mbi aktivitetin e elementëve antimarksistë, mbi punën armiqësore që zhvillohej në klubin «Petef» dhe mbi gjithë punën antisovjetike, antisocialiste e revizioniste që zhvillohej në atë kohë në Hungari. Në Budapest agjentët jugosllavë kishin liri të plotë veprimi dhe me grupet e ndryshme antiparti zhvillonin një fushatë të gjerë mbi «ndërtimin specifik të socializmit në Jugosllavi», duke minuar kështu pozitën e Partisë së Punonjësve dhe të qeverisë popullore hungareze.

b) Kur shpërtheu kundërrevolucionin, udhëheqësit jugosllavë qenë të parët që e përshëndetën atë me anë të shtypit e të mesazheve të drejtpërdrejta të Titos si një revolucion popullor. Ndërsa të gjitha partitë marksiste-leniniste demaskuan hapët kundërrevolucionin dhe Nagin, shtypi jugosllav vazhdimisht e mbrojti qeverinë e Nagit. Jugosllavët kishin vendosur ushtrinë e tyre gjatë kufirit hungarez, gati për ta futur në Hungari. Siç kanë deklaruar zyrtarisht vetë, po të mos kishte ndërhyrë Ushtria Sovjetike më 4 nëntor, ata do të kishin futur ushtrinë e tyre në Hungari. Ja deri ku kishte arritur puna. Hyrja e ushtrisë jugosllave në Hungari do të kishte ndërlikuar jashtëzakonisht shumë situatën ndërkom-bëtare. Hungaria, pjesëtare e Traktatit të Varshavës, në kohën që kishte shpërthyer një kundërrevolucion fashist, do të sulmohej edhe nga një ushtri e huaj. Atëhere shteteve anëtare të Traktatit të Varshavës, duke përmbledhur dhe Ushtrinë Sovjetike që qe në Hungari, do t'u duhej ta likuidonin këtë sulm armiqësor. Vetëm

ndihma e Ushtrisë Sovjetike për shtypjen e kundërrevolucionit evitoi këtë provokacion ndërkom-bëtar.

c) Në kohën kur u dërmua kundërrevolucionin, udhëheqësit jugosllavë mbajtën një qëndrim armiqësor kundër Bashkimit Sovjetik, e dënuan ndihmën që ai u dha punonjësve hungarezë për shtypjen e kundërrevolucionit dhe e quajtën «intervencion». Imre Nagi, i cili thirri trupat imperialiste në ndihmë dhe që sigurisht kishte në plan dhe ndërhyrjen e forcave jugosllave, nën udhëheqjen e të cilit bandat fashiste vranë e varën mijëra komunistë e punëtorë, gjeti strehë në legatën jugosllave në Budapest.

Udhëheqësit jugosllavë dhe propaganda e tyre ishin me të tëra forcat kundër riorganizimit të Partisë Revolucionare të Punëtorëve e Fshatarëve, kundër forcimit të diktaturës së proletariatit. Kardeli foli hapët kundër masave të qeverisë hungareze. Ai kërkoi që pushtetin ta merrnin këshillat territoriale të punëtorëve (të mbushura me kundërrevolucionarë) dhe i ftoi udhëheqësit hungarezë të ndryshojnë rrënjësisht sistemin politik të Hungarisë. Është e qartë se, duke marrë parasysh që në Hungari gjatë vjetëve para kundërrevolucionit ndërtohej socializmi, kërkesa e Kardelit për «ndryshimin rrënjësor të sistemit politik» do të thotë vetëm likuidimi i diktaturës së proletariatit dhe rivendosja e sistemit kapitalist. Me një fjalë, qëndrimi i udhëheqjes e i shtypit jugosllav nuk mund të konsiderohet veçse si një ndërhyrje në punët e brendshme të Hungarisë, për të penguar partinë dhe qeverinë hungareze në zhdukjen e mbeturinave të kundërrevolucionit dhe në normalizimin e situatës.

Kundërrevolucionin i shkaktoi Hungarisë dëme të mëdha materiale, vështirësoi shumë gjendjen ekonomike të popullit, krijoi anarshi dhe konfuzion të madh. Partia u likuidua nga goditjet e kundërrevolucionit, nga përçarjet e brendshme të elementëve antimarksistë.

Me të gjitha forcat tona të mundshme ne duhet të ndihmojmë popullin hungarez, vëlla dhe aleat, të shërojë sa më shpejt plagët.

3. — NGJARJET NË POLONI

Edhe në Poloni, kohët e fundit, kur u rrit veprimtaria armiqësore kundër vendeve të kampit të socializmit, ngjanë gjëra të papëlqyera, të cilat krijuan një situatë të rëndë, sidoqë ato nuk u zhvilluan si në Hungari.

Forcat reaksionare, elementët e djathtë dhe oportunistë, pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, nën parullat demagogjike të luftës kundër «kultit të Stalinit» dhe «burokratizmit», «për demokratizimin e sistemit socialist», «për një rrugë të re polake», «për barazinë», «për mosndërhyrjen në punët

e brendshme», «për sovranitetin dhe independencën nga Bashkimi Sovjetik» etj., filluan një ofensivë të tërbuar për të denigruar Bashkimin Sovjetik, vetë Partinë Punëtore të Bashkuar Poloneze dhe pushtetin popullor në Poloni. Në shtypin polonez, deri edhe në organin e Komitetit Qendror «Tribuna Ludu» u lihej vend gjithnjë më tepër artikujve dhe propagandës nacionaliste borgjeze, propagandës së ideologjisë reaksionare. Më vonë gjendja u bë edhe më e rëndë, derisa reaksioni kaloi në veprime të hapëta armiqësore, në aksione të armatosura, si në Poznan⁵, dhe në akte e demonstrata antisovjetike. Elementëve nacionalistë borgjezë ju la rruga e lirë dhe ata, duke përfitur nga disa gabime të vërtetuara në marrëdhënjet e Bashkimit Sovjetik me Poloninë, të cilat duhej të ndreqeshin në rrugë normale, shpërthyen në një fushatë të egër kundër Bashkimit Sovjetik, për të prishur miqësinë e popullit polak me popullin sovjetik, për të ndarë Poloninë nga kampi i socializmit. Forcat reaksionare dhe elementët e djathtë filluan të nënvleftësojnë çdo gjë që ishte arritur në Poloni nën pushtetin popullor dhe, duke spekuluar e duke ekzagjeruar disa vështirësi ekonomike, të krijuara në Poloni gjatë kësaj periudhe, filluan një fushatë të madhe për të revizionuar vetë sistemin politik të demokracisë popullore, për ta zëvendësuar atë me një sistem të ri, që t'i përgjigjej «socializmit të ri», vijës «nacionale», «specifike» polake. Kjo punë armiqësore gjeti shesh të lirë, sepse mungonte uniteti i partisë, sepse udhëheqja ishte e përçarë nga elementët oportunistë dhe nuk mundi t'i luftojë me energji dhe vendosmëri armiqtë dhe demagogët.

Plenumi VIII⁶ i Partisë Punëtore të Bashkuar Poloneze u mbajt në një situatë ku predominonin parullat antisovjetike, oportuniste, të djathta. Në plenum u shprehën mendime e u muarën edhe disa vendime, që ne nuk na duken të drejta. Partia dhe qeveria polake mund të kenë bërë gabime (këtë e dinë shokët polakë), por ne mendojmë se këto mund të ndreqeshin në rrugë normale e jo të quhej Plenumi VIII «revolucioni polonez i tetorit», «rilindje e Polonisë» etj. Ne na duken të padrejta pikëpamjet dhe vendimet në lidhje me rolin drejtues të partisë në sistemin e diktaturës së proletariatit, në lidhje me marrëdhënjet e partisë me partitë e tjera jomarksiste, me rolin ndërkombëtar të Bashkimit Sovjetik e të eksperiencës sovjetike, me politikën agrare, me kishën katolike etj. Kjo është çështje e brendshme e Partisë Punëtore të Bashkuar Poloneze, por ne si internacionalistë themi se nuk e kemi të qartë pse u hoqën nga Byroja Politike dhe nga Sekretariati shumë shokë që mund të kishin bërë gabime praktike, por që janë revolucionarë të vjetër, besnikë të marksizëm-leninizmit e të Bashkimit Sovjetik. Këtë pyetje e bëjmë edhe për arsye se Partia jonë, kur ka marrë masa ndaj disa udhëheqësve që kishin gabuar, e ka vënë në dijeni Partinë Punëtore të Bashkuar Poloneze në shenjë miqësie dhe solidariteti internacionalist.

Duke u mbështetur në shtypin polak, ne mendojmë se pas Plenumit VIII pati shfaqje jo të drejta. U bënë aktive e konferenca partie, ku në mjaft raste rrëzoheshin shokët e vjetër punëtorë dhe zgjidheshin elementë oportunistë. Në organizatën e rinisë filluan diskutime dhe shthurje të mëdha. Gjithë udhëheqja e Bashkimeve Profesionale u hoq dhe u zëvendësua me të rinj. U larguan nga ushtria shumë oficerë të sprovuar, midis të cilëve edhe Rokosovski, dhe filluan të rehabilitohen shumë oficerë, midis të cilëve dhe oficerë të vjetër, oficerë që ishin arratisur jashtë ose që kishin shërbyer në forcat ajrore angleze (RAF). U liruan nga burgjet me dhjetëramijë vetë. U shpërndanë shumë kooperativa bujqësore. U gjallërua aktiviteti i klerit katolik dhe u lejua të jepet mësim feje në shkolla.

Partia jonë nuk ishte drejtpërdrejt e informuar se ç'po ndodhte në Poloni, por duke marrë parasysh këto gjëra, që merrnim vesh nga shtypi zyrtar polak, ne mbajmë një qëndrim të rezervuar, por të drejtë për këto ngjarje, qëndrim që mund të mos u ketë pëlqyer shokëve polakë. Çështjet që ne s'na u dukën të drejta, në kundërshtim me marksizëm-leninizmin dhe me unitetin e kampit të socializmit ja thamë haptas Partisë dhe mendojmë se bëmë shumë mirë dhe kështu do të veprojmë kurdoherë.

Kohët e fundit situata ka bërë disa përmirësime, por megjithkëtë ne mendojmë se ka ende mjaft gjëra të paqarta. Gomulka ka thënë se në parti tani ka 3 rryma: ata që janë me Plenumin VIII, «konservatorët» dhe revizionistët, të cilët mbajnë ende pozita të forta në parti. Në shtypin polak vazhdojnë të dalin pikëpamje jo të drejta, antimarksiste e antisovjetike. Ne mendojmë se shokët polakë nuk e çmojnë drejt nevojën e forcimit të diktaturës së proletariatit në situatën e sotme dhe nuk po bëjnë luftë të vendosur kundër reaksionit e ideologjisë së huaj. Siç e tregon edhe shypi i tyre, ata janë për një qëndrim më të butë ndaj imperializmit, kanë rezerva në lidhje me vlerësimin e rolit ndërkombëtar të Bashkimit Sovjetik e të eksperiencës sovjetike. Udhëheqësit polakë ngulmojnë për «rrugën specifike polake të ndërtimit të socializmit». Deri sot Partia e Bashkuar Punëtore Polake nuk ka mbajtur asnjë qëndrim kundër devijimeve serioze oportuniste, revizioniste dhe antimarksiste të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Përsa u përket shkaqeve të ngjarjeve hungareze, shokët polakë s'janë dakord me pikëpamjen se imperializmi është shkaktari i tyre kryesor. Përpjekjet e udhëheqësve polakë për të siguruar ndihma nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga imperialistët e tjerë ne na duken veprime të dyshimta dhe shumë të rrezikshme, pavarësisht në se shteti polonez ka apo s'ka aq nevojë për këto ndihma nga amerikanët, të cilët kanë për qëllim vetëm t'i shkatërrojnë dhe t'i skllavërojnë vendet tona socialiste.

Ne shpresojmë se gjendja në Poloni do të shkojë drejt përmirësimit më të madh të saj, se klasa punëtore dhe Partia Punëtore e Bashkuar Poloneze do t'i kapërcejnë këto vështirësi. Ne, në frymën e internacionalizmit proletar, duhet të punojmë, si të gjitha partitë marksiste-leniniste, që të ndihmojmë në përmirësimin e gjendjes në Poloni, në forcimin e pozitave të marksizëm-leninizmit, për të forcuar unitetin e kampit tonë me Bashkimin Sovjetik në krye. Ne do ta ruajmë miqësinë me popullin vëlla polonez, ne do t'i forcojmë lidhjet shoqërore dhe internacionaliste me partinë poloneze dhe sinqeriteti e guximi leninist nuk do të na mungojnë t'ua themi haptas shokëve polonezë çështjet që nuk na bindin dhe nuk i gjejmë të drejta, ashtu sikundër edhe ata mund të na bëjnë vërejtje neve, kur ta shohin të nevojshme.

4. — LUFTA IDEOLOGJIKE DHE SULMET FASHISTE KUNDËR PARTIVE KOMUNISTE TË VENDEVE KAPITALISTE

Bashkë me ofensivën e tyre kundër kampit të socializmit, imperializmi dhe reaksioni ndërkombëtar shpërthyen sulme të egra kundër partive komuniste dhe punëtore të vendeve kapitaliste. Armiqtë përdorën të gjitha metodat e mundshme që nga shfrytëzimi i ngjarjeve hungareze deri te organizimi i grupeve fashiste të sulmit. Partitë komuniste e punëtore të vendeve kapitaliste qëndruan me guxim para sulmeve të armikut dhe vazhdojnë të mbrojnë me vendosmëri interesat e klasës punëtore dhe marksizëm-leninizmin. Por ndërsa propaganda e shfrenuar e reaksionit kundër Bashkimit Sovjetik, kundër ndihmës që ai i dha popullit hungarez dhe sulmet e vagabondëve fashistë nuk mund të lëkundin partitë komuniste e punëtore, ato mundën të influencojnë e të tronditin disa elementë në rrethet e miqve të partisë, në radhët e socialistëve të majtë, bile edhe disa komunistë. Këta ishin përgjithësisht intelektualë jo të qëndrueshëm dhe jo të lidhur ngushtë me çështjen e klasës punëtore, me çështjen e socializmit.

Sidomos të egra qenë sulmet e armikut kundër Partisë Komuniste Franceze. I tërë reaksioni francez u turr me urrejtje kundër saj, duke organizuar edhe goditje me anë të grupeve fashiste, sepse te Partia Komuniste Franceze ata shikojnë një pengesë shumë të madhe për qëllimet e tyre. Partia Komuniste Franceze me qëndrimin e saj i theu përpjekjet e armiqve dhe vazhdon të mbrojë me besnikëri marksizëm-leninizmin, çështjen e klasës punëtore, miqësinë me Bashkimin Sovjetik, çështjen e socializmit. Kjo i ka egërsuar shumë armiqtë, të cilët kohët e fundit, duke u përpjekur të shpërthejnë një fushatë të re antikomuniste, kanë arritur sa të propozojnë në parlamentin francez shpërndarjen e Partisë Komuniste Franceze dhe një sërë ligjesh nga më reaksionaret që kanë

pasë ekzistuar në kohën e fashizmit. Por Partia Komuniste Franceze, në krye të klasës punëtore, dhe të gjitha forcat demokratike nuk do të lejojnë një akt të tillë. Partia Komuniste Franceze do të dijë të luftojë me kurajo dhe do të bëjë që të dështojnë edhe këto provokacione të reja fashiste. Partia jonë ka një simpati të thellë për Partinë Komuniste Franceze dhe u ka shprehur shokëve francezë ndjenjat e solidaritetit për luftën e tyre heroike.

Elementët antimarksistë, së bashku me reaksionin dhe imperialistët, shpërthyen një ofensivë edhe kundër Partisë Komuniste Italiane. Pas Kongresit XX, kur imperialistët dhe gjithë armiqtë e socializmit u përpoqën të shfrytëzojnë kritikën që ju bënë J. Stalinin për të goditur marksizëm-leninizmin dhe partitë komuniste, pati elementë të lëkundshëm në Partinë Komuniste Italiane, që dualën nga binarët, zhvilluan aktivitet kundër partisë, përhapën «teoritë» antimarksiste dhe pikëpamje armiqësore kundër Bashkimit Sovjetik e vendeve socialiste, popullarizuan socializmin «specifik» jugosllav. Disa nga elementët revizionistë e armiq muarën pjesë si delegatë në Kongresin VIII⁷ të Partisë Komuniste Italiane dhe atje vollën vrer kundër marksizëm-leninizmit, Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Ndaj këtyre elementëve u mbajt një qëndrim hezitues dhe kjo patjetër dëmtoi.

Siç e dini nga shtypi, për fat të keq vetë shoku Toliati, megjithëse është një udhëheqës revolucionar i njohur, ka shprehur disa pikëpamje jo të drejta. Në intervistën e tij dhënë në qershor 1956 revistës «Nuovi Argumenti» ai ka shprehur pikëpamjen se «sistemi socialist ka degjeneruar». Po në këtë intervistë shoku Toliati ka shprehur pikëpamje jo të drejta në lidhje me rolin ndërkombëtar të Bashkimit Sovjetik dhe me rëndësinë universale të eksperiencës sovjetike; ai ka thënë se sot është objektivisht e pamundur të ketë një qendër të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe se kjo lëvizje duhet të ketë karakter policentrik. Në Kongresin VIII të Partisë Komuniste Italiane shoku Toliati shprehu pikëpamje jo të drejta në lidhje me atë që ai e quan «imitim servil të eksperiencës sovjetike nga vendet e demokracisë popullore», dhe përgjithësisht në lidhje me gjendjen në vendet e demokracisë popullore. Në intervistën e qershorit Toliati ka shprehur pikëpamje jo të drejta edhe në lidhje me rolin udhëheqës të klasës punëtore, bile dhe në Rezolucionin e Kongresit VIII, ku flitet për forcat lëvizëse të revolucionit, nuk përmendet roli udhëheqës i klasës punëtore. Ne gjithashtu nuk na duket i drejtë qëndrimi i shokëve italianë në lidhje me pikëpamjet antimarksiste të udhëheqjes jugosllave. Në Kongresin VIII këto pikëpamje të rrezikshme revizioniste e antimarksiste nuk u dënuan haptas, bile Luixhi Longo, një nga udhëheqësit kryesorë të Partisë Komuniste Italiane, në dhjetor të 1956-s, pas gjithë atyre gjërave që ngjanë, shkroi një

artikull të gjatë për eksperiencën jugosllave. Ne këto i themi, shokë, se na duken jo të drejta dhe shpresojmë se shokët italianë do ta forcojnë partinë e tyre në rrugën marksiste-leniniste.

* * *

Nga çështjet që u ngritën arrijmë në konkluzionin se veprimtaria e imperialistëve, agresioni kundër Egjiptit, kundërrevolucionit në Hungari, tentativa në Poloni, sulmi kundër partive komuniste dhe punëtore të vendeve kapitaliste etj. tregojnë se imperializmi nuk ka hequr dorë nga përgatitja e një lufte të re. Në radhë të parë planet e tij agresive drejtohen kundër kampit tonë të socializmit. Armiqtë e socializmit, armiqtë e vendeve tona përfitojnë nga çdo dobësim i vigjilencës, nga çdo dobësim i pushtetit popullor, nga çdo e çarë, sado e vogël, e unitetit të kampit tonë. Prandaj detyra jonë është të forcojmë vigjilencën revolucionare, të forcojmë unitetin e kampit tonë me Bashkimin Sovjetik në krye.

Shokë,

Mendoj se është e nevojshme të ndalemi në disa çështje kryesore që dalin nga analiza e zhvillimit të ngjarjeve ndërkombëtare të kohëve të fundit.

I. — MBI UNITETIN E KAMPIT SOCIALIST

Ngjarjet e fundit në arenën ndërkombëtare karakterizohen nga një sulm i gjithanshëm i reaksionit imperialist dhe i gjithë elementëve revizionistë e antimarksistë kundër unitetit të vendeve të kampit të socializmit dhe përgjithësisht kundër solidaritetit të lëvizjes komuniste e punëtore botërore. Armiqtë ndjekin taktikën e vjetër të imperializmit «përça e sundo». Udhëheqja jugosllave ka marrë flamurin e përçarjes së lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të revizionimit të marksizëm-leninizmit nën parullën e përmbysjes së «stalinizmit» e të «stalinistëve».

1. — Roli ndërkombëtar i Bashkimit Sovjetik dhe i eksperiencës sovjetike

Për të përçarë kampin e socializmit dhe lëvizjen komuniste botërore, imperialistët dhe revizionistët përpiqen, në radhë të parë, që të izolojnë Bashkimin Sovjetik, duke mohuar rolin e tij ndërkombëtar dhe duke e diskredituar atë.

Roli udhëheqës i Bashkimit Sovjetik në të gjithë lëvizjen komuniste është përcaktuar nga konditat historike, ky është një fakt objektiv.

a) Ky rol udhëheqës në radhë të parë lind nga kuptimi i Revolucionit socialist të Tetorit dhe nga rëndësia e tij ndërkombëtare.

E para, dihet se Revolucioni i Tetorit shënoi një kthesë në historinë e njerëzimit. I pari në histori ai vendosi diktaturën e proletariatis dhe i dha një hov të madh lëvizjes revolucionare të proletariatis botëror. Që nga Revolucioni i Tetorit proletarët e shumë vendeve të tjera në shembullin e punëtorëve rusë dhe me ndihmën e përkrahjen e tyre thyen zinxhirët e kapitalit dhe sot sistemi socialist përmbledh afro njëmiliard njerëz.

E dyta, Revolucioni socialist i Tetorit që fillimi i krizës së sistemit kolonial. Dyzet vjet pas Revolucionit të Tetorit një popullsi prej afro një miliard e gjysmë njerëz të vendeve koloniale e gjysmë-koloniale është çliruar, sistemi kolonial është në shturje të plotë.

E treta, Revolucioni socialist i Tetorit ishte njëkohësisht edhe një revolucion në ideologji, sepse ai i dha fund njëherë e përgjithmonë sundimit ideologjik të Internacionales së dytë, shënoi fitoren e marksizmit revolucionar në lëvizjen punëtore ndërkombëtare.

b) Roli udhëheqës i Bashkimit Sovjetik në lëvizjen socialiste ndërkombëtare është bërë realitet historik edhe nga vetë karakteri universal që ka eksperiencia sovjetike. Fakti që Bashkimi Sovjetik nga një vend i prapambetur, që ishte para revolucionit, është kthyer tani në një vend të fuqishëm industrial e me kulturë shumë të zhvilluar, fakti që Bashkimi Sovjetik mundi të korrë një fitore të madhe historike botërore, siç ishte fitorja e tij mbi Gjermaninë fashiste dhe Japoninë militariste në Luftën e dytë botërore, vërtetojnë se eksperiencia e Bashkimit Sovjetik, rruga e ndjekur nga ai janë të drejta dhe kanë një rëndësi universale për të gjithë. Eksperiencia e Bashkimit Sovjetik është jo vetëm shembulli i parë, por shembulli më i shkëlqyer i zbatimit të marksizëm-leninizmit. Por, siç kanë bërë vazhdimisht armiqtë e marksizëm-leninizmit, ashtu edhe tani revizionistët e rinj, në radhë të parë udhëheqësit jugosllavë, përpiqen me çdo mënyrë të mohojnë karakterin universal të eksperiencës sovjetike. Në këtë drejtim spekulohet shumë me kushtet specifike të çdo vendi, me «komunizmin nacional». Asnjë marksist nuk pretendon se çdo gjë e eksperiencës sovjetike duhet të zbatohet në mënyrë shabllone dhe absolutisht kudo; megjithatë çështjet themelore të eksperiencës sovjetike kanë karakter universal. Praktika e lëvizjes komuniste botërore dhe e ndërtimit socialist në vendet e demokracisë popullore vërteton fjalët e Vladimir Iliç Leninit se

«disa tipare kryesore të revolucionit tonë nuk kanë një rëndësi lokale, të veçantë nacionale, vetëm ruse, por një rëndësi ndërkombëtare»⁸.

Udhëheqja jugosllave krahas me mohimin e karakterit universal të eksperiencës sovjetike përpiqet të diskreditojë këtë ekspe-

riencë dhe paraqet «eksperiencën e socializmit jugosllav» si rru-
gën e vetme të drejtë dhe bile të domosdoshme për të gjitha vendet.

c) Bashkimi Sovjetik është sot fuqi e madhe ekonomike e ush-
tarake dhe me autoritet të madh ndërkombëtar. Ai është vendi që
në kampin e socializmit ka mundësi të ndihmojë më shumë si me
eksperiencën e tij, ashtu dhe me mundësitë e tij materiale të gji-
tha vendet socialiste, bile edhe vendet që po çlirohen nga zgjedha
koloniale. Ky rol i Bashkimit Sovjetik është rezultat i natyrshëm
objektiv i zhvillimit historik. Ai s'është vendim arbitrar i «stali-
nistëve» dhe as mund t'i vihet kryqi për hatër të dëshirës së re-
vizionistëve. Këtë rol të Bashkimit Sovjetik e njohin gjithë partitë
marksiste-leniniste, çdo komunist. Në artikullin «Përsëri mbi ekspe-
riencën historike të diktaturës së proletariatit» të organit të Ko-
mitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës «Zhenminzhibao»
thuhet:

«Në interes të çështjes së përbashkët të proletariatit
të vendeve të ndryshme, të rezistencës së përbashkët
ndaj sulmit kundër çështjes së socializmit nga ana e
kampit imperialist, të kryesuar nga Shtetet e Bash-
kuara, dhe të hovit ekonomik e kultural të përbash-
kët për të gjitha vendet socialiste, ne duhet të vazh-
dojmë të forcojmë solidaritetin proletar ndërkombëtar
me Bashkimin Sovjetik si qendër të tij»⁹.

Gjithashtu Partia jonë, që në lindjen e saj, e ka parë drejt
këtë çështje themelore dhe e ka rrënjosur thellë në zemrën e ko-
munistëve e të popullit të vet.

2. — Mbi marrëdhënjet midis vendeve socialiste, midis partive marksiste-leniniste dhe mbi internacionalizmin proletar.

Imperialistët dhe revizionistët e marksizëm-leninizmit kanë
shpërthyer një fushatë të shfrenuar shpifjesh kundër marrëdhënje-
ve të vendeve socialiste dhe partive komuniste me Bashkimin Sovje-
tik. Si imperialistët, ashtu edhe elementët oportunistë akuzuan
Bashkimin Sovjetik se gjoja kishte vendosur marrëdhënje jo të
drejta me vendet socialiste, se gjoja i kishte skllavëruar këto vende
dhe, si rezultat, ato kishin humbur pavarësinë e tyre. Ata në më-
nyrë sistematike nxitën ndjenjat nacionaliste dhe antisovjetike.
Ata hodhën parulla demagogjike që të fitohej «indipendenca» ndaj
Bashkimit Sovjetik, të vendosej «sovrانيتeti» i vendit etj. Udhë-
heqja jugosllave arriti deri atje sa që Josif Broz Tito në fjalimin
që mbajti në Pula deklaroi se shkaku kryesor që provokoi ngjarjet
kundërrevolucionare në Hungari qenë marrëdhënjet jo të drejta
që ishin vendosur midis Bashkimit Sovjetik dhe Hungarisë. Pra, si-

pas Titos, përgjegjësia bie jo mbi imperializmin, po mbi Bashkimin
Sovjetik.

Por dihet, shokë, se marrëdhënjet e vendeve socialiste me
Bashkimin Sovjetik janë marrëdhënje të një tipi të ri, që nuk
janë parë në histori. Edhe marrëdhënjet tona me Bashkimin Sovje-
tik mbështeten mbi parimet leniniste të barazisë së plotë të të dy
palëve, të ndihmës shoqërore reciproke, të respektimit të sovra-
nitetit kombëtar dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme, mbi
parimet e internacionalizmit proletar, mbi parimet e marksizëm-
leninizmit.

Vendi ynë, që është vendi më i vogël i kampit të socializmit,
më mirë se kushdo tjetër dëshmon për drejtësinë e marrëdhënjeve
që kanë ekzistuar midis vendeve socialiste. Partia jonë ka dekla-
ruar se marrëdhënjet tona me Bashkimin Sovjetik kanë qenë të
drejta. Përkundrazi imperialistët dhe udhëheqësit jugosllavë, që na
kanë «këshilluar» të çliroheshim nga Bashkimi Sovjetik, janë
sjellë ndaj vendit tonë si shovinistë, si kolonizatorë e si armiq.

Miqësia e singertë e popullit tonë me Bashkimin Sovjetik,
ndihma e tij vëllazërore, që i ka dhënë Shqipërisë, jo vetëm që e
kanë ndryshuar faqen e vendit tonë nga ana ekonomike dhe kul-
turale, por kanë forcuar besimin e popullit tonë në forcat e veta,
kanë forcuar pavarësinë dhe sovranitetin e atdheut tonë. Në ditët
e rënda dhe të vështira të pasluftës, kur vendi dhe populli ynë
ishin në mjerim, pa bukën e gojës dhe pa veshje në trup, dhe kur
pavarësia dhe sovraniteti i atdheut, të fituara me aq gjak dhe sakri-
fica, kërcënoheshin nga jugosllavët, shokët e Komitetit Qendror të
Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe J.V. Stalini u thanë
delegatëve të Komitetit Qendror të Partisë sonë se «çdo gjë do të
kapërcehet, ne do t'ju ndihmojmë të ndërtoni industrinë tuaj, të
mëkëmbni bujqësinë, të zhvilloni arësimin dhe kulturën kombë-
tare». Ata na thanë «duhet të krijoni kuadrot tuaj nacionalë, dhe
keni parasysh se specialistët që ne do t'ju dërgojmë, duhet të
kthehen shpejt. Shqipëria duhet të ecë me këmbët e veta». Vull-
neti i Partisë dhe i popullit dhe ndihma vëllazërore e Bashkimit
Sovjetik u bënë realitet. U ngritën kombinatet e fabrika, u hapën
shkolla e institute, u ndërtuan hekurudha e u organizuan SMT,
ndërmarrje transporti etj. Shumë kuadro të talentuar sovjetikë i
erdhën popullit tonë në ndihmë dhe mësuan kuadrot tanë. Sot,
me mijëra kuadro të vendit drejtojnë kombinatet, fabrikat, minie-
rat, shkollat e institutet. Këshilla e Partisë Bolshevike u vu në
vend. Eksperienca e Bashkimit Sovjetik ka udhëhequr kurdoherë
njerëzit tanë. Ne do të përfitojmë nga çdo eksperiencë e mirë e ven-
deve të tjera.

Udhëheqësit jugosllavë kanë deklaruar se Jugosllavia është
i pari vend që ka mundur të vendosë marrëdhënje të «drejta» me
Bashkimin Sovjetik e se këto marrëdhënje janë «modeli» që du-

het të ndiqet edhe nga vendet e tjera, në qoftë se nuk duam t'u japim shkas «turbullirave» të tilla si ato të Hungarisë. Partia jonë, si dhe i gjithë populli ynë i kanë hedhur poshtë këto «këshilla», sepse këto në fakt kërkonin të na shkëputnin nga Bashkimi Sovjetik e nga kampi i socializmit, ashtu siç është shkëputur Jugosllavia.

Dihet se imperialistët, të cilët kanë krijuar një sistem të tërë paktesh, bloqesh e aleancash ndërkombëtare si NATO, SEATO, Pakti i Bagdatit etj., janë shumë të interesuar për të përçarë kampin e socializmit, me qëllim që të realizojnë më lehtë planet e tyre. Për këto arsye, detyrë jetike për Partinë tonë është forcimi i unitetit të kampit socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, forcimi i fuqisë ekonomike e ushtarake të këtij kampi, forcimi i Traktatit të Varshavës.

Jugosllavia, megjithëse thotë se është kundër bloqeve, është pjesëtare e Paktit të Ballkanit, dhe nëpërmjet Greqisë dhe Turqisë lidhet me paktet agresive të NATO-s dhe me atë të Bagdatit. Me një fjalë udhëheqësit jugosllavë na këshillojnë që të çarmatosemi.

Lenini i madh na mëson se format e lidhjeve dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar midis partive komuniste e punëtore ndryshojnë sipas kushteve historike, sipas gjendjes dhe detyrave të reja që dalin para lëvizjes punëtore ndërkombëtare. Në kushtet e sotme është e domosdoshme që lidhjet dhe bashkëpunimi midis partive komuniste e punëtore të forcohen edhe më shumë, duke u gjetur rrugët dhe format më të përshtatshme. Partitë tona tani preokupohen dhe mendojnë për gjetjen e këtyre formave që të sigurojnë një bashkëpunim e koordinim sa më të ngushtë e efektiv. Nga ana e tyre udhëheqësit jugosllavë kanë ngritur një «sistem të tërë teorik» për të «vërtetuar» se partitë komuniste duhet të jetojnë të përçara dhe secila të punojë më kokë të vet.

E gjithë kjo, po ta shohim të lidhur me teoritë dhe me pretendimet e tyre për «rolin e madh ndërkombëtar të Jugosllavisë» dhe të «rrugës jugosllave të socializmit», do të thotë: tani për tani të shkëputen partitë komuniste nga lidhjet internacionaliste me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e të fillojnë lidhjet me Jugosllavinë dhe pastaj të ngrënë ndërkombëtares me Titon në krye. Këto pikëpamje janë në kundërshtim me internacionalizmin proletar dhe kanë për qëllim të përçajnë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Detyra e Partisë sonë, ashtu si e gjithë partive motra, është të luftojmë kundër këtyre pikëpamjeve, si edhe kundër të gjitha përpjekjeve të armiqve për të përçarë kampin e socializmit, detyra jonë është të luftojmë me të gjitha forcat për të çelënikosur unitetin e vendeve socialiste dhe të partive komuniste e punëtore motra. Te uniteti qëndron forca jonë.

II. — MBI NEVOJËN E LUFTËS IDEOLOGJIKE PËR MBROJTJEN E MARKSIZËM-LENINIZMIT NGA ORVATJET E OPORTUNISTËVE DHE TË REVIZIONISTËVE

Ofensiva që ka shpërthyer kundër ideologjisë marksiste-leniniste zhvillohet paralelisht (në mos e koordinuar) nga forcat e imperializmit e të reaksionit, si edhe nga elementët oportunistë e revizionistë me udhëheqësit jugosllavë në krye. Qëllimi i tyre është të shturin radhët e partive komuniste dhe të devijojnë ato nga rruga e drejtë, të përçajnë vendet socialiste dhe partitë komuniste, ta diskreditojnë marksizëm-leninizmin dhe t'ja heqin klasës punëtore këtë busull, këtë armë të domosdoshme për ndërtimin e socializmit. Karakteristika e kësaj lufte është se ajo zhvillohet me parulla «të majta», ajo zhvillohet nën flamurin e revizionimit të marksizëm-leninizmit. Revizionizmi në lëvizjen punëtore lindi atëhere kur marksizmi siguroi fitoren e plotë teorike mbi armiqtë e tij të hapët dhe prandaj këta filluan të luftojnë kundër marksizmit, të maskuar me petkun e marksizmit, nën flamurin e marksizmit. Duke folur për esencën e revizionizmit, Lenini thotë se ai përpiqet ta kthejë marksizmin në një ikonë të shenjtë,

«merr nga marksizmi gjithshka që është e pranueshme për borgjezinë liberale, deri luftën për reforma, deri luftën e klasave (pa diktaturën e proletariatit), deri njohjen e «përgjithshme» të «idealeve socialiste» dhe zëvendësimin e kapitalizmit me «rendin e ri» dhe hedh poshtë «vetëm» shpirtin e gjallë të marksizmit, «vetëm» revolucionizmin e tij»¹⁰.

Këtë flamur të revizionimit të marksizëm-leninizmit e kanë marrë sot udhëheqësit jugosllavë dhe prandaj imperialistët i konsiderojnë ata si një mjet kryesor për të luftuar komunizmin. Në mbledhjen e fundit të Këshillit të NATOS-s, ministri i punëve të jashtme të Republikës Federale Gjermane, Fon Brentano, shtroi që NATO-ja të përkrahte zhvillimin e «titizmit në vendet e demokracisë popullore», sepse, sipas tij, «kjo metodë është më e frytshme se sa nxitja direkte e kryengritjeve». Të gjitha radiot e Perëndimit vazhdimisht u bëjnë thirrje popujve të kampit të socializmit të përmbysin udhëheqësit e partisë e të shtetit dhe t'i zëvendësojnë me elementë «antistalinistë», që të heqin dorë nga ndërtimi i socializmit «stalinian» dhe të përqafojnë rrugën e socializmit «nacional e specifik» jugosllav. Armiqtë dërgojnë proklamata të firmuara nga kriminelin fashist Sadik Premtja (që tani quhet shefi i seksionit shqiptar të Internacionales IV komuniste), ku i bëhet thirrje popullit tonë të përmbysë socializmin «burokrtik» dhe të ndjekë rrugën e Titos e të Imre Nagit.

Udhëheqësit jugosllavë i paraqesin «teoritë e tyre» si një «zbulim të madh» në shërbim të lëvizjes punëtore e të mbarë njerëzimit, por objektivisht «teoritë» dhe veprimet e tyre i shërbejnë imperializmit për të luftuar marksizëm-leninizmin, partitë komuniste e kampin e socializmit.

Udhëheqësit jugosllavë i paraqesin «teoritë» e tyre si fjalën e re të fundit të marksizmit, por në fakt «sistemi i tyre teorik» është një përzierje e teorive të kalbura të rrymave të ndryshme antimarksiste, duke filluar nga anarkizmi i Prudonit e i Bakuninit dhe duke mbaruar me Trockin, Buharinin e «opozitën punëtore».

Lufta për revizionimin e marksizëm-leninizmit maskohet tani nën tri parulla kryesore demagogjike:

1) Spekullohet shumë me tezën e drejtë marksiste-leniniste për zhvillimin krijues të marksizëm-leninizmit dhe për luftën kundër dogmatizmit.

2) Marksistë-leninistët e kuptojnë zhvillimin krijues të marksizëm-leninizmit jo si mohim të bazave të tij, por si pasurim të kësaj teorie me konkluzione e teza të reja të nxjerra nga eksperiencia e luftës së klasës punëtore dhe nga zhvillimi i shkencave. Kurse revizionistët, siç do ta shohim dhe më poshtë, mohojnë bazat kryesore të teorisë marksiste-leniniste si p.sh. luftën e klasave, diktaturën e proletariatit, rolin udhëheqës të partisë etj. Por marksizmi është shkencë dhe ligjet objektive të zbuluara prej tij janë të vërteta absolute, si edhe ligjet e zbuluara nga kimia, fizika etj. Prandaj ato s'mund të vjetërohen ose të rrëzohen. Megjithatë Vllahoviçi, anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, e quan marksizmin si «teori të Marksit të vjetër» dhe gazeta «Borba» shkruan se përveç «stalinizmit» ekziston edhe rreziku i «leninizmit dogmatik», të vjetëruar.

3) Spekullohet shumë dhe me tezën e drejtë marksiste-leniniste se marksizmi duhet të zbatohet në mënyrë krijuese në konditat e veçanta të çdo vendi.

Marksizëm-leninizmi mëson se me gjithë bashkësinë e tipareve e ligjeve të përgjithshme kryesore, format, metodat dhe ritmet e kalimit në socializëm të vendeve të ndryshme mundet të kenë ndryshime të kushtëzuara nga konditat konkrete të zhvillimit të tyre. Duke u kapur pas kësaj, revizionistët, nën parullat e «socializmit specifik e nacional», bëjnë përpjekje për të na larguar nga rruga e përgjithshme marksiste-leniniste e ndërtimit të socializmit dhe nga eksperiencia e Bashkimit Sovjetik. Marksizmi mëson se çështjet themelore të ndërtimit të socializmit janë të përbashkëta, se ligjet e zhvillimit të shoqërisë nuk kanë kufi nacionalë. Eksperiencia historike tregojnë se çështje të tilla të përbashkëta janë: diktatura e proletariatit, domethënë vendosja e pushtetit politik të klasës punëtore, nën udhëheqjen e partisë marksiste-leniniste, forcimi me çdo mënyrë i aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë

dhe me shtresat e tjera punonjëse, likuidimi i pronës kapitaliste dhe vendosja e pronës shoqërore mbi mjetet kryesore të prodhimit, organizimi socialist i bujqësisë, zhvillimi i planifikuar i ekonomisë, udhëheqja nga teoria revolucionare marksiste-leniniste, mbrojtja me vendosmëri e fitoreve të revolucionit socialist nga atentatet e ish-klasave shfrytëzuese dhe nga shtetet imperialiste. Rruga e përgjithshme e ndërtimit të socializmit është rruga kryesore, është, si të thuash, bulevardi. Specifikat e këtij ose të atij vendi janë si rrugicat që i ngjiten këtij bulevardi. Të mos ndjekësh këtë rrugë kryesore, rrugën e përgjithshme marksiste-leniniste do të thotë të futesh në qorrrokak. Këtë e vërteton edhe eksperiencia e Jugosllavisë.

Është e qartë se «komunizmin nacional» armiqtë e klasës punëtore e shohin si levën më kryesore, me anë të së cilës do të donin të nxirrnin nga binarët vendet socialiste dhe partitë komuniste dhe kështu ta kthenin prapsht rrotën e historisë...

3) Gjithë fushata e tërbuar që kanë shpërthyer imperialistët dhe revizionistët kundër marksizëm-leninizmit, kundër komunizmit, bëhet nën maskën e luftës kundër «stalinizmit». Menjëherë pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik armiqtë i frynë pa masë «gabimet» e Stalinin dhe i trumbetuan nga të katër anët për të diskredituar shtetet socialiste, partitë komuniste dhe udhëheqësit e tyre, për të mbjellë konfuzion ideologjik e përçarje në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Nën presionin e kësaj fushate elementët oportunistë e të lëkundshëm ngritën krye kudo dhe filluan të punojnë me zell kundër partive politike me parulla false e antimarksiste (si «demokratizimi», «destalinizimi», «independenca», «mirëqenja e popullit», etj.) për të luftuar udhëheqjet marksiste-leniniste të partive dhe vijën e tyre të drejtë. Partia jonë para kësaj situatë veprimi drejt. Ajo mori masa për të luftuar elementët që nën flamurin e luftës së «kultit të individit» dëshëronin të nxirrnin Partinë nga binarët.

Në dritën e ngjarjeve të fundit u vërtetuan edhe një herë sa me vend kanë qenë qëndrimet e Komitetit Qendror të Partisë, që u aprovuan njëzëri nga Kongresi III në lidhje me luftën e drejtë që u është bërë elementëve të ndryshëm oportunistë, trockistë, revizionistë dhe tradhëtarë, të cilët në veprimtarinë e tyre të hapët apo të maskuar ishin përpjekur të nxirrnin Partinë tonë nga rruga e marksizëm-leninizmit, të goditnin në zemër Partinë dhe diktaturën e proletariatit, për t'i hapur kështu rrugën vendosjes së kapitalizmit dhe zgjedhës imperialiste. Këtu synonin planet e armiqve të Partisë, të Tuk Jakovës e të Bedri Spahiut, prekursorët e armiqve të tjerë që ngritën veshët në konferencën e Tiranës¹¹ e që ushqeheshin, në veprën e tyre tradhëtare, nga burimi i legatës jugosllave. Zhvillimi i hidhur i situatës në Hungari, ku shpërtheu

kundërrevolucionari, vërtetoi plotësisht drejtësinë e vijës së Partisë sonë dhe veprimtarinë e saj të drejtë dhe tej pamëse.

a) Ne nuk jemi dakord me gjithë ata që e likuidojnë gjithë veprimtarinë revolucionare të Stalinit dhe shohin në të vetëm anë të zeza. Ne mendojmë se Stalini duhet vlerësuar drejt. J.V. Stalini, siç dihet, është një marksist i madh, se ai pas Leninit e mbrojti marksizëm-leninizmin nga të gjithë armiqtë e revizionistët dhe dha një kontribut të çmueshëm në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj shkence. Ai ka merita të mëdha në përgatitjen e zhvillimin e Revolucionit të Tetorit, në ndërtimin e shtetit të parë socialist, në fitoren historike mbi invazorët fashistë, në përparimin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Për të gjitha këto Stalini gëzonte autoritet të madh jo vetëm në Bashkimin Sovjetik, por edhe në të gjithë botën. Stalini në çështjet kryesore, në mbrojtjen e interesave të klasës punëtore e të teorisë marksiste-leniniste, në luftën kundër imperializmit e armiqve të tjerë të socializmit kurrë nuk gaboi, por ishte dhe mbetet shembull.

Dua të theksoj se udhëheqësit jugosllavë, që bëjnë kaq zhurmë për kultin e individit të Stalinit, e kanë kultin me mjekër në vendin e tyre. Bakariçi, anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, në artikullin e tij me rastin e ditëlindjes së Titos, arrin të thotë se veprat «marksiste» të Titos mund të krahasohen vetëm me veprat më të mira të Marksit, Engelsit dhe Leninit, d.m.th. se Titua qëndron më lart se Marksit, Engelsit e Lenini. Prandaj ne themi se zhurma e udhëheqësve dhe e shtypit jugosllav kundër «kultit të individit» të Stalinit nuk bëhet për të luftuar për mbrojtjen e parimeve marksiste-leniniste, por për të diskredituar sistemin socialist, për të diskredituar udhëheqjet marksiste-leniniste të partive komuniste, për të revizionuar marksizëm-leninizmin dhe për t'i hapur rrugën «socializmit jugosllav».

b) Vlerësimi i drejtë i veprimtarisë së Stalinit ka rëndësi, sepse ai për 30 vjet pas Leninit ka qenë në krye të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe ka udhëhequr Bashkimin Sovjetik e lëvizjen punëtore ndërkombëtare. Armiqtë, duke e nxirë me bojë të zezë Stalinin, s'e kanë hallin tek personi, por kanë qëllim të diskreditojnë Bashkimin Sovjetik, sistemin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare — rrjedhimisht të minojnë besimin e punonjësve ndaj socializmit.

Në fjalimin që mbajti Titua në Pula në nëntor të vitit të kaluar tha: «Qysh në fillim ne kemi thënë se nuk është fjala vetëm për kultin e individit, por për sistemin që bëri të mundur krijimin e kultit të individit, se këtu qëndrojnë rrënjët, se këtu duhet të goditet vazhdimisht dhe me insistim».

Pra, sipas udhëheqësve jugosllavë, kulti i individit lindi nga sistemi sovjetik, prandaj ky sistem duhet revizionuar (në mos përmbysur) dhe duhet zëvendësuar me sistemin «demokratik ju-

gosllav». Dihet se në ç'mulli vete ky ujë. Ideologët e borgjezisë s'po lënë gjë pa bërë për të vërtetuar se «gabimet» e Stalinit janë pjellë e ligjshme e sistemit sovjetik, se ky sistem është një «gabim», një «eksperiment i dështuar», prandaj punonjësit duhet të heqin dorë nga socializmi dhe të punojnë për «kapitalizmin popullor». Këto pretendime të shtrembëra janë hedhur poshtë nga gjithë historia e zhvillimit të sistemit sovjetik, i cili i ka siguruar Bashkimit Sovjetik suksese kolosale, ka dalë fitues nga provat më të vështira historike dhe u shërben si një shembull i shkëlqyer të gjithë punonjësve që luftojnë për t'u çliruar dhe për të ndërtuar një jetë më të mirë.

c) Flamuri i luftës kundër «stalinizmit» u shërben udhëheqësve jugosllavë dhe gjithë revizionistëve si maskë për të larë hesapet me gjithë kundërshtarët e tyre. Ata veprojnë kështu: tezat e drejta marksiste-leniniste i quajnë «dogmatizëm stalinist», partitë komuniste e udhëheqësit e tyre, që janë besnikë të marksizëm-leninizmit, i quajnë «stalinistë», sistemet tona shtetërore dhe ekonomike i quajnë «burokratizëm stalinist», dhe çdo gjë «staliniste» u dashka likuiduar e zëvendësuar me «antistaliniste». Ndarja e partive dhe e komunistëve në «stalinistë» e «antistalinistë» dhe shpallja e luftës kundër «stalinistëve», siç bëjnë udhëheqësit jugosllavë, i shërben vetëm përçarjes së lëvizjes punëtore.

Duke u kapur nga gabime dhe të meta që ja atribuojnë Stalinit, ata mohojnë tërë rezultatet që kanë arritur Bashkimi Sovjetik, demokracitë popullore dhe partitë komuniste gjatë këtyre vjetëve. Ata thonë se shtetet socialiste dhe lëvizja komuniste ndërkombëtare janë në krizë për shkak se vuajnë nga «stalinizmi». Ata propozojnë si rrugëdalje «rrugën jugosllave të ndërtimit të socializmit». Ata thonë se Jugosllavia, për shkak se u shkëput nga kampi i socializmit më 1948, shpëtoi nga «stalinizmi» dhe prandaj vetëm ajo ka gjetur rrugën e drejtë të ndërtimit të socializmit, që tani duhet t'u shërbejë si model të gjitha vendeve. Bëhet reklamë e madhe për ta paraqitur «socializmin jugosllav» si pa asnjë të metë dhe si modelin e vetëm të drejtë, bile si modelin e vetëm të mundshëm për ndërtimin e socializmit nga të gjitha vendet.

Po si qëndron puna në të vërtetë? A ka treguar «rruga jugosllave» ndonjë epërsi? Përkundrazi vetë udhëheqësit jugosllavë pranojnë dobësitë serioze në rendin shoqëror e sidomos në ekonominë e vendit. Ne e dimë se çfarë «demokracie» u siguron UDB-ja punonjësve jugosllavë. Vetë udhëheqësit jugosllavë kanë pohuar shturjen e madhe në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, pasi u dha orientimi që partia të luajë vetëm rol edukativ.

Dihet se kryesorja është riorganizimi i ekonomisë, bazë e gjithë shoqërisë. Udhëheqja jugosllave flet shumë për riorganizimin e ekonomisë jugosllave, por ç'rezultate ka dhënë ajo? Sipas të dhënave jugosllave, rendimenti i punës në Jugosllavi është më i ulët se në vitin 1939. Indeksi i përgjithshëm i çmimeve të shitjes

me pakicë më 1955 u ngrit 27% në krahasim me indeksin mesatar të çmimeve të shitjes me pakicë të vitit 1952. Në fshatin jugosllav sundon ekonomia individuale. Pas riorganizimit të kooperativave bujqësore, gjatë viteve 1953-55 nga 4.192 kooperativa mbeten 896. Në vitin 1952-53 mbeten pa u punuar 358.000 ha tokë, kurse më 1955-56, 575.000 ha. Prodhimi i drithërave s'ka arritur nivelin e paraluftës dhe deficitit i drithërave për çdo vit arrin 600-650.000 ton. Ekonomia jugosllave varet shumë nga ndihmat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që i kanë dhënë asaj një ndihmë të madhe prej një miliard e dyqind milion dollarë. Sigurisht imperialistët amerikanë i kanë dhënë këtë ndihmë të madhe Jugosllavisë jo nga dëshira për të ndihmuar ndërtimin e socializmit. A mund të mendosh se imperializmi mund të të ndihmojë të ndërtosh socializmin që t'i pregatisësh varrin sa më shpejt? Aq më pak mund ta paraqesësh këtë «rrugë ndërtimi të socializmit» si modelin më të mirë.

Sidoqoftë është çështje e «komunistëve» dhe e punonjësve jugosllavë të ndjekin këtë ose atë rrugë, të ruajnë format që u duken atyre më të mira. Pavarësisht se këto ne s'na pëlqejnë, ne s'përzihemi në punët e tyre të brendshme. Por Titua dhe shtypi jugosllav, që janë deklaruar partizanë të flaktë të «rrugëve të ndryshme të ndërtimit të socializmit» dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme, tani jo vetëm bëjnë çmos për të reklamuar «rrugën jugosllave» si të vetmen «recetë të mirë», por «teorikisht» e argumentojnë këtë rrugë si objektivist të domosdoshme për të gjitha vendet tona. Ata thonë se sistemet tona «staliniste» janë në kundërshtim me ligjet objektive dhe prandaj duhet të zëvendësohen patjetër me sistemin e tipit jugosllav, se përndryshe na kërcënon katastrofa e do ta pësojmë si Hungaria. Konsekuentë të kësaj, Tito e Kardeli e quajtën kundërrevolucionin fashist në Hungari si revolucion për të përmbysur «regjimin stalinist» dhe Maria Vilfan, sekretare e komisionit të jashtëm të Bashkimit Socialist të Punonjësve të Jugosllavisë, e quan këtë «fillimin e rilindjes së Evropës Lindore». Udhëheqësit jugosllavë kanë deklaruar haptas se ata i vënë vetes detyrë t'ua imponojnë rrugën e tyre partive të tjera, bile «me një luftë të gjatë e të vështirë». Dhe ata që nuk pranojnë rrugën jugosllave udhëheqësit e shtypi jugosllav i quajnë «stalinistë» dhe u bëjnë thirrje komunistëve për t'i përmbysur e për t'i zëvendësuar me partizanë të «kursit të ri». Titua në Pula tha se fati i zhvillimit të lëvizjes punëtore varet «në se në partitë komuniste do të triumfojë kursi i ri, i cili filloi në Jugosllavi... ose do të fitojë përsëri kursi stalinist» dhe më poshtë vazhdon: «Jugosllavia nuk guxon të ndrydhet në lëvizhjen e vet, ajo duhet të punojë në të gjitha drejtimet... që të triumfojë fryma e re».

Duke marrë parasysh këto, del se sa i çuditshëm është pretendimi i udhëheqjes jugosllave e i «Borbës» se ata as që mendojnë t'u imponojnë rrugën e tyre të tjerëve; se ata akuzohen» pa të drejtë!

Ja, shokë, ç'rrezik paraqet sot revizionizmi. Ja përse Partia jonë dhe gjithë partitë e tjera marksiste-leniniste duhet të shtojnë vigjilencën dhe të godasin me vendosmëri, pa asnjë lëkundje, të gjithë revizionistët dhe renegatët e marksizëm-leninizmit.

Dua të ndalem gjithashtu dhe në disa çështje të tjera themele të teorisë marksiste-leniniste, rreth të cilave revizionistët orvaten të përhapin konfuzion ideologjik.

1. — Mbi rolin e partisë së klasës punëtore në revolucionin socialist dhe në ndërtimin e socializmit.

Në Hungari reaksionarët dhe elementët antimarksistë e antileninistë i përqëndruan bateritë kryesisht kundër Partisë së Punonjësve Hungarezë, shfrytëzuan gabimet e dobësitë e partisë për të diskredituar Komitetin Qendror dhe për ta shthurur dhe përçarë partinë, u përpoqën të diskreditojnë partinë para masave dhe të ndërsejnë kundër saj shtresat e lëkundura dhe të gjithë armiqtë, e larguan partinë nga udhëheqja e shtetit dhe me krijimin e qeverisë së «koalicionit» të Imre Nagit pushteti në fakt u kaloi partive reaksionare e këshillave kundërrevolucionare, që me terror e masakra u përpoqën të shfarosnin komunistët. Kështu në çastet më tragjike populli hungarez mbeti pa udhëheqje dhe nuk qe në gjendje që, me kohë e me forcën e duhur, t'i mbyllte portën kundërrevolucionit fashist. Edhe një herë u vërtetua se pa udhëheqjen e partisë marksiste-leniniste nuk mund të ekzistojë diktatura e proletariatit.

Por tamam në këto çaste udhëheqja jugosllave po përhap pikëpamjet oportuniste në lidhje me mohimin e rolit udhëheqës të partisë. Mihallko Todoroviçi shkruan: «... socializmi ka fituar një bazë politiko-shoqërore shumë më të gjerë. Kjo s'është çështje e disa partive të caktuara, as edhe vetëm e klasës punëtore, por është çështje e shumicës dërmuese të popullit, çështje nacionale e shumë vendeve dhe gati e çdo vendi».

Kardeli thotë: «Roli i partisë kufizohet gjithnjë e më shumë në një rol edukativ, kështu që shkëputet lidhja prej aparatit të administrimit shtetëror».

Edhe në Poloni elementët reaksionarë si edhe elementët oportunistë nën parullën e demokratizimit po flasin kundër udhëheqjes së partisë dhe në shtypin e tyre dalin pikëpamje të tilla, kurse në plenumin e sindikatave dhe në konferencën nacionale të rinisë u fol shumë për pavarësinë e organizatave të masave nga partia.

Gjithë eksperiencia historike tregon se sa e rrezikshme është të mohosh rolin udhëheqës të partisë së klasës punëtore, që në fakt do të thotë t'ja heqësh klasës punëtore partinë e vet. Udhëheqja e partisë marksiste-leniniste është një domosdoshmëri jetike për

kryerjen e revolucionit socialist dhe për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, sepse vetëm partia është e armatosur me shkencën marksiste-leniniste, që i jep asaj mundësinë të njohë ligjet objektive të shoqërisë, vetëm ajo është e zonja të drejtojë e të koordinojë aktivitetin e gjithë organizatave të klasës punëtore. Duke luftuar pikëpamjet e «opozitës punëtore», Lenini shkruante:

«Marksizmi na mëson — dhe ky mësim... është vërtetuar... në praktikë nga revolucioni ynë, — se vetëm partia politike e klasës punëtore, d.m.th. partia komuniste, është në gjendje të bashkojë, të edukojë, të organizojë një pararojë të tillë të proletariatit dhe të të gjitha masave punonjëse, e cila të jetë në gjendje t'u bëjë ballë lëkundjeve të pashmangshme mikroborgjeze të kësaj mase, traditave dhe recidiveve të pashmangshme të pikëpamjeve të ngushta profesionaliste, ose të paragjykimeve profesionaliste midis proletariatit dhe të udhëheqë gjithë veprimtarinë e bashkuar të gjithë proletariatit, d.m.th. ta udhëheqë atë politikisht, dhe nëpërmjet tij të udhëheqë të gjitha masat punonjëse. Pa këtë diktatura e proletariatit është e parealizueshme.

Kuptimi jo i drejtë i rolit të partisë komuniste në marrëdhënjet e saj me proletariatin pa parti dhe pas-taj në marrëdhënjet e faktorit të parë dhe të dytë me gjithë masën e punonjësve është një largim teorik rrënjësor nga komunizmi dhe devijim drejt sindikalizmit dhe anarkizmit, devijim, i cili mban gjallë të gjitha pikëpamjet e grupit të «opozitës punëtore»¹².

Ja, shokë, të mohosh udhëheqjen e partisë marksiste-leniniste do të thotë ta lesh klasën punëtore pa shtab drejtues, ta çarmatosësh plotësisht klasën punëtore në interes të borgjezisë, ta tradhëtosh klasën punëtore.

Tezën e tij të gabuar, në lidhje me rolin e partisë, Kardeli e justifikon me pretendimin absurd se udhëheqja e partisë «është e papajtueshme me rolin me të vërtetë vendimtar të masave të prodhuesve...» dhe dëshirën e komunistëve për të forcuar partinë e tyre e shpjegon duke thënë se ata janë mësuar «të mos kenë besim te masat». Por klasikët e marksizëm-leninizmit dhe eksperiencia kanë vërtetuar se ekzistenca e partisë jo vetëm nuk e pengon rolin e masave si krijuese të historisë, por se vetëm nën udhëheqjen e partisë komuniste klasa punëtore, gjithë punonjësit, mund të kryejnë me sukses këtë rol.

«... proletariati, — thotë Engelsi, — bëhet forcë që prej çastit kur ai krijon një parti punëtore të pavarur»¹³.

Udhëheqësit jugosllavë pikëpamjet e tyre të shtrembëra në lidhje me rolin e partisë i fshehin nën flamurin e kursit «të destalinizimit e demokratizimit». Kardeli thotë se klasa punëtore dhe masat punonjëse duhet të ushtrojnë një influencë të drejtpërdrejtë mbi sistemin politik jo nëpërmjet partisë ose nëpërmjet udhëheqjes së saj dhe e konsideron udhëheqjen e partisë si personifikimin e despotizmit burokratik. Kjo është në fakt teza e vjetër e «opozitës parimore» gjermane, e trockistëve, e oportunistëve si dhe e ideologëve të borgjezisë, të cilët duke u nisur nga roli udhëheqës i partisë në sistemin e diktaturës së proletariatit thoshin se në Bashkimin Sovjetik ekziston jo diktatura e klasës punëtore, por «diktatura e partisë», «diktatura e udhëheqësve»¹⁴. Qëllimi i tyre ishte të mohonin karakterin demokratik të shtetit socialist dhe të vinin në opozicion masat me udhëheqësit dhe me partinë. Çdo shtet i çdo tipi qoftë udhëhiqet nga klasa sunduese nëpërmjet partisë përkatëse. Nga kjo «burokraci» as një shtet s'është i lirë. Pra të pretendosh që të «demokratizosh» vendin, duke asgjësuar udhëheqjen e partisë marksiste-leniniste, do të thotë t'ja lësh drejtimin një partie tjetër. Këtë e vërteton gjithë historia, këtë e vërteton edhe eksperiencia e ngjarjeve të fundit.

2. — Mbi rolin e diktaturës së proletariatit në fazën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm.

Çështja kryesore e çdo revolucionit është çështja e pushtetit. Nga ngjarjet e kohëve të fundit, sidomos nga ngjarjet në Hungari, komunistët nxjerrin mësim të rëndësishme për forcimin e diktaturës së proletariatit, kurse ideologët e borgjezisë e të revizionistëve të marksizëm-leninizmit përfituan nga këto momente për të nxjerrë nga varri të gjitha shpifjet e «teoritë» e kalbura kundër diktaturës së proletariatit. Udhëheqja jugosllave e ka ngritur mohimin e diktaturës së proletariatit në një «sistem teorik». Nga fjalimi i Kardelit në Oslo dhe nga fjalimi i tij i fundit del një konkluzion: të likuidohet «mekanizmi i shtetit të periudhës kalimtare» d.m.th. diktatura e proletariatit. Ai përdor për këtë çdo rast: ngjarjet në Hungari, luftën kundër «stalinizmit» e «burokratizmit», decentralizimin e «demokracisë së drejtpërdrejtë prodhuese», jugosllave, bile mallkon diktaturën e jakobinëve, megjithëse Lenini ka thënë se:

«jakobinët e vitit 1793 kanë hyrë në histori si një shembull i madh i luftës me të vërtetë revolucionare kundër klasës së shfrytëzuesve nga ana e klasës së punonjësve dhe të shtypurve që ka marrë në duart e saj gjithë pushtetin shtetëror»¹⁵.

Kardeli e shokët e tij luftojnë kundër teorisë marksiste-leniniste të diktaturës së proletariatit dhe e quajnë këtë luftë kundër «stalinizmit». Po dihet se Marksi në «Kritikën e programit të Gotës» thotë se shteti i periudhës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm mund të jetë vetëm diktatura revolucionare e proletariatit¹⁵. Marksi e Lenini kanë luftuar kundër anarkistëve e revizionistëve, të cilët kanë dashur t'i heqin klasës punëtore diktaturën e proletariatit, mjetin e domosdoshëm për ndërtimin e shoqërisë komuniste.

a) Pikësëpari diktatura e proletariatit është e domosdoshme për të shpronësuar klasat shfrytëzuese dhe pastaj për të shtypur përpjekjet e këtyre, si edhe ato të shteteve imperialiste, që së bashku kërkojnë me të gjitha mënyrat të rivendosin kapitalizmin.

Ideologët e borgjezisë dhe revizionistët përpiqen ta diskreditojnë diktaturën e proletariatit, duke e akuzuar si një shtet antidemokratik. Diktatura e proletariatit është i vetmi shtet që siguron për herë të parë në histori demokracinë e vërtetë, sepse ajo është pushteti i klasës punëtore në aleancë me fshatarësinë punonjëse për të shtypur pakicën — klasën shfrytëzuese, sepse ajo mbështetet në pronën socialiste mbi mjetet e prodhimit dhe në çlirimin e masave nga shfrytëzimi. Kurse demokracia më e përparuar borgjeze është në thelb antidemokratike, është false dhe e gënjeshtërt, sepse ajo është diktatura e pakicës, është armë e borgjezisë për të shtypur e shfrytëzuar shumicën dërmuese të popullsisë. Edhe në periudhën e luftës më të ashpër të klasave, shteti socialist është njëmijë herë më demokratik nga republika më demokratike borgjeze dhe bile as që mund të krahasohet me të. Kjo s'do të thotë se ne pajtohemi me shkeljet e demokracisë e të ligjëshmërisë, ato duhet të mos lejohen, se ndryshe dobësohen e minohen vetë themelet e diktaturës së proletariatit, krijohet rreziku për vetë ekzistencën e kësaj diktature. Ne duhet të luftojmë vazhdimisht për të zhvilluar demokracinë socialiste, të forcojmë gjithnjë e më shumë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse dhe me masat e tjera punonjëse.

Lidhur me ngjarjet e Hungarisë, armiqtë e socializmit e revizionistët predikojnë se diktatura e proletariatit duhet të liberalizohet, duke «zbutur» sundimin mbi klasat shfrytëzuese, duke ju dhënë liri armiqve të socializmit. Botëkuptimi dhe pikëpamjet e Tuk Jakovës e të Bedri Spahiut ngjasin si dy pika uji me këto predikime. Ngjarjet në Hungari treguan se një politikë e tillë do të thotë që klasa punëtore me duart e saj t'i hapë portat kundër-revolucionit, përmbysjes së pushtetit të klasës punëtore dhe rivendosjes së diktaturës së borgjezisë. Partia jonë kurrë s'ka shkelur në dërrasën e kalbur ku duan ta çojnë revizionistët. Partia jonë është udhëhequr nga mësimet e Leninit, i cili thotë se:

«Diktatura e proletariatit nuk do të thotë se lufta e klasave ka marrë fund, ajo vazhdon në një formë të re dhe me mjete të reja»¹⁷.

«Diktatura e proletariatit është lufta më heroike dhe më e pamëshirshme e klasës së re kundër një armiku më të fuqishëm, kundër borgjezisë, rezistenca e së cilës është dhjetëfishuar nga përmbysja e saj... Diktatura e proletariatit është një luftë e ashpër, e përgjakshme dhe jo e përgjakshme, violente dhe paqësore, ushtarake dhe ekonomike, pedagogjike dhe administrative kundër forcave dhe traditave të shoqërisë së vjetër»¹⁸.

Në periudhën e diktaturës së proletariatit, liria dhe demokracia janë të siguruara vetëm për masat e gjera punonjëse, ndërsa për klasat shfrytëzuese të përmbysura por të paasgjësuar, për armiqtë e socializmit, për agjentët e imperializmit ka vetëm sundim, nuk ka liri e demokraci. Lenini i kërkoi regjimit proletar hungarez të vitit 1919 të përdorë «zbatimin e një dhune të ashpër dhe të pamëshirshme, të shpejtë dhe të vendosur...» për të shtypur kundër-revolucionarët dhe thoshte se:

«Kush nuk e ka kuptuar këtë, ai nuk është revolucionar, dhe duhet të hiqet nga posti i udhëheqësit ose i këshilltarit të proletariatit»¹⁹.

Violencën klasa punëtore duhet ta përdorë sipas shkallës së rezistencës së klasave shfrytëzuese dhe pa u lëkundur.

b) Diktatura e proletariatit është e domosdoshme për të ndër-tuar shoqërinë socialiste e komuniste. Në kundërshtim me këtë udhëheqja jugosllave paraqet teoritë e «sistemit të demokracisë së drejtpërdrejtë», bazë e së cilës është mohimi i rolit të shtetit në ndërtimin e shoqërisë socialiste.

Kjo «teori» e udhëheqjes jugosllave është marrë nga arsenal i teorisë të Prudonit e të Bakuninit, të decistëve e të «opozitës punëtore», të Troçkit e të Buharinut. Për të na bindur Kardeli arrin deri atje sa të thotë se «Marksi dhe Engelsi, duke parë pas komunës së Parisit rrezikun e burokracisë, hoqën dorë nga mendimi se shteti është mjeti kryesor i proletariatit për të transformuar ekonomikisht shoqërinë». Por në të vërtetë Marksi dhe Engelsi e kanë kritikuar Komunën e Parisit «për faktin se ajo e ka përdorur shumë pak këtë autoritet»²⁰, d.m.th. forcën e pushtetit shtetëror për të zgjidhur detyrat e transformimit ekonomik.

Drejtimi i centralizuar i ekonomisë është një nevojë objektive që lind zhvillimi i prodhimit të madh industrial. Aq më tepër kjo është nevojë në ekonominë socialiste, e cila mbështetet mbi pronën shoqërore mbi mjetet e prodhimit e ku vepron ligji objektiv i zhvillimit proporcional e të planifikuar të ekonomisë.

Centralizmi demokratik i ka rezistuar provës së jetës. Zhvillimi ekonomik, që është arritur në Bashkimin Sovjetik dhe në demokracitë popullore, është rezultat i drejtimit të planifikuar të ekonomisë nga ana e shtetit. Drejtimi i centralizuar i ekonomisë, po s'u kombinua me demokracinë, lind shtrembërime burokratike dhe kufizon iniciativën lokale. Por që këtej s'mund të nxirret konkluzioni i Kardelit që të hiqet dorë nga roli drejtues i shtetit socialist në ekonominë kombëtare. Decentralizimi që predikojnë udhëheqësit jugosllavë e mohon rolin udhëheqës të partisë e të diktaturës së proletarietit, përmban rrezikun e spontaneitetit e të anarkisë së tregut, minon planifikimin e ekonomisë dhe thellon diferencimin e klasave. Këtë e vërteton realiteti i Jugosllavisë.

Udhëheqësit jugosllavë ngrënë në qiell si mjetin që zgjidh çdo gjë, si eliksirin e qemotit²¹, «këshillat punëtore të vetadmirstrimit të ndërmarrjeve». Këtu ka dy probleme; prona dhe administrimi. Udhëheqësit jugosllavë, për të luftuar diktaturën e proletarietit, arrijnë deri atje sa të thonë se prona shtetërore në socializëm s'është socialiste, por është kapitalizëm shtetëror dhe M. Todroviçi nxjerr konkluzionin e poshtë se «shteti socialist grabit punëtorët» («Nasha Stvarnost», nr. 7,8.1956). Ata kërkojnë që ndërmarrjet të hiqen nga duart e shtetit socialist, që shpreh interesat e gjithë shoqërisë, dhe t'u jepen grupeve të prodhuesve ashtu siç kërkonte Prudoni dhe «opozita punëtore». Marksi dhe Engelsi që në Manifestin Komunist kanë thënë se shteti socialist duhet të centralizojë në duart e tij të gjitha mjetet e prodhimit.

Përsa i përket «vetadmirstrimit të ndërmarrjeve», këshillat punëtore s'e kanë justifikuar veten. Vetë shtypi jugosllav dhe Titua e Kardeli pohojnë se kjo formë administrimi ka lindur tendenca anarkiste, konkurrence, shpërdorim të mjeteve financiare e materiale për gjëra që nuk duhen, shpirtin e spekulimit me anë të konjunkturës së çmimeve etj. Vlera e formave të ndryshme të administrimit të ekonomisë matet me faktin se sa ato i ndihmojnë zhvillimit të ekonomisë së vendit. Por gjendja e ekonomisë jugosllave (për të cilën folëm më lart) tregon se çfarë rezultatesh ka dhënë «sistemi i demokracisë së drejtpërdrejtë» në Jugosllavi. Ekonomia jugosllave zvarriset pas lëmshave të imperializmit amerikan.

Lenini ka theksuar vazhdimisht se teoria e diktaturës së proletarietit është pjesa më esenciale e marksizmit, se pranimi ose hedhja poshtë e diktaturës së proletarietit përbën diferencën më të thellë midis marksizmit dhe borgjezisë së zakonshme të vogël (si edhe të madhe). Pra ata që revizionojnë teorinë marksiste mbi diktaturën e proletarietit nën flamurin e luftës kundër «stalinizmit e burokratizmit» hedhin poshtë gjithë marksizëm-leninizmin ata në të vërtetë e tradhetojnë proletariatin dhe hidhen me borgjezinë.

Jo ta asgjësojmë diktaturën e proletarietit, siç thotë Kardeli,

por ta forcojmë sa më shumë, mos të lejojmë dobësimin e saj, «liberalizimin e saj», mos të lejojmë konfuzion e çorganizim në radhët e saj, sepse këtë e dëshërojnë armiqtë tanë.

Udhëheqësit jugosllavë flasin shumë për «shuarjen» e shtetit, por marksizëm-leninizmi mëson se kjo çështje shtrohet vetëm atëherë kur të jetë siguruar fitorja vendimtare botërore e proletarietit mbi borgjezinë dhe të jetë zhdukur kështu rreziku i restaurimit të kapitalizmit. Por sot, përkundrazi, imperialistët dhe forcat kundërrevolucionare me çdo mënyrë përpiqen që të përmbysin shtetet socialiste. Të ngresh çështjen e «shuarjes» së shtetit tani do të thotë ta çarmatosësh klasën punëtore. Nga ana tjetër në Jugosllavi nuk dëgjojmë të merren masa për të dobësuar shtetin. Atëherë cili është qëllimi i predikimeve të Kardelit me shokë?

3. — Mbi luftën e klasave në fazën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm

Ngjarjet politike të kohëve të fundit, e veçanërisht ato të Hungarisë, shënuan një ashpërsim të luftës së klasave në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Kuptohet, pra, sa e rrezikshme është në këtë kohë që të çorientosh dhe të nanurisësh klasën punëtore dhe të gjithë punonjësit me «teoritë» e mohimit të luftës së klasave. Udhëheqësit jugosllavë po bëjnë tamam këtë punë. Në fjalimin e fundit Eduard Kardeli, duke «vlerësuar» ngjarjet kundërrevolucionare në Hungari, tha: «Kuptimi i procesit të zhvillimit socialist vetëm nëpërmjet prizmit të pikëpamjes së revolucionit socialist, domethënë nëpërmjet konfliktit midis proletarietit dhe borgjezisë, është një absurditet ideologjik dhe një kuptim reaksionar në pikëpamje politike» (fjalimi në Skupshtinën popullore të RPFJ më 7.XII.1956). Kjo do të thotë të hidhet poshtë teoria e luftës së klasave, e cila na mëson se kurdoherë ngjarjet historike duhet të shihen nën prizmin e konfliktit midis proletarietit dhe borgjezisë, nën prizmin e luftës së klasave. Konsekuentë në mohimin e luftës së klasave, udhëheqësit jugosllavë kundërrevolucionin fashist në Hungari, barbarizmat dhe raprezaljet e bandave hortiste i quajtën një «revolucion popullor». Duke lexuar fjalimet e udhëheqësve dhe të shtypit jugosllav, krijon përshtypjen se imperializmi, planet amerikane për rivendosjen e kapitalizmit në vendet tona, lufta e klasave nuk ekzistojnë në përgjithësi dhe nuk janë një problem që duhet të tërheqë vëmendjen e partive tona. Jo vetëm kaq, po në materialet e tyre ka pësuar një metamorfozë edhe terminologjia më e zakonshme. Kështu, p.sh., fjala «imperializëm» zëvendësohet me terma të tilla si «politika perëndimore e bloqeve» ose «liria e tipit perëndimor» etj. Për udhëheqësit jugosllavë rreziku nuk qëndron aspak te imperializmi, po te «elementët

konservatorë e burokratë», siç quajnë ata të gjitha ato parti dhe ata udhëheqës që nuk janë dakord me pikëpamjet antimarksiste të udhëheqësve jugosllavë.

Marksizëm-leninizmi na mëson se në periudhën kalimtare lufta e klasave është e pashmangshme. Kjo luftë klasash është një realitet objektiv, që është i lidhur me ekzistencën e klasave shfrytëzuese apo të mbeturinave të tyre, me ekzistencën e agjentëve të imperializmit, me ekzistencën e sektorit të gjerë të prodhuesve të vegjël, me ekzistencën e mbeturinave kapitaliste në ndërgjegjen e njerëzve dhe, më në fund, me vetë ekzistencën e imperializmit, pra të luftës së klasave në shkallë ndërkombëtare. Në lidhje me këtë ja ç' thotë Lenini:

«Zhdukja e klasave arrihet me anë të një lufte klase të gjatë, të vështirë dhe të vendosur, e cila, pas përmbysjes së pushtetit të kapitalit, pas shkatërrimit të shtetit borgjez, pas vendosjes së diktaturës së proletariatit, nuk zhduket... por vetëm i ndryshon format e saj, nga shumë pikëpamje bëhet akoma më e ashpër»²².

Jeta ka treguar se duke u forcuar socializmi, duke u rritur forcat e tij si brenda vendit, ashtu edhe në shkallë ndërkombëtare, dobësohet baza ekonomike e mbeturinave të klasave shfrytëzuese, pakësohet çdo ditë e më shumë influenca e tyre politike; bllë edhe forcat e tyre numerike vijnë duke u pakësuar, por me gjithë këtë lufta e klasave nuk shuhet...

Mirëpo pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik elementët oportunistë e liberalë në disa vende e kuptuan në mënyrë dogmatike dhe oportuniste problemin e luftës së klasave. Kjo solli si pasojë uljen e vigjilencës, ndihmoi armiqtë e socializmit në ato vende, ku këto pikëpamje nuk u goditën në kohën e duhur. Partia jonë e ka kuptuar dhe e ka shtruar drejt çështjen e luftës së klasave. Komiteti Qendror dhe organizatat e Partisë goditën me kohë manifestimet oportuniste që u shfaqën në disa raste nga elementët oportunistë të paqëndrueshëm. Partia jonë e shtroi drejt se tendenca e dobësisimit të armiqtë të brendshëm të klasës, krahas me rritjen e forcave tona, nuk ka asgjë të përbashkët me pikëpamjet oportuniste që mohojnë luftën e klasave, me pikëpamjet armiqtësore të tipit të buharinistëve, që e shikonin periudhën e ndërtimit të socializmit si periudhë «paqeje e harmonie» midis klasave, si periudhë «ekuilibri të qëndrueshëm», ku lufta e klasave zhduket. Komiteti Qendror shpjegoi se në këtë periudhë lufta e klasave nuk zhvillohet kurdoherë në vijë të drejtë, ajo ka kthesat e zigzaget e saj. Këtë e vërtetojnë më së miri ngjarjet e këtyre vjetëve: provokacioni i Berlinit më 1953²³, ai i Poznanit më 1956 dhe sidomos kundërrevolucioni fashist në Hungari.

III. — MBI MARRËDHËNJET TONA ME JUGOSLLAVINË

Eksperienca e Shqipërisë në marrëdhënjet me Jugosllavinë, më mirë se eksperienca e çdo vendi tjetër, tregon qëndrimin e vërtetë të udhëheqjes jugosllave kundrejt marksizëm-leninizmit, sepse në asnjë vend tjetër ata s'kanë ndërhyrë kaq brutalisht sa në Shqipëri. Udhëheqja jugosllave ka mbajtur ndaj Partisë, shtetit dhe popullit tonë një qëndrim antimarksist dhe shovinist. Qëllimi i udhëheqjes jugosllave ka qenë që ta kthejë Partinë tonë nga një parti marksiste-leniniste në një parti oportuniste dhe ta bëjë Shqipërinë republikë të shtetit jugosllav. Këtë e vërtetojnë faktet historike që shkurtimisht po i radhis.

a) Udhëheqja jugosllave më 1944, në prakun e çlirimit të Shqipërisë, me anën e Velimir Stojniçit, ndërhyri në punët e Partisë sonë dhe organizoi në Berat një fraksion të rrezikshëm me qëllim që ta largonte Partinë tonë nga vija e drejtë marksiste-leniniste dhe ta përmbyste udhëheqjen e saj. Udhëheqja jugosllave e akuzoi udhëheqjen e Partisë sonë se kishte zbatuar një vijë jo të drejtë, sektare. Por populli ynë në bazë të kësaj vije arriti fitoren historike mbi pushtuesit e reaksionarët e brendshëm. Vija jugosllave që u përpoq të na impononte Velimir Stojniçi errësonte rolin drejtues të Bashkimit Sovjetik, rolin udhëheqës të Partisë, mohonte luftën e klasave dhe u hapte rrugën prirjeve oportuniste.

Pas Plenumit të Beratit u forcuan pozitat e elementëve anti-parti si Koçi Xoxe dhe Sejfulla Malëshova në udhëheqjen e Partisë, të cilët mbështetën futjen e «eksperiencës» jugosllave. Udhëheqja jugosllave e akuzon Partinë tonë se e ka dënuar pa të drejtë Koçi Xoxen dhe e quan këtë «patriot» e «marksist». Po ç'ka bërë Koçi Xoxe? Ai u përpoq të asgjësonte Partinë, duke e fshehur dhe duke e shkrirë në Front. Ai shqëlmoi parimet më elementare leniniste të ndërtimit të partisë. Ai e vuri Partinë nën kontrollin e organeve të Sigurimit të Shtetit: 15 mijë dosje të anëtarëve të Partisë u gjetën në arshivën e Sigurimit. Në çdo organizatë bazë kishte rrjetë të Sigurimit. Ai mblihte materiale komprometuese dhe po pregatiste komplotin për zhdukjen fizike të udhëheqësve të Partisë dhe të shtetit. Si ministër i brendshëm ai shkeli ligjëshmërinë socialiste në mënyrën më brutale. Ai ishte dakord me planet e udhëheqjes jugosllave për ta bërë Shqipërinë republikë të shtatë të Jugosllavisë dhe vepronte në këtë drejtim. Për të gjitha këto faje Koçi Xoxe jo vetëm s'duhej rehabilituar, por po të qe gjallë, duhej varur.

Udhëheqja jugosllave është përgjegjëse për vetëvrasjen e Nako Spiros. Ky në Berat u përzie me Koçi Xoxen etj., por më vonë kuptoi lojën e jugosllavëve dhe u vu në rrugë të drejtë. Nakua s'pati kurajon t'i tregonte Partisë të vërtetën dhe vrau veten. Ju e dini se vrasja e Nakos e ndërlikoi çështjen dhe intrigat e jugos-

llavëve dhe të Koçi Xoxes me shokë çuan në Plenumin VIII²⁴. Pas këtij plenumi ndërhyrjes jugosllave ju hapën portat më shumë.

b) Marrëdhënjet ekonomike në mes të dy vendeve tona kanë qenë në baza antimarksiste dhe kolonialiste, u shkelën edhe rregullat më elementare të marrëdhënjeve midis vendeve sovraane. Më 1946 u krijuan gjashtë shoqëri shqiptaro-jugosllave, por pala jugosllave nuk bëri investimet që i takonin, vetëm merrte fitime nga shfrytëzimi i investimeve ekzistuese shqiptare. Parifikimi i monedhës shqiptare me dinarin jugosllav u bë me një zhvlehtësim të madh të frangut shqiptar, duke humbur të paktën 3.5 lekë për çdo frang. Bashkimi doganor u hapi rrugën organizatave tregëtare jugosllave dhe tregëtarëve privatë për të rjepur rezervat e mallrave në tregun tonë. Shkëmbimi i mallrave në bazë të çmimeve të brendshme e jo me çmimet e tregut ndërkombëtar e dëmtoi rëndë ekonominë tonë.

U krijua Komisioni i përbashkët i koordinimit të planeve me në krye Krajgerin, komision që qe në fakt qeveri mbi qeverinë e shtetit shqiptar. Ne kemi një dokument të planifikimit të firmuar nga Kidriç, ish-kryetar i Komisionit të Planit të Jugosllavisë, ku Shqipëria figuron si republikë e shtatë jugosllave.

Udhëheqja jugosllave bën zhurmë të madhe për ndihmë ekonomike që Jugosllavia i ka dhënë Shqipërisë, por shifrat e kësaj ndihme janë të fryra nga çmimet e larta të importit. Ndihmat për «industrializimin e Shqipërisë» ishin: maqineritë e shkatërruara të Fabrikës së sheqerit «Ali Kelmendi» në Korçë që në Jugosllavi kishin dalë jashtë përdorimit, punishtëja primitive e litarit në Rrogozhinë, që s'i ka mbetur nishan, dhe hekurudha që e ndërtoi rinia jonë heroike. Po të bëjmë llogaritë se sa muarën jugosllavët nga ne e sa ne nga ata, s'dihet kush del borxhli. Po pse jugosllavët nuk thonë gjysmë fjale për luftën heroike të dy divizioneve tona, që ndihmuan në çlirimin e Jugosllavisë?

c) Më 1948 udhëheqja jugosllave na kërkoi që të lejonim hyrjen në Shqipëri të disa divizioneve, gjoja për të mbrojtur Shqipërinë nga agresioni i monarko-fashistëve grekë. Në të vërtetë ata donin që ta bënin fakt të kryer pushtimin e Shqipërisë.

Njerëzit e jugosllavëve pëshpërisnin poshtë e lart për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, si republikë e shtatë. Gjithashtu filloi të bisedohej dhe për Federatën Ballkanike. Ne i shkruam udhëheqjes jugosllave që të shpjegonte qëndrimin e saj në lidhje me këtë çështje, po ajo kurrë nuk na u përgjegj.

c) Udhëheqja jugosllave gjatë kësaj periudhe u përpoq ta izolonte vendin tonë nga Bashkimi Sovjetik, duke thënë se Shqipëria duhet ta marrë ndihmën dhe eksperiencën sovjetike vetëm nëpërmjet Jugosllavisë, se eksperiencia jugosllave vlen për konditat e Shqipërisë, kurse ajo sovjetike s'i përshtatet, se këshilltarët sovjetikë duhet të ikin. Sidomos pas Plenumit VIII këshilltarët jugos-

llavë u futën kudo dhe ata punuan kundër zhvillimit të ekonomisë sonë dhe që ta bënin këtë drejtpërdrejtë të varur nga Jugosllavia. Udhëheqja jugosllave kërkonte ta izolonte Shqipërinë nga e gjithë bota. Në fakt ne nuk kishim marrëdhënje ekonomike me asnjë vend tjetër veç Jugosllavisë, bile dhe me Bashkimin Sovjetik i kishim të kufizuara. Deri më 1948 ne kishim marrëdhënje diplomatike vetëm me Bashkimin Sovjetik, Jugosllavinë, Bullgarinë, Hungarinë dhe Francën.

Letra e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Rezolucioni i Informbyrosë i vitit 1948 e ndihmuan Partinë tonë që të shohë qartë synimet e udhëheqjes jugosllave ndaj Partisë dhe vendit tonë.

Kritikat parimore që ju bënë atëhere udhëheqjes jugosllave kanë qenë të drejta. Këtë e vërtetojnë edhe pikëpamjet që ushqejnë tani udhëheqësit jugosllavë.

Gjatë viteve 1948-1953 kemi shkruar e kemi vepruar kundër njëri-tjetrit, si ne, si ata. Nuk është e drejtë që të dalë se gjatë kësaj periudhe ne kemi pasur faj. Ata kanë vepruar kundër republikës sonë me të gjitha mjetet, kanë dërguar me qindra diversantë dhe grupe të armatosura, përveç provokacionit grek të 1949-ës²⁵. Asnjë shtet armik s'ka zhvilluar një veprimtari kaq të tërbuar kundër vendit tonë sa ajo që zhvilloi udhëheqja jugosllave pas vitit 1948.

Siç dihet udhëheqja e Bashkimit Sovjetik mori iniciativën për të përmirësuar marrëdhënjet²³, dhe bëri të gjitha përpjekjet në këtë drejtim. Ne atëhere propozuam që para se të fillonin bisedimet e Beogradit të mbledhesh Informbyroja, e cila më 1948 vendosi përjashtimin e Jugosllavisë, dhe të analizonte çështjen e jugosllavëve, duke nxjerrë të mirat e të metat e tyre dhe të Informbyrosë. Ne mendojmë se kështu do të kishte qenë drejt, sepse kjo nuk do t'i linte udhëheqësit jugosllavë që të mbulonin gabimet e tyre dhe tërë përgjegjësinë t'ua hidhnin vendeve tona dhe të dilnin si flamurtarë të situatës.

Në fakt iniciativën e Bashkimit Sovjetik ata e shpërdoruan. Autokritikë nuk bënë fare, se, gjoja ishin marksistë. Ata duhej të bënin autokritikë, atyre u duhej kërkuar që ta bënin këtë. Ata e shfrytëzuan situatën e re për të zhvilluar aktivitet përçarës e minues kundër partive e shteteve të demokracisë popullore. Legatat jugosllave në vendet e demokracisë popullore u bënë qendra të veprimtarisë agjenturale; ato filluan të grumbullojnë elementët antiparti, oportunistë e të lëkundur dhe, nën flamurin e «destalinizimit», t'i ndërsejnë këta kundër partive për të rrëzuar udhëheqjet marksiste-leniniste të partive tona dhe për t'i zëvendësuar me elementë të tyre, për të zëvendësuar vijën e drejtë me vijën titiste. Ata bashkëpunuan edhe me elementë armiq, si p.sh. në Bullgari me ish-ministrin e punëve të brendshme të qeverisë bor-

gjeze bullgare të paraqirimit. Pas ngjarjeve në Hungari doli dhe më qartë fytyra e udhëheqjes jugosllave.

Partia jonë mbajti qëndrim të drejtë. Ne deklarua se jemi gati të përmirësojmë marrëdhënjet në baza marksiste-leniniste dhe jo në bazat e vjetra antimarksiste (e kaluara s'kthehej më). Por udhëheqësve jugosllavë s'u pëlqeu qëndrimi ynë, sepse ata kërkoi të përsëritnin situatën e 1948-ës, kërkoi që ne t'u bënim lëshime parimore: 1) të thoshim se jugosllavët s'kanë asnjë gabim; 2) të rehabilitonim Koçi Xoxen etj. Ne këtë nuk mund ta bënim kurrë. Kjo s'do të ishte marksiste, kjo do të ishte tradhëti ndaj Partisë dhe atdheut tonë.

Ndërkaq udhëheqësit jugosllavë vazhduan me intensitet punën kundër Partisë dhe shtetit tonë. Ata kurrë nuk mund të pajtohen me udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit tonë. Ata duan të zëvendësojnë këtë udhëheqje, që mbron me kurajo marksizëm-leninizmin, Partinë dhe pavarësinë e vendit tonë, me ndonjë klikë aventurierësh oportunistë, t'i imponojnë Partisë «vijën jugosllave» dhe Shqipërinë ta bëjnë republikë të shtatë të Jugosllavisë.

Ata zhvilluan dhe zhvillojnë një propagandë të shfrenuar në shtyp dhe në radio kundër vendit tonë, duke e paraqitur gjendjen e Shqipërisë si skëterrë, ku mbretëron terrori dhe varfëria.

Legata jugosllave në Tiranë ka zhvilluar dhe zhvillon punë agjenturale, përpiket të grumbullojë elementët antiparti dhe të organizojë luftën kundër Partisë sonë. Në pranverën e vitit 1956 udhëheqja jugosllave, me anë të legatës së saj në Tiranë, grumbulloi armiq të Partisë Dali Ndreun, Liri Gegën etj. dhe pregtiti një komplot, që kishte për qëllim të përmbyste udhëheqjen e Partisë e të shtetit dhe ta zëvendësonte me armiq të Partisë. Ata organizuan punën armiqësore në konferencën e Tiranës, por Partia e zbuloi këtë veprimtari armiqësore dhe mori menjëherë masat e duhura.

Vetë ministri jugosllav në Tiranë, Arso Milatović, zhvillon propagandë dhe flet kundër politikës dhe gjendjes së Republikës Popullore të Shqipërisë, kundër udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit tonë, nxit elementë të dobët për veprimtari armiqësore antishtetërore dhe antiparti dhe merret me veprimtari spiunazhi. Për këtë qëllim, ai është përpjekur me anë presioni dhe mjetesh të tjera të shfrytëzojë shtetasit jugosllavë të vendosur prej kohësh në Shqipëri, me të cilët mban kontakte aktive, elementë armiq të Partisë dhe të pushtetit popullor, individë të ndryshëm që shkojnë për punë zyrtare në legatën jugosllave, ose që ai i merr rrugës në maqinën e vet duke lëvizur nëpër Shqipëri. Duke shkelur edhe dispozitat zyrtare mbi qarkullimin e diplomatëve të huaj në vendin tonë, ay ka shkuar pa lejen përkatëse në Vlorë, ku, duke abuzuar nga mikpritja e një familjeje patriote, ka kërkuar të nxjerrë informata me karakter politik e ushtarak mbi bazën de-

tare të ishullit të Sazanit. Po kështu ka shkuar në Berat dhe ka fotografuar objekte ushtarake të ndaluara dhe ka kërkuar të takohet me Tuk Jakovën.

Një çështje serioze është fakti se në Jugosllavi ka 3000 e ca të arratisur shqiptarë, midis të cilëve shumë kriminelë fashistë. Duke marrë parasysh zhvillimin e ngjarjeve në Hungari, ne kemi të drejtë të mendojmë se mund të organizohen edhe provokacione me anën e tyre, me qëllim që të gjendet shkak për të sulmuar Shqipërinë. Në çastet më tragjike në Hungari, Vidiçi, nënsekretar i shtetit për punët e jashtme të Jugosllavisë, u tha atasheve të shtypit të Bullgarisë, të Shqipërisë, të Çekoslovakisë etj: «Prisni, ato që ndodhën në Hungari do të ndodhin patjetër edhe te ju». Prandaj Partia jonë është e detyruar të jetë shumë vigjilente ndaj udhëheqjes jugosllave.

Udhëheqja jugosllave mban një qëndrim shovinist e çnjerëzor ndaj popullsisë së Kosovës. Gjendja në këtë krahinë është e mjerueshme, udhëheqja jugosllave atje po ndjek një politikë shfarosjeje. Me dhjetëra mijëra kosovarë detyrohen të lënë tokën dhe shtëpinë për të emigruar në Turqi. Këtë politikë s'e kanë bërë as kralët e Serbisë. Ajo bën çmos për ta kthyer Kosovën në një bazë kundër Shqipërisë, në një bazë për të bashkuar Shqipërinë nëpërmjet Kosovës me Jugosllavinë.

Shtypi jugosllav në Kosovë e Metohi po zhvillon çdo ditë një propagandë të poshtër shpifëse kundër Partisë dhe Republikës sonë Popullore, sa që zëri i Amerikës ja ka zili. Bëhet pyetja nga ana jonë: përse kjo propagandë kaq e poshtër dhe sidomos e posaçme në Kosovë e Metohi kundër regjimit popullor të Shqipërisë? Vallë a do të vazhdojë gjatë të rrjedhin kështu ndotësira në kanalet e ujërave të zeza të shtypit jugosllav? Për ne është e qartë ku synon udhëheqja jugosllave. Ajo kujton se po i gënjen shqiptarët e Kosovës mbi realitetin e vendit tonë, por edhe në qoftë se mund të ketë të tillë që të jenë gënjer, shtypi ynë e ka për detyrë internacionaliste të sqarojë të gënjerit nga propaganda e ndyrë nacionaliste, shoviniste, fashiste.

Partia jonë ka mbajtur dhe mban qëndrim të drejtë për çështjen e Kosovës, një qëndrim marksist, internacionalist. Por ne s'mund të mos vemë në dukje qëndrimin shovinist të udhëheqjes jugosllave në Kosovë për të vërtetuar edhe një herë se ajo është në pozita antimarksiste dhe antinjerëzore kundrejt shqiptarëve të Kosovës.

Si konkluzion, shokë, mund të themi se qëndrimi i udhëheqjes jugosllave kundrejt vendit tonë është haptas antimarksist e shovinist, se ajo gjatë 13 vjetëve ka ndërhyrë sistematikisht në punët e brendshme të Partisë e të shtetit tonë, me qëllim që të realizojë planet e saj kolonialiste ndaj vendit tonë. Këto plane kanë dështuar në saje të qëndrimit të vendosur të Partisë sonë. Kjo gjë e

bën udhëheqjen jugosllave që ta sulmojë Shqipërinë më me tërbim se vendet e tjera. Arësye tjetër që udhëheqësit jugosllavë luftojnë me kaq tërbim kundër Partisë sonë është se Shqipëria është dokumenti që tregon pozitën e tyre antimarksiste e shoviniste, që vërteton se tezat e tyre për mosndërhyrje, për barazi etj. janë vetëm demagogji. Dhe ata duan të zhdukin dëshmitarët që vërtetojnë këtë, ashtu si përpiqet vrasësi të zhdukë gjurmat e krimit.

Gjatë gjithë raportit doli se ç'përfaqësojnë udhëheqësit e sotëm jugosllavë. Ata janë në pozita antimarksiste, ata përpiqen të revizionojnë marksizëm-leninizmin, luajnë një rol përçarës në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të kampit të socializmit, ndërhyjnë në punët e partive për të asgjësuar udhëheqësit e tyre, për të minuar partitë komuniste e punëtore dhe për të imponuar të ashtuquajturën «vijë jugosllave». Se sa e rrezikshme është bërë përhapja e «teorive» të tyre helmuese dhe e veprimtarisë së tyre armiqësore e vërtetojnë faktet e shumta që u përmendën, duke përmbledhur edhe punën e tyre armiqësore ndaj vendit tonë si edhe rolin e tyre në zhvillimin e ngjarjeve në Hungari. Ata përpiqen të nxitin elementët revizionistë në Poloni, të aktivizojnë elementët oportunistë të Partisë Komuniste Italiane dhe futen kudo që gjejnë të çara. Ata janë shumë aktivë.

Veprimtaria antimarksiste, përçarëse dhe armiqësore që po zhvillojnë udhëheqësit jugosllavë, paralelisht me veprimtarinë agresive të imperialistëve, kundër kampit socialist, përbën një rrezik të madh për gjithë lëvizjen punëtore. Objektivist kjo veprimtari u shërben planeve të imperializmit. Është e ditur se imperialistët amerikanë i kanë dhënë Jugosllavisë një miliard e dyqind milion dollarë jo nga dëshira për të ndihmuar ndërtimin e socializmit, po sepse shpresojnë ta përdorin Jugosllavinë kundër kampit të socializmit. Që pas vitit 1948 është zhvilluar degjenerimi ideologjik i udhëheqjes jugosllave dhe atje është rritur një brez kuadrosh që mbajnë qëndrim armiqësor ndaj Bashkimit Sovjetik e kampit tonë socialist.

Do të ishte shumë gabim të nënvleftësohej dëmi që mund të sjellë puna përçarëse e udhëheqësve jugosllavë, duke menduar se ata s'kanë kaq forcë. Forca e tyre qëndron në faktin që ata janë antimarksistë dhe prandaj «teoritë» dhe «veprimtaritë» e tyre mbështeten nga të gjithë elementët oportunistë e të lëkundshëm, nga të gjithë armiqtë e socializmit. Në një farë mënyre ata kanë pasur disa rezultate, që, megjithëse të përkohshme, kanë dëmtuar shumë rëndë çështjen e socializmit, si në Hungari.

Ç'qëndrim duhet të mbajmë ndaj tyre? Ne mendojmë se ata nuk do të bëjnë kthesë drejt rrugës marksiste-leniniste. Këtë e themi me plot bindje, sepse mësimet e këtyre trembëdhjetë vjetëve na kanë mësuar të mos u besojmë gënjeshtreve dhe demagogjisë, që kanë patur për qëllim shkatërrimin e Partisë sonë marksiste

dhe të regjimit tonë popullor. Marksistët mund të gabojnë, por kur i njohin gabimet bëjnë kthesë dhe vijnë në binarë. Udhëheqësit e tanishëm jugosllavë s'janë marksistë derisa jo vetëm s'shohim të bëjnë asnjë kthesë, po thellojnë akoma më shumë punën e tyre antimarksiste. Mjafton të këndosh artikullin e «Borbës», ku bëhet fjalë për kongresin e tyre të ardhshëm, për të nxjerrë konkluzionin që ky kongres do të bëjë sumimin e teorisë antimarksiste e revizioniste të një partie në fuqi për të dhënë një vijë, e cila, sipas tyre, duhet të ndiqet nga të gjitha partitë dhe nga të gjitha vendet. Koha dhe veprimet e udhëheqjes jugosllave deri tani nuk na kanë provuar se ne kemi qenë të gabuar në mendimet tona. Le të na i provojë koha dhe veprimet e tyre të ardhshme nëse janë të gabuara këto pikëpamje dhe ne do të jemi gati, si kurdoherë, pse jemi marksistë, të pranojmë nëse gjykimet tona mbi jugosllavët nuk kanë qenë të drejta.

Duke marrë parasysh të gjitha këto në qëndrimin tonë kundrejt udhëheqjes jugosllave, ne duhet të udhëhiqemi kurdoherë nga parimet marksiste-leniniste, pa bërë asnjë lëshim dhe pa lejuar që të cënohen ato, duke patur gjithmonë parasysh interesat e përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të vendit tonë.

Marrëdhënje partie me ta ne nuk dëshirojmë të kemi në këto kushte, por ne do të punojmë për të ruajtur dhe për të forcuar ndjenjat e miqësisë së singertë me popujt jugosllavë, do të vazhdojmë rrugën për normalizimin dhe përmirësimin e marrëdhënjeve shtetërore midis vendit tonë e Jugosllavisë, mbi parimet e barazisë e të mosndërhyrjes në punët tona të brendshme.

Ne duhet të jemi shumë vigjilentë kundrejt udhëheqjes jugosllave dhe të gjitha përpjekjeve të tyre. Luftën ideologjike kundër pikëpamjeve të tyre revizioniste ne jo vetëm nuk do ta zbusim, por do ta forcojmë edhe më tepër, me qëllim që maska demagogjike të shkatërrohet dhe t'i pritët hovi punës shkatërruese të elementëve antimarksistë, që përpiqen të helmojnë me «teoritë» e huaja partitë dhe vendet tona, që të na nxjerrin nga rruga e drejtë marksiste-leniniste, të përçajnë kampin e socializmit dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Qëndrimi kundrejt tyre, pra, duhet të jetë i vendosur, parimor, pa asnjë lëkundje, pa asnjë iluzion, sepse lëshimet e liberalizmi vetëm dëm mund t'i sjellin çështjes sonë.

Nga ana tjetër, ne duhet të jemi gjithmonë gjakftohtë në marrëdhënjet me Jugosllavinë, të mos biem në provokacione, por nga pozita parimore ta kritikojmë udhëheqjen jugosllave, të bëjmë luftë ideologjike e politike kundër saj dhe t'i bëjmë të njohur Partisë e popullit gjendjen e vërtetë në Jugosllavi me pasojat katastrofale të së ashtuquajturës «vijë jugosllave».

Shokë!

Sulmi që shpërtheu imperializmi për të ndryshuar zhvillimin e ngjarjeve dhe për të përmirësuar pozitat e tij dështoi.

Kjo periudhë ka qenë një periudhë e vështirë për lëvizjen punëtore ndërkombëtare. Lenini ka thënë se lëvizja revolucionare s'është bulevard i Nevës. Sulmi i kombinuar i imperializmit, i forcave reaksionare fashiste dhe i revizionistëve kishte për qëllim të përcante unitetin e kampit socialist, unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Momentet që kaluam qenë të vështira, ngjarjet zhvilloheshin shpejt dhe papritur. Kjo qe periudha e një prove të madhe për çdo parti, për çdo komunist. Partia jonë e kaloi këtë provë me sukses, ajo mbajti një qëndrim plotësisht të drejtë, marksist-leninist, të palëkundur. Byroja Politike dhe qeveria kanë qenë në krye të situatës. U muarën masat e nevojshme politike, ushtarake, të sigurimit dhe ekonomike për forcimin e gjendjes së brendshme, të gatishmërisë mbrojtëse si edhe për të ngritur edhe më shumë mirëqenjen e popullit. Byroja Politike mori masat e duhura për të sqaruar Partinë dhe për të luftuar pikëpamjet revizioniste të udhëheqjes jugosllave e të tjerëve. Gjithë Partia dhe populli dënuan me vendosmëri veprimtaritë dhe pikëpamjet armiqësore dhe me entuziazëm të paparë mbështetën politikën e Partisë. Kurrë s'kanë qenë kaq të fortë uniteti i Partisë, lidhjet e saj me masat, gatishmëria, entuziazmi dhe mobilizimi i komunistëve, i popullit, i rinisë. Edhe elementë të lëkundshëm intelektualë ose të shtresave të mesme në ato çaste kur imperialistët kërcënonin pavarësinë e Shqipërisë së re u afruan edhe më shumë me Partinë, sepse shikonin te ajo mbrojtësen e vendosur dhe besnike të interesave më jetike të popullit tonë. Entuziazmi i madh, me të cilin u festua 15-vjetori i themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë, dhe rezultatet e shkëlqyera të zgjedhjeve të këshillave popullore janë një provë e pamohueshme e dashurisë dhe e besimit të palëkundur që kanë masat te Partia dhe te pushteti popullor.

Qëndrimi i drejtë që mbajti Partia jonë, qëndrimi i drejtë i patundur i popullit tonë në këto çaste janë një fitore e madhe për ne dhe patjetër na gëzojnë neve dhe gjithë miqtë tanë. Partia jonë relativisht është një parti e re dhe me një nivel jo aq të lartë kulturale dhe teorik. Partia ka bërë gabime konkrete, si p.sh. në çështjet ekonomike etj., dhe gabime të kësaj natyre mund të ketë edhe në të ardhmen. Por deviatorët e ndryshëm s'kanë mundur ta nxjerrin Partinë tonë nga binarët, ata janë zbuluar me kohë dhe janë luftuar me vendosmëri. Në çështjet kryesore, në çështjen e mbrojtjes së marksizëm-leninizmit, të Bashkimit Sovjetik, të kampit socialist, të interesave të masave punonjëse dhe të pava-

rësisë së vendit tonë, në luftën kundër armiqve, ne s'kemi gabuar dhe kurrë nuk do të gabojmë. Dhe këtë ne ja dedikojmë besnikërisë së pakufishme ndaj marksizëm-leninizmit, unitetit të çeliktë të Partisë sonë.

Nga zhvillimi i këtyre ngjarjeve, shokë, Partia jonë duhet të nxjerrë mësim të mëdha. Cilat janë detyrat tona?

Në radhë të parë duhet të luftojmë për forcimin e unitetit të kampit të socializmit nën flamurin e internacionalizmit proletar, nën flamurin e marksizëm-leninizmit. Ne duhet të luftojmë me vendosmëri çdo përpjekje për të përçarë kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Në qëndrimin ndaj shteteve kapitaliste, së pari, duhet të kemi parasysh që shtetet e kampit socialist të rrisin vigjilencën dhe gatishmërinë, forcën e tyre ekonomike dhe ushtarake në luftën kundër planeve agresive të imperializmit. Kjo nuk do të thotë se ne do të heqim dorë nga politika për uljen e tensionit ndërkombëtar. Po të jetë nevoja ne do t'u përgjigjemi imperialistëve edhe me armë (për këtë duhet të jemi të fortë e të gatshëm kurdoherë), por ne duhet edhe në të ardhmen të ndjekim me vendosmëri rrugën për uljen e tensionit ndërkombëtar, të përiqemi të mbrojmë paqen. Këtë gjë e bën të mundshme gjendja objektive e raportit të forcave në botë. Këtë gjë e kërkojnë interesat jetike të popujve tanë, që i kanë vënë vetes detyrën të ndërtojnë socializmin, këtë e kërkojnë interesat e mbarë popujve të botës. Por këtë politikë ne do të mund ta zbatojmë me sukses vetëm po të jemi të fortë dhe të bashkuar si një trup i vetëm. Forca dhe uniteti i kampit të socializmit janë faktori kryesor për mbrojtjen e paqes, të lirisë së popujve dhe të përparimit të njerëzimit. Detyra jonë është të rrisim vigjilencën kundër armikut të klasës, i cili punon me çdo mënyrë kundër rendit të demokracisë popullore dhe pret rastin e volitshëm për ta goditur atë. Forcimi i vigjilencës, forcimi i lidhjeve të Partisë me masat janë mjete të fuqishme për të luftuar kundër armiqve, për të mos lejuar që ata të prekin sado pak rendin demokratik popullor. Çdo dobësim i rendit tonë demokratik është një lëshim që i bëhet armikut. Prandaj forcimi i pushtetit popullor, që luan rolin e diktaturës së proletariatit, është detyra kryesore e tanishme.

Detyra kryesore e Partisë është të forcojë unitetin e saj ideologjik, organizativ dhe politik, të forcojë e të ngrejë në një nivel më të lartë rolin e saj udhëheqës në luftën për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste. Uniteti i Partisë duhet të forcohet dhe të ruhet si sytë e ballit, pse ai është baza e fuqisë së saj. Uniteti i udhëheqjes së Partisë, uniteti i gjithë Partisë në çdo kohë ka qenë i çeliktë. Si dhi të zgjebosura janë eliminuar përnjëherë dhe me unanimitet të plotë të gjithë ata elementë deviatorë dhe armiq të Partisë, që kanë ngritur veshët për të dobësuar këtë unitet të

çeliktë. Forcimi i këtij uniteti ka shkuar gjithnjë duke u rritur. Në çastet e turbullta dhe të rrezikshme të kohërave të fundit, uniteti i gjithë Partisë rreth Komitetit Qendror dhe Byrosë së tij Politike ka qenë i shkëlqyer, i çeliktë, i pamposhtur. Ta ruajmë, ta forcojmë edhe më shumë në rrugën marksiste këtë unitet të çeliktë, garanci e vërtetë e fitoreve të Partisë dhe të popullit.

Në situatën e sotme ka një rëndësi të dorës së parë forcimi i luftës ideologjike kundër pikëpamjeve revizioniste e antimarksiste, forcimi i luftës për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Në luftën kundër socializmit elementët antimarksistë, oportunistë e revizionistë luajnë një rol të madh. Dihet se në kushte të caktuara dhe në kohë të ndryshme del në plan të parë herë një formë e luftës së klasave e herë një tjetër. Në kushtet e tanishme në plan të parë ka dalë lufta në fushën ideologjike. Prandaj puna e Partisë për edukimin politik e ideologjik të anëtarëve të Partisë dhe të të gjitha masave merr një rëndësi të dorës së parë, natyrisht pa harruar punën në drejtimet e tjera. Në ditët tona armiqtë e marksizmit punojnë zakonisht në mënyrë të maskuar; ata e veshin veprimtarinë e tyre revizioniste, oportuniste me frazeologji të majta, me parulla «marksiste». Prandaj edhe vigjilenca jonë duhet të jetë gjithnjë më e mprehtë. Le të kemi kurdoherë parasysh fjalët e Leninit të pavdekshëm, i cili thoshte:

«Mos u besoni frazave, shihni më mirë se në dobi të kujt janë ato!»²⁷

Mbrojtja e marksizëm-leninizmit kërkon sot të demaskohet dhe të luftohet në radhë të parë propaganda antimarksiste dhe revizioniste e udhëheqësve jugosllavë. Lufta ideologjike nuk duhet të nënvleftësohet në asnjë mënyrë, sepse helmi i ideologjisë së huaj përdoret nga armiqtë e socializmit për të çarmatosur klasën punëtore. Ngjarjet e fundit vërtetuan se sa dëme të mëdha mund t'i vijnë klasës punëtore kur dobësohet sado pak lufta ideologjike, sa shumë e shfrytëzojnë armiqtë neglijencën e palejueshme në këtë fushë.

Të gjitha forcat e Partisë dhe të masave duhet të mobilizohen për të realizuar planin e shtetit, sepse kështu ne forcojmë edhe gjendjen politike të brendshme, rrisim fuqinë e vendit tonë. Ekonomia jonë popullore po zhvillohet dita-ditës. Vitin që kaloi u shënuan suksese të rëndësishme. Prodhimi i përgjithshëm industrial u realizua 102.2% dhe sektori i ndërtimeve e realizoi planin 105%. Të pakënaqshme duhen konsideruar rezultatet në tregëtinë shtetërore dhe kooperativiste, si dhe në sektorin e transportit, të cilët nuk realizuan planin. Bujqësia, që zë një vend të rëndësishëm në ekonominë tonë, shënoi një kthesë të madhe përsa i përket kolektivizimit, por duhet thënë se prodhimet, me gjithë rritjen në krahasim me vitet e përparshme bujqësore në përgjithësi, nuk u realizuan. Kjo krijon vështirësi serioze për ekonominë tonë. Ne

jemi të detyruar kështu të importojmë sivjet drithëra, pambuk e yndyrna sa asnjëherë. Viti që kaloi nuk ishte i mirë për bujqësinë, por dobësitë e theksuara që vërtetohen në këtë sektor rrjedhin edhe për faktin se kjo degë e rëndësishme e ekonomisë sonë drejtohet ende në mënyrë të përciptë dhe burokratike. Detyrat që na dalin për realizimin e planit të vitit 1957 janë të mëdha e të rëndësishme. Duhet hequr dorë me vendosmëri nga drejtimi i përgjithshëm dhe të merremi konkretisht me problemet kardinale të ekonomisë, të fuqizojmë aparatën shtetëror, të luftojmë burokracinë dhe të gjitha të metat e tjera. Duhet të forcohet puna politiko-organizative e organizatave të Partisë e të masave, si edhe e të gjitha organeve të propagandës për të siguruar mobilizimin efektiv të të gjitha masave punonjëse për realizimin e planit.

Partia jonë do të luftojë me të gjitha forcat e saj për të plotësuar këto detyra të mëdha. Besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit, ajo do të vazhdojë me vendosmëri të ecë përpara në rrugën e socializmit.

**Botohet sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë**

Nr.101

V E N D I M :

**MBI APROVIMIN E RAPORTIT TË BYROSË POLITIKE TË KQ
TË PPSH TË PARAQITUR NGA SHOKU ENVER HOXHA**

16 shkurt 1957

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 13 shkurt 1957, pasi dëgjoi raportin e Byrosë Politike të paraqitur nga Sekretari i Parë, shoku Enver Hoxha, «Mbi gjendjen ndërkombëtare dhe detyrat e Partisë» dhe pasi diskutoi mbi problemet që ngrihen në këtë raport,

V e n d o s i :

Të aprovojë plotësisht raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH të paraqitur në plenum nga Sekretari i Parë, shoku Enver Hoxha, «Mbi gjendjen ndërkombëtare dhe detyrat e Partisë». Të gjitha organizatat dhe organet e Partisë të mobilizohen për zbatimin e plotë të detyrave që parashikohen në këtë raport.

PLENUMI I KOMITETIT QËNDROR TË PPSH

**Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 41,
datë 17 shkurt 1957**

PLENUMI VI I KQ TË PPSH

Tiranë, 10-12 korrik 1957

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Nga 10 deri më 12 korrik u mbajt Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili diskutoi:

1. — Raportin «Mbi tregëtinë shtetërore e kooperativiste dhe masat për zhvillimin e saj», mbajtur nga sekretari i KQ të PPSH, shoku Haki Toska.

2. — Raportin «Mbi gjendjen e kuadrit në RP të Shqipërisë dhe detyrat për të ardhshmen», mbajtur nga sekretari i KQ të PPSH shoku Rita Marko.

Plenumi aprovoi njëzëri raportet e paraqitura dhe mori vendimet përkatëse.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Nr. 102

NGA RAPORTI

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI GJENDJEN E KUADRIT NË RPSH DHE DETYRAT PËR TË ARDHSHMEN»

12 korrik 1957

Shokë,

Byroja Politike e Komitetit Qendror vendosi t'i paraqesë këtij plenumi raportin «Mbi gjendjen e kuadrit në RPSH dhe detyrat për të ardhshmen». Në periudhën që kalojmë, kur është ndërtuar një industri e re moderne, e pajisur me një teknikë shumë të përparuar, kur kolektivizimi i bujqësisë po ecën me hapa shumë të shpejta dhe... po hapen perspektiva të shkëlqyera për zhvillimin e shpejtë ekonomik e kultural të vendit tonë gjatë periudhës së 10-15 vjetëve të ardhshëm, në këtë periudhë që kalojmë, problemi i kuadrit, mund të themi, bëhet vendimtar.

S'ka dyshim se problemi që do të analizojmë nuk është i ri

për shokët e KQ dhe për gjithë Partinë. Ne vazhdimisht, gjatë gjithë punës sonë, në plenumë të tjera e në kongrese, e kemi diskutuar këtë. Por sot ne duam që në mënyrë të veçantë më gjërisht dhe në tërë aspektet e tij të ndalemi në këtë problem, të analizojmë më thellë punën tonë në këtë drejtim dhe të përcaktojmë detyra më konkrete për zgjidhjen e nevojave shumë të mëdha dhe urgjente që na shtrohen në këtë fushë.

Të gjithë ne e dimë se sa i madh dhe i vështirë ishte problemi i kuadrove për Partinë tonë që në ditët e para të krijimit të saj. Partia jonë e re, e porsakrijuar, nuk kishte as komandantë dhe as komisarë të pregatitur, por ajo i krijoi dhe i rriti ata në luftë e sipër, në zjarrin e luftës. Dhe pastaj, me marrjen e pushtetit në dorë nga ana e masave punonjëse, me krijimin, zgjerimin e sektorit socialist të ekonomisë, me zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës te ne, lindën nevoja kolosale për kuadro besnikë e të aftë e në gjendje të drejtonin me sukses jetën e vendit. Edhe këtë detyrë Partia jonë e ka realizuar deri më sot në mënyrë të kënaqshme, me gjithë vështirësitë e mëdha që paraqiteshin dhe prapambetjen e madhe që trashëguam nga e kaluara.

Si ka punuar Partia jonë për përgatitjen e kuadrove, veçanërisht në periudhën pas çlirimit dhe cilat janë rezultatet?

Në radhë të parë, me qindra e mijëra kuadro të aftë për të kryer me nder detyrat që u ngarkoheshin u rritën dhe u përgatitën në luftë për realizimin e detyrave të rindërtimit të vendit dhe të ndërtimit të bazave të socializmit. Jeta, praktika, lufta — kjo ishte shkolla e parë, forma bazë që përgatiti dhe krijoi në fillim kuadrot tanë kryesorë.

Së dyti, mijëra e mijëra kuadro u përgatitën nëpërmjet të avancimit të punëtorëve të pararojës, besnikë të çështjes së Partisë, duke organizuar për ta kurse perfeksionimi e shkolla pa u shkëputur nga puna. Tani ne kemi në vendin tonë një sistem të tërë shkollash e kursesh për përgatitjen e kuadrove, pa i shkëputur nga prodhimi, siç do ta shikojmë dhe më poshtë.

Së treti, një pjesë e kuadrove janë përgatitur me anën e aktivizimit dhe të riedukimit të inteligjencies së vjetër përparimtare.

Dhe, së katërti, me anën e përgatitjes së kuadrove në shkolla të rregullta brenda e jashtë shtetit.

... Jeta e këtyre 13 vjetëve nën pushtetin popullor ka vërtetuar plotësisht se kjo rrugë që ndoqi Partia ka qenë e drejtë. Sukseset e shkëlqyera ka korrur populli ynë në këto 13 vjet. Çlirimi i atdheut, shndërrimi i vendit tonë nga një vend i prapambetur agrar në një vend agraro-industrial, sukseset e korrura në punën për ndërtimin e bazave të socializmit pa dyshim i detyrohen në një masë të rëndësishme punës që kanë bërë kuadrot tanë.

Revolucioni ynë popullor përmbysi nga themeli pushtetin e vjetër dhe në krye të pushtetit të ri të punëtorëve e të fshatarëve,

në udhëheqje të të gjithë sektorëve të jetës së vendit u vunë kuadrot tanë të rinj të dalë nga lufta për çlirimin dhe ndërtimin socialist të vendit.

Kështu, në fund të pesëvjeçarit të parë kishim 232 për qind kuadro të lartë dhe 252 për qind kuadro të mesëm më shumë se në vitin 1950. Vetëm gjatë 5-vjeçarit të parë janë kualifikuar 44.900 punëtorë të rinj dhe është ngritur kualifikimi i 41.100 punëtorëve ekzistues. Kështu deri në fund të vitit 1955, 62 për qind e punëtorëve të të gjithë ekonomisë sonë ishin të kualifikuar. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë përgatitur 6.300 kuadro teknikë të mesëm, nga të cilët rreth 4.800 me arësim të mesëm special dhe 1000 kuadro të lartë. Nga specialistët, teknikë të lartë që trashëgoi vendi ynë nga e kaluara, pati një pjesë që qysh gjatë luftës u vu krejtësisht në shërbim të armikut, prandaj, mbas çlirimit, u gjend në atë anë të barikadës. Pjesa tjetër simpatizoi lëvizjen dhe mori pjesë aktive në luftën për çlirimin e atdheut ose i qëndroi besnik asaj. Pas çlirimit, pushteti popullor u përpoq të shfrytëzojë në interes të popullit dijenitë e tyre. Pa dyshim pati ndër ta njerëz që mbajtën qëndrim armiqësor ndaj pushtetit, u munduan të sabotojnë ekonominë tonë, por pjesa më e madhe punoi dhe punon për ndërtimin e socializmit. Kështu që në sektorët e ekonomisë, të shkencës, të kulturës e të shëndetësisë punojnë sot mbi 370 teknikë të lartë që kanë mbaruar studimet e tyre para çlirimit. Në saje të trajtimit të drejtë nga ana e Partisë dhe e shtetit, në saje të forcimit të gjithanshëm të vendit tonë, të kampit të socializmit e të paqes, me BS në krye, një pjesë e mirë e këtyre kanë vendosur e po vendosin përditë e më shumë të vënë me ndërgjegje në shërbim të popullit të gjitha dijet e tyre.

Me anën e shkollave jashtë shtetit dhe në vend, deri në fund të 1956 janë përgatitur 1715 vetë, shumica në BS dhe në vendet e demokracisë popullore. Kështu në Bashkimin Sovjetik 451, në Bullgari 146, në Çekoslovakia 151, në Hungari 111, në Rumani 95, në Poloni 69.

Nga ana tjetër Partia jonë ka punuar që kuadrot tanë të rriten jo vetëm në numër, por njëkohësisht të përgatiten kuadro në radhë të parë nga shtresat e varfëra sidomos punëtores, kuadro besnikë deri në fund ndaj Partisë, popullit dhe atdheut.

Në tërë këtë punë për zgjedhjen, rritjen dhe përgatitjen e kuadrove, Partisë i është dashur të luftojë kundër shfaqjeve të huaja dhe shtrembërimeve në politikën e kuadrit, kundër pikëpamjeve sektare dhe shpirtit të repartit, kundër prirjes së nënvleftësimit të kuadrove të rinj si dhe kundër vetëkënaqësisë dhe mburrjes me të kaluarën që shfaqej në disa kuadro etj. Rezultatet që përmendëm tregojnë se kjo luftë e Partisë është kurorëzuar me sukses, megjithëse, siç do ta shohim edhe më poshtë, ende nuk jemi shkëputur plotësisht nga të meta të tilla.

Kongresi III i PPSH vuri si detyrë që të forcohet kontrolli i përgjithshëm i Partisë në punën me kuadrot dhe të përmirësohet puna për zgjedhjen dhe edukimin e tyre, të shtohet kujdesi për njohjen e kuadrove dhe për ngritjen e kuadrove të rinj nga radhët e punëtorëve të prodhimit. Të luftohet kundër lëvizjeve të tepërta e pa kriter dhe kundër vendosjes së kuadrove mbi baza familjare. Të ngrihet niveli teknik e profesional i kuadrove. Të bëhet një studim i saktë i nevojave që ka vendi ynë për kuadro. Të përmirësohet seriozisht puna në kurset e kualifikimit, sidomos përsa i përket cilësisë së punës në to, duke u udhëhequr nga parimi që t'i japim shtetit sa më shumë kuadro dhe të përgatitur sa më mirë. Në programet e kurseve e të shkollave t'i jepet rëndësi e madhe mësimi në praktikë. Kongresi porositi që për gjithë Partinë dhe organet shtetërore problemi i kuadrit duhet të bëhet problemi më i rëndësishëm ndër më të rëndësishmit. Në këtë raport ne do të ndalemi në një analizë më të hollësishme të këtyre çështjeve dhe posaçërisht do të mundohemi të përcaktojmë disa masa konkrete për zgjedhjen e detyrave që na shtroi Kongresi III i PPSH.

— I —

DISA ÇËSHTJE TË PËRBËRJES SË KUADRIT

Për ta analizuar gjerësisht këtë problem jemi të detyruar të përdorim disa pasqyra statistikore, të përmendim mjaft shifra që të mund të bazohemi në to dhe, natyrisht duke u mbështetur edhe në ato çka tregojnë vetë jeta, të nxjerrim disa konkluzione të përgjithshme.

Si total në tërë republikën në fund të vitit 1956 punonin 32454 kuadro, pa ushtrinë dhe Ministrinë e Brendshme. Në përqindje përbërja e tyre paraqitet si vijon:

	Punëtorë	Të shtresave			Studentë ose shtëpiakë	% e femrave mbi totalin	% elementëve pa parti	M o s h a		
		Të varfër	Të mesëm	Të pasur				18-30 vjeç	31-45 vjeç	46 vjeç e lart
Origjina e kuadrit	11.7	49.3	32.9	5.9		20.20	67.2	53.9	36.7	9.3
Gjendja e kuadrit	9.6	34.1	15.6	2.4	38					

Shënim: Kudo gjatë raportit, për origjinë merret për bazë puna e prindërve, ndërsa për gjendje merret për bazë puna që ka bërë vetë kuadri para se të merret si nëpunës në pushtetin popullor.

Duke analizuar të dhënat e mësipërme mund të arrijmë në këto konkluzione kryesore:

a) Në shumicën dërmuese kuadrot tanë janë kuadro të dalë nga gjiri i masave punonjëse të vendit tonë; ato i karakterizojnë besnikëria për Partinë, popullin, për Bashkimin Sovjetik dhe kampin e socializmit. Kjo, si rezultat i influencës së thellë të propagandës së Partisë mbi këto kuadro qysh gjatë Luftës nacional-çlirimtare dhe pas çlirimit.

b) Kuadrot tanë janë kuadro të dalë nga lufta për çlirimin e atdheut dhe për rindërtimin e vendit e ndërtimin e bazave të socializmit. Natyrisht ata s'kanë patur mundësi të jenë në një nivel të lartë kulturalo-arësimesor etj., por ata janë të rrahur me vështirësitë e jetës dhe të mësuar të luftojnë me vështirësitë, të lindur e të rritur bashkë me Shqipërinë e re, pjesëmarrës aktivë në të gjitha fitoret që ka arritur vendi ynë, prandaj të vendosur për të mbrojtur e për të çuar përpara këto fitore.

c) Kuadrot tanë në shumicë janë kuadro të rinj. Në moshë prej 18-30 vjeç kemi 53,9 për qind të kuadrove, prej 31-45 vjeç 36,7 për qind dhe vetëm 9,3 përqind të kuadrove janë të moshës 46 vjeç e lart. Pra si të tillë, janë kuadro me perspektivë e që do të ecin përpara.

ç) Në përbërjen e kuadrove tanë kemi një numër të konsiderueshëm komunistësh (32,6 për qind të të gjithë efektivit), të cilët jo vetëm në shumicë janë shembull për kuadrot e tjerë, por me forcën e vijës së Partisë mobilizojnë gjithë kuadrot e tjerë për realizimin e detyrave. Veç kësaj shtrirja e Partisë në të gjithë sektorët në përgjithësi u përgjigjet detyrave të planit.

Këto janë disa anë pozitive në përbërjen e kuadrove tanë, mbi të cilët mund të mbështetemi me siguri për rezultate në të ardhmen. Por megjithkëtë nga të dhënat që u paraqitën më lart ne nuk mund ta konsiderojmë të kënaqshme përbërjen e kuadrove tanë.

Cilat janë dobësitë kryesore dhe masat që duhen marrë:

1) Megjithëse në shumicë në efektivin e gjithë kuadrove mbi-sundojnë kuadrot e dalë nga shtresat e varfëra (rreth 61 për qind), kuadrot e dalë nga klasa punëtore përfaqësojnë akoma një përqindje të vogël mbi numrin e gjithë kuadrove që kemi (vetëm 11,7 për qind me origjinë dhe 9.6 për qind me gjendje). Dhe e keqja është se ritmi i përmirësimit të kësaj dobësie është shumë i pakënaqshëm. Kështu, në krahasim me vitin 1953 kemi një rritje vetëm prej 1,3 për qind. Ky është një defekt i rëndësishëm në përbërjen e kuadrove tanë dhe që duhet punuar seriozisht në të ardhmen për ta përmirësuar.

Si mund të shpjegohet një gjendje e tillë?

Dihet se ne kemi trashëguar nga e kaluara një prapambetje të madhe; Partisë sonë ju desh t'ja fillonte punës për ngritjen

e nivelit arësimesor e kultural të punonjësve që nga lufta kundër analfabetizmit. Veç kësaj kontingjentet e para që gjetëm në shkollat tona në vitet e para pas çlirimit nuk vinin prej punëtorëve, por në shumicë prej shtresave të mesme e të pasura. Pa dyshim këto arësye kanë influencuar në përbërjen e kuadrit. Por kjo s'është e gjitha. Duhet pranuar se nuk është bërë një punë e kujdesshme për zgjedhjen, edukimin dhe ngritjen e kuadrit nga radhët e klasës punëtore. Dobësia kryesore në këtë drejtim qëndron në punën e pamjaftueshme për edukimin e klasës punëtore. Burokracia që ekziston në aparatet shtetërore është shkaku kryesor i lidhjeve të pamjaftueshme me punonjësit dhe i punës së dobët që bëhet për edukimin e tyre. Pa shkuar te punëtorët, pa hequr gardhet që qëndrojnë njëri mbi tjetrin dhe që mbajnë larg kuadrot kryesorë nga baza nuk mund të njihen ata dhe as mund të ndihmohen. Shpesh bëhet një politikë pa perspektivë me kuadrin, duke u kufizuar në një rreth të ngushtë njerëzish, të cilët transferohen sa andej-këtej dhe nuk ka kujdes për të ngritur në vende me përgjegjësi elementë punëtorë, të cilët në fillim sigurisht do të kenë vështirësi, nuk do të kenë zotësi administrative e drejtimi, por që shpejt do t'i fitojnë ato. Dhe një gjë është e sigurt, këtë e ka treguar qartë praktika e deritanishme: kuadrot që ngrihen nga prodhimi janë më praktikë, ata njohin mirë proceset e punës, gjë që shumë nga kuadrot e tjera «me zotësi administrative» nuk e kanë; ata njohin mirë çështjet e normimit të punës pa shumë fjalë dhe dinë të organizojnë më konkretisht prodhimin. Kuadrot e dalë nga prodhimi dinë të lidhen më shpejt e më mirë me punëtorët, i çmojnë më objektivistisht vështirësitë e tyre dhe qëndrojnë më afër tyre si prodhues të të mirave materiale. Kuadrot e ngritur nga radhët e punëtorëve të përparuar dinë të luftojnë më me vendosmëri kundër metodave burokratike të drejtimit, e njohin më mirë realitetin e ndërmarrjes.

Duke qenë kështu, për të përmirësuar përbërjen e kuadrove tanë me elementë punëtorë, është e nevojshme:

a) Të shkëputemi nga format burokratike të punës, ta luftojmë burokracinë si një të metë të madhe në tërë punën tonë e veçanërisht në punën me njerëzit dhe të luftojmë që të mos infektohen edhe të tjerë nga kjo sëmundje. Duhet, pra, t'i njohim punëtorët, elementët më të përparuar të klasës punëtore, t'i ngarkojmë këta me përgjegjësi dhe t'i ndihmojmë që të mos thyhen në vështirësitë e para që mund të hasin. Të dalim nga rrethi i ngushtë i njohjes vetëm ose më shumë të njerëzve të zyrave. Dhe, që të njihen punëtorët nga kuadrot kryesorë, duhet të shkohet më dendur te punëtorët, të punohet tok me ta. Në këtë mënyrë do të gjykojmë më drejt dhe do të heqim dorë nga puna burokratike me relacione, mbledhje, studime, analiza brenda zyrave.

b) Të përmirësojmë punën për edukimin ideo-politik e kul-

tural të klasës punëtore, duke shtuar shumë më tepër se sa tani aktivitetin tonë në këtë drejtim. Duhet patjetër të ngrëmë nivelin e kësaj pune dhe të lidhim punën ideo-politike me detyrat e prodhimit. Në këtë drejtim ne duhet patjetër të përmirësojmë punën me Bashkimet Profesionale, t'i bëjmë ato me gjithë mend shkolla të komunizmit. Organet udhëheqëse të Bashkimeve Profesionale në qendër, qarqe e rrethe të heqin dorë përfundimisht nga formalizmi në punë; aparatet e tyre të thjeshtohen, të bëhen sa më operative dhe të mbështetin aktivitetin e tyre në radhë të parë në aktivin e tyre, se sa në njerëzit me rrogë. Organizatat e Partisë dhe Bashkimet Profesionale duhet të organizojnë një fushatë të tërë propagandistike për rritjen e iniciativës së punonjësve të thjeshtë, të kurajos komuniste për të kaluar çdo pengesë.

c) Të përmirësojmë punën për edukimin profesional të punëtorëve, duke filluar nga kurset e perfeksionimit dhe deri në pajisjen e punëtorëve me arësim të lartë profesional. Për këtë mendojmë se duhen marrë disa masa të shpejta dhe të efektshme:

— Të zgjerohet pjesëmarrja e punëtorëve në shkollat e natës e me korrespondencë, duke filluar që nga filloret, 7-vjeçarët, teknikumet e institutet pa u shkëputur nga prodhimi.

— Duke marrë parasysh faktin se tani 62 për qind e të gjithë punëtorëve kanë kryer kurse kualifikimi, dhe se kemi një kontingjent të mirë punëtorësh me stazh pune dhe arësim 7-vjeçar, mund të zgjerohet rrjeti i teknikumeve të natës e me korrespondencë, sidomos në qytetet e mëdha (Durrës, Korçë, Shkodër, Vlorë).

— Të tërhiqen nga prodhimi rreth 500 kuadro punëtorë çdo vit për t'u përgatitur në shkolla të mesme profesionale me afat të shkurtër. Me mbarimin e shkollës së mesme, një pjesë e tyre të dërgohen në prodhim dhe pjesa tjetër të mbetet si kontingjent për shkollat e larta.

— Komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive dhe ndërmarrjet duhet të realizojnë plotësisht kontingjentet për kurset e shkollat dhe të kenë parasysh që të dërgohen sa më shumë elementë nga radhët e klasës punëtore. Po kështu duhet punuar më shumë për të përmirësuar përbërjen e shkollave të mesme, posaçërisht të gjimnazeve me elementë që mbarojnë 7-vjeçaren. Dihet se çdo vit tërhiqen për në shkollat e mesme rreth 45 për qind të kontingjenteve që mbarojnë 7-vjeçarët, ndërsa mbi 77 për qind të kontingjenteve që mbarojnë gjimnazet kalojnë në institutet. Duke qenë kështu, duhet punuar që të tërhiqen në shkollat e mesme në radhë të parë bijtë e punëtorëve dhe të fshatarëve të varfër që mbarojnë 7-vjeçarët. Lidhur me këtë, në kushtet e tanishme, kur niveli kultural dhe gjendja ekonomike e fshatit është përmirësuar, përqindja e bursave për qytetin mund të jetë më e madhe se sa deri tani, d.m.th. mund të arrijë nga 10-20%.

— Një numër gjithnjë më i madh punëtorësh komunistë

duhet të kalojnë në shkollat e kurset e Partisë, po kështu në kurset e bashkimeve profesionale, të rinisë etj.

Në mënyrë të veçantë duhet shikuar puna për edukimin e disa kuadrove më të dalluar të prodhimit që ka vendi ynë, të cilët kanë funksione dhe tituj të rëndësishëm. Është fjala këtu për ata që janë deputetë, heronj të popullit e të punës socialiste si edhe elementë të tjerë të shquar të prodhimit. Titujt dhe funksionet që mbajnë këta njerëz i mbajnë për meritat e mëdha që kanë ndaj popullit dhe atdheut, por niveli i një pjese të këtyre është i ulët. Prandaj duhen marrë masa që të dërgohen në shkolla për të zgjeruar njohuritë e tyre kulturele e profesionale; ata që për arësye të moshës etj. nuk mund të specializohen për ndonjë degë prodhimi duhen dërguar në Shkollën e Partisë për të zgjeruar dijet e tyre dhe të pajisen me ideologjinë marksiste-leniniste. Kjo ka rëndësi të madhe për t'i bërë këta që të jenë konsekuente në veprimtarinë e tyre në dobi të popullit dhe që të bëhen më të aftë për ta përfaqësuar gjithnjë e më mirë popullin dhe shtetin tonë si brenda ashtu edhe jashtë.

Këto janë disa masa që mendojmë se janë të nevojshme të merren për zbatimin e detyrës së rëndësishme që na vuri Kongresi III i Partisë për përmirësimin e përbërjes së kuadrit me punëtorë. Por edhe një herë theksojmë se çështja kryesore mbetet gjithmonë kujdesi i përhershëm i organeve dhe i organizatave të Partisë dhe i organeve shtetërore për zgjedhjen dhe përgatitjen e kuadrit punëtor në punë e sipër, mbasi edhe në të ardhshmen lufta për ndërtimin e bazave të socializmit mbetet shkolla dhe terreni i parë për edukimin dhe përgatitjen e kuadrit. S'ka dyshim se kjo luftë duhet të bëhet më efektive në ndërmarrjet ekonomike dhe në rrethet ku kemi klasën punëtore më të përqëndruar, por njëkohësisht një luftë e tillë duhet të bëhet edhe në të gjithë sektorët e tjerë. As në sektorin e bujqësisë, që ka vetëm 7,4 për qind të kuadrit me origjinë e gjendje punëtore, nuk mund të justifikohet një përqindje kaq e ulët, duke marrë parasysh faktin që ne kemi sot një numër të konsiderueshëm punëtorësh të bujqësisë.

2) Një detyrë tjetër e rëndësishme që na ngarkoi Kongresi III i Partisë është kujdesi që duhet të tregojnë organet dhe organizatat e Partisë për ngritjen e grave në përgjegjësi. Ndërsa në vitin 1953 gratë zinin vetëm 14.1 për qind të efektivit të kuadrove, tani ato zënë 20.2 për qind. Gjatë këtij viti ka një kujdes më të madh në këtë drejtim, sidomos nga komitetet e Partisë. Kështu këtë vit janë ngritur në përgjegjësi 126 gra, ndërsa në 1955 vetëm 99, janë emëruar 188, ndërsa në 1955 vetëm 98 dhe janë pushuar vetëm 19, ndërsa në vitin 1955 — 20. Por duhet thënë se nga ana e dikastereve kjo çështje s'është mbajtur parasysh. Kështu ndërsa nga ana e tyre janë bërë 19 ngritje të reja, njëkohësisht janë bërë edhe 22 pushime.

Pa dyshim as mund të bëhen krahasime me të kaluarën lidhur me përparimet që ka bërë vendi ynë përsa i përket pjesëmarrjes së gruas në prodhim e në jetë. Por megjithkëtë duhet thënë se pjesëmarrja e grave mbi totalin e kuadrove duhet shtuar akoma. Ne kemi në gjithë kuadrot që përfshijnë organikat vetëm 6579 gra mbi 32454 kuadro; kjo është pak po të marrim parasysh faktin që të prakun e çlirimit ne kishim në radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare rreth 6000 gra e të reja. Veç kësaj duhet theksuar se ka shumë pak gra në vende me përgjegjësi, prandaj duhet luftuar veçanërisht për ngritjen e grave në vende me përgjegjësi. Shumica e tyre janë me përgjegjësi nga referente e poshtë. Kështu, në përbërjen e kuadrove kryesorë të administratës qendrore (nga kryetar dege e lart), gratë zënë vetëm 7,9 për qind, ndërsa në përbërjen e kuadrove kryesorë drejtues të prodhimit dhe të pushtetit lokal zënë përkatësisht 1,5 për qind dhe 12 për qind. Në 87 shefa llogarie ka vetëm 1 grua. Në trikotazhin e Korçës e në tisazhin e Shkodrës, ku efektivit i punonjësve përbëhet nga gra, përgjegjësit janë burra, në NISH Këpuca, ku gati 87 për qind e punëtorëve janë gra, s'ka asnjë përgjegjëse.

Ka sektorë ku përqindja e grave duhet të jetë në mënyrë absolute më e madhe, si në arësim, në shëndetësi, në tregëti, në kuadrin e llogarisë etj. Por edhe në këta sektorë ka ende pak gra, përkatësisht 35,7 për qind; 42,1 për qind; 20,3 për qind; 26,4 për qind.

Ku duhen gjetur shkaqet kryesore të këtyre të metave.

Së pari, në punën e pamjaftueshme për edukimin ideo-politik, kultural e profesional të grave. Ngritja e kuadrove nga masat e grave nuk mund të bëhet në mënyrë mekanike, duke bërë disa lista se ku mund të punojnë gratë, siç vepohet shpesh te ne. Kjo kërkon nga ana e tërë Partisë, e organizatave të masave dhe e organeve të pushtetit një punë të madhe dhe të vazhdueshme për edukimin ideo-politik e profesional të grave, për t'i dërguar këto në kurse e shkolla që të specializohen. Nga ana tjetër duhet organizuar një luftë e vendosur kundër mentalitetit prapanik që ekziston ende në disa kuadro, të cilët nënvleftësojnë forcën e gruas si anëtare të shoqërisë, si pjesëtare aktive të shoqërisë sonë, që është në gjendje të kryejë çdo punë të dobishme për shoqërinë. Njëkohësisht duhet luftuar ndjenja e inferioritetit që ekziston në mjaft gra. Të edukohen këto me besimin dhe kurajon komuniste në vetëvete dhe me dashurinë për punën. Propaganda e Partisë duhet t'u hapë gjithnjë e më shumë perspektiva grave, sepse përmirësimi i konditave materiale për fëmijët e tyre e për gjithë popullin varet shumë edhe nga pjesëmarrja aktive e tyre në punë prodhimi.

Së dyti, shkaku i të metave në punën për futjen e grave në punë dhe për ngritjen e tyre në përgjegjësi duhet gjetur në punën

e pamjaftueshme që është bërë për t'u krijuar kondita lehtësuese për punën e tyre si nëna dhe amvisa. S'ka dyshim se në këtë drejtim janë bërë mjaft përparime në krahasim me të kaluarën, por duhet të themi se ne nuk i kemi shfrytëzuar si duhet ose plotësisht të gjitha mundësitë që ekzistojnë në vend. Ka një vendim të Këshillit të Ministrave që i detyron të gjitha ndërmarrjet, ku ka mbi 12 fëmijë të punonjësve të saj, që të ngrënë çerdhet e tyre. Po ky vendim nuk po gjen kudo zbatim të plotë. Ne mund të sjellim si shembull Tiranën, ku në çerdhet e qytetit 400 vende, nga 1048 që kanë ato gjithsej, zihen nga fëmijët e punonjësve të ndërmarrjeve që duhet të ngrinin çerdhet e tyre. Në shumë qytete ka mjaft kërkesa për vende në çerdhe e kopshte fëmijësh. Kështu në Tiranë ka 418 kërkesa për në çerdhe dhe 300 për në kopshte, në Korçë 80 për në çerdhe dhe 280 për në kopshte etj. Rezulton nga ana tjetër një farë disproporcioni midis çerdheve dhe kopshteve për fëmijë. Një problem jo më pak serioz është edhe mungesa e qendrave të grumbullimit për fëmijët e shkollave fillore.

Partia duhet të luftojë me të gjitha forcat kundër këtyre të metave dhe të marrë masa të atilla që të sigurojë një pjesëmarrje gjithnjë e më aktive të grave si në punët administrative e drejtuese, ashtu edhe në prodhim. Organizatat e Partisë në gjithë punët duhet të llogarisin medoemos forcat e gruas dhe të luftojnë për pjesëmarrjen e gjërë dhe aktive të grave në jetën politike. Sistemi ynë shoqëror, udhëheqja e Partisë, patriotizmi i vetë grave tona dhe shembulli i grave sovjetike janë garanci e shëndoshë për suksese në të ardhmen.

Konkretisht ne duhet të arrijmë që pjesëmarrja e gruas në punë prodhuese si në qytet dhe në fshat të jetë në masë të gjërë. Në disa sektorë si në arësim, në shëndetësi, në sektorët e llogarisë, në PTT, në tregëti, në industrinë tekstile dhe në disa sektorë të artizanatit etj. të punohet që pjesëmarrja e gruas të arrijë brenda 10-15 vjetëve rreth 60-85 për qind dhe të shtohet shumë edhe në sektorët e tjerë.

Për të arritur objektivat e mësipërm është e nevojshme që të mbahen parasysh dhe të zgjidhen duke u marrë me shumë seriozitet nga Partia këto detyra:

a) Të luftohet për të sjellë sa më shumë gra, sidomos të reja, nëpër kurset dhe në shkollat e ndryshme. Këtu nuk është puna vetëm ta shtrojmë këtë çështje dhe të presim spontanisht të na vijë gratë në këto forma. Duhet luftuar patjetër kundër mentaliteteve të vjetra, fanatizmi etj. Shumica e vajzave që mbarojnë 7-vjeçaren nuk shkojnë më lart. Dhe me bursat ne nuk insistojmë sa duhet në këtë drejtim dhe ndodh pastaj që në institutin e lartë mjekësor, ku përqindja dermuese duhet të jenë vajza, nga 363 studentë vetëm 98 janë vajza. Kështu dhe në shkollën e Kombinatit

të tekstilit «Stalin», ku duhet të pranohen vetëm vajza, pse ato janë të përshtatshme për atë zanat, u detyruan të pranojnë 160 djem. Duhet të bëhet rregull që Komisioni i Planit dhe çdo dikaster tjetër, kur u dërgojnë organeve dhe organizatave poshtë planin për kurse ose shkolla, të shënojnë edhe përqindjen që duhet të zënë gratë e të rejtat në tërë kontingjentin e kërkuar. Komitetet e Partisë dhe organizatat e gruas e të rinisë duhet të luftojnë seriozisht për plotësimin e tyre. Kjo duhet konsideruar çështje e rëndësishme partie. Në këtë drejtim ka rëndësi të madhe krijimi i bindjes dhe i besimit të plotë në prindërit dhe njerëzit e tjerë të familjes se kjo është rruga e lumturisë së bijave të tyre. Ne kemi një eksperiencë shumë të mirë të punës së Partisë me gratë dhe të rejtat sidomos gjatë luftës. Çfarë kujdesi të madh tregonin atëhere shokët tanë! Një ndjenjë e lartë përgjegjësie dhe një korrektësi shembëllore karakterizonin punën e Partisë në këtë fushë. Dhe rezultatet qenë të kënaqshme. Kujdesi i madh dhe korrektësia duhet të karakterizojnë edhe në të ardhshmen punën tonë për tërheqjen më të gjerë të gruas në shkolla, në punë e në jetën shoqërore. Partia duhet të dënojë me forcë çdo qëndrim jo të drejtë ndaj grave jo vetëm nga kuadrot, por edhe nga njerëzit e thjeshtë.

b) Të merren masa efektive nga organet shtetërore për krijimin e konditave lehtësuere për gratë. T'u jepen një herë e mirë fund neglijencave në këtë drejtim. Të porositen në mënyrë kategorike dikasteret që të zbatojnë pa hezitim vendimin e qeverisë për ngritjen e çerdheve pranë ndërmarrjeve sipas normativës së caktuar. Të zgjerohet brenda mundësive që ekzistojnë rrjeti i çerdheve dhe i kopshteve në qytetet dhe të rregullohet raporti midis çerdheve dhe kopshteve. Të studjohet mundësia për krijimin e disa qendrave për grumbullimin e fëmijëve të shkollave fillore në qytetet.

Nga ana e organeve të industrisë, të tregëtisë dhe të artizanatit të merren masa serioze për të prodhuar mjete më të përshtatshme për të lehtësuar punën e gruas si amvisë.

c) Një terren shumë i përshtatshëm për aktivizimin e grave në punë është artizanati. Duhet zgjeruar artizanati i kooperuar e shtëpiak me gratë, sidomos për punim leshi e pambuku, për qëndisje, qepje etj. Për këtë të organizohen shkolla e kurse. Artizanati duhet të zgjerohet shumë punën me kontrata, duke u dhënë grave lëndën e parë të përpunuar e gjysmë të punuar. Në këtë mënyrë mund të prodhohen gjëra me më pak shpenzime, pa aparat administrativ të fryrë jo vetëm për nevojat e vendit, por edhe për eksport. Të organizojë reparte për të përgatitur konfeksione për fëmijë, kostume të vendit e sende të tjera të qëndisura me vlerë artistike etj.

3) Lidhur me përmirësimin e përbërjes së kuadrit mbetet detyrë në të ardhshmen edhe përmirësimi i përbërjes me kuadro nga

shtresat e varfëra të dala nga radhët e fshatarësisë dhe nga të gjitha krahinat e vendit.

Në përgatitjen e kuadrove që janë të lidhur drejtpërdrejt me punën e fshatit si arësimtarë, agronomë e teknikë bujqësorë, in-fermierë, mami, ndihmësmjekë për fshatin, kuadro për kooperativat e shitblerjes etj. ka shumë elementë nga qyteti. Dhe nga kjo shkaktohen vështirësi në shpërndarjen e kuadrit që përgatitet, në plotësimin në mënyrë pak a shumë të barabartë të nevojave për gjithë krahinat. Kjo influencon negativisht edhe në punë. Kështu ndodh që në Tiranë ka mami e arësimtare të tepërta, ndërsa në rrethe të tjera ka nevojë për kuadro të tillë. Ose në Institutin e lartë bujqësor në janar të vitit 1956 80% e studentëve ishin të rinj nga qytetet dhe 25% e tyre i kishin familjet në Tiranë, gjë që nuk është fort e drejtë.

Prandaj në të ardhshmen kuadrot që do të nevojiten për fshatin të luftohet të përgatiten në radhë të parë nga radhët e fshatarësisë së varfër. Është e domosdoshme që komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive dhe organizatat bazë të sigurojnë kontingjentin e nevojshëm për shkollat dhe kurset sipas planifikimit që kanë, në mënyrë që të sigurohen jo vetëm kuadro nga radhët e fshatarëve të varfër, por mundësisht edhe sipas nevojave që ka çdo krahinë e vendit tonë.

4) Siç u tha edhe më lart, në përbërjen e kuadrove ne kemi një numër të mjaftueshëm komunistësh — 32.6 për qind dhe shumica e tyre në vendet me përgjegjësi. Në përbërjen e kuadrove kryesore të administratës komunistët zënë 82 për qind të efektivit, në kuadrin kryesor të pushtetit lokal 91.5 për qind, në kuadrot kryesore drejtues të prodhimit në sektorë ekonomikë 82,5 për qind dhe në kuadrin e llogarisë 20,3 për qind. Në përgjithësi një shpërndarje e tillë mund të konsiderohet e kënaqshme. Veç duhet përmirësuar kjo në sektorët e arësimit e të kulturës, ku 82,3 për qind e kuadrit janë pa parti, në kuadrin e llogarisë, ku rreth 80 për qind janë pa parti etj. Dihet se edhe këta sektorë janë plotësisht nën influencën e ideologjisë së Partisë. Megjithkëtë qenja e më tepër kuadrove komunistë veçanërisht në sektorin e arësimit e të kulturës është e nevojshme.

Përqindjet e mësipërme janë mbi totalin e kuadrove që u përmendën. Por, ashtu siç e ka theksuar edhe herë të tjera Komiteti Qendror i Partisë, në administratat tona ka shumë komunistë, të cilët mbajnë vende jo shumë të rëndësishme dhe që do të shërbenin më shumë po të ishin në prodhim. Tani rreth 41 për qind e komunistëve nuk janë në prodhim. Ka shumë komunistë që kanë përgjegjësi të vogla e nuk janë të kualifikuar. Nga komunistët që janë në administratë rreth 40,4 për qind mbajnë vende nga referent e poshtë dhe nga këta vetëm 2,04 për qind janë të kualifikuar, ndërsa rreth 59,5 për qind mbajnë vende nga referent e lart dhe

nga këta vetëm 17,10 për qind janë të kualifikuar. Prandaj organizatat e partisë duhet të luftojnë më shumë në të ardhshmen për të zbatuar detyrat që ka caktuar Kongresi III i Partisë për shpërndarjen e forcave të Partisë midis administratës e prodhimit. Komunistët që punojnë në administratat tona duhet të bëjnë punë të kualifikuar, duhet pra të kualifikohen, ndryshe nuk mund të luajnë rolin e pararojës dhe influenca e tyre si komunistë mbi të tjerët do të jetë e paktë.

5) Siç konstatoi edhe kongresi i Partisë, dobësia kryesore e kuadrove tanë është niveli i ulët kulturalo-teknik i tyre. Me gjithë përparimet që janë bërë në këtë drejtim, ende është i theksuar disproporcioni midis teknikës së përparuar dhe nivelit kulturalo-teknik të kuadrove tanë. 33,3 për qind e të gjithë kuadrove tanë janë me shkollë fillore e poshtë, 32,8 për qind me 7-vjeçare, 27,4 për qind me të mesme dhe vetëm 6,3 për qind me të lartë. Nga të gjithë kuadrot vetëm 13,4 për qind e tyre kanë shkolla e kurse profesionale. Duke u shtuar këtyre edhe faktin se shumë kuadro kanë eksperiencë të shkurtër në punën praktike që drejtojnë (65,8 për qind e kuadrove kanë një stazh pune prej 1-5 vjet, 22,2 për qind 6-10 vjet dhe vetëm 11,8 për qind mbi 10 vjet), del e qartë se duhet punuar më me ngulm dhe duhen marrë masa më energjike për ngritjen e nivelit kultural dhe tekniko-profesional të kuadrit.

Më poshtë do të shtrojmë masat konkrete që mendojmë të merren për shpejtimin e ritmit të përgatitjes së kuadrove, por këtu do të theksojmë këto tri çështje:

Para së gjithash duhet të shtojmë kujdesin e të gjitha enteve shtetërore dhe të vetë kuadrove për ngritjen kulturalo-teknike të tyre. Vihet re një keqkuptim i asaj që është thënë se politika e kuadrit është një çështje që u përket para së gjithash organeve të Partisë. Ky parim i drejtë nuk duhet të shpërgjegjësojë sado pak drejtuesit e dikastereve etj., duke kujtuar se mendon tjetër kush për këtë çështje. Kjo do të ishte shumë e rrezikshme. Duhet patjetër çdo dikaster të mendojë seriozisht për edukimin kultural e teknik të kuadrove të vet. Dhe jo vetëm të kërkojë t'i jepen kaq inxhinierë apo agronomë, por të kujdeset t'i përgatisë ata; të përgatisë kuadrot e rinj dhe nga ana tjetër të aftësojë duke edukuar pa shpëputje nga puna kuadrot ekzistues. Ndjekja e shkollave të natës apo me korrespondencë si dhe e kurseve nga ana e kuadrove duhet të vihet shumë mirë nën kontrollin e vetë udhëheqjes së dikasterit. Vlen të marrim si shembull në këtë drejtim, përsa i përket kujdesit të dikasterit për përgatitjen e kuadrit, Ministrinë e Mbrojtjes. Megjithëse kuadrot që kishte ushtria ishin mjaft të ulëta nga ana e kulturës dhe e aftësive profesionale, sot mund të themi se në tërësi kuadrot e ushtrisë i përgjigjen si nivelit të detyrave edhe nivelit të teknikës shumë të lartë e moderne që disponon.

Nga ana tjetër duhen kritikuar për një punë të dobët organet e planifikimit, të cilat deri kohët e fundit nuk kishin një studim të plotë të nevojave për kuadro e veçanërisht lidhur me perspektivën e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës në vendin tonë. Dobët punon Kryeministria për kuadrot e pushtetit lokal si dhe Ministria e Industrisë, e Ndërtimit dhe ajo e Bujqësisë për kuadrot e tyre. Nga ana e dikastereve ka burokraci në këtë drejtim. Nga ana e tyre Bashkimet Profesionale, sidomos, si dhe organizata e rinisë nuk kanë punuar si duhet për edukimin profesional të punonjësve.

Së dyti, duhet të kufizojmë në maksimum lëvizjet e kuadrit, posaçërisht lëvizjet nga një sektor në tjetrin. T'u japim mundësi njerëzve të mësojnë në punë e sipër nga praktika.

Dhe, së treti, duhet të bëhet një shpërndarje më e drejtë e kuadrit më të kualifikuar, duke e lidhur atë më direkt me prodhimin. Duhet të themi se mjaft kuadro nga më të kualifikuarit i kemi mbledhur në aparatat qendror, i cili, me gjithë vendimet e herëpashershme për shkurtime, ka ardhë vazhdimisht duke u zgjeruar.

Nën pretekstin se në aparatat qendror duhet të kemi kuadrot më të mirë, i kemi hequr bazës kuadrit më të aftë dhe e kemi dobësuar atë në mënyrë të ndjeshme. Në aparatat qendror të shtetit, kuadrot me arësim të lartë zënë 26,8 për qind, ndërsa mbi gjithë kuadrit ato zënë vetëm 6, 3 për qind dhe mbi kuadrit kryesor të pushtetit lokal 1,5 për qind. Një gjendje e tillë nuk mund të konsiderohet normale.

Duhet të na preokupojë patjetër gjendja e ulët kulturalo-teknike e kuadrit kryesor të pushtetit lokal dhe e kuadrove kryesore drejtues të ndërmarrjeve të ndryshme shtetërore. Në pushtetin lokal, ndër shokët e komiteteve ekzekutive dhe në kryetarët e sekretarët e lokalitetit 43 për qind e tyre janë me shkollë fillore dhe më pak, 37 për qind me 7-vjeçare dhe vetëm 18,2 për qind me të mesme. Edhe ndër drejtorët e ndërmarrjeve mbi 74 për qind janë me shkollë fillore e 7-vjeçare, vetëm 21,6 për qind prej tyre kanë kurse e shkolla profesionale, ndërsa 70,6 për qind e tyre kanë një stazh të shkurtër në punë prej 1-5 vjet. Është e vërtetë se deri më tani ne me këto kuadro e kemi bërë punën, por nga një anë e kemi bërë me të meta dhe nga ana tjetër detyrat për të ardhshmen bëhen edhe më të mëdha. Prandaj çështja e shkurtimeve të aparatit qendror, dërgimi në bazë i disa prej kuadrove më të kualifikuar që punojnë në aparatat qendror, pra forcimi i bazës me kuadro më të aftë është një detyrë urgjente dhe e domosdoshme që pret zgjidhje.

6) Tani, shokë, të ndalemi pak më gjatë në lidhje me përbërjen e kuadrit të Partisë.

Përbërja shoqërore e aparateve të Partisë paraqitet si më poshtë:

Punëtorë	Të shtresave			Të ndryshme
	Të varfëra	Të mesme	Të pasura	
Me origjinë 12,2%	59%	24,2%	4,5%	—
Me gjendje 22,50%	43,7%	13,8%	0,3%	19,42%

Siç shikohet, si në gjendjen dhe në origjinën e kuadrove të aparateve të Partisë predominojnë shtresat e varfëra dhe punëtorë, që kapin për origjinën 71,2 për qind të totalit dhe për gjendjen 66,2 për qind.

Në krahasim me 1955 kemi këtë vit rreth 1 për qind më shumë kadro me origjinë punëtorë. Megjithkëtë, në të ardhshmen më shumë duhet punuar për të sjellë në aparatet e Partisë shokë që vijnë nga radhët e klasës punëtorë, duke i ndihmuar këta, duke i përgatitur në kurse e shkolla dhe duke i ngritur më me kurajo në vendet me përgjegjësi.

Përbërja shoqërore e aparateve të partisë shpjegohet me vetë përbërjen e Partisë sonë. Për qindja e kuadrove me origjinë e gjendje është mbi mesataren e përqindjes së efektivit të Partisë me origjinë e gjendje punëtorë.

Megjithkëtë kjo nuk e justifikon plotësisht gjendjen. Në mënyrë të veçantë disa komitete partie në rrethe, ku ka një klasë punëtorë më të zhvilluar, nuk kanë punuar me kujdes për të ngritur në përgjegjësi elementin punëtor.

Komiteti Qendror i PPSH vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen e komiteteve të Partisë për të forcuar punën me elementët punëtorë. Kongresi III i Partisë ka vënë si një detyrë të rëndësishme ngritjen dhe përgatitjen e kuadrove nga radhët e klasës punëtorë. Me qëllim që të shpejtohet përgatitja e kuadrove që vijnë nga klasa punëtorë, me vendim të Sekretariatit të KQ të Partisë 50 për qind e kuadrove që u pranuan në shkollën e Partisë këtë vit arësimor janë me origjinë ose gjendje punëtorë. Kjo sigurisht nuk e zgjidh të gjithë problemin, por sidoqoftë kjo ndihmon mjaft. Nga ana tjetër duhet që nga komitetet e Partisë të zhvillohet një punë më e kujdeshme e me perspektivë për të zgjedhur, për të përgatitur e për të ndihmuar në punë konkrete kuadrot që vijnë nga radhët e klasës punëtorë, duke filluar që nga detyra e instruktorit. Për këtë duhet punuar posaçërisht për të edukuar dhe për të avancuar shokët punëtorë që janë zgjedhur në plenumet dhe në byrotë e rretheve e të qarqeve.

Siç thamë dhe më lart, një problem tjetër me rëndësi në përbërjen e aparateve të Partisë është edhe pjesëmarrja e paktë e grave. Gratë zënë vetëm 6,15 për qind të të gjithë efektivit të kuadrove të Partisë dhe nga këto shumica janë me përgjegjësi deri instruktore.

Përsa i përket nivelit kultural, profesional dhe ideo-politik të kuadrove të Partisë duhet thënë se këtë vit kemi patur përmirësime të dukshme në krahasim me të kaluarën. Ku konsistojnë këto përmirësime:

a) Se ne kemi tani më shumë shokë me shkolla e kurse partie se sa më 1953 e se sa më 1955 dhe ja konkretisht:

Viti	Me fillore	Me 7-vjeçare	Me të mesme	Me të lartë	Me shkollë partie	Me kurse partie
1955	40,19%	47,24%	9,56%	2,9 %	18,35%	18,06%
1956	27,59%	56,53%	12,01%	3,8 %	25,09%	51,15%

Siç shihet, është ulur mjaft numri i atyre që ishin me fillore, ndërsa është rritur numri i atyre që kanë shkolla 7-vjeçare ose të mesme e të larta; po kështu është rritur numri i atyre që kanë shkolla e kurse partie. Kjo është një gjë pozitive. Veç në rrethe e qarqe ne kemi shumë pak kadro me arësim të lartë.

Një anë tjetër pozitive është se shumica e kuadrove të Partisë kanë një stazh në punë partie prej 3-11 vjet dhe vetëm 29,4 për qind kanë stazh 1-2 vjet; shumica e kuadrove të Partisë kanë një stazh partie prej 9-15 vjet dhe vetëm 11,5 për qind kanë stazh partie më pak se 9 vjet.

Për aparatit e Komitetit Qendror gjendja është më e mirë, për arësye se ne kemi sot 27,9 për qind të kuadrove me arësim të lartë të përgjithshëm e profesional, ndërsa në korrik të 1953-së kishim vetëm 4,8%, ose 24,3 për qind me shkolla të mesme, 26 për qind me shkolla partie dhe 29,5 për qind me kurse partie. Veç kësaj shumica e kuadrove të aparatit të KQ kanë një stazh pune si punëtor partie relativisht të gjatë: 18,2% mbi 11 vjet.

37,3% " 6-10 "

31,3% " 3-5 "

dhe vetëm 13% " 1-2 "

Nga ana tjetër 60,8 për qind e kuadrove që punojnë në aparatit e KQ janë me stazh partie të viteve 1941-1944, 36,5 për qind të viteve 1945-1948 dhe vetëm 2,6 për qind të viteve 1949 e lart.

b) Një ndihmë të mirë në përgatitjen e kuadrove të Partisë

ka dhënë shkolla e Partisë, nga e cila kanë dalë 866 kuadro dhe vazhdojnë 561 të tjerë, po kështu edhe kurset e Partisë.

Është shtuar numri i kuadrove që vazhdojnë shkollat e natës e me korrespondencë. Nga 510 veta që ndoqën shkollat e natës e me korrespondencë në vitin arësimor 1953-1954, këtë vit vazhdojnë 672 veta. Një rritje të dukshme kemi në kuadrot që vazhdojnë institutet e larta; nga 19 veta që kishim më 1954-1955 tani vazhdojnë këto institute 119 veta dhe shumica e këtyre janë regjistruar në ato institute që i përshtaten më shumë sektorit të punës ku punojnë. Në bazë të vendimeve të Komitetit Qendror në fund të 5-vjeçarit të dytë duhet të kemi 150 kuadro të nomenklaturës së Komitetit Qendror (nga kuadrot e Partisë) me arësim të lartë dhe 134 me arësim të mesëm. Duke marrë parasysh gjendjen, kontingjentet që kemi në shkollat e Partisë në vend e në BS si edhe ato që vazhdojnë shkollat me korrespondencë e të natës, detyrat e caktuara në këto vendime do të zbatohen deri në qershor të vitit 1961. Për të plotësuar disa sektorë (në qendër dhe në qarqe e rrethe me rëndësi industriale e bujqësore) me kuadro me arësim të lartë profesional (ekonomistë për industri, tregëti e sidomos agronomë për bujqësi) do të na nevojiten rreth 35 kuadro nga ata që përgatit shteti për t'i kthyer në punëtorë partie.

Për të realizuar ato që u thanë më lart është e domosdoshme që të forcohet kontrolli i organizatave të Partisë, i komiteteve të Partisë dhe i çdo përgjegjësi mbi punën që bën çdo kuadër për edukimin e tij, të forcohet disiplina dhe autodisiplina nga vetë kuadrot dhe të ndihmohen për t'ua bërë sa të jetë e mundur më të lehtë detyrën e madhe që kanë kuadrot për vazhdimin dhe përparimin e rregullt në shkolla.

Është e vërtetë që totalisht detyra e caktuar nga Komiteti Qendror për shkollat realizohet, por ka kuadro të veçantë që nuk do ta realizojnë këtë detyrë, disa pa arsye të justifikuar. Prandaj është e domosdoshme të paralajmërohen këta kuadro sa nuk është tepër vonë që të marrin masa dhe në mënyrë të organizuar të ngrenë nivelin e tyre ideo-politik, kultural e profesional. Qëndrimi i deritanishëm që mbahet nga këta është i dëmshëm jo vetëm për punën, por edhe për të ardhshmen e tyre si kuadro.

Me qëllim që të lehtësohet puna e kuadrove që vazhdojnë shkollat me korrespondencë, të studjohen programet për thjeshtimin e tyre nga gjërat jo shumë të domosdoshme dhe të organizohen disa qendra konsultimi për shokët që vazhdojnë institutet e larta. Veç këtyre të studjohet më mirë koha e provimeve, që të mos largohen shumë kuadro përnjëherësh nga puna.

Veç këtyre komitetet e Partisë duhet të organizojnë më mirë se deri tani punën për edukimin ideologjik e profesional të punonjësve të aparateve të Partisë dhe të shtojnë kujdesin për t'i bërë këta organizatorë të zot.

MBI DISA PROBLEME TË DREJTIMIT TË PUNËS ME KUA-DROT NGA ANA E ORGANEVE DHE E ORGANIZATAVE TË PARTISË

Qysh nga Kongresi I i PKSH dhe këtej, vazhdimisht KQ i Partisë sonë i ka kushtuar kujdes të veçantë drejtimit të tërë punës me kuadrin. Duke u nisur nga parimet bazë se «kuadri vendos për gjithshka» dhe se «njerëzit janë kapitali më i çmuar», Partia jonë në gjithë hallkat e saj është përpjekur për të bërë në këtë drejtim një punë sa më të thelluar. Gjithë politika e kuadrit bëhet kolegjalisht nga organet e Partisë. Kudo është siguruar kontrolli i Partisë në këtë punë. Me rëndësi në këtë drejtim ishin vendimi dhe instruksioni mbi punën e kuadrit që aprovoi Byroja Politike e Komitetit Qendror në muajin tetor të vitit 1955 dhe veçanërisht vendimet e Kongresit III të Partisë.

Si rrjedhim mund të themi se në tërësi drejtimi i punës me kuadrin nga ana e organizatave dhe e organeve të Partisë është përmirësuar. Komitetet e Partisë dhe organizatat bazë kanë filluar tashmë të kujdesen më seriozisht dhe të ndjejnë përgjegjësi për tërë politikën e kuadrit që punon në territorin e tyre, pavarësisht nga nomenklatura.

Duke u udhëhequr nga parimi leninist mbi njohjen, zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit, komitetet e Partisë gjatë këtij viti kanë bërë një politikë më të drejtë kuadri, është punuar për njohjen më të mirë të kuadrit si me anën e dokumentave, të cilat po vihen në rregull, ashtu edhe në punë e sipër, duke lidhur më mirë kontrollin e zbatimit të vendimeve me njerëzit. Por megjithkëtë në punën me kuadrin ka ende të meta të rëndësishme. Ka ende shkelje të parimeve mbi zgjedhjen e vendosjen e kuadrit dhe të instruksioneve e nomenklaturave përkatëse; mungon ende një interesim i gjithanshëm e i plotë për kuadrin, si për trajtimin edhe për edukimin e tij, duke u marrë më shumë me lëvizjet e kuadrit, megjithëse dhe këtu ka të meta. Komitetet e Partisë dhe organizatat bazë nuk janë kujdesur sa duhet për perspektivën. Ka komitete partie si ai i Krujës, i Gjirokastrës etj. që i presin kuadrot nga lart dhe që punojnë më dobët për përgatitjen dhe edukimin e kuadrove të tyre.

Cilat janë disa nga problemet kryesore të drejtimit të punës me kuadrin?

1. — Përmirësimi i metodës së punës — kusht i domosdoshëm për një politikë të drejtë kuadri.

E metë e madhe në punën tonë të Partisë dhe të shtetit është kontrolli i dobët për zbatimin e vendimeve dhe të detyrave nga secili kuadër. Pasojat e një dobësie të tillë, si për vetë realizimin

e vendimeve, ashtu edhe për edukimin dhe ndihmën që u duhet dhënë kuadrove janë të ndjeshme. Mungesa e kontrollit si nga lart-poshtë, ashtu edhe nga poshtë-lart dobëson kuadrin. Gabimet në zbatimin e politikës së kuadrit ndodhin jo se nuk njihen parimet, por pse nuk njihen njerëzit. Shumë njerëz me çanta në duar shkojnë poshtë për kontroll, por, me gjithë këtë, rrethet ankohen shumë për ndihmën e paktë që u jepet, sidomos nga ana e dikastereve, dhe kjo është e drejtë. Nga kontrollet bëhen shumë konstatime, por merren pak masa praktike për përmirësimin e punës në vend. Kuadrot kryesorë shkojnë pak poshtë, sepse ata janë të angazhuar me një punë të madhe burokratike në qendër, me mbledhje, konsulta, takime etj.; atyre u serviren shumë materiale, relacione, informacione, raporte e projekte. Këto të gjitha vinë sepse aparatet administrative janë të fryra dhe gjithë ata nëpunës, referentë, shefa, kryetarë dege e drejtorë prodhojnë shumë shkresa, ata duan përgjigje për çështje që ngrenë, ata bëjnë shumë mbledhje, shpikin formularë etj., sepse derisa janë si seksion apo degë duhet patjetër t'i krijojnë punë të rregullt vetes. Dhe kështu jo vetëm që gozdojnë shokët kryesorë në zyra, por mbytin dhe ata poshtë me kërkesa e shkresa. Është e palejueshme, shokë, por për fat të keq është fakt që Ministria e Bujqësisë u kërkon rretheve të plotësojnë disa formularë me të dhëna për kooperativat bujqësore që po t'i radhitin arrijnë 60 e ca metra të gjatë! Ndërsa Ministria e Shëndetësisë kërkon të dhëna edhe për gjatësinë e atyre fëmijëve që kanë vdekur vjet para kohe nëpër maternitetet! Është e qartë se njerëzit e tepërt duan punë; ata nuk janë të pandërgjegjshëm, prandaj fantazia punon! Kjo është një situatë e rëndë. Mjaft kuadro të mirë janë zhytur në një punë të vdekur, pa shumë fryt, në një kohë kur baza vuan mjaft për kuadro e ndihmë konkrete. Ka ardhur koha të veprojmë energjikisht në këtë drejtim; me një gur të vrasim dy zogj, nga një anë të thjeshtojmë aparatin administrativ, pra ta lirojmë atë nga punët e tepërta e të panevojshme, të lirojmë kuadrot kryesorë nga shumë punë të tyre dhe të mundin më shpesh të shkojnë poshtë e të ndihmojnë efektivisht dhe, nga ana tjetër, të dërgojmë në bazë disa kuadro më të aftë.

Pastaj, vihet re një fenomen interesant, ndërsa të metën kryesore e kemi në kontrollin e dobët, njëkohësisht kemi krijuar një aparat të gjerë kontrolli. Poshtë të zënë kudo për pallto «kontrollorët». Dhe sa ikën njëri, vjen tjetri. Nga disa llogaritje jo fort ekzakte rezulton se gjatë vitit 1956 vetëm nga 27 dikastere e institucione qendrore kanë shkuar poshtë 10.101 kuadro dhe kanë qëndruar atje 80.587 ditë. Kështu vështirësohet edhe shërbimi i popullit me mjete transporti e hotele. Nga disa të dhëna të përafërta rezulton se çdo ditë nisen nga Tirana për në rrethe me autobusë e tren (pa llogaritur ata që shkojnë me vetura e gaze) mbi 100 vetë. Kështu, prej datës 14 e deri 21.5.1957 janë nisur nga Tirana 893 vetë. Vetëm

në Durrës prej janarit deri në prill kanë vajtur 388 të «deleguar». Në Shkodër vetëm në 15 ditët e majit ishin 65 të «deleguar».

Për tërë këto udhëtime e qëndrime poshtë harxhohen fonde të mëdha për udhëtim e dieta. A nuk do të ishte më e drejtë që një pjesë të mirë të këtyre «të deleguarve» t'i zbrisnim poshtë, t'i kthenim nga kontrollues në zbatues të drejtpërdrejtë? Kështu do të kishte edhe shpenzime më pak, edhe të deleguar më pak, edhe kuadro më të kualifikuar në bazë.

Të gjitha të dhënat tregojnë se është e nevojshme dhe se janë krijuar mundësitë për të bërë shkurtime të ndjeshme në aparatet administrative.

Mendimi se duhen shkurtuar aparatet administrative ka gjetur përkrahjen e kuadrove të Partisë, por megjithkëtë vihen re ende ngurrime në këtë drejtim. Partia duhet të luftojë me forcë kundër këtyre ngurrimeve, kundër mendimit për të mbajtur në qendër të gjithë kuadrot më të kualifikuar e sidomos kundër mungesës së gatishmërisë që vihet re në disa kuadro edhe komunistë për të shkuar në bazë.

Me qëllim që të ndihmohet baza me kuadro të aftë nga qendra, duhet patur parasysh që kuadrot, të cilët do të lirohen nga shkurtime, të dërgohen drejt për së drejti në bazë.

Në metodën tonë të punës — në luftë kundër burokracisë — ne duhet të forcojmë edhe më shumë kontaktin e drejtpërdrejtë të shokëve që drejtojnë sektorët e ndryshëm me punonjësit. Jo me kalie për vizitë në ndërmarje e kooperativa dhe e shumta me u takue me drejtuesit e tyre, por me marrë kontakte të shpeshta e të gjalla me punëtorët e fshatarët për problemet e ndryshme të prodhimit etj. Kjo do të na ndihmojë për të njohur më mirë si punën dhe vetë kuadrot.

Sëmundja tjetër, kundër së cilës duhet të luftojmë për të përmirësuar metodën e punës, për të luftuar burokracinë, janë mbledhjet e tepërta e pa fund që bëhen. Është gjetur si më e përshtatshme nga disa shokë që kur puna nuk shkon mirë të bëhen mbledhje. Pa dyshim se mbledhjet kanë rëndësinë e tyre, kur ato bëhen për probleme që duhen bërë. Por kur nga një mbledhje vendoset të bëhen një varg mbledhjesh të tjera e jo punë, kur mbledhjet zëvendësojnë punën e gjallë, kjo është shumë e keqe. Duhet ta themi se ka shokë, të cilëve mbledhjet u janë bërë mani, sa të hapësh gojën e të thuash që kjo apo ajo çështje s'na vete mirë, menjëherë vendosin të organizojnë mbledhje. . .

Organet dhe organizatat e Partisë veçanërisht duhet të luftojnë ashpër kundër këtyre metodave të drejtimit.

Puna me kuadrin, me njerëzit nuk e duron kërkund formalizmin, burokracinë, prandaj përmirësimi i metodës së punës — lufta kundër burokracisë, forcimi i kontrollit efektiv për zbatimin e vendimeve, lidhja e ngushtë me masat — përbën kushtin themelor për një politikë të drejtë me kuadrin.

2. — Respektimi me përpikmëri i parimit leninist mbi zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit.

Lenini që më 1921, duke u interesuar për një punëtor, kërkonte t'i jepeshin këto të dhëna: si është ky punëtor:

- a) nga pikëpamja e ndërgjegjes
- b) » ana politike
- c) » pikëpamja e njohjes së punës
- ç) » ana e zotësive administrative.

Ky është një përcaktim shumë i saktë i të dhënave që duhen patur parasysh në zgjedhjen e vendosjen e një kuadri.

Në punën e organeve dhe të organizatave të Partisë ka të meta në këtë drejtim. Ka raste që nuk bëhet një kombinim i mirë i besimit politik dhe i aftësive në punën e një kuadri. Faktet që u përmendën më lart në pjesën mbi përbërjen e kuadrit e vërtetojnë këtë.

Disa shokë, duke mos bërë një politikë me perspektivë, kanë ndjekur një rrugë të shkurtër, por jo të drejtë, duke pranuar në punë elementë me përbërje jo të mirë, pa patur garancitë e nevojshme politike. . .

Veç besimit politik në zgjedhjen e një kuadri, duhen marrë parasysh edhe aftësitë e tij në punë. Duhet thënë se ngandonjëherë ose pse këto aftësi nuk njihen mirë ose pse nuk vlerësohet drejt sektori i punës vendosen në punë njerëz, që nuk kanë zotësitë që kërkon sektori. Pa dyshim mund të ndodhë që një kuadër i marrë rishtas në punë nuk i ka aftësitë e nevojshme profesionale dhe administrative, por është e rëndësishme që të kemi bindjen se për një kohë relativisht të shkurtër, duke u ndihmuar, ky kuadër do të mund t'i fitojë këto aftësi.

Gabimet kryesore në politikën e kuadrit ndodhin para së gjithash pse nuk njihen mirë njerëzit. Gabimi i njohur dhe i kritikuar disa herë, por që ende vazhdon, i të vërtiturit rreth disa kuadrove të njohur tregon jo vetëm që s'njihën njerëzit, por dhe se s'po bëhen ende sa duhet përpjekje në këtë drejtim. Shpeshherë bëhet një punë e përciptë për vendosjen e kuadrit. . .

. . . Është e domosdoshme që komitetet e Partisë të përmirësojnë punën me kuadrin, duke përmirësuar metodën e punës së tyre, duke lidhur shumë ngushtë kontrollin e zbatimit të vendimit me punën e kuadrit si dy anë të një detyre të vetme. Kështu do të mund të njohim më mirë kuadrot dhe do të dimë pastaj të bëjmë një politikë më të drejtë për vendosjen dhe përgatitjen e kuadrit. Për kuadrin duhet gjykuar gjithnjë me një pjekuri dhe përgjegjësi të plotë. Në asnjë mënyrë të mos gjykohet mbi kuadrin duke u nisur nga mendime ose nevoja të çastit.

3. — Evitimi i lëvizjeve të shpeshta dhe ruajtja e profilit të kuadrove.

Kongresi III i Partisë, sikurse dihet, në lidhje me punën me kuadrin kritikoi veç të tjerave edhe lëvizjet e shpeshta të shumta e pa kriter që bëhen si nga ana e dikastereve, ashtu edhe nga ana e komiteteve të Partisë.

Ruajtja e profilit është një nga çështjet kryesore të politikës së kuadrit. Kuadrot s'mund të jenë enciklopedikë dhe të përshtatshëm për çdo vend. Çdo njeri ka prirjet dhe aftësitë e tij. Puna pak a shumë e gjatë në një sektor të caktuar i rrit pa dyshim aftësitë në punë. Por duke i lëvizur sa andej-këtej, ata nuk do të jenë të zot për asnjë sektor dhe gjithnjë do të vazhdojnë të jenë njerëz të përgjithshëm. Jo vetëm lëvizjet jashtë sektorit, por janë shumë të dëmshme edhe lëvizjet nga një ndërmarrje në tjetrën ose nga një rreth në tjetrin, qoftë edhe në të njëjtin sektor pune. . .

. . . Duhet të jemi shumë të matur në lëvizjet e kuadrit. Lëvizjet, gradime, degradime, pushime e transferime që janë të domosdoshme edhe në të ardhmen do të ketë, por këto duhet të jenë plotësisht të studjuara e të justifikuar.

Një problem tjetër i rëndësishëm në këtë drejtim është çështja e ruajtjes së kontingjenteve që përgatiten për sektorët e ndryshëm. Në këtë drejtim ka gjëra shumë skandaloze. Shumë kuadro kemi përgatitur në kurse e shkolla për sektorë të caktuar, por sot punojnë në sektorë të tjerë. Ja p.sh. nga 890 kuadro të përgatitur për kooperativat e konsumit, tani punojnë 537; të tjerët kanë ndërruar sektor; nga 277 kuadro që mbaruan FZO-n e naftës, 164 nuk punojnë fare në këtë sektor; në Tiranë dhe në qytetet Shkodër, Elbasan e Gjirokastër ka 1091 vetë që nuk punojnë në sektorët për të cilët janë specializuar etj. Ka dhe të tillë që sa mbarojnë një kurs apo shkollë, shkojnë në një tjetër dhe vazhdimisht po e kalojnë jetën nëpër kurse e shkolla. S'ka shumë kohë që erdhi të ankohet një i ri, sepse nuk i jepnin bursë. Pasi u bisedua me të, doli se ai kishte mbaruar para disa vjetësh teknikumin e naftës, por meqë s'i pëlqente të punonte atje, ishte futur në teknikumin e fiskulturës dhe tani që e mbaroi atë kërkonte të studjonte edhe për mjekësi. Ne duhet të tregojmë shumë kujdes për të mbajtur në sektorin e tyre të punës kuadrot që me aq zor po i përgatisim.

Në një masë të rëndësishme evitimi i lëvizjeve të tepërta është i lidhur me sigurimin e kontingjenteve për në shkolla e kurse, siç u tha dhe më lart, me përgatitjen e kuadrove. Për ta ndrequr më mirë këtë gjendje duhen marrë disa masa. Të përmirësohet puna në teknikumet e në institutet, të plotësohen nga të gjitha rrethet kontingjentet për shkolla. Lidhur me këtë duhet që çdo rreth e qark të ketë planin perspektiv për përgatitjen e kuadrit të tij. Shpërndarja për herë të parë e kuadrove që mbarojnë teknikumet

të bëhet nga dikasteret nën kujdesin e aparatit të Komitetit Qendror. Të përcaktohet në kontratë që kuadrot (të ulët, të mesëm e të lartë), të cilët mbarojnë me bursa të shtetit, të jenë të detyruar të shkojnë atje ku do të dërgohen për 3-5 vjet dhe vetëm pas këtij afati të kenë të drejtë të kërkojnë të transferohen.

4. — Lufta kundër zgjedhjes e vendosjes së kuadrit në mënyrë familjare

Çështja e kuadrit është një punë me rëndësi partie, prandaj në punën për zgjedhjen e vendosjen e kuadrit duhet të nisemi vetëm nga interesat e Partisë. Në përgjithësi komitetet e Partisë, organizatat bazë dhe organet shtetërore janë nisur në zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit drejt, duke patur parasysh parimin leninist dhe interesat e Partisë. Por megjithkëtë ka raste kur bëhet një politikë jo e drejtë, por nga pozita familjare e miqësore, gjë që është në dëm të punës. . .

Si ndodhin këto gjëra?

Ka elementë, të cilët qëllimisht grumbullojnë rreth vetes së tyre miq e fafëfis, për të krijuar një situatë të qetë nga kritikata, për të rregulluar njerëzit e tyre në punë etj.

Ka të tjerë që i nënshtrohen presionit që u bëhet nga elementët që njohin dhe nuk i drejtojnë t'i zgjidhin kërkesat e tyre në rrugë të rregullt, ose pse nuk ua prishin dot qefin miqve, ose pse pranojnë servilizmin e këtyre njerëzve.

Në saje të një përkrahjeje të tillë janë futur në aparatet tona edhe një pjesë e elementëve të padëshiruar.

Eksperienca ka treguar se çfarë rezultatesh negative ka për punën një grumbullim i tillë kuadrosh në një sektor pune, duke shkelur parimet bazë mbi politikën e kuadrit. Në këta sektorë s'ka kritikë dhe autokritikë, s'ka luftë për ta çuar përpara punën. . .

Një akt i tillë jo vetëm i sjell dëme punës, por edukon keq edhe njerëzit, të cilët duhet të kuptojnë se të gjitha problemet e tyre u zgjidhen e do t'u zgjidhen nga Partia dhe pushteti popullor e jo në saje të përkrahjes së «mikut». Miqësia e sëmurë në punë e tarafilëku janë mbeturina të edukatës borgjeze në ndërgjegjen e njerëzve dhe të papajtueshme me edukimin komunist të kuadrove, si të tilla ato duhen shrrënjësuar nëpërmjet kritikës dhe autokritikës së shëndoshë, të hapur e publike si dhe me anën e forcimit të kontrollit në punën e çdo kuadri. Organizatat dhe organet e Partisë të dënojnë rëndë rastet e vendosjes në mënyrë familjare të kuadrove dhe të mos lejojnë asnjë lëshim nga parimet bazë mbi politikën e kuadrit.

5. — Forcimi i kujdesit për trajtimin e kuadrit

Komiteti Qendror i Partisë sonë vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen e organizatave të partisë, të organeve të partisë dhe të atyre shtetërore për një trajtim gjithmonë më të kujdesshëm të kuadrove.

Masat që ka marrë Komiteti Qendror dhe qeveria kohët e fundit për përmirësimin e kategorizimit dhe të pagave, për trajtimin e arësimitarëve, për shtimin e lejeve për ato kategori kuadrosh që punojnë në kondita të vështira, rritja e pagave për punonjësit që kishin rroga të ulëta, uljet e vazhdueshme të çmimeve, vendimi për trajtimin e kuadrove të shkencës, dhënja e titujve shkencorë disa kuadrove, masat favorizuese për gratë që janë në marrëdhënje pune, dekorimet dhe shpërblimet e herpashershme, zgjerimi i shtëpive të pushimit etj. kanë qenë masa të rëndësishme për trajtimin e kuadrove, të cilët kanë rritur vullin, iniciativën dhe preokupacionin për punë.

Por me gjithë përmirësimet e bëra duhet thënë se në këtë drejtim kemi ende shumë për të bërë.

Parimi i shpërblimit të njerëzve sipas punës është parim socialist i drejtë. Me ndryshimet që u bënë në kategorizimet u përcaktua në praktikë më mirë se më përpara ky parim. Megjithkëtë nuk duhet thënë se në këtë drejtim s'ka më gabime; çështja është që organizatat dhe organet e Partisë duhet të preokupohen shumë më tepër për këtë problem. Ka sekretarë partie në rrethe, që nuk dinë si zbatohet konkretisht sistemi i pagave e i normave, cili është efekti për çdo sektor pune etj., por mjaftohen me disa të dhëna të përgjithshme.

Lidhur me sistemin tonë të pagave është e nevojshme që organizatat e Partisë të kontrollojnë vazhdimisht zbatimin e këtij parimi në praktikë dhe të mos lejojnë gabime në këtë drejtim. Njëkohësisht ato duhet të shqyrtojnë me kujdes këtë problem dhe të bëjnë sugjerimet e nevojshme për ta përfeksionuar gjithnjë e më shumë. Sistemi ynë i pagave përcaktohet nga vendi që mban çdo kuadër si edhe nga shkalla e kulturës profesionale; kjo është e drejtë, nga një anë, se puna e kualifikuar është më e ndërlikuar se puna e thjeshtë dhe, nga ana tjetër, sepse ndihmon dhe stimulon zhvillimin kultural-profesional të kuadrove.

Në disa sektorë kuadrot shpërblehen edhe me përqindje të caktuar mbi vjetërsinë në punë. Edhe kjo është plotësisht e drejtë, se influencon që kuadrot të lidhen më ngushtë me zanatin që kanë, ndihmon në ruajtjen e profilit të kuadrit dhe evitimin e lëvizjeve pa vend. . .

Një masë me rëndësi lidhur me trajtimin e kuadrit, që nuk përdoret mirë e gjithnjë, është edhe ajo e dekorimeve, lavdërimeve etj. E vërteta është se në krahasim me të kaluarën ka një ndryshim

shumë të madh edhe në këtë drejtim, por kjo formë inkurajimi e shpërblimi nuk përdoret si duhet. Dalja e dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi dekorimet ka përcaktuar në mënyrë të drejtë kriteret për dekorime, por në praktikë bëhen gabime. P.sh. shqyrtohet problemi i grumbullimeve dhe bëhen propozime për dekorimin e kuadrove të grumbullimit; por pa nënvleftësuar rolin dhe punën e kuadrove të grumbullimit, dihet se në realizimin e planit të grumbullimeve, veçanërisht duke u bazuar në atë që thotë praktika jonë, merita nuk u takon vetëm dhe kryesisht këtyre kuadrove, por në radhë të parë atyre që kanë punuar mirë për të korrur prodhime të bollshme e që mbajnë në fakt përgjegjësinë më të madhe për realizimin e planit. Prandaj dekorimi i kuadrove të grumbullimit pa shikuar edhe kuadrot e bujqësisë, të pushtetit lokal e të Partisë nuk është i drejtë.

Por një e metë me rëndësi është se dekorimet janë bërë më shumë gjatë fushatave e përvjetoreve të festave të ndryshme. Nuk ndiqen me kujdes rekordistët e rendimenteve të larta, nuk mbahen parasysh rastet kur kuadrot kryesore mbushin 40-50 ose 60 vjeç, kur ata plotësojnë vjetërsinë e nevojshme në punë, kur merret në analizë puna e sektorit që drejtojnë etj. etj.

Në propozimet për dekorime ka edhe gabime. Propozohen persona për t'u dekoruar nga dy herë për të njëjtat rezultate në të njëjtën kohë, siç ka vepruar Ministria e Ndërtimit. Në disa raste, duke mos njohur mirë dhe nga afër punën e njerëzve ose duke mos dashur «t'i hapin telashe vetes», propozohet dekorimi i të gjithë punonjësve me të njëjtën medalje, siç ka vepruar, p.sh., Ministria e Financave, e cila ka propozuar të dekorohen të gjithë punonjësit e sistemit të financave me medalje pune etj. Këto dhe të tjerë shembuj tregojnë se edhe në këtë drejtim bëhet një punë burokratike me njerëzit, se në mjaft raste shokët përgjegjës nuk i njohin kuadrot personalisht, por nga të dhënat që marrin nëpërmjet rrugës së gjatë hierarkike që ekziston.

Veç kësaj nga ana e organizatave të Partisë dhe e përgjegjësve të punës nuk ka një preokupacion të vazhdueshëm për shpërblimin normal të kuadrove. Edhe kur shpërndahen dekoratat ose titujt, nuk organizohet puna në mënyrë të atillë, që të bëjë një efekt sa më të madh. Pastaj, nuk ka iniciativë poshtë për ta vlerësuar si duhet punën e mirë të kuadrove.

Po japim një shembull: një shofer ka punuar 10-15 vjet mirë, ka realizuar e tejkaluar planin, ka mirëmbajtur mjetin, s'ka bërë asnjë kundravajtje etj. A nuk do të ishte e drejtë që këtij shoferi t'i festohet në qendrën e ndërmarrjes ditëlindja ose përvjetori i 10 apo i 15 i shërbimit të tij, të lavdërohet për punën e mirë nga kuadrot e Partisë, të ndërmarrjes, të pushtetit, të policisë rrugore etj. Pa dyshim që një gjë e tillë do të ishte e drejtë dhe e dobishme. Prandaj duhet tërhequr vëmendja e organizatave të Partisë dhe

e përgjegjësve të dikasterëve, të ndërmarrjeve dhe të sektorëve të tjerë që të shtojnë kujdesin në këtë drejtim. Të ndjekin vazhdimisht në mënyrë të kujdesshme punën e kuadrove, qofshin këta me përgjegjësi të mëdha ose të vogla dhe të mendojnë e t'u propozojnë organeve kompetente për shpërblimet që duhet t'u jepen duke patur kujdes që për punë të barabartë të ketë edhe shpërblim të barabartë.

Një problem tjetër është krijimi i konditave më të mira të jetesës për kuadrot. Masat që janë marrë për ngritjen e nivelit material e kultural të popullit kanë patur një efekt të drejtpërdrejtë në kuadrot dhe punëtorët. Megjithkëtë jo të gjithë përgjegjësit e punës interesohen që brenda mundësive tona të krijohen për punonjësit e tyre kondita pune e pushimi sa më të favorshme. Është e njohur që ne kemi ende mjaft vështirësi në këtë drejtim, por me një kujdes më të madh mundet dhe duhet të përmirësohen kushtet e punës, të banimit dhe të çlodhjes së njerëzve tanë. Prandaj në këtë drejtim organizatat e Partisë dhe ato profesionale duhet të luftojnë më tepër kundër qëndrimit burokratik të disa drejtuesve ekonomikë. Duhet kërkuar pa dyshim që kuadrot dhe punëtorët të realizojnë me nder detyrat, por gjithashtu duhet kërkuar që t'u jepen atyre gjithë ato të drejta dhe favore të cilat u takojnë.

Një çështje me rëndësi është që kur studjohen e vendosen masa favorizuese për një kategori kuadrosh, duhen shikuar në raport edhe me kuadro të sektorëve të tjerë; p.sh. u caktohet lejë suplementare punonjësve të shëndetësisë që shërbejnë në laboratore, reparte infektimi etj. Kjo është e drejtë, por pak a shumë në këto kondita janë edhe punonjësit e laboratoreve dhe klinikave veterinare, të cilët janë lënë jashtë. Këtu bashkimet profesionale duhet të ndihmojnë shumë dhe duhet të thonë fjalën e tyre në projektin që paraqesin dikasteret e ndryshme.

Por ato që u thanë më lart janë njëra anë e problemit të trajtimit të kuadrit. Ana tjetër, po ashtu shumë e rëndësishme, është kujdesi i vazhdueshëm, trajtimi i ngrohtë që duhet t'u bëhet kuadrove. Çdo kuadër ka nevojë që të ndihmohet e të inkurajohet në punë. Sigurisht ai ka nevojë të kontrollohet, të kritikohet e të bëjë autokritikë, por ka rëndësi si të ndihmohet e si të kritikohet. Kuadri duhet të shikojë në ata që e kontrollojnë ose e komandojnë, që e kritikojnë dhe e vënë përpara përgjegjësisë njerëzit që me gjithë shpirt duan ta ndihmojnë, ta nxjerrin nga prapambetja, ta çojnë përpara, ta korrigojnë. Të kritikosh pa e ndihmuar vartësin nuk është e drejtë. Po ashtu nuk është e drejtë dhe s'i lejohet askujt të fyejë kuadrin. Te ne ka shokë që gabojnë dhe për gabimet ose fajet duhet të përgjigjen, të ndëshkohen dhe kjo është e drejtë; por në vlerësimin e gabimeve duhet parë edhe ç'është bërë me këtë kuadër para se të arrinte në gabim; veç kësaj rëndësi të madhe ka

ç'bëhet më pas për ta shëruar këtë kuadër. Te ne ka shumë masa në Parti dhe në shtet, por punohet pak për shlyerjen e këtyre masave. Kjo ndodh jo vetëm se ka pakujdesi për t'i shlyer edhe kur njihet se kuadri ka punuar mirë më pas, por edhe pse shpesh mjaftohemi me kaq: «I bëjmë një vërejtje shokut që ta ketë parasysh e të marrë masa të ndreqet». Ka raste që kur një kuadër gabon, të tjerët e shohin me sy të keq (këtu nuk është fjala për elementë që bëjnë faje kundër Partisë, popullit e shtetit). Atëhere si do të përmirësohet ky kuadër? Këto janë rrugë administrative, por jo politikë kuadri. Të konsiderohet si detyra më e lartë e Partisë ndihma që duhet t'u jepet kuadrove. Ne duhet të luftojmë që kuadri të bëhet për ditë e më i aftë për detyrën që mban dhe të përparojë gjithmonë. Ulja e zëvendësimi i një kuadri në një sektor të caktuar duhet të konsiderohet si dobësi për atë sektor, dhe këtu nuk është fjala për të mbajtur në punë dembela dhe elementë që nuk përfitojnë nga ndihma, por është fjala për të shtuar kujdesin për kuadrot. Eksperienca ka treguar se rruga për përgatitjen e kuadrit është e gjatë dhe e vështirë dhe nga një kujdes i pamjaftueshëm ka kuadro që i kemi humbur për një kohë të shkurtër (dhe këtu është fjala për kuadro që gabojnë për fajin tonë). Njerëzit që punojnë edhe gabojnë, por Partia duhet të bëjë që kuadrot të gabojnë sa më pak e të korrigjohen shpejt. Prandaj është e nevojshme të përmirësohet qëndrimi në këtë drejtim, të shohim prapa çdo kuadri njeriun, shokun tonë të luftës dhe të ndërtimit të jetës së re.

Lidhur me masat ndëshkimore është e nevojshme të përcaktohen në një rregullore të posaçme llojet e masave, kush ka të drejtë t'i japë e t'i shlyejë etj. si edhe kriteret për dhënjen e masave ndëshkimore, meqë deri tani veprohet sipas atyre kriterëve të përgjithshme që ka Kodi i punës dhe Rregullorja mbi disiplinën në punë, e cila në shumicë është abroguar; pastaj secili dikaster ka edhe rregullat e tij.

Një problem me rëndësi, lidhur me trajtimin e kuadrove, është qëndrimi ndaj kuadrove të rinj. Ka raste që kuadro të rinj të dalë nga shkolla ose kurse nuk preferohen ose dhe kur mirren në punë nuk ndihmohen, pse mendohet se ai që ka dalë nga shkolla duhet t'i dijë të gjitha gjërat. Që të dyja qëndrimet e mësipërme nuk janë të drejta. Ne kemi nevojë të madhe për kuadro; me shumë sakrificë e shpenzime përgatiten kuadrot e rinj, prandaj këta duhet të vendosen në punë menjëherë. Veç asaj duhet të ndihmohen ata për të mos u thyer para vështirësive që hasin në prodhim.

Dihet se kuadrot nuk përgatiten vetëm me anën e shkollës, por në radhë të parë në jetë. Prandaj trajtimi i kujdesshëm i tyre do t'i kalitë ata, do t'i mësojë dhe do t'i edukojë si kuadro të ndërgjegjshëm në shërbim të popullit.

6. — Përmirësimi i punës për edukimin ideologjik të kuadrove.

Partia jonë i ka kushtuar dhe i kushton një kujdes të veçantë edukimit marksist-leninist të kuadrove të Partisë e të shtetit.

Partia jonë në Kongresin III të saj vuri detyra të rëndësishme për forcimin e mëtejshëm të përgatitjes ideo-politike dhe profesionale të kuadrove me qëllim që ata të njohin më thellë dhe të drejtojnë më mirë ekonominë dhe kulturën tonë popullore në rrugën e socializmit.

Edukimi marksist-leninist i kuadrove dhe i gjithë punonjësve dhe zbatimi në mënyrë krijuese i shkencës marksiste-leniniste janë kusht i domosdoshëm për zgjidhjen me sukses të detyrave të ndërtimit socialist.

Në konditat që kalojmë, kur ka shpërthyer një sulm i tërbuar nga ana e imperialistëve dhe e veglave të tyre, oportunistëve dhe revizionistëve të çdo ngjyre, kundër ideologjisë së proletariatit, kundër marksizëm-leninizmit, nevoja e kalitjes ideo-politike të kuadrove merr një rëndësi edhe më të madhe.

Qëndrimi i pjekur i të gjithë kuadrove tanë, i të gjithë Partisë përballë ngjarjeve të tetor-nëntorit 1956²⁹ ishte treguesi më i mirë i punës së madhe të bërë nga Partia për edukimin e drejtë dhe të shëndoshë të kuadrove.

Por duhet të themi se me gjithë masat e marra deri më tani nga Partia për përgatitjen më të mirë ideologjike të kuadrove, prapë në këtë drejtim kemi ende mjaft dobësi. Kryesorja është mungesa e një pune të kualifikuar në propagandimin e marksizëm-leninizmit në të gjitha format e edukimit të kuadrit.

Plenumi i prillit 1955²⁹ i Komitetit Qendror theksoi se kyçi për të përmirësuar edukimin marksist-leninist është rritja e nivelit ideo-kultural të propagandistëve dhe caktonte detyrën që gjendja e pakënaqëshme në këtë drejtim «të përbyset, sepse ndryshe vendimet për zhdukjen e prapambetjes së komunistëve e të kuadrove do të mbetet në hava». Por deri tani kjo detyrë nuk po kryhet aq mirë, mbasi niveli ideo-kultural i propagandistëve ka bërë shumë pak ndryshime: nga 14 për qind me shkollë të mesme që kanë qenë në prill të vitit 1955 tani ka arritur në 18,5 për qind, me shkollë të lartë nga 6 për qind në 12 për qind; ndërsa me kurse e shkolla partie nga 32,8 për qind në 34 për qind.

Prandaj del si një nga çështjet më të rëndësishme në punën tonë për ngritjen ideo-politike të kuadrove kujdesi për zgjedhjen më të mirë dhe përgatitjen e propagandistëve. Çështja është të mos propagandohen idetë e marksizëm-leninizmit në mënyrë skolasitike dhe monotone, por ato të lidhen me mjeshtëri me realitetin tonë, me politikën konkrete të Partisë sonë në periudha të ndryshme, me detyrat praktike që qëndrojnë para Partisë. Natyrisht kjo çështje nuk mund të zgjidhet menjëherë, por komitetet e par-

tisë dhe drejtoria e agjitpropit duhet të punojnë me kujdes dhe sistematikisht për të përgatitur propagandistë të mirë për të gjitha format e edukimit marksist-leninist të kuadrove.

Propaganda e Partisë duhet t'i edukojë kuadrot tanë duke u nisur nga realiteti i vendit tonë. Të rrënjës në ta vendosmërinë për të kaluar me sukses vështirësitë që hasim në ndërtimin e socializmit. Propaganda e Partisë duhet t'i edukojë kuadrot që të jenë të thjeshtë, parimorë dhe praktikë, të luftojë prirjen që kanë disa kuadro për t'i paraqitur çështjet si shumë të vështira, që filozofojnë kot, që nën pretekstin e studimeve i zgjatin gjërat pa masë, që mundohen gjoja t'i kripin gjërat e më në fund i bëjnë shëllirë.

Një kërkesë tjetër, së cilës duhet t'i përgjigjet propaganda e Partisë, është që të rritë ndjenjën e përgjegjësisë dhe inisiativën e kuadrove.

Një çështje tjetër me rëndësi në këtë drejtim është kujdesi i vazhdueshëm i Partisë për edukimin ideo-politik të inteligjencies sonë. Është e vërtetë se në përqindjen dërmuese (rreth 80 për qind të saj) inteligjencia jonë përbëhet nga elementë të përgatitur pas çlirimit. Por kjo nuk duhet aspak të na bëjë të dobësojmë kujdesin për edukimin e saj, së pari, sepse kuadrot e vjetër përbëjnë 20 për qind të numrit të përgjithshëm të inteligjencies e ky nuk është një numër shumë i vogël. Pa dyshim në këtë numër ka elementë që qysh gjatë luftës dhe pas çlirimit u lidhën ngushtë me Partinë, u ushqyen me ideologjinë e saj, ndoqën format e edukimit marksist-leninist etj. Por ka dhe mjaft të tjerë që ruajnë dhe bluajnë në ndërgjegjen e tyre mbeturina të ideologjisë borgjeze si rezultat i shkollave të ndryshme (të ndryshme dhe nga vendet) dhe i influencës së shoqërisë (rrethit shoqëror), në të cilin kanë jetuar. Kjo gjendje patjetër duhet mbajtur parasys. Riedukimi i këtyre njerëzve pa dyshim kërkon punë të vazhdueshme dhe me durim. Së dyti, sepse edhe kuadri i ri i përgatitur pas çlirimit, megjithëse qoftë nga përbërja qoftë nga edukata që ka marrë në shkollë (shumica është përgatitur në vend dhe në Bashkimin Sovjetik) është shumë më i shëndoshë, prapëseprapë edhe ai ka nevojë për një kalitje të vazhdueshme, për ta ruajtur nga shkarje të ndryshme që vijnë si rezultat i papjekurisë, mendjemadhësisë e mendjelehtësisë, i intelektualizmit të sëmurë etj. Prandaj Partisë i duhet që të bëjë një punë të kujdesshme dhe me këta kuadro, për të forcuar më shumë shpirtin e tyre revolucionar, qëndrimin e tyre klasor para çdo ngjarjeje, të edukojë në ta thjeshtësinë, maturinë dhe urtësinë.

Partia në punën e saj praktike, duke udhëhequr inteligjencien, ka realizuar bashkëpunimin midis kuadrove të vjetër dhe të rinj të inteligjencies. Puna e kënaqshme që bëjnë shumë nga intelektualët e vjetër, duke zbatuar vijën e Partisë në sektorët e punës ku janë, si dhe puna e frytshme e shumicës së intelektualëve të

rinj tregon ndihmën reciproke që i japin këta njëri-tjetrit; të rinjtë kanë ndihmuar të vjetrit, të vjetrit kanë ndihmuar e ndihmuan këta me eksperiencën e gjatë të punës së tyre. Veç duhet theksuar se pikërisht këtu ka disa shfaqje megallomanie nga disa kuadro të rinj siç ka ndodhur në radhët e mjekëve, të cilët mendojnë se vetë dinë gjithshka, se kolegët e tyre të vjetër s'bëjnë etj. Një qëndrim i tillë përmbysës ndaj eksperiencës shumëvjeçare është krejt i padrejtë dhe i dëmshëm. Patjetër Partia duhet t'i edukojë kuadrot e saj me modestinë dhe thjeshtësinë karakteristike të domosdoshme për kuadrot tanë.

Një problem i rëndësishëm që e dikton shkalla e zhvillimit dhe e perspektivës së vendit tonë është çështja e inteligjencies me kualifikim të lartë. Në vendin tonë rritja e inteligjencies me kualifikim të lartë është në fazën e saj fillestare të organizimit. Partia dhe qeveria kanë marrë disa masa të rëndësishme për këtë çështje: është vendosur organizimi i aspiranturës, janë dërguar kuadro për të kryer aspiranturën në Bashkimin Sovjetik me shkëputje nga prodhimi, u dhanë gradat e para shkencore dhe ka filluar organizimi i ndjekjes së aspiranturës në vend pa shkëputje nga prodhimi. Por konditat kërkojnë një punë më të kujdesshme dhe me ritme më të shpejta në këtë drejtim.

Inteligjencia jonë patriote jep një kontribut të vlefshëm në punën e ndërtimit socialist të vendit. Sigurisht Partia jonë ka çmuar dhe çmon si duhet rolin e inteligjencies popullore në jetën e vendit, por njëkohësisht ajo ndjek me kujdes edhe të metat që vihen re dhe që mund të shfaqen në radhët e saj. Duhet të themi se në disa gabime dhe të meta të tyre influencon dhe puna jonë e dobët. Në disa nga intelektualët, si në disa arësimtarë, punonjës të shkencës etj., vihet re një farë indiferentizmi, qëndrimi prej spektatori, qëndrimi heshtjeje përpara problemeve që shtron Partia dhe qeveria me masat e popullit, megjithëse kohët e fundit ka një farë gjallërimi në këtë drejtim. Sigurisht kjo është një shfaqje e dëmshme. Kjo shfaqje, siç e theksoi edhe Plenumi i prillit i vitit 1955 i Komitetit Qendror, e ka burimin edhe në qëndrimin sektar, në konsideratën jo të drejtë ndaj intelektualëve, bile në disa raste duke i përbuzur si «borgjezë». Kjo ka ardhur nga se në praktikë në mjaft raste sektarizmi, si antipod i oportunitizmit, të cilin Partia e ka luftuar dhe e lufton me vendosmëri, nuk është konsideruar kudo i rrezikshëm. Partia jonë i ka luftuar dhe i dënon këto shfaqje të qëndrimeve jo të drejta, jo në rrugë partie dhe i ka konsideruar pengesë për shfaqjen e gjithanshme të forcave krijuese të inteligjencies. Si refleksi i kësaj të metë në praktikë është vënë re edhe një e metë tjetër, mosmbështetja sa duhet në masën e këtyre njerëzve për diskutimin dhe zgjidhjen e problemeve të sektorit të punës. Sado që kohët e fundit ka përmirësime në këtë drejtim,

është e nevojshme që kjo gjë të shtrihet e të thellohet në të gjitha format.

Për të mobilizuar plotësisht forcat krijuese të inteligjencies sonë, për të ngritur në një shkallë më të lartë ndërgjegjen politike dhe aftësitë e saj profesionale është e nevojshme që të zhvillohet një punë e thellë e gjithanshme edukative dhe praktike. Një mjet i fuqishëm për edukimin e inteligjencies është njohja mirë nga ajo se çfarë është bërë dhe ç'po bëhet në vendin tonë, pjesëmarrja e saj aktive në zhvillimin e realitetit të vendit tonë. Sikurse u përmend edhe më lart, edukimi teorik e ndihmon inteligjencien në forcimin e botëkuptimit revolucionar, por ajo që e edukon më shumë atë është praktika, jeta shoqërore, puna që bëjnë intelektualët për të ndërtuar socializmin bashkë me të gjithë popullin.

Kësaj çështjeje, aktivizimit sa më të madh të tyre, në interes të shoqërisë, të kombit, të lumturisë së popullit, duhet t'i kushtojmë kujdes të madh.

Për të gjitha sa u thanë më lart dhe meqenëse inteligjencia jonë është e re dhe nga që ajo është më e ndjeshme e më lehtë mund të infektohet nga ideologjia e huaj, është e domosdoshme që të përmirësohet puna me intelektualët dhe të shtohet kujdesi i Partisë për ta.

Një formë pune shumë e rëndësishme për edukimin e inteligjencies është kontakti i drejtpërdrejtë dhe i ngrohtë midis drejtuesve të Partisë e të shtetit dhe intelektualëve. Është e rëndësishme që për të gjithë intelektualët të krijohet një atmosferë e ngrohtë. Partia duhet të bëjë që ata ta ndiejnë veten plotësisht si pjesëtarë aktivë të shoqërisë sonë, dhe të jetë e qartë mirë për ata se në zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të sektorit ku punojnë nën udhëheqjen e Partisë, propozimet dhe sugjerimet e tyre të vlefshme studjohen me vëmendje dhe merren parasysh. Detyra e organizatave të Partisë është që t'i ndihmojnë intelektualët për ngritjen e tyre ideologjike dhe politike, të zhvillohen me ta biseda dhe tema në këtë drejtim, të organizohen diskutime shkencore dhe sipas rastit të ndihmohen për t'u korrigjuar me anën e kritikës shoqërore.

Më në fund, një çështje e rëndësishme për edukimin ideo-profesional të kadrove tanë është çështja e përvetësimit dhe e zbatimit në mënyrë krijuese, në përshtatje me konditat tona, të eksperiencës sovjetike në radhë të parë dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore.

Partia e ka ngritur prej kohësh me forcë këtë çështje dhe në fakt është bërë mjaft, por ende ka mjaft çështje të pazgjidhura në këtë drejtim. Bazat materiale për një punë shumë të frutshme në këtë drejtim janë krijuar. Te ne vijnë qindra botime të ndryshme shkencore e teknike nga Bashkimi Sovjetik, në radhë të parë, dhe nga vendet e tjera të demokracisë popullore. Por tërë ky ma-

terial nuk shfrytëzohet në masën e duhur, sepse te ne, dhe nga bibliotekat qendrore, bëhet një punë e pakënaqshme, aspak shkencore në sistemimin, organizimin dhe lehtësimin e punës për shfrytëzimin e tërë këtij materiali.

Nga ana tjetër këtu ka të bëjë dhe çështja e njohjes së gjuhëve të huaja, sidomos e gjuhës ruse. Te ne, brenda mundësive, përkthehet mjaft material i vlefshëm. Por është krejt e pamundur të përkthehet gjithshka që del në BS ose në vendet e tjera. Prandaj çështja e mësimit të gjuhës ruse duhet të shtrohet dhe një herë me forcë në Parti. Ne kemi mjaft suksese në këtë drejtim. Por mund të bëhet më shumë. S'duhet të lejohet, fjala vjen, që nxënësit e shkollave të mesme, pa le të instituteve [të larta], të mbarojnë shkollat pa mësuar të lexojnë dhe të kuptojnë tekstet në rusisht. Kësaj çështjeje Ministria e Arësimit duhet t'i kushtojë më tepër kujdes se sa deri më sot.

— III —

MBI MASAT QË DUHEN MARRË PËR PREGATITJEN E KUADROVE.

Kongresi III i Partisë shtroi si një detyrë të rëndësishme studimin më konkret të nevojave në perspektivë për kadro që kanë gjithë sektorët e aktivitetit në vend dhe duke u bazuar në këtë studim të përcaktohen masat praktike që duhen marrë për plotësimin sa më mirë të këtyre nevojave. Më poshtë ne do të përpikemi t'i zbërthejmë sa më konkretisht këto detyra themelore.

Siç dihet në përputhje me detyrat e caktuara nga Partia dhe me qëllim që të përballohen nevojat e ekonomisë popullore me punëtorë të aftë dhe të kualifikuar si edhe me kadro të mesëm dhe të lartë janë organizuar një seri formash, kursesh e shkollash të ndryshme.

1) Një punë e madhe është bërë gjatë kësaj kohe për kualifikimin e punëtorëve dhe për përgatitjen e kadrove të ulët:

Duke marrë parasysh se klasa punëtorë është e re dhe pa eksperiencë profesionale, si dhe zhvillimin e shpejtë të industrisë sonë, veçanërisht gjatë planit të parë pesëvjeçar, i është kushtuar një kujdes i veçantë edukimit profesional të punëtorëve dhe kualifikimit të tyre. Për këtë qëllim janë përdorur si forma pune: kurset e kualifikimit pranë ndërmarrjeve ekonomike, ku kanë kaluar mijëra punëtorë me shkëputje dhe kryesisht pa shkëputje nga prodhimi, sistemi i nxënësve në ekonomi dhe ai i patronazhit mbi punëtorët e rinj nga ata më me eksperiencë, janë hapur gjithashtu shkolla të ulëta profesionale, ato të rezervave të punës dhe një

sasi punëtorësh të dalluar janë dërguar jashtë shtetit që të kualifikohen për nevojat e industrisë sonë të re.

Duhet shënuar se në punën për përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar dhe për rritjen e kualifikimit të kuadrove ekzistues gjatë kësaj kohe ka patur të meta të mëdha, të cilat duhen mënjanuar në të ardhshmen:

a) Përgatitja e punëtorëve të kualifikuar nuk është bërë gjithnjë me një kriter të drejtë, sidomos kjo përsa i përket organizimit të kurseve dhe të shkollave të rezervave të punës. Në disa raste, pa u njohur nevojat reale për punëtorë të kualifikuar sipas specialiteteve të ndryshme janë përgatitur punëtorë të kualifikuar për specialitete më pak të nevojshme. Kjo gjë ka shkaktuar anomali në vendosjen në punë të kuadrove dhe në mosplotësimin e nevojave për specialitetet e nevojshme. Për këtë një përgjegjësi e madhe bie mbi ndërmarrjet ekonomike si dhe mbi dikasteret, të cilat nuk i kushtojnë kujdes studimit të drejtë të nevojave të tyre. Kështu, p.sh., NISH-Çimentua në Vlorë në vitin 1955 kishte shumë nevojë për përgatitjen e shefave të turneve për mekanikë etj., ndërsa plani i Ministrisë së Industrisë nuk parashikonte gjë për këtë qëllim. NISH Peshkimi në Durrës kishte planifikuar kualifikimin për peshkim të 44 punonjësve dhe kualifikoi vetëm 16, kurse nga 3 mekanikë që kishte nevojë për të kualifikuar ajo kualifikoi 12 veta. Shembuj të tillë ka boll.

Disa ndërmarrje, ministri dhe institucione qendrore bëjnë një punë të përciptë, të përgjithshme dhe pa shumë rezultate lidhur me përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar. Nuk ka preokupacion për të zgjidhur nevojat për ato kuadro që decidojnë më shumë në procesin e punës dhe të prodhimit siç janë, p.sh., muratorët ose karpentierët në ndërtim, kryesaldatorët dhe motoristët në industrinë e naftës, llogaritarët në sistemin e financës etj., ose ka prirje për të plotësuar nevojat që dalin aty për aty pa menduar për nevojat në perspektivë.

b) Siç thamë dhe më lart, nga ana e dikastereve dhe e organeve ekonomike e kulturalo-arësimore nuk i kushtohet kujdes ruajtjes së kontingjenteve të kuadrove që përgatiten në kurse e shkolla. Kjo ngjet për dy arsye: nga njera anë sepse kujdesi i enteve dhe i organeve përkatëse, duke filluar që nga ministrinë, për përgatitjen, për lidhjen me zanatin, për vendosjen e rregullt të tyre, duke u krijuar dhe konditat e nevojshme, nuk ka qenë kurdoherë në lartësinë e duhur, dhe, nga ana tjetër, sepse nuk është patur parasysh kurdoherë që për kurse e shkolla të zgjidhen njerëzit nga zonat ku do të dërgohen të punojnë.

c) Një e metë tjetër me shumë rëndësi është puna e dobët që zhvillohet për përgatitjen e kuadrove të kualifikuar si në kurset, ashtu edhe në shkollat e rezervave të punës. Mungesa e instruktorëve të aftë për to si dhe mungesa e ndjeshme e dispencave

dhe e mjeteve të nevojshme mësimore bën që përfitimi në këto kurse e shkolla, sidomos për përgatitjen e dëgjuesve nga ana praktike, të jetë i pakët. Kështu që në fakt atyre u duhet të kalojnë edhe një kurs tjetër në praktikë që të fitojnë kualifikimin e nevojshëm. Rezultatet e provimeve lidhur me kategorizimin e punëtorëve që u bënë vitin e kaluar treguan qartë dobësitë e mësipërme. Kështu, p.sh., gjatë provimeve vetëm në sektorët e industrisë, të ndërtimit, të komunikacionit dhe të artizanatit nga 3102 punëtorë, që mbanin kategorinë VII, mbetën në po këtë kategori vetëm 1106 dhe nga 4290 punëtorë të kategorisë VI, mbetën vetëm 2758 vetë. Kjo tregon se kualifikimi i tyre ka qenë jo i rregullt dhe nuk u përgjigjet kërkesave teknike.

Këtyre të metave është e domosdoshme t'u jepet fund sa më parë me qëllim që të përmirësohet puna për kualifikimin dhe edukimin profesional të punëtorëve tanë.

2) Masa të rëndësishme janë marrë gjithashtu për përgatitjen e kuadrove të mesëm për ekonominë dhe kulturën popullore. Për të përballuar nevojat e industrisë, të bujqësisë, të komunikacionit, të ndërtimit, të tregëtisë, të financës, të arësimit etj. janë ngritur një numër i madh shkollash të mesme profesionale. Duhet shënuar se kujdesi i Partisë dhe i qeverisë për përgatitjen e specialistëve të mesëm, që lidhet edhe me zhvillimin e gjerë të industrisë e të kulturës popullore pas çlirimit, shprehet edhe në faktin se, ndërsa para luftës kishte vetëm 5 shkolla profesionale me jo më shumë se 800 nxënës, sot kemi 23 shkolla profesionale me 6100 nxënës. Gjatë periudhës 12-vjeçare nga teknikumet dhe shkollat profesionale të vendit janë përgatitur gjithsej 7044 kuadro, ndërsa vetëm gjatë pesëvjeçarit të parë janë përgatitur përmbi 4800 teknikë të mesëm. Si rezultat i kësaj pune numri i kuadrove të mesëm në vitin 1955 kundrejt vitit 1950 është ngritur në 252 për qind. Në disa sektorë kjo ngritje paraqitet kështu: në industri 364 për qind, në bujqësi 500 për qind, në ndërtim 339 për qind dhe në komunikacion 345 për qind.

Veç sistemit të rregullt, me qëllim që të shpejtohet ritmi i përgatitjes së kuadrove të mesëm, janë organizuar shkollat e natës dhe ato me korrespondencë, në të cilat sot mësojnë 2998 vetë, duke mos përfshirë këtu ata të shkollave të kulturës së përgjithshme.

Megjithkëtë, siç do të shohim edhe më poshtë, si nga pikëpamja e sasisë, ashtu edhe e cilësisë së kuadrove tanë të mesëm ka mungesa.

Përsa i përket cilësisë së përgatitjes së kuadrove të mesëm, veç atyre që u përmendën edhe për teknikët e ulët (si mungesa e planifikimit etj.) në shkollat tona profesionale e teknike vihen re këto të meta:

a) Mungon lidhja e shëndoshë midis teorisë dhe praktikës,

për të cilën foli edhe Kongresi III i Partisë. Megjithëse kohët e fundit si rezultat i masave që janë marrë ka pasë disa përmirësime, prapë del detyra që në të ardhshmen të zgjidhet edhe më drejt ky problem. Në mënyrë të veçantë kjo duhet të mbahet parasysh për teknikumet, ku lidhja e teorisë me praktikën, e shkollës me jetën janë ende shumë të dobëta.

b) Në përgatitjen e kuadrit teknik të mesëm, siç thamë edhe për teknikët e ulët, nuk është patur kurdoherë parasysh përgatitja e kuadrove sipas krahinave të ndryshme. Kjo veçanërisht për arësimin, për shëndetësinë dhe për industrinë e minierat, gjë që ka shkaktuar shpesh që kuadrot e mesëm për arësye të ndryshme të mos shkojnë në sektorin, për të cilin kanë mbaruar.

3) Krahas me punën e madhe që është bërë në vendin tonë për përgatitjen e kuadrit teknik të ulët dhe të mesëm, një kujdes i veçantë është treguar dhe për përgatitjen e kuadrove të lartë.

Menjëherë pas çlirimit çdo vit u dërguan me qindra kuadro për t'u përgatitur në institutet e larta të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore. Veç kësaj në 5-vjeçarin e parë u hapën në vend 6 institute të larta, të cilat kanë dhënë kuadrot e parë.

Që nga çlirimi deri më sot kanë mbaruar studimet e larta në shkollat jashtë shtetit 1000 kuadro, nga të cilët: inxhinierë të ndryshëm 400, për mjekësi 166, për agronomi dhe zooveterinari 112, për pedagogji dhe për fizkulturë 145 etj. dhe nga institutet tona kanë dalë gjithsejt 342 kuadro të lartë.

Për të shpejtuar ritmin e përgatitjes së kuadrit të lartë, krahas me përgatitjen në sistemin e rregullt, janë marrë masa për përgatitjen e kuadrove të lartë pa shkëputje nga prodhimi me anë të arësimit të natës dhe me korrespondencë. Sot në këto forma mësojnë 2260 vetë (duke përfshirë edhe institutin 2-vjeçar), nga të cilët 931 në shkollat e natës dhe 1329 me korrespondencë. Rezultate më të mira ka në këtë drejtim në Institutin e lartë pedagogjik dhe në Institutin e lartë ekonomik, ku mësojnë shumica e atyre me korrespondencë dhe të natës.

Me gjithë sukseset e arritura për përgatitjen e kuadrit të lartë vërehen edhe një sërë të metash. Ata që mbarojnë jashtë shtetit janë të shkëputur nga problemet ekonomike të vendit tonë dhe nga gjendja konkrete e punës në ndërmarrjet tona, kështu që, kur kthehen nga studimet, duan një farë kohe për t'u ambientuar me problemet e ndërmarrjes. Edhe për kuadrot që mbarojnë institutet tona duhet të rishikohen programet përvoja të përkjet forcimit të lidhjes së mësimin me praktikën. Studentët tanë ende pak merren me punë praktike gjatë kohës që janë në shkollë. Përveç kësaj, për specialistët e lartë të ardhshëm ka rëndësi shumë të madhe praktika në qendrat e prodhimit, ku ata duhet të merren më gjatë me punë të drejtpërdrejtë.

Një e metë tjetër për përgatitjen e kuadrit të lartë jashtë shtetit është se ka raste që dërgohen studentë në specialitete që nuk janë kaq të nevojshme dhe kështu ndodh që të ndërrohen specialitetet e studentëve. Por ajo që duhet theksuar lidhur me këtë është disiplina e dobët; shpesh studentët, me iniciativën e tyre, nxjerrin gjithfarë pretekstesh, tentojnë, shpesh jo pa sukses, për të ndryshuar specialitetin dhe kontrolli në këtë drejtim është mjaft i dobët.

Edhe ministritë nuk mbajnë lidhje të rregullta me studentët jashtë shtetit. Shumë pak ndihmohen studentët për zgjedhjen e diplomës me temë shqiptare. Materialet e nevojshme dërgohen jo të plota dhe me shumë vonesë. Si përfundim studentët tanë jashtë shtetit kanë pengesa dhe kur kthehen nuk i shërbejnë aq shpejt sa kërkohet çështjes.

Në të ardhmen duhen marrë të gjitha masat që t'u jepen fund këtyre të metave.

* * *

Në përgjithësi dhe veçanërisht për secilin sektor gjendja e punëtorëve të kualifikuar, e kuadrove të mesëm dhe të lartë, duke e krahasuar vitin 1955 me vitin 1950 në përqindje, paraqitet si më poshtë:

Nr. Rd.	E m e r t i m	Punëtorë të kualifikuar	Kuadro të mesëm	Kuadro të lartë
	I. Gjithsejt :	213	252	232
	Nga të cilët :			
1.	Në industri-miniera	216	364	972
2.	Në bujqësi	600	500	279
3.	Në ndërtim	109	339	623
4.	Në tregëti	120	367	400
5.	Në komunikacion	169	345	740
6.	Në arësim kulturë	115	196	156
7.	Në shëndetësi	153	225	150

Më 1 gusht 1956 numri i specialistëve me arësim të mesëm profesional dhe të lartë arrin në rreth 10.500, prej të cilëve 1750 me arësim të lartë dhe 8750 me arësim të mesëm special. Është e rëndësishme të vihet në dukje se rreth 74 për qind e kuadrove me arësim të lartë dhe 83 për qind e kuadrove të mesëm janë përgatitur gjatë këtyre 12 vjetëve që pas çlirimit.

Duke krahasuar shifrat e sipërme me ato që u thanë në fillim, lidhur me përgatitjen sidomos të teknikëve të ulët dhe atyre të

mesëm, del, së pari, se sot nuk punojnë që të gjithë ata që janë specializuar ose kualifikuar në prodhim. Ky është problemi më i rëndësishëm, ku duhet të përqëndrohet vëmendja jonë. Në qoftë se vazhdohet në këtë rrugë, duke shpenzuar me miliona lekë për të pregatitur kuadro dhe këto kuadro nuk futen në prodhim, ne nga njëra anë do të shpenzojmë kot dhe nga ana tjetër do të mbajmë veten me ëndrra se po i plotësojmë nevojat në kuadro.

Së dyti, në krahasim me nevojat, deficitet e ekonomisë dhe të kulturës në kuadro të mesëm dhe të lartë janë ende të mëdha. Kështu, përsa u përket teknikëve të mesëm ky deficit deri në vitin 1956 arrin në rreth 2400 vetë dhe në teknikë të lartë në 1900 vetë.

Theksojmë se për të zgjidhur problemin e kuadrit për ekonominë dhe kulturën tonë duhet një kujdes i posaçëm, një punë sistematike, e planifikuar e me perspektivë nga të gjitha organet shtetërore dhe të Partisë. Faktet e deritanishme tregojnë mjaft pakujdesi. Ja disa shembuj: Megjithëse të gjithë sektorët e punës kanë nevoja të mëdha për kuadro teknikë të mesëm, çdo vit dikasteret e ndryshme lejojnë mbi 250-300 teknikë të mesëm që të largohen nga puna për të vazhduar studimet e larta jashtë planit të caktuar, ose luftohet shumë nga dikasteret për të kërkuar hapjen e një teknikumi apo të një dege, por kur vjen puna për të caktuar një ose dy kuadro teknikë për të dhënë mësim në këto shkolla, ata nuk pranojnë të japin asnjë. Ka edhe më keq; ndodh ngandonjëherë që kur autorizohen të hapin një shkollë profesionale, dikasteret nuk kanë të qarta nevojat. Kështu për dy vjet në teknikumin teknologjik, pranë Kombinatit të tekstilit, nuk ishin përcaktuar as profilet, as edhe planet apo programet mësimore, por vazhdohej të zbatohesh programi i degës mekanike të Politeknikut «7 Nëntori».

Nga të gjitha sa u thanë del se problemi i përgatitjes së kuadrit për nevojat e ekonomisë dhe të kulturës popullore ka një rëndësi të dorës së parë. Qysh tani kemi deficite të mëdha. Por në pesëvjeçarin e dytë këto deficite, nëse ne do të vazhdojmë të punojmë me të meta, siç i theksuam më sipër, do të rriten dhe, si pasojë, zhvillimi ekonomik e kultural i vendit tonë do të pengohet seriozisht. Në të kundërtën, nëse çështja e kuadrit do të merret si një çështje shumë e rëndësishme, në bazë të një studimi që është bërë për këtë qëllim, del se ekzistojnë të gjitha mundësitë për ta zgjidhur drejt këtë problem kyç. Masa e parë urgjente që duhet të merret nga komitetet e Partisë, nga komitetet ekzekutive dhe Ministria e Arësimit është sigurimi i kontingjenteve të planifikuara të nxënësve në të gjitha kategoritë e shkollave, sepse boshllëqet që janë krijuar, sidomos në mosfrekuentimin total të arësimit 7-vjeçar dhe të shkollave të mesme profesionale, kanë filluar që tani të ndikojnë negativisht në plotësimin e nevojave të ekonomisë e të kulturës për kuadro të mesëm dhe të lartë.

Në përputhje me zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore, gjatë 5-vjeçarit të dytë parashikohet një rritje e mëtejshme edhe në lëmin e përgatitjes së kuadrit. Në këtë mënyrë gjatë 5-vjeçarit të dytë parashikohet të pregatiten jo më pak se 39.000 punëtorë të rinj të kualifikuar, kurse në format e ngritjes së kualifikimit do të kalojnë rreth 70.000 kuadro ekzistuese. Në këtë mënyrë në vitin 1960 jo më pak se 71 për qind e punëtorëve, që punojnë në ekonominë popullore, do të jenë punëtorë të kualifikuar nga 62 për qind që ishin në vitin 1955. Në këtë mënyrë sipas planit të dytë pesëvjeçar numri i punëtorëve të kualifikuar do të arrijë nga 56.400 në vitin 1955 në 81.000 në vitin 1960. Gjithashtu gjatë 5-vjeçarit të dytë parashikohen të pregatiten 6.200 teknikë të mesëm dhe 2.300 kuadro të lartë.

Me gjithë rezultatet e arritura dhe masat që parashikohen të merren gjatë 5-vjeçarit të dytë, është e nevojshme të vihet në dukje se: nevojat e degëve të ndryshme të ekonomisë dhe të kulturës nuk plotësohen me kuadro të mesëm dhe të lartë dhe ne trashëgojmë në 5-vjeçarin e dytë deficite të ndryshme për teknikë të mesëm dhe specialistë me arësim të lartë.

Në 5-vjeçarin e dytë numri i kuadrove të mesëm do të arrijë në rreth 12.300 dhe të lartë në rreth 3.750.

Në këtë mënyrë në 1960 nevojat e sektorëve të ndryshme do të sigurohen afërsisht në këtë masë:

Nr. Rd.	E m ë r t i m i	% e sigurimit në kuadro të mesëm deri më 1960	% e sigurimit në kuadro të lartë deri më 1960
1.	Industri — miniera	89	61
2.	Bujqësia	76	76
3.	Komunikacioni	73	62
4.	Ndërtimi	89	86

Megjithëse gjatë 5-vjeçarit të dytë për nevojat e arësimit-kulturës do të mbarojnë 1700 kuadro të mesëm dhe 447 kuadro të lartë, përqindja e sigurimit me kuadrin mësimor përkatës, sipas gradës së shkollës, parashikohet të jetë në vitin 1960 si vijon: në arësimin parashkollor 60 për qind, në arësimin fillor 60 për qind, në arësimin 7-vjeçar 40 për qind dhe në arësimin e mesëm 80 për qind. Gjithashtu në sektorin e shëndetësisë do të ketë 1150 kuadro të mesëm dhe 615 të lartë. Në këtë mënyrë në vitin 1960 për afro 2500 banorë do të kemi një mjek dhe për 1300 banorë një ndihmësmjek.

Për disa specialitete kryesore përqindja e sigurimit do të vërtitet rreth këtyre shifrave:

Nr. Rd.	E m ë r t i m i	0/0 e siguri- mit me kua- dro të mesëm deri në 1960 sipas disa specialiteteve	Nr. Rd.	E m ë r t m	0/0 e sig. me kuadro të lar- të deri më 1960 sipas specialiteteve
1.	Mekanikë	94	1.	Ingj. gjeologë	72
2.	Elektricit	81	2.	" min. naftë	45
3.	Gjeologë e minera- logë	93	3.	" elektrikë	81
4.	Teknologë	66	4.	" teknologë	70
5.	Agro—zooteknikë— veterinerë	78	5.	" ndërtimi	85
6.	Ekonomistë	63	6.	Agronomë	66
7.	Personel i mesëm mjek	74	7.	Ekonom. financiarë	64
			8.	Mjekë	56

Në përgjithësi në fund të 5-vjeçarit të dytë ne parashikojmë një deficit prej 2200 teknikësh të mesëm dhe 1600 teknikësh të lartë, nga të cilët: për Ministrinë e Industrisë 180 teknikë të mesëm dhe përmbi 250 teknikë të lartë, për bujqësinë përmbi 500 teknikë të mesëm dhe përmbi 250 kuadro të lartë, për komunikacionin rreth 100 teknikë të mesëm dhe 50 të lartë, po kështu edhe për ndërtimin. Këto deficite mund të shtohen në qoftë se nuk ruhen kontingjentet e nxënësve në kategoritë e ndryshme të shkollave.

Duhet të përmendim se nevojat për punëtorë të kualifikuar, teknikë të mesëm dhe të lartë gjatë pesëvjeçarit të dytë janë përcaktuar në bazë të planit të aprovuar. Ndryshimet eventuale që mund t'i bëhen planit të dytë pesëvjeçar për të shpejtuar ritmin e zhvillimit të ekonomisë në bazë të studimit të veçantë që po bëhet mbi zhvillimin në perspektivë të ekonomisë sonë popullore do të bëjnë që këto nevoja të jenë edhe më të mëdha. Në këtë rast, me përjashtim të punëtorëve të kualifikuar, për përgatitjen e të cilëve mund të merren masa suplementare për të përballuar shtimin e nevojave nga ndryshimet eventuale që përmendëm më sipër, deficiti përse u përket teknikëve të mesëm dhe të lartë do të jetë edhe më i madh. Kuptohet që mundësitë për përgatitjen e kuadrit të mesëm dhe të lartë në këto 3 vjet të pesëvjeçarit të dytë që mbeten janë të kufizuara.

Nevojat për pesëvjeçarin e tretë janë edhe më të mëdha. Prandaj me qëllim që të plotësohen nevojat në përgjithësi dhe veçanërisht në sektorët ku deficitet janë më të mëdha, në vitet e ardhshme gjatë 5-vjeçarit të dytë dhe të tretë duhen marrë masa për të rritur ritmin e përgatitjes së kuadrove, duke përdorur

edhe disa forma të shpejta si kurset 2-vjeçare etj. Për këtë qëllim ekziston edhe një vendim i Byrosë Politike dhe i Këshillit të Ministrave, i cili do të fillojë të vihet në jetë nga shtatori i vitit 1957. Në bazë të një plani orientues dhe sipas nevojave të përfërta, të përcaktuara në bazë të një studimi të veçantë të bërë nga Komisioni i Planit në bashkëpunim me dikasteret përkatëse, ne mund të plotësojmë në masën 100% nevojat e ekonomisë dhe të kulturës deri në vitin 1965.

Në këtë mënyrë gjer në vitin 1965 në Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave do të kemi përmbi 1000 teknikë të lartë dhe 2700 teknikë të mesëm, në bujqësi përkatësisht 1700 dhe 3900, në komunikacion 200 të lartë dhe 500 të mesëm, në ndërtim 400 të lartë dhe 1200 të mesëm etj.

Gjithashtu deri në pesëvjeçarin e tretë në sektorin e arësimit dhe të kulturës ne do të kemi rreth 7700 kuadro të mesëm dhe rreth 1200 kuadro të lartë dhe në këtë mënyrë do të mundim të plotësojmë 100 për qind me mësues të arësimit përkatës arësimin parashkollor, fillor, 7-vjeçar dhe arësimin e mesëm.

Në sektorin e shëndetësisë deri në vitin 1965 do të kemi rreth 2000 kuadro të mesëm dhe rreth 1700 kuadro të lartë, me të cilët relativisht plotësohen nevojat, duke marrë parasysh mundësitë reale të vendit.

Kuptohet se përqindja e plotësimit të nevojave sipas sektoreve është deri diku relative, sepse ajo varet edhe nga sasia e kuadrove që i jepen çdo sektori në kohën e shpërndarjes së tyre. Sigurisht në lidhje me këtë duhet mbajtur gjithnjë parasysh precedenca për sektorët më të rëndësishëm. Por për të patur parasysh një pasqyrë më të qartë është më mirë të shikohet se si plotësohen nevojat për vitin 1965 për disa specialitete kryesore. Afërsisht gjendja do të jetë kjo:

Nr. Rd.	E m ë r t i m i	Kuadro të mesëm 1965		Nr. Rd.	E m ë r t i m i	Kuadro të lartë 1965	
		Nevojat gjith.	Siguro- hen			Nevojat gjith.	Siguro- en
1.	Mekanikë	1100	1100	1.	Inxh. mekanikë	400	400
2.	Elektricitë	450	450	2.	" elektrikë	250	250
3.	Gjeol. mineral.	1000	1000	3.	" gjeologë	300	300
4.	Gjeom. topografë	1600	1600	4.	" për minier naftë	200	200
5.	Teknologë	750	750	5.	" ndërtimi	400	400
6.	Agro-zooveterinerë	3000	3000	6.	" teknologë	350	350
7.	Ekonom. finan.	2500	2500	7.	Agronomë	950	950
				8.	Zooveterinerë	400	400
				9.	Ekonom. finan.	900	900

Nga shifrat e mësipërme del se deri në vitin 1965 ne mund t'i plotësojmë nevojat në mënyrë të kënaqshme për sektorët kryesorë të ekonomisë dhe të specialiteteve kryesore, natyrisht brenda mundësive që kemi ne dhe me këto përpjesëtime: në industri për çdo një kuadër të lartë 2,6 teknikë të mesëm, në komunikacion përkatësisht një me 2,5, në ndërtim një me 3 etj. ose për çdo inxhinier mekanik rreth 3 mekanikë të mesëm, për çdo inxhinier elektrik rreth 2 të mesëm, për çdo inxhinier ndërtimi rreth 4 teknikë të mesëm etj. Këto përpjesëtime dalin nga nevojat, por njëkohësisht ato tregojnë se ne shkojmë drejt pajisjes me ritme më të shpejta me kuadro të lartë, gjë që është shumë pozitive dhe e domosdoshme për ekonominë socialiste.

Në bujqësi ne do të kemi në vitin 1965 për çdo teknik të lartë 2,2 të mesëm. Sigurimi në masën e mësipërme i nevojave të bujqësisë është i kënaqshëm. Relativisht më keq paraqitet gjendja për shëndetësinë, ku deri në vitin 1965 do të kemi një mjek për 1000 banorë; kjo në krahasim me shtetet e tjera më të zhvilluara është e ulët.

Në bazë të të dhënave paraprake, në mbështetje të studimit të deritanishëm mbi zhvillimin në perspektivë të ekonomisë popullore për 10-15 vjet deri në vitin 1975, rezulton se numri i teknikëve të mesëm duhet të rritet rreth 57 për qind më shumë në vitin 1970 kundrejt vitit 1965 dhe ai i teknikëve të lartë rreth 62 për qind më shumë dhe në vitin 1975 kundrejt vitit 1970 respektivisht 32 për qind dhe 30 për qind. Ndërkaq vlen të përmendet se në bazë të parashikimeve paraprake zhvillimi i arësimit në pesëvjeçarin e katërt dhe të pestë është në gjendje të përballojë plotësimin e nevojave në teknikë të mesëm e të lartë, që përmenden më lart, në mënyrë normale.

Çfarë masash duhet të merren dhe ç'detyra dalin për të plotësuar nevojat deri në fund të 5-vjeçarit të tretë.

1. — Plotësimi i nevojave do të bëhet si zakonisht nëpërmjet sistemit të rregullt arësimor, duke patur parasysh detyrat që janë përcaktuar për këtë qëllim nga Kongresi III i Partisë. Por me gjithë shpejtimin dhe zhvillimin me ritme mjaft të larta të arësimit 7-vjeçar, të arësimit të mesëm të përgjithshëm dhe profesional si dhe të arësimit të lartë del se mundësitë e sigurimit të nevojave për teknikë të mesëm dhe të lartë si për 5-vjeçarin e dytë, ashtu dhe për të tretin në rrugën e zakonshme janë të pamjaftueshme.

Prandaj për të plotësuar nevojat në mënyrë pak a shumë të kënaqshme, të paktën për 5-vjeçarin e tretë, është e domosdoshme që, përveç sistemit të shkollave të rregullta, të merren masa suplementare për shpejtimin e ritmit të përgatitjes së kuadrove. Kjo

masë suplementare konsiston në përgatitjen e teknikëve dhe të specialistëve të lartë nga radhët e klasës punëtore, siç u tha edhe më lart. Përsa i përket hapjes së këtyre shkollave dhe kurseve sipas specialiteteve, kjo duhet të bëhet plotësisht në bazë të nevojave që dalin sipas sektorëve dhe specialiteteve kryesore që janë përcaktuar më lart. Duke u nisur nga këto, shkollat 2-vjeçare të punëtorëve duhet të hapen për të përgatitur mekanikë, elektrikistë, gjeolog-mineralogë, teknikë të mesëm ndërtimi, arësimtarë, kuadro kontabël etj.

2. — Siç dihet shkollat e natës dhe me korrespondencë janë të kufizuara (veçanërisht në shkollat profesionale me përjashtim të pedagogjikeve dhe deri diku të ekonomikes) dhe deri më sot kanë dhënë pak rezultate. Megjithkëtë po të merret parasysh se këto forma duhet të jenë një burim jo vetëm për ngritjen e nivelit kultural e profesional të kuadrove ekzistues, por mund të vlejnjë si burim për plotësimin e nevojave me kuadro përkatës, do të jetë e nevojshme të studjohen dhe të përcaktohen masa konkrete si për zgjerimin e forcimit e shkollave të natës, ashtu edhe të atyre me korrespondencë. Lidhur me këtë duhet të studjohet edhe shpërngulja e ndonjë teknikumi nga Tirana si dhe organizimi i teknikumeve të natës në qarqe ose rrethe, duke përdorur për këtë qëllim kuadro teknikësh që gjenden atje, sipas propozimit që kanë bërë punëtorët e Durrësit. Për bazat materiale të shfrytëzohen mundësitë e ndërmarrjeve si edhe mjetet që kanë gjimnazet dhe të mos hezitohet me pretekstin se nuk ka teknikume të ditës.

3. — Duke u nisur nga nevojat në perspektivë për teknikë të mesëm dhe të lartë sipas specialiteteve, del se ekonomia popullore ka nevojë të konsiderueshme për kuadro teknologë. Prandaj duhet parë mundësia e përgatitjes së kuadrove të mesëm dhe të lartë teknologë në vend, duke rihapur teknikumin teknologjik për nevojat e industrisë së veshëmbathjes dhe të industrisë ushqimore, ose degë të tilla pranë Politeknikut «7 Nëntori» si dhe fakultete të teknologjisë pranë universitetit. Por njëkohësisht duhet të merren masa për përgatitjen e planeve dhe të programeve mësimore.

Serioze është gjithashtu çështja e përgatitjes së mjekëve. Për të arritur që deri në fund të pesëvjeçarit të tretë të kemi një mjek për çdo 1000 banorë, gjë që nuk është shumë e kënaqshme, siç përmendëm më lart, parashikohet të shpejtohet shumë ritmi i përgatitjes së kuadrove të lartë mjekësorë në vitet e fundit të pesëvjeçarit të dytë dhe gjatë pesëvjeçarit të tretë. Por baza ekzistuese e Institutit të lartë mjekësor nuk e lejon në asnjë mënyrë një gjë të tillë. Ajo është shumë e ngushtë. Prandaj del i domosdoshëm dhe urgjent zgjerimi i kësaj baze. Gjithashtu duhet parë mundësia e hapjes së fakultetit të stomatologjisë për përgatitjen e dentistëve. Më në fund, shtimi i vrullshëm i kooperativave bujqësore, zhvillimi i gjithanshëm i tyre etj. do ta bëjë patjetër në

një të ardhme të afërt krejt të domosdoshme edhe hapjen e fakultetit të ekonomisë agrare për të përgatitur ekonomistë për bujqësinë.

4. — Për përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar krahas me format ekzistuese duhet të shikohen edhe forma të reja më të përshtatshme. Veçanërisht duhet të merren masa për forcimin e shkollave të rezervave të punës, në mënyrë që këto të bëhen një burim i rëndësishëm për përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar dhe për përgatitjen kulturele të klasës punëtore. Të përcaktohen më mirë profilet e shkollave të rezervave dhe për profesionet e vështira si për miniera e ndërtim të zëvendësohen këto me kurse 1-vjeçare, duke marrë nga prodhimi punëtorë të rritur. Gjithashtu të organizohen dhe të zgjerohen shkollat stakanoviste për shkëmbimin e eksperiencës së punëtorëve më të përparuar.

Të organizohet në kurset, në shkollat e rezervave të punës dhe shkollat e ulëta profesionale mësimi i më shumë se një profesioni (i 2-3 profesioneve të ngjashme), sidomos në ndërtim, në bujqësi për traktoristët dhe në disa degë të industrisë.

5. — Zgjerimi i kolektivizimit dhe i mekanizimit në bujqësi kërkon një numër të madh kuadros, prandaj duhet shtuar numri i kuadrove në shkollën e kooperativave bujqësore deri 600 vetë (300 për kryetarë, 300 për llogaritarë). Gjithashtu të organizohen kurse me afat të shkurtër në qendër dhe sidomos në rrethe për kuadro më të ulët të kooperativave bujqësore; këto kurse të mbahen me vetë shpenzimet e kooperativave, ndërsa shteti t'u sigurojë pedagogët e nevojshëm. Kooperativat bujqësore kanë nevoja të mëdha për kuadro. Shteti do të përgatisë agronomë dhe teknikë të tjerë të lartë për tërë sistemin e bujqësisë, pra edhe për kooperativat. Orientimi i përgjithshëm duhet të jetë që nëpër organikat të mbahet një numër i kufizuar shumë i domosdoshëm i këtyre kuadrove, kurse pjesa tjetër të vihet në dispozicion të kooperativave për t'i bërë anëtarë të tyre. Nga ana tjetër kooperativat bujqësore duhet të përgatisin me shpenzimet e tyre në shkollat shtetërore gjithë kuadrot e tjerë që kanë nevojë si teknikë të mesëm për bujqësi, infermierë e ndihmësmjekë, mami, arësimtarë etj. Kooperativat çdo vit në planet vjetore të tyre duhet të parashikojnë shpenzimet për përgatitjen e kuadrit. Një burim i rëndësishëm për përgatitjen e kuadrove të ulët të bujqësisë duhet të jenë fermat e SMT-të. Të bëhet rregull që traktorët e rëndë të punojnë me dy turne, duke patur 2 traktoristë e 2 ndihmës, duke marrë për këtë qëllim bujq të mirë nga kooperativat; po kështu mund të dërgohen anëtarë të kooperativave të punojnë e të mësojnë në fermat për perime, patate, për pambukun, për mjelëse etj., të cilët, pasi të mësojnë, të kthehen në kooperativat e tyre.

6. — Ndërtimet po zgjerohen qoftë si rezultat i investimeve të rëndësishme që bën shteti, qoftë dhe si rezultat i ndërtimeve që bëjnë kooperativat e shitblerjes e të artizanatit, sidomos kooperativat bujqësore dhe vetë individët. Si rezultat i kësaj, nevojat për kuadro të ndërtimit veçanërisht për muratorë e karpentierë po zgjerohen. Edhe për këtë kategori kuadros duhet menduar seriozisht, prandaj të përmirësohet puna në kurset e specializimit në kantieret e ndërtimit si edhe në shkollën e rezervave të punës; të zgjerohet mësimi me anë të sistemit të patronazhit, të merren masa për të siguruar pjesëmarrjen në punë të të gjithë pjesëtarëve të aftë të familjeve që janë vendosur pranë kantierëve të ndërtimit etj. Vetë ndërmarrjet e ndërtimit dhe komitetet ekzekutive të rretheve të vihen para përgjegjësisë për të përgatitur të gjithë kuadrot që u nevojiten për të kryer volumin e punimeve të planifikuara të ndërtimit. Pa dyshim të mbahet parasysh që të përgatiten kuadro nga vendi për të evituar transferimet e shumta të muratorëve e të karpentierëve. Të studjohet kategorizimi si edhe shpërblimi për vështirësi në punë për efekt transferimi për muratorët e për karpentierët. Për të evituar anomalitë që ndodhin, ndërtimet në kooperativat bujqësore të planifikohen nga ana e komiteteve ekzekutive të rretheve, kurse kooperativat të mos lejojnë specialistët e tyre të punojnë në privatë në kohën kur ndërmarrjet shtetërore kanë nevojë.

7. — Po kështu çdo dikaster duhet të mendojë seriozisht se cilët janë ato kuadro, për të cilët ka më shumë nevojë sektori i tyre dhe si do t'i përgatisë ata, p.sh. se ç'duhet bërë për përgatitjen e kuzhinierëve e të merceologëve në tregëti ose të zooveterinerëve etj. në bujqësi, të teknikëve për përpunimin e qumështit në industri, të mjeshtërve të prodhimit, të teknologëve e të përgjegjësve të kyçeve, kryesondatorëve e të tjerë në naftë dhe të mos bëhen kurse për kurse, pa ditur pse i bëjnë e cilat janë rezultatet.

8. — Një ndër çështjet themelore që ka të bëjë me plotësimin e nevojave për teknikë të mesëm dhe të lartë është realizimi i planit të edukimit dhe ruajtja e kontingjentit të nxënësve në shkollat tona. Realizimi i numrit të nxënësve dhe ruajtja e kontingjentit të tyre duhet të bëhet një problem i madh partie dhe i organeve të pushtetit në qendër dhe në bazë.

Duhet caktuar më mirë kriteret për pranimin e njerëzve në kurse e shkolla, në mënyrë që mosha e tyre, aftësitë fizike dhe niveli kultural i tyre t'u përgjigjen më mirë jo vetëm detyrave në shkolla ose kurse, por sidomos praktikës së prodhimit e të mos ndodhë si deri tani që elementë shumë të vegjël janë përgatitur për miniera ose për ndërtim dhe pastaj në fakt s'kanë mundur të punojnë dhe janë larguar.

Të gjitha shifrat dhe përpjesëtimet që përmendëm më lart

do të mbeten të pazgjdhura në qoftë se nuk realizohet plani i edukimit në shkollat e rregullta, ose në shkollat 2-vjeçare të punëtorëve. Ky është problem kryesor. Prandaj duhet forcuar shumë më tepër puna në këtë drejtim, në mënyrë që të realizohen parashikimet. Njëkohësisht për të shmangur largimet nga puna dhe për të zgjidhur problemin e kuadrit për krahinat e ndryshme duhet që organet e Partisë dhe të pushtetit të punojnë që të sigurojnë elementët për shkolla e kurse, duke patur parasysh nevojat në të ardhshmen për çdo krahinë e fshat, dhe në radhë të parë për bujqësinë, arësimin, shëndetësinë dhe tregëtinë. Po kështu duke patur të qartë perspektivën e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës të pregatiten kuadro atje ku do të punojnë.

9. — Të merren të gjitha masat për të lidhur më mirë teorinë me praktikën, mësimin me jetën. Prandaj është e domosdoshme që të përfundojë rishikimi i planeve dhe i programeve të shkollave.

Disa programe kanë shumë të meta. Në institutin politeknik, p.sh. dega e mekanikëve bën gjatë një simestri teorinë e ndërtimit të maqinave, ndërsa ekonomia jonë ka më shumë nevojë për inxhinierë shfrytëzimi se sa për konstruktorë, prandaj edhe programet duhet ta kenë parasysh këtë. Për inxhinierë mekanikë ka nevojë të ndjeshme tërë ekonomia jonë, por ne i përgatisim këta me profil shumë të ngushtë, vetëm për motora, dhe këta dërgohen pastaj në transport, në SMT, në industri etj., ku hasin mjaft vështirësi. Pra duhen studjuar më me kujdes profilet, po kështu duhen studjuar programet e kurseve e të shkollave dhe vetë shtrirja e tyre. Një problem me rëndësi për mbarëvajtjen e kurseve dhe të shkollave është çështja e literaturës së nevojshme për to. Ne kemi mjaft dispenca të shtypura keq dhe ato jo në sasi të mjaftueshme. Duhet të merren masa sidomos për të shtypur libra për disa specialitete kryesore dhe ato të shërbejnë jo vetëm gjatë kohës së shkollës, por edhe si material, me të cilin mund të konsultohet kuadri kur del në praktikë...

Një problem tjetër me rëndësi është zgjedhja e mirë e elementeve që dërgohen për specializim jashtë shtetit si edhe caktimi i saktë i profileve për studentët që vazhdojnë institutet e larta jashtë shtetit si edhe ruajtja e këtyre profileve më pas. Në kurse specializimi jashtë shtetit duhen dërguar punëtorë ose kuadro që kanë një lloj stazhi në punën, për të cilën do të specializohen, e jo njerëz që kur venë jashtë s' dinë as nga të kapen. Studentëve që dërgohen nëpër institute jashtë shtetit t'u përcaktohen mirë profilet dhe në asnjë mënyrë të mos lejohen ndryshime të tyre pa arësye. Dikasteret nga ana e tyre duhet të ndjekin me kujdes gjatë gjithë kohës së studimeve punën e studentëve që do të jenë kuadro për ta në të ardhshmen dhe të mos ndodhë që të marrin vesh për ta vetëm kur t'u zënë derën. Ose ç'është më

keq të mos ndodhë si me Ministrinë e Komunikacionit, që ka shumë nevojë për inxhinierë shfrytëzimi etj., ndërsa për të janë pregatitur inxhinierë për ndërtim anijesh me hekur! (Te ne nuk ndërtohen fare të tilla anije).

Një ndihmë e madhe për kuadrot tanë ka qenë dhe mbetet ndihma e Bashkimit Sovjetik, eksperiencia sovjetike në tërësi si dhe ndihma e specialistëve sovjetikë dhe të vendeve të tjera miq në vendin tonë... Ne të mësojmë për ditë nga eksperiencia e tyre. Prandaj duhet të bëhet rregull që pranë çdo specialisti sovjetik ose të një vendi tjetër mik, që punon në vendin tonë, të vihen 2-3 specialistë tanë që të përfitojnë nga eksperiencia e tyre dhe brenda një kohe të jenë në gjendje të drejtojnë vetë punën.

10. — Përveç sa thamë më lart duhet të mbahen parasysh edhe këto detyra:

a) Duke marrë parasysh se disa shkolla profesionale, siç janë teknikumat bujqësore, shkollat pedagogjike dhe teknikumi tregëtar e ai ekonomik, nuk para frekuentohen nga të rinjtë, është e nevojshme që të mbahet parasysh shtimi i kontingjentit të bursave për këto shkolla.

b) Me qëllim që shkollat e mesme profesionale të frekuentohen më mirë nga të rinjtë, t'i jepet e drejta çdo të riu që mbaron këto shkolla të ndjekë studimet e larta pasi të ketë shërbyer në praktikë 3 vjet me rezultate të mira.

c) T'i kushtohet kujdes zgjerimit dhe sigurimit të kontingjentit të shkollave 7-vjeçare si dhe zgjerimit të shkollave të mesme të kulturës së përgjithshme me qëllim që, nga një anë, të sigurohen kontingjente më shumë për shkolla profesionale dhe, nga ana tjetër, kontingjenti i shkollave të larta të sigurohet në radhë të parë nga kontingjenti i gjimnazeve (shkollave të kulturës së përgjithshme).

11. — Krahas me marrjen e masave për sigurimin e plotësisht të nevojave me specialistë të mesëm dhe të lartë është gjithashtu e nevojshme të merren masa për ngritjen e nivelit të kuadrove drejtues ekzistues si drejtorë ndërmarrjesh etj. dhe përgatitjes së kuadrove të rinj drejtues teknikë dhe administrativë në format që do të gjenden më të përshtatshme.

12. — Gjithashtu, duke marrë parasysh nevojat në rritje të kuadrove që duhet të merren me punime dhe kërkime shkencore, duhet të merren masa që të fillohet qysh nga ky vit gradualisht të organizohet aspirantura në vend sipas vendimit të aprovuar qysh më parë për këtë qëllim nga qeveria dhe të dërgohen gjithashtu jashtë shtetit çdo vit për t'u pregatitur aspirantë për nevojat e degëve të ndryshme të ekonomisë dhe të kulturës.

13. — Në radhë të parë duhet përmirësuar kujdesi e drejtimi për përgatitjen e kuadrove nga organizatat dhe organet e Partisë

e veçanërisht nga organet shtetërore. T'i jepet fund punës burokratike e formale që bëhet nga dikasteret në këtë drejtim. Ka rëndësi të njohim mirë nevojat në perspektivë dhe kjo jo me shifra mesatare, por për çdo degë prodhimi, për çdo ndërmarrje e për çdo rreth. Veç dikastereve, komitetet e Partisë e komitetet ekzekutive të qarqeve e rretheve si edhe ndërmarrjet të kenë planet e tyre perspektive dhe të përgjigjen për realizimin e planeve, qoftë për sigurimin e kontingjenteve për kurset e shkollat që organizohen nga qendra qoftë për rezultatet në kurset e shkollat që kanë në juridiksionin e tyre, mbasi deri tani, nga praktika që kemi, rrethet, qarqet dhe vetë ndërmarrjet deri në një farë mase janë shkarkuar nga përgjegjësia për këtë punë, ndërsa dikasteret qendrore e ndjekin këtë punë me të meta.

Duhet marrë masa që të përmirësohet puna në tërë sistemin e përgatitjes së kuadrove.

• • •

Shokë,

Këto ishin anët më të rëndësishme të problemit të madh mbi kuadrin që menduam të trajtonim në këtë raport. Duke parë se në punën me kuadrin përveç sukseseve vërehen disa të meta të rëndësishme, e shohim të nevojshme të theksojmë se drejtoritë e Komitetit Qendror të PPSH nuk e kanë kryer ashtu si duhet detyrën, nuk kanë ngritur në shkallën e duhur kontrollin e gjithë Partisë mbi organet shtetërore për trajtimin, edukimin dhe përgatitjen e kuadrit.

Në të ardhmen është e nevojshme që ne të ndërrojmë rrënjësisht metodën e punës në këtë drejtim, të forcojmë kujdesin e organizatave dhe të organeve të Partisë si edhe të organeve shtetërore për punën e kuadrit. Vendit tonë i hapen perspektiva të mëdha përpara, prandaj edhe me kuadrin duhet bërë një punë me perspektivë dhe e kujdesshme për të siguruar suksese në të gjithë sektorët e vendit tonë.

Siç dihet, problemi i kuadrit është i madh dhe i vështirë. Nga studimet që po bëhen për planin perspektiv 14-15 vjeçar, perspektiva të shkëlqyera i hapen vendit tonë. Tani ne kemi mundësi të shpejtojmë ritmet e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës, të caktuara nga vendimet e kongresit III të Partisë sonë. Realizimi i këtyre detyrave kërkon kuadro. Siç u pa edhe nga i gjithë raporti, Partisë sonë, qeverisë, organizatave të ndryshme dhe gjithë kuadrove tanë u dalin detyra të mëdha.

Ne kemi bindje se edhe këto detyra do të realizohen si kurdoherë me sukses, se kuadrot tanë, gjithë klasa punëtore e vendit tonë do të venë të gjitha forcat e tyre për kualifikimin e tyre,

se rinia jonë do të mësojë më me entuziazëm në shkollat dhe në punë. Ndihma që na kanë dhënë e do të na japin Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të demokracisë popullore në këtë drejtim ka qenë e do të jetë e madhe dhe kuadrot tanë duhet të përfitojnë gjithnjë më shumë nga kjo ndihmë, nga eksperiencia sovjetike në tërësi dhe nga eksperiencia e specialistëve sovjetikë që punojnë te ne veçanërisht.

Partia jonë i ka të gjitha mundësitë që ta zgjidhë me sukses në të ardhmen këtë detyrë shumë të rëndësishme, problemin e kuadrit.

PLENUMI I KOMITET QENDROR TË PPSH

**Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë**

Nr. 103

NGA VENDIMI

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

«Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të tregëtisë
shtetërore e kooperativiste»

11 korrik 1957

Në konditat e ndërtimit të socializmit tregëtia shtetërore dhe kooperativiste kryen funksione të rëndësishme në jetën ekonomiko-shoqërore të vendit. Ajo shërben për të realizuar kërkesat e ligjit ekonomik të socializmit për ngritjen sistematike të mirëqenjes materiale e kulturele të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit.

Tregëtia, duke pasqyruar kërkesat e popullit për mallra të konsumit të gjerë dhe duke organizuar lidhjen e prodhimit dhe të konsumit, përbën një nga konditat e domosdoshme për zhvillimin e degëve të ndryshme të ekonomisë popullore dhe për përmirësimin e cilësisë së prodhimit. I madh është roli i tregëtisë në forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë, pasi ajo përbën një nga format kryesore të lidhjeve ekonomike në mes qytetit dhe fshatit.

Nën drejtimin e Partisë... tregëtia socialiste ka arritur rezultate të mira në rritjen e qarkullimit të mallrave dhe në përmirësimin e ndijshëm të furnizimit të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Në vitin 1956 qarkullimi i mallrave i realizuar nga tregëtia socialiste, në krahasim me vitin 1950, është rritur 120,9 për qind sipas çmimeve ekzistuese. Në krahasim me vitin 1950, më 1956 i janë shitur popullatës më tepër tekstile të pambukta 74,8 për qind, tekstile të leshta 58,6 për qind, këpucë-opinga 106,8 për qind, sheqer 57,4 për qind, yndyrna 111,7 për qind, djathë-gjizë 135,3 për qind, mish-peshk 55,7 për qind, fasule-oriz 112,7 për qind. Plani i xhiros i tregëtisë socialiste për gjashtëmu-jorin e parë të këtij viti u realizua 100,7 për qind dhe në krahasim me periudhën e vitit të kaluar është rritur 19,6 për qind.

Heqja e triskëtitimit për artikujt e veshmbathjes dhe ndryshimi i formës së tregëtisë reciproke, që ishin një sukses i madh i ekonomisë sonë, i dhanë mundësi të gjera rritjes së prodhimit, përmirësimit të cilësisë, shtimit të asortimenteve, zgjerimit të qarkullimit të mallrave fshat-qytet dhe, në përgjithësi, zhvillimit të tregëtisë socialiste. Masat e marrura nga Partia dhe qeveria më 1956 për uljen dy herë të çmimeve të shitjes me pakicë, në masën 2.250 milion lekë, si dhe për ngritjen e pagave dhe të pensioneve të ulëta kanë rritur fuqinë blerëse të popullit. Këto masa të rëndësishme krijuan kushte më të mira për përmirësimin e gjendjes materiale e kulturele të punonjësve dhe kanë shërbyer për gjallërimin e tregëtisë dhe për përmirësimin e furnizimit të popullit.

Në vitin 1956 rrjeti i tregëtisë dhe i ushqimit social u rrit 58,5 për qind në krahasim me vitin 1950. Është forcuar baza materiale në rrjetin e tregëtisë dhe janë arritur suksese në specializimin dhe shpërndarjen e lokaleve të tregëtimit. Si rezultat i këtyre sukseseve masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit janë shërbyer më mirë dhe kanë plotësuar më shpejt nevojat e tyre.

Por, duke marrë parasysh se kërkesat e popullit janë rritur dhe po rriten vazhdimisht, vihet re se në sektorin e tregëtisë ekzistojnë mungesa e dobësi, të cilat pengojnë furnizimin më të mirë të popullit.

Në punën e organeve të tregëtisë në qytet, qendra pune dhe në fshat ka dobësi në qarkullimin, mirëmbajtjen dhe tregëtimin e mallrave pa ndërprerje, në shërbimin ndaj blerësve dhe në ngritjen e nivelit të kulturës dhe të teknikës së tregëtisë, sidomos në tregëtinë e fshatit. Të theksuara janë të metat në përgatitjen e tregëtisë stinore, dhe në mënyrë të veçantë të tregëtisë verore. Planet e xhiros në mjaft raste nuk janë realizuar në mënyrë ritmike nga njëri dhjetëditor në tjetrin, nga njëri muaj në tjetrin, si strukturë dhe për çdo rreth.

Tregëtia e prodhimeve ushqimore është zhvilluar në një masë të kufizuar në krahasim me mundësitë që kanë ekzistuar. E pakë-

naqshme është tregëtia e prodhimeve bujqësore e blegtorale të nevojës së përditshme të popullit, siç janë zarzavatet, frutat, bulmetrat, mishi, vezët dhe buka. Ritmi i shtimit të fondeve të tregut me këto prodhime ka qenë i ngadalshëm, tregëtimi i tyre bëhet me ndërprerje dhe në një mënyrë të prapambetur. Rrjeti është i kufizuar dhe nuk është mbajtur mirë. Pak kujdes tregohet për mbajtjen e pastërtisë.

Organet e tregëtisë i kanë kushtuar vëmendje të paktë zhvillimit të tregëtimit të një sere artikujsh industrialë, si në qytet edhe në fshat. Kjo ka qenë një ndër arësyet kryesore që këta artikuj nuk janë tregëtuar vazhdimisht në asortimente të ndryshme, modele dhe ngjyra sipas kërkesës së popullit. Tregëtimi i veglave bujqësore, i punimeve të drurit, të poçerisë, i artikujve shkollorë, i materialeve hidrotermosanitare, elektrike dhe të ndërtimit, i lodrave për fëmijë, i parfumerisë, i bizhuterisë, i artikujve kulturalë etj. ecën me ritëm të ngadalshëm.

Në ushqimin social nuk janë përhapur sa duhet gjellët me perime pa mish që kushtojnë më lirë, gjellët me brumëra karakteristike të kuzhinës sonë. Ka raste që cilësia e gjellëve të mos jetë e kënaqshme. Shërbimi ndaj konsumatorëve kryhet me të meta dhe në lokalet e këtij sektori higjena nuk është në lartësinë e duhur. Pak kujdes është treguar për shtimin e mëngjezoreve, të bulmetoreve dhe të rostiçerive, për të cilat ka nevojë popullsia. Ushqimi social në fshat është i kufizuar. Rrjeti ambulant është i paktë dhe nuk plotëson nevojat e punonjësve të qytetit dhe të fshatit.

Është bërë një punë e pamjaftueshme për realizimin e planit të grumbullimit të tepricave të prodhimeve bujqësore-blegtorale dhe, si rrjedhim, janë krijuar defiqite në fondet e drithit të bukës, të bulmetrave etj.

Është nënvleftësuar lidhja e kontratave me detyrime reciproke dhe këto janë ndjekur me të meta. Marrëdhënjet ndërmjet kooperativave të konsumit dhe atyre bujqësore nuk janë zhvilluar sa duhet dhe ka ngurrime në shitjen e tepricave. Grumbullimet në zonat në thellësi janë zgjeruar në një masë të kufizuar. Nuk është bërë ndonjë punë serioze për konservimin e prodhimeve të grumbulluara, si mollë, agrume, patate, vezë etj. për t'ja shitur këto popullsisë në kohën kur nuk është sezoni i tyre. Bazat tekniko-materiale, si depot, qendrat e grumbullimit, frigoriferët, ambalazhet dhe të tjera, nuk mirëmbahen dhe janë të pamjaftueshme. Për shtimin dhe aktivizimin e grumbulluesve jashtë organikës nuk është treguar kujdesi i duhur. Ofertat e grumbullimit shpesh kanë qenë të pastudjuara, në caktimin e tyre nuk janë patur parasysh sa duhet kostua e prodhimit, kërkesat e konsumit etj., dhe kjo ka bërë që ato të mos luajnë rolin e duhur për shtimin e prodhimit. Lëvizja e mallrave, sidomos në drejtim të qyteteve kon-

sumatore, vazhdon të jetë e organizuar dobët dhe ka prirje për të bërë qarkullimin e mallrave vetëm me mjete të mekanizuara, duke nënvleftësuar transportin primitiv.

Përpunimi i prodhimeve bujqësore-blegtorale nga kooperativat e konsumit është i kufizuar, asortimenti dhe cilësia e tyre nuk është e kënaqshme. Përpunimi i prodhimeve në zonat në thellësi dhe sidomos në zonat e Veriut nuk është zhvilluar sa duhet. Veçanërisht e dobët është paraqitja e prodhimeve të përpunuara dhe kujdes i paktë tregohet për mirëmbajtjen e tyre.

Kooperativat e konsumit, si organizata ekonomike të masave punonjëse, nuk kanë aktivizuar sa duhet anëtarët në organizimin më të mirë të tregëtisë, në grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Ministria e Tregëtisë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe Drejtoria qendrore e ndërmarrjeve shtetërore të furnizimit të punëtorëve nuk kanë marrë masa për organizimin e një tregëtie të kulturuar, që t'u përgjigjet si duhet kërkesave në rritje të konsumatorëve. Ato nuk kanë organizuar mirë bashkëpunimin me organet furnitore për të zgjidhur dhe për të lehtësuar problemet e furnizimit të ndërmarrjeve të tyre, kanë lejuar gabime në planifikimin e treguesve të tregëtisë dhe kanë punuar në mënyrë jo sistematike për organizimin e zbatimit të vendimeve përkatëse dhe për forcimin organizativ dhe ekonomik të ndërmarrjeve që drejtojnë. Puna e këtyre organeve, në lidhje me ndihmën konkrete për bazën, ka qenë e pamjaftueshme dhe nuk është karakterizuar nga operativiteti në zgjidhjen e problemeve. Përgjegjësit e ndërmarrjeve dhe të organizatave tregëtare nuk janë thelluar për të njohur problemet e sektorëve që drejtojnë, nuk kanë organizuar në mënyrë të kënaqshme punën për porositë dhe pranimin e mallrave, nuk kanë përdorur si duhet levat ekonomike që ndihmojnë në përmirësimin e furnizimit, si kontratat, sanksionet dhe nuk kanë marrë masa të gjithanshme për zhvillimin e tregëtisë sipas sezoneve. Si rrjedhim, organet e tregëtisë nuk kanë influencuar si duhet për shtimin e prodhimit të artikujve dhe të asortimenteve të reja, si dhe për të përmirësuar cilësinë e tyre.

Organet prodhuese të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, të Bujqësisë dhe të Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit nuk u janë përgjegjur në rregull detyrimeve kundrejt tregëtisë. Disa ndërmarrje të industrisë dhe të kooperativave të artizanatit e kanë bërë zakon të shkelin disiplinën e planit, të krijojnë defiqite në furnizim dhe të bëjnë shpërndarje mekanike të mallrave, pa marrë parasysh gustot e konsumatorëve dhe kërkesat e tregëtisë sipas sezonit, asortimenteve, ngjyrave, modeleve dhe dimensioneve të ndryshme. Një prodhim dhe shpërndarje e tillë pa përgjegjësi nga ana e tyre ka penguar qarkullimin normal të një

sëre artikujsh, duke krijuar herë pas here në rrjetin e tregëtisë mallra mbi normativë. Interesim i paktë është treguar për të prodhuar artikuj që importohen, sidomos vogëlsira, dhe nuk inkurajohen si duhet iniciativat në këtë drejtim. Fakti që në rrjetin e tregëtisë gjenden mallra të një cilësie të dobët vërteton se zyrat e kontrollit të cilësisë nuk funksionojnë mirë dhe bëjnë një punë formale.

Populli nuk furnizohet gjithnjë me mish të një cilësie të mirë dhe pa ndërprerje. Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit nuk kanë marrë masa organizative për t'i dhënë fund kësaj situatë që vazhdon prej vjetësh.

Furnizimi me qumësht dhe zarzavate nga organet e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit, me gjithë porositë e Partisë dhe të qeverisë, vazhdon të mos i kënaqë nevojat e popullit dhe në disa periudha të vitit gjendja vështirësohet.

Komitetet ekzekutive nuk kanë drejtuar mirë sektorin e tregëtisë dhe sidomos tregëtinë e fshatit e të qendrave të punës. Ato nuk e kanë bërë problem kryesor në punën e tyre realizimin e planit të furnizimit nga organet furnitore, nuk kanë treguar kujdes të mjaftueshëm për shfrytëzimin e burimeve lokale dhe për të shtuar fondet e mallrave për tregun. Kontrolli dhe ndihma e tyre për organet e tregëtisë shpeshherë kanë qenë të kufizuara, me hope dhe jo në mënyrë të organizuar. Pak janë aktivizuar anëtarët e këshillave popullore për përmirësimin e punës në sektorin e tregëtisë.

Komitetet e Partisë nuk janë thelluar sa duhet në problemet e rëndësishme të tregëtisë dhe të grumbullimit, për të dalë me konkluzione të plota dhe detyra konkrete si për organizatat bazë të partisë në tregëti, ashtu edhe për organet e pushtetit lokal. Ato, në mjaft raste, i shqyrtojnë problemet me vonesë dhe në frymë shtetërore, gjë që ndihmon pak në përmirësimin e të metave në tregëtinë e fshatit dhe të qytetit. Organizatat bazë të Partisë në ndërmarrjet e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste nuk merren sa duhet me probleme konkrete të tregëtisë dhe të grumbullimit në fshat dhe në qytet. Ato kanë ushtruar kontroll të paktë dhe nuk kanë kërkuar si duhet llogari nga komunistët për kryerjen e detyrave të tyre, nuk kanë punuar që kjo frymë të përhapet edhe në punonjësit pa parti dhe nuk kanë aktivizuar sa duhet organizatat e masave për problemet që preokupojnë tregëtinë, dhe, si rrjedhim, në organizimin e emulacionit, në edukimin e punonjësve dhe në kontrollin shoqëror është bërë më tepër një punë formale. Puna e Partisë për të rritur ndërgjegjen e punonjësve të tregëtisë dhe për të mprehur vigjilencën për ruajtjen e vlerave materiale dhe monetare ka qenë e pamjaftueshme.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, duke patur parasysh të metat që ekzistojnë në punën e tregëtisë, me qëllim që të përmirësohet shërbimi dhe furnizimi i masave punonjëse dhe të sigurohet zbatimi i direktivave të Kongresit III të PPSH,

Vendosi:

I. — DETYRAT KRYESORE PËR PËRMIRËSIMIN E ORGANIZIMIT TË TREGËTISË SOCIALISTE DHE PËR FURNIZIMIN E POPULLIT

1. — Ministria e Tregëtisë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit, Drejtorja qendrore NSHFP-ve dhe ndërmarrjet tregëtare shtetërore e organizatat kooperativiste të marrin masa për përmirësimin e organizimit të tregëtisë dhe furnizimin e popullit, për realizimin ritmik të planit të xhiros sipas rretheve, në kohë dhe strukturë.

2. — Të forcohet puna në drejtim të shpejtimin të qarkullimit të mallrave, t'i jepet fund shpërndarjes mekanike të prodhimeve dhe të rritet kujdesi, ndërgjegjja e kontrolli i punonjësve të tregëtisë për mirëmbajtjen e tyre.

3. — Të rritet influenca e tregëtisë mbi prodhimin dhe konsumin për një furnizim pa ndërprerje të popullit me të gjitha asortimentet, të merren me kohë masat përgatitore për tregëtinë stinore, dhe në mënyrë të veçantë për tregëtinë verore, si dhe për furnizimin e zonave që izoloohen nga dimri.

4. — Të merren të gjitha masat e nevojshme për ta përgatitur tregëtinë socialiste për heqjen e triskave të artikujve ushqimorë. Për këtë organet qendrore të tregëtisë dhe ato të bazës të sigurojnë përmirësimin e shërbimit të blerësve, të ngrënë në një shkallë më të lartë teknikën dhe kulturën tregëtare, si në qytet ashtu edhe në fshat, të pajisin më mirë rrjetin, të organizojnë më mirë ekspozimin dhe mirëmbajtjen e mallrave dhe t'i kushtojnë vëmendje të posaçme përgatitjes dhe kualifikimit të punonjësve.

A. — Për përmirësimin e furnizimit të popullit me artikuj ushqimorë

1. — Të përmirësohet rrënjësisht tregëtia e artikujve ushqimorë, dhe sidomos e produkteve bujqësore e blegtorale, të rriten fondet e mallrave të tregut me këto produkte, në mënyrë që të sigurohet furnizimi pa ndërprerje i popullatës, si dhe heqja para afatit e sistemit të triskëtimit për artikujt ushqimorë.

2. — Ministria e Tregëtisë, Drejtorja qendrore e NSHFP-ve, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe organet e

pushtetit lokal të organizojnë gjerësisht tregëtimin e frutave, të perimeve dhe të patateve. Të sigurohet furnizimi i rregullt nga depot në dyqane dhe brenda muajit shtator 1957 të përcaktohen rregullat për mirëmbajtjen e këtyre prodhimeve në gjendje të freskët, për klasifikimin, ambalazhimin, transportimin dhe shitja e tyre të bëhet me çmime të diferencuara.

3. — Të sigurohet konservimi në natyrë i patateve, i qepëve, i hudhrave, i lakrave, i mollëve, i agrumeve, i gështenjave dhe i vezëve, në mënyrë që të zgjatet koha e ruajtjes së tyre dhe të përmirësohet furnizimi pa ndërprerje i popullit me këta artikuj. Ministria e Tregëtisë dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit të shfrytëzojnë me kapacitetin e tyre maksimal depot ekzistuese dhe vendet e tjera të përshtatshme. Për këtë qëllim të shikohet adaptimi dhe zgjerimi i tyre duke parashikuar në planet vjetore ndërtime deposh të reja të specializuara, që janë të domosdoshme për depozitimin dhe konservimin e prodhimeve në fjalë. Në qendrat kryesore konsumatore kapaciteti i depove në vitin 1960 të jetë baraz me rezervat dymujore. Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1958 të gjitha ndërmarrjet të kenë plotësuar nevojat e tyre me ambalazh, si për zarzavatet, frutat dhe vezët.

4. — Të merren masa për tregëtimin pa ndërprerje të qumështit, sidomos për fëmijët dhe të sëmurët, të sigurohen kondita higjienike për shitjen e tij dhe të bulmetrave, si dhe të shtohen pikat për tregëtimin e këtyre artikujve për të plotësuar sa më mirë nevojat e konsumatorëve me këto prodhime të rëndësishme.

Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit t'i kushtojë një vëmendje të posaçme zgjerimit të asortimentit dhe përmirësimit të cilësisë së bulmetrave.

5. — Krahas me rritjen e fondeve për treg të frutave, të perimeve dhe të patateve, të zgjerohet dhe rrjeti stabël dhe ambulant i tregëtisë, duke e vendosur atë sa më afër konsumatorëve. Në lagjet e qyteteve kryesore të punohet për krijimin e blok-dyqaneve. Në mënyrë të veçantë gjatë kohës së prodhimit të këtyre artikujve të zhvillohet tregëtia stinore me anë të barakave të përkohshme.

6. — Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të marrin seriozisht çështjen e sigurimit dhe të seleksionimit të farërave, si dhe të prodhimit të perimeve, në mënyrë që të arrihet një furnizim i bollshëm me këto prodhime në çdo stinë.

Ministria e Bujqësisë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe komitetet ekzekutive, në bazë të kërkesave të organeve të tregëtisë, të marrin masa për të shtuar prodhimin dhe grumbullimin duke caktuar detyra suplementare mbi sasi të e parashikuara në planin e dytë pesëvjeçar për frutat, perimet, patatet, qumështin dhe vezët, në mënyrë që popullsia të furnizohet pa ndërprerje dhe në sasi të mjaftueshme.

Ministria e Bujqësisë, për të siguruar furnizimin ritmik dhe pa ndërprerje të popullit me zarzavate dhe patate, të caktojë afatet kalendarike për fillimin dhe mbarimin e mbjelljeve, sipas asortimenteve dhe për çdo zonë. Mbi këto afate të mbështetet edhe kontraktimi i ndërmarrjeve tregëtare me prodhuesit e zarzavateve dhe të patateve. T'i kushtohet një kujdes i veçantë prodhimit të farërave në vend dhe shtimit të varieteteve me rendimente të larta dhe të hershme. Brenda vitit 1957 të studjohet shfrytëzimi i ujërave të nxehta të Llixhës së Elbasanit dhe të zgjerohet rrjeti i serave pranë NBSH-ve.

Gjer në muajin shtator 1957 të përcaktohen sipërfaqet e tokave të përshtatshme për mbjelljen e zarzavateve që janë jo më larg se 10 km. nga qytetet dhe të punohet që brenda vitit 1958 pranë qyteteve të mëdha të organizohen kooperativa bujqësore me destinacion zarzavate dhe qumësht, duke u siguruar atyre plotësisht nevojat për bukë. Ministria e Bujqësisë, gjer në dhjetor 1957, t'i paraqesë Këshillit të Ministrave studimin për zgjerimin e fermave të lopëve të racës për prodhimin e qumështit dhe t'u rekomandohet kooperativave bujqësore që janë afër qyteteve dhe qendrave të punës që të kenë 25 deri 30 lopë për çdo 100 hektarë tokë bujqësore.

7. — Ministria e Tregëtisë, Drejtoria qendrore e NSHF-ve, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe komitetet ekzekutive të marrin masa të shpejta për të gjallëruar tregëtinë e mishit dhe të peshkut, të krijojnë kondita që këta artikuj të tregëtohen pa ndërprerje, me një asortiment të gjerë dhe në mënyrë të kulturuar...

8. — Të konsiderohet si një detyrë e rëndësishme shtimi dhe përmirësimi i cilësisë së konservave të perimeve, të frutave dhe të peshkut. Të prodhohen gjerësisht në vitin 1958 komposto konservash prej frutash, molle, kumbulle, qershie, vishnje, dardhe, pjeshke etj. Të konservohen më tepër frutat që nuk mund të ruhen dhe konsumohen të freskëta. Të prodhohen ullinj të konservuar në forma dhe mënyra të ndryshme dhe 20 për qind e fondeve t'i jepet tregëtisë të ambalazuara në kavanoza.

9. — T'i kushtohet një vëmendje më e madhe tregëtimit të bukës e miellrave dhe të përmirësohet furnizimi i punonjësve me këto produkte kryesore të nevojës së përditshme...

10. — Për përmirësimin e tregëtisë së produkteve të tjera ushqimore dhe shtimin e fondeve të tyre për tregun të merren këto masa:

a) Ministria e Tregëtisë, Drejtoria qendrore e NSHF-ve, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe komitetet ekzekutive të shfrytëzojnë në maksimum rrjetin ekzistues dhe të ma-

rrin menjëherë masat organizative për përgatitjen e dyqaneve të tregut të garantuar për tregëtinë e lirë. Brenda vitit 1957 të përpilojnë normat teknike të organizimit të brendshëm të dyqaneve. Në qytetet e mëdha të punohet për specializimin e mëtejshëm të dyqaneve ushqimore, të shtohet numri i dyqaneve të mëdha gjer në vitin 1960 në 15 me 90 vende pune. Të marrë një zhvillim më të madh gjatë vitit 1958 shitja me copë dhe në pako e produkteve ushqimore.

b) Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe organet e pushtetit lokal të marrin masa të duhura përgatitore lidhur me heqjen e triskave, të ngrenë në një nivel më të lartë punën e tyre për prodhimin e produkteve ushqimore...

B. — Të zhvillohet gjerësisht tregëtia e artikujve industrialë dhe të përmirësohet furnizimi i popullit

1. — Ministria e Tregëtisë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit, Drejtoria qendrore e NSHF-ve, komitetet ekzekutive dhe ndërmarrjet tregëtare të organizojnë më mirë tregëtinë e artikujve industrialë që populli të furnizohet me mallra sipas gustos. Heqja e triskave për artikujt ushqimorë shtron detyrën e forcimit të mëtejshëm të tregëtisë së artikujve industrialë. Të përmirësohet puna e kontraktiveve dhe e porosive, të organizohet më mirë prodhimi dhe tregëtimi i artikujve stinorë, për të cilët prodhuesve t'u jepen kërkesa me kohë, në mënyrë që rrjeti i tregëtisë të jetë i furnizuar me të gjithë artikujt përpara fillimit të çdo sezoni. Të konsiderohet detyrë kryesore plotësimi i dyqaneve me mallra nga të gjitha asortimentet dhe për çdo moshë. Të pasurohet rrjeti i tregëtisë me të gjitha llojet, ngjyrat dhe modelet që kërkohen nga populli.

Një rëndësi e veçantë t'i jepet sigurimit të artikujve të ndryshëm për fëmijë, si këpucë, opinga, çorape, konfeksione, trikotazhe etj.

2. — Të vazhdojë specializimi i mëtejshëm i rrjetit. Të zgjerohet rrjeti i dyqaneve për shitjen e mobiljeve, të rrobave të gatshme, të metrazheve, të këpucëve dhe të artikujve kulturalë. Në dyqanet e mëdha të organizohen reparte të specializuara për shitjen e galanterisë, të parfumerisë, të kozmetikës, të artikujve shkollorë, të kancelarisë, të trikotazhit etj.

3. — T'i jepet fund qëndrimin të palejueshëm dhe nënvlef-tësues ndaj tregëtisë së materialeve të ndërtimit, artikujve të fshatit, mobiljeve e orendive, artikujve shkollorë, kancelarisë dhe lodrave për fëmijë. Në mënyrë të veçantë të tregohet kujdes në tregëtimin e këtyre artikujve në fshat.

4. — Kooperativat e konsumit të përqëndrojnë punën e tyre më tepër në fshat. Për këtë Ministria e Tregëtisë, në bashkëpunim me Bashkimin Qendror të Kooperativave të Konsumit, të marrë në studim rrjetin e tregëtisë kooperativiste në qytet, ku ka edhe ndërmarrje tregëtare shtetërore, dhe, duke filluar nga 1 janari 1958, të bëhen ndryshimet e duhura për largimin e kooperativave të konsumit nga këto qytete.

5. — Të përmirësohet rrënjësisht tregëtimi i konfeksioneve dhe i këpucëve dhe tregëtia të ketë iniciativën për zgjerimin e modeleve, shtimin e asortimenteve etj.

6. — Një rëndësi e madhe t'i jepet organizimit të reklamimit dhe propagandimit të mallrave industriale. Të informohen blerësit për mallrat që gjenden në dyqan. Ekspozimi dhe mirëmbajtja e mallrave të konsiderohet si detyrë e rëndësishme për punonjësit e tregëtisë. Për këto probleme të organizohen konsulta, konferenca dhe konkurse... për të përgjithësuar eksperiencën e punëtorëve më të mirë të tregëtisë sonë.

7. — Ministria e Arësimit, Ministria e Tregëtisë dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit të marrin masa për tregëtimin e mirë të librit, sidomos në fshat.

8. — Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Artizanatit dhe organet e pushtetit lokal të zgjerojnë asortimentin e artikujve industrialë dhe të përmirësojnë cilësinë e tyre.

9. — Të merren masa për të zgjeruar në një masë të konsiderueshme prodhimin e asortimenteve të galanterisë prej lëkure, të pajisjeve të guzhinës, të artikujve shkollorë, të mobiljeve dhe të bizhuterisë. Për këtë brenda vitit 1957 të bëhen studime dhe t'u jepen detyra ndërmarrjeve dhe kooperativave të artizanatit për asortimentet që duhet të prodhojnë.

10. — Për përmirësimin e tregëtimit të konfeksioneve për popullatën, të shtohet prodhimi i tyre në jo më pak se 25 për qind mbi detyrat e planit pesëvjeçar për çdo vit. Të shtohen asortimentet dhe modelet për veshje të të gjitha moshave dhe sipas stinëve. Duke filluar nga ky vit, kooperativat e artizanatit të fillojnë gjerësisht nga prodhimi i kapeleve verore dhe dimërore për burra, gra dhe fëmijë, duke shfrytëzuar për këtë qëllim edhe mbeturinat e ndryshme, kuponet etj.

11. — Të shtohet asortimenti i prodhimit të këpucëve dhe sandaleve me forma dhe ngjyra të ndryshme, sidomos për gra dhe fëmijë. Në vitin 1958 të prodhohen në shkallë të gjerë këpucë me suprina tekstili.

12. — Duke filluar nga janari 1958 të zgjerohet tregëtia e konfeksioneve të leshta dhe të këpucëve me porosi në Tiranë, Shkodër, Korçë e Durrës dhe gradualisht të përhapet në qytetet e tjera.

13. — Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe Bashkimi

Qendror i Kooperativave të Artizanatit të marrin masa për të përmirësuar punën e Fabrikës së trikotazhit në Korçë dhe të kooperativave që merren me prodhimin e trikotazheve, të mekanizojnë më mirë proceset e prodhimit të artikujve të trikotazhit, duke siguruar një asortiment të gjerë dhe me cilësi të lartë.

14. — Të zgjerohet prodhimi i lodrave prej lastiku, druri etj. për fëmijë të moshave të ndryshme. Të organizohet një punishte e specializuar për lodra fëmijësh në Tiranë gjer në vitin 1958 dhe për këtë qëllim të përdoren maqineritë ekzistuese. T'i kushtohet vemendja e duhur prodhimit të lodrave me karakter dëfryes dhe edukues si për fëmijë të moshës parashkollore, ashtu edhe për ata të moshave shkollorë.

Brenda gjashtëmuorit të parë të vitit 1958 në dyqanet e artikujve për fëmijë të qyteteve të mëdha të organizohen reparte të specializuara për shitjen e lodrave për fëmijë dhe në Tiranë, Shkodër e Durrës të çelen dyqane të posaçme.

15. — Të përmirësohet rrënjësisht prodhimi i asortimenteve dhe cilësia e artikujve prej qelqi. Duke filluar nga viti 1958 asortimenti i prodhimeve të qelqit të zgjerohet me artikuj të rinj...

16. — Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe ai i Artizanatit të përmirësojnë tregëtimin dhe prodhimin e veglave bujqësore dhe të artikujve të tjerë të hekurit. Të zgjerohet asortimenti, të përmirësohet shumë cilësia dhe në qendrat e rretheve kryesore bujqësore të çelen dyqane të veçanta për shitjen e tyre.

Të organizohet më mirë tregëtimi i materialeve të ndërtimit, shitja e të cilave të përqëndrohet në qendrat kryesore të lokaliteteve dhe të fshatrave, si dhe afër bazave të prodhimit të tyre.

C. — Të zhvillohet më tej ushqimi social dhe të përmirësohet shërbimi ndaj konsumatorëve

1. — Ministria e Tregëtisë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit, Drejtoria qendrore e NSHFP-ve dhe organet e pushtetit lokal të marrin masa serioze për forcimin e sektorit të ushqimit social, që ky të kryejë plotësisht dhe në mënyrë të kulturuar shërbimin ndaj popullit.

2. — Të zgjerohet rrjeti i ushqimit social aty ku është e nevojshme për të plotësuar kërkesat e popullatës, dhe sidomos rrjeti i rostitçerive, bulmetoreve dhe mëngjezoreve. Të punohet për zgjerimin e rrjetit të ushqimit social në lagje, sidomos të bufeve me asortimente të gjera, duke përfshirë edhe ato të guzhinës, të cilat të shërbejnë si baza fillestare të ushqimit social në lagje. Për këtë të bëhen studime të posaçme gjer në nëntor të vitit 1957.

3. — Për t'u shërbyer më mirë punonjësve, kooperativave bujqësore, nxënësve dhe studentëve, brenda vitit 1958 të jenë ma-

rrë në dorëzim tërësisht nga organet e tregëtisë të gjitha mensat dhe bufetë që paraqesin leverdi ekonomike.

4. — Të zgjerohet asortimenti i gjellëve, duke prodhuar të gjitha gjellët nacionale, brumërat, ëmbëlsirat e kuzhinës, gjellët me peshk dhe pa mish, si dhe produktet e qumështit. Të rriten asortimentet e menyve të ngrohta në lokalet e restoranteve dhe të rostitçerive...

6. — Për të siguruar zgjerimin e asortimenteve dhe ngritjen e cilësisë së gjellëve dhe të ëmbëlsirave, duke filluar që nga viti 1958 të organizohen ekspozita të prodhimeve të kuzhinës në bazë rrethi-qarku, duke shpallur konkurse për kuzhinierët më të mirë...

7. — T'i jepet fund formalizmit në funksionimin e këshillave të kuzhinierëve dhe të forcohet kontrolli shoqëror i bashkimeve profesionale në mensat. Detyra kryesore e këshillit të kuzhinierëve është zgjerimi i asortimenteve dhe ngritja e cilësisë së gatimit, duke përgjithësuar eksperiencën e përparuar të punonjësve të ushqimit social. Kontrolli shoqëror në ushqimin social të jetë më i dendur dhe të synojë në zbatimin e normativave, respektimin e rregullave higjieniko-sanitare dhe në sigurimin e shërbimit normal të punonjësve. Bashkimet profesionale të merren më seriozisht me kontrollet shoqërore dhe përgjithësimin e eksperiencës së tyre. Për këtë punë, duke filluar qysh nga ky vit, të organizojmë seminare të ndryshme dhe konferenca për përgjithësimin e eksperiencës.

8. — Të organizohet më mirë ushqimi social në stinën e verës. Të merren masa për përmirësimin e tregëtisë në plazhin e Durresit, të Vlorës dhe të Sarandës, të zgjerohet rrjeti ambulant në një masë të konsiderueshme dhe në vitin 1958 të rritet jo më pak se 50 për qind në krahasim me vitin 1957, për t'u bërë ballë nevojave, dhe sidomos në vendet e grumbullimeve publike.

9. — Të përmirësohen rrënjësisht pastërtia dhe konditat higjieniko-sanitare në lokalet e ushqimit social, dhe sidomos në mensat e qendrave të punës dhe të instituteve arësimore. Për këtë të aktivizohen kryesisht vetë punonjësit e mensave, të restoranteve, të rostitçerive dhe të lokaleve të tjera të ushqimit social dhe të konsiderohet si një nga detyrat e tyre më të rëndësishme.

Inspektoriatit sanitar dhe organet e shëndetësisë të ushtrojnë një influencë më të madhe dhe të përmirësojnë të metat serioze që kanë në punën e tyre për të siguruar pastërtinë e nevojshme në rrjetin e tregëtisë dhe të ushqimit social.

10. — T'i jepet fund qëndrimit të pakujdesshëm për futjen e vetëshërbimit në ushqimin social, sidomos në mensat e qendrave të punës dhe të institucioneve arësimore. Brenda muajit shtator 1957 Ministria e Tregëtisë të përcaktojë rregullat, llogaritë teknike dhe një plan masash për kalimin e lokaleve në vetëshërbim, të gjen-

den forma të tjera që lehtësojnë shërbimin e punonjësve, si shitja me abonime, me porosi etj.

11. — Të vlerësohet më mirë organizimi i shërbimit të hoteleve, duke ju kushtuar një vemendje më e madhe nga ana e ndërmarrjeve tregëtare pajisjes së tyre. Brenda vitit 1957 të bëhet kategorizimi më i drejtë i hoteleve. Gjer në gjashtëmuorin e parë të vitit 1958 t'u sigurohen hoteleve pajisjet e nevojshme, të bëhet meremetimi i tyre dhe të punohet për krijimin e komoditeteve të tilla, si ngrohja gjatë dimrit etj. Të inkurajohet më mirë puna e punonjësve të hoteleve.

12. — Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe organet e pushtetit lokal të marrin masa që brenda gjashtëmuorit të parë të vitit 1958:

a) Të sigurohet furnizimi me akull, aranciata, shabeso, ujë sifon, lëng frutash dhe pije të tjera freskuese, duke shfrytëzuar mundësitë që ekzistojnë për të prodhuar në vend gazin karbonik.

b) Fabrikat e konservave të prodhojnë lëng frutash të ndryshme, prej limonësh, portokallësh, qershish, vishnjesh, kajshish, dardhash etj., që të përdoren si lëndë e parë për pijet freskuese, për karamele dhe ëmbëlsira të ndryshme.

13. — Të forcohet organizimi i prodhimit të ëmbëlsirave. Brenda vitit 1957 të studjohet ngritja në Tiranë e një fabrike, duke përdorur në radhë të parë maqineritë që ndodhen në ndërmarrjet e ndryshme. Një rëndësi e veçantë t'i jepet zgjerimit të asortimentit të karameleve... Të përmirësohet prodhimi i bis-kotave dhe të shtohen llojet e cilësisë së lartë të tyre.

14. — Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit të marrë masa për forcimin dhe zhvillimin e sektorit të ushqimit social në fshat, dhe sidomos në kooperativat bujqësore...

II.— TË FORCOHET INFLUENCA E ORGANEVE TË TREGËTISË MBI ORGANET PRODHUESE DHE GRUMBULLUESE QË TË ZBATOJNË MIRË DETYRAT QË KANË KUNDREJT FURNIZIMIT TË POPULLIT

Për këtë të merren këto masa:

1. — Ministria e Tregëtisë, Drejtoria qendrore e NSHFP-ve, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe organet e tyre vartëse:

a) Të organizojnë më mirë studimin e kërkesave të konsumatorëve në dyqan, në ndërmarrje, në rreth, në qark dhe në të gjithë vendin dhe t'i çojnë ato më mirë te prodhuesi e grumbulluesi. Për këtë, në bashkëpunim me organet prodhuese në çdo rreth, të zhvillohen jo më pak se 5 anketa në çdo tremujor për grupe të ndryshme mallrash; të praktikohen gjerësisht ekspozitat

e shitjes... si dhe të shfrytëzohen më mirë librat e kërkesave, fletanketat etj. Organizatat prodhuese të luftojnë që modelet e prodhuara të kthehen pa humbur kohë në mallra për tregun. Brenda vitit 1957 të rishikohet tipkontrata, protokoll-marrëveshjet të bëhen më të studjuara dhe të shtohen sanksionet për detyrimet kontraktuale. Gjatë fushatës së kontraktiveve të organizohen diskutime me punonjësit lidhur me asortimentin e cilësinë e mallrave.

b) Duke filluar nga muaji tetor 1957, në çdo ndërmarrje të përmirësojnë rrënjësisht evidencën e realizimit të burimeve të furnizimit sipas afateve dhe specifikimit, si dhe evidencën e shitjeve për grup mallrat e ndryshme.

c) Të forcojnë kontrollin e cilësisë së mallrave nga organet e tregëtisë. Për këtë, brenda muajit dhjetor 1957, të lëshohen udhëzime të posaçme lidhur me format dhe mënyrat e ndryshme të kontrollit të cilësisë. Të mos lejohet depërtimi i mallrave me cilësi jo të mirë në rrjetin e tregëtisë. Ndërmarrjet tregëtare të pajisen me të gjitha standardet që janë në fuqi dhe nga muaji gusht 1957 të fillojë studimi i tyre në mënyrë të organizuar nga punonjësit e tregëtisë. Ministria e Tregëtisë në bazë të propozimeve të inspektoriatit të tregëtisë, të ndalojë ndërmarrjet tregëtare që të marrin në dorëzim mallra me cilësi jo të mirë, për derisa furnitorët të përmirësojnë punën e tyre.

c) Në bashkëpunim me Komisionin e Planit të Shtetit dhe organet prodhuese, të zgjerojnë standardizimin dhe të rishikojnë standardet drejt rritjes së kërkesave për cilësinë, në mënyrë që ato të pasqyrojnë rezultatet e arritura në prodhimin dhe të shërbejnë për nxitjen e prodhimit me cilësi të lartë.

2. — Ministria e Industrisë dhe e Minierave, ajo e Bujqësisë e Shëndetësisë, Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Artizanatit dhe ai i Konsumit, si dhe organet e tyre vartëse të marrin masa që të sigurojnë:

a) Realizimin e detyrimeve kundrejt tregëtisë në sasi, kohë dhe cilësi. Kjo të konsiderohet si detyrë kryesore e tyre. Vlerësimi i punës së ndërmarrjeve prodhuese dhe grumbulluese, zbatimi i stimujve të ndryshëm të bëhen duke marrë për bazë edhe realizimin e planit të shpërndarjes dhe t'i jepet fund indiferentizmit që ekziston në këtë drejtim.

b) Përgatitjen me kohë të ndërmarrjeve industriale për prodhimin e artikujve në sasi dhe në asortimentet e nevojshme të kërkuara nga organet e tregëtisë. Ministria e Tregëtisë, Drejtoria qendrore e NSHFP-ve dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit të paraqesin porositë paraprake jo më vonë se në muajin korrik për vitin e ardhshëm.

c) Studimin brenda vitit 1957 për lehtësimin gradual të artizanatit nga prodhimet e rënda, duke ja kaluar këto industrisë,

në mënyrë që artizanati të merret më shumë me prodhimin e atyre artikujve dhe me ato shërbime që ka më shumë nevojë populli.

III. — MBI GRUMBULLIMIN DHE PËRPUNIMIN E PRODHIMEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE

1. — Zgjerimi i kolektivizimit në fshat dhe heqja e triskave për artikujt ushqimorë shtrojnë me forcë të madhe zgjerimin e mëtejshëm të blerjeve të prodhimeve bujqësore-blegtorale nga fshati dhe rritjen e prodhimit nga kooperativat e konsumit. Për këtë qëllim të merren këto masa:

a) Të vlerësohet drejt kontraktimi me kooperativat bujqësore dhe me ekonomitë individuale, duke u konsideruar kjo si metodë pune dhe bazë për shkëmbimin e mallrave fshat-qytet. Të zbatohen drejt parimet e kontraktimit me zotime të dyanshme; të ndiqet sistematikisht realizimi i kontratave të lidhura; të akordohen me kriter të drejtë paradhënjet dhe të ndiqet arkëtimi me kohë i tyre. Paradhënjet e vjetra të jenë likuiduar brenda vitit 1957. Këshilli i Ministrave të aprovojë brenda muajit tetor 1957 kriteret dhe masat për akordimin e paradhënjeve.

b) Të përmirësohet rrënjësisht grumbullimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale, sidomos në thellësi. Të kuptohet mirë se realizimi i planeve të grumbullimit nga kooperativat e konsumit lidhet drejtpërdrejt me furnizimin e punonjësve të qytetit dhe të qendrave të punës.

Zbatimi i detyrës që caktoi Kongresi III i PPSH për sigurimin e bukës në vend varet shumë edhe nga organizimi më i mirë i grumbullimit të tepricave të drithit, i cili duhet të konsiderohet si një nga çështjet më të rëndësishme për kooperativat e konsumit.

Të forcohet dhe të rritet volumi i grumbullimeve në fshat, sidomos për zarzavate, patate, fruta dhe rrush. Të hiqet dorë nga grumbullimi vetëm i artikujve me vleftë të lartë. Të shtohet numri i grumbulluesve jashtë organikës, si dhe i grumbulluesve ambulante dhe brenda vitit 1958 në 50 për qind të fshatrave të ketë grumbullues jashtë organikës. Të punohet për ngritjen e depove të specializuara për patate, fruta, zarzavate.

c) Të forcohen marrëdhënjet reciproke të kooperativave bujqësore me kooperativat e konsumit. Kooperativat bujqësore të japin shembullin e mirë përpara fshatarësisë për shitjen e tepricave të prodhimeve të tyre. Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj vartëse duhet të ndihmojnë më tepër kooperativat bujqësore në organizimin e shitjes kolektive të tepricave të produkteve bujqësore e blegtorale organeve shtetërore dhe kooperativave të konsumit. Kooperativat e konsumit, nga ana e tyre, t'i furnizojnë me

preçedencë kooperativat bujqësore për ngritjen e ekonomisë kolektive për elektrifikimin etj.

ç) Të organizohet më mirë lëvizja e prodhimeve nga thellësitë në qendrat konsumatore. Një kujdes i veçantë t'i kushtohet sigurimit të ambalazhimit të mirë. Brenda vitit 1957 të studjohen modelet të ndryshme ambalazhi për produktet bujqësore e blegtorale, të cilat të jenë rezistente, të lehta dhe komode. Të forcohet dhe të shfrytëzohet mirë transporti primitiv.

d) Të përmirësohet dhe të zgjerohet përpunimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale, sidomos në thellësi. Të zgjerohet asortimenti i prodhimit të turshive, të frutave të thata, të verës, të pijeve alkoolike etj. Të ngrihet cilësia e prodhimit dhe të ulet kostua. Të përmirësohet gjendja e punishteve dhe të krijohen kondita të mira higjienike dhe sanitare.

dh) Të konsiderohet si detyrë e rëndësishme e organizatave kooperativiste përpunimi i qumështit. Të zgjerohet dhe të përmirësohet shumë rrjeti i baxhove, sidomos në zonat e Veriut dhe në thellësi, ku mundësitë janë të mëdha. Të rritet asortimenti dhe të prodhohen djathëra me çmime sa më të lira.

e) T'i jepet fund zbatimit të marzheve të larta. I rekomandohet Këshillit të Ministrave që brenda vitit 1957 të studjojë dhe të aprovojë marzhe të reja për shitjen e produkteve të grumbulluara nga kooperativat e konsumit.

2. — Komitetet ekzekutive të përmirësojnë punën e tyre në caktimin e çmimeve të grumbullimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Caktimi i çmimeve të bëhet me kritere të studjuara, duke marrë parasysh koston e prodhimit, rëndësinë e tij, kërkesën konsumatore etj. dhe të vendosen përpjesëtime të drejta ndërmjet produkteve të ndryshme. Ministria e Tregëtisë dhe Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve të forcojnë ndihmën dhe kontrollin për këtë problem të rëndësishëm.

IV. — PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË TREGËTISË FSHATARE DHE PRIVATE

A.— Tregëtia në pazaret fshatare.

Ministria e Tregëtisë dhe organet e pushtetit lokal të shtojnë influencën e tyre në organizimin e tregëtisë në pazaret fshatare në këto drejtime kryesore:

1. — Të punohet për të hedhur në shitje nga fshatarësia dhe kooperativat bujqësore që ndodhen në afërsitë e qyteteve dhe të qendrave të punës sidomos zarzavate, fruta, vezë dhe qumësht, ndërsa produktet e tjera të grumbullohen nga kooperativat e konsumit.

2. — Të merren masa për përgatitjen e bazave tekniko-materiale në pazaret fshatare. Brenda vitit 1957 të përpilohen norma teknike, në bazë të të cilave të bëhen adaptimi, meremetimi dhe ndërtimi i pazareve. Fondet e caktuara për rregullimin e pazareve të përdoren plotësisht sipas destinacionit të tyre dhe t'i nënshtrohen procedurës së zakonshme të financimit të investimeve.

3. — Për zhvillimin e rregullt të ditëve të pazarit të caktohen vende të veçanta për shitjen e prodhimeve, sipas natyrës së tyre. Në këtë mënyrë fshatarit t'i krijohen kushte për të shitur në këto pazare sa më shumë nga prodhimet e tij.

4. — Organet e shëndetësisë të marrin masa për të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e prodhimeve në ditët e pazarit dhe të punojnë për edukimin e prodhuesve të fshatit për të respektuar kushtet sanitare, në mënyrë që të ruhet shëndeti i popullatës së qyteteve dhe të qendrave të punës.

5. — Organizatat tregëtare të marrin masa për zgjerimin e tregëtisë në ditët e pazarit, sidomos me artikuj industrialë, me prodhime të ushqimit social, si dhe me shërbime të ndryshme artizanë në brendësi dhe në afërsitë e pazareve fshatare.

B. — Tregëtia private

Ekzistenca e sektorit privat të tregëtimit të produkteve bujqësore e blegtorale është ende e nevojshme. Por duhet që Ministria e Tregëtisë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe organet e pushtetit lokal të shtojnë influencën e tyre rregulluese, ndërsa organet financiare të forcojnë kontrollin mbi veprimtarinë e këtij sektori. Të merren masa për t'i prerë hovin spekulimit, tregëtisë ilegale dhe të punohet për zbatimin e përpiktë të rregullave higjieniko-sanitare nga tregëtarët privatë. Brenda vitit 1957 të studjohen mundësitë e organizimit të tregëtarëve privatë që shesin zarzavate, mish ose artikuj të tjerë ushqimorë mbi baza kooperimi, me qëllim që ky organizim t'i shërbejë shtimit të fondit të mallrave për treg, duke lehtësuar furnizimin e konsumatorëve. Kjo mënyrë organizimi krijon mundësi që shteti të ushtrojë kontroll mbi të, për të mënjeluar spekulimin dhe, nëpërmjet kësaj forme, të bëhet edukimi socialist i tregëtarëve të vegjël.

V. — PËR FORCIMIN E KOOPERATIVAVE TË KONSUMIT SI ORGANIZATA EKONOMIKE MASASH

1. — Të forcohet edhe më shumë tregëtia kooperativiste si një hallkë e rëndësishme që shërben për forcimin e mëtejshëm të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse. Të pu-

nohet për forcimin e demokracisë kooperativiste dhe të dëgjohe mirë zëri i anëtarve. Të zhvillohet kritika e anëtarëve për funksionimin më të mirë të aparatit të kooperativave dhe të organeve të zgjedhura prej tyre, të tërhiqet interesimi i anëtarëve për problemet që preokupojnë kooperativën dhe të aktivizohen gjerësisht në çështjet kryesore, si në përpilimin e në realizimin e planeve, në ruajtjen dhe administrimin e mirë të pasurisë kooperativiste, në ndihmën e tyre me punë vullnetare për ngritjen dhe sistemin e rrjetit, në transportimin vullnetarisht të mallrave etj. Të bëhet diferencimi në furnizimin e anëtarëve dhe pjesës tjetër të fshatarësisë dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit të studjojë krijimin e formave më të mira për lidhjen e anëtarëve me kooperativën.

Të luftohet kundër formalizmit në funksionimin e organeve të zgjedhura drejtuese, dhe veçanërisht të atyre të kontrollit.

2. — Të punohet më shumë për shtimin e radhëve të anëtarëve dhe për vjeljen e kuotave. Më 1960 numri i anëtarëve në kooperativat e konsumit të arrijë rreth 80 për qind të të gjitha ekonomive individuale dhe kooperativiste të fshatit. Sistemi i caktimit të kuotave të anëtarësisë të mos jetë në bazë të të ardhurave të anëtarëve, por në bazë të kuotave fikse me afate të caktuara. Në fund të pesëvjeçarit të përfundojë vjelja e kuotave të anëtarësisë.

3. — Komitetet dhe organizatat e Partisë të preokupohen më seriozisht për funksionimin organizativ të kooperativave të konsumit, të shqyrtojnë herë pas here rezultatet e tyre ekonomike dhe t'i ndihmojnë ato për t'u fuqizuar edhe më shumë.

5. — Kongresi III i Kooperativave të Konsumit, që do të mblihdet në muajin korrik 1957, të analizojë mirë aktivitetin e kooperativave të konsumit dhe të marrë masa për forcimin e tyre organizativo-ekonomik, për forcimin e tregëtisë dhe të grumbullimeve në fshat.

6. — Të zgjerohet rrjeti i kooperativave të konsumit në fshat, duke u shtrirë në thellësi. Në planet vjetore të parashikohen fonde për të përmirësuar gjendjen e dyqaneve dhe të depove ekzistuese dhe për ngritjen e lokaleve të reja.

Në ato fshatra ku nuk do të ketë mundësi që të çelen dyqane nga kooperativat për furnizimin e fshatarësisë dhe për grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, kjo detyrë t'u besohet fshatarëve të ndershëm me anën e çeljes së dyqaneve-shtëpi. Duke aktivizuar mundësitë e këtyre të fundit për lokale, transport e mjete të tjera, brenda vitit 1958 të ketë dyqane-shtëpi në çdo fshat dhe ku nuk do të ketë dyqan kooperativa. Menjëherë të studjohen dhe të përcaktohen rregullat për mënyrën e furnizimit, të caktimit të fitimit e të tjera për këto dyqane.

VI. — PËR FORCIMIN E GJENDJES EKONOMIKE-FINANCIARE TË NDËRMARRJEVE DHE TË ORGANIZATAVE TREGËTARE

Ministria e Tregëtisë, Drejtoria qendrore e NSHFP-ve, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe organet e pushtetit lokal të marrin këto masa:

1. — Të mos lejojnë asnjë ndërmarrje që të dalë me humbje duke filluar që nga viti 1958. Të sigurojnë uljen e shpenzimeve të qarkullimit në total dhe sipas zërave, në bazë të organizimit të shfrytëzimit të rezervave të brendshme. Të mënjanojnë dëmtimin e mallrave, të studjojnë likuidimin e gjendjes së mallrave mbi normativë dhe të mos lejojnë krijimin e tyre në të ardhmen. Të mënjanohet sa më shumë krijimi i debi-kredive të paligjshme.

2. — Të forcojnë luftën kundër deficiteve dhe suficiteve. Të përmirësojnë punën e kontrollit shtetëror, të inspektoriatit të tregëtisë dhe të aktivizojnë gjerësisht kontrollin shoqëror në këtë drejtim. Të shpejtojnë azhurnimin e kontabilitetit dhe të përgjithësojnë eksperiencën e përparuar të punonjësve të këtij sektori.

3. — Të studjojnë brenda vitit 1957 shkurtimin e hallkave dhe të personelit të tepërt administrativ, që ka në sektorin e tregëtisë, dhe sidomos në kooperativat e konsumit, me qëllim që të forcohet baza me kuadro, të mënjanohet burokracia dhe të ulen shpenzimet.

VII. — PËR PËRMIRËSIMIN E PUNËS ME KUADRIN DHE NGRITJEN E TIJ TEKNIKO-PROFESIONALE

Për të siguruar përgatitjen më të shpejtë tekniko-profesionale të kuadrit të tregëtisë, të merren këto masa nga Ministria e Tregëtisë, Drejtoria qendrore e NSHFP-ve, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit, Komisioni i Planit dhe Ministria e Arësimit dhe e Kulturës:

1. — Të përmirësohet rrënjësisht puna e përgatitjes së kuadrit në teknikumin tregëtar të ditës, të natës dhe me korrespondencë. Të shtohet pjesëmarrja e të rejave në teknikumet. Të planifikohen më mirë kontigjentet e nxënësve sipas nevojave të rretheve e qarqeve në numër dhe specialistë. Të studjohen brenda vitit 1957 të gjitha format ekzistuese të përgatitjes dhe të kualifikimit të kuadrit, me qëllim që këto t'u përgjigjen më mirë nevojave që i paraqiten sektorit të tregëtisë.

2. — Duke filluar që nga viti 1958, nën drejtimin e Ministrisë së Tregëtisë, të çelet shkolla dyvjeçare për të nxjerrë kuzhinierë dhe teknikë për ushqimin social për nevojat e të gjithë sektorëve të ekonomisë.

3. — Të shtohet pjesëmarrja dhe të ngrihet cilësia e përgatitjes së kuadrit në kurset pa shkëputje nga puna. Të përmirësohen programet, duke përfshirë në to mësim praktikë lidhur me merceologjinë e mallrave, standardet etj. Brenda vitit 1958 të pajisen teknikumi dhe kurset me mjetet e nevojshme për ta bërë mësimin më të kuptueshëm për pjesëmarrësit dhe të lidhet më mirë teoria me praktikën.

4. — Brenda muajit gusht të këtij viti të çelen kurse të posaçme për kualifikimin e punonjësve të tregëtisë së artikujve ushqimorë, për t'i përgatitur ata më mirë për kalimin në tregëtinë e lirë.

VIII. — PËR PËRMIRËSIMIN E PUNËS SË PARTISË, TË ORGANIZATAVE TË MASAVE DHE TË PUSHTETIT NË SEKTORIN E TREGËTISË

1. — Komitetet e Partisë të konsiderojnë si problem kryesor furnizimin e popullit, të organizojnë më mirë punën e tyre për t'u thelluar në problemet konkrete të tregëtisë dhe të grumbullimit, të ndihmojnë dhe të kontrollojnë në mënyrë sistematike punën e organizatave të Partisë në organizatat tregëtare dhe të kërkojnë më shumë llogari nga komitetet ekzekutive, me qëllim që të përmirësojnë drejtimin për furnizimin e popullit, për zgjerimin e grumbullimeve dhe të prodhimeve lokale.

2. — Organizatat e Partisë të sektorit të tregëtisë të njohin nga afër problemet e organizatave tregëtare, t'i trajtojnë ato më mirë dhe të ngjallin në të gjithë punonjësit shpirtin e kritikës dhe të frymës luftarake për kryerjen e detyrave. Organizatat bazë të Partisë të sektorit të tregëtisë, dhe sidomos organizatat bazë në fshat, të merren më shumë me problemet e organizimit të tregëtisë dhe të grumbullimit, duke analizuar herë pas here gjendjen e lokaleve, furnizimin, organizimin e shërbimit të popullit e probleme të tjera që kanë të bëjnë me forcimin e punës në këtë sektor dhe të punojnë për zbatimin e vendimeve, duke mobilizuar punonjësit për t'i vënë ato në jetë.

3. — Komitetet dhe organizatat e Partisë, organet e tregëtisë dhe të pushtetit të përmirësojnë përbërjen e mëtejshme të kuadrit në sektorin e tregëtisë. T'u jepet fund lëvizjeve të kota dhe të ndalohej kategorikisht që kuadrot e specializuar në kurset dhe në shkollat e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste të largohen nga ky sektor.

4. — Të punohet për rritjen e pjesëmarrjes së komunistëve në tregëti dhe brenda vitit 1957 të rishikohet shpërndarja më e drejtë e komunistëve në këtë sektor. Të rritet pjesëmarrja e komunistëve të tregëtisë në kurset e ndryshme të Partisë.

5. — Të forcohet puna ideo-politike me punonjësit e tregëtisë, të gjenden format më të përshtatshme që të sigurohet pjesëmarrja e të gjithë punonjësve në format e punës politike të Partisë.

Kolektivat e agjitorëve në tregëti të punojnë më tepër për të përmirësuar shërbimin ndaj blerësve, administrimin e pasurisë, etj.

6. — Komitetet dhe organizatat e Partisë t'i drejtojnë më mirë organizatat e masave. Për këtë të merren këto masa:

a) Të forcohet puna e bashkimeve profesionale në tregëti për zhvillimin e emulacionit socialist për mobilizimin e punonjësve në realizimin e planit dhe të detyrave ekonomike. Duke filluar që nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, të merren masa për përmirësimin e punës edukative, për të forcuar ndërgjegjen e punonjësve në punë dhe për t'i bërë ata të aftë në kryerjen e detyrave para popullit.

Në bashkëpunim me organet e tregëtisë, të organizohet shkëmbimi i eksperiencës në tregëti, nëpërmjet konferencash, konsultash, shkëmbimeve të delegacioneve etj.

b) Organizata e gruas të forcojë edhe më shumë punën e saj në drejtim të ndihmës që duhet t'i jepet sektorit të tregëtisë për edukimin e grave që punojnë në tregëti, për zgjerimin e asortimenteve, për përmirësimin e shërbimeve dhe për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në tregëti, në mënyrë që më 1960 pjesëmarrja e gruas të arrijë jo më pak se 55 për qind për tregëtinë shtetërore dhe 35 për qind për tregëtinë kooperativiste.

c) Një kujdes i posaçëm duhet treguar për fuqizimin e organizatave të rinisë, me qëllim që rinia në tregëti të kryejë mirë detyrat që i ngarkohen. Të organizohen aksione nga rinia dhe takime, me qëllim që të forcohet puna e rinisë në tregëti për ngritjen e kulturës së shërbimit. Organizatat e rinisë të punojnë për pjesëmarrjen sa më të gjerë të të rejave në tregëti dhe për dërgimin e tyre në kurse.

c) Të aktivizohen gjerësisht organet e kontrollit shoqëror në tregëti për të forcuar kontrollin mbi shërbimin, matjen, peshimin etj.

7. — Komitetet ekzekutive të tregojnë kujdes dhe të marrin në dorë si duhet furnizimin e popullit, të ndihmojnë e të kontrollojnë në kohën e duhur ndërmarrjet dhe organizatat tregëtare, duke përfshirë edhe kooperativat e konsumit dhe NSHFP-të. Ato duhet të tregojnë interesim të veçantë për shfrytëzimin e burimeve lokale për të shtuar fondet e mallrave dhe të punojnë më mirë për koordinimin e prodhimit lokal me nevojat.

Të forcohet roli i anëtarëve të këshillave popullore në përmirësimin e punës së tregëtisë dhe të furnizimit të popullit. Të aktivizohen komisionet e tregëtisë pranë komiteteve ekzekutive.

8. — Shokët kryesorë të Partisë, të pushtetit dhe të organizatave të masave në rreth e në qark ta bëjnë zakon që herë pas

here të shkojnë vetë në dyqanet, restorantet, mensat, depot dhe lokalet e tjera të tregëtisë dhe të marrin masa për përmirësimin e të metave. Ata duhet t'i ndihmojnë më mirë punonjësit e tregëtisë për përmirësimin e shërbimit të blerësve dhe për organizimin më të mirë të punës për furnizimin e popullit.

9. — Të përmirësohet puna e Ministrisë së Tregëtisë, e Drejtorisë qendrore së NSHFP-ve dhe e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit për drejtimin më të mirë të tregëtisë dhe të furnizimit të popullit. Heqja e triskave për artikujt ushqimorë kërkon përmirësimin rrënjësisht të metodës së drejtimit të tregëtisë. Ato të zgjidhin më shpejt çështjet e tregëtisë dhe të ndihmojnë operativisht organet e tyre vartëse dhe të pushtetit lokal. Ndihma e tyre të jetë e efektshme, duke lënë gjurmat organizative të nevojshme. Të merren masat e duhura për përgjithësimin e eksperiencës së përparuar dhe të punohet më mirë për problemet e kuadrit.

Të zhduken të metat në planifikimin e deritanishëm të tregëtisë, të hartohen rregullisht bilancet e të ardhurave dhe të shpenzimeve, të planifikohen më mirë rezervat e mallrave dhe të shtohet influenza e organeve qendrore të tregëtisë mbi prodhimin.

Aparati i Kryeministrisë të përmirësojë punën e tij, të organizojë më mirë kontrollin e zbatimit të vendimeve, të shtojë operativitetin, të zgjidhë më shpejt problemet që i ngrihen dhe të ndihmojë më tepër bazën e sidomos organet e pushtetit lokal.

10. — Drejtorja e tregëti-financës e Komitetit Qendror të PPSH të ndihmojë më mirë komitetet dhe organizatat e Partisë, të organizojë më mirë kontrollin e zbatimit të vendimeve të Partisë dhe të qeverisë dhe të merret më shumë me problemet e kuadrit.

* * *

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë i mbështetur në punën e palodhshme të punonjësve të tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste, në sukseset e arritura deri më sot në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë... ka besim se komitetet e partisë, organizatat bazë, komunistët, si dhe punonjësit e tregëtisë dhe të sektorëve të tjerë ekonomikë do t'i kryejnë me nder detyrat që u ngarkohen për përmirësimin e mëtejshëm të miqënjës materiale të popullit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 170,
datë 16 korrik 1957

Nr 104

V E N D I M

I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË DHE I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

mbi

Heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit, zbritjen e çmimeve të tregut komercial për artikujt ushqimorë, zbritjen e çmimeve unike të artikujve industrialë e ushqimorë, ngritjen e pagave të punëtorëve dhe nëpunësve, rritjen e pensioneve, bursave të studentëve, ndihmën për fëmijët e prindërve në marrëdhënje pune, rritjen e çmimeve të grumbullimeve të detyrueshme, si dhe mbi rregullimin e çmimeve të tepricave të prodhimeve bujqësore në bazë të çmimeve unike të shitjes me pakicë.

19 gusht 1957

Masat punonjëse të vendit tonë me klasën punëtore në krye, të udhëhequra nga Partia e Punës, janë mobilizuar me entuziazëm dhe vetëmohim për zbatimin e vendimeve të Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe kanë arritur rezultate të mëdha përsa i përket rritjes së prodhimit të përgjithshëm industrial dhe bujqësor, kolektivizimit të bujqësisë dhe në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë dhe të kulturës, duke krijuar kështu të gjitha kushtet e nevojshme për marrjen e një mase kaq të rëndësishme, sikurse është heqja e plotë e sistemit të triskëtimit, para afatit të caktuar nga Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë.

Sistemi i triskëtimit, që u vendos pas çlirimit të vendit si një masë ekonomike e përkohshme, ju imponua vendit tonë nga prapambetja e madhe e trashëguar nga regjimet e kaluara dhe nga shkatërrimet që i solli pushtimi nazi-fashist ekonomisë sonë kombëtare. Pushteti popullor ishte i detyruar që të mbante për një kohë të caktuar sistemin e triskëtimit, që të siguronte, brenda disa normave, furnizimin e garantuar të klasës punëtore me artikuj ushqimorë dhe industrialë.

Sistemi i triskëtimit është një pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore, ai është bërë pengesë në

here të shkojnë vetë në dyqanet, restorantet, mensat, depot dhe lokalet e tjera të tregëtisë dhe të marrin masa për përmirësimin e të metave. Ata duhet t'i ndihmojnë më mirë punonjësit e tregëtisë për përmirësimin e shërbimit të blerësve dhe për organizimin më të mirë të punës për furnizimin e popullit.

9. — Të përmirësohet puna e Ministrisë së Tregëtisë, e Drejtorisë qendrore së NSHFP-ve dhe e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit për drejtimin më të mirë të tregëtisë dhe të furnizimit të popullit. Heqja e triskave për artikujt ushqimorë kërkon përmirësimin rrënjësisht të metodës së drejtimit të tregëtisë. Ato të zgjidhin më shpejt çështjet e tregëtisë dhe të ndihmojnë operativisht organet e tyre vartëse dhe të pushtetit lokal. Ndihma e tyre të jetë e efektshme, duke lënë gjurmat organizative të nevojshme. Të merren masat e duhura për përgjithësimin e eksperiencës së përparuar dhe të punohet më mirë për problemet e kuadrit.

Të zhduken të metat në planifikimin e deritanishëm të tregëtisë, të hartohen rregullisht bilancet e të ardhurave dhe të shpenzimeve, të planifikohen më mirë rezervat e mallrave dhe të shtohet influenca e organeve qendrore të tregëtisë mbi prodhimin.

Aparati i Kryeministrisë të përmirësojë punën e tij, të organizojë më mirë kontrollin e zbatimit të vendimeve, të shtojë operativitetin, të zgjidhë më shpejt problemet që i ngrihen dhe të ndihmojë më tepër bazën e sidomos organet e pushtetit lokal.

10. — Drejtorja e tregëti-financës e Komitetit Qendror të PPSH të ndihmojë më mirë komitetet dhe organizatat e Partisë, të organizojë më mirë kontrollin e zbatimit të vendimeve të Partisë dhe të qeverisë dhe të merret më shumë me problemet e kuadrit.

* * *

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë i mbështetur në punën e palodhshme të punonjësve të tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste, në sukseset e arritura deri më sot në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë. . . ka besim se komitetet e partisë, organizatat bazë, komunistët, si dhe punonjësit e tregëtisë dhe të sektorëve të tjerë ekonomikë do t'i kryejnë me nder detyrat që u ngarkohen për përmirësimin e mëtejshëm të miqënjës materiale të popullit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 170,
datë 16 korrik 1957

Nr 104

V E N D I M

I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË DHE I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

mbi

Heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit, zbritjen e çmimeve të tregut komercial për artikujt ushqimorë, zbritjen e çmimeve unike të artikujve industrialë e ushqimorë, ngritjen e pagave të punëtorëve dhe nëpunësve, rritjen e pensioneve, bursave të studentëve, ndihmën për fëmijët e prindërve në marrëdhënje pune, rritjen e çmimeve të grumbullimeve të detyrueshme, si dhe mbi rregullimin e çmimeve të tepërcave të prodhimeve bujqësore në bazë të çmimeve unike të shitjes me pakicë.

19 gusht 1957

Masat punonjëse të vendit tonë me klasën punëtore në krye, të udhëhequra nga Partia e Punës, janë mobilizuar me entuziazëm dhe vetëmohim për zbatimin e vendimeve të Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe kanë arritur rezultate të mëdha përsa i përket rritjes së prodhimit të përgjithshëm industrial dhe bujqësor, kolektivizimit të bujqësisë dhe në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë dhe të kulturës, duke krijuar kështu të gjitha kushtet e nevojshme për marrjen e një mase kaq të rëndësishme, sikurse është heqja e plotë e sistemit të triskëtimit, para afatit të caktuar nga Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë.

Sistemi i triskëtimit, që u vendos pas çlirimit të vendit si një masë ekonomike e përkohshme, ju imponua vendit tonë nga prapambetja e madhe e trashëguar nga regjimet e kaluara dhe nga shkatërrimet që i solli pushtimi nazi-fashist ekonomisë sonë kombëtare. Pushteti popullor ishte i detyruar që të mbante për një kohë të caktuar sistemin e triskëtimit, që të siguronte, brenda disa normave, furnizimin e garantuar të klasës punëtore me artikuj ushqimorë dhe industrialë.

Sistemi i triskëtimit është një pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë popullore, ai është bërë pengesë në

stimulimin e prodhimit, në përmirësimin e cilësisë dhe në zgjerimin e asortimenteve të mallrave, çënon parimin socialist të shpërblimit sipas punës dhe lejon elemente barazimi në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare dhe, për pasojë, pengon ngritjen e rendimentit të punës, që është kusht i domosdoshëm për ndërtimin e shoqërisë socialiste.

Heqja e plotë e sistemit të triskëtimit dhe kalimi në tregëtinë e lirë dhe pa kufizime të artikujve ushqimorë është një masë e domosdoshme dhe me një rëndësi të madhe politike dhe ekonomike për vendin tonë, masë e cila do të ndihmojë në përmirësimin e kushteve materiale të punonjësve.

Kjo masë e rëndësishme në fushën ekonomike do t'i japë një hov edhe më të madh zhvillimit të prodhimit, zgjerimit të asortimenteve të mallrave, përmirësimit të cilësisë së prodhimit në interes të mirëqenjes së masave punonjëse.

Heqja e plotë e sistemit të triskëtimit do të ndihmojë në zbatimin më të drejtë të parimit socialist të shpërblimit sipas punës dhe në shpërndarjen më të drejtë të të ardhurave kombëtare. Kjo masë do të shërbejë për forcimin e mëtejshëm të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë nëpërmjet zgjerimit të shkëmbimit të lirë dhe pa kufizime të prodhimeve bujqësore me prodhimet industriale. Heqja e sistemit të triskëtimit do të ndihmojë shumë në forcimin e hozrashotit dhe në përmirësimin e tregëtisë.

Partia dhe qeveria e kanë cilësuar kurdoherë sistemin e triskëtimit si një masë ekonomike të përkohshme, të nevojshme për disa rrethana në një etapë të caktuar, dhe prandaj kanë luftuar për të përgatitur kushtet e nevojshme materiale për heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit. Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë aprovoi një program madhështor për zhvillimin e ekonomisë popullore, që gjen shprehjen e tij në detyrat kryesore të planit të dytë 5-vjeçar 1956-1960, që parashikon ngritjen e mëtejshme të gjendjes materiale të popullit, në bazë të zhvillimit të prodhimit industrial e bujqësor, të uljes së vazhdueshme të çmimeve dhe të heqjes së plotë të sistemit të triskëtimit.

Emulacioni socialist, që është organizuar në vendin tonë për nder të 40-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit, po jep rezultate të mëdha për sa i përket rritjes së prodhimit, rritjes së rendimentit në punë dhe uljes së kostos.

Si rezultat i përpjekjeve të punonjësve të qytetit dhe të fshatit nën udhëheqjen e Partisë dhe me ndihmën e gjithanshme të Bashkimit Sovjetik në radhë të parë, dhe të vendeve të demokracisë popullore, janë arritur suksese të mëdha për sa i përket rritjes së prodhimit industrial e bujqësor dhe janë siguruar rezervat e mjaftueshme për të hequr sistemin e triskëtimit para afatit të caktuar nga Kongresi III i Partisë.

Prodhimi i përgjithshëm industrial është rritur në vitin 1957

(realizim i pritshëm) 14 herë më shumë në krahasim me vitin 1938, nga i cili prodhimi i naftës — 3,4 herë, nxjerrja e mineralit të kromit — 22,8 herë, prodhimi i çimentos — 6,9 herë, i energjisë elektrike — 11,3 herë, prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë — 14,3 herë, nga i cili tekstilet e pambukta — 52 herë, këpucët e sandalet — 2,4 herë, makaronat 17 herë etj. Ndërsa para çlirimit nuk ekzistonte industria e sheqerit, tani prodhohet në vend sasia e sheqerit të nevojshëm për furnizimin e popullatës.

Në lëmin e bujqësisë, pas çlirimit të vendit janë arritur gjithashtu rezultate të mëdha. Sipërfaqja e mbjellë gjithsejt në vitin 1957, në krahasim me vitin 1938, është rritur 78 për qind. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor është rritur 84 për qind në krahasim me vitin 1938, nga i cili prodhimi i drithërave të bukës — 96 për qind.

Si rezultat i zhvillimit dhe i rritjes së prodhimit industrial e bujqësor, furnizimi i popullsisë është përmirësuar nga viti në vit. Në vitin 1957 (realizim i pritshëm) populli është furnizuar, në krahasim me vitin 1950, nëpërmjet tregëtisë socialiste me 64 për qind më shumë sheqer, 129 për qind më shumë yndyrna ushqimore, 93 për qind më shumë fasule e oriz, 73 për qind më shumë mish e peshk, 109 për qind më shumë tekstile të pambukta, 193 për qind më shumë këpucë e opinga, etj. . .

Këshilli i Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, të udhëhequr nga ligji themelor i Partisë dhe nga vendimet e Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë, që përcaktojnë si detyrën më të lartë të Partisë përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve materiale dhe kulture të punonjësve, duke vlerësuar rezultatet e arritura në fushën e ekonomisë në këta vjetët e fundit, eksperiencën dhe rezultatet pozitive të arritura pas heqjes së pjesshme të sistemit të triskëtimit që u bë në fillim të vitit 1956 dhe duke u bazuar në ndihmën e dhënë posaçërisht nga... Bashkimi i madh Sovjetik e quajnë se janë krijuar plotësisht kushtet e nevojshme dhe janë siguruar të gjitha rezervat e mallrave që lejojnë për të avancuar detyrën e caktuar nga Kongresi III i Partisë së Punës të Shqipërisë për heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit, prandaj

V E N D O S Ë N

I. — Heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit dhe caktimin e çmimeve unike të artikujve ushqimorë.

1) Më 1 nëntor 1957 të hiqet krejtësisht sistemi i furnizimit të popullsisë me mallra ushqimore, në bazë të triskave për bukën, miellin, mishin, makaronat, vajin, gjalpin, dhjamin, orizin,

fasulet, sapunin, qumështin dhe këta artikuj të vihen në shitje me çmimet unike të shitjes me pakicë.

2) Çmimet teknike të shitjes me pakicë për artikujt ushqimorë që hiqen nga sistemi i triskëtimit caktohen duke zbritur çmimet e sotme të tregut të lirë shtetëror në masën që vijon:

	% e zbritjes
Bukë gruri e zakonshme me miell rreze 96 ⁰ / ₀	42-48
Bukë misri e zakonshme me miell rreze 95 ⁰ / ₀	44-48
Miell gruri për të gjitha llojet	28-39
Makarona me miell rreze 36 ⁰ / ₀	22-25
Sheqer	27,8
Qumësht	24-33
Vaj ulliri i parafinuar	3,5
Dhjamë derri i tretur dhe i patretur	5-12
Vaj vegjetal	21,4
Sapun rrobash me 58 ⁰ / ₀ yndyrë	23
Gjalpë i tretur	18
Oriz vendi i cilësisë së parë	20

3) Çmimi i shitjes së misrit caktohet në 3000 lekë kv. dhe i grurit në 3500 lekë kv.

Çmimi i misrit që u jepet si stimulacion prodhuesve të bimëve industriale mbetet në fuqi në masën 1.500 lekë kv.

II. — Zbritja e çmimeve unike të shitjes me pakicë për artikujt industrialë dhe ushqimorë të patriskëtuar.

Më 1 nëntor 1957 të zbriten çmimet unike të shitjes me pakicë të artikujve industrialë dhe ushqimorë të patriskëtuar për një shumë me efekt vjetor 425 milion lekësh.

Zbritja e çmimeve për grupe mallrash të bëhet në përqindjet mesatare si më poshtë:

	% e zbritjes
1) Pëlhurë prej pambuku	5
2) Konfeksione të pambukta	4-5
3) Pëlhurë prej leshi	7
4) Konfeksione të leshta	7-8
5) Penj për qepje	15
6) Kadife e drillë	10-33
7) Çorape vendi dhe importi	10
8) Trikotazhe pambuku	8
9) Litar e spango	10
10) Pëlhurë ambalazhi e jute	10
11) Këpucë e sandale vendi dhe importi	5
12) Opinga gjithfarësh	5

13) Lëndë druri e sharruar	10
14) Lëndë druri e staxhionuar	12
15) Kompensatë	20
16) Gozhdë	9
17) Xhama	10
18) Enë llamarine	5
19) Enë alumini	5
20) Bojë vendi zmalto	20
21) Vajguri për ndriçim	16,7
22) Konserva peshku	10
23) Kafe kokërr, cilësia II	10
24) Batanije	10
25) Mobilje	5

III. — Ngritja e pagës së punëtorëve dhe të nëpunësve, ngritja e pensioneve dhe e bursave, si dhe dhënja e një ndihme për fëmijët.

Diferencat për triskat në mes të çmimeve unike të shitjes me pakicë dhe të çmimeve të tregut të garantuar të kompensohen plotësisht në mënyrat dhe kriteret që vijojnë:

Të gjithë punëtorët dhe nëpunësit që punojnë në institucionet shtetërore dhe organizatat kooperativiste dhe shoqërore dhe që kanë gëzuar të drejtën e triskës kompensohen për çdo muaj:

a) Në formë shtese mbi pagën.

b) Në formë ndihme për ata që kanë fëmijë.

Punëtorët dhe nëpunësit do të përfitojnë shtesë mbi pagën bazë sipas grupeve dhe në masën që shënohet më poshtë:

1. — Punëtorët e nëntokës në minierat e qymyrgurit 1900 lekë në muaj
2. — Punëtorët e pyllit në sharrat 1600 lekë në muaj
3. — Punëtorët e nëntokës në minierat e tjera, punëtorët e sharrave, që nxjerrin e afrojnë trupa, etj. Punëtorët shkrirës, fryrës etj. të industrisë së qelqit, maqinistët e lokomotivave dhe instruktoret maqinistë në transportin hekurudhor, si dhe punëtorët e ngarkim-shkarkimit në port etj. 1500 lekë në muaj
4. — Punëtorët e tjerë në minierat e qymyrgurit 1400 lekë në muaj

5. — Punëtorët e tjerë të minierave dhe të gjeologjisë, brigadierët dhe traktoristët e SMT-ve dhe të NBSH-ve, shoferët e kamionave dhe të autobusëve 1350 lekë në muaj
6. — Punëtorët e industrisë së çimentos, të tullave e të material-ndërtimit, të industrisë mekanike dhe energjitike, punëtorët e tjerë të sharrave, punëtorët e industrisë së drurit, të industrisë së lëkurës, të gomës, të këpucëve, të industrisë tekstile, të ndërtimit, të montimit, punëtorët e ekonomisë komunale, kryetarët e trenave, ndruetit e binarëve, frenuesit në transportin hekurudhor etj. 1300 lekë në muaj
7. — Punëtorët e industrisë së duhanit, të vaj-sapunit, të birrës, të sheqerit, të industrisë farmaceutike, tipografike, ndihmëstraktoristët në SMT-të, punëtorët e fushës në bujqësi dhe punëtorët e blegtorisë, fatorinot dhe ndihmësшоferët në transport, si dhe punëtorët e PTT-së etj. 1250 lekë në muaj
8. — Punëtorët e tjerë të industrisë ushqimore, punëtorët e ngarkim-shkarkimit në sektorët e tjerë, rojet e binarëve dhe manovruetit në transportin hekurudhor etj. 1200 lekë në muaj
9. — Punëtorët e tjerë të industrisë së veshmbathjes, punëtorët e tjerë të industrisë së qelqit, shoferët e veturave dhe punëtorët e mirëmbajtjes së rrugëve etj. 1100 lekë në muaj
10. — Personeli i rjetit të tregëtisë dhe të grumbullimit në të gjitha degët 1000 lekë në muaj

Nxënësit në ekonomi do të marrin një shtesë mbi pagën prej 800 lekësh në muaj.

Rritja e pagave për punëtorët që nuk përmenden më sipër, për personelin inxhiniero-teknik, për punonjësit e arësimit, të shëndetësisë dhe të administratës, si dhe kriteret e dhënjes së kompensimit në përgjithësi do të përcaktohen me udhëzim të veçantë të Komisionit të Planit të Shtetit, të Ministrisë së Financave dhe të Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, sipas pagave dhe profesioneve, sipas kategorisë së triskës që kanë marrë, duke ju dhënë një shtesë nga 1000 gjer në 1900 lekë në muaj.

Të ardhurat që kanë punëtorët dhe nëpunësit nga rritja e pagës për efekt të heqjes së triskave dhe nga ndihmat mujore për fëmijët nuk formojnë objekt tatimi mbi të ardhura për punëtorët e nëpunësit, tatim mbi beqarë etj.

Duke filluar nga muaji janar 1958, kompensimi për ndër-marrjet dhe organizatat ekonomike do të rëndojë koston e prodhimit.

Prindërve me fëmijë që janë në marrëdhënje pune në institucionet shtetërore dhe në organizatat kooperativiste dhe shoqërore dhe që kanë gëzuar të drejtën e triskës për fëmijët në ngarkim u jepet një shumë mujore në masën që vijon:

- | | |
|---|------------------|
| 1. — Për fëmijën e dytë | 250 lekë në muaj |
| 2. — Për fëmijën e tretë edhe | 520 lekë në muaj |
| 3. — Për fëmijën e katërt edhe | 560 lekë në muaj |
| 4. — Për fëmijën e pestë e lart për çdo fëmijë edhe | 600 lekë në muaj |

Ndihma mujore jepet duke përfshirë në numrin e fëmijëve fëmijët gjer në moshën 13 vjeç, ose gjersa të mbarojnë shkollën, në qoftë se nuk janë me bursë.

Ndihma për nënat me shumë fëmijë dhe nënat e vetme e caktuar me dispozita të veçanta mbetet në fuqi.

Pensionistët që gëzojnë triska t'u rritet pensioni mujor në masën që vijon:

- | | |
|--|-------------------|
| 1. — Invalidëve të grupit I | 1250 lekë në muaj |
| 2. — Invalidëve të grupit II që nuk janë në marrëdhënje pune | 1200 lekë në muaj |
| 3. — Pensionistëve me pension pleqërie që banojnë në qytet dhe që nuk janë në marrëdhënje pune | 500 lekë në muaj |
| 4. — Pensionistëve me pension familjar me një pjesëtar familjeje | 375 lekë në muaj |

me dy pjesëtarë] 750 lekë në muaj
dhe me tre pjesëtarë e lart 1.125 lekë në muaj

Grave me barrë, që kanë gëzuar të drejtën e triskës plotësuese, kompensimi t'u jepet në formë ndihme të menjëhershme në masën 1100 lekë.

Bursat në të holla të studentëve të universitetit dhe të instituteve të larta të rriten 900 lekë në muaj.

Kompensimi që u jepet sot punonjësve për triskat e artikulave industrialë mbetet në fuqi.

Tarifat e çerdheve, të kopshteve dhe të konviktorëve me pagësë mbeten të pandryshuara.

Ministria e Financave ngarkohet që, duke filluar nga data e heqjes së triskave, të paguajë në formë paradhënjeje 50 për qind të shumës mujore të ngritjes së pagës së punëtorëve dhe nëpunësve. Gjithashtu të paguajë në formë paradhënjeje edhe shumën mujore të ndihmës për fëmijët në datën e heqjes së triskave.

Ministria e Financave dhe Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale ngarkohen që të lëshojnë udhëzime mbi rritjen e pensioneve dhe ndihmën e prindërve me fëmijë.

IV. — Çmimet e grumbullimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

1) Çmimet e grumbullimit të detyrueshëm për drithërat e bukës të rriten në masën trefish në krahasim me çmimet në fuqi.

2) Çmimet e grumbullimit të detyrueshëm për elbin, tagjinë, fasulet dhe orizin çeltik të rriten në rreth dyfish nga çmimet në fuqi.

3) Çmimet e grumbullimit të detyrueshëm të mishit të rriten mesatarisht 50 për qind në krahasim me çmimet në fuqi.

4) Komiteti shtetëror i grumbullimeve dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit ngarkohen që, me aprovim të qeverisë, të ndërtojnë çmimet e grumbullimit të tepricave të drithërave dhe të prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale në raport të drejtë me çmimin unik të shitjes me pakicë të bukës dhe të artikulave të tjerë ushqimorë që caktohen në këtë vendim, duke patur parasysh që 100 kg grurë në formë tepricash të blihen 3100 lekë dhe 100 kg. misër 2.600 lekë.

* * *

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë e konsiderojnë

heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit si një nga masat më të rëndësishme për jetën ekonomike të vendit, e cila u arrit në sajë të përpjekjeve të masave punonjëse, me klasën punëtore në krye, në sajë të ndihmës bujare të Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore dhe në sajë të rritjes dhe zhvillimit të pandërprerë të ekonomisë sonë popullore.

Heqja e plotë e sistemit të triskëtimit bëhet në kondita të favorshme për punonjësit që gëzonin të drejtën e triskave. Rritja e pagës së punëtorëve dhe të nëpunësve, rritja e pensioneve, e bursave, si dhe dhënja e ndihmës për fëmijët mbulojnë plotësisht të gjithë shumën e diferencës për triskat në mes të çmimeve unike të shitjes me pakicë dhe të çmimit të garantuar për artikulat ushqimorë dhe ajo arrin shumën rreth tre miliard lekë në vit.

Zbritja e çmimeve të artikulave industrialë në shumën prej 425 milionë lekë në vit është një tjetër masë e rëndësishme për ngritjen e fuqisë blerëse të masave punonjëse dhe ndihmon në mbulimin e ndonjë prekjeje eventuale të të ardhurave të veçuara të atyre familjeve që i kanë patur siguruar me sistemin e triskëtimit.

Punonjësit e qytetit e të fshatit do të përfitojnë gjithashtu rreth 800 milion lekë në vit nga zbritjet e çmimeve të mallrave ushqimore të tregut komercial në nivelin e çmimeve të reja unike. Mbajtja në nivelin e sotëm të tarifave të çerdheve e kopshteve është një tjetër ndihmë për punonjësit me shumë fëmijë. Si rezultat i masave të mësipërme, paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve do të rritet rreth 4 për qind.

Të gjitha këto masa të rëndësishme tregojnë ngritjen e mëtejshme dhe të vazhdueshme të ekonomisë sonë popullore.

Para klasës sonë punëtore dhe fshatarësisë punonjëse dalin edhe detyra të rëndësishme për fuqizimin e ekonomisë popullore, që konsistojnë: në shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve prodhuese, në zbulimin dhe mobilizimin e rezervave të brendshme në industri dhe në bujqësi, në ngritjen e vazhdueshme të rendimentit në punë, në luftën për uljen e mëtejshme të kostos së prodhimeve, në shtimin e asortimenteve të mallrave dhe në përmirësimin e cilësisë së këtyre. Para punonjësve të bujqësisë dalin detyra të rëndësishme për rritjen e sipërfaqeve të mbjella, për rritjen e rendimenteve të prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe për plotësimin e nevojave të klasës punëtore me artikulat ushqimorë.

Para gjithë drejtuesve të ekonomisë dhe gjithë punonjësve shtrohet detyra e forcimit të regjimit të kursimit, e harxhimit me ekonomi të mjeteve materiale dhe monetare, me qëllim që të krijohen kushtet e favorshme për uljen sistematike të çmimeve dhe për ngritjen e fuqisë blerëse reale të monedhës.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave i bëjnë thirrje klasës punëtore heroike dhe fshatarësisë punonjëse të vënë

të gjitha forcat për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit dhe kanë bindje të plotë se punonjësit e republikës do t'i kryejnë me nder detyrat ndaj atdheut.

KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS POPULLORE
TË SHQIPËRISË

KOMITETI QENDROR
I PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 262,
datë 31 tetor 1957

PLENUMI VII I KQ TË PPSH

Tiranë, 2 dhjetor 1957

KOMUNIKATË

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 2 dhjetor 1957 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të P P S H për të dëgjuar raportin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror shokut Enver Hoxha mbi mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste dhe mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që muarën pjesë në festimin e 40-vjetorit të Revolucionit socialist të Tetorit, si dhe mbi veprimtarinë e delegacionit të Partisë e të qeverisë sonë në Moskë.

Plenumi i Komitetit Qendror theksoi rëndësinë historike të mbledhjeve të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore dhe aprovoi njëzëri Deklaratën e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste Manifestin e paqes dhe veprimtarinë e delegacionit të Partisë e të qeverisë.

Lidhur me këto plenumi aprovoi një rezolutë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nr. 105

NGA REZOLUTA

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Mbi

Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste dhe mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që muarën pjesë në festën e 40-vjetorit të Revolucionit socialist të Tetorit, si dhe mbi veprimtarinë e delegacionit të Partisë e të qeverisë sonë në Moskë

Më 2 dhjetor 1957 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH për të dëgjuar raportin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qe-

ndror shokut Enver Hoxha mbi mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste dhe mbi mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore që muarën pjesë në festimin e 40-vjetorit të Revolucionit socialist të Tetorit, si dhe mbi veprimtarinë e delegacionit të partisë e të qeverisë sonë në Moskë.

Plenumi i Komitetit Qendror theksoi rëndësinë historike të mbledhjeve të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore... Plenumi i Komitetit Qendror aprovoi njëzëri Deklaratën e mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste dhe Manifestin e paqes.

Në këto dokumenta i bëhej një analizë e thellë epokës së kalimit nga kapitalizmi në socializëm dhe ndryshimeve historike në raportin e forcave në botë, të cilat kanë sjellë forcimin e socializmit e dobësimin e imperializmit. Fitorja e Revolucionit të madh socialist të Tetorit 40 vjet më parë shënoi fillimin e kësaj epoke të re...

Plenumi i Komitetit Qendror konsideron se uniteti i pikëpamjeve të partive komuniste e punëtore për çështjet themelore të revolucionit socialist dhe të ndërtimit të socializmit është një kusht i domosdoshëm për triumfin e çështjes sonë.

Në Deklaratën e partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste theksohet se revolucioni socialist dhe ndërtimi i socializmit bazohen në ligje kryesore që janë të përbashkëta për të gjitha vendet, por kjo s'do të thotë të mos mbahen parasysh veçoritë e çdo vendi në zbatimin e tyre. Mohimi i këtyre ligjeve të përbashkëta, duke mbivlerësuar veçoritë kombëtare, të shpie në revizionizëm, që është sot rreziku kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. E kundërta, mosmarrja parasysh e veçorive kombëtare, të shpie në dogmatizëm. Partia jonë ka zhvilluar një luftë të vendosur kundër revizionizmit dhe shfaqjeve sektariste e dogmatike dhe do të vazhdojë të luftojë për pastërtinë e marksizëm-leninizmit.

Plenumi i Komitetit Qendror solidarizohet plotësisht me konkluzionin e mbledhjeve të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore në Moskë se mbrojtja e paqes është një detyrë kryesore. Veçoria e gjendjes së tanishme është se popujt kanë mjaft forca për të ndaluar shpërthimin e një lufte të re, që e përgatitin imperialistët me qarqet agresive të SHBA në krye. Për këtë duhet që popujt të bashkojnë përpjekjet e tyre në luftën kundër planeve të luftënxitësve dhe të shtojnë vigjilencën...

Plenumi i Komitetit Qendror porositi të gjitha organizatat e partisë të studjojnë me kujdes këto dokumenta... Organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe organet e propagandës duhet të bëjnë të njohur në masat punonjëse çështjet e rëndësishme që ngrihen në këto dokumenta historike. Të shërbejë gjithë kjo punë

për mobilizimin e popullit për zbatimin e detyrave të mëdha të ndërtimit të socializmit e për konsolidimin e fitoreve të demokracisë popullore.

Plenumi i Komitetit Qendror vendosi të mblidhen aktivet e Partisë në qarqe e rrethe për të punuar dokumentat e aprovuara nga mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore në Moskë.

Plenumi i Komitetit Qendror shpreh bindjen se gjithë Partia e Punës dhe populli shqiptar, si gjithmonë, do të ecin në rrugën që çau Partia e bolshevikëve me Leninin e madh në krye, në miqësi të përjetshme me Bashkimin Sovjetik e vendet e kampit të socializmit, në unitet të plotë me gjithë partitë komuniste e punëtore motra, do të udhëhiqen gjithmonë nga parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, për ndërtimin me sukses të socializmit në Shqipëri, për lumturinë e begatinë e popullit shqiptar dhe për mbrojtjen e paqes.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 290,
datë 3 dhjetor 1957

PLENUMI VIII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 3-5 Shkurt 1958

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nga 3 deri 5 shkurt u mbajt Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH me këtë rend dite:

1. — Raport mbi rezultatet e arritura në realizimin e planit të shtetit për vitin 1957 dhe detyrat e planit të vitit 1958, mbajtur nga shoku Mehmet Shehu.

2. — Raport mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 1957 dhe detyrat për realizimin e plotë të buxhetit për vitin 1958, mbajtur nga shoku Abdyl Këllezi.

3. — Raport mbi shtesat në planin e dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik e kultural të RP të Shqipërisë, mbajtur nga shoku Spiro Koleka.

Plenumi aprovoi njëzëri raportet e paraqitura dhe mori vendimet përkatëse, ku përcaktohen detyrat që dalin përpara organeve të Partisë dhe atyre shtetërore për të realizuar para afatit planin e dytë pesëvjeçar.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nr. 106

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS SË SHQIPËRISË

MBI

REZULTATET E ARRITURA NË REALIZIMIN E PLANIT TË SHTETIT DHE TË BUXHETIT PËR VITIN 1957 DHE DETYRAT E PLANIT DHE TË BUXHETIT PËR VITIN 1958

5 shkurt 1958

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur prej datës 3 deri më 5 shkurt 1958 nën kryesinë e

Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, shokut Enver Hoxha, dëgjoi dhe shqyrtoi raportet e Byrosë Politike mbi rezultatet e arritura në realizimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1957 dhe detyrat e planit dhe të buxhetit për vitin 1958, mbajtur nga shokët Mehmet Shehu dhe Abdyl Këllezi.

I

Si rezultat i punës vetëmohuese të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse, të inteligjencies popullore, nën udhëheqjen e urtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, në vitin 1957 u arritën suksese të rëndësishme në zhvillimin e ekonomisë popullore të vendit tonë. Viti 1957 karakterizohet nga realizimi i kënaqshëm i planit të shtetit në të gjithë sektorët e ekonomisë popullore, nga zgjerimi i hovshëm i kolektivizimit të fshatit, nga ngritja e mëtejshme e nivelit ekonomik e kultural të masave punonjëse dhe nga hapja e perspektivës konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore me ritme të shpejta.

1. — Volumi i përgjithshëm i prodhimit industrial në vitin 1957 u realizua në masën 21 miliard e 726 milionë lekë ose 103,5 për qind, që do të thotë 26 për qind më shumë se në vitin 1956. Në vitin 1957 u prodhuan më shumë se në vitin 1956: naftë 84,0 për qind, qymyrguri 5,2 për qind, mineral kromi 26,6 për qind, mineral bakri 100,8 për qind dhe bakër blister 60,6 për qind, energji elektrike 20,5 për qind, lëndë druri e sharruar 17,2 për qind, çimento 8,4 për qind, mobilje 27,6 për qind, tekstile të pambukta 17,2 për qind, tekstile të leshta — 27,8 për qind, këpucë 14,6 për qind, gjalpë 79,3 për qind, etj. Rendimenti i punës në prodhimin e përgjithshëm industrial u rrit 12, 8 për qind dhe kostua u ul 4,5 për qind.

2. — Në fund të vitit 1957 numri i kooperativave bujqësore arriti në 1698 që përfshijnë 46,4 për qind të numrit të familjeve fshatare dhe 58,1 për qind të sipërfaqes së mbjellë të fshatarësisë, kundrejt 881 kooperativave, me 24,2 për qind të numrit të familjeve fshatare dhe 30,8 për qind të sipërfaqes së mbjellë të fshatarësisë që ishte në fund të vitit 1956. Futja në masë e fshatarit të mesëm në rrugën e kolektivizimit në shumë rrethe është sot karakteristika kryesore e jetës së fshatit.

Në vitin 1957 u prodhuan më shumë se në vitin 1956: grurë 29 për qind, thekër 10 për qind, misër 25 për qind, oriz 28 për qind, pambuk 78 për qind, duhan 14 për qind, panxhar sheqeri 55 për qind, ullinj 60 për qind. U hapën 22.500 ha tokë të reja, plani i ndërimit artificial të dhenve u tejkalua 25,4 për qind, SMT-të kryen një volum pune 43 për qind më shumë se në vitin 1956. Plani i të ardhurave neto të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore u rea-

lizua 127,2 për qind ose rreth 219 për qind më shumë se në vitin 1956.

Plani i grumbullimit të detyrueshëm në vitin 1957 u realizua në mënyrë të kënaqshme. Gjithsejt në vitin 1957 u grumbulluan më shumë se në vitin 1956: drithëra buke 28 për qind, pambuk 94 për qind, duhan 17 për qind, panxhar sheqeri 53 për qind, patate 51 për qind, qumësht 40 për qind etj.

3. — Transporti automobilistik e realizoi planin e vitit 1957 në masën 102,3 për qind ose 21 për qind më shumë se në vitin 1956. Transporti hekurudhor e realizoi planin 120,5 për qind ose 50,3 për qind më shumë se në vitin 1956, dhe transporti detar 134,4 për qind ose 92,6 për qind më shumë se në vitin 1956.

4. — Plani i ndërtimeve në vitin 1957 u realizua në masën 2 miliard e 796 milion lekë, ose 103,6 për qind. Ky volum ndërtimi është 23,2 për qind më i madh se ai i vitit 1956. Ndërmarrjet e Ministrisë së Ndërtimit e realizuan planin vjetor 110,2 për qind, ose 29,2 për qind më shumë se në vitin e mëparshëm, kurse ndërmarrjet lokale të ndërtimit e realizuan planin vjetor 88 për qind, ose 27,7 për qind më shumë se në vitin 1956. Në ndërtim rendimenti i punës u rrit 23,8 për qind dhe kostua u ul 5,5 për qind. U vunë në shfrytëzim objekte të rëndësishme si hidrocentralet «Karl Marks», fabrika e kadifesë, fabrika e qelqit etj.

5. — Volumi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave, në vitin 1957, arriti në 15 miliard e 145 milion lekë, që është baraz me 99,4 për qind të planit vjetor, ose 22,4 për qind më shumë se në vitin 1956. Në këtë mënyrë konsumi mesatar për frymë të popullsisë u rrit 19 për qind.

Në vitin 1957, nëpërmjet tregëtisë socialiste masat punonjëse të të gjithë vendit kanë marrë më shumë se në vitin 1956: bukë dhe miellra 18,6 për qind, sheqer 17,4 për qind, yndyrna 12,6 për qind, mish e peshk 2,3 për qind, makarona 2,5 për qind, djathëra 28,9 për qind, qumësht 18,0 për qind, perime 16,3 për qind, sapun 13,3 për qind, tekstile të pambukta 26,5 për qind, tekstile të leshta 45 për qind, këpucë e opinga 33,0 për qind, çorape 62,0 për qind, gozhdë 2 për qind, lëndë druri 37,4 për qind, mobilje dhe orendi 32 për qind etj.

Volumi i të ardhurave kombëtare, sipas të dhënave paraprake, u rrit 14 për qind. Heqja e plotë e sistemit të triskëtimit është një fitore e madhe për të gjithë popullin.

U çel për të parën herë në vendin tonë Universiteti shtetëror në Tiranë. Viti 1957 shënoi suksese të rëndësishme në ngritjen kulturele të të gjithë popullit dhe në përmirësimin e shëndetit të tij.

Buxheti i shtetit për vitin 1957, në bazë të të dhënave paraprake u realizua 106 për qind për të ardhurat dhe 98 për qind për shpenzimet, gjendja e depozitave të popullatës në arkat e kursimit u rrit nga 285 milion lekë në 482 milion lekë.

U rrit shpejtësia e qarkullimit të monedhës, fshatarësisë kooperativiste dhe individuale ju dhanë huara me afat të gjatë për 330 milion lekë, u akorduan huara me afat të gjatë për ndërtim banesash në qytete në masën 35 milion lekë. Financat e shtetit siguruan financimin pa ndërprerje të ekonomisë dhe të kulturës. Është forcuar regjimi i kursimit dhe kontrolli me anë të lekut.

6. — Me gjithë sukseset e mëdha që janë arritur në realizimin e planit të vitit 1957, ka ende të meta të shumta e të mëdha në punën tonë për realizimin e planit. Lufta për ngritjen e treguesve kualitativë të prodhimit (rritja e rendimentit të punës, ulja e kostos së prodhimit, shtimi i asortimenteve, përmirësimi i cilësisë së prodhimit) nuk është në lartësinë e duhur. Kapacitetet prodhuese nuk përdoren plotësisht, sidomos nga mosorganizimi i mirë i punës për realizimin ritmik të planit. Kalimi nga drejtimi «në përgjithësi» i ekonomisë në metodën e drejtimit konkret bëhet me ngadalë. Ka ende formalizëm dhe burokraci, kontrolli i zbatimit të detyrave është i dobët në të gjitha hallkat e aparateve ekonomike, shtetërore dhe të Partisë. Nuk tregohet interesimi i duhur nga organet shtetërore dhe të Partisë për forcimin organizativ dhe ekonomik të kooperativave bujqësore. Nuk ka ende një regjim të fortë kursimi në të gjitha ndërmarrjet ekonomike, shtetërore dhe kooperativiste. Puna për blerjen dhe grumbullimin e tepricave të produkteve bujqësore dhe blegtorale është ende e dobët. Sidomos puna e kooperativave të konsumit në këtë drejtim është shumë e dobët.

Në zbatimin e buxhetit janë konstatuar të meta si: mungesa e përpjekjeve për të gjetur burime të reja të ardhurash, disiplina e dobët në nxjerrjen e të ardhurave, sidomos për tatimet nga popullata, nuk është vendosur kudo një kontroll i rreptë në kryerjen e shpenzimeve dhe në financimin e ndërtimeve, nuk është arritur të sigurohen me kohë projektet dhe preventivat, organet financiare nuk futen sa duhet thellë në procesin e prodhimit e të shpërndarjes me anë të kontrollit dhe të analizave ekonomiko-financiare. Ka ende tendenca për kërkesa të fryra në shpenzime dhe nuk u vihet sa duhet fre shpenzimeve të panevojshme.

— II —

Duke u mbështetur në detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë sonë, në sukseset e arritura në dy vjetët e para të pesëvjeçarit të dytë, në mundësitë reale e materiale që ekzistojnë, Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë vendosi që shifrat kryesore për planin e shtetit të vitit 1958 të jenë si më poshtë:

1. — Volumi i përgjithshëm i prodhimit industrial në vitin 1958 të arrijë në 25 miliard e 747 milion lekë, ose 18 për qind më shumë se viti 1957 dhe 7 për qind më shumë nga sa ka qënë pa-

rashikuar në planin e dytë pesëvjeçar. Prodhimi i mjeteve të prodhimit të rritet 23 për qind kundrejt 10 për qind që ka qënë parashikuar në planin pesëvjeçar dhe prodhimi i mallrave të konsumit të rritet 15 për qind kundrejt 11 për qind që ka qënë parashikuar në planin pesëvjeçar.

Prodhimi industrial, sipas degëve, në vitin 1958 të rritet në këtë masë: industria e naftës 18 për qind, industria e bitumit 9 për qind, industria e qymyrgurit 14 për qind, nxjerrja e mineralit të kromit 20 për qind, industria e bakrit 18 për qind, industria elektrike 12 për qind, industria mekanike 18 për qind, industria e materialeve të ndërtimit 13 për qind, industria e drurit 17 për qind, industria e lehtë 23 për qind, industria ushqimore 11 për qind, industria lokale 27 për qind, sektori kooperativist 24 për qind.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave të rritë rendimentin e punës 7,5 për qind dhe të ulë koston 5 për qind, industria lokale të rritë rendimentin e punës 7 për qind dhe të ulë koston 6 për qind, kooperativat e artizanatit të rritin rendimentin e punës 10 për qind dhe të ulin koston 6 për qind, kooperativat e konsumit të rritin rendimentin e punës 29 për qind dhe të ulin koston 6 për qind. Rritja e rendimentit të punës për prodhimin e përgjithshëm industrial të jetë 8 për qind dhe nga kjo rritje të sigurohet rreth 51 për qind e rritjes së prodhimit industrial për vitin 1958.

2. — Volumi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor në vitin 1958 të arrijë në 28 miliard e 826 milion lekë, ose 24 për qind më shumë se në vitin 1957 dhe rreth 8 për qind më shumë nga sa parashikohet në planin e dytë pesëvjeçar.

Sipërfaqet e mbjella në vitin 1958 të rriten 7 për qind për të gjithë republikën, të hapen 22.160 ha toka të reja; mbjelljet e dyta të kapin 20 për qind të sipërfaqes së përgjithshme të mbjellë të republikës ose 126 për qind më shumë nga sa u realizua në vitin 1957. Prodhimi i drithërave të bukës të rritet 19,4 për qind ose 11,6 për qind më tepër nga sa parashikonte plani pesëvjeçar. Prodhimi i pambukut të rritet 26 për qind, i duhanit 26 për qind, i panxhar sheqerit 16 për qind.

Në vitin 1958 mekanizimi i punimeve bujqësore në fushë për fshatarësinë kooperativiste dhe individuale të arrijë këtë shkallë: plugimet 65 për qind, prashitjet 20 për qind, mbjelljet e pranverës 40 për qind, mbjelljet e vjeshtës 35 për qind, korrjet 30 për qind, shirjet 65 për qind. Numri i gjedheve të rritet 4,6 për qind, produktiviteti i lopëve mesatarisht për të gjithë republikën të rritet nga 590 litra qumësht në vit, në 655 litra. Numri i dhenve të rritet 12,6 për qind, i dhive 17 për qind, i derrave 84 për qind, i shpendëve 100 për qind. Mbjellja e vreshtave të rritet 526 për qind.

Në vitin 1958 të grumbullohen më shumë se në vitin 1957 drithëra buke 38 për qind, nga të cilat volumi i drithërave të bukës që do të grumbullohet nga tepricat të jetë dyfishi i realizimit të

vitit 1957, fasule të grumbullohen 30 për qind më shumë, pambuk 23 për qind, panxhar sheqerit 13 për qind, duhan 5 për qind, elb distik 34 për qind, perime 28 për qind, patate 98 për qind, fruta 106 për qind, rrush 84 për qind, qumësht 85 për qind, mish 15 për qind, lesh 41 për qind, vezë 42 për qind, gjalpë 78 për qind, djathë 120 për qind, lëkurë të imta 31 për qind.

3. — Volumi i përgjithshëm i transportit të mallrave me anë të automjeteve për të gjithë republikën të rritet 17 për qind dhe volumi i transportit me automjetet e Ministrisë së Komunikacionit të rritet 13 për qind. Volumi i përgjithshëm i transportit hekurudhor të mallrave të rritet 16 për qind dhe transporti detar 31 për qind, transporti i pasagjerëve të rritet 15 për qind. Rendimenti i punës në transport të rritet përgjithësisht 5 për qind dhe kostua të ulet 7,2 për qind.

4. — Volumi i përgjithshëm i investimeve në vitin 1958 të jetë 10 miliard e 373 milion lekë, ose 85 për qind më shumë se në vitin 1957 dhe 83 për qind më shumë nga sa parashikonte plani pesëvjeçar. Investimet në miniera të rriten 90 për qind, në industri 36 për qind, në bujqësi 108 për qind, në komunikacion 76 për qind, në arësim e kulturë 107 për qind, në shëndetësi 90 për qind, në shërbimet komunale 34 për qind.

Volumi i përgjithshëm i ndërtimeve në vitin 1958 të arrijë në 3 miliard e 553 milion lekë, ose 27 për qind më shumë se në vitin 1957 dhe 33 për qind më shumë nga sa parashikonte plani pesëvjeçar. Përfundimet e ndërtimeve në sektorët prodhues të jetë 71 për qind dhe në sektorët joprodhues 29 për qind. Të fillojë ndërtimi i hidrocentralit të Bisticës dhe ndërtimi i hidrocentralit të Shkopetit, në mënyrë që të dy këto hidrocentrale të vihen në shfrytëzim në vitin 1961-1962. Në vitin 1958 të ndërtohen 147.000 m² sipërfaqe banimi, ose 43 për qind më shumë se në vitin 1957. Rendimenti i punës në ndërtim të rritet 4 për qind dhe kostua të ulet 5,8 për qind.

5. — Volumi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave në vitin 1958 të arrijë në 19 miliard e 770 milion lekë, ose mbi 30 për qind më shumë se në vitin 1957 dhe 23 për qind më shumë nga sa ka qënë parashikuar në planin e pesëvjeçarit, duke rritur konsumin mesatar për frymë të popullsisë 27 për qind. Shpërndarja e mallrave të konsumit të gjerë mesatarisht për çdo frymë të popullsisë, në bazë të furnizimit nëpërmjet rrjetit të tregëtisë socialiste, të rritet në këtë masë: sheqer 14 për qind, sapun 37 për qind, tekstile të pambukta 8 për qind, tekstile të leshta 25 për qind, këpucë e opinga 47 për qind, dhe veç kësaj, konsumi mesatar për çdo frymë të qytetit të rritet: miellra buke 16 për qind, yndyrna 37 për qind, fasule e oriz 19 për qind, mish e peshk 21 për qind, djathë gjizë 102 për qind, perime e patate 30 për qind, qumësht 62 për qind.

Të bëhet një ulje e ndjeshme e çmimeve të mallrave të kon-

sumit të gjerë. Volumi i përgjithshëm i të ardhurave kombëtare të rritet rreth 20 për qind, të ardhurat e fshatarësisë të rriten 10 për qind dhe paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve të rritet 8,5 për qind.

Volumi i përgjithshëm i importit në vitin 1958 të jetë 60 për qind më i madh se në vitin 1957 dhe volumi i eksportit 12 për qind më i madh.

Numri i nxënësve në shkollat fillore të rritet 5 për qind, në shkollat shtatëvjeçare 8 për qind, në shkollat e mesme 22 për qind dhe në arësimin e lartë të ketë jo më pak se 3.000 vetë. Të hapen 75 kopshte të rinj për fëmijë, të ndërtohen 17 shkolla të reja shtatëvjeçare, 5 shkolla të reja të mesme, 2 shtëpi kulture, 57 shtëpi leximi.

Numri i institucioneve të mjekimit të rritet 6 për qind dhe numri i shtretërve në to 13 për qind; numri i vendeve në qerdhet dhe befotrofet të rritet 31 për qind.

— III —

Për të siguruar realizimin e detyrave të planit të vitit 1958 është e nevojshme që të mobilizohet e gjithë Partia, të gjitha organet shtetërore dhe ekonomike, të gjitha masat punonjëse. Duhet të merren të gjitha masat për të zhdukur të metat në punën tonë. Prandaj:

1. — *Të thjeshtojmë sa më shumë aparatet shtetërore, ekonomike dhe të Partisë, t'i afrohem më tepër bazës, të zgjerojmë kompetencat e organeve vartëse.*

Plenumi i Komitetit Qendror aprovon masat që ka marrë Byroja Politike për shkurtimin e organikave dhe thjeshtimin e aparateve drejtuese shtetërore, ekonomike dhe të Partisë. Kjo është një masë shumë e rëndësishme organizative. Ajo do të plotësohet me shkurtimin e afërt edhe të organikave të ndërmarrjeve ekonomike. Jo vetëm që shteti do të kursejë dhjetëra milion lekë në vit, por edhe puna operative do të shkojë shumë më mirë, burokracia do të luftohet më mirë dhe punonjësit do të lidhen më konkretisht me bazën, me prodhimin.

Për të pasur sukses të plotë puna e ndërmarrë nga Byroja Politike për thjeshtimin e aparateve drejtuese, kërkohet që këto masa organizative të mbështeten nga të gjitha organet e shtetit dhe të Partisë. Njerëzit që do të mbeten jashtë organikave duhet të vendosen në punë dhe në prodhim. Masat që janë duke u marrë për riorganizimin dhe shkurtimin e aparatit shtetëror të shërbejnë për të dërguar sa më shumë kuadro të aftë në prodhim në fshat, në lokalitetet dhe në kooperativat bujqësore. Të tregohet kujdes i veçantë me rastin e shkurtimit të organikave që

të mbahen sa më shumë gra në aparatet administrative ku puna mund të kryhet prej tyre dhe të dërgohen sa më shumë burra në prodhim. Çështja e thjeshtimit të aparateve drejtuese duhet të mbahet ngritur vazhdimisht.

Këshilli i Ministrave të studjojë me kujdes kompetencat e organeve shtetërore duke u lënë më shumë kompetenca dhe iniciativë, gjë që do të ndihmojë në përmirësimin e punës dhe në forcimin e ndjenjës së përgjegjësisë në organet shtetërore.

2. — *Të organizojmë më mirë ndihmën dhe kontrollin e zbatimit të detyrave nga organet më të larta ndaj organeve më të ulëta.*

Për t'ja arritur këtij qëllimi, në radhë të parë, duhet luftuar si një metodë e dëmshme dhe krejtësisht burokratike metoda e kontrollit formal, kur njerëzit shkojnë në bazë për kontroll dhe nuk i zgjidhin problemet që konstatojnë. Kjo metodë burokratike duhet zëvendësuar me metodën e drejtë, sipas së cilës për ndihmë dhe kontroll në bazë duhet të dërgohen kuadrot kryesorë, njerëzit më me eksperiencë dhe me kompetenca të plota. Metoda e drejtë e ndihmës dhe e kontrollit kërkon që të përmbushen dy kushte kryesore, së pari, që ai që kontrollon, qoftë individ ose grup, të jetë i plotfuqishëm nga dikasteri ose enti që e dërgon për kontroll për të zgjidhur në vend të gjitha problemet që i takojnë dikasterit ose entit në emër të të cilit ai kontrollon, përveç ndonjë çështjeje të rëndësishme që kërkon studim dhe, së dyti, të organizohet rikontrolli i vazhdueshëm për zbatimin e detyrave që i janë lënë entit të kontrolluar. Nga ana tjetër të merren masa efektive për thjeshtimin e aparateve shtetërore dhe ekonomike, si edhe për të shkurtuar në mënyrë të ndjeshme evidencat dhe formularët e ndryshëm.

3. — *Të marrim masat për të siguruar realizimin ritmik të planit.*

Për këtë, në radhë të parë, është e nevojshme që në çdo ndërmarrje të sigurohet një rezervë minimale materialesh dhe lëndë të parë, lëndësh djegëse dhe karburantësh në sasi të mjaftueshme për 1-3 muaj prodhim, pa ndërprerje. Viti 1958 të jetë viti i forcimit të kësaj rezerve në të gjitha ndërmarrjet. Veç kësaj, puna dhe lufta në ndërmarrje për realizimin e planit të një periudhe të caktuar nuk duhet të shkëputet, por duhet të plekset me punën përgatitore për organizimin e prodhimit për periudhën pasardhëse. Organizatat e Partisë dhe udhëheqjet e ndërmarrjeve prodhuese duhet të sigurojnë mobilizimin e vazhdueshëm të kolektivit punonjës, pa lënë që të bjerë tensioni i punës, sikurse është vërtetuar gjer më sot në fillim të periudhës së planit.

4. — *Lufta për përmirësimin e cilësisë së prodhimit dhe shtimitin e asortimenteve duhet të ngrihet në një nivel më të lartë.*

Për këtë është e nevojshme që dikasteret prodhuese ta kon-

siderojnë çështjen e përmirësimit të cilësisë dhe shtimin e asortimenteve të prodhimit si një nga detyrat më kryesore. Vlera e mallrave të prodhuara nga një ndërmarrje jashtë standardit dhe me cilësi të keqe t'i zbritet ndërmarrjes nga volumi i përgjithshëm i prodhimit të saj, kur bëhet vlerësimi i realizimit të planit të kësaj ndërmarrjeje, dhe po kështu të veprohet dhe në shkallë dikasteriale. Të ndalohej rreptësisht shitja e mallrave me çmime të padiferencuara. Mallrat këtej e tutje duhet të shiten me çmime të diferencuara, në bazë të cilësisë dhe të asortimentit. Të rishikohen asortimentet e vjetra çdo vit, me qëllim që të përmirësohen dhe të punohet seriozisht për krijimin e asortimenteve të reja. Këshilli i Ministrave të organizojë një kontroll më të fortë drejtpërdrejt në bazën e prodhimit, për të siguruar respektimin e standardeve shtetërore dhe cilësinë e mallrave që prodhohen. Organizatat e Partisë në të gjitha qendrat e prodhimit, si dhe të gjitha organet ekonomike dhe të gjithë punonjësit e prodhimit duhet të mobilizohen për të realizuar kthesën në lidhje me përmirësimin e cilësisë së prodhimit.

5. — *Duhet të merren masa për kapërcimin e vështirësive në realizimin e planit të industrisë ushqimore në përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale.*

Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe ndërmarrjet vartëse të tyre të marrin të gjitha masat për të bërë që viti 1958 të jetë viti i kthesës në përmirësimin e përgjithshëm të punës së industrisë ushqimore, sidomos në grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale.

Duhet t'i kushtohet vëmendje e posaçme grumbullimit dhe përpunimit të qumështit. Për këtë duhet që të zgjerohet në mënyrë të konsiderueshme rrjeti i baxhove. Fshatarët individualë ose kooperativat bujqësore që marrin kullota shtetërore duhet t'ja shesin qumështin shtetit ose kooperativave të konsumit, të punohet me kooperativat bujqësore që qumështin e prodhuar nga bagëtitë kolektive t'ja shesin shtetit, ndërsa nevojat e kooperativistëve për bulmetra të plotësohen nga bagëtia personale e oborreve kooperativiste.

Të merren masa për të shtuar efektivisht asortimentet e prodhimit të artikujve ushqimorë. Të zgjerohet kapaciteti i kantinave dhe i punishteve të rrushit, në përputhje me perspektivën e zhvillimit të vitikulturës. Të merren masat për sigurimin e lëndës së parë për fabrikat e konservave, të sigurohet ambalazhimi i nevojshëm, etiketat përkatëse, etj. Të merren masa serioze për uljen e kostos dhe për përmirësimin e cilësisë në të gjithë industrinë ushqimore.

6. — *Të marrim masat për të siguruar forcimin e metejshëm*

të regjimit të kursimit, rritjen e rendimentit të punës dhe uljen e kostos.

Për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit, për rritjen e rendimentit të punës dhe për uljen e kostos duhet të mobilizohen të gjitha organet shtetërore, ekonomike dhe të Partisë, të gjithë punonjësit. Duhet të merren masa për të ndaluar investimet dhe shpenzimet e kota dhe jo produktive, të vendoset rregulli dhe disiplinë në dhënjen e punës me akord në ndërtimet, për të mos lejuar shpërdorimet dhe spekulimin. Titullarët e dikastereve qendrore duhet të shqyrtojnë me kujdes kërkesat për import dhe të mos lejojnë që të importohen mallra të panevojshme dhe që mund të sigurohen në vend.

Si ministritë dhe entet e tjera qendrore, ashtu edhe ndërmarrjet e tyre vartëse dhe organizatat e Partisë në qendrat e prodhimit duhet t'i japin rëndësi më tepër organizimit të punës për rritjen e rendimentit të punës dhe për uljen e kostos. Shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve prodhuese, lufta kundër ndërprerjeve dhe ndalesave në punë, përgatitja profesionale dhe kualifikimi i kadrove, përhapja e eksperiencës së përparuar, tejkalimi i normave ekzistuese të punës dhe vendosja e normave të reja më të përparuara, të gjitha këto janë masa të domosdoshme që duhet të merren për të rritur rendimentin e punës. Shkurtimi i shpenzimeve jo prodhuese, forcimi i gjithanshëm i regjimit të kursimit, kursimi i materialeve dhe i lëndëve të para, i lëndëve djegëse dhe i karburanteve janë masat më të rëndësishme që duhet të vihen në jetë për uljen e kostos. Organet dhe organizatat e Partisë duhet të bëjnë një punë edhe më të madhe për të rritur shpejtësi dhe nënërgjegjen e çdo punëtori nevojën e luftës së vazhdueshme për forcimin e regjimit të kursimit, për rritjen e rendimentit të punës dhe për uljen e kostos.

7. — *Duhet të përmirësohet më tej puna e komiteteve ekzekutive dhe e komiteteve të Partisë në bazë.*

Detyrat e vitit 1958 janë të mëdha. Për t'i realizuar ato kërkohet që komitetet ekzekutive dhe të Partisë të kuptojnë mirë rëndësinë e këtyre detyrave dhe të mos kënaqen me sukseset e arritura deri më sot.

Komitetet ekzekutive të rretheve duhet të merren më seriozisht me realizimin e planit të grumbullimeve të prodhimeve bujqësore e blegtorale, me përmirësimin e shërbimeve komunale, me arësimin dhe shëndetësinë. Ato duhet të thellohen më tepër në njohjen e agroteknikës, të përqëndrohen më tepër në çështjet ekonomiko-organizative të kooperativave bujqësore, të zgjidhin drejt kërkesat e popullit.

Komitetet e Partisë të rretheve duhet të futen më thellë në çështjet e brendshme të organizatave bazë të Partisë, për të aktivizuar më tepër çdo komunist individualisht, që ky të bëhet shem-

bull përpara të tjerëve në kryerjen e detyrave. Të punojnë më tepër për ngritjen ideo-politike të komunistëve dhe të masave për t'i bërë masat sa më të ndërgjegjshme për detyrat e reja dhe shumë të rëndësishme. Të organizojnë më mirë emulacionin socialist në punë dhe të vënë në lëvizje hallkat e Partisë: Bashkimet Profesionale, organizatën e rinisë, organizatën e Frontit, organizatën e gruas.

8. — Duhet të kthejmë më tepër vëmendjen nga bujqësia.

Detyrat që cakton plani i vitit 1958 në lëmin e bujqësisë janë të mëdha dhe për t'u realizuar ato duhet që të mobilizohet e gjithë Partia, të gjitha organet shtetërore, e gjithë fshatarësia. Në lëmin e prodhimit bujqësor duhet të merren këto masa:

a) Të kryejmë mirë dhe me kohë të gjitha përgatitjet për mbjelljet e pranverës. Të marrin masa për ruajtjen e vlagës, duke praktikuar gjerësisht lesimin pas çdo punimi të tokës, kur thasësira rrezikon zhdukjen e vlagës. Gjatë kohës kur nuk ka punime bujqësore forcat punonjëse në fshat të shfrytëzohen për pastrimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse, për sistemimin e fushave, prishjen e gjerdheve dhe zgjerimin e tokave, të merren masa me kohë për mbjelljen e rasateve të duhanit si dhe të farërave të tjera për mbjelljet pranverore, të organizohet më mirë lufta kundër dëmtuesve të bimëve dhe sidomos kundër krimbit të misrit, duke mbledhur e duke djegur kallamishtet e misrit.

b) Mbjellja e duhanit duhet të kryhet brenda këtyre afateve: 10-30 prill në zonat bregdetare dhe 20 prill-15 maj në zonat fushore. Dendësia e bimëve për hektar për duhanin të jetë sipas këtyre normave: për duhanet e vendit 60-70.000 bimë për hektar, për duhanet orientale të varieteteve «bashiballi», «samsun», «perustica» dhe «basma nr. 40» 100-120.000 bimë për hektar dhe për duhanet orientale «basma» 150-160.000 bimë për hektar.

Mbjellja e pambukut duhet të fillojë qysh në fillim të prillit, të vihen forcat që mbjellja të mbarojë deri më 1 maj, duke siguruar 80-100.000 bimë për hektar për pambukun e varietetit «108-F» dhe 90-100.000 bimë për hektar për varietetin «12-98». Mbjellja e panxharit të sheqerit duhet të mbarojë brenda muajit mars dhe jo më vonë se në 6 prill, duke siguruar 100-110.000 bimë për hektar.

c) Të merren të gjitha masat për të siguruar gatishmërinë teknike të traktorëve dhe të maqinave bujqësore, që ato të punojnë pa difekte dhe me cilësi të mirë. Të shfrytëzohet sa më mirë parku i traktorëve dhe i maqinave bujqësore, duke përdorur mekanizmat bujqësore në të gjitha proceset e punës sipas planit; këtë vit të zgjerohet mbjellja e misrit dhe e pambukut me fole katrore.

ç) Të mobilizohet e gjithë fshatarësia për grumbullimin sa më shumë dhe për përdorimin gjerësisht të plehut natyral; kjo duhet të bëhet një fushatë e madhe dhe e përhershme, çdo vit dhe gjatë gjithë stinave të vitit.

d) Të merren të gjitha masat përgatitore për të shkurtuar në maksimum afatin e korrjeve dhe të shirjeve; korrjet duhet të mbarojnë brenda 10 ditëve në një zonë të caktuar dhe të bëhen pa firo. Për fushatën e korrjeve dhe të shirjeve duhet të shfrytëzohen mirë kombajnat dhe autokombajnat, maqinat korrëse dhe shirëse si dhe të gjitha forcat e fshatarësisë punonjëse. Shirjet duhet të marrin fund jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të korrjeve.

dh) Organizatat e Partisë dhe organet shtetërore, sidomos specialistët e blegtorisë në rrethe dhe në bazë të marrin masat tekniko-organizative të nevojshme dhe të punojnë me masat punonjëse të fshatarësisë me kooperativat bujqësore për realizimin me sukses të detyrave që shtrohen për ndërzimin artificial të dhenve dhe të lopëve dhe për sigurimin e bazës ushqimore të blegtorisë. Viti 1958 duhet të shënojë një kthesë rënësore në realizimin e mbjelljeve të dyta për misër foragjer dhe hasëll për të siguruar ushqime të mjaftueshme për blegtorinë. Në përgatitjen e silazhit një ndihmë të madhe duhet të japin SMT-të me anën e maqinave grirëse të silazhit.

e) Të vazhdojë zgjerimi i kolektivizimit të bujqësisë, duke u orientuar që në vitin 1958 të marrë fund në përgjithësi kolektivizimi i bujqësisë në tokat fushore. Të mbahen gjithnjë parasysh porositë e Partisë që pjesëmarrja e fshatarëve në kooperativat të bëhet me vullnet të plotë dhe me bindje, duke bërë me ta një punë të vazhdueshme sqaruuese. Ministria e Bujqësisë dhe organet e Partisë dhe të pushtetit në bazë të merren më seriozisht me forcimin organizativ të kooperativave bujqësore dhe sidomos t'u japin ndihmë të veçantë kooperativave të reja.

ë) Ndërmarrjet bujqësore të shtetit duhet të përqëndrojnë vëmendjen e tyre në realizimin e planit të prodhimit në të gjitha zonat e planifikuara. Të marrin masa për organizimin më të mirë të punës për pakësimin e shpenzimeve dhe uljen e kostos, e cila është akoma e lartë. T'i kushtojnë kujdes të veçantë blegtorisë, sigurimit të ushqimit, luftimit të sëmundjeve, rritjes së përqindjes së pjellshmërisë, realizimit të planit të qumështit, të mishit dhe të leshit. Rëndësi të veçantë t'u kushtojnë perimeve, pemëve frutore dhe mbjelljes të vreshtave të reja.

f) Këshilli i Ministrave të nxjerrë dispozita ligjore, me anën e të cilave të përcaktohen masat dhe mënyra e pjesëmarrjes së fshatarësisë në veprat e mëdha të bonifikimeve dhe të vaditjes që ndërmerr shteti.

g) Komiteti Qendror porositi organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe u bënë thirrje kooperativave dhe fshatarësisë punonjëse që t'i kushtojnë kujdes të veçantë blegtorisë, ushqimit dhe strehimit të saj, shtimit numerik dhe përmirësimit të racës, veçanërisht të tregohet kujdes për shtimin e lopëve në zonat fushore dhe për rritjen e produktivitetit të tyre. Kooperativat bujqësore

duhet të formojnë tufat e lopëve të tyre, duke u mbështetur në burimet e tyre të brendshme: në lopët kolektive që kanë sot dhe në viçat femra që duhet të blejnë çdo vit nga oborret kooperativiste. Rritja e produktivitetit të lopëve duhet të arrihet kryesisht nëpërmjet përmirësimit të bazës ushqimore të tyre si edhe me anën e kryqëzimit për përmirësimin e racës. Në lidhje me çështjen e shtimit të numrit të lopëve dhe të produktivitetit të tyre të organizohet së afërmi nga Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave një aktiv i gjerë bujqësor në shkallë kombëtare, ku të përcaktohen masat konkrete që duhen marrë në këtë drejtim.

gj) Grumbullimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale duhet të konsiderohet si një detyrë shumë e rëndësishme nga ana e organeve të Partisë dhe të shtetit dhe nga e gjithë fshatarësia. Kjo është vendimtare për përmirësimin e gjendjes materiale të punonjësve. Të merren masa për zhdukjen e të metave që u konstatuan vitin e kaluar për grumbullimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Të organizohet më mirë puna për grumbullimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, organet grumbulluese, sidomos kooperativat e konsumit, të lidhin me kohë kontratat me kooperativat bujqësore dhe fshatarësinë, të sigurohen depot dhe të zgjerohet rrjeti i pikave të grumbullimit. Vlerësimi i punës së një kooperative bujqësore, të një komiteti ekzekutiv, ose të një komiteti partie të një rrethi duhet të bëhet kryesisht nga shkalla e realizimit të planit të prodhimit dhe të grumbullimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, në radhë të parë nga shkalla e grumbullimit të tepricave të drithit. Çështja e grumbullimit të tepricave duhet të bëhet çështje e madhe nderi dhe patriotike për gjithë fshatarësinë; realizimi i kësaj detyre të shërbejë për forcimin e lidhjeve midis fshatit dhe qytetit, si një masë që forcon aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse.

9. — *Të marrim masa për forcimin e mëtejshëm të disiplinës financiare.*

a) Ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike, ministritë dhe institucionet e ndryshme, Ministria e Financave dhe organet e tjera të sistemit financiar duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të plotësuar me sukses detyrat e buxhetit të vitit 1958 për të siguruar financimin e rregullt të planit për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë.

Ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike duhet të konsiderojnë si një tregues kryesor të punës së tyre plotësimin e detyrimeve ndaj buxhetit dhe t'i kushtojnë një vemendje të veçantë zbatimit dhe tejkalimit të detyrës për uljen e kostos, e cila është burimi kryesor për rritjen e akumulimit.

Ministria e Financave dhe organet e sistemit financiar, nëpërmjet kontrollit dhe analizave ekonomiko-financiare, duhet të thellohen më shumë në procesin e prodhimit e të shpërndarjes dhe

të marrin e të propozojnë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin me sukses të buxhetit.

b) Të përmirësohet edhe më tej puna për planifikimin dhe përdorimin e kreditit, në mënyrë që ky të bëhet një armë gjithnjë më e fortë për të kontrolluar veprimtarinë e ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike.

c) Ministria e Financave dhe komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë duhet të përmirësojnë punën në lidhje me caktimin dhe nxjerrjen me kohë të tatimeve e të taksave nga fshatarësia. Ministria e Financave duhet të marrë masat për zgjerimin e depozitave të kursimeve dhe të sigurimeve shtetërore, sidomos në fshat, dhe të studjojë brenda 6-mujorit të parë 1958 forma të reja që do të stimulojnë shtimin e depozitave në arkat e kursimit.

Duke patur parasysh ndryshimet e mëdha që ndodhin në fshat dhe konditat e krijuara pas heqjes së triskave, Ministria e Financave të studjojë përmirësimin e dispozitave në lëmin e tatimeve, duke caktuar me kritere më të drejta si të ardhurat e tatueshme të kooperativave bujqësore, ashtu dhe vetë tarifat e tatimit mbi punëtorët, nëpunësit etj. lidhur me përjashtimin nga tatimi të rrogave të vogla etj.

c) Ministria e Financave duhet të përmirësojë punën për planifikimin, financimin dhe kontrollin e zbatimit të shpenzimeve të buxhetit. Të forcohet puna e organeve të kontroll-revizionit të Ministrisë së Financave dhe të të gjitha ministrive. Kontroll-revizioni të jetë i shpejtë, operativ dhe preventiv, të zbulojë në kohë shkeljet e disiplinës financiare dhe me punën e tij të kontrollojë e të ndihmojë për përmirësimin e gjendjes financiare dhe kontabël. Për shpenzimet e paparapara që lindin gjatë zbatimit të buxhetit, të zbatohet pa asnjë lëshim rregull që sektorët përkatës të sigurojnë burime plotësuese të ardhurash ose pakësim në shpenzimet e aprovuara. Ministritë e ndryshme dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore duhet të mos angazhojnë qysh në fillim të gjitha fondet që u janë akorduar, por të mbajnë pa shpërndarë një rezervë për të përballuar nevojat e reja; gjithashtu gjatë ndjekjes së zbatimit të buxhetit të praktikojnë, ku ka mundësi, caktimin e detyrave plotësuese për të shtuar të ardhurat ose për të pakësuar shpenzimet e buxhetit.

d) Ministria e Ndërtimit të marrë masa serioze që brenda vitit 1959 të arrihet që të përpilohen projektet teknike dhe preventivat para fillimit të ndërtimit të objekteve. Banka e shtetit të forcojë kontrollin mbi organizatat e ndërtimit.

dh) Ministria e Financave dhe organet e saj, ministritë e ndryshme dhe ndërmarrjet e organizatat ekonomike duhet të shtojnë përpjekjet për forcimin e vazhdueshëm të hozrashotit dhe të regjimit të kursimit. Të shqyrtohen dhe të përmirësohen dispozitat që stimulojnë zbatimin dhe tejkalimin e detyrave të planit e të

buxhetit dhe të mos lejohen shtigje që dëmtojnë hozrashotin. Të merren masa për të zhdukur shkaqet që kanë lejuar krijimin e debi-kredive të shumta midis ndërmarrjeve. Të kontrollohet nga afër dhe sistematikisht veprimtaria e ndërmarrjeve që punojnë pa rentabilitet ose dalin me humbje të parapara dhe të forcohet përgjegjësia e drejtuesve të ndërmarrjeve për mosrealizimin e detyrave ndaj planit dhe buxhetit të shtetit.

e) Ministria e Financave, Banka e shtetit, ministritë, komitetet ekzekutive dhe të gjithë sektorët e ekonomisë, si dhe komitetet e Partisë të luftojnë me këmbëngulje për zbatimin e plotë të planeve të arkës dhe rritjen e shpejtësisë së qarkullimit të monedhës. Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i fuqisë blerëse të monedhës duhet të konsiderohet si tregues më i rëndësishëm për vlerësimin e punës së Bankës së shtetit dhe të Ministrisë së Financave.

10. — *Të forcojmë punën e Partisë në lëmin e financave.*

1. — Komitetet e Partisë ta konsiderojnë si problem të rëndësishëm dhe të merren më shumë me çështjet ekonomike-financiare të rrethit të tyre. Herë pas here të shqyrtojnë buxhetin, të marrin masat e nevojshme për shtimin e të ardhurave dhe për vendosjen e regjimit të kursimit në shpenzimin e lekut të popullit, të ndjekin me kujdes përdorimin e kthimin e kreditit agrar etj.

2. — Komitetet dhe organizatat e Partisë të shtojnë kujdesin e tyre për zbatimin e ligjëshmërisë dhe të disiplinës financiare. Një vëmendje e madhe t'i kushtohet ruajtjes së fondeve buxhetore nga përdorimet jo të drejta. Krahas me këtë të tregohet kujdes në dhënjen e favoreve ose kur bëhen përjashtime të tatimit në akordimin e pensioneve, të shpërblimeve të nënave me shumë fëmijë etj. Këto probleme të analizohen herë pas here nga komitetet e Partisë.

3. — Komitetet e Partisë të mbajnë afër organizatat e Partisë të organeve financiare dhe të bankës. Një kujdes më i madh t'i kushtohet zgjedhjes, vendosjes dhe edukimit të kuadrove dhe punonjësve të organeve financiare dhe të bankës, duke shtuar pjesëmarrjen e komunistëve dhe të grave në këta sektorë.

* * *

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH ka besim të plotë se klasa punëtore, fshatarësia punonjëse, inteligjencia popullore, të gjitha organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë do të mobilizohen plotësisht dhe do të venë të gjitha forcat e tyre për realizimin dhe tejkalimin e planit të vitit 1958.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH.

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 34,
datë 9 shkurt 1958

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË
PUNËS TË SHQIPËRISË

«MBI SHITESAT NË PLANIN E DYTË PESËVJEÇAR PËR
ZHVILLIMIN EKONOMIK E KULTURAL TË REPUBLIKËS
POPULLORE TË SHQIPËRISË»

5 shkurt 1958

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë i mbledhur nga 3 deri më 5 shkurt 1958, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, shokut Enver Hoxha, pasi dëgjoi dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike, mbajtur nga shoku Spiro Koleka, «Mbi shtesat në planin e dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë»,

K o n s t a t o i :

1. — Vendimet historike të Kongresit III të Partisë ngjallën në popullin tonë energji të veçanta dhe një besim gjithmonë e më të madh në drejtësinë dhe urtësinë, me të cilat udhëheq Partia popullore në rrugën e lavdishme të ndërtimit të socializmit. Populli dhe Partia bashkuan si një trup, më fort se kurrë. . .

2. — Direktivat e planit të dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë, të vendosura nga Kongresi III i Partisë, u pritën dhe u përfaquan me gatishmëri dhe besim të madh nga populli ynë. Ai pa në to, siç ka parë kurdoherë në programet e Partisë, detyrat historike që i shtroheshin për ndërtimin e jetës së re, më të begatshme, të socializmit. Kolektivat punonjësë kudo, në miniera dhe në fabrika, në qendrat e transportit dhe në kantieret e ndërtimit, në NBSH-të dhe në SMT-të, në kooperativat bujqësore etj. i bënë të tyre këto direktiva dhe muarën zotime të guximshme për arritjen dhe tejkalimin e detyrave që u shtroheshin.

3. — Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria i kanë mbajtur vazhdimisht të ngritura detyrat që shtroi Kongresi III i Partisë për zhvillimin ekonomik dhe kultural, duke i pasqyruar më së miri në planet e viteve 1956 dhe 1957 dhe duke i bërë sidomos probleme të vazhdueshme të Partisë dhe të pushtetit në qendër dhe në periferi, të organizatave bazë të Partisë në qendrat e punës dhe në fshat dhe të të gjitha organizatave ekonomike.

4. — Përfundimet e mira të arritura në kryerjen e detyrave të vitit të parë të pesëvjeçarit... puna e madhe e ndërmarrë nga Komiteti Qendror dhe qeveria për hartimin e projektplanit perspektiv dhe për zbulimin e mundësive të brendshme për arritjen dhe tejkalimin e pesëvjeçarit të dytë bënë që emulacioni për arritjen dhe tejkalimin e detyrave të vitit 1957 të marrë përpjesëtime të mëdha, sidomos për nder të 40-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit, të 16-vjetorit të themelimit të Partisë dhe të 45-vjetorit të shpalljes së pavarësisë kombëtare, dhe të bëhet një forcë e madhe nxitëse në arritjen dhe tejkalimin e detyrave të planit.

5. — Si rrjedhim i sa u tha më sipër, në mbarimin e dy vjetëve të parë të pesëvjeçarit të dytë, përfundimet konkrete janë:

A. — Në *prodhimin industrial*: Vëllimi i përgjithshëm është arritur 102,7 për qind, nga i cili prodhimi i Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave 104,2 për qind, i krejt sektorit shtetëror 103,9 për qind, i Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit 106,6 për qind dhe i Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit 80,9 për qind. Ritmi mesatar i rritjes së prodhimit industrial, nga 15 për qind që parashikohej në të dy vjetët, ka qenë 16,4 për qind.

Në degët e prodhimit të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, me përjashtim të degëve të qymyrgurit, të bakrit dhe të drurit, që arritën parashikimet secila deri në 99 për qind, të gjitha degët e tjera arritën dhe tejkaluan parashikimet.

Janë arritur përfundime të mira në shpimet nga industria e naftës; duke e tejkaluar detyrën 10 për qind, vëllimi i shpimeve të kryera gjatë të dy vjetëve është barazi me 66,5 për qind të të gjitha shpimeve të naftës gjatë pesëvjeçarit të parë. Ky sukses u kurorëzua me shpërthimin e njohur të pusit «542», i cili i hapi perspektiva të mëdha zhvillimit të industrisë së naftës në vendin tonë.

B. — Në *prodhimin bujqësor*: Gjatë këtyre të dy vjetëve ka përparime të dukshme kundrejt pesëvjeçarit të parë në NBSH-të, në SMT-të dhe në sektorin kooperativist. NBSH-të janë duke hyrë në një fazë të re të kryerjes më mirë të detyrave. SMT-të janë forcuar dhe kanë filluar të luajnë më mirë rolin që u është ngarkuar; detyrat e të dy vjetëve këto i arritën 110 për qind, që është barazi me 130 për qind të volumit të punës së kryer gjatë gjithë pesëvjeçarit të parë. Lëvizja kooperativiste në fshat gjatë këtyre dy vjetëve ka bërë hapa të mëdha përpara në forcimin ekonomik dhe në zhvillimin numerik, tej parashikimeve nga 318 kooperativa bujqësore më 15.315 familje, që ishin në fund të vitit 1955, me 14,48 për qind të tokave të mbjella të republikës, në fund të vitit 1957 numri i tyre ka arritur në 1.698, me 74.764 familje dhe me 58,1 për qind të tokave të mbjella të fshatarësisë. Në fund të vitit

1957 sektori socialist i bujqësisë zinte 60,7 për qind të tokave të mbjella të republikës.

Gjatë dy vjetëve janë hapur rreth 40 mijë ha toka të reja, barazi me 53 për qind të detyrës së pesë vjetëve. Plani i mbjelljeve për bimët kryesore është realizuar. Rendimenti i bimëve si republikë, me përjashtim të duhanit, nuk është realizuar, veçse në vitin 1957 ka qenë më i lartë se në vitin 1956. Në NBSH-të dhe në shumicën e kooperativave bujqësore rendimenti ka qenë më i lartë se në fshatarësinë individuale. NBSH-ja e Maliqit ka marrë 23 kv/ha grurë dhe 343,7 kv/ha panxhar sheqeri, NBSH-ja e Kamzës 15,2 kv/ha grurë, NBSH-ja e Sukthit 171,8 kv/ha perime, kooperativat e Maminasit dhe të Cakranit, në toka të paujitura, kanë marrë prej 14 gjer më 20 kv/ha pambuk; rrethet Berat, Fier, Lushnjë dhe Durrës arritën dhe tejkaluan detyrat e vitit 1957 në prodhimin e pambukut. Qarqet Shkodër dhe Elbasan arritën dhe tejkaluan detyrat e vitit 1957 në prodhimin e duhanit. Kooperativat e Dobraçit, Grilit, Boksit, Shtërmënit, Shalësit, Kojanit, etj. kanë marrë mesatarisht mbi 13 kv/ha duhan. Qarku i Korgës arriti dhe tejkaloi detyrat e prodhimit të panxharit të sheqerit të vitit 1957, kooperativa e Libonikut mori 340 kv/ha, e Vashtëmisë 223 kv/ha etj.

C. — Në *investimet dhe në ndërtimet*: Investimet e parashikuara për të dy vjetët janë kryer në masën 94,4 për qind, ndërsa ndërtimet 104,4 për qind. Ndërmarrjet shtetërore të Ministrisë së Ndërtimit detyrat e dy vjetëve i tejkaluan në masën 7,5 për qind, kurse ndërmarrjet lokale detyrën e arritën 93 për qind. Ndërtimet që kryhen nga vetë investitorët për të dy vjetët u tejkaluan 6,2 për qind. Disa qindra vepra ndërtimi janë përfunduar gjatë këtyre të dy vjetëve dhe janë dhënë për shfrytëzim. Në ndërtim janë hedhur hapat e para në drejtim të parafabrikimit të ndërtesave të banimit, është shkuar më përpara me mekanizimin e punimeve, është përmirësuar puna në projektin, në drejtim të uljes së kostos në ndërtimet.

Ç. — Në *transportet e Ministrisë së Komunikacionit*: Për të dy vjetët transporti i mallrave është arritur me automjete 101,3 për qind në ton dhe 97,7 për qind në ton/km, me tren 106,5 për qind në ton dhe 104,7 për qind në ton/km. dhe me det 66,6 për qind në ton dhe 113,5 për qind në ton/mila. Parashikimi në transportimin e udhëtarëve është arritur 109,9 për qind si numër dhe 93,5 për qind si udhëtarë/km. Rritja e përkohshme mesatar ditore të kamionave nga 137,2 km. më 1955, në 142,16 më 1957 dhe e koeficientit të përdorimit të tyre nga 57,14 më 1955, në 60,73 më 1957, rritja e përkohshme mesatar ditore të trenave të mallrave nga 53,65 km më 1955, në 57,49 km. më 1957 dhe e koeficientit të përdorimit të tyre nga 38,1 më 1955, në 40,45 më 1957 dhe rritja e përkohshme mesatar ditore të mjeteve detare nga 58,2 mila më 1955, në 96,49 mila më 1957 tregojnë se klasa punëtore në transportet tona shkon përpara me sukses.

D. — Në përmirësimin e jetesës së masave punonjëse: Gjatë këtyre dy vjetëve janë arritur përfundime të mira: dy ulje çmimesh, ngritja e rrogave të ulëta në vitin 1956 dhe heqja e plotë e triskave gjatë vitit 1957 janë fitore të mëdha të popullit dhe të Partisë sonë. Shitja e mallrave nga tregëtia socialiste është rritur 96 për qind, nga Ministria e Tregëtisë 97,1 për qind, nga NSHFP-ja 109,3 për qind, nga Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit 95,8 për qind dhe nga Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve 76,3 për qind. Gjatë dy vjetëve u dhanë për shfrytëzim 167.500 m² banesa.

Depozitat në arkat e kursimit në fund të vitit 1957 kanë qenë 212 për qind kundrejt fundit të vitit 1955.

Qarkullimi i mallrave në tregëtinë e jashtme është shtuar mjaft në këto dy vjet; vitin e kaluar ka qenë rreth 38,2 për qind më i madh se në vitin 1955.

Dh. — Në veprimtarinë kulturalo-shoqërore: Janë arritur gjithashtu përfundime të mira. Detyrat e caktuara në lëmin e edukimit, me përfundim të arësimit shtatëvjeçar, janë kryer. Gjatë këtyre dy vjetëve janë hapur 59 shkolla shtatëvjeçare, 21 të mesme dhe qendra më e madhe e arësimit dhe e dijes, Universiteti shtetëror. Në të dy vjetët janë përgatitur rreth 1.900 teknikë të mesëm në teknikumet e ditës dhe të natës dhe kanë mbaruar shkollat e larta, në vend dhe jashtë shtetit, 800 vetë. Detyrat për përgatitjen e kuadrit në përgjithësi janë arritur dhe tejkaluar. Është zgjeruar rrjeti i institucioneve shëndetësore dhe është rritur 5 për qind numri i shtretërve në to, kundrejt vitit 1955.

6. — Me gjithë këto përfundime të mira që janë arritur nga klasa jonë punëtore heroike, nga fshatarësia patriotike dhe nga inteligjencia popullore, nën udhëheqjen e urtë të Partisë... Plenumi i Komitetit Qendror vëren se ka ende dobësi në metodën e drejtimit të çështjeve ekonomike, në luftën kundër burokracisë dhe zvarritjes së çështjeve, në kontrollin e zbatimit të vendimeve, në punën ritmike për kryerjen e detyrave të planit, në shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese të fabrikave dhe në përgjithësi të maqinerisë, në llojet dhe në cilësinë e prodhimeve dhe në luftën për ngritjen e rendimentit në punë, për sa më shumë kurseme në të gjitha drejtimet dhe për uljen e kostos. Plenumi vëren gjithashtu se mosarritja e detyrave të parashikuara në një seri prodhimesh shumë të rëndësishme për jetën e popullit, siç janë perimet dhe patatet, peshku, bulmetrat, mobiljet dhe orenditë, poçeritë, tullat dhe tjegullat etj., ka krijuar vështirësi jo të vogla në furnizimin e popullit. Sasia e pakënaqshme gjithashtu që është arritur, kundrejt parashikimeve, në grumbullimin e tepricave të drithërave të bukës ka krijuar boshllëqe të ndjeshme për shtetin në bilancin e drithërave. Plenumi i Komitetit Qendror ka besim të plotë se Partia, klasa punëtore, fshatarësia dhe inteligjencia popullore do

t'u bëjnë një luftë më të vendosur këtyre dobësive dhe me entuziazmin dhe ndërgjegjen në punë që i karakterizon do të mbulojnë çdo boshllëk të këtyre dy vjetëve, duke arritur dhe duke tejkaluar detyrat që u shtrohen përpara.

Duke u nisur nga përfundimet e mira të arritura gjatë këtyre dy vjetëve në zhvillimin në përgjithësi të forcave prodhuese, në arritjen dhe tejkalimin e detyrave në ndërtim, në përmirësimin e jetesës së masave punonjëse, në arritjen dhe në tejkalimin e detyrave në lëmin e përgatitjes së kuadrit, duke u nisur nga pjesëmarrja shumë e gjerë e klasës punëtore dhe e fshatarësisë në zbulimin e mundësive të brendshme dhe nga zotimet e mëdha të marra nga ato për arritjen përpara kohe të detyrave që shtron plani i dytë pesëvjeçar, ... Plenumi i Komitetit Qendror,

V e n d o s i :

Të bëhen shtesa në planin e dytë pesëvjeçar për zhvillimin ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë, në përputhje të plotë me orientimin e Kongresit III të Partisë, për një shpejtim më të madh të ritmit të zhvillimit të forcave prodhuese dhe në masën e mëposhtme:

A. — *Prodhimi i përgjithshëm industrial dhe bujqësor* nga 62 miliard dhe 18 milion lekë në vitin 1960, të ngrihet në 72 miliard e 509 milion lekë dhe si përqindje, kundrejt vitit 1955, nga 169 që është të bëhet 197. Rritja mesatare vjetore nga 11,1 për qind të ngrihet në 14,6 për qind. Pësia specifike e prodhimit të përgjithshëm industrial, nga 49,3 që është të bëhet 49,1 dhe e prodhimit të përgjithshëm bujqësor nga 50,7 të ngrihet në 50,9 për qind.

B. — *Prodhimi i përgjithshëm industrial*. — nga 30 miliard e 627 milion lekë në vitin 1960, të ngrihet në 35 miliard e 606 milion lekë dhe si përqindje, kundrejt vitit 1955, nga 192 që është të bëhet 224. Rritja mesatare vjetore nga 14 për qind të ngrihet në 17,5 për qind. Pësia specifike e prodhimit të mjeteve të prodhimit, nga 42 në vitin 1960 të ngrihet në 45 dhe ajo e prodhimit të mjeteve të konsumit, nga 58 të ulët në 55 për qind. Rritja mesatare vjetore e prodhimit të mjeteve të prodhimit, nga 14,8 për qind të ngrihet në 20,0 për qind dhe ajo e prodhimit të mjeteve të konsumit nga 13,5 për qind të ngrihet në 15,8 për qind dhe nga ky:

I. — *Prodhimi industrial shtetëror* nga 23 miliard e 976 milion lekë, në vitin 1960, të ngrihet në 27 miliard e 945 milion lekë dhe si përqindje, kundrejt vitit 1955, nga 196 të arrijë në 229. Rritja mesatare vjetore nga 14,4 për qind të bëhet 18,0 për qind. Dhe nga ky:

1. — *Industria e naftës* nga 1 miliard e 639 milion lekë në vitin 1960, të arrijë në 3 miliard e 429 milion lekë dhe si për-

qindje, kundrejt vitit 1955, nga 290 të ngrihet në 606³⁰. Rritja mesatare vjetore nga 23,7 për qind të ngrihet 43,4 për qind.

2. — Industria e bitumit, nga 183 milion lekë në vitin 1960, të arrijë në 199 milion lekë dhe si përqindje, kundrejt vitit 1955, nga 121 të ngrihet në 132. Rritja mesatare vjetore nga 3,9 për qind të ngrihet në 5,7 për qind.

3. — Industria e qymyrgurit të mbetet aq sa ka qenë në planin pesëvjeçar.

4. — Industria e kromit të mbetet sa ka qenë në planin pesëvjeçar.

5. — Industria e bakrit, nga 243 milion lekë në vitin 1960, të bëhet 372 milion lekë dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 181 të ngrihet në 278. Rritja mesatare vjetore nga 12,6 për qind të ngrihet në 22,7 për qind.

6. — Industria e hekurit të mbetet sa ka qenë në planin pesëvjeçar.

7. — Industria elektrike, nga 986 milion lekë në vitin 1960, të bëhet 1 miliard e 46 milion lekë dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 192 të ngrihet në 204. Rritja mesatare vjetore nga 14 për qind të ngrihet 15,3 për qind.

8. — Industria mekanike, nga 479 milion lekë në vitin 1960, të bëhet 497 milion lekë dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 347 të ngrihet në 360. Rritja mesatare nga 28,3 për qind të ngrihet në 29,2 për qind.

9. — Industria e material ndërtimit të bëhet 590 milion lekë dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, të jetë 335 për qind dhe rritja mesatare vjetore të bëhet 27,4 për qind.

10. — Industria e drurit, nga 1 miliard e 281 milion lekë, në vitin 1960, të bëhet 1 miliard e 330 milion lekë.

11. — Industria e lehtë, nga 4 miliard e 756 milion lekë, në vitin 1960, të bëhet 4 miliard e 926 milion lekë dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 206 të ngrihet në 214. Rritja mesatare vjetore nga 15,6 për qind të ngrihet në 16,4 për qind.

12. — Industria ushqimore, nga 3 miliard e 957 milion, në vitin 1950, të bëhet 4 miliard e 955 milion lekë dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 210 të ngrihet në 264. Rritja mesatare vjetore nga 16 për qind të ngrihet në 21,4 për qind.

13. — Industria lokale, nga 3 miliard e 664 milion lekë, në vitin 1960, të bëhet 3 miliard e 914 milion lekë, dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 217 të ngrihet në 232. Rritja mesatare vjetore nga 16,8 për qind të ngrihet në 18,3 për qind.

14. — Të tjera, nga 5 miliard e 55 milion, në vitin 1960, të bëhen 5 miliard e 681 milion lekë dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 143 të ngrihet në 161. Rritja mesatare vjetore nga 7,5 për qind të ngrihet në 10 për qind.

II. — Prodhimi industrial kooperativist nga 6 miliard e 651

milion lekë, në vitin 1960, të bëhet 7 miliard e 661 milion lekë dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 181 të ngrihet në 208. Rritja mesatare vjetore nga 12,6 për qind të ngrihet në 15,8 për qind. Dhe nga ky:

1. — Në kooperativat e artizanatit, nga 4 miliard e 561 milion lekë në vitin 1960, të bëhet 5 miliard e 426 milion lekë dhe përqindja kundrejt vitit 1955, nga 173 të ngrihet në 206. Rritja mesatare vjetore nga 11,6 për qind të ngrihet në 15,6 për qind.

2. — Në kooperativat e konsumit nga 2 miliard e 90 milion lekë të parashikuara në planin pesëvjeçar, të arrijë në 2 miliard e 235 milion lekë.

Kryerja e detyrave të mësipërme në fushën e industrisë kërkon që Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Komiteti Shtetëror i Gjeologjisë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Artizanatit, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe organet e tjera qendrore, si edhe komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë në rrethe të marrin një seri masash për forcimin e mëtejshëm të organizimit të punës në organizatat industriale, të tregojnë vëmendje më të madhe për njohjen dhe zbrëthimin në praktikë të treguesve tekniko-ekonomikë, siç janë rendimenti në punë, koha dhe lëndë e parë e domosdoshme për njësi prodhimi, shfrytëzimi i maqinerisë, kostua për njësi prodhimi etj., të shtojnë përpjekjet për përmirësimin kudo të cilësisë së prodhimit, në mënyrë të veçantë në industrinë e lëndëve të ndërtimit dhe të drurit si në tulla, tjegulla, lëndë të sharruar dhe të tharë, mobilje, orendi, poçeri etj. Të luftohet kudo më shumë për një zgjerim më të madh të prodhimit të mallrave të ndryshme të përdorimit të gjerë, duke ju përgjigjur kështu më mirë kërkesave të popullit. Të nxitet me çdo mjet iniciativa krijuese përsa i përket nxjerrjes nga prodhimi në mënyrë më dinamike të gjithëfarë mallrash të dobishme, të bukura dhe të lira, për të cilat ka nevojë ekonomia dhe populli.

Të mbahet vazhdimisht në qendrën e vëmendjes përgatitja dhe aftësimi në përgjithësi i kuadrove, veçanërisht për industrinë e naftës, për industrinë e qumështit, për forcimin e shpejtë dhe të plotë të kooperativave bujqësore dhe për ndërtimet, që t'u përgjigjemi plotësisht ritmeve të mëdha të zhvillimit që kanë marrë dhe do të marrin këto degë prodhimi.

Detyrë tjetër e madhe dhe e ngutshme për Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave, në radhë të parë, për Komitetin Shtetëror të Grumbullimeve, për Ministrinë e Tregëtisë dhe Ministrinë e Ndërtimit është të pregatisin mirë dhe në kohë studimet që do të shërbejnë për hartimin e projekteve nga grupet e shumta të projektuesve që do të vijnë së shpejti nga jashtë, të sigurojnë me kohë projektet dhe preventivat, të përfundojnë punimet e ndërtimit sipas parashikimeve, të sigurojnë ardhjen dhe vendosjen e pajisjeve në afatet e caktuara për të gjitha veprat industriale që

do të rindërtohen dhe do të ndërtohen të reja, brenda vjetëve 1958-1960.

C. — *Prodhimi i përgjithshëm bujqësor*: Nga 31 miliard e 491 milion lekë, në vitin 1960, të arrijë në 36 miliard e 900 milion lekë dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 150 të ngrihet në 176. Rritja mesatare vjetore nga 8,5 për qind të ngrihet në 12 për qind.

1. — Hapja e tokave të reja për ara, nga 75 mijë ha, që parashikon gjithsejt pesëvjeçari, të arrijë në 88 mijë ha dhe për kulturat drunore toka e re, e kthyer sipas sipërfaqes që ato zënë, nga 22.000 ha të shtohet në 77.000 ha.

2. — Sipërfaqja gjithsejt për t'u mbjellë, në vitin 1960, nga 445 mijë ha, të jetë 452 mijë ha, nga e cila NBSH-të nga 29 mijë ha, në 31 mijë ha. Mbjelljet e dyta nga 100 mijë ha, në vitin 1960, të arrijë në 108 mijë ha, nga të cilat misër foragjer dhe hasëll 77.600 ha.

a) Sipërfaqja e mbjellë me drithëra buke, nga 304 mijë ha, në vitin 1960, të arrijë në 312 mijë dhe rritja kundrejt vitit 1955 nga 122 për qind të ngrihet në 125 për qind. Nga kjo NBSH-të 16.200 ha.

b) Sipërfaqja e mbjellë me bimë industriale, nga 46.000 ha, në vitin 1960, të jetë 52.300 ha dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 119 të ngrihet në 135 për qind. Nga kjo sipërfaqe NBSH-të të zënë 3.000 ha. Sipërfaqja e mbjellë me pambuk, në vitin 1960, të mbetet ajo që parashikon pesëvjeçari, e ndarë kështu: 1.300 ha në NBSH-të dhe 21.700 ha në kooperativat bujqësore. Sipërfaqja e mbjellë me duhan, nga 12.000 ha, në vitin 1960, të ngrihet më 17.500 ha dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 124 të ngrihet në 181. Sipërfaqja e mbjellë me panxhar sheqeri, në vitin 1960, të mbetet ajo që parashikon pesëvjeçari.

c) Sipërfaqja e mbjellë me perime e patate, nga 15.500 ha, në vitin 1960, të arrijë në 20.000 ha dhe përqindja, kundrejt vitit 1955, nga 103 të ngrihet në 133 për qind. Nga kjo sipërfaqe NBSH-të të zënë 1.550 ha. Për vitin 1960 të mbillen 2950 ha oriz.

3. — Rendimentet mesatare të bimëve kryesore të parashikuara në planin e dytë pesëvjeçar, për vitin 1960, si republikë të ngrihen (në kv/ha) për drithërat e bukës nga 13,8 në 14,8, nga ky: për grurin nga 13 në 14, për thekrën nga 10,2 në 10,7 dhe për misrin nga 15,35 në 16; për orizin nga 30 në 32,4, për tagjirat nga 10,5 në 12, për pambukun nga 10 në 11, për duhanin nga 8 në 8,2, për panxhar sheqerin nga 225 në 238, për patatet nga 100 në 104,5.

4. — Prodhimet bujqësore, të shprehura në ton në vitin 1960: drithëra gjithsejt nga 516 mijë në 552 mijë, nga të cilat drithëra buke nga 451 mijë të bëhet 493 mijë, orizi të jetë 9.500 ton. Pambuku nga 25 mijë të bëhet 25.700 dhe si përqindje, kundrejt vitit 1955, nga 187 të ngrihet në 209. Duhani nga 9.600 të arrijë në 14.400 dhe si përqindje, kundrejt vitit 1955, nga 135 të ngrihet në

202. Panxhar sheqeri nga 135 mijë të bëhet 142.600 dhe si përqindje, kundrejt vitit 1955, nga 123 të ngrihet në 130. Perimet nga 145 mijë të bëhen 156 mijë dhe si përqindje, kundrejt vitit 1955, nga 143 të ngrihen në 153. Patatet nga 45 mijë të bëhen 78.800 dhe si përqindje, kundrejt vitit 1955, të ngrihen nga 149 në 261.

5. — *Blegtoria*:

a) Si numër (krerë) në vitin 1960: gjedhet nga 423 mijë të bëhen 430 mijë, nga të cilat lopët nga 130 mijë në 155 mijë dhe, kundrejt vitit 1955, në përqindje nga 116 në 138. Dhentë nga 1 milion e 800 mijë në 1 milion e 943 mijë dhe, kundrejt vitit 1955, nga 104 në 112, nga këto dhentë pëlleja nga 1 milion e 260 mijë në 1 milion e 374 mijë. Dhitë nga 1 milion e 300 mijë në 1 milion e 381 mijë, nga këto dhitë pëlleja nga 910 mijë në 972 mijë. Shpendët nga 3 milion në 4 milion e 93 mijë dhe, kundrejt vitit 1955, në përqindje nga 250 në 341.

b) Prodhimi i qumështit në kg krerë në vitin 1960 të jetë për lopën nga 700 në 830, për delen nga 42,5 në 45,5, për dhinë nga 65 në 69. Prodhimi i leshit për delen nga 1,250 gk/krerë, në vitin 1960, të arrijë në 1,685 kg/krerë.

c) Prodhimet kryesore blegtoriale, të shprehura në mijë ton, në vitin 1960 të zenë: qumështi nga 198 në 238 dhe, kundrejt vitit 1955, në përqindje nga 140 në 169, mishi nga 49 në 56 dhe, kundrejt vitit 1955, në përqindje nga 153 në 173; leshi nga 2,5 në 3,5 dhe përkatësisht nga 136 për qind në 187 për qind.

6. — *Frutikultura*:

a) Mbjelljet e reja për krejt pesëvjeçarin (në rrënjë): fidana frutore nga 3 milion e 360 mijë në 18 milion, fidana ullinjsh nga 1 milion e 500 mijë në 3 milion, fidana agrumesh nga 600 mijë në 685 mijë, pjergulla nga 1 milion e 500 mijë në 23 milion, vreshta të reja nga 2.000 ha në 14.000 ha.

b) Në vitin 1960 të ketë gjithsejt: pemë frutore 18 milion rrënjë, nga të cilat: 3 milion e 600 mijë në prodhim, ullinj 3 milion e 800 mijë rrënjë, nga të cilat 1 milion e 340 mijë në prodhim, agrume 760 mijë rrënjë, nga të cilat 154 mijë në prodhim, pjergulla 21 milion rrënjë, nga të cilat në prodhim 2 milion e 700 mijë dhe vreshta 16.500 ha, nga të cilat 2.900 ha në prodhim.

7. — *Mekanizimi i punimeve të bujqësisë*: gjithsejt si republikë, vëllimi i punimeve të mekanizuara në unitet hamullor në vitin 1960 nga 941 mijë ha të shtohet në 1 milion e 180 mijë ha. Numri i traktorëve në 15 KF në shfrytëzim, në vitin 1960, nga 2.675 të arrijë 3.375 dhe, kundrejt vitit 1955, në përqindje nga 212 në 268. Nga këto: vëllimi i punimeve të mekanizuara me traktorë për SMT-të, në vitin 1960, nga 726 mijë ha të bëhet 896 mijë ha; numri i traktorëve në 15 KF në SMT-të në vitin 1960, nga 2.168 të bëhet 2.675.

8. — *Grumbullimi i artikuljve kryesorë bujqësorë e blegtoriale*:

i shprehur në mijë ton në vitin 1960: drithëra buke gjithsejt nga 137 të bëhen 186. Nga këto detyrimet të mbeten të pandryshueshme, dorëzimi i NBSH-ve nga 14 të bëhet 19 dhe blerja e tepricave nga 66 të bëhet 110; fasule nga 5,9 në 6,7; oriz nga 10,5 në 7,9, nga këto tepricat nga 7,6 në 5,9; pambuk nga 22,3 në 24,5; panxhar sheqeri nga 132 në 139; duhan nga 7,7 në 11,6; ullinj nga 19 në 21; perime nga 35,7 në 47,5, nga këto NBSH-të nga 10,1 në 10,5; patate nga 13,4 në 26,7; fruta të njoma nga 16,8 në 21; agrume nga 2,8 në 3,2; rrush nga 13,2 në 20; qumësht nga 41,8 në 58,3, nga i cili NBSH-të nga 6,4 në 9,9; mish peshë e gjallë nga 24 në 26,1, nga i cili blerje tepricash nga 9,5 në 12; lesh nga 1,9 në 2,1; vezë nga 34 milion e 500 mijë në 45 milion e 700 mijë, nga këto blerje tepricash nga 23 milion në 34 milion e 200 mijë.

Që të arrihen detyrat e sipërme në lëmin e bujqësisë është e domosdoshme që Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive në rrethe, krahas me shpejtimin e ritmit të kolektivizimit, të marrin masa për forcimin organizativ, ekonomik dhe financiar të kooperativave, të mbajnë ngritur vazhdimisht çështjen e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese, si kusht themelor në vendin tonë për arritjen e përfundimeve të mira në prodhimet bujqësore. Pastrimi i kanaleve të kryhet çdo vit para mbjelljeve të vjeshtës, duke siguruar kështu mbjellje në kushte të mira dhe mbirje të rregullt të bimëve. Mbjelljet të kryhen patjetër në afatet që përcakton agroteknika. T'i jepet fund sistemit antiekonomik të ujitjes me përmbytje, duke marrë masa të veçanta që në vitin 1958 të përdoret ujitja me brazda në shkallë të gjerë. Të caktohen vendet ku do të mbillen pemët dhe vreshtat, duke bërë rajonizimin e kulturave drunore në lartësi, të përcaktohen sa më parë llojet më të mira të rrushit dhe të frutave që do të përhapen në shkallë të gjerë në vendin tonë, duke organizuar njëkohësisht dhe në mënyrë të veçantë prodhimin dhe shpërndarjen e fidanave me kohë, të zgjidhet patjetër problemi i sigurimit të bazës ushqimore për blegtorinë, duke arritur parashikimet, që mund të merren si më të ulëtat, në pastrimin e kullotave, në mbjelljet e misrit foragjer dhe të hasëlleve si dhe në silazhet.

Detyrë tjetër e madhe për Ministrinë e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve është pregatitja e kuadrit drejtues dhe teknik për kooperativat bujqësore. Për këtë qëllim deri në fund të vitit 1960 të kemi me shkollë të kooperativave bujqësore dhe me kurse përkatëse mbi 2000 kryetarë kooperativash, mbi 2.000 llogaritarë, mbi 5.000 brigadierë etj.

Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve, në mënyrë të veçantë Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe komitetet e Partisë e komitetet ekzekutive në rrethe çështjen e grumbullimit të tepricave në përgjithësi dhe në veçanti të tepricave të drithë-

rav të bukës ta marrin më mirë në dorë dhe të bëjnë kthesë rrënjësore në këtë drejtim. Çështja e grumbullimit të tepricave të drithërave të bukës të bëhet problem i organizatës bazë të Partisë në fshat dhe treguesi numër një i marrëdhënjeve të shëndosha ndërmjet kooperativave bujqësore dhe shtetit.

Ç. — *Nga Ministria e Komunikacioneve* të përballohet transporti i mallrave që shtohen me mjetet e parashikuara në pesëvjeçarin dhe me përmirësimin e mëtejshëm të treguesve tekniko-ekonomikë, duke ngritur gatishmërinë teknike të mjeteve me anë të kryerjes së rregullt të shërbimeve dhe të përhapjes së eksperiencës së pasur të punëtorëve pararojë në tri llojet e transportit.

Për një shfrytëzim më të plotë të automjeteve, të kalohet gradualisht në përqëndrimin e tyre në vartësinë e Ministrisë së Komunikacionit.

D. — *Investimet dhe ndërtimet;*

1. — *Investimet:* nga 26 miliard e 200 milion lekë si pesëvjeçar të bëhen 40 miliard e 500 milion lekë dhe, kundrejt pesëvjeçarit të parë, nga 26 për qind më shumë të bëhen 94 për qind më shumë. Investimet në degët prodhuese, nga 81,2 për qind të krejt investimeve të parashikuara të bëhen 85,3 për qind të investimeve me shtesat. Pësha specifike e investimeve në industri nga 42,7 të bëhet 44,8; në bujqësi nga 18,1 të bëhet 18,5; në komunikacion nga 11,4 të bëhet 10,1, në degët kulturalo-shoqërore nga 12,8 të bëhet 10,1 për qind.

2. — *Ndërtimet:* nga 13 miliard lekë të parashikuara për gjithë pesëvjeçarin, të bëhen 17 miliard lekë. Kundrejt pesëvjeçarit të parë ndërtimet ishin 16 për qind më të mëdha, tani të bëhen 52 për qind më të mëdha. Shtesa prej 4 miliard lekësh të ndahet kështu: 31,2 për qind në industri-miniera, 30 për qind në bujqësi, 12,2 për qind në komunikacion, 8,5 për qind në degët kulturalo-shoqërore dhe 18,1 për qind në të tjerat. Pësha specifike e ndërtimeve në industri-miniera ishte 30,7 të bëhet 31; në bujqësi ishte 22,2 të bëhet 24,3; në komunikacion ishte 12,1 të bëhet 11,7, në degët kulturalo-shoqërore ishte 20,3 të bëhet 17,9. Kundrejt pesëvjeçarit të parë, me shtesat ndërtimet janë më të larta 23 për qind në industri-miniera, 110 për qind në bujqësi, 36 për qind në komunikacion dhe 56 për qind në degët kulturalo-shoqërore. Ndërtimet të bëhen 75,1 për qind në vend të 73,6 për qind që parashikon pesëvjeçari në degët prodhuese.

Që të kryhet ky vëllim ndërtimesh është e domosdoshme të merren masa të veçanta nga të gjithë investitorët për thjeshtimin e projekteve, duke hequr çdo gjë të tepërt, duke synuar në ndërtimet që të kenë madhësitë më të domosdoshme, që të ngrihen sa më shumë me materiale vendi dhe që të kushtojnë sa më pak.

Ministria e Ndërtimit nga ana tjetër të përmirësojë rrënjë-

sisht punën e projektimit, në drejtim të thjeshtimit, të tipizimit dhe të standardizimit të pjesëve të ndryshme, të kalojë nga projektideja, në projektin e zbatimit, të përdorë në projektim dhe në zbatim më shumë lëndët e ndërtimit që janë përdorur gjerësisht në vendin tonë si qerpiç, kallama, çatma, gardh, duke përcaktuar zonat dhe lëndët e ndërtimit që do të përdoren në to; të kalojë nga faza eksperimentale në parafabrikimin në fazën e zbatimit në shkallë të gjerë, sidomos në ndërtesat e banimit, të shkojë duke e zgjeruar projektimin e veprave të reja të industrisë dhe të degëve të tjera në bashkëpunim me specialistët e huaj që të mos varemi për çdo projekt të këtyre veprave nga jashtë dhe të kursejmë divizë; të marrë masa të posaçme për përmirësimin e shpejtë të jetesës së punëtorëve në kantieret e ndërtimit dhe për të përgatitur mbi 1500 kadro specialistë të tjerë për maqinerinë e shumtë dhe të vështirë që do të ketë, përveç atyre që parashikon pesëvjeçari.

Komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë në rrethe të marrrin në dorë sa më parë çështjen e organizimit të pjesëmarrjes së fshatarësisë në ndërtimin e veprave të mëdha të përmirësimeve ujore. Fshatarësia të kryejë këtej e tutje të gjitha punimet për gërmimet e kanaleve të dyta dhe të treta, të veprave të mëdha, si edhe sistemet bujqësore.

Dh. — *Rendimenti në punë*: në prodhimin e përgjithshëm industrial, nga 154 për qind, në vitin 1960, të bëhet 166 për qind dhe ky rendiment të mbulojë 72 për qind të rritjes së prodhimit nga rreth 71 që parashikon pesëvjeçari. Rendimenti në punë në industri-miniera, nga 158 për qind, në vitin 1960, të arrijë 177 për qind, në kooperativat e artizanatit nga 147 për qind, në vitin 1960, të bëhet 157 për qind; në kooperativat e konsumit nga 177 për qind në vitin 1960, të arrijë në 221 për qind, në Ministrinë e Ndërtimit nga 137 për qind, në vitin 1960, të arrijë në 166 për qind. Për arritjen e detyrave të reja në rendimentin në punë u dalin të gjithëve detyra të mëdha, sidomos në ngritjen çdo ditë e më shumë të aftësive tekniko-profesionale të klasës punëtore, në përdorimin sa më me vend të fuqisë punëtore, në shfrytëzimin sa më të mirë të kohës së punës, që sot për sot janë burimet e brendshme më të rëndësishme në krijimin e kushteve më të mira të jetesës së klasës punëtore.

E. — *Ulja e kostos dhe e shpenzimeve të qarkullimit*: të jetë në qendrën e vëmendjes së organeve qendrore dhe në veçanti të udhëheqjes dhe të kolektivit punonjës në çdo qendër prodhimi dhe pune. Për treguesit si rendimenti në punë dhe ulja e kostos të mos flitet në përgjithësi, por të zërthehen dhe të trajtohen thjesht, në mënyrë të qartë, të kuptueshme nga çdo punonjës dhe secili të ngarkohet me detyra të caktuara.

Ulja e kostos në Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave

në vitin 1960, kundrejt vitit 1955, të arrijë 22 për qind, në vend të 18 për qind që cakton pesëvjeçari, në Ministrinë e Ndërtimit në 25 për qind, në vend të 20 për qind; në SMT-të 27 për qind në vend të 20 për qind, në prodhimin e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Konsumit në 20 për qind në vend të 18 për qind. Shpenzimet e qarkullimit në vitin 1960, kundrejt vitit 1955, të ulen 20 për qind në vend të 15 për qind në Ministrinë e Tregëtisë dhe 18 për qind në vend të 15 për qind në Bashkimin Qendror të Kooperativave të Konsumit.

Ministria e Bujqësisë të shqyrtojë thellë çështjen e uljes së kostos në NBSH-të, sepse këto kanë ngritur koston kundrejt vitit 1955, dhe të marrë masa të veçanta e t'u caktojë detyra të hollësishme ndërmarrjeve, t'i kontrollojë dhe t'i ndihmojë ato për zbatimin e detyrave të caktuara dhe vetë NBSH-të të bëjnë kthesë rrënjësore në këtë drejtim.

E. — *Përmirësimi i mëtejshëm i mirëqenjes së masave punonjëse*. Të ardhurat kombëtare në vitin 1960, kundrejt vitit 1955, të rriten rreth 73 për qind në vend të 53 për qind që parashikon pesëvjeçari. Paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve të rritet 35 për qind në vend të 25 për qind. Të ardhurat e fshatarësisë të rriten 45 për qind në vend të 38 për qind. Qarkullimi i mallrave në tregëtinë socialiste, në vitin 1960, të jetë 24 për qind më i madh nga parashikimi i pesëvjeçarit. Shitja e mallrave për frymë si republikë në vitin 1960, kundrejt vitit 1955, në përqindje nga 121 të bëhet 163 për sheqerin, nga 106 të bëhet 137 për të pambuktat, nga 117 të bëhet 146 për të leshtat dhe nga 156 të bëhet 187 për këpucët dhe opingat. Shitja e mallrave për frymë si qytet: në vitin 1960, kundrejt vitit 1955, në përqindje nga 127 të bëhet 138 për miellrat, nga 123 të bëhet 147 për yndyrnat, nga 136 të bëhet 157 për fasulet dhe orizin, për mishin dhe peshkun të jetë 136, nga 310 të bëhet 344 për djathin e gjizën, nga 251 të bëhet 363 për qumështin dhe nga 186 të bëhet 276 për perimet dhe patatet.

Gjatë pesë vjetëve 1956-1960 të investohen rreth 230 milion lekë mbi parashikimet për ndërtesa banimi, duke ndërtuar kështu gjatë gjithë pesëvjeçarit 730 mijë metra katrore ndërtesa banimi, në vend të 670 mijë metra katrore të parashikuara.

Detyra të mëdha i dalin tregëtisë socialiste, në qytet dhe në fshat, sidomos në gjendjen e re të tregëtisë së lirë dhe të zhvillimit të shpejtë të kolektivizimit. Tregëtia të bëhet nxitësi më i mirë i prodhuesve që të arrijnë dhe të tejkalojnë detyrat, duke shtuar çdo vit e më shumë llojet e mallrave, duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e tyre dhe duke ulur koston. Të shërbejë tregëtia jonë, në çdo qendër pune, qytet dhe fshat, në mënyrë më të shpejtë dhe më të përsosur; të bëjë çmos që më parë të njohë thellësisht dhe pastaj të plotësojë nevojat, shijet dhe mundësitë e çdo shtrese të popullsisë. Të ngrihet tregëtia kooperativiste në

lartësinë e detyrave që shtron sot fshati ynë. Ajo të bëhet mjete më i mirë për forcimin e marrëdhënjeve qytet-fshat. Organet qendrore prodhuese dhe ato të tregëtisë të bashkëpunojnë ngushtësisht dhe vazhdimisht për njohjen dhe plotësimin e nevojave të fshatit në kohë, në sasinë dhe në llojin që i duhen me mallra që prodhon shteti. Komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë të kenë vazhdimisht në qendrën e vëmendjes çështjen e tregëtisë me fshatin dhe, si rrjedhim, të kontrollojnë dhe të ndihmojnë pa ndërprerje që të lidhen dhe të zbatohen pa të meta kontratat e shit-blerjes ndërmjet fshatit dhe kooperativave të konsumit.

* * *

Këshilli i Ministrave brenda muajit shkurt të bëjë ndarjen e planit në vjete sipas degëve të ndryshme dhe të caktojë detyra më të hollësishme për çdo dikaster, duke vendosur në këtë mënyrë planin e dytë pesëvjeçar me shtesat. Brenda muajit mars çdo organizatë ekonomike të marrë planin për të tre vjetët 1958-1960 të vendosur nga Këshilli i Ministrave dhe ta zbërthejë në tregues më të hollësishëm për çdo sektor dhe repart pune, gjer në brigadë dhe grup punonjësish.

Në direktivat e Kongresit III të PPSH thuhet: «Plani i dytë pesëvjeçar i zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë shënon një etapë të re të rëndësishme në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të forcave prodhuese të vendit, të zhvillimit të hovshëm të ekonomisë popullore. . .»³¹ Shtesat që i bëhen këtij plani e plotësojnë më mirë atë dhe na pregatisin për plane edhe më të guximshme.

Detyrat e reja janë më të mëdha se ato që parashikon pesëvjeçari dhe për kryerjen e tyre kërkohen përpjekje më të mëdha dhe të gjithanshme. Për kryerjen me sukses të këtyre detyrave është e domodoshme të përmirësojmë vazhdimisht metodën e drejtimit të ekonomisë, që nga organet qendrore dhe deri në organizatat bazë të Partisë dhe në organizatat ekonomike. Të forcojmë disiplinën dhe të ngremë sa më lart ndërgjegjen në punë, të luftojmë çdo shfaqje të burokracisë, kudo që ajo të paraqitet, të vëmë në lëvizje të gjitha masat punonjëse për arritjen e detyrave të planit në sasi, cilësi dhe lloje, të vazhdojmë pa ndërprerje punën e filluar për zbulimin dhe shfrytëzimin e mundësive të brendshme, mbasi këto janë të pafund në çdo kohë në ekonomi.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH ka besim të plotë se masat punonjëse, të cilat me zotimet e tyre të guximshme kanë dhënë pjesën dërmuese të shtesavet që i bëhen programit madhështor të pesëvjeçarit, do t'i arrijnë dhe do t'i kalojnë detyrat e reja dhe komunistët do të jenë kudo, si kurdoherë, në ballë të luftës,

shembull pune, vetëmohimi dhe thjeshtësie. Masat punonjëse të vendit tonë, nën udhëheqjen e urtë dhe largpamëse të Partisë sonë dhe me ndihmën e . . . Bashkimit Sovjetik në radhë të parë dhe të të gjitha vendeve të socializmit, do të mposhtin me heroizëm çdo pengesë dhe do të ecin përpara nga fitorja në fitore në veprën e tyre ndërtimore dhe paqësore.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

**Botohet sipas broshurës
Vendim i Plenumit të
Komitetit Qendror të
Partisë së Punës të
Shqipërisë «Mbi shtesat
në planin e dytë pesë-
vjeçar për zhvillimin
ekonomik e kultural të
Republikës Popullore të
Shqipërisë» Tiranë 1958**

PLENUMI IX I KQ TË PPSH

Tiranë, 1-2 Prill 1958

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Më datën 1-2 prill 1958 u mbledh plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, shokut Enver Hoxha. Plenumi dëgjoi dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi masat për përmirësimin e mëtejshëm të punës në Bashkimet Profesionale të Shqipërisë», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike dhe President i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, shoku Pilo Peristeri, dhe mori vendimin përkatës.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nr. 108

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

«MBI MASAT PËR PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS NË BASHKIMET PROFESIONALE TË SHQIPËRISË»

2 prill 1958

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur me datën 1-2 prill 1958, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, shokut Enver Hoxha, pasi dëgjoi dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi masat për përmirësimin e mëtejshëm të punës në Bashkimet Profesionale të Shqipërisë», mbajtur nga shoku Pilo Peristeri, mori vendimin që vijon:

Fitoret e mëdha në ndërtimin e socializmit në vendin tonë, realizimi me sukses i planit të dy vjetëve të parë të pesëvjeçarit të dytë, shtimi me ritme të shpejta i prodhimit industrial, zhvillimi i vrullshëm i kolektivizimit të bujqësisë, sukseset e rëndësishme në përmirësimin e jetës së popullit, si heqja e sistemit të triskëtimtimit, ulja e çmimeve, ngritja e pagave dhe e pensioneve të ulëta, frymëzimet në klasën punëtore dhe të gjithë punonjësit e tjerë në luftën për plotësimin e detyrave të reja të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës, për të realizuar me sukses planin e dytë pesëvjeçar.

Entuziazmi dhe vrulli në punë i klasës punëtore, i fshatarësisë punonjëse dhe i inteligjencies popullore, politika largpamëse marksiste-leniniste e Partisë sonë, ndihma... e Bashkimit Sovjetik bënë të mundshme shtesat në planin e dytë pesëvjeçar, duke i hapur vendit tonë perspektiva të reja të mëdha në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Në sajë të politikës së urtë të Partisë sonë, e cila, që në fillim e pa lëkundje, është udhëhequr nga parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe ka luftuar pa mëshirë armiqtë e hapur dhe të fshehur, oportunistët dhe revizionistët e ndryshëm, janë forcuar pozitat e brendshme të Republikës sonë Popullore dhe autoriteti i saj ndërkombëtar.

Republika Popullore e Shqipërisë, anëtare e kampit të socializmit, që ka në krye Bashkimin Sovjetik, është bërë një faktor i rëndësishëm paqeje në Ballkan e në Evropë dhe lufton për miqësinë e bashkëpunimin midis popujve në bazë të parimeve të barazisë dhe mosndërhyrjes në punët e brendshme të të tjerëve.

... Bashkimet Profesionale të Shqipërisë kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në arritjen e këtyre fitoreve të popullit tonë. Me fitoren e revolucionit popullor, klasa punëtore u bë forcë kryesore dhe udhëheqëse e shoqërisë sonë. Në aleancë me fshatarësinë punonjëse, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, ajo po kryen misionin e saj historik: të transformojë atdheun tonë nga një vend i prapambetur në një vend socialist të përparuar, të fuqishëm ekonomikisht, të pasur e të kulturuar. Bashkimet Profesionale të Shqipërisë, si organizata më e gjerë e klasës punëtore dhe e masave punonjëse, të krijuara me iniciativën dhe kujdesin e Partisë, sipas mësimëve leniniste dhe eksperiencës së Bashkimeve Profesionale Sovjetike, kanë luftuar me të gjitha forcat e tyre për realizimin e programit të Partisë në të gjitha etapat e ndërtimit socialist të vendit tonë: në luftën për konsolidimin e rendit të ri popullor, në forcimin e aleancës me fshatarësinë punonjëse, në perfeksionimin e aparatit shte-

tëror, në forcimin e miqësisë dhe bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të kampit socialist.

Ato zbatuan drejt parullën «fytyrën nga prodhimi» dhe u bënë një nga levat më të rëndësishme për të tërhequr masën e punëtorëve, të intelektualëve, nëpunësve në administrimin e ekonomisë, në luftën për rritjen e rendimentit të punës dhe të prodhimit, për zgjerimin e iniciativës dhe aktivitetit krijues të klasës punëtore nëpërmjet zhvillimit të emulacionit socialist dhe përhapjes së eksperiencës së përparuar, për zbatimin e kontratave kolektive, sistemit të pagave, kategorizimit dhe normimit të punës.

Duke ndjekur porositë e Partisë, Bashkimet Profesionale të Shqipërisë kanë treguar kurdoherë një kujdes të madh për të përmirësuar kushtet e punës dhe të jetesës së punonjësve. Nën drejtimin e Partisë dhe me pjesëmarrjen e tyre aktive janë hartuar ligjet dhe vendimet që përbëjnë të drejtën socialiste të punës. Ato kanë luftuar për respektimin dhe zbatimin e legjislacionit të punës.

Bashkimet Profesionale kanë punuar për edukimin e klasës punëtore me mësimet e marksizëm-leninizmit, për ngritjen e nivelit të saj kultural dhe teknik. Të udhëhequra nga parimet e internacionalizmit proletar, ato kanë luftuar dhe luftojnë për forcimin e unitetit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar të klasës punëtore në gjirin e Federatës sindikale botërore, për paqen, lirinë, pavarësinë kombëtare dhe për një jetë më të mirë të punonjësve.

Bashkimet Profesionale grumbullojnë në gjirin e tyre shumicën dërmuese të punëtorëve, të nëpunësve dhe të intelektualëve. Autoriteti dhe forca mobilizuese e Bashkimeve Profesionale është rritur, fusha e veprimtarisë së tyre është zgjeruar dhe sot nuk ka sektor të jetës që të mos ndihet puna e tyre.

Por në punën e Bashkimeve Profesionale vërehen ende shumë dobësi. Influenca e tyre në zgjidhjen e problemeve të prodhimit dhe në përmirësimin e punës së ndërmarrjeve nuk ndihet sa duhet dhe kudo. Ato nuk ushtrojnë kurdoherë të gjitha të drejtat që u janë dhënë përsa i përket zbatimit të legjislacionit të punës, kontratave kolektive dhe dispozitave të tjera mbi kushtet e punës dhe të jetesës së punonjësve. Puna edukative e Bashkimeve Profesionale nuk përfshin të gjithë punonjësit, nuk lidhet sa duhet me jetën dhe prodhimin dhe nuk ka atë forcë bindëse që kërkohet.

Këto dobësi e kanë burimin në punën e pamjaftueshme të vetë forumeve dhe kuadrove që punojnë në Bashkimet Profesionale në qendër dhe në bazë. Këshilli i Qendror i BPSH nuk ka luftuar si duhet për të zbatuar plotësisht direktivat e Partisë për rritjen e rolit të organizatave profesionale në radhë të parë në prodhim, për gjallërimin e tyre. Ai kontrollon dobët vendimet që merr, nuk studjon si duhet dhe nuksjell mirë e në kohën e duhur në Komitetin Qendror të Partisë dhe në qeveri probleme të rëndësishme që

dalin në punë e sipër. Organizatave në rrethe dhe në bazë u jepet një ndihmë e pakët dhe jo sa duhet e kualifikuar nga qendra.

Ato me ngadalësi po shpëputen nga metodat e vjetëruara të punës dhe shpeshherë zëvendësojnë punën e gjallë për edukimin dhe mobilizimin e masave me forma të përgjithshme. Tendenca e shfaqur në disa kuadro për t'ua besuar kryerjen e detyrave vetëm njerëzve me pagesë pakëson karakterin shoqëror e vullnetar të punës së Bashkimeve Profesionale, pengon pjesëmarrjen e vetë masës së anëtarëve në zgjidhjen e problemeve dhe dobëson forcën mobilizuese të organizatave profesionale.

Drejtimi i komiteteve dhe i organizatave të Partisë mbi Bashkimet Profesionale është forcuar. Ato shqyrtojnë më shpesh probleme të punës së organizatave profesionale, u caktojnë detyra, i ndihmojnë dhe i kontrollojnë në zbatimin e tyre. Megjithatë ka komitete dhe organizata bazë të Partisë që tregojnë akoma një kujdes të pamjaftueshëm për Bashkimet Profesionale. Disa komitete dhe organizata të Partisë në praktikë i zëvendësojnë organizatat profesionale, ka gjithashtu komunistë, të cilët, duke mos kuptuar mirë çështjen e lidhjeve të Partisë me masat, rolin e organizatave shoqërore dhe kërkesat e statutit që anëtari i Partisë është i detyruar të punojë në një organizatë masash, nuk japin shembullin në zbatimin e detyrave shoqërore që u ngarkohen.

Partia jonë ka caktuar drejt marrëdhënjet e organeve ekonomike shtetërore me Bashkimet Profesionale, por ka raste kur disa organe shtetërore dhe të ekonomisë nuk mbështeten si duhet në Bashkimet Profesionale, nuk shqyrtojnë me seriozitetin e duhur vërejtjet dhe propozimet e tyre. Disa punonjës të ministrive dhe drejtues të ndërmarrjeve nuk marrin kurdoherë më parë mendimin e organeve profesionale për zgjidhjen e çështjeve të punës e të punëtorëve dhe Bashkimet Profesionale nuk luftojnë sa duhet për respektimin e normave të caktuara nga Partia për këtë qëllim.

Është e nevojshme të kuptohet mirë se roli i masave dhe pjesëmarrja e tyre në zgjidhjen e problemeve të prodhimit është i një rëndësie të dorës së parë. Pra, çdo hap i ynë përpara drejt socializmit çon edhe në rritjen e rolit dhe të detyrave të Bashkimeve Profesionale, si organizatë që grumbullon tërë klasën punëtore, e cila ka rolin drejtues në shoqërinë tonë. Realizimi me sukses i detyrave të mëdha që caktojnë vendimet e Kongresit III të PPSH dhe të Plenumit të shkurtit 1958 të Komitetit Qendror të Partisë mbi shtesat në planin e dytë pesëvjeçar kërkon mobilizimin e të gjitha energjive dhe të iniciativës krijuese të masave, pjesëmarrjen aktive të tyre në zgjidhjen e problemeve të prodhimit dhe të ekonomisë. Prandaj përmirësimi i shpejtë i punës së

Bashkimeve Profesionale, forcimi i rolit të tyre në ndërtimin e socializmit ka qenë dhe mbetet një nga detyrat më të rëndësishme për Partinë tonë.

— II —

Të përmirësohet puna e Bashkimeve Profesionale për aktivizimin e punonjësve në ndërtimin ekonomik

Sukseset madhështore të arritura në ndërtimin e socializmit tregojnë se Partia jonë e ka zgjidhur drejt çështjen e pjesëmarrjes së masave në drejtimin e ekonomisë, të prodhimit. Ajo ka ditur të zgjojë interesin dhe iniciativën e masave, t'i mobilizojë ato, t'i zgjidhë çështjet së bashku me to. Besimi i pakufishëm në klasën punëtore, në fshatarësinë punonjëse, në inteligjencien popullore është një veçori me shumë rëndësi e Partisë sonë.

Bashkimet Profesionale kanë qenë një ndihmë e madhe për Partinë dhe shtetin në aktivizimin e punonjësve për shtimin e prodhimit. Por me gjithë përmirësimet mbetet akoma për të bërë për zhvillimin e mëtejshëm të iniciativës së klasës punëtore dhe për shtimin e pjesëmarrjes së saj në zgjidhjen e problemeve të prodhimit. Bashkimet Profesionale të kuptojnë më mirë se interesat themelore të klasës punëtore, ngritja e mirëqenjes së punonjësve varen drejtpërdrejt nga zhvillimi i ekonomisë, nga rritja e prodhimit. Prandaj ato duhet ta konsiderojnë mobilizimin e punonjësve për rritjen e rendimentit të punës, për realizimin e planeve ekonomike si detyrën e tyre të parë, të përhershme dhe me përgjegjësi. Nga ana tjetër, të kuptohet nga organet ekonomike shtetërore se Bashkimet Profesionale janë një ndihmë e madhe për to, se pa këto nuk mund të kryejnë detyrat si duhet, nuk mund të realizohen planet, prandaj të kërkojnë në çdo gjë ndihmën e tyre, të mbështeten në to. Për të forcuar edhe më shumë rolin e Bashkimeve Profesionale në zhvillimin e ekonomisë, plenumi tërheq vëmendjen veçanërisht në këto çështje:

1. — Emulacioni socialist është një nga format më të rëndësishme për zhvillimin e iniciativës krijuese të masave për rritjen e rendimentit të punës. Emulacioni socialist është bërë të ne një lëvizje e gjerë popullore, që ka përfshirë të gjithë vendin, një fuqi e madhe në prodhim, një mjet shumë i rëndësishëm për edukimin e punonjësve me qëndrimin e ri ndaj punës. Por ne kemi ende punëtorë dhe ndërmarrje të prapambetura, që nuk realizojnë planin dhe nxjerrin prodhime me cilësi të dobët e me kosto të lartë. Emulacioni nuk ka përfshirë të gjithë punëtorët, në drejtimin e tij ka formalizëm. Punohet dobët për përhapjen e eksperiencës së përparuar. Disa herë ndodh që drejtuesit e

ndërmarrjeve nuk sigurojnë lëndën e parë, mjetet, frontin e punës, duke u bërë kështu pengesë për realizimin e zotimeve që kanë marrë punonjësit. Është e domosdoshme të merren masa për të ngritur emulacionin socialist në një shkallë më të lartë, që t'u përgjigjet detyrave të reja të zhvillimit të ekonomisë. Bashkimet Profesionale, mbi të cilat bie përgjegjësia për udhëheqjen e emulacionit socialist, duhet të kuptojnë se:

a) Zhvillimi i emulacionit kërkon një punë individuale me njerëzit. Nga organizatat profesionale kërkohet të njohin nga afër nevojat e punëtorëve, vështirësitë që hasin dhe t'i ndihmojnë që t'i kapërcejnë ato, të zbulojnë arësyet e prapambetjes së punëtorit, të brigadës, të repartit, të ndërmarrjes dhe t'u sjellin eksperiencën e përparuar. Të drejtohet emulacioni konkretisht, të organizohet mirë popullarizimi i rezultateve, krahasimi i tyre, të përdoren me gjallëri format e ndryshme të propagandës së prodhimit, të agjitacionit figurativ, të inkurajimit moral e material të pjesëmarrësve në emulacion.

b) Krahas zhvillimit të emulacionit socialist për realizimin e planit në sasi të zhvillohet emulacioni socialist për përmirësimin e treguesve kualitativë të prodhimit, si rendimenti, kostua, cilësia, asortimenti. Treguesit kualitativë të planit të vihen si kushte të rëndësishme të garave. Bashkimet profesionale dhe kuadrot e tyre të hyjnë më thellë në çështjet teknike dhe ekonomike të prodhimit, sepse pa këtë nuk mund të udhëheqin konkretisht emulacionin socialist.

c) Çështja kryesore e emulacionit socialist është përhapja e eksperiencës së përparuar, ndihma për të prapambeturit. Të organizohet dhënja e eksperiencës në vendin e punës, të praktikohen më dendur shkollat e eksperiencës së përparuar, këmbimi i delegacioneve e të tjera. Dikasteret dhe ndërmarrjet të shqyrtojnë shpejt dhe me seriozitetin e duhur propozimet e novatorëve dhe të racionalizatorëve. T'u vihen ndërmarrjeve detyra shtetërore për zbatimin e metodave të reja të punonjësve sovjetikë dhe të punëtorëve tanë. Të tërhiqen më shumë në këtë çështje inxhinierët dhe teknikët. Gazeta «Puna» dhe gjithë organet e shtypit të ndihmojnë në përhapjen e eksperiencës së përparuar, të japin jo vetëm rezultatet, por edhe rrugët se si ato u arritën, në mënyrë që të mësojnë dhe të tjerët.

ç) Dikasteret dhe organet ekonomike të merren më mirë dhe më konkretisht me problemet e emulacionit, si një mjet i fuqishëm për realizimin e planit.

2. — Partia jonë ka përcaktuar drejt rolin dhe rëndësinë e mbledhjeve të prodhimit. Ajo ka porositur gjithmonë se një nga format më të rëndësishme për t'i tërhequr punonjësit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme tekniko-ekonomike të prodhimit, për edukimin e tyre me ndjenjën e përgjegjësisë, për shfrytëzimin e re-

zervave të brendshme janë mbledhjet e prodhimit. Me gjithë përmirësimet, në këtë drejtim ka ende të meta. Shumë herë çështjet shtrohen aty në mënyrë të përgjithshme. Propozime të vlefshme të punëtorëve nuk shqyrtohen kurdoherë me seriozitetin e duhur dhe nuk vihen kurdoherë në jetë. Plenumi i Komitetit Qendror rithekson edhe një herë që mbledhjet e prodhimit të bëhen një formë efektive për të shqyrtuar me pjesëmarrjen e punonjësve çështjet më të rëndësishme që preokupojnë ndërmarrjet, siç janë projektet e planit, probleme të caktuara të prodhimit, të rendimentit të punës, të kostos dhe të kursimeve, të shfrytëzimit të kapacitetit të maqinerisë, të rezervave të brendshme, të racionalizimit të fuqisë punëtore, të kualifikimit të punonjësve, problemet e mbrojtjes në punë etj.

Komitetet dhe organizatat e Partisë të kontrollojnë dhe të ndihmojnë më shumë organizatat profesionale dhe organet ekonomike për përgatitjen e mirë të mbledhjeve të prodhimit, për shqyrtimin me kohë të propozimeve të punëtorëve dhe për zbatimin e tyre. Drejtuesit e ndërmarrjeve të venë rregullisht në mbledhjet e prodhimit, të raportojnë aty mbi probleme të ndryshme dhe mbi zbatimin e propozimeve të punëtorëve. Dikasteret ekonomike, komitetet ekzekutive, në bashkëpunim me Këshillin Qendror të Bashkimeve Profesionale dhe këshillat e rretheve të organizojnë më dendur dhe më mirë aktivet ekonomike, konsultat me punonjës të dalluar e kuadro teknike, ku të diskutohen probleme të caktuara ekonomike që kërkojnë zgjidhje.

3. — Kontratat kolektive janë një mjet me shumë rëndësi në mobilizimin e punonjësve për realizimin e planeve të prodhimit dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës së tyre. Kontratat kolektive të hartohen njëkohësisht me projektin e planit në ndërmarrje, në mënyrë që të përfshihen aty propozimet e drejta të punëtorëve. Ato të hartohen në përputhje me ligjet dhe planin e shtetit, në bazë të kushteve, të nevojave dhe të mundësive të çdo ndërmarrjeje, duke patur për qëllim shfrytëzimin e të gjitha rezervave të brendshme. Bashkimet Profesionale dhe organet shtetërore të forcojnë kontrollin, me qëllim që kontratat kolektive të realizohen plotësisht nga të dy palët.

4. — Bashkimet Profesionale të luftojnë më mirë për respektimin e normave të caktuara nga Partia dhe qeveria për bashkëpunimin me organet ekonomike shtetërore.

a) Organet ekonomike shtetërore dhe Bashkimet Profesionale të zbatojnë me kujdes porositë e Partisë që projektplanin tekniko-ekonomiko-financiar të hartohet në repartë dhe të shqyrtohet në mbledhjet e prodhimit të ndërmarrjeve. Vërejtjet dhe propozimet e drejta të punëtorëve të përfshihen në projektplanin.

b) Të forcohet edhe më shumë bashkëpunimi midis dikastereve, organeve ekonomike shtetërore dhe Bashkimeve Profe-

sionale. Të respektohet rregulli i caktuar që problemet e pagave, të normimit të punës dhe të jetës së punonjësve të shqyrtohen dhe të vendosen në mbledhje të përbashkëta të kolegjumeve të dikastereve dhe të Presidiumit e Sekretariatit të Këshillit Qendror të BPSH.

c) Me qëllim që të ndihmohen komitetet dhe këshillat e Bashkimeve Profesionale për njohjen e problemeve që preokupojnë shtetin, është e domosdoshme që drejtorët e ndërmarrjeve, kryetarët e komiteteve ekzekutive, ministrat dhe zëvendësit e tyre të flasin më shpesh në mbledhjet e tyre për masat që duhen marrë për zhvillimin e ekonomisë, për çështje të jetës dhe të punës së punonjësve.

5. — Bashkimet Profesionale dhe organet ekonomike shtetërore të merren më shumë e më konkretisht me problemet e rëndësishme të pagave, kategorizimeve dhe normimit të punës.³² Sipas porosive të Partisë, organet e shtetit dhe Bashkimet Profesionale kanë punuar për të përsosur sistemin e pagave dhe të normimit të punës; por në zbatimin praktik vërtetohen edhe gënjime. Organet shtetërore dhe ato të Bashkimeve Profesionale nuk i njohin mirë, nuk i çmojnë si duhet dhe merren ende pak me këto probleme. Me qëllim që të zhidhen të metat dhe të perfeksionojmë sistemin e pagave dhe të normimit të punës, plenumi porositi të merren këto masa:

a) Të punohet vazhdimisht për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të pagave. Të zgjerohet sistemi i stimuljeve materiale për kursimin e lëndës së parë dhe të materialeve kryesore, duke forcuar edhe kontrollin për zbatimin e tyre.

Të merren masa në mënyrë që sistemi i punës me akord të zbatohet në ata sektorë ku praktikisht është i vështirë caktimi dhe kontrolli i normave ditore, si p.sh. në ndërtime, sharrat, kumitë. Në sektorët e tjerë të zgjerohet puna me norma si një sistem më progresiv.

b) Të përmirësohet puna për përgatitjen e kuadrove të reja dhe të bëhet një shpërndarje më e drejtë e punëtorëve të kualifikuar. Bashkimet Profesionale dhe organet shtetërore të jenë të kujdesshme në kategorizimin e punëtorëve, për të mos lejuar përsëritjen e gabimeve të kaluara.

c) Komisioni i Planit të Shtetit dhe dikasteret të planifikojnë drejt fondin e pagave, të mos lejojnë fonde të tepërta që çojnë në përdorimin pa vend të fuqisë punëtore, punën suplementare etj. Ministria e Financave dhe Komisioni i Kontrollit të Shtetit të jenë më të rreptë në këtë çështje.

c) Normat statistikore eksperimentale fshehin rezerva të mëdha për rritjen e rendimentit të punës. Rritja e kualifikimit të punëtorëve, perfeksionimi i proceseve teknologjike, zbatimi i metodave të reja duhet të çojnë në zëvendësimin e normave të vjetra me

norma të reja më të larta. Pra, është e nevojshme që organizatat profesionale dhe organet ekonomike të shqyrtojnë normat kur krijohen mundësitë në përputhje me ndryshimet që ndodhin në procesin teknologjik dhe në kualifikimin e punonjësve. T'i kushtohet më shumë kujdes regjistrimit të saktë të punës me norma. Të merret mirë në dorë nga ministritë çështja e vendosjes së normave teknike, për të zbatuar me kohë vendimin e Kongresit III të Partisë. Të vihet më shumë rregull në hartimin, interpretimin dhe kontrollin e sistemit të pagave dhe të normimit të punës. Këshilli i Ministrave të studjojë mundësinë e krijimit të komitetit shtetëror të pagave dhe të punës për të centralizuar më mirë këtë problem.

Realizimi me sukses i planit të dytë pesëvjeçar kërkon nga Partia dhe nga Bashkimet Profesionale që të zbatohet porosia e Kongresit të III të Partisë për të hyrë më thellë në çështjet ekonomike, për drejtimin e punëve në mënyrë konkrete, për inkurajimin e iniciativës krijuese të masave në prodhim, për zhvillimin e mëtejshëm të emulacionit socialist.

— III —

Kujdesi për përmirësimin e kushteve të punës e të jetës së punonjësve ka qenë dhe mbetet një detyrë e rëndësishme e Bashkimeve Profesionale

Niveli i jetesës së punonjësve në vendin tonë është pa krahasim më i lartë se në të kaluarën dhe shkon duke u rritur. Paga reale e punonjësve dhe fondet për qëllime social-kulturale rriten çdo ditë. Veprimtaria e organeve të shtetit për përmirësimin e kushteve të punës është shtuar. Një punë të madhe në këtë drejtim bëjnë Bashkimet Profesionale, Megjithatë, vihet re se nganjëherë organet shtetërore dhe ato të Bashkimeve Profesionale e ndajnë në mënyrë artificiale realizimin e detyrave të prodhimit nga problemet e jetës së punonjësve, nga edukimi i tyre. Legjislacioni i punës në vendin tonë është i plotë. Por ka kuadro që nuk tregojnë kujdesin e duhur për jetën e punonjësve, i zvarritin çështjet, veprojnë arbitrarisht në kundërshtim me ligjet. Bashkimeve Profesionale u janë besuar me ligje shumë të drejta, por ato nuk i ushtrojnë këto si duhet. Shumë herë tregohen të buta ndaj shkeljeve, nuk marrin me kohë masa për të zgjidhur drejt e në kohë kërkesat e punonjësve. Prandaj është e nevojshme që Bashkimet Profesionale të veprojnë më me këmbëngulje për zbatimin e përpiktë të legjislacionit të punës.

1. — Vendosja e 8-orëshit në punë është një fitore e madhe për punonjësit tanë. Bashkimet Profesionale dhe organet ekono-

mike, duke punuar për një organizim më të mirë të punës, të luftojnë rastet e panevojshme, që shfaqen aty këtu, për zgjatjen e kohës së punës jashtë orarit. Lufta për të kufizuar punën jashtë orarit është lufta për rregull në punë, për realizimin e planit sipas grafikut, për mbrojtjen e ligjeve të nxjerra në interes të shtetit dhe të punonjësve. Këshilli Qendror i BPSH, organet e drejtësisë dhe ato të kontrollit të shtetit duhet të tregohen më të rrepta në këtë drejtim.

2. — Të shtohet kujdesi, kontrolli dhe përgjegjësia për sigurimin teknik në punë. Kryesorja është ruajtja e jetës së njerëzve. Ndërmarrjet tona janë të reja dhe kanë të gjitha kushtet për të mënjeluar rreziqet në punë. Por ka ende të meta. Drejtuesit e disa ndërmarrjeve tregohen shumë herë të pakujdesshëm për plotësimin e masave mbrojtëse në punë dhe ka dikastere ekonomike që nuk sigurojnë si duhet mjetet mbrojtëse të nevojshme. Bashkimet Profesionale, nga ana e tyre, bëjnë mjaft lëshime në këtë drejtim. Është e domosdoshme që drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të dikastereve të punojnë më seriozisht për të mbyllur të gjitha shtigjet, nga mund të vijnë rreziqet në punë, dhe të mos lejojnë të punohet jashtë rregullave të caktuara. Komisioni i Planit të Shtetit dhe Këshilli Qendror i BPSH të studjojnë më me kujdes nevojat e ndërmarrjeve dhe të sigurojnë mjetet përkatëse për mbrojtjen në punë. Këshilli Qendror së bashku me dikasteret të rishikojë rregulloret e vjetra të sigurimit teknik dhe të hartojë rregullore për ato degë ku nuk ka të tilla. Organizatat profesionale, në bashkëpunim të ngushtë me organet ekonomike, të organizojnë mirë propagandën e sigurimit teknik në çdo ndërmarrje.

3. — Nga viti në vit po shtohen investimet për banesat e punonjësve. Me kursimet e tyre dhe me kredinë shtetërore shumë punonjës kanë ndërtuar banesa personale. Gjithashtu, me shtesat e planit të dytë pesëvjeçar investimet për banesa rriten shumë. Por me gjithë këto problemi i strehimit paraqet akoma disa vështirësi, të cilat vijnë edhe për faktin që ndërmarrjet nuk realizojnë plotësisht e me kohë ndërtimin e banesave. Prandaj organizatat profesionale dhe organet ekonomike duhet të tregojnë më shumë kujdes për ndërtimin në kohë dhe me cilësi të mirë të banesave... Komitetet ekzekutive të ndajnë fondin e banesave për çdo ndërmarrje pasi të kenë marrë më parë edhe mendimin e këshillave profesionale të rretheve. Ndarja e banesave në ndërmarrjet të bëhet me vendim të përbashkët të drejtorisë dhe të komitetit profesional. Është e domosdoshme të aktivizohen më shumë punëtorët për administrimin e banesave, për zbukurimin e tyre me punë vullnetare. Të formohen në apartamentet dhe në ndërtesat kolektive këshillat e banesave dhe të forcohet kontrolli shoqëror i Bashkimeve Profesionale.

4. — Përmirësimi i mëtejshëm i shërbimit të sigurimeve sho-

qërore është një nga detyrat më të rëndësishme të Bashkimeve Profesionale. Në kemi një sistem të plotë të sigurimeve shoqërore. Punonjësit janë materialisht të garantuar në të gjitha rastet e paaftësisë së përkohshme, të invaliditetit, të pleqërisë e të tjera. Nga sigurimet shoqërore janë shpenzuar çdo vit miliona lekë për shtëpitë e pushimit të punëtorëve dhe të pionierëve, për sanatoriumet e mencaat dietetike. Bashkimet Profesionale nuk luftojnë si duhet për uljen e paaftësisë së përkohshme, për organizimin e ndihmës shoqërore për të siguruarit. Ato duhet të marrin masa që ta përmirësojnë më tej shërbimin e sigurimeve shoqërore për punonjësit, duke patur parasysh:

a) Të shtojnë luftën e tyre kundër epidemive, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, me qëllim që të ulen paaftësinë e përkohshme në punë. Është e nevojshme që të shtohet puna për edukatën sanitare me punonjësit dhe për shërbimin shëndetësor profilaktik në ndërmarrje. Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Këshillin Qendror dhe me ministrinë përkatëse, të pregatit një plan me afat të gjatë për zgjerimin e rrjetit shëndetësor në qendrat e punës dhe për plotësimin e tij me kuadrot e domosdoshëm. Organet e planifikimit dhe Ministria e Shëndetësisë t'u japin precedencë qendrave të punës, e në radhë të parë atyre jashtë qyteteve, në shpërndarjen e kuadrove shëndetësore të lartë e të mesëm. Ministria e Shëndetësisë dhe organizatat profesionale të shtojnë kontrollin në institutet shëndetësore, me qëllim që të përmirësohet shërbimi për punonjësit.

Bashkimet Profesionale të kuptojnë se detyrë kryesore në lëmin e sigurimeve shoqërore është ruajtja e shëndetit të punonjësve, shërbimi për të sëmurët. Ato duhet të zgjerojnë edhe më shumë rrjetin e shtëpive të pushimit të punëtorëve dhe të pionierëve në qendrat kryesore klimaterike të vendit tonë dhe të sigurojnë në to një shërbim më të mirë dhe të kulturuar.

b) Bashkimeve Profesionale u janë besuar mjete të shumta financiare dhe ato duhet të jenë mjaft të kujdesshme që të përdoren me vend në interes të punonjësve. Të forcojnë kontrollin dhe revizionin, me qëllim që të mënjanohen shpërdorimet. Për kontrollin e veprimtarisë financiare të sigurimeve shoqërore në ndërmarrjet të ndihmojnë edhe revizionet e Komisionit të Kontrollit të Shtetit, të Ministrisë së Financave, të dikastereve dhe të komiteteve ekzekutive. Fondet që krijohen nga kontributi i sigurimeve shoqërore të përdoren drejt dhe më me nikoqirllëk për këto qëllime. Bashkimet Profesionale të sigurojnë që punonjësit të marrin drejt dhe në kohë shpërblimet që u takojnë, të zgjidhin me kohë kërkesat e tyre të ligjshme.

c) Me qëllim që të rregullohen disa boshllëqe dhe të përkohet ligja e sotme e sigurimeve shoqërore, Këshilli Qendror

i BPSH të fillojë hartimin e ligjës së re të sigurimeve shoqërore, duke përfshirë këtu edhe pensionet, e cila, përpara se t'i dërgohet për aprovim Kuvendit Popullor, të diskutohet me punëtorët. Të hiqen pensionet nga administrimi i Ministrisë së Financave dhe të kalojnë në Bashkimet Profesionale.³³

5. — Të studjohen masat për forcimin dhe zgjerimin e ekonomisë ndihmëse, të cilat, sipas konditave të ndërmarrjeve, mund të jenë edhe të specializuara: bujqësore, blegtorale etj. Dikasteret të marrin masa që ekonomitë ekzistuese të bëhen të gjitha rentabile dhe të forcohet mbi to kontrolli për të mënjanuar shpërdorimet.

6.— Kontrolli shoqëror mbi rrjetin e tregëtisë, të menceve, të depove, të magazinave, të dyqaneve është një mjet i fuqishëm për të përmirësuar punën e rrjetit të tregëtisë dhe të ushqimit social. Në këtë drejtim roli i Bashkimeve Profesionale është i madh dhe ato duhet të kujdesen më shumë për aktivizimin e kontrollit shoqëror.

Autoriteti dhe forca mobilizuese e Bashkimeve Profesionale varet shumë nga sa ato kujdesen për nevojat e jetës së punonjësve. Ato, në bashkëpunim me organizatat e gruas, të njohin më thellë nevojat e jetës së njerëzve, t'i ndihmojnë ata për të zgjidhur çështjet e familjes dhe personale. Realizimi i planit në ndërmarrje dhe përmirësimi i konditave të jetës së punonjësve janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën dhe prandaj Bashkimet Profesionale të luftojnë me të gjitha forcat për zbatimin e legjislacionit të punës, të kontratave kolektive, për të zgjidhur me kohë dhe drejt kërkesat dhe ankesat e punonjësve, për t'i ngritur këto probleme përpara Partisë dhe organeve shtetërore.

— IV —

Edukimi i gjithanshëm i klasës punëtore është çështje themelore në punën e Partisë dhe të Bashkimeve Profesionale

Prapambetja e madhe kulture e trashëguar nga e kaluara, rritja e shpejtë e klasës punëtore, roli udhëheqës i saj në sistemin tonë shtetëror dhe shoqëror, ritmi i shpejtë i zhvillimit të vendit tonë drejt socializmit e bëjnë punën e edukimit të klasës punëtore një detyrë të dorës së parë.

Suksese të mëdha janë arritur në edukimin e klasës punëtore dhe në ngritjen e nivelit të saj kultural e teknik. Veçantia e klasës sonë punëtore nuk është vetëm rritja e saj numerike, por edhe ngritja e nivelit të saj ideologjik, arësor dhe teknik. Pas Plenumit të prillit të 1955-ës të Komitetit Qendror të Partisë mbi punën ideologjike, jeta kulture e politike me punëtorët u gjallërua, puna

e edukimit filloi të vlerësohet më mirë, u rrit preokupacioni dhe iniciativa e bazës.

Por akoma niveli kultural dhe teknik i punonjësve është i ulët në krahasim me detyrat e mëdha që i shtrohen klasës punëtore. Puna edukative e kulture e Bashkimeve Profesionale dhe e organizatave të rinisë me punëtorët zhvillohet me të meta.

Bashkimet Profesionale, para së gjithash, janë shkolla të edukimit komunist të masave, dhe pra veprimtaria e tyre edukative zë një nga vendet e para. Plenumi porositi organizatat e Partisë, të Bashkimeve Profesionale dhe ato të rinisë:

1. — Të shtojnë dhe të përmirësojnë punën për edukimin politik dhe ideologjik të punëtorëve, të nëpunësve dhe të inteligjencies. Heroizmat që tregojnë klasa jonë punëtore në ndërtimin e vendit dëshmojnë për formimin e pikëpamjeve të reja të njerëzve tanë mbi punën, se po lind njeriu i ri, që mbi të gjitha vë interesat e atdheut e të popullit.

Por puna ideologjike edukative me klasën punëtore nuk është aq e thellë e bindëse, e vazhdueshme, e diferencuar. Ajo nuk lidhet sa duhet me problemet ekonomike dhe i shërben akoma pak formimit të qëndrimit të ri ndaj punës dhe pronës socialiste, forcimit të disiplinës në punë. Ndërtimi i socializmit është një proces i gjatë dhe i vështirë i luftës kundër ideologjisë së vjetër, i çlirimit të njerëzve nga zakonet e vjetra prapanike, i formimit të botëkuptimit të ri socialist. Puna e Partisë dhe e Bashkimeve Profesionale për formimin ideologjik të njerëzve, për shpjegimin e marksizëm-leninizmit duhet të lidhet shumë ngushtë me qëndrimin e ri ndaj punës, me zbatimin e detyrave, me forcimin e disiplinës, me problemet e ndërtimit socialist. Bashkimet Profesionale të përmirësojnë propagandën e prodhimit, të shpjegojnë më mirë dhe më thellë vendimet e Partisë dhe të qeverisë, ligjet e problemet konkrete të ekonomisë. Në punën edukative sqaruese të përfshihen të gjithë punëtorët, të bëhet një punë e veçantë me punëtorët e rinj stinorë dhe me gratë punëtore, të bashkëpunohet me shumë me organizatën e Bashkimit të Rinisë së Punës dhe organizatën e gruas për këtë qëllim. Të caktohen si propagandistë e agjitorë njerëzit më të aftë në ndërmarrje, të përgatitur politikisht, kuadro të shtetit, drejtorë të ndërmarrjeve, inxhinierë, kuadro të komiteve ekzekutive dhe të dikastereve. Të organizohen më mirë puna me leksione, mbledhjet për pyetje e përgjigje, mbrëmjet tematike, të shfrytëzohet më mirë shtypi, radioja, qendrat e përhapjes së zërit dhe të gjenden forma të reja tërheqëse. Gjithë puna edukative e Bashkimeve Profesionale t'i shërbejë ngritjes politike dhe ideologjike të punëtorëve, formimit të qëndrimit të ri ndaj punës, pronës socialiste, interesave të përgjithshme dhe forcimit të disiplinës në punë.

2. — Ngritja e nivelit tekniko-profesional të klasës punëtore

është detyrë e dorës së parë për Bashkimet Profesionale. Me gjithë sukseset e mëdha në ngritjen e nivelit profesional të punëtorëve dhe në përgatitjen e inteligjencies teknike, ka ende një disproporcion midis nevojave për zhvillimin me ritëm të shpejtë të ekonomisë dhe numrit të kuadrove, midis kërkesave të teknikës së re dhe nivelit të ulët tekniko-profesional të punonjësve. Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë porositi edhe një herë Bashkimet Profesionale dhe organet shtetërore të marrin masa, me qëllim që:

a) Të përmirësohet planifikimi në format e arësimit teknik. Dikasteret të marrin parasysh gjatë planifikimit edhe mendimin e vetë ndërmarrjeve. Komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive dhe këshillat e Bashkimeve Profesionale të rretheve të ushtrojnë më shumë kontroll dhe të ndihmojnë në realizimin e planeve për përgatitjen e kuadrove të rinj dhe kualifikimin e punonjësve. Dikasteret të përgatitin sa më shpejt për disa degë të ekonomisë programe dhe lëndë mësimore që mungojnë dhe të hartojnë programe të diferencuara sipas kategorive të punonjësve. Programet e kurseve të kualifikimit, me përjashtim të rasteve të veçanta, të bëhen në bazë të viteve të rregullta shkollore.

b) Të caktohen si drejtues dhe inxhinierë të formave të arësimit teknik elementët më të aftë nga radhët e inxhinierëve dhe të teknikëve, në radhë të parë specialistët e atyre reparteve ku ata punojnë.

c) Në disa sektorë pune e prodhimi me karakter stinor, siç janë industria e sheqerit, e konservave, e vajit, e duhanit, SMT-të, ndërmarrje të ndërtimit etj., të organizohen kurse për t'u mësuar punëtorëve dy-tri mjeshtëri, që të mund të punojnë gjatë gjithë vitit. Për të lehtësuar pjesëmarrjen e grave në format e arësimit teknik, të organizohen kurse të veçanta me gratë me orar të favorshëm, sidomos në disa qendra industriale. Kurse të tilla me gratë mund të zhvillohen edhe në qendrat e banimit dhe për këtë të ndihmojë më shumë organizata e gruas. Komitetet profesionale dhe drejtoritë e ndërmarrjeve t'i kushtojnë shumë më tepër kujdes planifikimit dhe organizimit të mirë të formave të patronazhit të punëtorëve të rinj, nga punëtorët e kualifikuar, lidhjes së marrëveshjes midis tyre. Organizatat e Bashkimeve Profesionale dhe ato të rinisë të bëjnë një punë shumë më të madhe për të rritur te punëtorët e rinj dashurinë për mjeshtërinë, vullnetin për të mësuar. Ngritja e nivelit profesional të klasës punëtore është pjesë e edukimit të saj, prandaj organizatat profesionale ta marrin në dorë mirë këtë çështje.

3. — Ngritja kulture e arësimore e punëtorëve dhe e nëpunësve është një detyrë shumë e rëndësishme në punën edukative të Bashkimeve Profesionale dhe të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë.

a) Shkollat e natës dhe me korrespondencë po ndihmojnë shu-

më në ngritjen e nivelit arësor e kultural të klasës punëtore. Rëndësia e tyre po shtohet çdo vit, sepse numri i pjesëmarrësve po rritet me shpejtësi. Vendimi i qeverisë për ta bërë arësimin fillor të detyrueshëm për punëtorët është një masë me shumë rëndësi, por ai nuk po zbatohet si duhet. Shumë punëtorë që kanë mbaruar kursin kundër analfabetizimit është rrezik që të kthehen përsëri në analfabetë. Ministria e Arësimit dhe Kulturës dhe organet e saj në rrethe duhet të shtojnë kujdesin dhe kontrollin mbi shkollat e natës dhe me korrespondencë.

Organizatave profesionale, ato të rinisë dhe drejtoritë e ndërmarrjeve duhet të nxitin dhe të ndihmojnë punonjësit që ndjekin shkollat e natës. Të studjohet mundësia e kalimit në vjetet e ardhshëm për disa kategori punonjësish në arësimin 7-vjeçar të detyrueshëm.

b) Me gjithë përmirësimet, Bashkimet Profesionale dhe organizatat e rinisë nuk kujdesen sa duhet për të organizuar çlodhjen aktive dhe të kulturuar të rinisë dhe të punëtorëve pas punës. Organizimi i kësaj pune është një çështje shumë serioze, prandaj duhet të bëhet problem i organizatave profesionale dhe të rinisë. Të përdoren më mirë dhe më gjerësisht për këto qëllime aktiviteti artistik, kinematë, fizikultura e turizmi, mbrëmjet kulture argëtuese.

4. — Krahas rritjes së aktivitetit kultural, janë shtuar dhe zgjeruar institucionet kulture të shtetit dhe të Bashkimeve Profesionale. Bashkimet Profesionale në ndërmarrjet më të rëndësishme kanë klube, kinema, biblioteka, kënde të kuq, terrene sportive. Por ato nuk shfrytëzohen ende si duhet dhe zhvillojnë një aktivitet të kufizuar. Në to nuk ndihet sa duhet influenca e punës shoqërore. Këto dobësi vijnë sepse në mjaft qendra caktohen elementë të pa aftë dhe të papregatitur nga ana profesionale e kulture, programet nuk përgatiten mirë dhe mbledhjet e shumta pengojnë pjesëmarrjen. Bashkimet Profesionale të luftojnë për zgjerimin e bazave materiale, për shfrytëzimin e tyre më të mirë, për ruajtjen e tyre. Të zgjerohet rrjeti i aktivitetit, të zgjerohet puna shoqërore në to, të tërhiqet në aktivitetin e tyre inteligjencia jonë. Komitetet e Partisë të caktojnë në drejtimin e qendrave kulture kuadro të kualifikuar, me horizont të gjerë, energjikë dhe me iniciativë. Të zgjidhen ata me kujdes dhe të mos lëvizin dëndur dhe pa kriter. Bashkimet Profesionale dhe organizatat e rinisë të kujdesen më shumë për të shfrytëzuar në maksimum qendrat kulture të shtetit, të frekuentohen më gjerë teatrot, kinematë, bibliotekat, muzeumet dhe shtëpitë e kulturës.

5. — Përmirësimi i aktivitetit të gjithanshëm të Bashkimeve Profesionale kërkon që ato të merren më shumë se deri sot me inteligjencien, të kujdesen për nevojat materiale, për edukimin dhe aktivizimin e saj. Inteligjencia jonë është një fuqi e madhe

kulture, e cila duhet të vihet në lëvizje për zbatimin e detyrave shoqërore që kanë Bashkimet Profesionale.

6. — Edukimi fizik është pjesë përbërëse e edukimit komunist të klasës punëtore. Ndryshimet në strukturën, përqëndrimi i lëvizjes fizikulture në një shoqëri të vetme, në Bashkimin e Sportistëve të Shqipërisë, nuk i shkarkon aspak Bashkimet Profesionale nga përgjegjësia dhe detyrat për zhvillimin e fizikulturës. Ato duhet të luftojnë për zgjerimin e pjesëmarrjes së punëtorëve dhe të grave punëtore në aktivitetet e ndryshme sportive, të zgjerohen veçanërisht disa gjini të tilla masive të sportit siç janë kroset, gjimnastika në prodhim, eskursionet turistike, kompleksi GPM e të tjera. Bashkimet Profesionale të luftojnë për zgjerimin dhe shfrytëzimin më të mirë të bazës materiale, të terreneve sportive, për forcimin organizativ të kolektivave fizikulture, për edukimin e sportistëve.

Formimi i njerëzve të rinj është një proces i gjatë dhe i vështirë. Bashkimet Profesionale, si shkolla të edukimit komunist, kanë në këtë punë një rol dhe një përgjegjësi shumë të madhe. Kombinimi i luftës për rritjen e rendimentit të punës dhe të prodhimit me përmirësimin e kushteve të jetesës, lidhja e punës edukative dhe organizative me çështjet e zhvillimit të ekonomisë përbëjnë hallkën më të rëndësishme në drejtimin e punës së Bashkimeve Profesionale.

— V —

Ngritja e nivelit të punës organizative është kusht i domosdoshëm për zbatimin e detyrave që u shtrohen Bashkimeve Profesionale

Bashkimet Profesionale janë rritur, janë forcuar dhe është shtuar autoriteti i tyre në masat. Ndryshimet që janë bërë në strukturën organizative, thjeshtësimi i aparatit administrativ kanë çuar në gjallërimin e tyre të brendshëm, në shtimin e punës shoqërore, në forcimin e lidhjeve të organizatës me masat, në përmirësimin e punës së organeve drejtuese. Por organizatat profesionale nga pikëpamja organizative janë ende të dobëta dhe jo në nivelin e detyrave të kohës. Organet drejtuese në përgjithësi çalojnë. Organizatat bazë në ndërmarrje kanë ende pak iniciativë.

Gjallërimi dhe rritja e rolit të organizatave bazë të Bashkimeve Profesionale, përmirësimi i punës me kuadrin dhe aktivin, forcimi i organeve drejtuese, forcimi i udhëheqjes së Partisë mbi Bashkimet Profesionale janë hallkat më të rëndësishme për forcimin e mëtejshëm organizativ të Bashkimeve Profesionale.

1. — Organizatat bazë janë themeli i Bashkimeve Profesionale. Për forcimin e mëtejshëm të tyre është e nevojshme:

a) Me qëllim që të zgjerohen edhe më shumë funksionet dhe

kompetencat e organizatave bazë të Bashkimeve Profesionale në ndërmarrje dhe në institute, Këshilli Qendror i BPSH dhe organet e tjera kompetente të nxjerrin dispozitat përkatëse, duke i diskutuar këto më përpara me të gjithë punëtorët.

b) Forcimi i mëtejshëm i organizatës bazë të Bashkimeve Profesionale kërkon zgjedhjen me kujdes dhe edukimin e kryetarëve të komiteteve profesionale. Të zgjidhen në krye të komiteteve profesionale elementë të aftë, që jo formalisht, por efektivisht të jenë autoritet në ndërmarrje. Të zgjidhen njerëzit më të mirë të ndërmarrjes, punëtorët më të dalluar në prodhim, inxhinierët, teknikët, që e njohin prodhimin, njerëz të masave dhe që duan të punojnë me to. Këshilli Qendror i BPSH, me anën e kurseve, shkollave, seminareve, të punojë më me perspektivë për përgatitjen e kryetarëve të komiteteve profesionale dhe të mbahet parasysh që këta të mos lëvizin shpesh. Të forcohen komitetet profesionale. Të luftohet për respektimin e parimit të kolegjalitetit dhe gjërat të mos i vendosë vetëm kryetari i komitetit profesional, por komiteti, dhe për çështje me rëndësi mbledhja e përgjithshme e anëtarëve. Të kufizohen mbledhjet e shumta dhe të gjata.

Forcimi dhe gjallërimi i organizatës bazë të Bashkimeve Profesionale kërkon një ndihmë më të mirë e më të kualifikuar nga ana e organeve drejtuese të rretheve dhe të Këshillit Qendror të BPSH.

2. — Përmirësimi i punës me kuadrin dhe aktivin është një nga kushtet kryesore për forcimin e mëtejshëm organizativ të Bashkimeve Profesionale. Në aparatet e Bashkimeve Profesionale punojnë kuadro të mira, të dala nga radhët e klasës punëtore dhe me eksperiencë. Është formuar një bërthamë aktivistësh që kryen shumë detyra shoqërore. Megjithatë, puna për zgjedhjen, edukimin dhe aktivizimin e kuadrit dhe të aktivitetit nuk është në nivelin e duhur. Organet e Partisë të marrin masa për të forcuar Bashkimet Profesionale me kuadro të aftë. Në aparatet e tyre të vijnë më shumë njerëz nga baza që njohin prodhimin, më shumë specialistë që të kenë edhe cilësinë e organizatorit dhe të njeriut të masave. Organet e Partisë, Këshilli Qendror dhe këshillat e rretheve të Bashkimeve Profesionale duhet të kërkojnë nga kuadrot që të ngrenë nivelin e tyre arësor e profesional. Më shumë kuadro të Bashkimeve Profesionale të dërgohen në Shkollën dhe në kurset e Partisë... Këshilli qendror të ketë një program perspektiv për përgatitjen e kuadrit.

Aktivi është forca kryesore e organizatës profesionale. Me gjithë përmirësimet, Bashkimet Profesionale vënë pak njerëz në lëvizje. Intelektualët pak aktivizohen. Kuadrot profesionalë përpiqen t'i bëjnë punët vetë. Ka edhe pikëpamje të ngushta për të ngarkuar po të njëjtët njerëz në shumë detyra. Është e nevojshme të kuptohet se Bashkimet Profesionale pa aktiv nuk mund t'i

kryejnë detyrat e tyre. Zgjedhja e tij me kujdes nga radhët e punëtorëve të përparuar, nga të rinjtë, nga radhët e intelektualëve, të grave, përbën një çështje shumë të rëndësishme në punën organizative të Bashkimeve Profesionale. Të aktivizohen ata më me kurajo dhe t'i mësojnë t'i njohin detyrat e tyre më me durim. Të vendosen kontakte të gjalla midis funksionarëve dhe aktivistëve, të përdoren titujt dhe shpërblimet morale e materiale, si dekorimet, fletët e nderit, distinktivet, me qëllim që titulli i aktivistit të bëhet një titull nderi.

3. — Përmirësimi dhe forcimi i udhëheqjes së Partisë mbi Bashkimet Profesionale është faktori vendimtar për zgjerimin e aktivitetit të Bashkimeve Profesionale dhe për forcimin e mëtejshëm organizativ të tyre. Sukseset në punë të organizatave profesionale varen në radhë të parë nga fakti se si organet dhe organizatat e Partisë i drejtojnë, si i udhëheqin, si i ndihmojnë ato. Është e domosdoshme që organet dhe organizatat e Partisë të mos bëjnë ato vetë punën e Bashkimeve Profesionale, por t'u ngarkojnë atyre detyra dhe të kërkojnë nga ato më shumë, t'i ndihmojnë që të bëhen të afta për t'i zgjidhur vetë çështjet që u përkasin. Komitetet e Partisë, në mbledhjet e plenumeve, të aktiveve dhe të organizatave bazë të shqyrtojnë herë pas here problemet e punës së Bashkimeve Profesionale, t'u hapin perspektiva. Kuadrot e Partisë të shkojnë më dendur në organet e Bashkimeve Profesionale dhe në mbledhjet e anëtarëve të tyre. T'u shpjegohet më mirë komunistëve se anëtari i Partisë është i detyruar, sipas statutit, të punojë me masat, të bëjë pjesë në një organizatë masash, të kryejë një detyrë shoqërore.

Detyra e Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë është që të forcojnë edhe më shumë marrëdhënjet vëllazërore që egzistojnë me Bashkimet Profesionale të Bashkimit Sovjetik, në radhë të parë, dhe me ato të vendeve të demokracisë popullore, dhe të përfitojnë nga eksperiencia e punës së tyre. Bashkimet Profesionale të Shqipërisë të forcojnë e të zgjerojnë marrëdhënjet me organizatat sindikale të të gjitha vendeve dhe, duke ndjekur vijën unitare të Federatës Sindikale Botërore, duke marrë pjesë aktive në përpjekjet e saj, të shtojnë kontributin e tyre në kapërcimin e përçarjes që egziston sot në lëvizjen sindikale botërore, kundër rrezikut të një lufte të re.

* * *

Bashkimet Profesionale janë leva të fuqishme që lidhin Partinë tonë me masat, që e ndihmojnë atë për të zgjidhur detyrat e ndërtimit socialist. Plenumi u bën thirrje gjithë anëtarëve të Partisë, organizatave dhe organeve të saj që të marrin të gjitha masat për të ngritur në një shkallë më të lartë punën e Bashkimeve Profesionale, për t'i forcuar ato, për t'i bërë më të gjalla dhe më

aktive në luftën që zhvillon Partia jonë për ta bërë atdheun tonë të zhvilluar ekonomikisht dhe të kulturuar, për ta bërë një kopsht të lulëzuar të socializmit.

Plenumi shpreh bindjen se Bashkimet Profesionale, nën udhëheqjen e Partisë, do të përmirësojnë shpejt punën e tyre dhe do të kryejnë me sukses rolin e tyre të rëndësishëm për organizimin, edukimin dhe mobilizimin e klasës punëtore në luftën për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 82
datë 6 prill 1958

PLENUMI X I KQ TË PPSH

Tiranë, 20 qershor 1958

KOMUNIKATË E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Më 20 qershor 1958 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Plenumi degjoi raportin e mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, shoku Enver Hoxha, mbi rezultatet e zgjedhjeve për në Kuvendin Popullor; mbi zhvillimin e punimeve të Mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve pjesëmarrëse në Këshillin Ekonomik të Ndihmës Reciproke të mbajtur kohët e fundit në Moskë³⁴; mbi pikëpamjet antimarksiste e antisocialiste të grupit Tito, që u shprehën edhe një herë në Kongresin VII³⁵ të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë e programin e saj dhe mbi luftën pa kompromis që duhet bërë për demaskimin e shkatërrimin politik e teorik të revizionizmit modern; si dhe mbi punën e delegacionit të PPSH dhe punimet e Kongresit VII të Partisë Komuniste Bullgare.

Plenumi aprovoi plotësisht raportin e paraqitur nga Sekretari i parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, dhe njëzëri mori vendimet përkatëse.

PLENIUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT I MBAJTUR NGA SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH SHOKU ENVER HOXHA

«Mbi pikëpamjet antimarksiste e antisocialiste të grupit Tito që u shprehën edhe një herë në Kongresin VII të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë e programin e saj dhe mbi luftën pa kompromis që duhet bërë për demaskimin e shkatërrimin politik e teorik të revizionizmit modern»

20 qershor 1958

Komiteti Qendror është në dijeni të të gjitha materialeve të ndryshme që ka botuar shtypi ynë si dhe shtypi i PK të BS, Partisë Komuniste të Kinës dhe i të gjitha partive të tjera motra mbi veprimtarinë armiqësore, tradhëtare të grupit trockist të udhëheqjes së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Nuk është nevoja të zgjatem këtu e të them se sa e drejtë, marksiste-leniniste ka qenë kurdoherë vija e KQ dhe e Partisë sonë ndaj këtyre tradhëtarëve. Partia jonë ka qenë vazhdimisht në këmbë kundër tyre, s'është lëkundur asnjëherë karshi tradhëtarëve të Beogradit dhe i ka luftuar ata pa mëshirë. Partia jonë e ka të qartë se ç'luftë të pamëshirshme duhet të zhvillojmë ne për demaskimin dhe shkatërrimin e plotë të revizionizmit modern, që udhëhiqet nga grupi tradhëtar i Beogradit.

Nuk është e tepërt që, në dritën e ngjarjeve të fundit, të flasim edhe një herë për trockistët jugosllavë, megjithëse ne ishim të bindur qënd për qënd se ata prisnin çastin e favorshëm për të na dëmtuar. Tani ne na duhet të formulojmë se ç'rrezik paraqet revizionizmi i sotëm, dmth punën armiqësore të LKJ si në projekt-programin, ashtu edhe në Kongresin VII të tyre.

Dihet se në bazë të situatës së krijuar u muar vendim nga KQ i PK të BS, qysh në 1954, për të përmirësuar marrëdhënjet me klikën e Beogradit. Por trockistët jugosllavë edhe pas këtyre përpjekjeve treguan edhe një herë tjetër, akoma më mirë, se ç'ishin.

Udhëheqësit trockistë të Beogradit na ftuan të dërgonim një delegacion për të marrë pjesë në Kongresin VII të LKJ. Byroja Politike nuk u shpejtua të jepte përgjigje, për arsye se ne e dimë mirë se ç'janë ata dhe ç'do të bënin. Bile Byroja Politike gjykonte drejt duke menduar se ata do të përfitonin nga situata që kishte krijuar Partia jonë për përmirësimin e marrëdhënjeve për të bërë grushtin që bëjnë dhe poshtërsitë e tyre.

Duke mos u shpejtuar në përgjigjen e kësaj ftese, Byroja Politike mendonte të shihte se ç'do të bënin edhe partitë e tjera motra dhe pastaj të vendoste. Po vendimi që do të merrte Partia

jonë nuk do të influencohej nga ai i partive të tjera motra, sepse edhe Partia jonë ka mendimet e veta dhe mendimi ynë, që në fillim, ishte që të mos merrnim pjesë në Kongresin VII të LKJ. Pastaj, kur u publikua edhe projektprogrami i LKJ, ne vendosëm përfundimisht të mos dërgonim në asnjë mënyrë delegacionin edhe sikur partitë e tjera të dërgonin. Mirëpo ashtu sikurse ne menduan dhe vepruan edhe të gjitha partitë e tjera motra ndaj Kongresit VII të LKJ.

Tani nga të gjitha partitë motra zhvillohet një luftë e ashpër kundër klikës tradhëtare të Beogradit. Edhe Partia jonë po lufton për të mbrojtur pastërtinë revolucionare të marksizëm-leninizmit nga sulmet që bëjnë imperialistët nëpërmjet revizionistëve dhe kryesisht nëpërmjet grupit tradhëtar të LKJ.

Partia jonë, besnike e marksizëm-leninizmit, së bashku me të gjitha partitë e tjera, ka luftuar, lufton dhe do të luftojë deri në fund për demaskimin e revizionizmit dhe për ruajtjen e pastërtisë ideologjike të Partisë. Me anën e materialeve që janë botuar dhe po botohen dhe që edhe më shumë duhet të botohen, Partia ka vënë në dijeni organizatat e partisë, anëtarët e saj dhe popullin për luftën që bëjnë partitë komuniste dhe punëtorë kundër revizionizmit.

Shfaqja e revizionizmit të sotëm nuk është një gjë e rastit. Ajo është diçka e diktuar nga disa rrethana historike objektive. Dihet se sot kontradikta themelore është kontradikta midis kampit socialist dhe kampit imperialist, lufta midis socializmit, që po rritet e zhvillohet me shpejtësi, dhe kapitalizmit, që po dobësohet vazhdimisht. Në këtë situatë imperializmi nuk i dorëzon armët. Përkundrazi ai përpiqet me çdo kusht që të pengojë rritjen e forcave të socializmit dhe të zgjasë ekzistencën e tij. Eksperienca historike ka treguar se për t'ja arritur këtij qëllimi imperializmi përdor dy metoda: a) metodën e dhunës, të shtypjes së lëvizjes revolucionare në vendet kapitaliste me anë të forcës, metodën e diversionit dhe të pregatitjes së hapët të luftës kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të kampit socialist, dhe b) metodën e mashtrimit e të shpifjes, të skllavërimit shpirtëror të masave. Metodën e parë imperializmi e realizon me anën e policisë, të gjyqeve dhe të diktaturës së tij, ndërsa metodën e dytë e realizon me anë të propagandistëve të tij, të ideologëve borgjezë dhe të agjentëve të ndryshëm në radhët e lëvizjes punëtorë, siç janë aristokracia punëtorë, socialistët e djathtë dhe oportunistët e revizionistët e ndryshëm. Në kohën e sotme, kur idetë e marksizëm-leninizmit janë bërë të masave dhe nën flamurin e tyre popujt po luftojnë me besim për të ardhmen e tyre, aristokracisë punëtorë e socialistëve të djathtë, që vazhdimisht kanë mbajtur anën e borgjezisë, u ka dalë boja. Ata nuk munden më të mashtrojnë popujt. Kështu, p.sh., askush nuk u

beson socialistëve në Francë, as laburistëve në Angli. Për këtë arësyje roli kryesor për mashtrimin e klasës punëtore dhe të popujve të ndryshëm i është besuar nga imperializmi revizionizmit të sotëm dhe në radhë të parë revizionistëve jugosllavë, që janë qendra e revizionizmit të sotëm. Prandaj ne shohim se simbas udhëzimeve të imperializmit, dhe kryesisht të imperializmit amerikan, revizionistët jugosllavë nga dita në ditë po shtojnë aktivitetin e tyre antisocialist e antimarksist-leninist, që arriti kulmin në kongresin VII të LKJ.

Bazë ideologjike e revizionizmit të sotëm, pra edhe e revizionizmit jugosllav, janë teoritë e vjetra të revizionizmit të Bernshajtinit, Kautskit etj.; janë teoritë antimarksiste të të gjithë oportunistëve dhe armiqve të socializmit, e trockistëve, buharinistëve, opozitës punëtore etj., janë teoritë false të socialdemokracisë. Kjo shprehet qartë në programin e LKJ. Por revizionistët jugosllavë këto «teori» kërkojnë t'i shesin si marksiste, ata flasin si «marksistë», si «luftëtarë për socializmin», pra fshehin fytyrën e e tyre të vërtetë.

«Dialektika e historisë është e tillë, — shkruante Lenini, — që fitorja teorike e marksizmit i detyron armiqut e tij të vishen si marksistë. . .»³⁶

Revizionistët jugosllavë, për të mashtruar edhe më mirë popujt dhe klasën punëtore, e paraqesin vendin e tyre si «socialist», partinë e tyre si «komuniste» etj. Në të vërtetë si është puna? Marksizëm-leninizmi mëson se partitë politike nuk gjykohen nga deklaratat e titujt që i venë vetes, por nga veprimet e tyre konkrete, nga vendi që zenë në luftën e klasës që zhvillohet midis klasës punëtore dhe borgjezisë, midis socializmit dhe kapitalizmit. Qysh shumë kohë më parë dhe veçanërisht në kohët e fundit gjithë bota po e sheh qartë se shteti jugosllav dhe LKJ në luftën midis dy kampeve objektivist ka marrë anën e armiqve të socializmit, atë të minimit të partive komuniste e punëtore, atë të shkatërrimit nga brenda të shteteve socialiste (ngjarjet e Hungarisë e provojnë këtë), atë të përçarjes së kampit socialist dhe partive komuniste. Askush nuk mashtrohet nga fakti që në Jugosllavi ka disa forma socialiste, që janë krijuar menjëherë pas çlirimit të vendit, dhe të thotë se gjoja klasa punëtore është në fuqi, se ndërmarrjet janë në duar të punonjësve etj. Të gjitha këto ruhen me qëllim nga udhëheqësit revizionistë jugosllavë. Ato nuk i prishin punë as imperializmit amerikan, sepse në këtë mënyrë titizmi fsheh më mirë fytyrën e tij të vërtetë përpara botës dhe përpara vetë popullit jugosllav dhe e ka më lehtë të zhvillojë veprimtarinë e tij armiqësore. Forma nuk e ndryshon përmbajtjen. Këtë e tregon vetë realiteti jugosllav: Në fuqi nuk janë borgjezia dhe çifligarët, shteti quhet republikë popullore, por po-

litika dhe veprimtaria e tij është kundër popullit, kundër socializmit, është në dobi të borgjezisë imperialiste; ndërmarrjet industriale gjoja «vetëadministrohen» nga punëtorët e jo nga kapitalistët, por kjo nuk pengon që në treg të veprojnë ligjet kapitaliste të konkurrencës dhe të anarkisë në prodhim, të varfërimit të masave, të pasurimit të një pjese të vogël, pra të lindjes së elementit të ri kapitalist; tokat nuk janë në duar të çifligarëve, por bujqësia zhvillohet mbi bazën e pronës private, kooperativat bujqësore u shkatërruan dhe dihet nga të gjithë se pronë e vogël private pjell përditë kapitalizmin. Të gjitha këto tregojnë se Jugosllavia gjendet në fazën e kalimit të plotë në rrugën e zhvillimit kapitalist, të shqelmimit përfundimtar të aspiratave dhe të luftës së popujve jugosllavë për socializmin. Shteti jugosllav objektivist po kthehet në një shtet borgjez të klasës punëtore dhe LKJ në një parti borgjeze të klasës punëtore, e cila nuk ndërton socializmin, por lufton kundër tij. Këtu shihet qartë se udhëheqja revizioniste jugosllave nuk është gjë tjetër, veçse një bandë e turpshme renegatësh, që ka tradhëtuar socializmin dhe që vepron edhe në dëm e interesave jetike të vetë popujve jugosllavë. Këtej del edhe detyra për të gjithë komunistët që të zhvillohet një luftë e papajtueshme për ta varrosur politikisht dhe teorikisht revizionizmin, si rrezikun kryesor për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, si agjenturën më të tërbuar të imperializmit, e veçanërisht të imperializmit amerikan.

Dihe se udhëheqësit jugosllavë u larguan nga parimet bazë të marksizëm-leninizmit dhe shkanë në pozitat e nacionalizmit borgjez qysh përpara vitit 1948. Vendi ynë dhe Partia jonë e Punës mbi kurrizin e tyre i provuan në atë kohë vijën dhe qëllimet antimarksiste të udhëheqjes revizioniste jugosllave. Në vitin 1948 në letrat e njohura të PK të BS dhe në rezolutën e Byrosë Informative të partive komuniste e punëtore motra «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave» u kritikuan në mënyrë parimore pikëpamjet antimarksiste e revizioniste të udhëheqjes jugosllave. Me këtë rezolutë u solidarizuan të gjitha partitë komuniste, duke përfshirë edhe Partinë tonë. Kjo kritikë parimore dhe tezat e saj kanë qenë dhe janë plotësisht të drejta dhe jeta provoi se ato janë të vlefshme edhe sot. Pas vitit 1948 nga partitë komuniste e punëtore u zhvillua një luftë e ashpër kundër pikëpamjeve revizioniste e armiqësore të udhëheqjes jugosllave.

Nga viti 1954 KQ i PK të BS, me shokun Hrushov në krye, mori iniciativën për të normalizuar marrëdhënjet me shtetin jugosllav dhe LKJ.

Por megjithkëtë udhëheqja revizioniste jugosllave jo vetëm që nuk hoqi dorë nga rruga e vjetër, por vazhdoi të futej edhe më thellë në rrugën revizioniste e antimarksiste. Ajo vazhdoi punën e saj minuese kundër vendeve socialiste dhe partive komuniste

e punëtores, vazhdoi aktivitetin e saj agjentural kundër kampit të socializmit. Vendi ynë dhe Partia jonë e njohin mirë këtë veprimtari të revizionistëve jugosllavë kundër Partisë dhe popullit. KQ i Partisë më se një herë i ka vënë në dijeni organizatat e Partisë për këtë. Këtu kemi parasysh rolin armiqësor që luajtën jugosllavët në organizimin e punës antiparti në Konferencën e Tiranës më 1956, përpjekjet e tyre për të organizuar turbullira kundër Partisë dhe kundër pushtetit tonë popullor me anë të elementëve armiq të Partisë e të popullit si Liri Gega, Dali Ndreu etj; nxitja aktive dhe mbështetja që u dhanë armiqve të Partisë dhe të popullit Tuk Jakova e Bedri Spahiu etj. Partia jonë e Punës, besnike e marksizëm-leninizmit dhe e interesave jetike të popullit tonë, vigjilente ndaj veprimeve armiqësore që organizoheshin kundër saj e kundër popullit, me vendosmëri i dërmoi këto komplete dhe nuk lejoi që sado pak të preken vija e interesat e Partisë dhe të popullit. Revizionistët jugosllavë tek ne nuk gjetën shesh. Por ata mundën të veprojnë dhe vepruan në Hungari, ku për organizimin e kundërrevolucionit luajtën një rol shumë aktiv. Atje filloi të shfaqet në mënyrë edhe më të hapur roli armiqësor përcarës dhe antisocialist i grupit udhëheqës të LKJ. Fjalimi i Titos në Pula dhe ai i Kardelit në Skupshtinën e Jugosllavisë në fund të vitit 1956, sulmet e tyre kundër Bashkimit Sovjetik, kundër partive komuniste e punëtores dhe kundër kampit socialist treguan se ata janë armiq të betuar të socializmit dhe që nën maskën e «marksizmit» dhe të «vijës jugosllave të socializmit» veprojnë për llogari dhe sipas udhëzimeve të imperializmit. Partitë komuniste e punëtores i dhanë përgjigjen e merituar në atë kohë kësaj veprimtare armiqësore të grupit udhëheqës të LKJ.

Me qëllim që edhe një herë t'i jepej mundësia për të ndërruar rrugë, u organizua takimi në Rumanë në vitin 1957 midis delegacioneve të PK të BS dhe të LKJ. Por edhe pas këtij takimi jugosllavët vajtën më thellë. Ata nuk pranuan të nënshkruanin Deklaratën e Moskës të partive komuniste e punëtores në nëntor 1957, dhe në prill të 1958-s në Kongresin VII të LKJ, duke sistematizuar më mirë pikëpamjet e tyre revizioniste e antimarksiste, aprovuan programin e punës së ardhshme, i cili synon të përçajë lëvizjen komuniste e punëtores ndërkombëtare, të minojë partitë komuniste e punëtores, të mbysë vrullin revolucionar të klasës punëtores, t'i hapë rrugën imperializmit amerikan për t'i skllavëruar popujt e ndryshëm. Në kongres udhëheqësit e LKJ hapur, përpara popullit të tyre dhe popujve të të gjithë botës, përpara syve të të gjithë komunistëve, dolën si renegatë të socializmit, si agjentë e mbrojtës të imperializmit e veçanërisht të imperializmit amerikan, si armiq të betuar të socializmit, të Bashkimit Sovjetik dhe të kampit të socializmit. Përpjekjet e partive komuniste e punëtores për të kthyer në rrugën e drejtë Jugosllavinë nuk dhanë rezultat,

por ato bënë që titizmi ta demaskojë vetveten përpara botës mbarë. Tani përpara lëvizjes komuniste e punëtores ndërkombëtare del detyra që të demaskohet dhe të luftohet deri në fund revizionizmi jugosllav, që të shkatërrohet ai politikisht e teorikisht si bandë e turpshme renegatësh, si agjunkturë që i shërben imperializmit. Këtë janë duke bërë tani partitë e ndryshme, këtë detyrë ka edhe Partia jonë, besnike e marksizëm-leninizmit. Detyra e të gjithë komunistëve, anëtarë të Partisë së Punës të Shqipërisë, është që, duke demaskuar grupin revizionist të udhëheqësve jugosllavë si armiq të betuar të Partisë e të vendit tonë, si armiq të kampit të socializmit dhe të Bashkimit Sovjetik, si një agjunkturë e fëlliqur në shërbim të imperializmit amerikan, të forcojnë vigjilencën revolucionare në radhët e Partisë dhe të popullit kundër çdo propagande e veprimtare armiqësore, që revizionistët jugosllavë mund të përpiqen të zhvillojnë kundër Partisë dhe popullit tonë.

* * *

Dihet se imperialistët i kanë dhënë deri tani Jugosllavisë një ndihmë prej afro 3 miliard dollarësh. Këto para kapitalistët nuk i kanë dhënë kot. Ata kërkojnë edhe shpërblimin përkatës. Këtë shpërblim grupi udhëheqës revizionist i LKJ ja bën imperializmit duke propaganduar kundër socializmit, duke u përpjekur që të minojë vendet socialiste e partitë komuniste. E thamë edhe më parë se rolin e tyre revizionistët jugosllavë e kryejnë edhe duke propaganduar tezat e tyre antimarksiste, të cilat kryesisht u formuluan në programin e LKJ që aprovoi Kongresi i saj VII. Anëtarët e Partisë sonë, nëpërmjet shtypit, janë njohur me këto teza dhe dinë se si duhen luftuar ato, por në këtë raport, për t'i patur mirë parasysh dhe për të qenë kurdoherë të gatshëm për t'i luftuar, edhe një herë shkurtimisht po ndalemi në disa prej tyre:

1. — Revizionistët jugosllavë mohojnë ekzistencën e dy kampeve të kundërta, të kampit socialist dhe të kampit imperialist. Ata me qëllim i quajnë ato «bloqe ushtarake» dhe në mënyrë të ulët dhe shpifëse deklarojnë se ndarja e botës në bloqe ushtarake, dhe si pasojë ndarja ekonomike e saj, është shkaktuar nga Bashkimi Sovjetik, i cili gjoja ka ndjekur politikën nga «pozitat e forcës», se pakti i Atlantikut u krijua si rrjedhim i kësaj politike të Bashkimit Sovjetik. Në këtë mënyrë revizionistët jugosllavë shpifin në mënyrë të poshtë për politikën konsekuente paqësore që ka ndjekur dhe ndjek vazhdimisht Bashkimi Sovjetik, që nga dita e krijimit të tij, dhe i bëhet një mbrojtje e hapur politikës agresive luftënxitëse të imperializmit amerikan. Qëllimi i revizionistëve jugosllavë është që të çorientojnë popujt, që të largojnë vëmendjen e tyre nga armiku i vërtetë i paqes, nga nxitësi dhe organizatori i vërtetë i luftës, që, siç e di gjithë bota dhe siç

mëson marksizëm-leninizmi, është imperializmi dhe në radhë të parë imperializmi amerikan.

2. — Revizionistët jugosllavë deklarojnë se ata ndjekin një politikë të pavarur dhe asnjë, se nuk bëjnë pjesë në asnjë kamp, se «qëndrojnë mbi bloqet». Në të vërtetë kjo pozitë e Jugosllavisë shpreh në mënyrë më të qartë nacionalizmin borgjez reaksionar të grupit udhëheqës të LKJ dhe, siç e ka vërtetuar koha dhe vetë veprimet e Jugosllavisë, pozita «asnjanëse» e shtetit jugosllav nuk është gjë tjetër veçse një maskë. Në fakt gjithë politika dhe veprimtaria e udhëheqësve të LKJ tregojnë se ata përditë e më shumë i përshtaten politikës së kampit imperialist, se kjo «pozitë asnjë» dhe «qëndrim mbi bloqet» nuk është gjë tjetër veçse mënyra më e mirë, që i intereson edhe imperializmit, për të mbrojtur kampin imperialist dhe për të shpifur e për të luftuar kundër kampit socialist.

3. — Me shpifjet kundër Bashkimit Sovjetik, udhëheqësit revizionistë jugosllavë synojnë të ulin influencën që ka dhe dashurinë e madhe që gëzon vendi i parë socialist në të gjithë popujt e botës, kërkojnë të ngjallin ndjenjat nacionaliste shoviniste dhe të përçajnë kampin socialist. Në të njëjtën kohë ata përpiqen të reklamojnë marrëdhënjet që ekzistojnë në botën kapitaliste, të ngrenë në qiell «ndihmën» amerikane sipas Planit Marshall³⁷ dhe, duke e pranuar këtë pa rezerva për veten e tyre, t'ua rekomandojnë edhe vendeve të tjera.

4. — Revizionistët jugosllavë e treguan veten si armiq të betuar të të gjitha partive komuniste e punëtore. Duke vepruar si agjenturë e borgjezisë në lëvizjen punëtore, ata godasin partitë komuniste dhe shpifin për udhëheqësit e sprovuar marksistë-leninistë të klasës punëtore. Sipas grupit titist, «lëvizja punëtore gjatë këtyre dekadave të fundit nuk ka ecur përpara» dhe partitë komuniste nuk bëjnë një politikë «të pavarur» etj. etj. Grupi udhëheqës i LKJ me këtë përpiqet të mbulojë dhe të zvogëlojë fitoret e mëdha të arritura nga lëvizja komuniste ndërkombëtare, duke filluar që nga Revolucioni i Tetorit, nga revolucionet popullore në vendet e demokracisë popullore në Evropë e në Azi, nga revolucioni i popullit të madh kinez, e deri tek shndërrimi i socializmit në një sistem botëror, që përfshin mbi 950 milion njerëz. Revizionistët jugosllavë mbajnë një qëndrim të ulët mendjemadh ndaj partive komuniste të vendeve kapitaliste, të cilat po luftojnë me heroizëm dhe në kushtet e një terrori të madh, me sakrificë e vetëmohim po u qëndrojnë forcave të reaksionit e të fashizmit, po mbrojnë me vendosmëri çështjen e paqes dhe të socializmit.

Si përçarës i lëvizjes komuniste e punëtore, grupi udhëheqës i LKJ, duke zbatuar porositë e borgjezisë imperialiste, kërkon të largojë partitë komuniste nga njëra-tjetra, nga solidariteti in-

ternacionalist i tyre, kërkon t'i shkëpusë nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Por partitë komuniste të botës, të udhëhequra nga shkenca ngadhënjimtare marksiste-leniniste, forcojnë unitetin e tyre, në të cilin qëndron edhe garancia e fitoreve të ardhshme të socializmit, luftojnë me vendosmëri kundër çdo shmangjeje nga parimet e internacionalizmit proletar.

5. — «Teoritë» e revizionistëve jugosllavë mbi kapitalizmin e sotëm, mbi shtetin dhe revolucionin, mbi luftën e klasave dhe partinë, mbi socializmin dhe komunizmin s'janë gjë tjetër, veçse një grumbullim, një gërshetim i të gjitha «teorive» revizioniste të vjetra dhe të reja, një ringjallje e tezave të atit të oportunitizmit Bernshtajnit dhe Kautskit, të oportunistëve të Internacionales së dytë dhe të socialistëve të djathtë të sotëm, të trockistëve dhe të buharinistëve, të cilat janë varrosur me kohë nga marksizëm-leninizmi.

Marksizëm-leninizmi ka treguar se imperializmi është faza e fundit e kapitalizmit. Kjo u vërtetua me triumfin e Revolucionit socialist të Tetorit dhe të revolucioneve socialiste në vendet e demokracisë popullore. Mirëpo revizionistët jugosllavë, duke dashur të mbrojnë kapitalizmin, përpiqen ta shtrembërojnë në mënyrë trashanike natyrën dhe realitetin e kapitalizmit të sotëm. Ata thonë se brenda në sistemin kapitalist ka lindur «socializmi», sepse sektori shtetëror në ekonominë kapitaliste është «socializëm». Pra kapitalizmi i sotëm në mënyrë spontane po integrohet në socializëm. Për «socializmin», sipas revizionistëve jugosllavë, janë jo vetëm klasa punëtore, por të gjitha klasat, edhe ata që e kuptojnë se ç'është socializmi, edhe ata që nuk e kuptojnë, edhe ata që e dëshirojnë atë, edhe ata që e urrejnë. Prandaj nuk qëndron më problemi i revolucionit socialist. Teoria leniniste e revolucionit proletar, thonë ata, «është vjetëruar». Këto teza nuk janë të reja. Ato janë marrë nga Kautski, i cili thoshte se do të vijë epoka e ultraimperializmit, ku kapitalizmi vetëvetiu, automatikisht do të shndërrohet në socializëm. Kjo është teza e teoricienëve të socialistëve të djathtë të sotëm etj.

Duke e paraqitur kapitalizmin monopolist shtetëror si «socializëm», revizionistët jugosllavë shtrembërojnë thelbin e shtetit të sotëm kapitalist dhe përpiqen ta paraqesin atë sikur nuk është armë në duart e borgjezisë monopoliste, por sikur qëndron mbi klasat. Këtë e bëjnë për të mohuar domosdoshmërinë e vendosjes së diktaturës së proletariatit dhe të shkatërrimit të aparatit shtetëror borgjez.

Sipas të gjitha këtyre pikëpamjeve del se klasa punëtore në vendet kapitaliste nuk duhet të organizohet dhe të luftojë për çlirimin e saj, për socializmin. Po kështu del se nuk është nevoja që ajo të ketë partinë e saj revolucionare marksiste-leniniste, sepse, siç e pohojnë revizionistët jugosllavë, në socializëm të udhëheqin edhe partitë borgjeze apo organizata të tilla si sindikatat reaksionare të SHBA. Ja deri ku arrijnë revizionistët jugosllavë.

Të gjithë e kuptojnë thelbin dhe qëllimin e këtyre pikëpamjeve antimarksiste, antisocialiste, thellësisht armiqësore për klasën punëtore, të revizionistëve jugosllavë. Si të gjithë agjentët e tjerë në lëvizjen punëtore ata përpiqen të skllavërojnë shpirtërisht klasën punëtore, ta largojnë atë nga lufta e vërtetë për socializëm, të mbrojnë e të zgjatin jetën e kapitalizmit. Por klasa punëtore dhe masat e tjera punonjëse në vendet kapitaliste, që e ndjejnë çdo ditë mbi shpatullat e tyre zgjedhën dhe shfrytëzimin imperialist, shtypjen dhe violencën e aparatit shtetëror kapitalist, që i vuajnë mbi kurrizin e tyre urinë dhe papunësinë, persekutimet dhe terrorin, nuk gënjehen lehtë nga përrallat e oportunistëve, të revizionistëve dhe të agjentëve të tjerë të imperializmit. Ato përqafojnë marksizëm-leninizmin dhe shkojnë pas partive komuniste, sepse vetëm këto shprehin interesat rrënjësore të tyre, i udhëheqin drejt në rrugën revolucionare të çlirimit nga skllavëria kapitaliste.

6. — Përderisa udhëheqësit revizionistë jugosllavë kanë marrë përsipër rolin e mbrojtësit të kapitalizmit, kuptohet se ata nuk mund të mos shpifin dhe të mos sulmojnë diktaturën e proletariatit dhe sistemin socialist të vendeve tona. Diktatura e proletariatit, sipas udhëheqësve jugosllavë, të shpie patjetër në burokraci, «kufizon demokracinë», prandaj duhet të hiqet dorë nga ajo, meqë edhe armiqtë e klasës tashmë nuk ekzistojnë, dhe duhet të kalohet në të ashtuquajturën «demokraci të drejtpërdrejtë». Kuptohet se këtë «këshillë» udhëheqësit jugosllavë ua japin vendeve socialiste, sepse në vendin e tyre ata e forcojnë diktaturën dhe të gjitha organet e saj, por kuptohet, jo në luftë kundër imperializmit dhe armiqve të socializmit, por për të ruajtur sundimin e tyre, për të shtypur kundërshtarët e tyre. Partitë komuniste dhe punëtore të vendeve socialiste janë gjithmonë vigjilente, ato e kanë gjithnjë parasysh eksperiencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që dërmoi trockistët e buharinistët, të cilët kërkonin gjithashtu dobësimin e diktaturës së proletariatit për t'i hapur rrugën rivendosjes së kapitalizmit. Ato i kanë parasysh mësimet e Leninit të madh se pa diktaturën e fortë dhe të ashpër të proletariatit nuk mund të ndërtohet socializmi. Ato kanë shumë të freskët eksperiencën e Hungarisë, ku dobësimi i diktaturës së klasës punëtore vuri në rrezik çështjen e socializmit në Hungari. Prandaj partitë komuniste të vendeve socialiste e forcojnë në mënyrë të gjithanshme shtetin socialist, të gjitha armët e tij. Diktatura e proletariatit, shteti socialist, siguron demokracinë e vërtetë për masat e gjera punonjëse, për popullin dhe shtyp pa mëshirë çdo rezistencë të armiqve të popullit, të armiqve të socializmit. Karakteri me të vërtetë demokratik i pushtetit tonë shihet në të gjitha fitoret tona në frontin e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës, në përmirësimin e parreshtur të jetës,

në pjesëmarrjen e gjerë të vetë punëtorëve dhe të fshatarëve në drejtimin e vendit. Prandaj pushteti popullor i ka rrënjët thellë në popull dhe gëzon përkrahjen e plotë të tij. Kjo u tregua në mënyrë të shkëlqyer edhe një herë në vendin tonë me rezultatet e zgjedhjeve për Kuvendin Popullor.

7. — Përsa i përket «demokracisë së drejtpërdrejtë», për të cilën bëjnë kaç zhurmë revizionistët jugosllavë, çështja është se ata duan të mohojnë rolin ekonomik që duhet të luajë shteti i diktaturës së proletariatit për ndërtimin e socializmit. Sipas grupit udhëheqës të LKJ, shteti socialist nuk duhet të drejtojë ekonominë, nuk duhet ta planifikojë zhvillimin e saj, nuk duhet të kujdeset për investimet apo për sigurimin e maqinerisë e të lëndës së parë, nuk duhet të bëjë shpërndarjen, të ushtrojë kontroll mbi prodhimin dhe konsumin. Këtë punë, sipas tyre, duhet ta bëjnë çdo ndërmarrje për veten e saj, punëtorët e çdo qendre pune, të cilët bëjnë planin, caktojnë normat, pagat, çmimet etj. Kjo është «demokracia e drejtpërdrejtë». Këto «këshilla» të revizionistëve jugosllavë kanë për qëllim të shkaktojnë konfuzion në mendjet e njerëzve, të nxisin çorganizimin e ekonomisë, konkurrencën dhe anarkinë në prodhim, të cilat janë karakteristike për kapitalizmin. Në këtë rrugë është futur vetë Jugosllavia dhe rezultatet tregojnë se kjo është rruga e restaurimit të kapitalizmit.

Me gjithë sasinë e madhe të dollarëve, që revizionistët jugosllavë kanë marrë nga vendet e kampit imperialist, ekonomia jugosllave në një varg degësh ka qëndruar në vend. Edhe ajo rritje e prodhimit industrial që është bërë në krahasim me paraluftën ka ardhur jo nga rritja e rendimentit në punë, por nga shtimi i numrit të punëtorëve në prodhim. Bujqësia ndodhet në një gjendje shumë të keqe. Në vitin 1956 u prodhuan afro katër milion ton drithë më pak se në vitin 1939. Ndërsa para lufte Jugosllavia eksportonte bereqet, tani ajo është e detyruar të importojë çdo vit mbi njëmilion ton drithë. Sipërfaqet e tokave të punueshme pakësohen nga viti në vit. Në vitin 1952 mbetën pa u punuar 358 mijë ha tokë, kurse në vitin 1956 kjo shifër u rrit deri në 575 mijë ha. Mbi 55 për qind të ekonomive fshatare u mungon inventari bujqësor. Numri i fshatarëve të varfër dhe i fshatarëve të pasur vjen gjithnjë duke u shtuar, gjë që siç dihet është karakteristike për zhvillimin kapitalist të bujqësisë. Në fshatin jugosllav përdoret gjerësisht puna me mëditje, shfrytëzohen fshatarët pa tokë ose me pak tokë. Niveli i jetesës së popullit është i ulët. Çmimet e mallrave të konsumit lëvizin sipas dëshirës së ndërmarrjeve tregëtare, të cilat me spekulime të ndryshme synojnë të nxjerrin sa më shumë fitime në kurriz të konsumatorëve. Ja cilat janë frutet praktike të tradhëtisë së udhëheqësve revizionistë jugosllavë. Ja «rruga jugosllave» e ndërtimit të socializmit.

Partia jonë e Punës, duke u qëndruar besnike mësimëve të marksizëm-leninizmit, me vendosmëri dhe mbi baza parimore ka luftuar kundër revizionistëve jugosllavë. Qëndrimi parimor dhe i drejtë i Partisë sonë, vlerësimi real i rrezikut që paraqiste për vendin dhe Partinë tonë grupi udhëheqës i LKJ, vigjilenca revolucionare e komunistëve tanë dhe e Komitetit Qendror kanë bërë që pikëpamjet dhe veprimet armiqësore të revizionistëve jugosllavë të mos kenë asnjë fushë veprimi në popullin e Partinë tonë heroike. Kjo i ka gëzuar miqtë tanë, te të cilët është shtuar simpatia dhe dashuria për Partinë e Punës, kjo ka xhindosur armiqtë tanë, revizionistët jugosllavë, të cilët vazhdimisht e kanë patur dhe e kanë halë në sy popullin dhe Partinë tonë. Edhe në të ardhshmen, duke ruajtur si sytë e ballit pastërtinë e marksizëm-leninizmit, ne do të vazhdojmë të demaskojmë revizionizmin jugosllav dhe do të luftojmë për shkatërrimin e tij politik e teorik deri në fund. Kjo luftë është një detyrë internacionaliste, që i shërben forcimit të unitetit të kampit tonë socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, i shërben çështjes së paqes dhe të socializmit, u shërben edhe vetë interesave të popujve të Jugosllavisë.

Në lidhje me luftën kundër revizionizmit përpara organizatave të Partisë dalin detyra të rëndësishme. Komiteti Qendror tërheq vëmendjen e organizatave bazë në detyrat e mëposhtme:

1. — Organizatat e Partisë duhet të punojnë në mënyrë sistematike për ngritjen e nivelit ideologjik të komunistëve, për t'i armatosur ata sa më mirë me shkencën marksiste-leniniste. Vetëm në këtë mënyrë anëtarët e Partisë do të jenë në gjendje plotësisht që të luftojnë jo vetëm në terrenin praktik, po edhe në atë ideologjik kundër veprimtarisë revizioniste të jugosllavëve, për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe për forcimin e çelnikosjen e mëtejshme të unitetit ideologjik të Partisë sonë.

2. — Eksperiencia e deritanishme tregon se në planet e revizionistëve jugosllavë për të minuar vendet socialiste dhe partitë komuniste e punëtore lufta kundër vendit e Partisë sonë përbën një nga objektivat kryesore. Këtë tregojnë tentativat e jugosllavëve për të minuar Partinë tonë që gjatë Luftës nacional-çlirimtare, ndërhyrjet e tyre brutale në punët tona të mbrendshme deri në vitin 1948, të cilat, siç janë në dijeni komunistët dhe populli ynë, synonin në skllavërimin e vendit, në kthimin e Shqipërisë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë, në likuidimin e pavarësisë politike dhe ekonomike të vendit tonë. Këtë tregojnë nxitja dhe përkrahja që ata i kanë dhënë tradhëtarit dhe armikut të Partisë e të popullit Koçi Xoxe me shokë, si edhe më vonë aktet e diversionit dhe të spiunazhit, nxitja e elementit antiparti kundër vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë, siç e provoi puna

armiqësore që u zhvillua në Konferencën e Partisë në Tiranë më 1956, puna agjenturale me armiqtë e Partisë dhe të popullit Liri Gega, Dali Ndreu, Tuk Jakova, Bedri Spahiu, Panajot Plaku etj, të cilët, duke zbatuar direktivat e revizionistëve jugosllavë, u përpoqën të godasin prapa shpine Partinë dhe pushtetin tonë popullor, presionet e vazhdueshme dhe propaganda me shtyp e radio kundër Partisë dhe qeverisë sonë popullore etj.etj. Por të gjitha këto tentativa të revizionistëve jugosllavë për të gjunjëzuar Partinë dhe popullin tonë kanë dështuar me turp. Qëndrimi heroik dhe konsekuent marksist-leninist i Partisë sonë të lavdishme, orientimi i drejtë i caktuar nga kongreset e Partisë dhe nga KQ i Partisë sonë, besnikëria e patundur ndaj marksizëm-leninizmit dhe ndaj Bashkimit të madh Sovjetik e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të gjitha këto kanë bërë që puna armiqësore e revizionistëve jugosllavë kundër Partisë e popullit tonë të dërmohet.

Por kjo nuk duhet të vërë në gjumë vigjilencën tonë në të ardhshmen. Shembulli i Hungarisë tregon qartë se armiku është dinak dhe i rrezikshëm. Prandaj është detyra e çdo komunisti, e të gjitha organizatave bazë, që të forcojnë vigjilencën revolucionare, që ta edukojnë edhe popullin në këtë drejtim. Revizionistët jugosllavë do të përpiqen edhe në të ardhshmen që ta dëmtojnë Partinë e pushtetin tonë, ata do të kërkojnë të nxisin armiqtë tanë të brendshëm kulakët, ish-diversantët dhe të arratisurit ose bazat e familjet e tyre, elementët antiparti dhe të përjashtuarit nga Partia për arsye politike etj. Detyra e organizatave bazë të Partisë është që të forcojnë vigjilencën dhe të njohin mirë veprimtarinë që zhvillojnë këta elementë. Në rast se vihen re shenja të një pune armiqësore, komunistët duhet të jenë të gatshëm për ta demaskuar dhe për ta shkullur atë nga rrënjët. Komunistët duhet të jenë vigjilentë edhe në ruajtjen e unitetit të çelniktë të Partisë sonë, që është gjëja më e shtrenjtë, garancia për fitoret tona të tashme dhe të ardhshme.

3. — Organizatat bazë të Partisë duhet të përmirësojnë punën e tyre për sqarimin politik të masave popullore dhe për demaskimin e plotë të revizionizmit jugosllav. Revizionistët jugosllavë do të përpiqen të helmojnë mendjet e njerëzve me propagandën e tyre. Radiot reaksionare, qofshin këto të Perëndimit apo të Jugosllavisë, vazhdimisht në mënyra të ndryshme propagandojnë idetë e revizionizmit, u bëjnë thirrje njerëzve për të ndjekur shembullin jugosllav etj. Komunistët duhet të jenë kurdoherë të gatshëm dhe aktivë për të demaskuar parullat e armikut dhe propagandën e tij armiqësore.

4. — Veçanërisht KQ i Partisë tërheq vëmendjen e organizatave të Partisë për të forcuar më tej punën edukative dhe kujdesin që duhet të tregohet për edukimin e rinisë sonë heroike dhe

V E N D I M

**I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI
APROVIMIN E RAPORTIT TË PARAQITUR NGA
SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH SHOKU ENVER HOXHA**

20 qershor 1958

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të datës 20 qershor 1958,

V e n d o s i :

Të aprovojë njëzëri raportin e paraqitur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbi rezultatet e zgjedhjeve për në Kuvendin Popullor; mbi zhvillimin e punimeve të Mbledhjes së përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve pjesëmarrëse në Këshillin Ekonomik të Ndhmës Reciproke të mbajtur kohët e fundit në Moskë; mbi pikëpamjet antimarksiste e antisocialiste të grupit Tito, që u shprehën edhe një herë në Kongresin VII të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë e programin e saj dhe mbi luftën pa kompromis që duhet bërë për demaskimin e shkatërrimin politik e teorik të revizionizmit modern; si dhe mbi punën e delegacionit të PPSH dhe punimet e kongresit VII të Partisë Komuniste Bullgare.

**Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë**

të intelektualëve tanë. Dihet se armiku synon që me punën e tij të çorientojë rininë, duke nxitur në të shfaqjet e huaja dhe pikëpamjet mikroborgjeze. Po kështu në radhët e intelektualëve armiku kërkon të ngjallë pakënaqësi dhe t'i çorientojë ata, të mbjellë konfuzion ideologjik. Duhet thënë se si rinia jonë, ashtu edhe intelektualët, kurdoherë janë treguar patriotë të denjë, besnikë për çështjen e popullit dhe të Partisë, luftëtarë të vendosur kundër armiqve dhe kundër revizionizmit. Organizatat e Partisë megjithkëtë duhet të përmirësojnë edhe më tej punën e tyre, duhet të qëndrojnë sa më afër këtyre masave dhe të mos nënvleftësojnë dëmin që mund të sjellë puna e armikut në këto drejtime.

5. — Revizionistët jugosllavë kanë për qëllim të përcajnë kampin e socializmit dhe të diskreditojnë Bashkimin Sovjetik. Detyra e Partisë sonë është që në të ardhshmen, ashtu si edhe deri tani, të punojmë për të forcuar dashurinë dhe miqësinë tonë të madhe për të gjithë popujt e vendeve të kampit socialist dhe në radhë të parë, për Bashkimin e lavdishëm Sovjetik. Organizatat e Partisë duhet të propagandojnë në masat sukseset e vendeve të kampit socialist, që shprehin edhe frutin e marrëdhënjeve vëllazërore e të ndihmës reciproke që ata i japin njëri-tjetrit, sukseset e Bashkimit Sovjetik dhe ndihmën që ai u jep vendeve socialiste. Në këtë drejtim duhet të aktivizohet veçanërisht Shoqëria e Miqësisë me Bashkimin Sovjetik. Organizatat e Partisë të marrin masa që këtë vit muaji i miqësisë me Bashkimin Sovjetik të festohet më mirë se çdo herë tjetër.

6. — Duke punuar për zbatimin e detyrave të sipërme, organizatat e Partisë të mobilizojnë gjithë komunistët dhe masat e gjera të punonjësve për zgjidhjen e problemeve ekonomike, për realizimin dhe tejkalimin e planit të shtetit në të gjithë sektorët. Sukseset tona ekonomike në të tëra fushat jo vetëm e forcojnë më shumë atdheun tonë nga çdo pikëpamje, por ato janë shprehja më e mirë e unitetit të popullit tonë, e lidhjes së ngushtë të tij rreth Partisë, një fitore e qartë e ideve të marksizëm-leninizmit mbi ideologjinë borgjeze dhe revizioniste. Ato janë një grusht i fortë kundër revizionistëve jugosllavë, të cilët do të dëshironin dobësimin ekonomik të republikës sonë.

Këto ishin mendimet që Byroja Politike mendon t'ja parashatrojë KQ. Forca e ideve të socializmit është e madhe. Ato po përhapen çdo ditë gjithnjë e më shumë në të katër anët e botës dhe po bëjnë për vete çdo vit me miliona e miliona njerëz dhe fitorja jonë në luftën kundër armiqve të socializmit dhe të komunizmit do të jetë e sigurt.

**Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë**

Nr. 111

V E N D I M

I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË MBI PËRMIRËSIMIN E PUNËS SË SHKOLLAVE

31 Korrik 1958

Komiteti Qendror i PPSH mori në shqyrtim punën e shkollave të kulturës së përgjithshme, të shkollave profesionale dhe të shkollave për të rritur.

Komiteti Qendror konstaton se gjatë viteve të pasqirimit arësimi ka marrë një zhvillim të vrullshëm. Në vitin shkollor 1957-1958 numri i shkollave fillore arriti në 2249, kundrejt 643 që kishte më 1938, i shkollave shtatëvjeçare në 400, kundrejt 11, i shkollave të mesme në 51, kundrejt 11. Tani në shkollat tona punon një ushtri e tërë mësuesish, prej afro 9.000 vetësh. Për të parën herë në historinë e vendit po zhvillohet edhe arësimi i lartë.

Në të njëjtën kohë, Komiteti Qendror konstaton se gjatë këtyre viteve, veçanërisht pas vendimeve të Plenumit të prillit të Komitetit Qendror mbi punën ideologjike, dhe sidomos pas Kongresit III të Partisë, krahas zgjerimit të rrjetit në të gjithë sistemin e arësimit, shkolla jonë ka bërë hapa të rëndësishme përpara në përmirësimin e punës mësimore-edukative, në forcimin e saj të gjithanshëm. Detyra e shtruar nga Partia në Kongresin III për të kapërcyer shkëputjen e teorisë nga praktika, për të lidhur të mësuarit me jetën, për të hyrë në rrugën e zbatimit gradual të arësimit politeknik, ka filluar të zbatohet me sukses.

Është bërë një punë e mirë për të përmirësuar planin dhe programet mësimore të shkollës së kulturës së përgjithshme, në mënyrë që ato t'u përgjigjen kushteve dhe nevojave tona. Për këtë qëllim janë marrë masa të tilla si hapja e ciklit mësimor, heqja e përsëritjeve të panevojshme, ulja e ngarkesës së tepërt të nxënësve, forcimi i dhënjes së mësimit të shkencave matematike dhe natyrore, futja e lëndëve të reja me karakter politeknik etj. Në përshtatje me këto ndryshime, ka filluar puna për përmirësimin e teksteve, për forcimin e bazës materiale-mësimore dhe për kualifikimin e kuadrit.

Ka filluar të përmirësohet puna edhe në shkollat profesionale. Është zgjeruar shumë rrjeti i arësimit për të rritur. Me përpjekjet më të mira të mësuesve e të pedagogëve për të kryer detyrat e shtruara nga Kongresi III ka filluar të ngrihet niveli i punës mësimore-edukative. Një sukses për shkollën tonë është rritja e kërkesave ndaj njohurive të nxënësve, luftimi i prirjes, sipas së cilës puna e shkollave dhe e mësuesve vlerësohet zakonisht në bazë të përqindjeve të kalimit, pa marrë parasysh se cili është niveli i përgatitjes së nxënësve që fshihet pas këtyre përqindjeve.

Por shkolla jonë ka ende dobësi në punën metodiko-mësimore. Dobësi të ndjeshme ka në cilësinë e mësimit. Niveli i njohurive të shumicës së nxënësve është i ulët. Atje ku njohuritë vlerësohen drejt, një pjesë e mirë e nxënësve nuk janë në gjendje të kalojnë klasën. Një gjendje e tillë e ka burimin në nivelin ende të ulët të punës mësimore-edukative, në cilësinë e dobët të dhënjes së mësimit dhe të punës me nxënësit, në shpjegimin e zbetë dhe të cekët të bazave të shkencave. Duke marrë parasysh se edhe gjatë viteve të ardhshme rrjeti i shkollave do të vijë gjithnjë duke u zgjeruar, se kuadri mësimor nuk do të jetë i tëri me arësimin përkatës, se vështirësitë e rritjes nuk do të zhduken menjëherë, të gjithë mësuesit dhe punonjësit e arësimit kanë si detyrë kryesore të luftojnë për të ngritur cilësinë e mësimit, nivelin e njohurive të nxënësve.

Me gjithë sukseset e para, puna për lidhjen e të mësuarit me jetën dhe për zbatimin gradual të arësimit politeknik ka gjithashtu të meta të theksuara. Mjaft dobët shpjegohet zbatimi i bazave të shkencave matematike dhe natyrore në degët e ndryshme të prodhimit. Në këtë mënyrë të mësuarit nuk lidhet me jetën, nxënësit njihen pak me jetën ekonomike të vendit, me ambientin ekonomik ku gjendet shkolla. Punët laboratorike zhvillohen vetëm në disa shkolla. Ekskursionet mësimore në qendrat e prodhimit zhvillohen rrallë dhe në formë vizitash të thjeshta. Puna e dorës, punët praktike me dru dhe me metal si dhe punët praktike bujqësore nuk bëhen në të gjitha shkollat dhe shpesh kryhen formalisht. Shumë shkolla nuk kanë siguruar ende parcelat mësimore-eksperimentale dhe dhomat e punës. Puna jashtë klase dhe jashtë shkolle, rrethet e teknikëve dhe të natyralistëve, puna e dobishme shoqërore e nxënësve janë shumë të kufizuara. Shkollat profesionale i kanë ende të dobëta lidhjet me qendrat e prodhimit.

Shkollat tona, si dhe organizatat e rinisë e të pionierëve, punojnë dobët për të edukuar nxënësit me dashuri për punën, për t'i mësuar të vlerësojnë drejt punën fizike dhe të merren me të, për t'u zhvilluar dëshira sa më të gjera, në mënyrë që t'i çmojnë drejt të gjitha mjeshtëritë. Nuk punohet siç duhet për të edukuar

brezin e ri që mëson në shkolla me shpirtin e sakrificës, për ta përgatitur që të luftojë kundër pengesave dhe vështirësive dhe që të shkojë të mësojë e të punojë atje ku është nevoja. Në shumë nxënës është përhapur prirja për të nënvleftësuar disa profesione të rëndësishme dhe të nevojshme për vendin tonë që janë të lidhura me punën në bujqësi, në ndërtim, në miniera etj. Mjaft nxënës dhe studentë që mbarojnë shkollat profesionale dhe të larta mundohen me të gjitha mënyrat që të vendosen në punë në qytetet kryesore dhe pranë familjeve dhe në disa raste i shmangen edhe detyrës. Prandaj edukimi me dashurinë ndaj punës, me ndjenjën e detyrës ndaj vendit dhe shoqërisë, është një problem kryesor i shkollës sonë.

Dobësi të theksuara vërehen sidomos në shkollën fillore, hallkën bazë të arësimit të përgjithshëm. Nuk i kushtohet vëmendja e duhur pasurimit të saj me mjete mësimore, që mund të sigurohen nga vetë shkollat dhe mësuesit, zbatimit të kërkesave të reja të programit, dobësitë së vazhdueshme që u duhet dhënë mësuesve të fillores.

Këto të meta në punën e shkollave janë të lidhura me dobësitë e kuadrit arësitor, me nivelin e ulët të përgatitjes së tij, me gjendjen e pakënaqshme të bazës materiale-mësimore të shkollave, me drejtimin e dobët të shkollave nga Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe organet e saj poshtë, nga ministritë e tjera, që kanë në vartësi shkolla profesionale, nga komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive. Në këto dobësi influencon mjaft edhe mobilizimi i pamjaftueshëm i një pjese të arësimitarëve. Vetëm me këtë mobilizim të pamjaftueshëm mund të shpjegohet fakti që në shkollat e Tiranës, ku mundësitë janë më të mëdha dhe kuadri më i përgatitur, dobësitë janë edhe më të theksuara.

Komiteti Qendror i PPSH, duke u nisur nga nevoja për të përmirësuar punën e shkollave, shtron këto detyra:

PËR ARËSIMIN E PËRGJITHSHËM

I. — Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës mësimore-edukative dhe zbatimin gradual të arësimit politeknik.

Shkolla e kulturës së përgjithshme duhet ta përqëndrojë vëmendjen kryesore në përmirësimin e cilësisë së punës mësimore-edukative, në ngritjen e nivelit të saj dhe të njohurive të nxënësve, në edukimin e qëndrimit komunist ndaj punës. E gjithë kjo punë duhet zhvilluar lidhur ngushtë me zbatimin e detyrës së shtruar nga Kongresi III i Partisë për lidhjen e teorisë me praktikën, e të mësuarit me jetën, për futjen graduale të arësimit

politeknik. Konkretisht, puna duhet të zhvillohet në këto drejtime kryesore:

1) Të punohet për të ngritur cilësinë e mësimimit dhe nivelin e njohurive të nxënësve, të luftohet për përvetësimin e thellë të bazave të shkencave. Në mënyrë të veçantë të punohet për të ngritur nivelin e shpjegimit të bazave të shkencave matematike dhe natyrore, që janë themeli i arësimit politeknik, dhe për të treguar zbatimin që gjejnë ato në degët kryesore të prodhimit shoqëror, duke e parë këtë zbatim jo vetëm në përgjithësi, por edhe në kushtet konkrete të vendit tonë, të ekonomisë sonë, si dhe të ambientit ku ndodhet shkolla. Në këtë drejtim të përmirësohen vazhdimisht programet dhe tekstet mësimore.

Për ta lidhur edhe më ngushtë teorinë me praktikën në shpjegimin e bazave të shkencave matematike dhe natyrore, të merren edhe këto masa:

a) Të bëhet kalimi gradual nga punët laboratorike demonstruese në punët laboratorike frontale, duke siguruar edhe bazën e nevojshme materiale-mësimore për këtë qëllim.

b) Të organizohen mirë ekskursionet mësimore në qendrat e prodhimit industrial e bujqësor, duke shfrytëzuar për këtë qëllim së paku të gjitha qendrat që ndodhen në afërsitë e shkollës. Për këtë është e nevojshme që mësuesit të njohin interesin mësimor që paraqesin qendrat e prodhimit dhe të jenë në gjendje t'u japin vetë shpjegime nxënësve gjatë ekskursioneve.

2) Të përmirësohet puna e dorës, punët praktike me dru dhe me metal, punët praktike bujqësore dhe të futen gradualisht në klasat e larta lëndët që lidhen me punën praktike të nxënësve dhe që kanë karakter politeknik, siç janë kultivimi i bimëve, studimi i automobilit ose i traktorit, elementet e maqinerisë (industriale ose bujqësore), elektroteknika etj. Për dhënjen e këtyre lëndëve duhet të përpunohen programet dhe tekstet përkatëse, të përgatitet kuadri dhe të sigurohet baza materiale-mësimore.

Në një vit të shkollës së mesme të futet praktika në prodhim e nxënësve në një ndërmarrje të caktuar. Për organizimin e mirë të kësaj praktike të përgjigjen si shkolla ashtu edhe ndërmarrja.

Si lëndët e reja që futen ashtu edhe praktika në prodhim të bëhen duke marrë parasysh ambientin ku ndodhet shkolla — pranë ndërmarrjeve industriale apo bujqësore.

3) T'i kushtohet kujdes punës jashtë klasës e jashtë shkollës që zhvillohet për thellimin e njohurive shkencore, për fitimin e shprehive praktike, për ngjalljen e dashurisë për punën dhe profesionet e ndryshme. Të organizohen sa më shumë rrethe natyralistësh e teknikësh të rinj pranë shkollave dhe qendrave të prodhimit.

4) Të organizohet puna e dobishme shoqërore e nxënësve për mirëmbajtjen e shkollës, për zbulimin e qytetit, për ndërtimin

dhe mirëmbajtjen e kopshteve, të shesheve dhe të parqeve sportive, të organizohet ndihma për ndërmarrjet gjatë vitit për punë të ndryshme, pjesëmarrja 2-3 javore në punë gjatë pushimeve verore pranë ndërmarrjeve industriale dhe kooperativave bujqësore. Organizimi i punës së dobishme shoqërore të nxënësve duhet të bëhet jo vetëm çështje e shkollave dhe e mësuesve, e organizatave të rinisë dhe të pionierëve, por edhe e komiteteve ekzekutive, si dhe e organeve shtetërore dhe e ndërmarrjeve të interesuara.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të marrë masa dhe të krijojë gjatë viteve shkollore 1958-1959 dhe 1959-1960 disa shkolla model për punën mësimore edukative, sidomos për lëndët e reja dhe elementet e reja të programeve, të cilat të vlejnjë për eksperimentime dhe për shpërndarje të eksperiencës.

II. — Të përmirësohet pregatitja dhe kualifikimi i kuadrit arësitor

Në përmirësimin e punës së shkollave rolin kryesor e lot kuadri arësitor, pregatitja e mirë dhe ngritja e vazhdueshme e nivelit të tij ideo-politik e profesional, mobilizimi i tij në punë.

Me gjithë përmirësimet në punën për pregatitjen dhe kualifikimin e kuadrit, ka ende mjaft dobësi. Shkollat pedagogjike, institutet pedagogjike dyvjeçare dhe fakultetet përkatëse të universitetit nuk i pregatitin mësuesit siç duhet për të zbatuar kërkesat e reja lidhur me zbatimin gradual të arësimit politeknik. Deficitet në pregatitjen e kuadrit janë ende të ndjeshme, sidomos për shkollat shtatëvjeçare dhe për shkencat matematike dhe natyrore. Shumë dobët paraqitet gjendja e studimit me korrespondencë. Gjatë dy viteve të fundit kanë mbaruar shkollën pedagogjike me korrespondencë 265 mësues, kurse Institutin pedagogjik dyvjeçar dhe fakultetet përkatëse të universitetit vetëm 42. Dobësi ka edhe në punën për edukimin, trajtimin dhe aktivizimin e drejtë të arësimitarëve.

Për të zhdukur këto të meta është e nevojshme të merren masat e mëposhtme:

1) Në shkollat pedagogjike t'i kushtohet më shumë kujdes studimit të kërkesave të reja që shtrohen para shkollës, fitimit të shprehive praktike profesionale nga mësuesit e rinj, zotërimit të mirë të gjuhës amëtare nga ana e tyre.

Në institutet pedagogjike dyvjeçare dhe fakultetet përkatëse të universitetit t'u kushtohet më shumë kujdes njohjes së programeve mësimore dhe kërkesave të shkollës, si dhe fitimit nga ana e studentëve të njohurive teorike dhe të shprehive praktike profesionale që u duhen atyre për të zbatuar këto programe dhe kërkesa. Studentët e fakulteteve matematiko-natyrore, përveç praktikës

pedagogjike, të bëjnë edhe praktikë në prodhim, si dhe të pregatiten për të dhënë lëndët e reja me karakter politeknik.

Përmirësimi i planeve dhe i programeve mësimore të shkollave pedagogjike, të instituteve dyvjeçare dhe të fakulteteve përkatëse të universitetit të bëhet duke marrë parasysh realizimin e detyrave të mësipërme.

Në këto shkolla brenda vitit 1958-1959 të krijohen parcelat mësimore-eksperimentale dhe punishtet e nevojshme për të pregatitur nxënësit dhe studentët për kryerjen e punëve praktike.

2) Për të mbuluar deficitet e krijuara në pregatitjen e kuadrit dhe për të përballuar nevojat gjithnjë në rritje të shkollës, duhet shpejtuar ritmi i pregatitjes së kuadrove arësimore.

Mësuesit që mbarojnë shkollat pedagogjike pregatiten kryesisht për fshatin, kurse një pjesë e mirë e tyre janë nga qyteti. Duke vazhduar të pregatitimit mësues nga qyteti dhe duke e shtruar si detyrë patriotike para tyre vajtjen në fshat, në të njëjtën kohë duhen tërhequr më shumë të rinj nga fshati në shkollat pedagogjike dhe institutet dyvjeçare.

Për të plotësuar me kuadro nevojat e shkollave fillore, të mbahet shkolla pedagogjike dyvjeçare me bazë shtatëvjeçare.

Të gjitha këto masa të shërbejnë që në fund të pesëvjeçarit të tretë përqindja e kuadrit me arësim përkatës të jetë afërsisht si vijon: në arësimin fillor — 90 për qind, shtatëvjeçar — 80 për qind dhe të mesëm — 100 për qind.

3. — Të nxitet më shumë studimi me korrespondencë i arësimitarëve, duke rritur diferencat e sotme në rrogë midis mësuesve pa dhe me diplomën përkatëse që punojnë në shkollat shtatëvjeçare dhe të mesme. Kjo çështje të zgjidhet kur të shqyrtohen korigjimet për kategorizimin e punëtorëve e të nëpunësve.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe organet e saj studimin me korrespondencë të mësuesve duhet ta konsiderojnë si një problem kryesor të tyre dhe ta nxjerrin nga gjendja e sotme. Në mënyrë të veçantë ata duhet të luftojnë prirjen e shumë mësuesve për të mësuar me korrespondencë vetëm në fakultetet humanitare.

4. — Instituti i perfeksionimit dhe kabinetet pedagogjike kanë filluar të punojnë për kualifikimin e kuadrit. Kjo punë duhet të marrë përpjesëtime gjithnjë e më të gjera. Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të përcaktojë rregullat për kualifikimin e mësuesve, në bazë të të cilave çdo 4-5 vjet një herë mësuesit duhet të kalojnë nëpër kurse. Në këto kurse e seminare mësuesit duhet të njihen me të rejat e shkencës që japin në mësim, me të rejat e shkencës pedagogjike, me kërkesat e reja të shkollës.

Në etapën e tanishme një masë e rëndësishme për kualifikimin e mësuesve të shkencave matematike dhe natyrore është organizimi i një stazhi pune praktike në prodhim në ndërmarrjet e

ndryshme industriale ose bujqësore, në vartësi nga lënda që jep mësuesi. Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të marrë masa që mësuesit ta kalojnë këtë stazh gjatë pesë viteve të ardhshme shkollore.

Gjithashtu, veç punës që do të bëjnë institutet pedagogjike dyvjeçare dhe universiteti, ministria duhet të marrë masa për përgatitjen e mësuesve për lëndët e reja me karakter politëknik nëpërmjet kurseve. Ky problem duhet të zgjidhet gjatë tre viteve të ardhshme.

5. — Në qendër të vëmendjes duhet të jetë puna për edukimin, trajtimin dhe aktivizimin e drejtë të arësimitarëve. Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të tregojnë interesim të veçantë për këtë problem.

Të tregohet më shumë kujdes për vendosjen e kuadrit mësikor në punë. Të pakësohen në maksimum lëvizjet e mësuesve nga njëra shkollë në tjetrën dhe nga njëri rreth në tjetrin. Në asnjë rast të mos u ndërrohen mësuesve lëndët për të cilat kanë fituar specialitetin ose ato për të cilat janë ngarkuar në fillim të japin mësim.

Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të merren drejt për së drejti me edukimin ideo-politik, me edukimin marksist-leninist të arësimitarëve, duke e zhvilluar këtë punë mbi bazën e dëshirave dhe nevojave të tyre. Për këtë qëllim ato duhet të aktivizojnë më shumë organizatat profesionale të mësuesve.

Komitetet ekzekutive duhet të tregojnë interesim të veçantë për përmirësimin e kushteve materiale të arësimitarëve të fshatit, për sigurimin e banesës etj.

Në aktivizimin e arësimitarëve duhet të kemi parasysh se Partia i konsideron ata si ndihmës të saj në punën politiko-edukative me masat, sidomos në fshat. Prandaj edhe aktivizimi i tyre duhet bërë në radhë të parë në këtë drejtim. Për këtë qëllim komitetet e Partisë gjatë pushimeve verore të organizojnë kurse dhe seminare me ata mësues që janë aktivistë të dalluar në punën politiko-edukative me masat.

6. — Komiteti Qendror i Partisë, duke marrë parasysh rolin e madh të mësuesit, u bën thirrje gjithë arësimitarëve që ta ndiejnë thellë përgjegjësinë e madhe që kanë në kryerjen e detyrës së tyre të shenjtë dhe të shumëfishojnë përpjekjet për mbarëvajtjen e gjithanshme të shkollës, për edukimin komunist të brezit të ri.

Për këtë është e nevojshme që arësimitarët të mësojnë vazhdimisht për të fituar arësimin përkatës ose për të pasuruar dijenitë që kanë, të shkëmbejnë e të rrahin mendimet mbi problemet e shkollës, të kritikojnë haptazi dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e punës, të ndjekin me vëmendje të rejtat e shkencës, të bëjnë përpjekje për të shkuar gjithnjë përpara.

Puna dhe përpjekjet e arësimitarëve në këtë drejtim duhet të gjejnë një mbështetje dhe nxitje të gjithanshme nga ana e organeve të arësimit, të cilat duhet ta shikojnë punën e mësuesve si një punë të gjallë krijuese.

III. — Mbi forcimin e bazës materialo-mësimore të shkollave

Për të ngritur në një nivel më të lartë punën mësimore-edukative dhe për të zbatuar gradualisht arësimin politëknik, është e domosdoshme që baza materiale mësimore e shkollës të forcohet nga të gjitha anët. Për këtë duhet të merren këto masa:

1. — Godinat e reja shkollore të ndërtohen duke marrë parasysh edhe kërkesat e reja që shtrohen para shkollës. Në to të parashikohen kabinetet e fizikës, të kimisë, të biologjisë, dhoma e punës dhe punishtet.

Projekti tip i ndërtimit të godinave shkollore i aprovuar nga Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të jetë i detyruar për të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet që ndërtojnë shkolla.

Ministritë dhe entet përkatëse duhet të marrin përsipër ndërtimin e shkollave në ndërmarrjet e mëdha industriale e bujqësore që janë sot dhe të parashikojnë fondet përkatëse për ndërmarrjet që do të ngrihen në të ardhshmen.

Këshillat popullore të fshatrave dhe kooperativat bujqësore të marrin përsipër ndërtimin e shkollave të fshatit dhe pajisjen e tyre, në bazë të projekteve tip, si dhe mirëmbajtjen e tyre.

Organizatrat e rinisë përgjithësisht, dhe në mënyrë të veçantë organizatat e rinisë shkollore, të marrin si aksion të rëndësishëm pjesëmarrjen në ndërtimin dhe meremetimin e shkollave, në ndërtimin e kopshteve dhe të shesheve sportive të tyre etj.

2. — Në kushtet e tanishme forcimi i bazës materiale laboratorike të shkollës është mjeti kryesor për të lidhur teorinë me praktikën në mësimin e shkencave matematike dhe natyrore. Prandaj është e nevojshme të shpejtohet ritmi i plotësimit të shkollës me laboratorë, në mënyrë që brenda këtij pesëvjeçari shkollat shtatëvjeçare të kenë laboratore fizike dhe kabinet biologjie, kurse shkollat e mesme laborator fizike, kimie dhe kabinet biologjie, duke krijuar kështu mundësitë për të realizuar në bazë të programit si punët laboratorike demonstruese, ashtu edhe ato frontale.

Të sigurohen brenda këtij pesëvjeçari disa mjete që janë të domosdoshme për shkollat dhe nxënësit, si atllaset, busullat, termometrat etj.

3. — Të shtohet prodhimi i mjeteve të mësimin në vend, sidomos për shkollat fillore dhe shtatëvjeçare, duke zgjeruar pu-

nishten e Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës. Ministria të marrë masa që brenda vitit 1960 të plotësojë shkollat me minimum e domosdoshëm të hartave.

Industria, artizanati dhe tregëtia t'i kushtojnë më shumë kujdes përgatitjes dhe shitjes së mjeteve që konsumohen nga shkollat dhe nxënësit. Kryesia e Këshillit të Ministrave ta shikojë në mënyrë të veçantë këtë problem.

4. — Pajimi i dhomave të punës dhe i punishteve të bëhet nga ana e ndërmarrjeve që kanë në kujdestari shkollat. Komitetet ekzekutive të tregojnë interesim të veçantë për këtë çështje dhe të ndihmojnë sidomos ato shkolla që nuk kanë pranë ndërmarrrje.

Të gjitha maqinat dhe mjetet e ndryshme që nuk përdoren më nga ndërmarrjet dhe vlejnë për punën mësimore dhe për punën jashtë klase, t'u kalojnë shkollave. Kjo çështje të zgjidhet brenda vitit shkollor 1958-1959.

Prodhimi i disa mjeteve të thjeshta të punës, veç ndërmarrjeve industriale, të planifikohet edhe në ofiçinat e Universitetit shtetëror të Tiranës dhe të Politeknikut «7 Nëntori».

5. — Komitetet ekzekutive për shkollat e qytetit dhe kooperativat bujqësore për shkollat e fshatit të caktojnë parcelat për kopshtin eksperimental mësimor. Në shkollat shtatëvjeçare të fshatrave këto parcela nuk duhet të jenë më të vogla se një gjysmë hektari dhe në shkollat e mesme të krahinave bujqësore, si dhe në shkollat pedagogjike, jo më pak se një hektar. Shkollat fillore të fshatrave, shkollat e vogla shtatëvjeçare dhe shkollat e qyteteve mund të kenë parcela edhe më të vogla. Caktimi i parcelave për shkollat të marrë fund brenda vitit 1958-1959.

IV. — Të përmirësohen tekstet shkollore

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës duhet të marrë masa për të përmirësuar tekstet shkollore, sidomos ato të shkencave matematike dhe natyrore. Tekstet që ende nuk mund të bëhen në vend dhe duhet të përkthehen, të adaptohen, në mënyrë që të sigurojnë lidhjen e bazave të shkencave me prodhimin në vendin tonë dhe me jetën përgjithësisht. Mbi këtë bazë të fillohet puna për hartimin e teksteve të adaptuara, si dhe origjinale, për shkencat matematike dhe natyrore, duke organizuar për këtë qëllim edhe konkurse. Për hartimin e këtyre teksteve të aktivizohen arësimitarët më të mirë dhe më të dalluar. Të tilla tekste shkolla të fillojë të marrë që nga viti 1959-1960.

Në mënyrë të veçantë Ministria e Arësimit dhe e Kulturës duhet të marrë masa për të përmirësuar rrënjësisht dhe për të unifikuar gjuhën e teksteve.

V. — Disa detyra për zhvillimin e mëtejshëm të shkollës së kulturës së përgjithshme dhe forcimin e saj

1. — Për t'ju përgjigjur nevojave që ka vendi për kuadro dhe kërkesave të popullit për arësim, rrjeti i shkollave të kulturës së përgjithshme duhet të vijë gjithnjë duke u zgjeruar. Në mënyrë të veçantë duhet të zgjerohet rrjeti i shkollave shtatëvjeçare. Në fund të pesëvjeçarit të tretë shkollat shtatëvjeçare duhet të përfshijnë rreth 75 për qind të nxënësve që mbarojnë filloren.

Nevojat e vendit dhe kërkesat e popullsisë shtrojnë me forcë shtimin e rrjetit të shkollave njëmbëdhjetëvjeçare në shumicën e qendrave të rretheve, si dhe në disa lokalitete kryesore e qendra të mëdha industriale. Në lidhje me këtë duhet të zgjidhen disa çështje:

a) Të studjohet perspektiva e zhvillimit të arësimit të mesëm të përgjithshëm dhe profesional dhe të përcaktohen përpjesëtimet midis tyre.

b) Të planifikohet ndërtimi i konvikteve pranë shkollave të qendrave të rretheve, ku fëmijët e fshatarëve të kenë mundësi të ndjekin mësimet me bursë të shtetit dhe të tyre.

Të përkrahet dhe të nxitet iniciativa e kooperativave bujqësore, sidomos në qendrat e disa lokaliteteve të mëdha, për të ndërtuar shkolla dhe konvikte për to me kontributin e tyre. Kooperativat bujqësore të dërgojnë me bursën e tyre bij të kooperativistëve në shkollat e mesme, që të sigurojnë kuadrot e nevojshëm për kooperativën.

Në qytetet kryesore, pa zbritur planin e nxënësve, nuk duhen krijuar shumë shkolla njëmbëdhjetëvjeçare, pasi është vështirë që ato të sigurohen të gjitha me bazën e nevojshme materiale-mësimore, me mësues dhe kuadër drejtues të përshtatshëm, dhe mund të ulin kështu nivelin e përgatitjes së nxënësve.

2. — Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, gjatë vitit shkollor 1958-1959, duhet të studjojë gjendjen e mësimit të gjuhës në shkollë dhe të marrë masa për përmirësimin e saj.

3. — Për të përmirësuar dhe për të forcuar punën e shkollës është e nevojshme që të ketë një normë më të përshtatshme të plotësimit të klasave me nxënës si dhe një ngarkesë më të përshtatshme pune për mësuesit. Ministria e Arësimit dhe e Kulturës duhet të studjojë brenda vitit 1959 mundësitë për zgjidhjen e këtyre dy çështjeve.

Edhe në punën e shkollave profesionale vërehen dobësi të theksuara. Ministritë nuk kanë treguar interesimin e duhur për këto shkolla. Më shumë është interesuar Ministria e Bujqësisë dhe deri diku e Shëndetësisë, kurse shumë pak Ministria e Industrisë dhe e Minierave. Në shkollat profesionale lidhja e punës mësimore me prodhimin dhe jetën e vendit është ende e dobët, për shkak të bazës së pakënaqshme materiale-mësimore, të gjendjes së kuadrit, i cili zakonisht jo vetëm që është i ngarkuar shumë, por është edhe i ri ose pa eksperiencë pune në prodhim, të teksteve, të cilat, duke qenë zakonisht të përkthyer, nuk pasqyrojnë jetën e vendit tonë, si dhe, në mënyrë të veçantë, të organizimit të dobët të praktikave në prodhim.

Është e nevojshme që ministritë përkatëse të shtojnë interesimin për shkollat profesionale. Ato duhet të punojnë në radhë të parë në këto drejtime:

1. — T'u sigurojnë shkollave kuadrin e nevojshëm dhe të përshtatshëm. Në radhë të parë të zhduket anomalia e ngarkimit të pedagogëve mbi normën që është karakteristike, sidomos për teknikumet industriale. Të merren gjithashtu masa për të shkëmbyer pedagogë të rinj, që nuk kanë punuar në prodhim, me specialistë që e njohin prodhimin, si dhe për të organizuar stazhin e praktikës së pedagogëve në prodhim. Çështja e kuadrit të shkollave profesionale duhet të zgjidhet gjatë vitit shkollor 1958-1959.

2. — Ministritë të marrin masa gjatë vitit 1958-1959 për të përmirësuar bazën materiale-mësimore të shkollave profesionale, për t'i pajisur ato me laboratorët dhe kabinetet e nevojshme.

3. — Të përcaktohen më drejt profilet e teknikumit financiar-ekonomik dhe tregëtar. Të dy këto të shkrihen në një teknikum të vetëm ekonomik me dy specialitete — ekonomistë kontabël dhe merceologë.

4. — Të punohet për përmirësimin e mëtejshëm të planeve mësimore të shkollave profesionale, duke synuar që të zhduken përsëritjet e panevojshme dhe paralelizmat, që specializimi të mos fillojë vetëm vitin e fundit ose të parafundit, por edhe më herët, që lëndët e kulturës së përgjithshme — shkencat matematike dhe natyrore — të shtrohen në më shumë semestra.

5. — Të përmirësohen tekstet e lëndëve profesionale, duke synuar që ato të adaptohen dhe të pasqyrojnë jetën e vendit tonë dhe problemet tona. Ministritë përkatëse të zgjidhin këtë problem gjatë vitit shkollor 1958-1959.

Të studjohet mundësia për të krijuar pranë universitetit një shtypshkronjë, për të shtypur tekstet e tij dhe të shkollave profesionale.

6. — Të ngrihet në një nivel më të lartë puna mësimore-educative. Edhe në shkollat profesionale detyrë kryesore duhet të konsiderohet lufta për përmirësimin e cilësisë së mëimit, për ngritjen e nivelit të njohurive të nxënësve. Në mënyrë të veçantë të mbahen parasysh çështjet e mëposhtme:

a) Të luftohet për realizimin e rregullt të planeve dhe të programeve mësimore dhe të ndiqet ky realizim. Të luftohen çrregullimet dhe mungesat që bëhen në këtë drejtim, zhvillimi i nxituar dhe i ngjeshur i programeve.

b) Të insistohet në zhvillimin e të gjitha punëve laboratorike të parashikuara në programe, si për lëndët e kulturës së përgjithshme, ashtu edhe për ato profesionale.

c) Të tregohet më shumë kujdes për praktikën mësimore, për shfrytëzimin racional të kohës së caktuar, për krijimin e bazës së nevojshme materiale-mësimore për to, për shtrirjen e tyre gjatë gjithë vitit.

ç) Të përmirësohen rrënjësisht praktikat në prodhim. Për organizimin e mirë të praktikave të mbajnë përgjegjësi si shkollat, ashtu edhe ndërmarrjet. Programet e praktikave të jenë të përcaktuara mirë dhe të përmbajnë punën efektive që duhet të bëjnë praktikantët. Praktikën në prodhim të jenë pjesë e pandarë e procesit mësimor, të jenë të lidhura organikisht me të. Shkollat dhe ndërmarrjet të ndjekin konkretisht punën e nxënësve gjatë praktikave në prodhim.

Për të zgjidhur këto probleme shkollat profesionale duhet të lidhen me ndërmarrje të mëdha dhe të jenë nën kujdestarinë e tyre.

E gjithë puna mësimore-educative në shkollat profesionale duhet të lidhet drejt për së drejti me edukimin e dashurisë për punën dhe profesionin.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës duhet të kontrollojë dhe të ndihmojë më shumë shkollat profesionale për përmirësimin e punës mësimore-educative, sidomos për rritjen e aftësive pedagogjike dhe metodike të kuadrit mësimor.

7. — Dobësi të theksuara ka në shkollat e rezervave të punës. Ministritë i kanë lënë fare pas dore këto shkolla, ato i janë larguar qëllimit të tyre — përgatitjes së punëtorëve të kualifikuar. Programet e tyre janë rënduar dhe zgjeruar. Ministritë, duke i nënvleftësuar këto shkolla, kanë filluar të përgatitin punëtorë nëpërmjet kurseve, gjë që i kushton shumë shtetit. Ato nuk kanë treguar kujdes për ruajtjen e kontingjenteve të punëtorëve që kanë mbaruar këto shkolla.

Për të dalë nga kjo gjendje ministritë përkatëse, brenda muajt gusht të këtij viti, të përcaktojnë drejt profilet e shkollave të rezervave të punës, moshat që duhet të kenë nxënësit që i ndjekin ato si dhe kategorinë që duhet të marrin ata pas mbarimit të shkollës.

PËR ARËSIMIN E TË RRRITURVË

Arësimi për të rritur është zgjeruar shumë. Gjatë vitit shkollor 1957-1958 kanë funksionuar 450 shkolla fillore, shtatëvjeçare dhe të mesme për të rriturit, në të cilat kanë ndjekur mësimet afro 20.000 vetë. Por megjithkëtë zgjerim të madh në punën e shkollave për të rritur vërehen mjaft të meta.

Interesimi që tregojnë organet e Partisë, të pushtetit dhe të arësimit, organizatat e Partisë dhe të masave, si dhe ndërmarrjet për ato, është krejtësisht i pamjaftueshëm. Frekuentimi i shkollave të mbrëmjes është shumë i dobët. Ka dobësi në punën mësimore-edukative, në planet, në programet dhe në tekstet. Në shkollën e të rriturve shpeshherë përdoren po ato metoda si dhe me nxënësit e shkollës së ditës. Kërkesat ndaj njohurive të nxënësve dhe studentëve janë ende të ulëta.

Duke marrë parasysh rëndësinë e arësimit për të rritur, perspektivën e shtrirjes së tij gjithnjë e më të madhe, është e nevojshme të tregohet një interesim i veçantë për të. Ministritë, entet dhe ndërmarrjet duhet të planifikojnë arësimin për të rritur dhe ta shikojnë atë si një problem të rëndësishëm shtetëror.

Për përmirësimin e arësimit për të rritur duhet të merren edhe këto masa:

1. — Kryerja e shkollave pa u shképutur nga puna është një detyrë e vështirë. Prandaj nga gjithë ata që ndjekin shkollat e natës dhe me korrespondencë kërkohet një mobilizim shumë më i madh për ndjekjen e rregullt të mësimave, për paraqitjen në konsultime e provime, për shfrytëzimin e lejes për qëllimet e caktuara, për të studjuar sistematikisht gjatë gjithë vitit, për të luftuar me këmbëngulje kundër pengesave që u dalin. Për këtë qëllim nga ana e ndërmarrjeve dhe e institucioneve, e organizatave të Partisë dhe profesionale duhet bërë një punë e gjerë sqaruese politike-edukative me nxënësit. Në të njëjtën kohë ato duhet t'i kushtojnë kujdes kontrollit dhe ndihmës që u duhet dhënë atyre që mësojnë në shkollat e të rriturve, si dhe t'u krijojnë të gjitha lehtësitë e mundshme dhe gjatë ditëve kur ka shkollë të mos i mbajnë në asnjë mënyrë nëpër mbledhje të ndryshme.

2. — Një kujdes i veçantë t'u kushtohet hapjes dhe funksionimit të rregullt të shkollave fillore dhe shtatëvjeçare të mbrëmjes si në qytet, ashtu edhe në fshat. Të punohet që në këto shkolla të regjistroheshin më radhë të parë komunistët, të rinjtë që kanë kryer kurset kundër analfabetizmit, punëtorët e qendrave industriale, në mënyrë që të zbatohen plotësisht vendimet e Komitetit Qendror për arësimin e komunistëve dhe të punëtorëve.

Organizatave të Partisë dhe organet e arësimit në mënyrë të veçantë të punojnë për të siguruar numrin e nxënësve që duhet për të hapur klasat në shkollat fillore dhe shtatëvjeçare të fshatit. Kur

nuk është e mundur të sigurohet numri i nevojshëm për hapjen e klasave, t'u bëhet thirrje arësimitarëve që të punojnë për të mësuar vullnetarisht komunistët, të rinjtë dhe të gjithë ata që dëshirojnë të ndjekin shkollën.

3) Të bëhen korrigjimet e nevojshme në afatet dhe në pranimet e shkollave për të rritur.

Shkolla e mesme e kulturës së përgjithshme dhe profesionale nga katër vjet të bëhet pesë.

Fakultetet e mbrëmjes të universitetit nga katër vjet të bëhen pesë.

Të luftohet prirja e shtrembër e shumë punonjësve që regjistroheshin në shkollat me korrespondencë, megjithëse jetojnë në qendrat ku ka shkolla mbrëmjeje dhe shumicën e kohës nuk janë në lëvizje.

4) T'u krijojnë më shumë lehtësi nxënësve dhe studentëve që vazhdojnë shkollat e të rriturve. Punonjësit e administratës që ndjekin shkollat e natës të lejohen të largohen nga puna 3 orë në javë.

Studentëve që ndjekin shkollat e larta me korrespondencë leja e provimeve t'u zgjatet në 30 ditë, si dhe t'u krijojnë lehtësi banimi nëpër konvikte.

5) Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe organet e saj të interesohen më shumë për punën e shkollave të të rriturve, sidomos për sigurimin e tyre me kuadër të përshtatshëm, për rritjen e kërkesave ndaj punës mësimore, dhe veçanërisht ndaj nivelit të njohurive të nxënësve e studentëve. Të luftohet kundër liberalizmit të theksuar që ka ekzistuar dhe ende ekziston në këtë drejtim.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës në hartimin e programeve dhe teksteve mësimore, në metodat e punës mësimore-edukative të shkollës për të rritur të ketë parasysh moshën e nxënësve. Në mënyrë të veçantë ky është një problem preokupant për shkollën fillore të mbrëmjes, dhe sidomos për tekstet e këndimit. Ministria dhe organet e saj duhet të përpunojnë problemet specifike të shkollës për të rritur, t'i bëjnë ato objekt diskutimi midis arësimitarëve.

TË PËRMIRËSOHET DREJTIMI I PUNËS SË SHKOLLAVE

Drejtimi i shkollave është ende i dobët. Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe organet e saj nuk kanë mundur të përqëndrohen siç duhet në kontrollin e përmbajtjes së punës mësimore-edukative dhe në ndihmën që u duhet dhënë mësuesve për përmirësimin e saj. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive interesohen shumë pak për punën e shkollave. Kjo punë shpeshherë mbetet vetëm një çështje e organeve të arësimit dhe e mësuesve, pa u bërë një problem i rëndësishëm shtetëror dhe shoqëror.

Problemet e reja që shtrohen para shkollës kërkojnë përmirësimin e drejtimit të saj, ngritjen e tij në një nivel më të lartë.

1) Ministria e Arësimit dhe e Kulturës duhet të përqëndrojë vemendjen në radhë të parë në drejtimin ideo-metodik të punës së shkollave, duke luftuar kundër drejtimit formal dhe burokratik, kundër zgjidhjes së çështjeve në rrugën administrative. Ajo duhet t'i kushtojë më shumë kujdes përmirësimit të teksteve dhe programeve mësimore; të organizojë kontrollin tematike sipas lëndëve dhe problemeve, duke aktivizuar specialistë, me qëllim që të zgjidhen çështje të caktuara të punës mësimore-edukative dhe t'u jepet një ndihmë efektive shkollave dhe mësuesve; të organizojë botimin e literaturës dhe të materialeve pedagogjike dhe metodiko-shkencore në ndihmë të mësuesve.

Në mënyrë të veçantë ministria duhet të organizojë studimin dhe diskutimin e problemeve shkencore-pedagogjike, duke aktivizuar për këtë qëllim universitetin dhe Institutin e Perfeksionimit të mësuesve; të nxitë mendimin krijues pedagogjik të mësuesve, të këshillohet me arësimitarët dhe veçanërisht me specialistët për çështje të ndryshme, të përgjithësojë dhe të shpërndajë eksperiencën pozitive të shkollave dhe të mësuesve më të mirë.

Duke marrë parasysh zgjidhjen e këtyre problemeve, forcimin e drejtimit ideo-metodik të shkollave, duhet të përmirësohet edhe metoda e punës e Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës, si dhe të studjohet struktura organizative e saj, me qëllim që t'i përshtatet zgjidhjes së detyrave të mësipërme.

2) Organet e arësimit në bazë duhet të përqëndrohen më shumë në kontrollin e përmbajtjes së punës mësimore-edukative dhe në shpërndarjen e eksperiencës pozitive pedagogjike. Për këtë qëllim të aktivizohen këshillat arësimore.

Organet e arësimit në rrethe duhet të tregojnë interesim të veçantë sidomos për shkollën fillore, për mobilizimin në punë të mësuesve dhe ndihmën që duhet t'u japin atyre. Të forcohet kuadri drejtues i organeve të arësimit, duke ngritur më me guxim në këto poste mësues dhe drejtorë shkollash nga më të dalluarit dhe duke punuar më shumë për kualifikimin e tyre. Gjithashtu, për të ndihmuar kuadrot e arësimit që nuk mund të mësojnë me korrespondencë, të studjohet mundësia që të hapet për to pranë universitetit një kurs i lartë dyvjeçar.

Të punohet për forcimin e kabineteve pedagogjike. Në kabinetet e rretheve kryesore, veç përgjegjësit, të ketë edhe një metodist, në mënyrë që ata të mund të ndihmojnë si mësuesit e shkencave humanitare, ashtu edhe ata të shkencave matematike dhe natyrore.

3) Në mënyrë të veçantë duhet forcuar udhëheqja e shkollës, puna e drejtorive dhe e këshillave pedagogjike të shkollave. Deri tani drejtoritë e shkollave, si të shtatëvjeçarëve, ashtu edhe të të mesmeve, shumë pak kontrollojnë punën mësimore-edukative, po-

thuajse nuk bëjnë fare kontrollin tematike, drejtojnë shumë dobët punën ideo-metodike që zhvillohet në shkollë dhe, si rezultat, nuk i ndihmojnë konkretisht mësuesit. Në këshillat pedagogjike problemet e punës mësimore-edukative diskutohen shumë rrallë dhe cekët.

Është e domosdoshme që të rritet përgjegjësia dhe iniciativa e drejtorive dhe e këshillave pedagogjike të shkollave. Për këtë Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të shikojë edhe çështjen e zgjerimit të kompetencave të drejtorive të shkollave.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe organet e saj të punojnë në mënyrë të veçantë për forcimin e kuadrit drejtues të shkollës, për rritjen e autoritetit të tij, duke caktuar në punë drejtues kuadrot më të aftë dhe më të dalluar.

Për të ndihmuar drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e shkollave në kryerjen e detyrave të mësipërme, është e nevojshme që të ulet ngarkesa mësimore e tyre.

4) Komitetet ekzekutive duhet të interesohen më shumë dhe konkretisht për arësimin. Për t'i dhënë mundësi Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës që të merret me drejtimin ideo-metodik të shkollave, ato duhet të luftojnë për të zgjidhur vetë të tilla probleme të rëndësishme si realizimi i planit të nxënësve, ndërtimi dhe meremetimi i shkollave, pajimi i tyre, sigurimi i kopshteve dhe i mjeteve të punës, organizimi i kujdestarisë mbi shkollat etj.

5) Komitetet e Partisë duhet të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre me shkollat, të merren konkretisht me problemet e saj. Në mënyrë të veçantë ato duhet të interesohen për përmbajtjen e punës mësimore-edukative në shkollë, për punën me kuadrin arësitor: edukimin, trajtimin dhe aktivizimin e drejtë të tij, për mbarëvajtjen e arësimit për të rritur, për lidhjet e gjithanshme midis shkollave e qendrave të prodhimit, për punën politike-edukative me nxënësit.

Komitetet e Partisë duhet të punojnë për forcimin e organizatave bazë të Partisë të shkollave dhe të arësimitarëve, puna e të cilave deri tani është krejt e pamiaftueshme. Këto organizata duhet të punojnë më shumë për të rritur ndërgjegjen në punë të mësuesve dhe për edukimin komunist të nxënësve. Për këtë qëllim ato duhet të aktivizojnë më shumë organizatat profesionale të mësuesve dhe organizatat e rinisë e të pionierëve në shkollë. Organizatat e rinisë dhe të pionierëve kanë si detyrë kryesore të punojnë me nxënësit, në mënyrë që ata të mësojnë me këmbëngulie për t'u pajisur me dijeni të thella, të përmirësojnë punën për edukimin e brezit të ri me patriotizmin socialist, me dashurinë ndaj punës.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe organet e saj, organet e Partisë dhe të pushtetit, organizatat e Partisë dhe të masave duhet të mobilizohen për të realizuar arësimin e detyruar dhe planin e nxënësve, për të ruajtur kontingjentin e nxënësve që mësojnë nëpër shkollë, për të mos lejuar largimet e nxënësve nga shkollë.

Puna e shkollave nuk mund të përmirësohet rrënjësisht në goftë se për të interesohen vetëm organet e arësimit dhe mësuesit. Problemet e shkollave duhet të bëhen çështje të rëndësishme për organet e Partisë dhe të pushtetit, për organizatat e Partisë dhe të masave, për ndërmarrjet ekonomike. Çështja është që arësimi të bëhet një problem i përgjithshëm shtetëror dhe shoqëror, problem i masave. Në mënyrë të veçantë duhet të përmirësohet puna e familjes për edukimin e fëmijëve, të rritet përgjegjësia e saj për këtë çështje, duhet që prindërit t'i edukojnë fëmijët e tyre me dashurinë për dijen dhe punën, t'i nxitin dhe t'i ndihmojnë për të mësuar. Për të ndihmuar familjen që të kryejë rolin e saj të madh, në ndihmë të shkollës për edukimin e brezit të ri, duhet të kujdesen më shumë organizatat e Partisë, organet e arësimit dhe gjithë arësimitarët, Bashkimet Profesionale, Bashkimi i Grave të Shqipërisë dhe të zhvillohet një punë më e gjerë edukative me anë të botimeve etj. Shtypi, radioja etj. duhet të ngrënë më shumë çështje të arësimit dhe të ndihmojnë që ai të bëhet një problem i të gjitha masave.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim se masa e mësuesve dhe e punonjësve të arësimit, komunistët dhe punonjësit do të mobilizohen me të gjitha forcat për të zbatuar detyrat që shtrohen në këtë vendim. Tani jemi para fillimit të vitit të ri shkollor 1958-1959. Duke u mobilizuar për të filluar këtë vit sa më mirë, le të punojmë pa u lodhur për të filluar një kthesë rrënjësore drejt forcimit të gjithanshëm të punës në shkollat tona.

**Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
196, datë 15 gusht 1958**

PLENUMI XI I KQ TË PPSH.

Tiranë 3-4 nëntor 1958

KOMUNIKATË

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Me datën 3-4 nëntor 1958 u mbledh plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Plenumi dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi masat që duhen marrë për shtimin me ritëm më të shpejtë të prodhimit të mishit dhe të qumështit», paraqitur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

Plenumi shqyrtoi gjithashtu çështjen «Mbi pjesëmarrjen në punën fizike të kuadrove drejtues dhe të nëpunësve të aparateve të Partisë, të shtetit dhe të organizatave të masave.»

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, pasi diskutoi mbi problemet e mësipërme, mori njëzëri vendimet përkatëse.

NGA PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nr. 112

VENDIM

**I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH
«MBI PJESËMARRJEN NË PUNË FIZIKE TË KUADROVE
DREJTUES DHE TË NËPUNËSVE TË APARATEVE TË
PARTISË, TË SHTETIT DHE TË ORGANIZATAVE TË
MASAVE»**

4 nëntor 1958

Vendi ynë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës së Shqipërisë, po ecën me sukses në rrugën e ndërtimit të socializmit. Masat punonjëse të vendit tonë, me klasën punëtore heroike në krye, me

patriotizëm të madh dhe me ndërgjegje të lartë u janë përgjigjur detyrave të mëdha të ndërtimit ekonomik e kultural të vendit. Puna është bërë një çështje nderi për çdo punonjës të vendit tonë.

Me iniciativën e masave punonjëse dhe veçanërisht të rinisë sonë të lavdishme, në vendin tonë qysh në kohën e Luftës nacional-çlirimtare dhe, në formë më të organizuar, në periudhën e rindërtimit të vendit lindi dhe u zhvillua lëvizja patriotike e punës vullnetare, e cila tanimë është bërë një traditë e mirë në vendin tonë. Me punën vullnetare të dhjetëra mijëra punonjësve të vendit tonë u krye rindërtimi i vendit, u ndreqën shtëpitë e djegura në fshatra, u ndërtuan rrugë e ura, parqe e fusha sportive, u ngritën hekurudhat e para të vendit tonë, hidrocentrale e shumë e shumë vepra të tjera të rëndësishme. Kjo traditë e mirë vazhdon të përdoret me sukses edhe sot.

Pjesëmarrja aktive e punonjësve në punë fizike për të ndërtuar vepra të dobishme për popullin, për të ndihmuar edhe më shumë në ndërtimin e socializmit ka luajtur një rol të madh jo vetëm sepse me punën vullnetare janë ngritur objekte me rëndësi për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës popullore, por kryesisht sepse kjo punë ka ndihmuar shumë në rritjen e ndërgjegjes socialiste në masat e gjera të popullit dhe të rinisë sonë.

Çështja e forcimit të ndërgjegjes socialiste, e shtimit të dashurisë për punën fizike, e respektit për të është një nga faktorët më të domosdoshëm për ndërtimin me sukses të shoqërisë socialiste. Për këtë arësyje Komiteti Qendror i PPSH quan të domosdoshme që edhe në të ardhshmen t'i kushtohet një kujdes edhe më i madh dhe të organizohet edhe më mirë pjesëmarrja e punonjësve në punë fizike. Në punën fizike duhet të marrin pjesë veçanërisht punonjësit e administratës shtetërore, intelektualët, punonjësit e aparateve të Partisë dhe të organizatave shoqërore, duke përfshirë edhe kuadrot më të lartë të shtetit dhe të Partisë.

Pjesëmarrja në punë fizike e nëpunësve dhe e kuadrove drejtues të aparateve shtetërore dhe të Partisë, e intelektualëve dhe e kuadrove të organizatave të masave ka një rëndësi të madhe edukative dhe politike. Në këtë mënyrë do të bëhet një hap i dobishëm drejt kombinimit më të mirë të punës fizike me atë mendore, kuadrot e aparateve shtetërore dhe të Partisë, si edhe intelektualët tanë do të lidhen edhe më mirë me jetën dhe praktikën e ndërtimit socialist, do t'i forcojnë lidhjet e tyre me masat e popullit, do të mësojnë nga eksperiencia e tyre e madhe dhe do të njohin më afër luftën që bëjnë kundër pengesave e vështirësive klasa punëtore e fshatarësia punonjëse. Puna fizike do të jetë një faktor i rëndësishëm në rritjen e hovit revolucionar dhe të entuziazmit në punë, në luftën kundër burokracisë dhe mbeturinave mikroborgjeze, në ngritjen në një nivel edhe më të lartë të ndërgjegjes politike të punonjësve të vendit tonë. Kështu nëpunësit dhe kuadrot

drejtues të aparateve të shtetit dhe të Partisë do të forcohen edhe më shumë dhe do të kaliten si punonjës të aftë për të udhëhequr ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Pjesëmarrja në punë fizike e kuadrove të Partisë dhe të shtetit, e intelektualëve dhe e punonjësve të organizatave shoqërore do t'i entuziazmojnë punonjësit tanë, klasën punëtore e fshatarësinë dhe do të shtojë në ta besimin, dashurinë dhe respektin ndaj funksionarëve të ndryshëm dhe intelektualëve tanë. Ky do të jetë një faktor i rëndësishëm që do të nxisë një përparim edhe më të madh në të gjitha fushat e aktivitetit të punonjësve: në industri, në bujqësi, në arësim e kulturë.

Duke patur parasysh sa më sipër, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të datës 4 nëntor 1958,

V e n d o s i :

1. — Të gjithë nëpunësit, duke përfshirë edhe kuadrot drejtues të aparateve të Partisë dhe ato shtetërore, anëtarët e Komitetit Qendror të PPSH, anëtarët e qeverisë dhe të Presidiumit të Kuvendit Popullor, nëpunësit e aparateve shtetërore dhe të Partisë, të ndërmarrjeve, të organizatave të masave dhe atyre shoqërore, duke filluar që nga muaji janar 1959, duhet të marrin pjesë në punë fizike të paktën për një muaj në çdo vit. Përjashtohen vetëm ata punonjës, të cilët janë të sëmurë ose të kaluar nga mosha.

2. — Puna fizike e punonjësve të mësipërm do të kryhet në sektorët e industrisë, të bujqësisë dhe të ndërtimit si edhe në punë të tjera të ndryshme me karakter komunal, si rregullime qyteti, ndërtim parqesh e fushash sportive etj.

3. — Objektet ku do të punohet do të përcaktohen nga komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Radha e punonjësve të një qendre pune, që do të marrin pjesë në punë fizike, duhet të caktohet nga drejtuesit e këtyre qendrave, sekretarët e organizatave bazë të Partisë, kryetarët e bashkimeve profesionale dhe sekretarët e BRPSH.

Normat e punës që do të kryejnë pjesëmarrësit në punën fizike mund të jenë deri në 30 për qind më të ulëta nga normat në fuqi. Për kohën që do të kryejnë punën fizike, punonjësve do të vazhdojë t'u paguhet rroga sipas funksionit zyrtar në përpjesëtim me realizimin e normave të punës së caktuar.

4. — Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive si edhe organizatat bazë e këshillat popullore të lokaliteteve dhe të fshatrave duhet të zhvillojnë iniciativën për të aktivizuar pjesëmarrjen sa më të gjerë të masave punonjëse, e veçanërisht atyre të fshatit, në punë vullnetare për ndërtimin e rrugëve të fshatit, çezmave, shtëpive e vatrave të kulturës, për pyllëzimet, pastrimet e kullota-

ve, hapjen e qilizmave etj., duke zhvilluar kështu edhe më tej traditën tonë të punës vullnetare.

5. — Ngarkohet Këshilli i Ministrave të marrë të gjitha masat për organizimin e kësaj pune dhe të lëshojë udhëzimet përkatëse.

* * *

Komiteti Qendror i Partisë u bën thirrje gjithë punonjësve të vendit tonë, e veçanërisht punonjësve të aparateve shtetërore dhe të Partisë, intelektualëve tanë që me entuziazëm, me ndërgjegje të lartë socialiste dhe me patriotizëm t'i përgjigjen këtij vendimi, zbatimi i përpiktë i të cilit do të shënojë një hap të madh në ndërtimin e shpejtë të socializmit në vendin tonë.

Komiteti Qendror i Partisë u bën thirrje në radhë të parë gjithë komunistëve, që, si kurdoherë, ata të jenë të parët në zbatimin e këtij vendimi, të tregojnë veten si udhëheqës të masave punonjëse të popullit tonë me shembullin e tyre personal.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
269, datë 8 nëntor 1958

PLENUMI XII I KQ TË PPSH

Tiranë, 26-27 dhjetor 1958

KOMUNIKATË

Më 26-27 dhjetor 1958 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Plenumi dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi rezultatet e arritura në realizimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1958 dhe detyrat e planit të buxhetit për vitin 1959», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe presidenti i Komisionit të Planit të Shtetit, shoku Koço Theodhosi.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, pasi diskutoi dhe aprovoi raportin e mësipërm, mori njëzëri vendimin përkatës.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nr. 113

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI REZULTATET E ARRITURA NË REALIZIMIN E PLANIT DHE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1958 DHE DETYRAT E PLANIT E TË BUXHETIT PËR VITIN 1959»

27 dhjetor 1958

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur më datën 26-27 dhjetor 1958, pasi dëgjoi raportin e Byrosë Politike, mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike dhe president i Komisionit të Planit të Shtetit shoku Koço Theodhosi, «Mbi rezultatet e arritura në realizimin e planit dhe të buxhetit të shtetit të vitit 1958 dhe detyrat për vitin 1959» konstatoi se gjatë vitit 1958 forcat prodhuese të vendit u zhvilluan më tej në rrugën e caktuar nga Kongresi III i PPSH, u bë një punë e madhe për realizimin e detyrave të avancuara nga Plenumi i shkurtit i vitit 1958 në kushtet e reja të krijuara pas heqjes së plotë të sistemit të triskëtimit, për ngri-

tjen e mëtejshme të mirëqenjes materiale dhe kulturele të popullit, për forcimin e aftësisë mbrojtëse të vendit, si dhe për rritjen e autoritetit ndërkombëtar të Partisë dhe të Republikës sonë Popullore.

I

Klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia popullore, nën udhëheqjen e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, janë mobilizuar për të vënë në jetë detyrat e Plenumit të shkurtit 1958 të Komitetit Qendror të PPSH dhe kanë arritur rezultate të dukshme në forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore, në zhvillimin e industrisë, në forcimin e bujqësisë mbi baza socialiste, në zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë dhe të kulturës. Në saje të këtyre sukseseve është hapur një perspektivë në e gjerë për ndërtimin e gjithanshëm dhe me ritme të shpejta të socializmit në vendin tonë.

Puna e bërë gjatë vitit 1958 tregon edhe një herë drejtësinë e plotë të politikës së Partisë sonë, e cila, duke zbatuar në mënyrë krijuese ligjet e përgjithshme të ndërtimit socialist në kushtet e reja historike, ka ditur të kombinojë drejt mundësitë dhe burimet tona të brendshme me ndihmën e madhe që na jep kampi socialist e në radhë të parë Bashkimi Sovjetik.

... 1. — Volumi i përgjithshëm i prodhimit industrial në vitin 1958, sipas të dhënave praktike, u realizua në masën 26 miliard e 116 milion lekë, dmth 102 për qind në krahasim me planin dhe 20 për qind më shumë në krahasim me vitin 1957. Në vitin 1958 janë prodhuar më shumë se në vitin 1957: benzinë 41 për qind, gazoil 31 për qind, bitum fluksat 25 për qind, qymyrguri 9 për qind, mineral kromi 20 për qind, mineral bakri 61 për qind, energji elektrike 20 për qind, pjesë këmbimi 47 për qind, maqina e pajisje 57 për qind, çimento 10 për qind, tulla 16 për qind, lëndë druri e sharruar 16 për qind, lëndë druri e staxhionuar 20 për qind, rimeso 60 për qind, mobilje e orendi 35 për qind, pëlhurë të pambukta 15 për qind, pëlhurë të leshta 68 për qind, sheqer 13 për qind, yndyrna industriale 47 për qind, sapun 22 për qind, birrë 11 për qind, peshk i freskët 10 për qind, cigare e duhan 87 për qind, ullinj të konservuar 45 për qind, djathëra gjithsejt 143 për qind etj.

2. — Në fund të muajit nëntor të këtij viti numri i kooperativave bujqësore arriti në 1935 me një sipërfaqe toke të kolektivizuar prej 284.200 ha, ose 76,2 për qind të tokës së punueshme të fshatarësisë.

Në vitin 1958 sipërfaqja e mbjellë me kulturat kryesore industriale, është rritur më shumë se në vitin 1957 në pambuk 11,7 për qind dhe në duhan 15,9 për qind. Janë pregatitur më shumë se në vitin e kaluar rreth 60 mijë ton ushqime të njoma për blegtori-

në. Është rritur mekanizimi i bujqësisë, është shtuar 36 për qind numri i traktorëve dhe volumi i punimeve të SMT-ve 44 për qind më shumë se në vitin 1957. Një hap i madh është bërë për zhvillimin e frutikuturës, të vreshtave dhe të ullinjve.

Plani i grumbullimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale për vitin 1958 u realizua në krahasim me vitin 1957 si vijon: pambuku 104 për qind, duhani 119 për qind, orizi 140 për qind, perimet 109 për qind, rrushi 114 për qind, qumështi 152 për qind, mishi 100 për qind, leshi 101 për qind, vezët 101 për qind.

3. — Transporti automobilistik realizoi planin e vitit 1958 në masën 100 për qind, ose 12 për qind më shumë se në vitin 1957 për transportin e mallrave dhe 106 për qind, ose 22 për qind më shumë se në vitin 1957 për transportin e pasagjerëve, ndërsa transporti hekurudhor realizon një volum pune prej 14 për qind më shumë nga viti i kaluar.

4. — Plani i ndërtimit për vitin 1958 u realizua 100 për qind, ose 23 për qind më shumë nga viti 1957. Me zbatimin e detyrave të planit, ndërmarrjet e ndërtimit i dhanë vendit tonë një numër veprash të reja industriale, bujqësore dhe social-kulturale. Gjatë këtij viti u vunë plotësisht në shfrytëzim të katër turbinat e hidrocentralit «Karl Marks», u ndërtuan linjat e tensionit të lartë Ulëz-Kurbnesh-Qyteti Stalin-Marinëz, u vu në shfrytëzim frigoriferi i Tiranës, janë shpejtuar punimet për ndërtimin e fabrikës së përpunimit të mineralit të bakrit në Kurbnesh, filluan punimet për ndërtimin e kombinatit ushqimor në Tiranë, të fabrikave të përpunimit të rrushit në Këlcyrë, Çorovodë, të fabrikave të tullave në Shkodër, Lushnjë e Vlorë etj. Për strehimin e punonjësve u ndërtuan mbi 2.400 apartamente, ose 50 për qind më shumë se në vitin e kaluar, dhe 500 të tjera janë në përfundim e sipër. Janë shtuar për së tepërmi ritmet e punimeve për tharjen dhe uitjen e fushave të Myzeqesë, të Roskovecit, të Vurgut, të Thumanës etj.

5. — Gjatë vitit 1958 është përmirësuar edhe më shumë mirëqenja materiale dhe është ngritur niveli kulturor i popullit. Vëllimi i të ardhurave kombëtare në vitin 1958 është rritur 15 për qind më shumë se në vitin 1957 dhe paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve 6 për qind më shumë. Volumi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave në vitin 1958 arriti në 19 miliard e 920 milion lekë, ose 97 për qind kundrejt planit dhe 32 për qind më shumë se në vitin e kaluar.

Masat që morën Partia dhe qeveria për heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit në fund të vitit që shkoi dhe për uljen e çmimeve të mallrave të konsumit të gjerë, për shtimin e prodhimit, zgjerimin e asortimenteve etj. kanë bërë që në vitin 1958 të përmirësohet shumë furnizimi i popullit me artikuj industrialë e ushqimorë. Në vitin 1958 populli ka blerë nëpërmjet tregëtisë socialiste më shumë se në vitin 1957: bukë 21 për qind, miellra 22 për qind,

sheqer 21 për qind, yndyrna 8 për qind, oriz 12 për qind, qumësht 31 për qind, birra 13 për qind, tekstile të pambukta 21 për qind, tekstile të leshta 35 për qind, këpucë dhe opinga 23 për qind, lëndë druri 76 për qind, çimento 85 për qind, xhama 21 për qind, tulla 49 për qind, tjegulla 339 për qind, gozhda 41 për qind, sapun 2 për qind etj.

Numri i nxënësve në shkollat fillore, shtatëvjeçare dhe të mesme është rritur 5,4 për qind. Në vitin 1958 mbaruan studimet e larta në vend 383 kuadro të lartë (pa përfshirë këtu ata me korrespondencë).

Suksese janë arritur edhe në zhvillimin e kulturës dhe është zgjeruar rrjeti i institucioneve shëndetësore.

6. — Buxheti i shtetit për vitin 1958 është realizuar 95 për qind për të ardhurat dhe 94 për qind për shpenzimet. Gjatë vitit 1958 financat e shtetit kanë siguruar financimin pa ndërprerje të ekonomisë dhe të kulturës popullore. Shumë ndërmarrje ekonomike i kanë dhënë buxhetit të shtetit të ardhura mbi planin financiar, është forcuar më shumë kontrolli lidhur me administrimin e mjeteve monetare.

7. — Me gjithë sukseset e arritura, plani i vitit 1958 nuk u realizua plotësisht në të gjitha degët dhe ndërmarrjet ekonomike. Disa komitete dhe organizata bazë të Partisë, organe qendrore të ekonomisë, të pushtetit lokal, organizata të masave, si dhe disa drejtues të ndërmarrjeve nuk e kapën menjëherë gjendjen e re të krijuar me aprovimin e shtesave të planit të dytë pesëvjeçar, u punua pothuajse me të njëjtat ritme si më parë dhe nuk u nxuarën që në fillim konkluzionet e nevojshme për plotësimin e detyrave që shtroreshin në vitin 1958.

Nga ana e organeve të Partisë dhe të pushtetit në bazë dhe nga disa organe qendrore ekonomike është përqëndruar më shumë vëmendja për të realizuar planin vetëm si vëllim global. Kështu, lufta për ngritjen e vazhdueshme të treguesve cilësorë të planit: rritja e rendimentit të punës, ulja e kostos, zgjerimi i asortimenteve dhe përmirësimi i cilësisë së prodhimit dhe të shërbimit, nuk ka qenë në lartësinë e duhur. Kapacitetet prodhuese ekzistuese dhe në radhë të parë maqineritë nuk janë përdorur plotësisht, sidomos nga mungesa e organizimit të mirë të punës për realizimin e planit në mënyrë ritmike.

Ka ende formalizëm dhe të meta në metodën e drejtimit konkret të ekonomisë, kontrolli i zbatimit të detyrave është ende i dobët në mjaft hallka të aparateve ekonomike shtetërore dhe të partisë. Nuk ka ende një regjim të fortë kursimi në të gjitha ndërmarrjet ekonomike shtetërore dhe kooperativiste. Nuk është bërë sa duhet nga organet shtetërore, të Partisë dhe të pushtetit lokal për forcimin organizativ të kooperativave bujqësore dhe vazhdon të paraqitet e dobët puna për blerjen dhe grumbullimin e tepricave

bujqësore dhe blegtorale. Nga Ministria e Bujqësisë dhe disa komitete partie e komitete ekzekutive nuk mbahet si duhet parasysh detyra kryesore e Kongresit III për sigurimin e bukës në vend. Disa dikastere, si Ministria e Industrisë dhe e Minerave, e Ndërtimit, e Komunikacionit etj., nuk morën me kohë masat e nevojshme për të nxjerrë nga prapambetja ndërmarrjet që shkonin keq me planin. Mjaft komitete partie me vështirësi po i futën punës për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme të shtruara nga Kongresi III i Partisë, si dhe nga plenumet e mëvonshme të Komitetit Qendror, sikurse janë: mundësitë e shtimit të prodhimit dhe të zgjerimit të asortimenteve të reja të mallrave, hapja e tokave të reja, prodhimi i drithërave në vend, rrugët për uljen e kostos së prodhimit dhe të shërbimit, shpenzimet e qarkullimit në tregëti, problemi i cilësisë së prodhimit dhe të shërbimit, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e maqinerisë, edukimi dhe pregatitja e kuadrit etj. Krahas me këto në mjaft raste problemet shqyrtohen nga ana e komiteteve të Partisë në përgjithësi dhe në rrugë shtetërore, për pregatitjen e tyre nuk aktivizohen sa duhet kuadrot kryesore të rrethit ose të qytetit si anëtarët e plenumit, inxhinierët, teknikët, ekonomistët, shefat e llogarisë, etj., të cilët duhet të ndihmojnë me eksperiencën dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e punës në sektorët ekonomikë. Në të njëjtën kohë duhet theksuar se duke i parë vetë në mënyrë të tillë problemet, komitetet e Partisë, sekretarët dhe instruktorët nuk i ndihmojnë organizatat bazë për trajtimin e çështjeve ekonomike në mënyrë të thelluar, me syrin e Partisë dhe jo ashtu si i analizon çështjet këshilli teknik i ndërmarrjes.

Gjatë këtij viti, organizatat e masave dhe në mënyrë të veçantë Bashkimet Profesionale nuk muarën masat e nevojshme për të mobilizuar si duhet kolektivat punonjëse që në fillim me anën e zhvillimit të emulacionit socialist, me qëllim që detyrat që shtruan Plenumet e shkurtit dhe të prillit të KQ të vitit 1958 të gjenin zbatimin e plotë. Bashkimet Profesionale me ngadalësi po u futën problemeve ekonomike dhe pak po punojnë për zhdukjen e formalizmit në punën e tyre.

— II —

Duke u mbështetur në detyrat kryesore të caktuara nga Kongresi III i Partisë sonë, si dhe në vendimet e Plenumit të shkurtit të KQ të Partisë mbi shtesat në pesëvjeçarin e dytë, në rezultatet e arritura, në mundësitë reale të vendit, si edhe në ndihmën e dhënë nga vendet socialiste dhe veçanërisht nga Bashkimi Sovjetik, plenumi i KQ të Partisë vendosi që shifrat e planit të shtetit për vitin 1959 të jenë si vijon:

1. — Vëllimi i përgjithshëm industrial për vitin 1959 të arrijë në 30 miliard e 554 milion lekë, ose 17 për qind më shumë se në vitin 1958.

Prodhimi industrial sipas degëve, për vitin 1959 të rritet, kundrejt vitit 1958, në këtë masë: industria e naftës 18 për qind, industria e bitumit 22 për qind, industria e qymyrgurit 8 për qind, industria e kromit 24 për qind, industria e bakrit 20 për qind, industria e hekurit 20 për qind, industria elektrike 12 për qind, industria mekanike 20 për qind, industria e drurit 20 për qind, industria e lehtë 15 për qind, industria ushqimore 29 për qind, industria lokale 7 për qind, sektori kooperativist 19 për qind. Rendimenti i punës për Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave të rritet 9 për qind më shumë dhe kostua të ulet 3,4 për qind.

2. — Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor në vitin 1959 të arrijë në 32 miliard e 340 milion lekë, dmth 26 për qind më shumë se në vitin 1958. Në vitin 1959, sipërfaqet e mbjella të arrijnë në 435.300 ha për të gjithë republikën, d.m.th. 10.5 për qind më shumë se në vitin 1958, mbjelljet e dyta të arrijnë në 90.000 ha, d.m.th. 20 për qind kundrejt të gjithë sipërfaqes së mbjellë. Të hapen 37.900 ha toka të reja, nga të cilat 17.000 ha toka për ara, si dhe të plotësohen defiqitet prej 15.600 ha të viteve të kaluara. Prodhimi i drithërave të bukës të arrijë në 453 mijë ton, ose 64 për qind më shumë se në vitin 1958, prodhimi i pambukut të rritet 34 për qind, i duhanit 28 për qind dhe i panxhar sheqerit 78 për qind më shumë se në vitin 1958.

Vëllimi i përgjithshëm i punimeve të mekanizuara për vitin 1959 të arrijë në 1 milion e 56 mijë ha unitet hamullor, ndërsa mekanizimi i proceseve të punimeve bujqësore në fushë të arrijë këtë shkallë: plugimet 75 për qind, prashitjet 25 për qind, mbjelljet e pranverës 40 për qind, mbjelljet e vjeshtës 45 për qind, korrjet 30 për qind dhe shirjet 67 për qind. Në vitin 1959 të prodhohet 47.210 ton mish, 208.800 ton qumësht dhe 2.900 ton lesh. Numri i lopëve të rritet 7,3 për qind më shumë se plani i vitit 1958 dhe rendimenti i qumështit të lopëve të rritet mesatarisht për të gjithë republikën nga 655 në 752 kg/krerë. Numri i dhenve të rritet 4 për qind, i dhive 8,9 për qind, i dosave 26 për qind, i shpendëve 32,5 për qind. Mbjelljet e pemëve frutore të rriten 9 për qind, e agrumeve 106 për qind, e vreshtave 17 për qind dhe e pjergullave 47 për qind.

Në vitin 1959 të grumbullohen më shumë se realizimi i vitit 1958: drithëra buke 42 për qind, fasule 62 për qind, pambuk 33 për qind, panxhar sheqeri 74 për qind, duhan 23 për qind, elb distik 21 për qind, perime 38 për qind, patate 316 për qind, fruta 140 për qind, rrush 83 për qind, qumësht 73 për qind, mish 16 për qind, lesh 38 për qind, vezë 67 për qind, lëkurë të trasha 13 për qind, lëkurë të imta 45 për qind etj.

3. — Vëllimi i transportit të mallrave me automjete, për të gjithë republikën, të arrijë në 294,5 milion ton/km, ose 28 për qind më shumë se në vitin 1958, nga i cili vëllimi i transportit me automjetet e Ministrisë së Komunikacionit të arrijë në 185 milion ton/km., ose 26 për qind më shumë. Në transportin hekurudhor të mallrave vëllimi i punës të arrijë në 48,5 milion ton/km, ose 47 për qind më shumë dhe në transportin detar vëllimi i punës të arrijë në 22,1 milion ton/mila ose 20 për qind më shumë. Rendimenti i punës në transport të rritet përgjithësisht 7 për qind dhe kostua të ulet 6,6 për qind.

4. — Vëllimi i përgjithshëm i investimeve për vitin 1959 të arrijë në 13 miliard e 600 milion lekë, ose 40 për qind më shumë nga viti 1958. Në vitin 1959 investimet të jenë më të mëdha se në vitin 1958: në miniera 39 për qind, në industri 179 për qind, në bujqësi 15 për qind, në komunikacion 30 për qind, në arësim 50 për qind, në shëndetësi 47 për qind, në ekonominë komunale 13 për qind etj.

Vëllimi i përgjithshëm i ndërtimeve të jetë 5 miliard e 880 milion lekë, ose 28 për qind më shumë se në vitin 1958. Peshat specifike në sektorët prodhues të jetë 70 për qind dhe në sektorët joprodhues 30 për qind. Të fillohet nga puna për rindërtimin e uzinës së përpunimit të naftës në Cërrik, të fillojnë punimet për ndërtimin e fabrikës së briketimit të qymyrit, të shpejtohen punimet për ndërtimin e fabrikës së pasurimit të bakrit në Kurbnesh, të hidrocentraleve të Bisticës dhe të Shkopetit, të kombinatit ushqimor në Tiranë. Gjatë vitit 1959 të ndërtohen banesa për punonjësit me një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 220 mijë m², ose 39 për qind më shumë se në vitin 1958. Rendimenti i punës në ndërtim e montim të rritet 17 për qind dhe kostua të ulet 10,8 për qind.

5. — Vëllimi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave në vitin 1959 të arrijë në 22 miliard e 870 milion lekë; ose 15 për qind më shumë se në vitin 1958. Shitja e mallrave të konsumit të gjerë mesatarisht për çdo frymë të popullsisë nga rrjeti i tregëtisë socialiste të rritet në këtë masë: sheqer 26 për qind, sapun 37 për qind, tekstile të pambukta, kadife e drill 3 për qind, tekstile të leshta 7 për qind, këpucë dhe opinga 36 për qind, dhe veç kësaj shitja mesatare për çdo frymë të qytetit të rritet: miellra 17 për qind, yndyrna 34 për qind, fasule dhe oriz 20 për qind, mish 40 për qind, peshk 68 për qind, djathë 31 për qind, qumësht 87 për qind, birra 4 për qind etj.

Vëllimi i përgjithshëm i të ardhurave kombëtare do të rritet më shumë se në vitin 1958 dhe do të merren masa në mënyrë që të rritet paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve dhe të ardhurat reale të fshatarësisë.

Vëllimi i përgjithshëm i mallrave të eksportit të rritet 32 për qind më shumë se në vitin 1958.

Numri i nxënësve në shkollat fillore të rritet 4 për qind, në shkollat shtatëvjeçare 14 për qind, në shkollat e mesme 20 për qind dhe në arësimin e lartë të jetë mbi 3.200 vetë. Të hapen 58 kopshte të reja dhe numri i përgjithshëm i fëmijëve në kopshte të rritet 11 për qind, të ndërtohen 17 shkolla shtatëvjeçare, 3 shkolla të mesme, 10 shtëpi kulture, 39 shtëpi leximi etj.

T'i kushtohet një kujdes i veçantë gjithë problemit të përgatitjes dhe të kualifikimit të kuadrit për të gjithë sektorët, në të gjithë sistemin e shkollave dhe të kurseve. Të merren që tani masat e nevojshme për një gatishmëri të plotë të shkollave për vitin e ardhshëm shkollor.

Komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë duhet të shtrojnë në mënyrë të posaçme përpara organeve shtetërore lokale dhe organizatave të Partisë çështjen e realizimit të numrit të nxënësve në të gjitha kategoritë e shkollave, duke tërhequr sa më tepër nxënës në to. Organizatat e Partisë në fshat, në qendra pune e ndër-marrje duhet të ndalen veçanërisht në punën që bëhet për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit, në punën e arësimit.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, të gjitha organet e arësimit dhe të gjithë arësitarët, përveç sigurimit të realizimit të planit të edukimit, t'i konsiderojnë si detyra të tyre kryesore forcimin e punës mësimore edukative në shkollë, ngritjen e cilësisë së mësimin, forcimin e disiplinës në shkollë si dhe ngritjen e cilësisë së punës nga gjithë trupi pedagogjik. Çështja e mësimin dhe e edukimit të brezit të ri, mbarëvajtja e punës në shkolla e kurse, të ditës ose të natës, me shkëputje ose pa shkëputje nga puna, duhet të tërheqë vëmendjen e të gjitha organeve shtetërore dhe organizatave të Partisë. Të përmirësohen kushtet e punës dhe të mësimin në shkollat dhe kurset, duke siguruar për këtë pajimet dhe mjetet mësimore që nevojiten.

Institucionet e mjekimit të rriten 3 për qind dhe numri i shtretërve në to 9 për qind.

6. — Buxheti i shtetit për vitin 1959 të jetë 27 miliard e 400 milionë lekë, ose 10,8 për qind më shumë se realizimi i vitit 1958, për të ardhurat dhe 26 miliard e 900 milion lekë, ose 9 për qind më shumë se shpenzimet e vitit 1958, me një suficit prej 500 milion lekësh.

Gjatë vitit 1959 të rriten të ardhurat e buxhetit nga tatimi mbi xhiro prej 10,4 për qind, nga teprica fitimi 44 për qind, kryesisht nga rritja e prodhimit dhe nga ulja e mëtejshme e kostos. Të rriten shpenzimet për financimin e ekonomisë popullore në 16 për qind, për financimin e masave social-kulturale 14,5 për qind.

Detyrat e planit të vitit 1959 janë të mëdha, por të realizueshme. Për të siguruar realizimin me sukses të këtyre detyrave është e nevojshme që të mobilizohen e gjithë Partia, të gjitha organet shtetërore dhe ekonomike, të gjitha masat punonjëse. Duhet të merren të gjitha masat për të zhdukur të metat në punën tonë, të përmirësojmë edhe më shumë metodën e drejtimit të ekonomisë për të realizuar plotësisht dhe me kohë të gjithë treguesit e planit. Veçanërisht në industri vëmendja e organeve të Partisë dhe e atyre shtetërore të përqëndrohet në këto çështje kryesore:

1. — Të forcohet puna në kërkimet gjeologjike në përgjithësi dhe veçanërisht në industrinë e naftës dhe të kromit.

Për plotësimin e detyrave të shërbimit gjeologjik për rritjen e rezervave dhe të numrit të vendburimeve të reja, sidomos për naftën dhe kromin, është e nevojshme të zgjerohen punimet e kërkimit. Të merren masa për të vënë në jetë rekomandimet e grupit të punës të komisionit të përhershëm të Këshillit Ekonomik të Ndihmës Reciproke që u mbajt në Tiranë për industrinë e naftës dhe të gazit.

Kombinati i naftës të përmirësojë punën në shpim-kërkimet e thella në zonën e Marinzës dhe në fushat e tjera të caktuara. Të forcohet kërkimi i horizonteve që shtrihen më poshtë në zonën e Marinzës, duke filluar sa më parë shpimin e puseve të rekomanduara.

Të punohet me kujdes për rritjen e shpejtësisë së shpimit, duke zgjeruar dhe duke përvetësuar më mirë shpimin me turbina, duke përdorur regjimin e shpejtë të shpimit, shkurtimin e ndalesave, zhdukjen e avarive në punë etj. Drejtoria e Kombinatit të naftës dhe Komiteti i Partisë të Qytetit Stalin të merren seriozisht me zgjedhjen dhe përgatitjen e kuadrove për shpim-kërkimet e thella. . .

Të përmirësohet puna për përgjithësimin e materialeve gjeologjike. Të forcohet bashkëpunimi midis shërbimit gjeologjik të Kombinatit të naftës dhe Komitetit Shtetëror të Gjeologjisë, duke bashkërenduar rregullisht planet e studimeve të tyre.

Të intensifikohen punimet e kërkimit për kromin, duke përqëndruar në rajonet Martanesh-Kalimash, Bulqizë dhe Pishkash rreth 33 për qind të të gjitha shpimeve. Të kryhen më 1959 mbi 140 km² rivelime gjeologjike në shkallë 1:10.000, me qëllim që të vendoset baza për studimet gjeologjike në të ardhshmen. Të forcohen punimet me metodat gravimetrike, të përmirësohet në mënyrë rrënjësore përgjithësimi i materialeve gjeologjike, marrja e kampioneve dhe dokumentimi gjeologjik i punimeve. Në vitin

1959 të sigurohen 1 milion ton rezerva të reja kromi, gjysma e të cilave me përmbajtje mbi 40 për qind krom.

Të vendoset një regjim i rreptë kursimi, në mënyrë që kostua e punimeve gjeologjike të dalë sa më e ulët. Për këtë qëllim të caktohen detyra më mobilizuese dhe të zbulohen rezerva të reja që ka në gjeologji. Të merren masa për të rritur shpejtësinë sondë-muaj dhe rendimentin e punës.

Të punohet për përmirësimin e punës së drejtimit në ndërmarrjet gjeologjike. Komitetet e Partisë të kontrollojnë dhe të ndihmojnë nga afër punonjësit e gjeologjisë dhe të gjallërojnë organizatat bazë të Partisë dhe të masave në këtë sektor.

Të merren masa për ngritjen e kualifikimit të kuadrit, nëpërmjet kurseve dhe vendosjes pranë specialistëve të huaj për të mësuar. Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të ketë parasysh përgatitjen e më shumë kuadrove nga zonat ku janë përqëndruar më shumë kërkimet gjeologjike dhe minierat, duke dërguar në shkollat e mesme dhe të larta një numër më të madh nxënësish nga këto zona. Të përmirësohet puna në degën gjeologjike të Universitetit të Tiranës, të shtohet numri i nxënësve, duke krijuar mundësitë edhe për studimin me korrespondencë, duke ndërruar dhe profilin e studentëve për naftën.

Krahas këtyre detyrave të vazhdojnë punimet në vendburimet e bakrit në Kurbnesh, në Spaç, në Rubik e në Rejë. Të përfundojnë punimet fushore në vendburimet e hekur-nikelit në Prrenjës, në Cervenakë-Hudenisht e në Bistricë dhe të jepen më 1960 raportet përfundimtare. Brenda 6 mujorit të parë të vitit 1959 të dorëzohet vendburimi i qymyrgurit në Alarup. Të vazhdojnë kërkimet e mëtejshme për nikelin, silikatet, fosforitet, boksitet, kaolinat, argjilet dhe mineralet e tjera të dobishme, në mënyrë që gjatë vitit 1959 të përcaktohen detyra më konkrete për studimin dhe kërkimin e tyre. Të zgjerohen kërkimet hidrogjeologjike edhe në zonat e Shkodrës e të Korçës, duke patur parasysh furnizimin me ujë edhe të bujqësisë.

2. — Duhet të merren masa për kapërcimin e vështirësive në realizimin e planit në industrinë e materialeve të ndërtimit.

Për të nxjerrë këtë sektor nga prapambetja është e nevojshme që Ministria e ndërtimit të përfundojë sa më parë rindërtimin në fabrikat e tullave në Tiranë, në Durrës dhe në Korçë. Ministria e Industrisë dhe e Minierave të marrë të gjitha masat për arritjen e plotë të treguesve tekniko-ekonomike të projektit të këtyre fabrikave që do të rindërtohen deri në vitin 1960.

Të projektohen dhe të ndërtohen brenda vitit 1959 fabrikat e tullave në Shkodër, në Lushnjë, në Vlorë dhe në Elbasan. Të

përfundojë montimi i maqinave të tullave tip «kolkoznik» në rrethet e parashikuara në plan dhe të fillojë prodhimi në muajin prill.

Të vazhdojë studimi i rezervave dhe i llojeve të lëndës së parë, të përcaktohet përdorimi dhe mënyra e shfrytëzimit të tyre. Të sigurohen maqineritë e nevojshme për mekanizimin e nxjerrjes dhe të lëvizjes së dheut në të gjitha fabrikat.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe komitetet ekzekutive të marrin të gjitha masat organizativo-teknike që në industrinë e tulla-tjegullave të ulet kostua e prodhimit dhe të rritet rendimenti i punës. Në të gjitha fabrikat e tullave të ngrihen laboratorët përkatës. Të shtohet prodhimi i tullave grez dhe të përmirësohet cilësia dhe rezistenca e tyre.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave të studojë në bashkëpunim me Ministrinë e Arësimit dhe të Kulturës dhe me komisionin e Planit të Shtetit mundësinë e përgatitjes në vend të teknikëve të mesëm me anën e kurseve me ndërprerje nga puna për industrinë e materialeve të ndërtimit dhe njëkohësisht të marrë masa për të përgatitur më shumë kuadro jashtë shtetit për këtë degë. Komitetet ekzekutive të sigurojnë me kohë fuqinë punëtore si për këto degë të ekonomisë, ashtu edhe për minierat, ndërtimin e sharrat etj.

3. — Të bëhet një kthesë rrënjësore në plotësimin e planit, në shfrytëzimin dhe përdorimin e lëndës së drurit.

Në mënyrë që industria e drurit të vihet në radhën e degëve të përparuara të ekonomisë dhe të kryejë me sukses detyrat e pesëvjeçarit të dytë, si dhe për të krijuar një bazë të shëndoshë për pesëvjeçarin e tretë, Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe komitetet e Partisë të ndihmojnë seriozisht degën e industrisë së drurit dhe të marrin të gjitha masat tekniko-organizative për të vënë në rrugën e plotësimit të planit të gjitha ndërmarrjet kombëtare dhe lokale të industrisë së drurit. Në mënyrë të veçantë të dalë nga prapambetja e vazhdueshme Kombinati i drurit «Nako Spiru».

Të sigurohen me çdo kusht rezervat e lëndës së parë për një periudhë tre deri katër muaj në trupa sharre për çdo stabiliment, në trup kompensate, në koçane për likus, lëndë për imprenjim etj. Ministria e Bujqësisë të caktojë parcela që nuk zihen nga bora për periudhën e dimrit dhe Ministria e Komunikacionit të zbatojë precedencën që i duhet dhënë furnizimit të sharrave.

Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Industrisë dhe e Minierave të hartojnë projektet, në bazë të të cilave do të shfrytëzohen zonat pyjore. Projektet të jenë një mjet i fortë për sigurimin e plotësimit të planit në perspektivë, për shfrytëzimin racional të

ekonomisë pyjore. Ndërmarrjet pyjore brenda muajt maj 1959 të bëjnë damkosjen paraprake të lëndës në këmbë për deri në fund të vitit, kurse në vitet e ardhshme damkosja të bëhet për një vit dhe gjithnjë në tremujorin e katërt të vitit paraardhës.

Nga ana e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, ndërmarrjeve të lëndës së drurit dhe e komiteteve të Partisë të rretheve përkatëse problemi i mekanizimit të konsiderohet si një nga problemet kryesore që përcaktojnë plotësimin e planit të prodhimit, të rendimentit dhe të kostos, të zgjerohet me ritme të shpejta dhe në mënyrë urgjente mekanizimi në sektorin e pyllit, gradualisht të bëhet mekanizimi i prerjes së drurit, në mënyrë që në fund të vitit 1960 prerja me motosharra të arrijë në 40 përqind, duke studjuar në kompleks ngritjen e kuadrit etj.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave, ndërmarrjet përkatëse dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të studjojnë çdo tremujor problemin e strukturës së asortimenteve, të zgjerohen asortimentet e prodhimeve nga përpunimi i drurit, duke ua përshtatur sa më tepër nevojave dhe kërkesave të punonjësve të qytetit dhe të fshatit, të përmirësohet cilësia e tyre dhe të ulët kostua e këtyre prodhimeve. Të organizohet pa humbur kohë evidentimi dhe kontrolli i fazës së prerjes së lëndës në pyll dhe të pakësohet prodhimi i druve të zjarrit. Në fund të 6-mujorit të parë të vitit 1959 t'i propozohen qeverisë masat organizativo-teknike që duhen marrë për të rritur sasinë e dru-punimit rreth 50 për qind kundrejt lëndës gjithsej të prerë. Të merren masa për shfrytëzimin e mbeturinave të lëndës së drurit. Për këtë çështje të ngrihen punishte pranë sharrave, të cilat të prodhojnë arka ambalazhi dhe prodhime prej druri për fshatin etj.

4. — Të forcohet vëmendja e organizatave të Partisë dhe të masave, e organeve shtetërore dhe të ekonomisë për përmirësimin e treguesve cilësorë: rendiment, kosto, cilësi, asortiment.

Për të përmirësuar punën lidhur me zbatimin e detyrave të planit është e nevojshme që dikasteret qendrore, komitetet dhe organizatat bazë të Partisë, organet e pushtetit dhe të ekonomisë të kenë në qendër të vëmendjes zbatimin e treguesve cilësorë të planit ekonomik të shtetit. Herë pas here të shikohen nga ana e tyre problemet e rendimentit të punës, të uljes së kostos, të zgjerimit të asortimenteve të reja të prodhimit dhe të cilësisë së mallrave.

Rendimenti i punës duhet të konsiderohet problemi qendror jo vetëm për realizimin e planit në tërësi, në mënyrë ritmike, por edhe për përdorimin e drejtë të forcës punëtore të planifikuar dhe të maqinerisë. Të studjohen rrugët për ngritjen e rendimentit të punës nëpërmjet njohjes dhe mobilizimit të rezervave të brendshme;

në këtë drejtim të punohet seriozisht për zëvendësimin e normave eksperimentale statistikore me norma teknike, si një faktor shumë i rëndësishëm për realizimin e tejkalimin e planit të rendimentit; të merren masa për zhdukjen e humbjeve të kohës së punës dhe të maqinerisë, të ngrihet kualifikimi i kuadrit dhe të zgjerohet emulacioni socialist në punë.

Ulja e kostos të konsiderohet një nga detyrat më të rëndësishme të organeve të pushtetit dhe të Partisë dhe të luftohet me këmbëngulje për arritjen e sukseseve në drejtim të uljes së mëtejshme të saj. Ulja e kostos duhet të shërbejë për financimin e ekonomisë popullore, për uljen e çmimeve dhe ngritjen e mëtejshme të mirëqenjes së masave punonjëse. Drejtuesit e ndërmarrjeve ekonomike, inxhinierët, ekonomistët, organizatat e Partisë duhet të luftojnë me vendosmëri për mënjanimin e humbjeve në prodhim, si dhe të studjojnë rrugët për ndalimin e tyre.

Të forcohet puna për respektimin e disiplinës së planit jo vetëm në tërësi, por edhe në drejtim të asortimentit dhe të cilësisë. Të luftohet prirja për të prodhuar ato asortimente që ngrenë vleftën e prodhimit në dëm të asortimenteve të tjera, sidomos në industrinë ushqimore, në industrinë e lehtë dhe në artizanat. Lufta për përmirësimin e cilësisë së prodhimit dhe të shërbimit të konsiderohet si një detyrë e dorës së parë në plotësimin e planit të prodhimit. Të forcohet kontrolli i standardeve pranë ndërmarrjeve si dhe influenca e tregëtisë mbi prodhimin, mallrat të ruhen dhe të mirëmbahen mirë në depo dhe në dyqanet e tregëtisë.

5. — Të marrim masa për sigurimin me kohë të lëndës së parë dhe të materialeve kryesore në industri dhe në ndërtim.

Për të patur në vitin 1959 një përmirësim të furnizimit materialo-teknik dhe për të siguruar me kohë lëndët e para dhe materialet për prodhim dhe ndërtim është e nevojshme që të gjitha ministrinë, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë t'i kushtojnë një vëmendje të posaçme problemit të furnizimit të ndërmarrjeve me lëndë të para e materiale. Duke realizuar planin e prodhimit të vitit 1959 të sigurohet nga të gjitha ndërmarrjet prodhuese furnizimi ritmik dhe i plotë i të gjithë konsumatorëve të tyre për të mënjeluar kështu çdo ndërprerje të prodhimit për mungesë materiale. Të merren masa për të krijuar me çdo kusht rezervat e planifikuara.

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka ulja e normave të përdorimit të materialeve dhe mundësitë në këtë drejtim, të gjitha organet qendrore dhe organizatat e Partisë të marrin masat e nevojshme që të sigurojnë jo vetëm plotësimin e

tyre sipas planit të furnizimit, por dhe t'i ulin vazhdimisht ato. Komisioni i Planit të Shtetit të kontrollojë më shumë dhe më mirë zbatimin e normave të materialeve dhe të marrë masa për përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

Ministria e Tregëtisë të përmirësojë punën e saj për kontraktimin dhe sjelljen e mallrave nga importi, duke siguruar ardhjen më parë të mallrave urgjente dhe të gjitha materialeve të tjera të importit sipas afateve të planit.

6. — Detyrat e planit të vitit 1959 në lëmin e bujqësisë janë të mëdha. Për plotësimin me sukses të këtyre detyrave vëmendja e organizatave të Partisë, e organeve shtetërore dhe e gjithë punonjësve të bujqësisë të përqëndrohet në këto çështje kryesore:

a) *Të merren masa për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore.* Për këtë qëllim të respektohet me përpikmëri më të madhe statuti nga çdo kooperativë bujqësore, sepse ai përbën ligjin themeltar të të gjithë jetës kooperativiste. Çdo shkelje e tij, sado e vogël që të jetë, dëmton rëndë ekonominë e përbashkët kooperativiste dhe interesat personale të anëtarëve. Zbatimi me përpikmëri i statutit kërkon zhvillimin e pandërprerë të demokracisë kooperativiste, me qëllim që të gjithë anëtarët e kooperativës, me pjesëmarrjen e tyre aktive në drejtimin e ekonomisë së përbashkët, të ndihmojnë për shtimin e konsiderueshëm të prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Shtimi i vazhdueshëm i prodhimeve bujqësore e blegtorale si dhe ulja e kostos së tyre kërkon që kooperativat bujqësore të zhvillojnë ekonominë e tyre në mënyrë të gjithanshme, duke prodhuar sa më shumë drithëra, bimë industriale, perime, rrush, pemë frutore, mish, qumësht etj. Krahas me këtë, çdo kooperativë me ndihmën e organeve të rrethit të përcaktojë drejtimin e saj kryesor, d.m.th. ato prodhime që do të zënë vendin më të rëndësishëm në ekonominë e kooperativës. Kjo të bëhet e lidhur ngushtë me kushtet konkrete të tyre, duke marrë parasysh interesat e anëtarëve dhe nevojat e planit të shtetit.

Zhvillimi i gjithanshëm i ekonomisë kooperativiste kërkon që ajo të bëhet në bazë të një planifikimi të drejtë. Prandaj komitetet ekzekutive të rretheve të ndihmojnë nga afër kooperativat bujqësore në hartimin e planeve vjetore dhe perspektive. Çdo vit, në muajin shtator, siç e parashikon metodologjia e planifikimit, komitetet ekzekutive të rretheve të shqyrtojnë një nga një dhe me hollësinë më të madhe planin e çdo kooperative. Në hartimin e planeve vjetore si kooperativat bujqësore, ashtu edhe organet e rrethit duhet të mbajnë vazhdimisht parasysh planin e rezervave të brendshme të hartuar qysh më 1957, planin e zhvillimit të blegtorisë në bazë të detyrave që shtroi Plenumi i nëntorit i Komitetit Qendror si dhe detyrat e tjera që u dalin kooperativave bujqësore.

Forcimi i vazhdueshëm ekonomik dhe organizativ i kooperativave bujqësore kërkon një organizim më të mirë në punë, me qëllim që të përdoren sa më drejt forcat e punës, koha dhe mjetet e kooperativës. Në të gjitha kooperativat punë ka në çdo kohë të vitit dhe për të tërë, por duhen luftuar mendimet e gabuara se gjoja duke bërë shumë ditë pune ulet vlera e saj. Të zbatohet drejt sistemi i shpërblimit të punës dhe të rritet interesi material i anëtarëve që punojnë më shumë dhe më mirë. Për këtë qëllim kooperativat bujqësore të zbatojnë shpërblimin e punës jo vetëm sipas punës që kryen secili, por edhe sipas rezultateve të arritura në prodhim. Kooperativat bujqësore t'u japin anëtarëve rregullisht paradhënje në lekë, në bazë të rregullave të caktuara për këtë qëllim. Lidhur me këtë kooperativat të kujdesen që të sigurojnë për shitje kryesisht në organet shtetërore dhe kooperativiste prodhime të ndryshme gjatë gjithë vitit, për të krijuar të ardhura të vazhdueshme. Kjo do të bëjë që gjithë kooperativistët të jenë të interesuar jo vetëm për plotësimin dhe tejkalimin me sukses të planit në të gjitha degët e ekonomisë kooperativiste, por dhe që të bëjnë ditë-pune gjatë gjithë vitit.

Sektorit të llogarisë t'i kushtohet një kujdes i posaçëm si nga ana e vetë kooperativave, ashtu edhe nga organet e rrethit. Çdo veprim ekonomik-financiar i kooperativës të dokumentohet dhe të kryhet sipas rregullave të caktuara. Komisionet e revizionimit në çdo kooperativë të forcojnë kontrollin dhe t'u presin rrugën shpërdorimeve dhe çrregullimeve. Mbledhjet e përgjithshme të kooperativave bujqësore dhe organet e drejtësisë të tregohen të rreptë kundrejt gjithë atyre që përpiqen të dëmtojnë sado pak ekonominë e përbashkët kooperativiste. Ruajtja e pasurisë kooperativiste kërkon që toka, kafshët e punës dhe mjetet e prodhimit dhe gjithë pasuria kooperativiste t'u jepet në ngarkim kooperativistëve të caktuar, të cilët të përgjigjen për administrimin e mirë të tyre.

Me qëllim që të forcohet drejtimi i kooperativave bujqësore të mëdha dhe që do të bashkohen, kur këto kanë një sipërfaqe mbi 500 ha ara të mbjella bashkë me vreshta, për ngritjen e shpejtë të prodhimit dhe për organizimin e një jete më të kulturuar në fshat Komiteti Qendror porositi gjithë komitetet e Partisë të rretheve, organet shtetërore qendrore si dhe aparatit e Komitetit Qendror të marrin masa që brenda vitit 1959-1960 të dërgohen rreth 200 kuadro të aftë për kryetarë kooperativash bujqësore. Këta të zgjidhen midis kuadrove të aparateve shtetërore qendrore, nga sekretarët e komiteteve të Partisë që njohin më mirë bujqësinë, nga nënkryetarët dhe shefat e seksioneve të komiteteve ekzekutive të rretheve, nga specialistët me aftësi drejtuese si dhe nga kuadrot e sektorëve të tjerë civilë ose ushtarakë që kanë aftësi për të udhëhequr punën në kooperativat bujqësore. Kuadrove që do

të dërgohen për këtë qëllim, përveç shpërblimit që do të marrin nga kooperativat bujqësore në bazë të vendimit të posaçëm të qeverisë mbi shpërblimin e punës, t'u paguhet në mënyrë suplementare nga ana e shtetit për vitin e parë 100 për qind, për vitin e dytë 80 për qind dhe për vitin e tretë 60 për qind e rrogës që merrnin muajin e fundit në qendrën e punës ku kanë punuar. Pas kësaj periudhe pagesa e tyre të bëhet vetëm nga kooperativa bujqësore, sipas rregullave në fuqi.

Komiteti Qendror u bën thirrje të gjithë kuadrove të aftë për drejtimin e kooperativave që ta kuptojnë drejt detyrën që shtrohet para tyre dhe ta vlerësojnë mirë çështjen e forcimit ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore të mëdha e të bashkuara, si një detyrë me rëndësi të madhe që ka të bëjë me zhvillimin me ritme më të shpejta të bujqësisë në vendin tonë për ndërtimin me sukses të socializmit në fshat.

b) *Të merret seriozisht në duar çështja e hapjes së tokave të reja.* Vendi ynë ka nevojë për të hapur shumë toka të reja, me qëllim që të rriten në mënyrë të dukshme prodhimet bujqësore e blegtorale. Shfrytëzimi i plotë i sipërfaqes së tokës dhe i të gjitha mundësive për hapjen e tokave të reja të bëhet problem i të gjitha kooperativave dhe ndërmarrjeve bujqësore. Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve të marrin të gjitha masat e nevojshme për hapjen e tokave të reja sipas planit të vitit 1959, si dhe për të plotësuar deficitet e viteve të kaluara, që janë krijuar nga mosndjekja me kujdes e këtij problemi kaq të rëndësishëm. Të luftohet kundër pikëpamjeve të gabuara për hapjen e tokave të reja vetëm me traktor. Për hapjen e tokave të reja duhet të mobilizohen sa më shumë forcat e krahut gjatë dimrit, kur punët bujqësore janë të kufizuara dhe sidomos atje ku nuk ka mundësi të përdoret forca motorike, dhe të mos pritet që e gjithë puna të kryhet me mjete të mekanizuara. Tokat e reja të porsahapura të vihen menjëherë nën kulturë. Gjatë punës për hapjen e tokave të reja të tregohet kujdes i posaçëm për masat që duhen marrë për mbrojtjen e tyre nga erozioni.

Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive të rretheve, komitetet dhe organizatat bazë të Partisë porositen që të tregojnë një kujdes të veçantë që fondi i tokës të përdoret sa më drejt, duke mos lejuar që toka e përshtatshme për drithëra, duhan etj. të përdoret për vreshta, ullishte e pemëtore. Gjithashtu të luftohet që me rastin e ndërtimeve dhe të bonifikimeve të zihet sa më pak tokë e përshtatshme për qëllime bujqësore.

c) *Mos të harrojmë për asnjë minutë se detyra kryesore që na ka shtruar Kongresi III i Partisë ka qenë dhe është sigurimi i bukës në vend.* Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë porosin

në mënyrë të veçantë Ministrinë e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve që të përqëndrojnë vëmendjen e tyre në plotësimin e detyrës kryesore të kongresit për shtimin e prodhimit të drithërave pa e pakësuar në asnjë mënyrë kujdesin për kulturat e tjera. Për këtë të sigurohet mbjellja e të gjithë sipërfaqes së planifikuar në bazë të planit pesëvjeçar me shtesat për grurë, misër dhe drithëra të tjera, duke i dënuar rëndë prirjet për uljen e tyre.

Prodhimi i drithërave të bukës në masën e kërkuar varet nga përgatitja e shpejtë e tokave dhe nga mbjellja e hershme sipas kushteve agroteknike. Duke marrë parasysh vonesën e mbjelljes së grurit të shkaktuar nga shirat e shumta të vjeshtës, plenumi porosin të gjithë punonjësit e bujqësisë që të luftojnë jo vetëm për mbjelljen e misrit sipas planit, por edhe për tejkalimin e tij sa më të madh.

Të zgjerohet sa më shumë mbjellja e kulturave të dyta e sidomos mbjellja e misrit hamullor, atje ku ka mundësi për kokërr ose edhe për silazh.

Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj, komitetet ekzekutive të këshillave popullore dhe ato të Partisë, kooperativat bujqësore dhe fshatarësia punonjëse duhet të marrin të gjitha masat për shfrytëzimin e mirë të ujit për vaditje, duke luftuar për shtimin e sipërfaqeve të vaditshme jo vetëm nga përdorimi i mirë i kanaleve vaditëse ekzistuese, por edhe nga përhapja në shkallë të gjerë e metodës së përparuar të vaditjes me brazda si dhe duke ndërtuar puse të vogla për mbledhjen e ujit për vaditje, duke përhapur sa më shumë çikrikët për vaditje.

Të marrim me kohë të gjitha masat përgatitore për fushatat e ndryshme bujqësore dhe t'i organizojmë mirë këto.

Që të shpëtojmë të lashtat nga lagështira, të krijojmë mundësitë për përgatitjen e shpejtë të tokave dhe të kryejmë mbjelljet pranverore në afatet e caktuara, është e domosdoshme të largojmë ujërat nga arat. Me kujdesin më të madh duhet të hapen vijat kulluese në arat e mbjella me të lashta, të mbahen pastër dhe të lidhen me kanale gjatë gjithë periudhës së dimrit dhe të pranverës.

ç) *Të shfrytëzohet çdo orë me kohë të mirë për plugimin e tokave.* Rendimenti i kulturave të pranverës varet shumë nga plugimet dhe mbjelljet e hershme, por për këtë është e nevojshme që qysh gjatë dimrit të plugohet një sipërfaqe sa më e madhe toke. Për t'ja arritur kësaj të shfrytëzohet çdo ditë dhe çdo orë me kohë të mirë dhe të përdoren të gjitha mjetet e mekanizuara si dhe pendët. Të kihet shumë kujdes në pranverë që të mos na iki vllaga nëpër duar, siç ndodh zakonisht, dhe mbjelljet të vonohen nga thatësira që na kap menjëherë. Për këtë drejtuesit dhe

specialistët e rrethit, kryetarët dhe brigadierët e kooperativave duhet të bëjnë një punë shumë të kujdesshme, t'i kontrollojnë tokat vazhdimisht dhe të mos presin sa të vijë e gjithë toka me-njëherë. Kudo bashkë me punimet përgatitore të tokës të bëhet edhe lesimi që është mjeti më i mirë për ruajtjen e vlagës.

Rëndësi të madhe ka përfundimi i mbjelljeve pranverore sa më herët. Mbjellja e panxhar sheqerit të përfundojë brenda muajit mars dhe jo më vonë se më 6 prill; mbjellja e duhanit në zonat bregdetare të bëhet nga 10-30 prill dhe në zonat fushore 29 prill-15 maj; mbjellja e pambukut të përfundojë brenda 1 majit. Një kujdes i veçantë të tregohet për sigurimin e numrit të bimëve për hektar në përputhje me agrorregulloren.

d) *Zgjedhja dhe përgatitja e farërave si dhe luftimi i dëm-tuesve me kohë duhet të bëhet një mjet i rëndësishëm për shti-min e prodhimit.* Një punë e kujdesshme të bëhet për të siguruar farë me cilësi të lartë dhe në sasi të mjaftueshme për të gjitha kulturat e pranverës. Të gjitha kooperativat bujqësore të sigurojnë dhe të përgatisin me kohë të gjithë farën e misrit të nevojshëm për mbjelljet e kulturës kryesore dhe për kulturë të dytë në hamullore, duke zgjedhur ato lloje që u përshtaten më mirë kushteve të vendit dhe japin rendiment më të lartë. Duhet organizuar tërheqja me kohë e farërave të bimëve industriale. Të organizohet mirë lufta kundër krimbit të misrit, duke mbledhur dhe duke djegur kallamishtet e misrit, si dhe të shkulen dhe të digjen kallamishtet e pambukut e të duhanit.

Të organizohet në stil të gjerë në kooperativat bujqësore dhe në NBSH-të tëharrja e të lashtave dhe pastrimi i tyre nga barërat e këqia.

Një kujdes i veçantë të tregohet për përgatitjen me kohë dhe me cilësi të mirë të farishteve të duhanit. Të sigurohet me kohë përgatitja e shtretërve të nxehtë, gjysmë të nxehtë dhe të ftohtë. Kujdes të tregohet për sigurimin e sasisë së nevojshme të fidaneve, duke mbjellë për këtë qëllim jo më pak se 80 m² farishte për çdo hektar duhan vendi, 130 m² farishte për çdo hektar duhan të llojit «samsun» dhe 160 m² farishte për çdo hektar duhan të llojeve orientale. Të luftohet për të siguruar xhamat e nevojshëm për farishtet; gjithë farishtet e duhanit të mbillen në sera të mbuluara me xhama ose me transhe dhe të mos lejohet mbjellja e tyre në vatra të hapëta, siç është bërë deri më sot, ku kemi pasur mjaft dëme dhe fidanat e duhanit janë përgatitur me vonesë. Çdo kooperativë që mbjell duhan të sigurojë një rezervë farishtesh duhani prej jo më pak se 30 për qind të nevojave që ka. Gjithashtu kujdes të tregohet për luftimin e sëmundjeve dhe të dëmtuesve në farishte, duke kryer shërbimet e duhura kultu-rale dhe duke siguruar me kohë mjetet e luftimit.

Të përdoren racionalisht të gjitha llojet e plehërave. Një punë e madhe dhe e organizuar mirë të bëhet për grumbullimin dhe shpërndarjen e plehut të stallave nëpër ara, si dhe për grumbullimin e të gjitha llojeve të plehërave sidomos plehërat e qyteteve dhe fekalet. Plehërimin të tokave t'i kushtohet më shumë kujdes, dhe ky të bëhet në përputhje me agroteknikën. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të punojnë më mirë për të mësuar kooperativat bujqësore që t'i përdorin drejt plehërat kimike.

dh) *Mekanika bujqësore të jetë në gatishmëri të plotë për mbjelljet e pranverës.* Punonjësit e SMT-ve të mobilizojnë të gjitha forcat e tyre që gjatë dimrit të riparohen mirë të gjithë traktorët dhe maqinat bujqësore që nevojiten për fushatën e mbjelljeve të pranverës. Kudo që janë mundësitë të vazhdojë pa ndërprerje gjatë dimrit plugimi i tokave. Njëkohësisht punonjësit e SMT-ve të marrin masat e nevojshme përgatitore edhe për fushatën e korrje-shirjeve, në mënyrë që këto të përfundojnë në një kohë sa më të shkurtër. Kryesitë e kooperativave bujqësore duhet të ndihmojnë punonjësit e SMT-ve për të gjetur vazhdimisht fronte pune për maqinerinë për të shfrytëzuar plotësisht fuqinë motorike. Ministria e bujqësisë, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë të marrin masa që të shfrytëzohen plotësisht të gjitha tipet e traktorëve dhe të maqinave bujqësore si në SMT-të dhe në fermat shtetërore sipas normave të planifikuara. Të ndiqet në mënyrë sistematike puna e mekanikës bujqësore, me qëllim që plani i saj të realizohet jo vetëm si unitet hamullor, por për të gjitha zërat e parashikuar.

Të drejtojmë më tepër vëmendjen në shërbimet dimërore të pemëve frutore dhe të vreshtave, të merren masa për realizimin e planit të mbjelljes së pemëve frutore dhe për zëvendësimin e atyre pemëve që nuk kanë zënë. Të bëhet një luftë e organizuar kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve në agrumet, pemët frutore etj. që të mbrohet prodhimi i tyre. Për këtë qëllim t'u bëhen në kohën dhe në sasi të duhura spërkatjet. Kujdes i veçantë t'i kushtohet realizimit të planit të mbjelljeve të pemëve frutore, të ullinjve dhe të agrumeve si dhe zëvendësimit të atyre pemëve që nuk kanë zënë. Plani i mbjelljes së pemëve frutore të konsiderohet i realizuar vetëm mbasi të jetë vërtetuar zënja e tyre. Me qëllim që të hidhen bazat e zgjerimit të frutikuturës dhe të vitikuturës, për vitet e ardhshme, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë, si dhe Ministria e Bujqësisë të marrin masa për të zgjeruar fidanishtet ekzistuese nacionale dhe lokale si dhe të krijohen fidanishte frutore nga vetë kooperativat bujqësore në çdo rreth për të plotësuar nevojat e rrethit me fidane frutore të llojeve të zgjedhura të frutave dhe të rrushit.

7. — Mirëmbajtja e mjeteve dhe shfrytëzimi racional i tyre duhet të jenë pikësynimet kryesore në transport.

Ministria e Komunikacionit, ndërmarrjet e saj dhe organizatat e Partisë në transport të përqëndrojnë vëmendjen e tyre për të përmirësuar punën në drejtim të mirëmbajtjes së mjeteve të transportit dhe për shfrytëzimin racional të tyre, në mënyrë që të sigurojnë plotësimin e planit në transport, që është një hallkë kryesore për sigurimin e realizimit me sukses të planit ekonomik të vitit 1959. Të forcohet kontrolli në mirëmbajtjen e mjeteve dhe të merren masa që të mënjanohen pakujdesitë në përdorimin e tyre. Të vendoset një disiplinë e rreptë në respektimin e rregullave teknike të mirëmbajtjes së mjeteve. Të forcohet puna e autoinspektoriatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për zbatimin jo vetëm të rregullave të qarkullimit, por edhe për gatishmërinë teknike të mjeteve.

Të merren masa serioze dhe të vendoset një disiplinë e fortë në riparimin me cilësi të mirë të mjeteve në ofiçinat e transportit dhe në kantierin detar dhe të mos lejohet të shkelen afatet e riparimeve mbi normativat e caktuara. Një kujdes i posaçëm të tregohet në ofiçinën qendrore për përmirësimin rrënjësor të punës, në mënyrë që gjatë vitit 1959 kjo ofiçinë të plotësojë me sukses planin e riparimeve të caktuara dhe me një cilësi të mirë.

Për arritjen e rendimentit të planifikuar Ministria e Komunikacionit duhet të marrë masa për një shfrytëzim më të mirë dhe më racional të mjeteve. Të luftohet për të mënjanoher humbjet e kohës për qëndrim pa punë të mjeteve dhe të vihet rregull në lëvizjen e mjeteve detare dhe hekurudhore me grafik të caktuar për të mos u përsëritur rastet që kanë ndodhur gjatë vitit 1958.

Të gjitha ministritë dhe ndërmarrjet ekonomike të marrin masa për të siguruar me kohë mallrat, t'i pregatisin ato për transport, të përmirësojnë kushtet e ngarkim-shkarkimit dhe të mos u shkaktojnë vonesë mjeteve të transportit si dhe të shfrytëzojnë më mirë mjetet që kanë. Duhet të kuptohet drejt se pa një shfrytëzim racional të mjeteve të transportit do të hasen vështirësi në qarkullimin e mallrave dhe do të pengohet realizimi ritmik i planit të shtetit. Ministria e Komunikacionit të marrë masa për shfrytëzimin më racional të rimorkiove dhe të automjeteve me dy ndërresa.

8. — Të ngrihet në një nivel më të lartë organizimi i punës në ndërtim për t'ju përgjigjur shpejtimit të ritmeve të ndërtimeve, për dorëzimin me kohë dhe me cilësi më të mirë të objekteve.

Për të përmirësuar punën në sektorin e ndërtimit është e nevojshme të mos fillojë asnjë punim pa plan organizimi të punimeve të ndërtimit. Brenda vitit 1959 këto plane të marrin formën e projektit të organizimit.

Brenda muajit shkurt të vitit 1959 t'i dorëzohen Ministrisë së Ndërtimit nga të gjithë investitorët karakteristikat e projekteve të vitit 1959 që kanë mbetur pa u dorëzuar, si dhe vendet e ndërtimit, ndërsa brenda muajit mars 1959 të gjitha karakteristikat për objektet e vitit 1960, sipas planit pesëvjeçar të aprovuar.

Kujdes i veçantë t'i kushtohet dorëzimit me kohë të objekteve me karakter prodhimi dhe për banesat e punonjësve. Për këtë qëllim të synohet që të mënjanoher shtrirja në shumë objekte përnjëherësh, por të përqëndrohet puna në disa objekte, sipas afateve dhe rëndësisë së tyre dhe në përputhje me këto të kryhen punimet e ndërtimit.

Detyra më e rëndësishme e punonjësve të ndërtimit për vitin 1959 është kthesa rrënjësore që duhet të bëjnë ata në përmirësimin e cilësisë së punimeve të ndërtimit, dhe kjo duhet të arrihet në radhë të parë duke vendosur disiplinën e domosdoshme në respektimin e plotë të kushteve teknike në zbatimin e punimeve, në organizimin e kontrollit të gjithanshëm teknik, si gjatë zbatimit të punimeve, ashtu edhe në fazën e kolaudimit e të dorëzimit të pjesshëm ose të plotë të veprave, si dhe në përgatitjen në perspektivë të kuadrit të ndërtimit.

9. — Të merren masa për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit.

Për të rrënjësuar një regjim sa më të rreptë kursimi, për ta bërë këtë edukatë dhe metodë të drejtimit të ekonomisë, është e nevojshme që të vlerësohet më shumë kjo çështje, të përmirësohet puna e planifikimit financiar në ndërmarrjet, në organizatat dhe në institucionet e ndryshme social-kulturale. Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Financave dhe organet e tyre varëse të përmirësojnë punën në drejtim të planifikimit sa më të drejtë të shpenzimeve të prodhimit dhe të shërbimit dhe të mënjanoher shpenzimet e kota, t'u bëhet një luftë më e fortë dëmtimeve, abuzimeve, prishjeve të mallrave etj. Problemi i uljes së kostos dhe studimi i rrugëve për kursimin e lëndëve të para dhe të materialeve ndihmëse, për rritjen e rendimentit në punë, të jenë në qendër të vëmendjes, jo vetëm në procesin e planifikimit, por edhe gjatë zbatimit të planit ekonomik dhe të buxhetit të shtetit. Të gjallërohet më tepër puna e aparateve të këtyre organeve, të forcohet ndihma e tyre ndaj bazës dhe kjo të shërbejë për të nxjerrë konkluzionet e nevojshme edhe për punën e planifikimit.

Komitetet dhe organizatat bazë të Partisë të merren më tepër me problemin e regjimit të kursimit dhe me uljen e kostos, të

punohet për përhapjen e eksperiencës së përparuar, për zgjerimin e emulacionit socialist, të forcohet puna politike me punonjësit për të prodhuar mallra me cilësi të mirë, me sa më pak shpenzime, të forcohet kontrolli në punën e ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike, mbasi në këtë mënyrë do të ndihmojnë aktivisht për vendosjen e regjimit të kursimit.

Dikasteret qendrore, komitetet dhe organizatat bazë të Partisë, organet e pushtetit dhe të ekonomisë duhet të forcojnë kontrollin e tyre në shpenzimin e lekut, të zduken çrregullimet në administrimin e fondeve materiale dhe financiare, të respektohet disiplina financiare. Ministria e Financave, dhe në përgjithësi organet financiare dhe Komisioni i Kontrollit të Shtetit duhet ta shtojnë punën e tyre për forcimin e regjimit të kursimit në çdo drejtim të ekonomisë dhe të kulturës.

Një kujdes shumë më i madh të tregohet për përdorimin me vend dhe me kursim të valutës si dhe për rritjen e të ardhurave në këtë drejtim.

10. — Ministrinë dhe institucionet e ndryshme, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike të sigurojnë plotësimin me kohë dhe në mënyrë ritmike të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore.

Për këtë qëllim ministrinë dhe komitetet ekzekutive të marrin në shqyrtim herë pas here plotësimin e detyrave ndaj buxhetit, duke përmirësuar punën në drejtim të problemeve ekonomike financiare të ndërmarrjeve në vartësi. Ministria e Financave dhe organet e saj vartëse të përmirësojnë punën për zbatimin e buxhetit për vitin 1959, duke shtuar kontrollin dhe analizat ekonomiko-financiare.

Ministria e Financave dhe dikasteret ekonomike ta konsiderojnë shpejtimin e qarkullimit të mjeteve të xhiros si një nga detyrat më të rëndësishme të tyre, të luftojnë për uljen e normativave të mjeteve të xhiros, nëpërmjet shpejtimin të qarkullimit të mallrave, organizimit më të mirë të furnizimit dhe të shpërndarjes, perfeksionimit të procesit teknologjik dhe mënjanimit të debikredive. Për këtë qëllim brenda tremujorit të parë të vitit 1959 të organizohet fushata e shpejtimin të qarkullimit të mjeteve të xhiros me pjesëmarrjen e ekonomistëve, inxhinierëve, teknikëve, llogaritarëve etj. Një ndihmë të madhe në organizimin e kësaj fushate të rëndësishme ekonomike të japin komitetet dhe organizatat bazë të Partisë.

11. — Të forcohet ndihma dhe kontrolli i zbatimit të planit nga ana e organeve drejtuese të Partisë dhe të shtetit në qendër dhe në bazë.

Për të përmirësuar më tej metodën e drejtimit është e nevojshme që të forcohet kontrolli i zbatimit të vendimeve të Partisë dhe të qeverisë. Të bëhet e detyrueshme në të ardhmen që për çdo projektvendim, për të cilin parashikohet dalja e një udhëzimi për zbatimin e tij me rastin e paraqitjes së projektvendimit, të paraqitet edhe udhëzimi përkatës. Komisioni i Kontrollit të Shtetit duhet t'i forcojë kontrollet për zbatimin e vendimeve dhe të marrë masa të rënda ndaj të gjithë shkelësve dhe atyre që nuk luftojnë për zbatimin e vendimeve të qeverisë dhe të Partisë.

Të ushtrohen më shumë kontrolle në drejtim të veprimtarisë ekonomike për treguesit kryesorë të planit të ndërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme. Konkluzionet e këtyre analizave të përgjithësohen në mënyrë të organizuar.

Një ndihmë në përgjithësimin e eksperiencës së përparuar ka filluar shumë mirë të jepet nëpërmjet të konferencave kombëtare, të cilat kanë qenë plot rezultate dhe kanë dhënë eksperiencë të mirë në njohjen e të metave dhe në përcaktimin e masave për të ardhshmen, prandaj të ngremë në një nivel edhe më të lartë përgatitjen e këtyre konferencave.

Të merren masa për një shfrytëzim sa më të mirë të materialeve të bashkëpunimit tekniko-shkencor, të ndihmës që japin specialistët e vendeve mike si dhe të eksperiencës që sjellin delegacionet nga jashtë shtetit.

Të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë të forcojnë edhe më tepër punën për mbrojtjen e pasurisë socialiste. Të merren masa për sigurimin e zbatimit me përpikmëri të udhëzimeve dhe të rregulloreve lidhur me dokumentin dhe lëvizjen e mallrave dhe të vlerave materiale.

Dikasteret, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë të mbështeten dhe të aktivizojnë sa më shumë punonjësit, sidomos personelin inxhiniero-teknik, me qëllim që ata të ndihmojnë në përgatitjen dhe kualifikimin e mëtejshëm të kuadrit, si dhe në përmirësimin e organizimit të punës së prodhimit.

Bashkimet Profesionale, Bashkimi i Rinisë së Punës, Organizata e Gruas dhe Fronti Demokratik i Shqipërisë të ndihmojnë më shumë organet ekonomike për plotësimin e detyrave të mëdha që shtrun ky plenum, duke organizuar më mirë emulacionin socialist, edukimin e punonjësve dhe ngritjen e tyre ideologjike dhe tekniko-profesionale.

Në kuadrin e detyrave që shtrun plenumi, dikasteret ekonomike, komitetet dhe organizatat bazë të Partisë, organizatat e

masave duhet të mobilizohen për të realizuar me sukses detyrat e mëdha ekonomike të planit të vitit 1959 dhe për të përmirësuar shërbimin në tregëti, në artizanat dhe në sektorin komunal.

Plenumi i Komitetit Qendror i bën thirrje Partisë, klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse dhe të gjitha masave punonjëse të vendit tonë që për nder të 15-vjetorit të çlirimit të vendit tonë të mobilizohen për realizimin me sukses të detyrave të planit të vitit 1959.

* * *

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë ka besim të plotë se klasa punëtore, fshatarësia punonjëse, inteligjencia popullore, të gjitha organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë do të mobilizohen plotësisht dhe do të vënë të gjitha forcat e tyre për realizimin dhe tejkalimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1959.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
313, datë 30 dhjetor 1958

Nr. 114

VENDIM

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI TRADITAT PATRIOTIKE - REVOLUCIONARE TË POPULLIT TONË DHE MASAT PËR NJOHJEN E ZHVILLIMIN E TYRE TË MËTEJSHËM»

7 korrik 1959

Historia e popullit tonë është plot ngjarje të lavdishme dhe shembuj të shkëlqyer vetëmohimi e heroizmi në luftën për lirinë kombëtare e shoqërore.

Traditat e kësaj së kaluarë të ndritur populli ynë i ka ruajtur dhe përforcuar brez pas brezi. Në të katër anët e vendit tonë ruhen dëshmi të gjalla, që tregojnë se populli ynë e ka çarë me shpatë në dorë rrugën e historisë së tij. Në veprat monumentale të arkitekturës, të arteve dhe të kulturës të shumë brezave, që nga kohërat më të lashta, duket gjenia krijuese e masave punonjëse të vendit tonë, forca shpirtërore dhe gjallëria e tyre e pamposhtur: në to mishërohen tiparet e veçanta kombëtare të popullit tonë, rruga e tij drejt zhvillimit e përparimit, kontributi i popullit tonë për pasurimin e thesarit të kulturës botërore.

Regjimet e kaluara antipopullore jo vetëm që nuk kanë punuar për t'i nxjerrë në dritë dhe për t'i zhvilluar këto tradita të shkëlqyera, jo vetëm që nuk kanë mbrojtur dhe vlerësuar këtë trashëgim të shtrenjtë që përbën krenarinë e popullit tonë, por kanë bërë ç'është e mundur për të errësuar çdo gjë përparimtare të së kaluarës, i kanë lënë në harresë ose janë përpjekur t'i paraqesin shtrembër ngjarjet e rëndësishme historike të luftës së popullit tonë për lirinë kombëtare dhe shoqërore, si edhe patriotët e revolucionarët e shquar të vendit tonë. Klikat sunduese e kanë nënvleftësuar dhe përbuzur veprën krijuese të popullit tonë punonjës, duke u gjunjëzuar përpara kulturës së huaj. Vlerave materiale dhe shpirtërore të popullit tonë u janë shkaktuar dëme të mëdha dhe humbje të pazëvendësueshme nga pushtimi i vendit tonë nga të huajt, nga luftërat e përgjakshme dhe shkatërrimtare

gjatë shekujve, nga moskokëçarja dhe tradhëtia e klikave sunduese feudo-borgjeze, të cilat i kishin braktisur monumentet e arkitekturës, të arteve e të kulturës në mëshirën e fatit dhe u kishin lënë dorë të lirë të huajve për të grabitur pasuri shumë të çmueshme kulturalo-artistike. Historianë të huaj reaksionarë shovinistë janë përpjekur dhe përpiqen që të diskriminojnë, të errësojnë dhe të shtrembërojnë historinë e lavdishme të popullit tonë dhe traditat e tij në fushën e kulturës materiale e shpirtërore.

Partia e Punës e Shqipërisë, e udhëhequr nga parimet marksiste-leniniste, që nga themelimi i saj i vlerësoi, i ruajti dhe i ngriti lart traditat luftarake dhe përparimtare që lindën dhe u zhvilluan gjatë shekujve në luftërat dhe përpjekjet e popullit tonë për liri dhe pavarësi, për tokë e bukë, për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës e të kulturës së tij kombëtare kundër pushtuesve të huaj dhe shërbëtorëve të tyre të brendshëm. Gjatë Luftës nacional-çlirimtare, me këto tradita, Partia edukoi dhe mobilizoi masat e gjera të qytetit dhe të fshatit në luftën për çlirimin e vendit dhe vendosjen e pushtetit popullor.

Pas çlirimit Partia i kushtoi një kujdes të veçantë njohjes, përjetësimit dhe zhvillimit të traditave patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe të veprës së tij krijuese shekullore kulturalo-artistike. Për të parën herë në historinë e vendit tonë vlerësimi i traditave, zbulimi dhe mbrojtja e vlerave materiale e shpirtërore të së kaluarës u bënë çështje shtetërore dhe për këtë u shpallën ligje dhe vendime zyrtare, u krijuan institucione të posaçme dhe u caktuan fonde të rëndësishme. Gjatë këtyre 15 vjetëve të pushtetit popullor janë marrë një varg masash të rëndësishme që përjetësojnë ngjarjet e shënuara historike, pasqyrojnë dashurinë, nderimin dhe mirënjohjen e thellë ndaj atyre që kanë punuar e luftuar, duke mos kursyer as jetën për lirinë e lumturinë e atdheut e të popullit. Janë ngritur me dhjetëra përmendore e buste dhe qindra lapidarë përkujtimorë për njerëzit e shquar të popullit tonë dhe për ngjarjet e rëndësishme të së kaluarës dhe të Luftës nacional-çlirimtare, që kurorëzoi me fitore përpjekjet shekullore të popullit tonë. Në vendin tonë është bërë kudo traditë përkujtimi i datave të shënuara dhe i njerëzve të shquar në luftën për liri dhe në punën krijuese. Me interesimin e pushtetit popullor janë sjellë eshtërat e patriotëve dhe të revolucionarëve që kanë vdekur jashtë atdheut, janë ngritur varret e dëshmorëve, janë botuar me dhjetëra vepra të shkrimtarëve dhe të njerëzve të shquar të së kaluarës si dhe vepra mbi jetën dhe veprimtarinë e tyre dhe mbi ngjarjet e shënuara historike.

Një punë e madhe është bërë për zbulimin e grumbullimin e vlerave të kulturës materiale e shpirtërore, si edhe të dokumentave historike, të cilat janë përqëndruar në muzeume e arkiva të posaçme. Zbulime me vlerë të veçantë për historinë e

kulturës sonë të lashtë janë bërë në gërmimet arkeologjike. Janë grumbulluar mbi 9.000 objekte etnografike dhe dhjetëra vëllime materiale të folklorit gojor, që tregojnë jetën materiale e shpirtërore të popullit tonë në zhvillimin e saj historik.

Nën udhëheqjen e Partisë trashëgimi i shkëlqyer i së kaluarës, çdo gjë pozitive dhe përparimtare, që kanë krijuar brezat e mëparshëm gjatë shekujve, është bërë një forcë e madhe mobilizuese në luftën për ndërtimin e jetës dhe të kulturës së re socialiste në vendin tonë.

Me qëllim që puna për zbulimin e traditave patriotike-revolucionare dhe të trashëgimit në lëmin e kulturës materiale e shpirtërore të marrë një zhvillim edhe më të madh, që e kaluara e shkëlqyer historike e popullit tonë të shfrytëzohet edhe më mirë e në shkallë më të gjerë për edukimin komunist të masave punonjëse e sidomos të brezit të ri, që të arrihen suksese të mëtejshme në zbulimin dhe grumbullimin e materialeve që ndihmojnë për studime më të thella në lëmin e historisë dhe të kulturës së popullit tonë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë

V E N D O S I :

— I —

Për ngjarjet e shënuara historike dhe njerëzit e shquar të vendit tonë

1. — Të përkujtohen në mënyrë më të organizuar ngjarjet e rëndësishme historike dhe njerëzit e shquar për veprimtari në shërbim të popullit. Të merren masa për të përkujtuar si duhet dy datat më të afërta të shënuara: 20-vjetorin e themelimit të PPSH (1961) dhe 50-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë (1962).

2. — Në bazë të një plani perspektiv të ngrihen monumente për Skënderbeun, Naim Frashërin, Sami Frashërin, Ismail Qemalin, Bajram Currin, A. Z. Çajupin, Avni Rustemin, Ali Kelmendin, Migjenin, Qemal Stafën etj.

Komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të kenë një plan konkret për ngritjen e monumenteve, busteve, lapidarëve e pllakave përkujtimore dhe të marrin masat për ruajtjen, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Shkollat dhe organizatat e masave të marrin nën patronazh monumente e lapidare dhe të kujdesen për mirëmbajtjen e tyre.

3. — Të vazhdohet në mënyrë më të organizuar vënja e emrave të patriotëve e revolucionarëve të shquar dhe e ngjarjeve

të shënuara historike, ndërmarrjeve ekonomike, kooperativave bujqësore, fshatrave, shkollave e institucioneve kulturele, rrugeve etj.

4. — Të botohen më shumë broshura shkencore-popullore mbi ngjarjet e shënuara historike dhe jetën e patriotëve dhe të revolucionarëve, të heronjve të Luftës nacional-çlirimtare si edhe të heronjve të punës socialiste. Të botohen ose të ribotohen veprat e plota e të zgjedhura të shkrimtarëve dhe të mendimtarëve të njohur shqiptarë. Botimi i këtyre veprave të bëhet nën drejtimin shkencor të Institutit të historisë e të gjuhësisë pranë Universitetit shtetëror të Tiranës.

5. — Partia u bën thirrje shkrimtarëve dhe artistëve që në krijimtarinë e tyre letrare artistike, në artet figurative dhe në kinematografi, pa lënë menjanë temën aktuale, të trajtojnë subjekte që të përjetësojnë ngjarjet dhe figurat historike të së kaluarës heroike të popullit tonë.

6. — Për popullarizimin e ngjarjeve historike dhe të njerëzve të shquar të botohen dhe të prodhohen në sasi të mëdha portrete, kartolina, albume, buste të vogla, pulla poste etj.

7. — Me qëllim që dëshmorët e luftës të përkujtohen nga gjithë populli, të caktohet si ditë pelegrinazhi në varrezat e tyre — 5 maji — dita e vrasjes së Qemal Stafës. Përveç kësaj, për të mbajtur gjallë kujtimin e të rënëve në luftë, në përvjetorët e vrasjes së dëshmorëve të organizohen roje nderi pranë busteve, lapidareve, pllakave përkujtimore ose varrezave të tyre.

Të tregohet kujdes i veçantë për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe të ngrihen në këto monumente përkujtimore.

Të sillen sa më shpejt eshtërat e patriotëve dhe të revolucionarëve që ndodhen ende jashtë atdheut dhe të vendosen ata në varrezat e dëshmorëve.

8. — Për të përjetësuar kujtimin e patriotëve dhe të revolucionarëve më të shquar të së kaluarës, të Luftës nacional-çlirimtare dhe të kohës së sotme, të ngrihet në Tiranë Panteoni dhe Monumenti i Lirisë.

— II —

Për monumentet historike dhe kulturalo-artistike

Duke marrë parasysh se zbulimi, studimi, mbrojtja, restaurimi e popullarizimi i monumenteve historike dhe kulturalo-artistike ka një rëndësi të madhe për edukimin e masave dhe për ndriçimin më të thellë të historisë së vendit tonë, të merren këto masa:

1. — Detyra e rëndësishme e zbulimit, e studimit, e restaurimit dhe e mbrojtjes së monumenteve historike i ngarkohet Insti-

tutit të historisë e gjuhësisë pranë Universitetit të Tiranës, të cilit duhet t'i sigurohen kuadrot dhe mjetet e nevojshme. Pranë këtij instituti të krijohet Këshilli metodiko-shkencor i monumenteve historike. Për mbrojtjen e monumenteve në rrethe ngarkohen komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, të cilat duhet të mbështeten në këshillat e muzeumeve dhe atje ku nuk ka muzeume të krijohen komisionet e monumenteve.

2. — Kujdes i madh i duhet kushtuar zbulimit dhe evidentimit të monumenteve historike. Brenda vitit 1960 nga Universiteti shtetëror i Tiranës të bëhet regjistrimi i ri i monumenteve historike e të kulturës, dhe Këshilli i monumenteve historike pranë Universitetit shtetëror të Tiranës të shpallë listën e monumenteve me rëndësi kombëtare e lokale. Të shpallen qytete muze qyteti i Beratit, i Gjirokastrës, pjesa e vjetër dhe nëntoka e qytetit të Durrësit si dhe pazari i Krujës.

3. — T'i kushtohet kujdes i madh ruajtjes, mirëmbajtjes, restaurimit dhe studimit të monumenteve historike. Ruajtja e monumenteve historike të ngrihet si një detyrë e lartë patriotike dhe të caktohen dispozita të rrepta kundër dëmtuesve të tyre.

Objektet me vlerë të madhe historike e artistike, me qëllim që të ruhen e të shfrytëzohen më mirë, të grumbullohen në muzeumet qendrore, duke u zëvendësuar në ato vende ku janë sot me kopjet e tyre.

Të merren masa urgjente për ruajtjen e mirëmbajtjen e monumenteve historike, për restaurimin e tyre në baza shkencore dhe për studimin e tyre.

4. — Në fushën e arkeologjisë, përveç zgjerimit të kërkimeve në qendrat e derisotme të kulturës antike dhe ilire, të zhvillohen në shkallë të gjerë kërkimet në fushën e kulturës ilire, si dhe në fushën e kulturës mesjetare, duke organizuar ekspedita të përbashkëta me institucionet përkatëse shkencore të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore.

5. — Për shfrytëzimin dhe popullarizimin më të mirë të monumenteve të botohen sa më shumë broshura, albume, harta, kartolina, të xhirohen filma, të organizohen ekspozita, leksione etj. Këshillat e muzeumeve ose komisionet e monumenteve të organizojnë më mirë punën edukative me masat e gjera punonjëse.

Organizatata e Partisë dhe të masave të tregojnë kujdes të veçantë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin sa më të mirë të monumenteve historike, si mjete të rëndësishme për edukimin e masave punonjëse, të ngjallin në masat dhe sidomos në të rinjtë dashurinë e respektin për monumentet historike e kulturalo-artistike.

Për muzeumet qendrore dhe ato të rretheve

1. — Për t'u përqëndruar në një qendër të vetme të gjitha objektet historike, kulturele e artistike dhe për t'u pasqyruar në mënyrë sa më të plotë e të gjithanshme historia madhështore e popullit tonë dhe gjenia e tij krijuese, të ngrihet në Tiranë Muzeumi historik, i cili të jetë një qendër e madhe edukimi dhe studimi dhe të përmbledhë arkeologjinë, historinë, etnografinë dhe historinë e letërsisë e të arteve të vendit tonë. Atje ku janë zhvilluar ngjarje të rëndësishme historike ose kanë banuar patriotë e revolucionarë të shquar, të ngrihen sipas mundësive dhe me aprovimin e organeve përkatëse dhoma ose shtëpi muze.

2. — Me qëllim që të pasurohen muzeumet e rretheve të organizohen në to sektorët e etnografisë dhe të periudhës së pushetitit popullor, të forcohet karakteri lokal i muzeumeve, duke shtuar përpjekjet për zbulimin e grumbullimin e materialeve që pasqyrojnë luftën dhe zhvillimin e ekonomisë e të kulturës së atij rrethi, të pasurohen sektorët e Luftës nacional-çlirimtare dhe të paraqiten më gjerë figurat e patriotëve si dhe figurat e shquara të kulturës dhe të arteve.

3. — Shtëpitë dhe vatrat e kulturës, shkollat dhe klubet të hartojnë historikun e qytetit, të fshatit, të ndërmarrjes apo të shkollës dhe të krijojnë dhoma ose kënde muze, ku të grumbullojnë dokumentat e materialet përkatëse.

Për ruajtjen dhe grumbullimin e mëtejshëm të materialeve dokumentare historike

1. — Të merren masa për të forcuar Arkivin qendror të shtetit, si qendër kryesore për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin tekniko-shkencor të materialeve dokumentare të vendit tonë. Gjithashtu institucionet qendrore, Kinostudioja «Shqipëria e Re», Radio Tirana, ATSH, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive në rrethe të sigurojnë grumbullimin e ruajtjen e materialeve të tyre arkiviale-dokumentare.

2. — Ka akoma shumë materiale dokumentare mbi historinë e popullit tonë, mbi luftërat e tij heroike, mbi zhvillimin e ekonomisë e të kulturës së tij, mbi lëvizjen revolucionare e komuniste në vendin tonë. . . mbi bijtë e shquar të popullit tonë, që ende s'janë grumbulluar. Prandaj, për pasurimin e mëtejshëm të fondeve arkiviale, të vazhdojë në mënyrë më të organizuar grumbullimi i tyre.

Komiteti Qendror i PPSH u bën thirrje patriotëve e revolucionarëve, familjeve të tyre, arësimitarëve, njerëzve të kulturës e të artit dhe të gjithë punonjësve të qytetit e të fshatit që të gjejnë e t'u dorëzojnë organeve përkatëse dokumenta, libra e dorëshkrime, si dhe objekte të tjera me vlerë historike. Kjo është një detyrë e lartë patriotike e çdo qytetari të Republikës sonë Popullore, jo vetëm përpara të tanishmes, por edhe të ardhshmes së atdheut tonë.

3. — Arkivi i shtetit, Instituti i historisë së Partisë pranë KQ të PPSH dhe Instituti i historisë dhe i gjuhësisë pranë Universitetit shtetëror të Tiranës të organizojnë në shkallë më të gjerë botimin e materialeve dokumentare arkiviale.

4. — Për të plotësuar të dhënat mbi ngjarjet e jetës sonë politiko-shoqërore dhe veçanërisht mbi periudhën e Luftës nacional-çlirimtare, Komiteti Qendror i Partisë fton të gjithë pjesëmarrësit dhe njohësit e këtyre ngjarjeve të shkruajnë kujtimet e tyre. Shkrimtarët, gazetarët, njerëzit e shkencës, të arësimit e të kulturës ftohen t'u japin atyre ndihmën e nevojshme për hartimin e redaktimin e kujtimeve dhe përgatitjen e tyre për botim.

* * *

Gjithë populli ynë po përgatitet të festojë me madhësi 15-vjetorin e çlirimit të atdheut, duke arritur suksese të reja e më të mëdha në rrugën e ndërtimit të socializmit. Me punën e tij krijuese, nën udhëheqjen e Partisë. . . ai po arrin suksese gjithnjë më të mëdha në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Në këtë rrugë ngadhnjimtare populli ynë frymëzohet edhe nga traditat më të mira të së kaluarës së tij heroike, të cilat ai po i zhvillon më tej, duke qenë zot i fateve të tij.

Komiteti Qendror i PPSH u bën thirrje organizatave të Partisë e të masave, institucioneve arësimore e kulturele dhe organeve të shtypit të zhvillojnë një punë më të madhe e sistematike për vlerësimin, popullarizimin, ruajtjen dhe njohjen e traditave patriotike revolucionare, kulturele dhe artistike të popullit tonë për zhvillimin e tyre të mëtejshëm dhe për edukimin e punonjësve e sidomos të rinisë e të fëmijëve.

Problemi i zhvillimit dhe i përjetësimit të traditave patriotike revolucionare të popullit tonë të bëhet një çështje e rëndësishme e masave punonjëse dhe të aktivizohen në këtë fushë sa më shumë njerëz, sidomos arësimitarët, të cilëve u është besuar edukimi i brezit të ri.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
218, datë 10 shtator 1959

PLENUMI XIV I KQ TË PPSH

Tiranë, 2-3 nëntor 1959

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Me datën 2 dhe 3 nëntor 1959 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH nën kryesinë e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të PPSH. Plenumi i Komitetit Qendror mori në shqyrtim dhe diskutoi raportet e Byrosë Politike: «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për zhvillimin e ekonomisë pyjore, shfrytëzimin racional të pyjeve dhe ekonomizimin e lëndës së drurit», paraqitur nga shoku Hysni Kapo, si dhe «Mbi shtimin e sipërfaqes së tokave të ujtshme dhe mbi teknikën e ujitjes në bujqësinë tonë», paraqitur nga shoku Spiro Koleka.

Në punimet e këtij plenumi merrnin pjesë si të ftuar sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve, kryetarët e komiteteve ekzekutive, specialistë dhe kuadro të dikastereve, të rretheve, të ndërmarrjeve dhe të kooperativave bujqësore.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH për dy çështjet e sipërme aprovoi vendimet përkatëse.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Nr. 115

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

«Mbi masat që duhen marrë për zhvillimin e ekonomisë pyjore, shfrytëzimin racional dhe ekonomizimin e lëndës së drurit»

3 nëntor 1959

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të datës 2 dhe 3 nëntor 1959, shqyrtoi dhe aprovoi raportin e Byrosë

Politike, paraqitur nga anëtarë i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH, shoku Hysni Kapo, «mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për zhvillimin e ekonomisë pyjore, shfrytëzimin racional të pyjeve dhe ekonomizimin e lëndës së drurit».

Pyjet janë një pasuri e madhe, shumë e çmuar e popullit tonë. Duke marrë parasysh nivelin dhe kushtet klimaterike të vendit, ato luajnë një rol të madh në mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe janë të lidhura drejt për së drejti me zhvillimin e bujqësisë socialiste, me vlerësimin dhe rimëkëmbjen për prodhim të tokave të pjerrëta e të gërryera, me shfrytëzimin në mënyrë të vazhdueshme të rezervave të ujit, me përmirësimin e klimës, me rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore, me bonifikimin dhe me elektrifikimin. Ato janë baza për zhvillimin e kafshëve të egra dhe për rritjen e gjuetisë, nga e cila ekonomia popullore mund të sigurojë të ardhura të mëdha.

Nuk ka degë të ekonomisë popullore që të mos jetë e lidhur me zhvillimin e ekonomisë pyjore. Lënda e drurit dhe prodhimet pyjore përdoren çdo vit e më tepër për nevoja të industrisë, të ndërtimit, të minierave, për eksport dhe për plotësimin e nevojave të popullatës me lëndë djegëse.

Vendi ynë ka trashëguar nga e kaluara një ekonomi pyjore të prapambetur e mjaft të shkatërruar. Regjimet antipopullore dhe pushtuesit i kanë shkatërruar pyjet tona, duke i shfrytëzuar pa asnjë kriter dhe rregull, pa treguar as kujdesin më të vogël për mbrojtjen e tyre nga zjarret, kullotja etj. Kështu që sot, megjithëse kemi një sipërfaqe mjaft të madhe pyjore, pyjet janë pak të vlefshme. Pyjet e mira janë të rralla dhe pjesa më e madhe e sipërfaqes pyjore është e mbuluar me pyje të degraduara e shkurre.

Me vendosjen e pushtetit popullor u morën masa për një trajtim më të drejtë të ekonomisë pyjore, pyjet u bënë pronë shtetërore, u krijua shërbimi pyjor për administrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, u përpilua legjislacioni i ri pyjor. Partia dhe qeveria kanë treguar një kujdes të vazhdueshëm për mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të pyjeve. Si rezultat i mobilizimit të masave të gjera fshatare, gjatë 15 vjetëve të pushtetit popullor janë pyllëzuar më tepër se 17.000 ha pyje dhe janë përmirësuar 57.000 ha. Një sukses i madh ka qenë realizimi i planit të parë pesëvjeçar të pyjeve në katër vjet. Në krahasim me të kaluarën, pyjet mbrohen dhe shfrytëzohen më mirë dhe lënda e drurit ka filluar të përdoret në mënyrë më racionale.

Plenumi vëren se me gjithë sukseset e përmendura, sot është bërë shumë serioz fakti që shfrytëzimi i pyjeve për lëndë punimi dhe dru zjarri është më i madh se rritja vjetore e vetë pyjeve, gjë që dëmton shumë ekonominë pyjore dhe shpie drejt pakësimit të saj. Kjo gjendje është vështirësuar edhe më shumë, pasi shfrytëzimi është përqëndruar kryesisht në pyjet ku ka rrugë transporti,

ndërsa shumë masive pyjesh, për mungesë rrugësh, nuk po shfrytëzohen, gjë që i dëmton edhe vetë këto pyje.

Shfrytëzimi i pyjeve dhe i lëndës së drurit nuk bëhet ende në mënyrë racionale. Ka të meta dhe humbje lënde në procesin e shfrytëzimit dhe gjatë transportit. Gjithashtu ka shpërdorime dhe humbje në përdorimin e lëndës. Çështja e kursimit të lëndës së drurit si material deficitar nuk është bërë rregull nga ndërmarrjet ekonomike që e përdorin. Zëvendësimi i saj me materiale më pak të kushtueshme dhe jo deficitare shkon ngadalë. Veçanërisht pak përpjekje bëhen për të kufizuar përdorimin e druve të zjarrit, që për vendin tonë është tepër i madh.

Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve nuk kanë marrë masat e nevojshme për zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve, në bazë të planeve të posaçme të mbarështrimit, në të cilat duheshin të konkretizoheshin të gjitha masat silvikulturale të domosdoshme për një ekonomi pyjore të përparuar. Ka dëmtime të theksuara dhe humbje të pajustificueshme të kësaj pasurie të madhe.

Kullotja e pasistemuar në pyje, krasitja e tyre për gjeth e krاند, që sot bëhet e pakontrolluar, çdo vit e dëmtojnë më shumë ekonominë pyjore, duke e çuar në një degradim të shpejtë. Erozioni ka marrë përpjesëtime të gjera, ndërsa lufta kundër tij ende nuk është marrë në duar si duhet.

Përveç kësaj, administrimi i pyjeve nga organe të ndryshme ka sjellë vështirësi në organizimin e kontrollit mbi mbrojtjen efikase të pyjeve dhe mbi përdorimin racional të lëndës së drurit në pyjet tona.

Organizatet e Partisë dhe gjithë organizatat e masave nuk e kanë bërë problem të tyre dhe të masave punonjëse çështjen e mbrojtjes së pyjeve, të shfrytëzimit racional të tyre, të shtimit dhe të përmirësimit të fondit pyjor. Propaganda për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve ka qenë e dobët. Të gjitha këto kanë bërë që ekonomia pyjore të zhvillohet me ritme të ngadalshme.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, me qëllim që ekonomia pyjore të zhvillohet me ritme më të shpejta, që të mënjanohej të metat në shfrytëzimin e pyjeve dhe në përdorimin e lëndës së drurit,

V e n d o s i :

I. — Për zhvillimin e ekonomisë pyjore.

Në pyjet e degraduara, në shkurret e papërshtatshme për kultura bujqësore, si dhe në pyjet që do të mbroheshin nga kullotjet, të organizohen punime përmirësimi, prerje kulture, pyllëzime,

shndërrim shkurresh e sisteme malore e punime të tjera silvikulture, me qëllim që të rritet rendimenti i tyre.

1. — Gjatë planit të tretë pesëvjeçar të përmirësohen dhe të kryhen prerje kulture në jo më pak se 40.000 ha pyje të degraduara, nga të cilat 15.000 ha të bëhen nga vetë fshatarësia. Ministria e Bujqësisë të marrë masat e duhura që këto punime të bëhen me cilësi të lartë teknike. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, në bashkëpunim me ndërmarrjet shtetërore pyjore, të organizojnë mirë punën e fshatarësisë, duke përpiluar për këto brenda vitit 1960 një plan konkret për çdo fshat e kooperativë bujqësore.

Edhe gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm të vazhdojnë punimet për përmirësimin e pyjeve dhe për prerjet kulture që deri në vitin 1975 të jenë përmirësuar gjithsejt 120.000 ha., nga të cilët 45.000 ha. me punën e vetë fshatarësisë.

2. — Të shtohet ritmi i pyllëzimeve të reja. Gjatë planit të tretë pesëvjeçar të pyllëzohen jo më pak se 20.000 ha., dhe deri më 1975 të jenë pyllëzuar gjithsejt jo më pak se 60.000 ha., nga të cilat rreth 50 për qind me punën e vetë fshatarësisë.

Pyllëzimet nga ndërmarrjet shtetërore pyjore të kryhen me objekte sa më të mëdha, në ranishtet e bregdetit, në shtretërit e lumenjve, në vendet e zhveshura, të gërryera etj. Në asnjë mënyrë të mos zihen me pyje ato vende që mund të mbillen me pemë frutore ose me bimë të arave.

Krahas krijimit të bloqeve të mëdha pyjore të punohet që fshatarësia të krijojë pyje të vogla edhe në kooperativat bujqësore, për plotësimin e nevojave të tyre. Të shfrytëzohen për këtë qëllim tokat e pavlefshme për kultura bujqësore, buzët e lumenjve, të përrënjeve, dhe të kanaleve. Brenda vitit 1960 komitetet ekzekutive, në bashkëpunim me ndërmarrjet shtetërore pyjore, të caktojnë vendet që duhet të pyllëzohen në të ardhshmen kooperativat bujqësore. Për të rritur interesin material të kooperativave bujqësore, pyjet që do të krijohen prej tyre të mos përfshihen në fondin e vetëm shtetëror pyjor, por të mbeten pronë e kooperativave bujqësore. Këshilli i Ministrave të nxjerrë dispozitat me anën e të cilave sipërfaqet që do të zënë pyjet e mbjella dhe të caktuara për nevoja të kooperativave bujqësore të përjashtohen nga detyrimet dhe taksat. Shfrytëzimi i këtyre pyjeve, si dhe i gjithë pyjeve të tjera, të bëhet gjithmonë duke respektuar rregullat e teknikës pyjore.

Me qëllim që të sigurohet lënda e drurit për nevojat e minierave, në afërsitë e minierave të Selenicës dhe të Memaliajt më 1960 të fillohet mbjellja në bloqe pyjore në jo më pak se 80-100 ha. e llojeve të drurëve që rriten shpejt dhe që japin sasi të mëdha lënde druri, si eukalipte, akacje etj.

3. — Për pyllëzimet e reja, për përmirësimin e pyjeve dhe

për luftën kundër erozionit në planin e tretë pesëvjeçar të investohen rreth 2,1 miliard lekë, nga të cilat 40 për qind të përballohen me kontributin e fshatarësisë.

4. — Pyllëzimet gjatë planit të tretë pesëvjeçar dhe më vonë të bëhen kryesisht me lloje drurësh pyjore që rriten shpejt, që janë më të përshtatshëm për konditat e vendit dhe që kanë më shumë vlerë. Rëndësi e veçantë t'i jepet përhapjes së drunjtve dhe shkurreve industriale, sidomos dafinës, arrës, gështenjës, valanidhit, blirit, xhixhibanozit etj.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë 1961-1965 të bëhen këto pyllëzime të reja nga rrethet dhe ndërmarrjet shtetërore pyjore (NSHP).

Nr.	R r e t h e t	Pyllëzime të reja gjithsejt hektarë	Ndarë sipas llojeve (në përqindje kundrejt totalit)					Ndarë sipas NSHP-ve
			Dafina	Gështenja	Arra	Lloje të tjerë drurësh fletorë	Lloje drurësh halorë	
1	Shkodër	800	—	25	6	19	50	NSHP-a e Shkodrës
2	Lezhë	650	—	16	7	46	31	
3	Rrëshen	200	—	25	25	25	25	
4	Pukë	600	—	18	8	8	66	NSHP-ja e Tiranës
5	Kukës	250	—	20	20	40	20	
6	Tropojë	200	—	75	25	—	—	
7	Tiranë	600	25	17	—	42	16	NSHP-ja e Elbasanit
8	Durrës	800	37	—	—	38	25	
9	Krujë	400	—	38	12	12	38	
10	Burrel	400	—	13	12	50	25	NSHP-ja e Beratit
11	Peshkopi	400	—	25	25	25	25	
12	Elbasan	1000	10	15	5	20	50	
13	Gramsh	400	—	25	12	25	38	NSHP-ja e Korçës
14	Librazhd	600	—	50	16	17	17	
15	Berat	1250	4	12	4	64	16	
16	Lushnjë	950	—	—	—	69	31	NSHP-ja e Vlorës
17	Skrapar	300	—	34	16	33	17	
18	Korçë	1900	—	5	5	22	68	
19	Pogradec	900	—	45	5	16	34	NSHP-ja e Gjirokastrës
20	Ersekë	500	—	20	10	10	60	
21	Vlorë	1500	43	—	—	30	27	
22	Fier	1500	13	—	—	53	34	NSHP-ja e Tepelenës
23	Gjirokastrë	1400	—	10	3	30	57	
24	Përmet	400	—	25	12	38	25	
25	Sarandë	1500	34	13	3	23	27	NSHP-ja e Tepelenës
26	Tepelenë	600	8	17	8	33	34	
Gjithsejt		20.000	10	15	6	32	37	

Përqindjet e drurëve me rëndësi industriale dhe frutore që jepen në këtë pasqyrë mund të tejkalohen në kurriz të llojeve të drurëve fletorë.

Buzë lumenjve, kanaleve dhe në kodrat e bregdetit, që nga Shkodra deri në Lushnjë të përhapet plepi, ndërsa eukalipti të përhapet më tepër në zonën e Jugut, ku ka dhënë rezultate të mira. Duke marrë parasysh rritjen e shpejtë të eukaliptit, sasinë e madhe të lëndës si dhe vlerën që ka për industrinë farmaceutike, të sillen nga jashtë farëra prej llojeve më të mira të eukalipteve që i qëndrojnë të ftohtit, për t'u përhapur në gjithë zonën bregdetare. T'i kushtohet kujdes rritjes së shëlgut industrial, i cili duhet të mbillet sa më shumë buzë përrenjve e lumenjve. Selvia dhe akacia të mbillen në tokat e varfëra të papërshtatshme për kultura të tjera pyjore, si dhe për shndërrimin e shkurreve. Në pyllëzimet e ardhshme të mbahet parasysh çështja e përmirësimit të përbërjes së llojeve pyjore, duke përhapur më tepër drurët halorë, e sidomos breddhin. Në pyllëzimet e bregdetit të Jugut të kultivohet kryesisht valanidhi, ndërsa në pjesën tjetër bregdetare të mbillet sa më shumë pisha, sidomos pisha e egër, e butë dhe pisha e detit, të cilat janë mjaft të përshtatshme për këto zona dhe rriten shpejt.

Komiteti Qendror i Partisë porositi Ministrinë e Bujqësisë, komitetet e Partisë, kooperativat bujqësore dhe gjithë fshatarësinë punonjëse të marrin masa që në zonën fushore të mbjellin sa më shumë kallama, të cilat janë një material shumë i çmueshëm për ndërtim, rriten shpejt dhe me lehtësi në konditat e vendit tonë. Organizata e rinisë ta marrë si aksion të saj mbjelljen e kallamit në shkallë të gjerë në të gjitha zonat fushore.

Ministria e Bujqësisë të provojë në shkallë të gjerë mbjelljen dhe përhapjen e bambusë në vendet e përshtatshme.

Ministria e Bujqësisë brenda gjashtëmuorit të parë 1960 të studjojë dhe t'i bëjë propozimet përkatëse Këshillit të Ministrave për vendosjen e formave të shpërblimit dhe të stimulimit për aktivistët dhe pjesëmarrësit në punë vullnetare për pyllëzime, përmirësime pyjore, mbrojtjen e pyjeve etj.

5. — Ministria e Bujqësisë të marrë masa menjëherë për të siguruar prodhimin e 100 milion fidaneve pyjore deri në vitin 1965. Në të ardhmen të prodhohen gjithashtu jo më pak se 100 milion fidane çdo pesëvjeçar. Për këtë qëllim Ministria e Bujqësisë, brenda 6 muajve të parë të vitit 1960, të ngrejë fidanishte të reja, të zgjerojë fidanishtet ekzistuese pyjore dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për organizimin e tyre sa më të mirë. Krahas fidanishteve kryesore pyjore, të ngrihen edhe fidanishte të vogla, të përkohshme, në afërsi të objekteve të pyllëzimeve; ato jo vetëm që sigurojnë fidane më të mira, të aklimatizuara me terrenet ku do të mbillen, por edhe pakësojnë shpenzimet për transportin e tyre. Fidanishtet pyjore të administrohen vetëm nga ndërmarrjet shte-

tërora pyjore, të cilat të prodhojnë fidane edhe për pyllëzimet që do të bëhen nga fshatarësia.

Për të siguruar material mbjellës për gjelbërimin e qyteteve të mëdha, Drejtoria e ekonomisë komunale, brenda vitit 1960, të krijojë fidanishtet e veta, ndërsa për qytetet e vogla fidanat të sigurohen nga fidanishtet pyjore me pagesë në bazë të kontratave. Për gjelbërimin e qyteteve, të rrugëve, të vendeve rreth qendrave të punës dhe të prodhimit, të mbillen sa më shumë drurë frutorë, bli, dafinë si dhe drurë që kanë më tepër vlerë industriale, qëndrojnë gjithë kohën të gjelbër dhe janë të përshtatshëm për zbukurimin e qyteteve.

Të merren masat e duhura që në fidanishtet pyjore të përmirësohet teknika e mbjelljes. Të bëhen më tepër përpjekje për mekanizimin e punimeve dhe të ulët kostua e prodhimit të fidaneve.

6. — Ministria e Bujqësisë të marrë masa që, duke filluar nga viti 1960, të bëhet shfrytëzimi i 170.000 ha pyjeve në bazë të planeve të mbarështrimit që janë përpiluar dhe të mos lejohet në asnjë mënyrë që në këto pyje të veprohet në kundërshtim me planin e mbarështrimit; gjithashtu, të marrë masa për hartimin e planeve të mbarështrimit të pyjeve që deri sot nuk i kanë këto plane, duke filluar në radhë të parë nga pyjet kryesore që janë sot në shfrytëzim. Deri në fund të pesëvjeçarit të tretë të jenë hartuar planet e mbarështrimit për 200.000 ha pyje të tjera. Gjatë vjetëve 1965-1975 të vazhdojë puna për hartimin e planeve të mbarështrimit në 200.000 ha çdo pesëvjeçar. Në këtë mënyrë, brenda 15 vjetëve të përfundojë mbarështrimi i gjithë fondit pyjor të RPSH. Në të ardhmen asnjë pyll të mos futet në shfrytëzim pa patur planin perspektiv të mbarështrimit. Ministria e Bujqësisë t'i kushtojë kujdes përmirësimit të cilësisë së hartimit të planeve të mbarështrimit. Këto, pasi të shqyrtohen nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, ku ndodhet ekonomia pyjore, të aprovohen nga kolegji i Ministrisë së Bujqësisë dhe të mos lejohet asnjë ndryshim në zbatimin e tyre.

7. — Të merren masa të rrepta për mbrojtjen e pyjeve nga kullotja e parregullt. Për këtë qëllim Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim me komitetet ekzekutive të rretheve, të përcaktojë çdo vit rreth 30.000 ha pyje, ku të ndalohet kullotja deri në rimëkëmbjen e tyre. Ndalimi i kullotjes në radhë të parë të bëhet në pyjet që janë në shfrytëzim, pyjet mbrojtëse si dhe në pyllëzimet e reja dhe në sipërfaqet e përmirësuara.

Duke marrë parasysh dëmet që u shkaktojnë dhitë pyjeve, komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive të rretheve të marrin masa që në të ardhmen numri i dhive të mos shtohet dhe, gradualisht, të shkohet drejt zëvendësimit të tyre me lloje të tjera kafshësh. Kjo të bëhet e organizuar mirë, që jo vetëm të mos ketë ulje në prodhimin e qumështit dhe të mishit, por të sigurohet zbatimin i plotë

i vendimeve të Plenumit të nëntorit 1958 për shtimin e mishit e të qumështit me ritëm më të shpejtë.

Duke filluar që nga viti 1960, të vihet një kontroll i rreptë në prerjen e gjethit për bagëti. Ndërmarrjet pyjore, në bashkëpunim me komitetet ekzekutive të rretheve, jo më vonë se muaji qershor i çdo viti, të caktojnë zonat e posaçme për prerje dhe t'u vënë fshatarëve detyra që, krahas me prerjen e gjethit në bazë të rregullave teknike, të bëjnë aty edhe punime përmirësimi e pyllëzimi, me qëllim që të ndalohet degradimi i pyjeve dhe të mos krijohen vatra të reja gërryerje.

Të ndalohet rreptësisht prerja e pyjeve për krande bagëtish si një veprim antiekonomik. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të kp të rretheve të marrin me kohë masat e duhura që të sigurojnë ushqimin e bagëtive përmes rrugëve të tjera, si kultivim bimësh foragjere, mbledhje e barit, silazh dhe të tjera ushqime të mjaftueshme, që të mos lindë nevoja të kërkojnë krande në muajt e parë të pranverës.

8. — Të organizohet në shkallë të gjerë lufta kundër erozionit të tokave. Lufta kundër erozionit të shtrohet në masat e gjera punonjëse si çështje shumë e rëndësishme dhe si problem i ngutshëm kombëtar.

Të merren masa mbrojtëse për të mos lejuar që të krijohen vatra të reja erozioni. Të gjitha masat që synojnë në mbrojtjen, shtimin dhe përmirësimin e ekonomisë pyjore të konsiderohen jo vetëm si masa për rritjen e rendimentit të pyjeve tona, por edhe si masa të rëndësishme për mbrojtjen e tokave, për luftimin e erozionit.

I rekomandohet Këshillit të Ministrave të aprovohet rregulla të posaçme për shpyllëzimet dhe çeljen e tokave të reja, në mënyrë që çdo shpyllëzim ose hapje tokash të reja në vende të pjerrëta të jetë siguruar me masa mbrojtëse kundër erozionit. Komitetet e Partisë të mobilizojnë fshatarësinë për një luftë aktive kundër erozionit me anë të ndërtimit të pritave të thjeshta nëpër përrrenj të vegjël me gjerde, gurë, mure si dhe me ngritjen e terracave përreth arave në vendet malore, duke bërë pyllëzime anës përrrenjeve etj. Për mbrojtjen nga erozioni të bëhen sa më shumë mbjellje shelgu të egër.

Komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve t'i caktojnë çdo kooperative dhe fshati detyra konkrete për luftimin e erozionit. Brenda pesëvjeçarit të tretë fshatarësia të bëjë jo më pak se 100.000 m³ prita e vepra përforcimi. Ministria e Bujqësisë të nxjerrë udhëzime në lidhje me ndërtimin e pritave, të veprave të përforcimit etj. që do të bëhen nga vetë fshatrat, dhe të organizojë ndihmën e specialistëve për zbatimin e tyre. Gjithashtu gjatë pesëvjeçarit të tretë të bëhen me investimet e shtetit 100.000 m³ vepra përforcimi për mbrojtjen e pyjeve dhe të tokave nga erozioni.

Sistemimet malore të bëhen në bazë të projekteve të studjuara më parë dhe të shoqërohen me të gjitha punimet e duhura, si pyllëzime, përmirësime etj., duke parashikuar edhe punimet për mirëmbajtjen e tyre.

9. — Që të forcohet mbrojtja e pyjeve, Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të rishqyrtojë ligjet dhe rregullat teknike pyjore dhe të paraqesë brenda tremujorit të parë 1960 projektligjin dhe rregullat e reja, ku të parashikohen masa më të rrepta për dëmet që kryhen në pyjet; t'u lihen kompetenca më të gjera organeve pyjore, të thjeshtohet procedura e marrjes në përgjegjësi penale e dëmtuesve të pyjeve tj. Ministria e Bujqësisë të organizojë më mirë kontrollin për mbrojtjen e pyjeve; personeli pyjor të jetë i papajtueshëm me çfarëdo dëmi që bëhet në pyjet tona.

Organet e drejtësisë, të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Ministrisë së Bujqësisë të tregojnë më shumë kujdes për zbatimin e ligjeve dhe të rregullave për mbrojtjen e pyjeve dhe për gjuetinë. Ministria e Bujqësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe organet e pushtetit lokal të organizojnë mirë mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, duke u dhënë një rëndësi të madhe masave paraprake.

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1960 Ministria e Bujqësisë të marrë masa për organizimin e mbrojtjes së pyjeve nga sëmundjet dhe të nxjerrë rregulloren për mbrojtjen e tyre, duke vënë në zbatim gradualisht masat karantinore. Të merren masat e duhura që për luftimin e sëmundjeve në pyje të përdoren sa më shumë mjete moderne.

Ministria e Bujqësisë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1960 të studjojë dhe të shpallë pyje mbrojtëse pyjet me rëndësi kombëtare për bukurinë e tyre, për rolin mbrojtës të liqeneve etj., siç janë Lura, Dajti, Voskopoja, Divjaka etj. Gjatë vitit 1960 për këto pyje të projektohen masa teknike silvikulturale të veçanta që të zbatohen gjatë pesëvjeçarit të tretë, si dhe rregulloret për administrimin më të drejtë të tyre.

10. — Të krijohet fondi i vetëm shtetëror i pyjeve, ku të përfshihen pyjet kombëtare, lokale e kolektive, tokat që duhen pyllëzuar si dhe kullotat që gjenden brenda në pyje. Ministria e Bujqësisë, brenda vitit 1962, të përcaktojë kufitë e çdo pylli, duke ndarë edhe kufitë e kullotave nga pyjet.

Ministria e Bujqësisë, brenda vitit 1960, të heqë nga fondi i vetëm shtetëror pyjor sipërfaqet e veshura me pyje të degraduara e shkurre dhe që janë të përshtatshme për toka bujqësore, vreshta e pemëtore, si dhe ato pyje që paraqesin më shumë interes për t'u shpyllëzuar që të mbillen me pemë frutore, me vreshta dhe me kultura të tjera bujqësore.

Fondi i vetëm shtetëror pyjor të administrohet nga një dorë e vetme. Për këtë pranë Ministrisë së Bujqësisë të ngrihet drej-

toria e përgjithëshme e pyjeve, e cila të administrojë fondin e vetëm shtetëror pyjor nëpërmjet ndërmarrjeve shtetërore pyjore. Personeli pyjor që ndodhet pranë komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve t'u kalojë ndërmarrjeve shtetërore pyjore. Ministria e Bujqësisë brenda tremujorit të katërt të këtij viti t'i paraqesë qeverisë masat organizative për forcimin e administratës pyjore.

11. — Ministria e Bujqësisë dhe ndërmarrjet pyjore (NSHP), krahas masave për forcimin e ekonomisë pyjore, të marrin nën drejtimin e tyre shtimin dhe ruajtjen e kafshëve e të shpendëve të egra për gjueti dhe organizimin më të mirë të gjuetisë në vendin tonë.

Ministria e Bujqësisë dhe Shoqata e gjuetarëve të organizojnë më mirë luftën kundër kafshëve dhe shpendëve grabitqarë dhe të dëmshëm për bujqësinë si dhe mbrojtjen e kafshëve dhe të shpendëve të dobishme të gjahut. Të organizohen më mirë rezervat e gjuetisë dhe, krahas rritjes së fazanit, të fillojë edhe rritja e derrave të egër, e kapronjve, lepujve të egër dhe e kafshëve të tjera të dobishme, duke organizuar kapjen e tyre nga vendet ku gjenden dhe kolonizimin nëpër rezervate.

Ministria e Tregëtisë të marrë masa për t'i furnizuar me rregull shoqatat e gjuetarëve me materiale gjuetie të një cilësie më të mirë dhe të organizojë më mirë marrjen në dorëzim, konservimin dhe transportimin e gjahut të vlarë.

Instituti i lartë bujqësor dhe Universiteti shtetëror i Tiranës, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Shoqatën e gjuetarëve, duke përfutur nga eksperiencia e vendeve të demokracisë popullore, të kryejnë studime mbi gjahun në vendin tonë, të cilat të vlejnjë për një trajtim shkencor të ekonomisë së gjahut.

Plani për grumbullimin e lëkurëve të kafshëve të egra të harthohet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe me Shoqatën e gjuetarëve, duke patur parasysh që të mos dëmtohet fondi i gjahut.

Shoqata e gjuetarëve të aktivizohet më shumë për të mobilizuar gjuetarët për zhdukjen e kafshëve dhe të shpendëve grabitqarë e të dëmshëm për bujqësinë, për realizimin e detyrave të furnizimit me mish gjahu dhe të bëjë më shumë punë edukative me anëtarët e saj për të respektuar ligjet dhe rregullat e gjuetisë.

II. — Për shfrytëzimin racional, kursimin dhe zëvendësimin e lëndës së drurit.

1. — I rekomandohet Këshillit të Ministrave të marrë masa që nga 1 janari 1960 të fillojë shfrytëzimi i centralizuar i pyjeve, duke përqëndruar vetëm në duart e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave prerien e lëndës së pyllit. Për kantieret e Ministrisë së Ndërtimit ky afat të zgjatet deri më 1 janar 1961.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave të marrë të gjitha masat e nevojshme për të filluar në mënyrë të organizuar nga shfrytëzimi i përqëndruar i pyjeve, duke siguruar nevojat e ekonomisë popullore me të gjitha asortimentet që dalin nga prerja e lëndës së drurit. Të rritet në mënyrë të vazhdueshme përqindja e lëndës së punimit në krahasim me drutë e zjarrit dhe në fund të pesëvjeçarit të tretë të arrihet që përqindja e nxjerrjes së lëndës së punimit, në krahasim me drurët e zjarrit, të jetë 75 për qind për pyjet halore dhe 70 për qind për pyjet fletore. Për këtë ndërmarrjeve t'u caktohen detyra konkrete në planin e çdo viti.

Ministria e Bujqësisë të forcojë kontrollin mbi shfrytëzimin racional të pyjeve. Në caktimin e pyjeve për prerje të mbajë parasysh mirë shfrytëzimin e gjithë lëndës së punimit dhe të marrë masa kur nuk zbatohen normat dhe rregullat teknike të caktuara për shfrytëzimin e pyjeve.

2. — T'i kushtohet kujdes i posaçëm çeljes së rrugëve të reja, për të vënë sa më shpejt në shfrytëzim të gjitha masivet pyjore kryesore. Gjatë pesëvjeçarit të tretë të hapen rreth 400 km. rrugë të reja.

Krahas rrugëve pyjore kryesore, Ministria e Industrisë dhe e Minierave të marrë masa për të përmirësuar transportin e brendshëm në pyll, duke çelur në ekonomi rrugë të shkurtëra pyjore të përkohshme për muajt e verës, me qëllim që të vihen në shfrytëzim parcelat e mënjanuara. Nga ana tjetër, për të shfrytëzuar disa pjesë pyjore 2-5 km. larg rrugëve automobilistike, sidomos kur këto janë në drejtim të kundërt të rrjedhjes së ujërave, të përdoret më shumë tërheqja me kafshë. Të përdoren më tepër motoorganot, të përmirësohet dhe të zgjatet rrjeti i rrugëve të dekovilit.

Ngarkohet qeveria, Komisioni i Planit dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave që të marrin masa për zgjerimin e rrjetit të teleferikëve për shfrytëzimin e pyjeve, duke e kombinuar në mënyrë më racionale transportin automobilistik me atë teleferik.

3. — Për të pakësuar dëmtimet dhe shpërdorimet që vërtetohen në prerje, trupim e transport, për t'ju përmbajtur normativave të aprovuara për prodhimin e lëndës së sharruar, të kompensatos, të rimesos etj., për shfrytëzimin e mbeturinave të shumta të lëndës së drurit që dalin, duke filluar nga prerja në pyll e deri në përpunimin e saj, Ministria e Industrisë dhe e Minierave të marrë masa për të nxjerrë nga pylli të gjitha asortimentet e vlefshme.

Të shtohet kujdesi për shfrytëzimin sa më racional dhe kursimin e lëndës së drurit në zdrukthtaritë dhe në të gjithë sektorët e tjerë me karakter industrial, duke ulur njëkohësisht normat e konsumimit të lëndës së drurit. Ministria e Industrisë dhe e Minierave, gjatë planit të tretë pesëvjeçar, të bëjë imprenjimin dhe staxhionimin e shtyllave për minierat, të shtyllave elektrike etj. Të bëhet e detyrueshme lyerja me bojë dhe mjete mbrojtëse e

pjesëve prej druri të ndërtesave. Shtyllat e telefonave prej druri të montohen në këmbë metalike ose prej betoni.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe Ministria e Ndërtimit të marrin masa që gjatë pesëvjeçarit të tretë dhe në të ardhmen të përdorin sa më shumë mjete që kursejnë lëndën e drurit, duke e zëvendësuar atë, kudo që është e mundshme, me materiale të tjera. Gradualisht të fillojë zëvendësimi i shtyllave elektrike, i hunjve të vreshtave etj. me materiale jodrurorë, duke mbajtur parasysh leverdinë për ekonominë popullore në tërësi.

Komisioni i Planit të Shtetit, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 1960, të rishikojë standardet ekzistuese në përdorimin e lëndës së drurit, me qëllim që kjo të kursehet dhe të përdoret në mënyrë racionale. Gjithashtu të rishikojë mënyrën e planifikimit në zdrukthtaritë, me qëllim që të rritet interesi i tyre për plotësimin e planit jo vetëm si vleftë, por edhe në asortimentet, sipas kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve.

4. — Ministria e Ndërtimit, duke filluar nga viti 1960, të marrë masat për zëvendësimin sa më të gjerë të lëndës së drurit me materiale të tjera. Të merren masat që skelat prej druri që përdoren sot të zëvendësohen me materiale të tjera, të kursehet lënda në ndërtimin e kallëpeve të armaturave, në kasat e dyerve etj. Të fillojë prodhimi i tullave të tipit «SAP» ose i llojeve të tjera që kursejnë lëndën e drurit. Të përhapen gjerësisht mënyra të tjera ndërtimi që të kursehet sa më shumë lënda e drurit. Ministria e Ndërtimit të ndjekë me kujdes metodat e përparuara të ndërtimit të banesave, përdorimin në shkallë të gjerë të pjesëve të parafabrikuara dhe të rishikojë brenda vitit 1960 manualët e preventivit për uljen e normave të përdorimit të lëndës së drurit.

Këshilli i Ministrave, në planin e tretë pesëvjeçar, të parashikojë ndërtimin e instalimit të posaçëm për vlerësimin e tallashit dhe të të gjitha pjesëve të tjera që dalin nga druri i prerë, siç janë fabrikat për prodhimin e pllakave të dërrasave etj.

5. — Të bëhet problem i madh partie dhe i gjithë fshatarësisë kooperativiste dhe individuale çështja e kursimit të lëndës së drurit në të gjitha ndërtimet dhe punimet që kryhen në fshat. Brenda vitit 1960 Ministria e Ndërtimit të hartojë projekte tip për ndërtesat e banimit, ato socialo-kulturale dhe të prodhimit (depo, stalla etj.), duke parashikuar përdorimin në to sa më të kufizuar të lëndës së drurit.

6. — Ministria e Industrisë dhe e Minierave, brenda pesëvjeçarit të tretë, të bëjë përqëndrimin e prodhimit të ambalazheve në forma të gatshme ose gjysmëfabrikate në Kombinatin e drurit «Nako Spiru» Elbasan, në kombinatin e ri të drurit në Shkodër dhe në fabrikën e re të lëndës së sharruar që do të ngrihet në Milot. Përveç kësaj, të studjohet një mënyrë administrimi më e mirë e

ambalazhimeve, me qëllim që të zgjatet koha e përdorimit të tyre. Gjithashtu të merren masa që të përdoren lloje të tjera ambalazhimesh, si shporta prej zhuge, kosha prej thupre, arka kartoni etj. Të vlerësohen më shumë arkat e drurit që vijnë nga jashtë, duke i ruajtur mirë gjatë transportit dhe qëndrimit në magazina, si dhe duke organizuar riparimin e tyre.

7. — Me qëllim që të vlerësohet më mirë lënda e drurit, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 1960, t'i propozojë qeverisë tarifën e re të prodhimeve pyjore që duhet të paguajnë ndërmarrjet shfrytëzuese të pyjeve. Të ndalohej tregëtimi i druve të zjarrit nga ekonomitë fshatare, duke marrë masa që furnizimi me dru zjarri të bëhet vetëm nga entet dhe organizatat ekonomike shtetërore dhe kooperativiste.

8. — Ministria e Industrisë dhe e Minierave, brenda fondeve të akorduara për vitin 1960 dhe në vitet e ardhshme, të marrë masa për mekanizimin e transportit dhe të proceseve të prodhimit të lëndës së drurit në një shkallë sa më të gjerë. Të zgjerohet përdorimi i motosharrave në pyll, ndërsa në sheshet e stabilimenteve të përdoren gjerësisht elektrosharrat. Gjithashtu të merren masa për të shtuar fuqinë motorike nëpër stabilimente dhe të pajisen këto me sharra cirkulare, me qëllim që të përmirësohet cilësia e prodhimit të lëndës së sharruar, të ulët firua e lëndës së parë dhe të shfrytëzohen mbeturinat.

9. — Të bëhet një kursim i madh në përdorimin e drurëve të zjarrit, duke arritur që për një periudhë 5-10 vjeçare konsumi i tyre të përgjysmohet. Për zbatimin e kësaj detyre komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të marrin të gjitha masat organizative dhe propagandistike që të ndryshohet sistemi i ngrohjes në fshatra. Të bëhen përpjekje që në kooperativat e zonave fushore brenda pesëvjeçarit të ngrihen furra kolektive dhe të merren masa për zëvendësimin e oxhaqeve të hapura me stufa. Ministria e Industrisë dhe e Minierave si dhe Bashkimi Qendror i Kooperativave të Artizanatit në vend të stufave prej llamarine të hollë të prodhojnë më shumë stufa ekonomike, për plotësimin e nevojave të qytetit dhe të fshatit.

10. — Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe Drejtoria e ekonomisë komunale, brenda vitit 1960, të studjojnë dhe t'i paraqesin qeverisë për shqyrtim mundësinë e përdorimit për nevojat e popullatës së qyteteve, sidomos të qytetit të Tiranës, të gazit të lëngëzuar. Ministria e Ndërtimit dhe komitetet ekzekutive të kp të rretheve të marrin masa për përqëndrimin e prodhimit të gëlqeres në disa vende, duke përdorur qymyrguri dhe gaz, në vend të druve të zjarrit. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të marrin masa që në mensat, restorantet, kaloriferët etj. në vend të druve të përdoren lëndë djegëse të tje-

ra. Në furrat e qyteteve të ndalohej përdorimi i druve të zjarrit, duke i zëvendësuar me flakëdhëse.

Me qëllim që të nxitet përdorimi i energjisë elektrike për nevoja shtëpiake, Këshilli i Ministrave të studjojë mundësinë e uljes së mëtejshme të tarifës së energjisë elektrike dhe sidomos dallimin sipas stinave, në mënyrë që përdorimi i energjisë elektrike të jetë më i leverdishëm për dimër.

III. — Mbi kuadrin

1. — Për një trajtim teknik më të drejtë të pyjeve, të punohet për shtimin e vazhdueshëm të kuadrove specialistë të lartë, të mesëm dhe të ulët. Të merren masa që deri në vitin 1965, brenda dhe jashtë shtetit, të kryejnë studimet e larta për inxhinierë pyjesh 110 vetë, duke siguruar kështu një teknik të lartë për çdo 20.000 ha pyje. Të synohet që norma e ngarkesës për çdo teknik të lartë të ulët vazhdimisht deri sa në të ardhshmen të kemi një inxhinier për çdo 5.000 ha pyje.

Ministria e Bujqësisë të kujdeset vazhdimisht për përgatitjen e kuadrove pyjorë dhe për një trajtim më të mirë të tyre. Që të sigurohet me kohë numri i nevojshëm i kuadrove për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë pyjore, të tregohet më shumë kujdes për fakultetin e pyjeve, që është hapur pranë Institutit të lartë bujqësor, duke i siguruar pedagogë të kualifikuar, pajisje laboratorike të përshtatshme dhe kushte të mira për zhvillimin e praktikave të studentëve.

2. — Për të shpejtuar përgatitjen e teknikëve të pyjeve, duke përmirësuar njëkohësisht edhe përbërjen e tyre, të shtohet kontingjenti i shkollës pyjore dyvjeçare të Shkodrës nga 30 veta që është sot në 60 veta, ndërsa dega e pyjeve pranë Teknikumit bujqësor të Kavajës të mbyllet. Të tregohet më shumë kujdes për mësimet praktike të shkollës pyjore, duke vënë rregull që nxënësit e saj praktikën ta bëjnë pranë fidanishteve të ndërmarrjeve shtetërore pyjore.

Pasi të jenë plotësuar nevojat më urgjente me teknikë të ulët, shkolla pyjore e Shkodrës të kthehet në një teknikum trevjeçar, për të nxjerrë teknikë të mesëm. Të punohet që në një të ardhshme të afërt të kemi një teknik për çdo 8.000 ha pyje. Më vonë kjo normë të ulët deri sa të arrijë në 3.000 ha për çdo teknik, duke synuar që edhe rojtarët e pyjeve të bëhen teknikë të ulët. Për të vendosur një kontroll të fortë në ruajtjen e pyjeve, Ministria e Bujqësisë të studjojë nevojat për rojtarët dhe, sipas nevojës, të shtojë numrin e tyre.

3. — Për të plotësuar nevojat e ngutshme që ka industria e drurit për kuadro të specializuar, Komisioni i Planit, Ministria e

Arësimit dhe e Kulturës si dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave të marrin masa që deri në 1965 numri i specialistëve me arësim të lartë në këtë sektor të arrijë deri në 40 dhe i teknikëve të mesëm në 180, ndërsa deri në vitin 1970 numri i tyre të arrijë përkatësisht në 70 dhe 260 vetë.

Komitetet e Partisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave të marrin masa për të influencuar në mënyrë rrënjësore në stabilizimin e fuqisë punëtore dhe në uljen e koeficientit të fluktacionit të saj.

Ndërmarrjet shfrytëzuese të organizojnë me punëtorët dhe kuadrot drejtues kurse dhe shkolla, në të cilat të mësohet si duhet bërë prerja, ndarja e trupit, vlerësimi i materialit druror për pregatitjen e asortimenteve me vlerë më të madhe ekonomike. Gjithashtu të organizohet më mirë shkëmbimi i eksperiencës së punonjësve për respektimin e standardeve shtetërore, kursimin e lëndës, trajtimin e pyjeve etj.

4. — Brenda tremujorit të parë të vitit 1960, Këshilli i Ministrave të marrë masa për një trajtim më të mirë të kuadrove inxhiniero-teknikë të pyjeve, të rojtarëve dhe të nëpunësve të ekonomisë pyjore. Të krijohen kondita nxitëse për punonjësit e pyjeve, në mënyrë që këta të lidhen sa më ngushtë me shërbimin në pyje.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave të tregojë më shumë kujdes për strehimin e punonjësve të sharrave, duke marrë masa për ndërtimin e banesave pranë qendrës së punës.

Drejtoritë e NSHFP-ve të marrin masa për të përmirësuar në mënyrë rrënjësore punën për furnizimin e punëtorëve, për sigurimin e komoditeteve të nevojshme, për pastërtinë dhe higjienën; organizatat bazë të Partisë dhe drejtoritë e ndërmarrjeve të merren më shumë me organizimin e jetës kulturele të punëtorëve, me ngrijtjen nëpër stabilimente të banjave, lavanderive, etj.

IV. — Disa masa organizative

1. — Për aktivizimin e masave të gjera të rinisë dhe të punonjësve të vendit tonë në gjelbërimin e qyteteve, në krijimin e pyjeve e parqeve dhe në mbjelljen e sa më shumë bimëve drurore, të organizohet çdo vit *Java pyjore*. Në zonat malore të Shqipërisë së Brendshme e Lindore ajo të zhvillohet në dhjetëditëshin e parë të muajit nëntor, ndërsa në zonat e ullirit në dhjetëditëshin e parë të muajit dhjetor. Java pyjore të vlejë për të organizuar një propagandë më të gjerë në dobi të pyjeve, për ngjalljen e dashurisë së masave punonjëse për to. Komitetet e Partisë, organet shtetërore dhe organizatat e masave të marrin masa që ajo të organizohet sa më mirë, duke siguruar pjesëmarrjen aktive të masave në çeljen e gropave, në mbjelljen dhe mbrojtjen e pemëve.

Në nëntor të çdo viti, kryesisht në fshat, të organizohet *Muaji i luftës kundër erozionit*, gjatë të cilit të aktivizohen masat e popullit për të bërë sa më shumë terraca, prita, gjerdhe, pyllëzime, përmirësime dhe të marrin masa të tjera kundër erozionit. Gjatë këtij muaji të bëhet gjithashtu një punë e madhe për të sqaruar masat mbi rrezikun e erozionit dhe mbi nevojën e domosdoshme të mbrojtjes së pyjeve.

Çdo vit, në maj, të organizohet *Muaji i luftës kundër kafshëve dhe shpendëve grabitqarë të dëmshëm për bujqësinë*. Gjatë këtij muaji, kur këto kafshë dhe shpendë janë në fazën e shumëzimit, të mobilizohen gjerësisht jo vetëm gjuetarët, por të gjitha masat punonjëse dhe rinia në fshat e qytet për shfarosjen e tyre.

2. — Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të k p të rretheve të marrin të gjitha masat e nevojshme që për çështjet që shtron ky plenum pjesëmarrja e fshatarësisë, e rinisë dhe e gjithë punonjësve të bëhet në mënyrë sa më të organizuar. Për këtë të gjitha forcat që do të marrin pjesë në Muajin e luftës kundër erozionit, në Muajin e luftës kundër kafshëve e shpendëve grabitqarë të dëmshëm për bujqësinë, dhe sidomos në Javën pyjore të organizohen në brigada sipas kooperativave, fshatrave, shkollave, qendrave të punës etj. Që këto aksione të marrin karakter masiv, organizatat e Partisë dhe gjithë organizatat e masave të bëjnë një punë të madhe sqaruese. Pjesëmarrja e masave në këto aksione të bëhet një detyrë patriotike, duke forcuar traditat e mira të popullit tonë. Organet e shtypit dhe të radios të ndjekin nga afër organizimin dhe zhvillimin e fushatave të përmendura.

3. — Të organizohet një propagandë e gjerë dhe e vazhdueshme për mbrojtjen e pyjeve. Luftimi i zjarreve në pyje, prerjet në bazë të rregullave teknike, mënjanimi i prerjeve abuzive, respektimi me rreptësi i rregullave të gjuetisë, moslejimi i kullotjes në vende të ndaluara etj. mund të sigurohen vetëm me pjesëmarrjen aktive të masave të gjera punonjëse, sidomos të fshatarësisë. Prandaj komitetet e Partisë duhet t'i kushtojnë një vemendje të madhe propagandës për mbrojtjen e pyjeve, duke e bërë një problem të vazhdueshëm të organizatave bazë të Partisë dhe të organizatave të masave në fshat. Të krijohet një atmosferë mbytëse kundër njerëzve që dëmtojnë pyjet, duke i konsideruar këta si dëmtues dhe vjedhës të pasurisë sonë socialiste.

Shtypi dhe radioja të merren shumë më tepër me problemet pyjore, duke luftuar për rritjen e ndërgegjes së masave punonjëse për mbrojtjen e pyjeve. Të organizohet një punë sistematike, me anë të së cilës të shpjegohet rëndësia e pyjeve për ekonominë e vendit, si influencojnë ato në prodhimtarinë e tokës, në rregullimin e klimës etj.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH është i bindur se masat punonjëse të vendit tonë do t'i kuptojnë drejt detyrat që shtrohen në këtë vendim për zhvillimin e ekonomisë pyjore, për përdorimin racional dhe për kursimin e lëndës së drurit. Me vrullin e tyre revolucionar që i karakterizon, ato do t'i kryejnë me nder këto detyra të mëdha patriotike.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

**Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
265, datë 4 nëntor 1959**

Nr. 116

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

«Mbi shtimin e sipërfaqes së tokave të ujitshme dhe mbi teknikën e ujitjes»

3 nëntor 1959

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur më datën 2 dhe 3 nëntor 1959 nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë, shokut Enver Hoxha, pasi shqyrtoi raportin e paraqitur nga shoku Spiro Koleka, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, «Mbi shtimin e sipërfaqes së tokave të ujitshme dhe mbi teknikën e ujitjes në bujqësinë tonë», vuri re se:

Krahas me fitoret e mëdha që ka korrur populli ynë që prej çlirimit të atdheut e gjer më sot në ndërtimin e socializmit në vendin tonë, në mënyrë të veçantë në kolektivizimin e bujqësisë, në shtimin e sipërfaqeve të mbjella, në zhvillimin e blegtorisë, të frutikuturës etj., një punë shumë e madhe është bërë edhe për shtimin e sipërfaqeve nën ujë, si dhe për shtimin dhe përmirësimin e tokave me anë të tharjes dhe të kullimit.

Gjatë kohës së pushtetit popullor në vendin tonë, nën udhëheqjen e urtë dhe largpamëse të partisë. . . në sajë të punës vetmohuese të popullit tonë, janë kryer ndërtime veprash të mëdha tharjeje, kullimi dhe ujitjeje. Atje ku në regjimet antipopullore dhe

shfrytëzuese të së kaluarës shtriheshin moçale e kënetë që përhapnin malarjen, sot shtrihen fusha të lulëzuara e pjellore; lumenjtë, që me vërshimet e tyre kërcënonin jetën dhe prodhimet e fshatarësisë, u bënë zap nga vepra të fuqishme mbrojtëse; atje ku vapa e fortë e verës thante para kohe bimët bujqësore, sot rrjeta të shumta kanalesh ujitëse përshkojnë fushat në çdo drejtim dhe e shpien ujin gjer në skajet më të largëta.

Gjatë 15 vjetëve të pushtetit popullor, në fushat e vendit tonë janë ndërtuar vepra ujore tharjeje, kullimi dhe ujitjeje të shumta, të rëndësishme e të mëdha, për të cilat populli ynë as që mund të ëndërronte në të kaluarën. Kjo dëshmon edhe një herë se ç'mund të bëjë një popull, sado i vogël dhe i prapambetur, kur ai ka fuqinë në dorë dhe udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste e sprovuar, siç është Partia jonë e Punës.

Në lëmin e tharjes dhe të kullimit janë kryer vepra si tharja e kënetës së Maliqit, të Bedenit, të Tërbufit, sistemimi dhe ndërtimi i shtretërve të lumenjve Devoll, Dunavec, Gjadër, Shkumbin, Bistricë, Kalasë, Pavlë dhe kullimi i fushave të Korçës, të Kavajës, të Myzeqesë, të Zadrimës, të Mursisë, të Vurgut etj. Si përfundim, janë përfutuar 13 mijë e 500 ha tokë e re dhe janë përmirësuar afro 55 mijë ha. Brenda vitit të ardhshëm do të përfundojnë edhe vepra të tjera të mëdha kullimi, si fusha e Roskovecit, e Thumanës, tharja e plotë e Myzeqesë dhe e Vurgut, që do të japin rreth 40 mijë ha tokë të re dhe të përmirësuar.

Për ujitjen e fushave tona janë ndërtuar kanale të mëdha ujitëse, si ai Vjosë-Levan-Fier, Peqin-Kavajë, «Naum Panxhi», i Myzeqesë, i Beratit, ura e Kuçit, i Penkovës, i Qafë-Dardhë-Trushit, i Zadrimës etj. si dhe një numër i madh kanalesh të tjera më të vogla. Nga 29 mijë ha tokë, dmth 13,2 për qind e sipërfaqes së punueshme, që ujiteshin deri në vitin 1938 nga kanale të ndërtuara nga vetë populli pa asnjë ndihmë, brenda 14 vjetëve, deri në fund të vitit 1958, pushteti popullor ndërtoi vepra për ujitjen e një sipërfaqeje prej 77 mijë ha, dmth 2,5 herë më shumë.

Kongresi III i PPSH ka shtruar detyrën që në fund të vitit 1960 të kemi vepra më aftësi ujitjeje për 125 mijë ha. Me veprat e ujitjes që do të mbarojnë brenda vitit të ardhshëm në Thumanë, në Roskovec, në Vurg, në Mursi etj. parashikohet që në fund të vitit 1960 aftësia ujitëse si republikë të arrijë në 135 mijë ha, kështu që detyra do të tejkalohet 8 për qind. Shtimi i sipërfaqes nën ujë prej 77 mijë ha. që nga viti 1938 deri më 1958 është arritur nëpërmjet veprave me karakter kombëtar me aftësi ujitëse prej 52 mijë ha dhe veprave të vogla lokale, kryesisht malore, me aftësi ujitëse prej 25 mijë ha. Fshatarësia jonë malore ka trashëguar një traditë shumë të mirë në heqjen dhe ndërtimin e vijave ujitëse nëpër shpatet e pjerrëta të maleve tona pa vegla topografike dhe pa projekte. Kjo mjeshtëri në malësitë tona është përdorur me

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH është i bindur se masat punonjëse të vendit tonë do t'i kuptojnë drejt detyrat që shtrohen në këtë vendim për zhvillimin e ekonomisë pyjore, për përdorimin racional dhe për kursimin e lëndës së drurit. Me vrullin e tyre revolucionar që i karakterizon, ato do t'i kryejnë me nder këto detyra të mëdha patriotike.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

**Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
265, datë 4 nëntor 1959**

Nr. 116

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

«Mbi shtimin e sipërfaqes së tokave të ujtitshme dhe mbi teknikën e ujitjes»

3 nëntor 1959

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur më datën 2 dhe 3 nëntor 1959 nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë, shokut Enver Hoxha, pasi shqyrtoi raportin e paraqitur nga shoku Spiro Koleka, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, «Mbi shtimin e sipërfaqes së tokave të ujtitshme dhe mbi teknikën e ujitjes në bujqësinë tonë», vuri re se:

Krahas me fitoret e mëdha që ka korrur populli ynë që prej çlirimit të atdheut e gjer më sot në ndërtimin e socializmit në vendin tonë, në mënyrë të veçantë në kolektivizimin e bujqësisë, në shtimin e sipërfaqeve të mbjella, në zhvillimin e blegtorisë, të frutikuturës etj., një punë shumë e madhe është bërë edhe për shtimin e sipërfaqeve nën ujë, si dhe për shtimin dhe përmirësimin e tokave me anë të tharjes dhe të kullimit.

Gjatë kohës së pushtetit popullor në vendin tonë, nën udhëheqjen e urtë dhe largpamëse të partisë... në sajë të punës vetmohuese të popullit tonë, janë kryer ndërtime veprash të mëdha tharjeje, kullimi dhe ujitjeje. Atje ku në regjimet antipopullore dhe

shfrytëzuese të së kaluarës shtriheshin moçale e kënetë që përhapnin malarjen, sot shtrihen fusha të lulëzuara e pjellore; lumenjtë, që me vërshimet e tyre kërcënonin jetën dhe prodhimet e fshatarësisë, u bënë zap nga vepra të fuqishme mbrojtëse; atje ku vapa e fortë e verës thante para kohe bimët bujqësore, sot rrjeta të shumta kanalesh ujitëse përshkojnë fushat në çdo drejtim dhe e shpien ujin gjer në skajet më të largëta.

Gjatë 15 vjetëve të pushtetit popullor, në fushat e vendit tonë janë ndërtuar vepra ujore tharjeje, kullimi dhe ujitjeje të shumta, të rëndësishme e të mëdha, për të cilat populli ynë as që mund të ëndërronte në të kaluarën. Kjo dëshmon edhe një herë se ç'mund të bëjë një popull, sado i vogël dhe i prapambetur, kur ai ka fuqinë në dorë dhe udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste e sprovuar, siç është Partia jonë e Punës.

Në lëmin e tharjes dhe të kullimit janë kryer vepra si tharja e kënetës së Maliqit, të Bedenit, të Tërbufit, sistemimi dhe ndërtimi i shtretërve të lumenjve Devoll, Dunavec, Gjadër, Shkumbin, Bistricë, Kalasë, Pavlë dhe kullimi i fushave të Korçës, të Kavajës, të Myzeqesë, të Zadrimës, të Mursisë, të Vurgut etj. Si përfundim, janë përfutuar 13 mijë e 500 ha tokë e re dhe janë përmirësuar afro 55 mijë ha. Brenda vitit të ardhshëm do të përfundojnë edhe vepra të tjera të mëdha kullimi, si fusha e Roskovecit, e Thumanës, tharja e plotë e Myzeqesë dhe e Vurgut, që do të japin rreth 40 mijë ha tokë të re dhe të përmirësuar.

Për ujitjen e fushave tona janë ndërtuar kanale të mëdha ujitëse, si ai Vjosë-Levan-Fier, Peqin-Kavajë, «Naum Panxhi», i Myzeqesë, i Beratit, ura e Kuçit, i Penkovës, i Qafë-Dardhë-Trushit, i Zadrimës etj. si dhe një numër i madh kanalesh të tjera më të vogla. Nga 29 mijë ha tokë, dmth 13,2 për qind e sipërfaqes së punueshme, që ujiteshin deri në vitin 1938 nga kanale të ndërtuara nga vetë populli pa asnjë ndihmë, brenda 14 vjetëve, deri në fund të vitit 1958, pushteti popullor ndërtoi vepra për ujitjen e një sipërfaqeje prej 77 mijë ha, dmth 2,5 herë më shumë.

Kongresi III i PPSH ka shtruar detyrën që në fund të vitit 1960 të kemi vepra më aftësi ujitjeje për 125 mijë ha. Me veprat e ujitjes që do të mbarojnë brenda vitit të ardhshëm në Thumanë, në Roskovec, në Vurg, në Mursi etj. parashikohet që në fund të vitit 1960 aftësia ujitëse si republikë të arrijë në 135 mijë ha, kësh-tu që detyra do të tejkalohet 8 për qind. Shtimi i sipërfaqes nën ujë prej 77 mijë ha. që nga viti 1938 deri më 1958 është arritur nëpërmjet veprave me karakter kombëtar me aftësi ujitëse prej 52 mijë ha dhe veprave të vogla lokale, kryesisht malore, me aftësi ujitëse prej 25 mijë ha. Fshatarësia jonë malore ka trashëguar një traditë shumë të mirë në heqjen dhe ndërtimin e vijave ujitëse nëpër shpatet e pjerrëta të maleve tona pa vegla topografike dhe pa projekte. Kjo mjeshtëri në malësitë tona është përdorur me

përfundime të mira edhe pas çlirimit. Janë për t'u admiruar kanale si ai i Brutit në Kukës, ose ai i Krasniqës në Tropojë, dhe shumë të tjera të çara për kilometra të tëra në shkëmbinj të thepisur, pa teknikë dhe inxhinierë, me inisiativën dhe punën heroike të malsorëve, nën drejtimin e mjeshtërve shumë të aftë.

Plenumi thekson në mënyrë të veçantë rëndësinë që ka ujitja për shtimin e prodhimeve bujqësore dhe rolin e saj të madh në intensifikimin e bujqësisë sonë. Punimet e mëdha që janë bërë dhe po bëhen në këtë lëmë janë një masë e domosdoshme për shndërrimin socialist të bujqësisë.

Por, nga ana tjetër, plenumi tërheq vëmendjen mbi disa mungesa dhe dobësi që vërehen në ujitjen.

E para, nuk shfrytëzohet aftësia e plotë e kanaleve ujitëse. Koeficienti i shfrytëzimit të veprave të mëdha ujitëse ndaj mundësive është vetëm 73 për qind. Në këtë drejtim është bërë një punë e përciptë nga Ministria e Bujqësisë. Sistemet e veprave ujore në përgjithësi nuk mirëmbahen, nuk pastrohen e nuk meremtohen në kohën dhe në masën e duhur. Ka mungesa organizimi në shpërndarjen e ujit dhe në kontrollimin e përdorimit të tij. Ka shpërdorime e dëmtime të veprave ujore në përgjithësi nga elementë të pandërgjegjshëm. Ministria e Bujqësisë, organet lokale të Partisë dhe të pushtetit nuk i kanë kushtuar kujdesin e duhur problemit të shfrytëzimit të plotë dhe kontrollit të veprave ujore.

E dyta, teknika e ujitjes nuk është përvetësuar nga fshatarësia e fushës. Ndërsa në rrethet malore, si në Peshkopi, në Kukës etj., fshatari e përdor me mjeshtëri dhe kursim të madh ujin, duke marrë rendimente të larta në misër, fasule, jonxhë etj., në shumicën e fushave vazhdohet ende të ujitet me përmbytje, për një kohë të gjatë dhe me sasi uji të mëdha, duke shkuar kështu kot shumë ujë dhe duke dëmtuar pjellshmërinë e tokës, si pasojë e ngritjes së ujërave të nëntokës, e kripëzimit, prishjes së strukturës etj. Si pasojë, rendimenti, p.sh., i pambukut në tokat e ujitura në vitin 1957 dhe afërsisht edhe më 1958 ka qenë vetëm 20 për qind më i lartë se në tokat e paujitura në rrethin e Durrësit, 27 për qind në atë të Lushnjës, 48 për qind në atë të Elbasanit dhe 55 për qind në atë të Fierit, kurse duhej të ishte dyfishin. Puna e organeve të bujqësisë në qendër dhe në rrethet fushore në drejtim të përvetësimit të teknikës së ujitjes nga fshatarësia ka qenë shumë e pakët.

E treta, nuk i kanë kushtuar të gjitha rrethet të njëjtën vëmendje shtimit të sipërfaqes nën ujë. Kështu, p.sh. rrethi i Pukës ka nën ujë 73 për qind të tokës, ai i Peshkopisë 61 për qind, i Librazhdit 61 për qind, i Tropojës 78 për qind, kurse Skrapari 7 për qind, Tepelena 8 për qind, Përmeti 8 për qind, Pogradeci 9 për qind, etj. Shumë rrethe kanë pritur e kërkuar që hapja e kanaleve ujitëse të bëhet kryesisht me investimet e shtetit dhe nuk kanë vënë në lëvizje fshatarësinë për të shtuar, me inisiativën dhe punën e saj,

sipërfaqen nën ujë, duke përdorur të gjitha format dhe burimet e ujit që ka në çdo rreth.

E katërta, nga shumë kooperativa të fushës nënvleftësohet rëndësia e ujitjes në rritjen e prodhimeve bujqësore. Kështu, p.sh., kooperativa e Bulgarecit nuk e ujiti vitin e kaluar panxhar sheqerin, se gjoja ujitja i dëmton bimët, dhe mori 121,2 kv/ha, ndërsa kooperativa e Bitinckës, në të njëjtat kushte të tokës, e ujiti panxharin dhe mori 204 kv/ha. Kooperativa e Babanit pa ujitje mori 10 kv/ha misër, ndërsa ajo e Vranishtit në të njëjtat kushte të tokës, por me ujitje, mori 30 kv/ha.

Duke u nisur nga kushtet e përshtatshme hidrologjike dhe të relievit që ka vendi ynë për shtimin e mëtejshëm të tokave nën ujë, për një zhvillim akoma më të madh të kulturave bujqësore në të gjitha drejtimet, nga kushtet që po krijon shndërrimi socialist i fshatit dhe nga ngritja e vazhdueshme e mirëqenjes së popullit, që është ligji më i lartë i Partisë sonë, plenumi shtron këto detyra kryesore:

1. — *Me anën e ndërtimeve të thjeshta e jo të kushtueshme, që do të kryejë vetë fshatarësia, me një mirëmbajtje të kujdesshme të kanaleve ujitëse dhe përmes përmirësimit rrënjësor të teknikës së ujitjes, të vihen sa më shumë toka nën ujë*, me qëllim që të rriten rendimentet e ndryshme bujqësore. Plenumi porositi në mënyrë të veçantë Ministrinë e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve që të përqëndrojnë punën e tyre për rritjen e sipërfaqes nën ujë me vepra të thjeshta të ndërtuara nga vetë kooperativat bujqësore, për mirëmbajtjen e kujdesshme e të vazhdueshme të veprave ujitëse, tharëse dhe të kullimit, si dhe për përdorimin e drejtë e me kursim të ujit për ujitjen e mirë të bimëve të ndryshme.

2. — Të rritet aftësia ujitëse e republikës nga 27,8 për qind në vitin 1958 në 39,9 për qind në vitin 1965, ose nga 106 mijë ha në vitin 1958 në 201 mijë ha në 1965, Kjo rritje e sipërfaqes të arrihet: 1) nëpërmjet ndërtimeve lokale dhe me iniciativën e vetë fshatarësisë, 2) me një rritje minimale prej 10 për qind të aftësive ujitëse të kanaleve me karakter lokal të ndërtuara deri më sot dhe 3) nëpërmjet ndërtimeve me karakter kombëtar.

3. — Plenumi është i mendimit se komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive duhet të përqëndrohen në punën për arritjen e ndërtimit të veprave ujitëse me karakter lokal me aftësi ujitëse gjithsejt 41 mijë ha përmes ndërtimeve të thjeshta e jo të kushtueshme, që do të bëjë vetë fshatarësia me iniciativën dhe punën e saj. Për këtë janë të gjitha mundësitë. Vendi ynë, sidomos zonat kodrinore dhe malore, kanë ende burime të shumta që nuk shfrytëzohen, kanë lugina, përrenj, rrëqe e gropa të përshtatshme për ndërtimin e hauzeve e pellgjeve artificiale, kanë mundësi të ujitin me çikrik, me rrota me kova, me anë të puseve, të ujërave arte-

ziane, e që mund të shfrytëzohen me motopompa etj. Është në dobi të vetë kooperativave bujqësore dhe të fshatarësisë në përgjithësi që të përqëndrojnë përpjekjet për shfrytëzimin e këtyre mundësive të mëdha për ujitje që ka vendi ynë.

Shtimi i aftësive ujitëse përmes ndërtimeve lokale, me iniciativën dhe punën e vetë fshatarëve, për çdo rreth gjer në vitin 1965, të jetë si vijon:

1) Për rrethin e Tiranës	2.100 ha	14) Për rreth- Pogradecit	900 ha
2) » » Elbasanit	5.800 »	15) » » Burrelit	1.300 »
3) » » Beratit	2.900 »	16) » » Përmetit	1.200 »
4) » » Korçës	2.800 »	17) » » Kukësit	1.100 »
5) » » Shkodrës	3.400 »	18) » » Krujës	1.000 »
6) » » Sarandës	2.200 »	19) » » Gramshit	800 »
7) » » Peshkopisë	1.800 »	20) » » Lushnjës	700 »
8) » » Vlorës	2.200 »	21) » » Librazhdit	1.400 »
9) » » Fierit	1.900 »	22) » » Lezhës	600 »
10) » » Durrësit	1.900 »	23) » » Tropojës	400 »
11) » » Gjirokastrës	1.100 »	24) » » Mirditës	500 »
12) » » Ersekës	1.300 »	25) » » Pukës	300 »
13) » » Tepelenës	1.000 »	26) » » Skraparit	200 »
		SHUMA:	40.800 »

Për plotësimin e kësaj detyre të madhe, por të mundshme, kërkohet iniciativa dhe puna këmbëngulëse e kooperativave bujqësore, puna sqaruese dhe organizimi i mirë i fshatarësisë nga organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethe, përqëndrimi i të gjitha mundësive që ka çdo rreth, përdorimi i gjithanshëm dhe i plotë i materialeve të vendit në radhë të parë i dheut, i gurit, i gëlqerës, i gardhit, i koritave prej druri etj. Shteti si gjithmonë do të japë, atje ku është e domosdoshme, ndihmë teknike dhe materiale, si eksploziv, çimento etj., por në asnjë rast jo më shumë se 30 për qind të vleftës së përgjithshme të veprës.

Përveç punës këmbëngulëse, sqaruese dhe bindëse të Partisë, dalin detyra të veçanta për organet e pushtetit në qendër, në rrethe e në fshat.

4. — Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Ndërtimit të hartojnë projektet tip për ndërtimin e rezervuarëve dhe të hauzeve për madhësi të ndryshme dhe në përputhje me natyrën e disa vendeve t'i plotësojnë me një përshkrim të qartë e të hollësishëm të procesit të ndërtimit dhe brenda muajit maj të vitit të ardhshëm t'ua kenë dërguar të gjitha rretheve.

5. — Brenda tremujorit të parë të vitit që vjen, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve të organizojnë punën, në mënyrë që të caktohen në çdo kooperativë detyrat konkrete për rritjen e sipërfaqes nën ujë me punën dhe mjetet e kooperativave:

a) Të bëhet inventarizimi i përpiktë i kanaleve ujitëse për të gjithë rrethin me të gjitha karakteristikat e tyre, me gjendjen dhe mundësitë për rritjen e aftësive ujitëse të tyre;

b) Të përshkohen vendet ku mendohet të kalohen kanalet me rrjedhje të lirë, që nga marrja e ujit deri në fund të kanalit, të përcaktohen karakteristikat kryesore teknike të veprës (marrja, prurja e ujit, gjatësia, pjerrësia, lloji i tokës, veprat e artit, sipërfaqja që do të ujitet etj.);

c) Të caktohen vendet ku ka mundësi të ndërtohen rezervuarë dhe hauze, duke vënë në dukje natyrën e vendit, të përroit ose të rrëkesë, llojin e materialit që gjendet në vend (tokën, gurët, drurët etj.), largësinë nga fshati dhe sipërfaqen që pak a shumë kërkohet të ujitet;

ç) Të zgjidhen vendet në ato pika të lumit ose të kanalit të ujitjes ku mund të vendosen çikrikë, rrota me kova, vendet ku mund të hapen puse të thjeshta dhe të vendosen në ta çikrikë ose rripa me kova, duke nxjerrë edhe sipërfaqen që kërkohet të ujitet për çdo njërin nga këto;

d) Të përcaktohen pikat, ku do të vendosen motopompat, dhe gjithë karakteristikat e veprës.

Brenda muajit nëntor të këtij viti, Ministria e Bujqësisë të japë udhëzime të hollësishme mbi këto çështje, në mënyrë që organet dhe organizatat që ngarkohen me kryerjen e kësaj pune të mundin ta kryejnë shpejt dhe mirë.

Kjo punë në rrethe të kryhet në radhë të parë nga agronomët e rretheve dhe të kooperativave, me ndihmën e organizatave të Partisë dhe të rinisë në fshat, të shqyrtohet nga kryesitë e kooperativave bujqësore dhe pastaj nga mbledhjet e përgjithshme. Brenda muajit prill të vitit të ardhshëm, ky studim i konkretizuar kështu të shqyrtohet dhe të aprovohet nga mbledhja e përbashkët e byrove të komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive.

6. — Komitetet ekzekutive të marrin masa që, brenda tremujorit të dytë të vitit të ardhshëm, të ndërtojnë në çdo rreth, me anën e ndërmarrjeve të bonifikimit dhe, atje ku nuk ka ndërmarrje të tilla, me anë të seksioneve të bujqësisë, nga një rezervuar të vogël, i cili të shërbejë si shembull për fshatarësinë. Në punimet e ndërtimit të këtij rezervuari të marrë pjesë nga çdo kooperativë, ku ka mundësi të ndërtohen rezervuarë dhe hauze, një i dërguar, i cili do të jetë më vonë tekniku i kooperativës për ndërtimin e rezervuarit të saj. Gjatë së njëjtës kohë të vendoset nga një çikrik në çdo rreth dhe të përdoret për t'u treguar konkretisht fshatarëve se si punon, sa tokë ujit, me ç'material ndërtohet dhe sa kushton. Ministria e Bujqësisë të japë ndihmën e nevojshme për plotësimin e kësaj detyre brenda afatit të caktuar.

Në mbështetje të punës së përmendur më lart, të projekteve tip të rezervuarëve dhe të hauzeve dhe të eksperiencës që ka fshatarësia në heqjen dhe ndërtimin e vijave ujitëse me rrjedhje të lirë, gjatë tremujorit të dytë të vitit të ardhshëm kooperativat bujqësore të fillojnë ndërtimin e rezervuarëve dhe të hauzeve më të thjeshta, të kanaleve me rrjedhje të lirë dhe të veprave që kërkojnë më pak punë; të përfundojnë rindërtimin e atyre kanaleve që nuk paraqesin vështirësi teknike dhe të vendosin 1-2 çikrikë, sa për fillim. Seksionet e bujqësisë në rrethe të kontrollojnë dhe të ndihmojnë nga ana teknike kooperativat bujqësore për kryerjen e këtyre punimeve.

7. — Planet e dala nga përpunimi, për të cilat flitet në pikën 5, t'i dërgohen Ministrisë së Bujqësisë brenda muajit maj të vitit të ardhshëm, duke theksuar veprat, për të cilat kërkohet ndihmë teknike e materiale, si dhe pajisje nga shteti. Ministria e Bujqësisë ta përpunojë më tej këtë material me shkallë republike, duke bashkëpunuar me kryeagronomët e rretheve për çdo çështje që kërkon sqarime të mëtejshme. Nga ky përpunim të nxjerrë detyrat që i takojnë për ato vepra ku është e domosdoshme ndihma e shtetit dhe të bëjë bashkërendimin e tyre sipas mundësive të projektimit dhe të bazës materiale që ka, duke u nisur nga parimi që shifrat orientuese, të caktuara në këtë plenum, për rritjen e sipërfaqes së ujitshme të arrihen patjetër, bile edhe të tejkalohen, brenda vitit 1965, dhe duke patur parasysh që ndihma e shtetit për projektimet, materialet dhe pajisjet të mos jetë më e madhe se 30 për qind e kushtimit gjithësejt të veprës. Brenda muajit shtator të vitit 1960 Ministria e Bujqësisë t'i dërgojë çdo rrethi planin përkatës, pasi të jetë aprovuar nga Këshilli i Ministrave.

8. — Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Ndërtimit të marrin masat për kryerjen e punës së projektimit në qendër dhe në rrethe për detyrat që dalin nga grafiku i aprovuar sipas pikës së sipërme. Njëkohësisht Ministria e Bujqësisë, me anë të organeve të saj në rrethe, të kontrollojë përfshirjen e veprave në planet vjetore dhe zbatimin e tyre.

9. — Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të vënë në lëvizje organet e tyre përkatëse për hartimin dhe zbatimin e këtij plani, duke synuar që kjo punë të bëhet çështje e madhe e fshatarësisë, dhe të organizojnë emulacionin socialist midis kooperativave dhe lokaliteteve.

10. — Për të patur të dhëna të sakta mbi aftësinë ujitëse të kanaleve, Ministria e Bujqësisë të marrë këto masa:

a) Brenda vitit të ardhshëm të përfundojë «Kadastrën e ujërave», ose regjistrimin e përpiktë të të gjitha kanaleve me karakter kombëtar dhe lokal. Për këtë të nxjerrë të gjitha karakteristikat e veprës, qoftë edhe duke bërë matjen, atje ku nuk gjenden projektet. Kadastra e ujërave për gjithë republikën të mbetet në minis-

tri, kurse çdo rrethi t'i dërgohet kadastra që i takon, e vërtetuar nga ministria.

b) Të përdorë si masë të aftësisë ujitëse të kanalit atë me të cilën vepra është projektuar dhe ndërtuar, të shprehur me njësinë bazë litra/sekondë/ha; por njëkohësisht të japë llogari edhe për «sipërfaqen e ujitur në fakt».

Brenda tremujorit të tretë të vitit 1960 t'i parashtrijë Komitetit Qendror të Partisë dhe Këshillit të Ministrave masat që do të marrë për të ujitur në vitin 1961 një sipërfaqe jo më pak se 85 për qind të aftësive ujitëse të veprave të marra si republikë.

c) Të bëhet rregull që çdo vepër e re ujitëse që ndërtohet, e vogël ose e madhe, si dhe çdo ndryshim në shtimin ose në pakësimin e aftësisë ujitëse të veprave në shfrytëzim, të regjistrohet me të gjitha karakteristikat e saj në kadastrën e ujërave pranë rrethit përkatës, njëkohësisht edhe në ato të qendrës.

ç) Për të kryer të gjitha këto punë për mirëmbajtjen, ndërtim-shfrytëzimin e veprave ujitëse, për të cilat flitet në këtë vendim, të forcohen me kuadro teknike dhe mjete ndërmarrjet e ujërave të Ministrisë së Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive.

11. — Që të përmirësohet brenda kohës më të shkurtër gjendja e shfrytëzimit të sistemeve ujitëse në fshat, porositet Këshilli i Ministrave të rishqyrtojë brenda vitit 1960 të gjitha dispozitat në fuqi mbi marrjen në dorëzim të veprave të ujërave nga ndërmarrjet e ndërtimit, mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre veprave, mbi regjimin e shfrytëzimit të rregullt dhe të plotë të tyre, mbi të drejtat dhe detyrat e organeve qendrore dhe të rretheve për përmirësimin e kësaj pasurie, mbi ujitjen etj. Atje ku nuk ka dispozita shtetërore, të vendosen. Për dispozitat mbi ujitjen të mbështetemi shumë në eksperiencën e çmueshme dhe të lashtë që kanë në këtë mjeshtëri malësitë tona të Veriut.

12. — Ministria e Bujqësisë brenda vitit 1960-1961:

a) Të plotësojë të gjitha veprat ujitëse në fushë, në veçanti ato që administrohen nga ndërmarrjet e saj, me rrjetin e kanaleve të shpërndarjes së ujit, me portat e pritit, atje ku mungojnë të bëhen të gjitha riparimet e sistemeve të ujitjes, të vendosen pajisje për matjen e ujit në pikat kryesore të shpërndarjes, si dhe në pusët (për vrojtimin e ujërave të nëntokës), në mënyrë që çdo sistem të vihet në gjendje që të japë maksimumin e ujit, brenda humbjeve të parashikuara nga projekti, dhe njëkohësisht të krijohen kushtet për përdorimin e plotë të ujit.

b) Të organizojë pranë Institutit të lartë bujqësor një kurs të detyruar për agronomët «Mbi teknikën e shfrytëzimit të veprave ujore, dhe në veçanti mbi ujitjen». Nga çdo rreth, nga Instituti i kërkimeve bujqësore dhe nga NBSH-të, brenda vitit të ardhshëm shkollor, të dërgohet në kurs nga një agronom me shkollë të lartë, i cili më vonë do të merret vetëm me çështjet e ujërave. Agrono-

mët e tjerë me shkollë të lartë dhe të mesme t'i ndjekin detyrimisht me korrespondencë këto kurse. Lënda «Mbi teknikën e shfrytëzimit të veprave ujore, dhe në veçanti mbi ujitjen» bëhet e detyrueshme për të gjithë ata që ndjekin Institutin e lartë bujqësor...

c) Të organizojë në tremujorin e dytë të vitit të ardhshëm kurse praktike të veçanta, në bazë rrethi, për ujitjen me brazda, duke vënë në krye të tyre bujqit më të specializuar nga rrethet e Peshkopisë etj. Në këto kurse, që duhet të zhvillohen pranë fermave dhe kooperativave më të rëndësishme, të marrin pjesë detyrimisht teknikët e ujitjes të ndërmarrjeve të bonifikimit dhe brigadierë nga më të mirët të NBSH-ve dhe të kooperativave bujqësore.

ç) Gjatë stinës së ujitjes të vitit të ardhshëm, rrethet që kanë fushat më të mëdha dhe më pjellore nën ujë, në formë të organizuar nga Ministria e Bujqësisë, të dërgojnë në rrethet Peshkopi etj. bujq të rinj dhe brigadierë që të mësojnë në praktikë, duke punuar, teknikën e ujitjes me brazda dhe rregullat mbi shfrytëzimin e plotë e me leverdi të ujit.

d) Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1960, të marrin në shqyrtim të veçantë çështjen e rregullimit të tokave për ujitje, duke e parë nga ana e mundësive të SMT-ve, të krahëve të punës, të mjeteve etj., dhe të hartojnë një plan të veçantë për përfundimin e kësaj pune në kohën më të shkurtër. Të organizohen seminare të posaçme me punonjësit e SMT-ve, me qëllim që këta të njohin mirë mënyrën e punimit të tokave në përshtatshmëri me kërkesat e relievit, të mbrojtjes së kulturave nga lagështira e shumtë, dhe të sigurohet ujitja e tokave sipas metodave të përparuara, më ekonomike për çdo kulturë. Komitetet ekzekutive, komitetet e Partisë, organizatat e Partisë në NBSH-të dhe në kooperativat bujqësore të quajnë si çështje të ngutshme kryerjen e rrafshimit të tokave, prandaj të vënë të gjitha forcat që kjo punë të përfundojë sa më parë. Organizatat e Partisë në SMT-të gjithashtu të merren në mënyrë të veçantë me këtë çështje, duke bërë punë të vazhdueshme me traktoristët, që këta, me punën e tyre të mos bëhen shkaktarë për prishjen e rrafshimit të fushave, por të ndihmojnë në çdo mënyrë që të kryhet rrafshimi i tokave atje ku mungon dhe të ruhet atje ku është.

13. — Porositet Këshilli i Ministrave që të zgjidhë në kohën më të shkurtër çështjen e vendosjes së normave dhe të afateve më të përshtatshme për ujitjen e bimëve më të rëndësishme.

14. — Instituti i kërkimeve bujqësore të vazhdojë sistematikisht studimet dhe eksperimentet për normat dhe afatet e ujitjes së bimëve të ndryshme, duke patur parasysh vendet dhe tokat e ndryshme. Kjo punë të bëhet sipas një plani të veçantë, i cili duhet t'i paraqitet Këshillit të Ministrave për aprovim.

Për qëllime ujitjeje, Komiteti shtetëror i gjeologjisë të vazhdojë studimin e ujërave arteziane dhe shërbimi hidro-meteorologjik të studijve ujërat e nëntokës.

15. — Me qëllim që t'u pritët rruga përhapjes së farërave të barërave të këqia, duhet të tregohet një kujdes i madh dhe i vazhdueshëm nga ana e kooperativave bujqësore për pastrimin e anëve të kanaleve.

16. — Plenumi porositi Ministrinë e Ndërtimit të tregojë më shumë kujdes për projektimin e veprave të ujërave në bujqësi, të ndihmojë më shumë për projektimin e veprave të vogla, ku është e domosdoshme ndihma e shtetit, dhe gjatë zbatimit të ndërtimeve të mëdha t'i kushtojë vemendje të veçantë kryerjes në afate dhe me cilësi të mirë të veprave të artit krahas kryerjes së gërmimeve. Në planin e ndërmarrjeve të bonifikimit si tregues i rëndësishëm të jetë edhe sasia e sipërfaqeve të tokave që do t'i dorëzohen bujqësisë.

17. — Me qëllim që motopompën e vogla të gjejnë një shfrytëzim më të mirë dhe të plotë, të kalojnë në administrim të drejtpërdrejtë të kooperativave bujqësore.

18. — Plenumi tërheq vëmendjen e organeve të Partisë dhe të pushtetit në bazë në lidhje me punën e pamjaftueshme që është bërë deri më sot në drejtim të mirëmbajtjes së veprave të ujërave, të kanaleve dhe të tharjes, të kullimit dhe të ujitjes nga ana e fshatarësisë, si dhe për pjesëmarrjen e tyre në ndërtimin e veprave të mëdha që po kryhen. Ligjet dhe vendimet përkatëse mbi pjesëmarrjen e detyruar të fshatarësisë në mirëmbajtjen e veprave të ujërave në bujqësi dhe në kryerjen e veprave të mëdha janë në dobi të fshatarësisë dhe të ekonomisë në përgjithësi, dhe si të tilla duhet të gjejnë zbatim të plotë.

Mirëmbajtja e veprave të kryera deri më sot, pjesëmarrja në veprat e mëdha dhe detyrat që shtron plenumi i Komitetit Qendror kërkojnë që çështja e ujitjes së tokave të bëhet problem i të gjithë fshatarësisë. Zbatimi i plotë i këtyre detyrave do të ndikojë në rritjen e rendimenteve të prodhimit bujqësor.

* * *

Duke u mbështetur në klimën dhe në tokën që ka vendi ynë, duke shfrytëzuar më mirë burimet e shumta të ujërave dhe me një zgjedhje më të leverdishme të bimëve që do të mbillen, ne kemi të gjitha mundësitë që të arrijmë përparime të mëdha në rritjen e prodhimeve bujqësore.

Me një punë edhe më të madhe të të gjithë fshatarësisë dhe të specialistëve të bujqësisë, nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës... ne i kemi të gjitha mundësitë, sidomos tani, që kolektivizimi në

fshat është bërë një forcë shumë e madhe, për të plotësuar me sukses detyrat që shtrohen para bujqësisë.

Plenumi shpreh bindjen se fshatarësia jonë patriotike do ta kryejë me nder këtë detyrë me rëndësi që i ngarkohet dhe, ashtu si gjithmonë, nën udhëheqjen e Partisë, do të korrë suksese të mëtejshme drejt triumfit të socializmit në fshatin tonë.

PLENUMI I KOMITETIT QËNDROR TË PPSH

**Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
266, datë 5 nëntor 1959**

PLENUMI XV I KQ TË PPSH

Tiranë, 22-23 dhjetor 1959

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më datën 22 dhe 23 dhjetor 1959 u bë mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha.

Plenumi i Komitetit Qendror dëgjoi dhe diskutoi rreth raportit të Byrosë Politike «Mbi realizimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për periudhën 1956-1959 dhe mbi detyrat e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1960», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Mehmet Shehu.

Plenumi i Komitetit Qendror aprovoi plotësisht raportin e paraqitur dhe mori vendimet përkatëse.

Në këtë mbledhje të plenumit merrnin pjesë edhe sekretarët e parë të komiteve të partisë të rretheve.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nr. 117

VENDIM

**I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH
MBI REZULTATET E ARRITURA NË REALIZIMIN E PLANIT
DHE TË BUXHETIT GJATË KATËR VJETËVE TË
PESËVJEÇARIT TË DYTË DHE DETYRAT E PLANIT
DHE TË BUXHETIT PËR VITIN 1960**

23 dhjetor 1959

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e tij të datës 22 dhjetor 1959 dëgjoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike, mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe Kryetari i Këshillit të

Ministrave të RPSH, shoku Mehmet Shehu, «Mbi realizimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për periudhën 1956-1959 dhe mbi detyrat e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1960».

E udhëhequr në tërë veprimtarinë e saj nga shkencë marksiste-leniniste, Partia jonë e Punës ka forcuar dhe gjallëruar gjatë kësaj periudhe lidhjet me masat, i ka udhëhequr ato me urtësi dhe zotësi në luftën për ndërtimin e socializmit, ka mbajtur një qëndrim të vendosur, parimor, në luftën e ashpër dhe të ndërlukuar kundër revizionizmit modern dhe në mënyrë të veçantë atij jugosllav.

Periudha katërvjeçare 1956-1959 karakterizohet nga suksese shumë të mëdha në jetën politike, ekonomike dhe kulturalë të vendit tonë, nga zhvillimi i mëtejshëm i forcave prodhuese në rrugën e caktuar nga Kongresi III i PPSH dhe Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror për shpejtimin e ritmeve të ndërtimit socialist, nga kryerja me sukses e riorganizimit të bujqësisë mbi baza socialiste, nga zhvillimi i revolucionit kultural, nga përmirësimi i dukshëm i gjendjes materiale të popullit dhe nga përmirësimi i gjithanshëm i metodës së drejtimit të ekonomisë nga ana e organeve ekonomike, shtetërore dhe të Partisë. Një entuziazëm i madh shpërtheu, sidomos këtë vit, në gjirin e klasës sonë heroike punëto-re, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore për nder të 15-vjetorit të çlirimit të Atdheut. . .

Në sajë të hovit të madh në punë të masave punonjëse, ndihmës së Bashkimit Sovjetik, në radhë të parë, dhe të vendeve të demokracisë popullore, plani i zmadhuar për katër vjetët e pesëvjeçarit të dytë (me shtesat e aprovuara në Plenumin e shkurtit 1958 të KQ) u realizua me sukses në prodhimin e përgjithshëm industrial, në ndërtimet, në transport, në qarkullimin e mallrave të konsumit, në përgatitjen e kuadrove, në uljen e kostos së prodhimit etj.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH zhvilloi punimet e veta në frymën e një analize të thellë, të një kritike dhe autokritike të shëndoshë për punën e kryer deri tani dhe përcaktoi detyrat dhe rrugët që sigurojnë realizimin me sukses të planit të vitit 1960, viti i fundit dhe vendimtar i planit të dytë pesëvjeçar.

Duke analizuar rezultatet e realizimit të planit për periudhën katërvjeçare, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH konstatoi:

— I —

1. — Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial për periudhën 1956-1959 parashikohet të arrijë 95 miliard e 900 milion lekë, kundrejt 89 miliard e 900 milion lekë të planit të aprovuar nga Kongresi III i PPSH dhe 95 miliard e 700 milion lekë të planit të

zmadhuar ose përkatësisht 107 për qind dhe 100 për qind. Plani i prodhimit të përgjithshëm industrial për vitin 1959 parashikohet të realizohet 101 për qind, ose 100 për qind kundrejt planit të zmadhuar. Shumë degë të rëndësishme si industria e kromit, e bakrit, e energjisë elektrike, industria mekanike, industria e lehtë etj. kanë realizuar dhe tejkaluar planin e zmadhuar 1956-1959.

Në vitin 1959, në krahasim me vitin 1955, rendimenti i punës për prodhimin e përgjithshëm industrial parashikohet të rritet 41 për qind, duke siguruar rreth 52 për qind të shtimit të prodhimit, ndërsa kostua e prodhimit për ndërmarrjet e Ministrisë së Industrisë dhe të Minerave parashikohet të ulet 19,4 për qind kundrejt 17 për qind që ishte vënë si detyrë nga Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH vëren se sukseset në lëmin e prodhimit industrial do të ishin edhe më të mëdha, në qoftë se organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë do të merrnin masat e duhura për të nxjerrë nga prapambetja industrinë e naftës, industrinë ushqimore, të materialeve të ndërtimit, të lëndës së drurit, të cilat kanë krijuar deficite të ndijshme në ekonominë popullore, sidomos në eksport.

Të pakënaqshme janë rezultatet e arritura në sektorin e gjeologjisë, sidomos në naftë e krom, ku realizimi i vëllimit të punimeve nuk është shoqëruar me krijimin e rezervave të parashikuara në plan, duke vënë në vështirësi punën e disa minierave.

Të pamjaftueshme kanë qënë masat e marra për të përdorur në dobi të shtimit të mëtejshëm të prodhimit industrial rezervat që fshihen në përdorimin e kohës së punës, në shfrytëzimin e maqinerisë dhe në realizimin ritmik të planit.

2. — Në sektorin e bujqësisë, gjatë këtyre katër vjetëve, janë arritur suksese të rëndësishme. Në vitin 1959, në krahasim me vitin 1955, vëllimi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor parashikohet të arrijë 26 për qind më shumë dhe për disa artikuj si vijon: drithëra buke 22 për qind, mish 32 për qind, qumësht 15 për qind, duhan 73 për qind, pambuk 47 për qind më shumë etj.

Plenumi vëren me kënaqësi se deri në fund të muajit tetor 1959 kooperativat bujqësore përfshinin rreth 82 për qind të sipërfaqeve të mbjella të fshatarësisë, kundrejt 14,5 për qind që ishte në fund të vitit 1955. Kjo do të thotë se riorganizimi i bujqësisë mbi baza socialiste, në përgjithësi, ka përfunduar dhe detyra e caktuar nga Kongresi III i Partisë në këtë drejtim u realizua një vit para afatit, duke korrur kështu një fitore me rëndësi historike në luftën për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Gjatë kësaj periudhe ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe stacionet e maqinave e të traktorëve janë forcuar nga pikëpamja ekonomike dhe në përgjithësi kanë dalë nga prapambetja.

Me gjithë këtë, në sektorin e bujqësisë janë vërtetuar një varg të metash e dobësish të mëdha. Në prodhimin bujqësor nuk janë realizuar detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë dhe atë pak detyrat e caktuara nga Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror; janë krijuar deficite të ndijshme sidomos në prodhimin e drithërave të bukës e të bimëve industriale.

Realizimi i pakënaqshëm i planit të prodhimit bujqësor e blegtoral është e meta kryesore që ka penguar seriozisht ekonominë popullore të vendit.

3. — Gjatë katër vjetëve 1956-1959 parashikohet të realizohet një vëllim investimesh prej 35 miliard e 700 milion lekë, ose 37 për qind më shumë se detyra e caktuar nga Kongresi III i Partisë dhe 97 për qind në krahasim me detyrën e caktuar nga Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror. Plani i ndërtimeve është realizuar në masën 17 miliard e 500 milion lekë, ose 29 për qind më shumë se detyra e caktuar nga Kongresi III i Partisë dhe 4 për qind më shumë se detyra e caktuar nga Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror.

Në vitin 1959, në krahasim me vitin 1955, rendimenti i punës në ndërtim është rritur 25 për qind, ndërsa kostua është ulur 21,5 për qind. Plani i ndërtimeve për vitin 1959 parashikohet të realizohet 102 për qind.

Kanë përfunduar së ndërtuari dhe janë vënë në shfrytëzim vepra me rëndësi të madhe: Uzina e përpunimit të naftës në Cërrik me vajgur-sjellësin, Hidrocentrali «Karl Marks», Fabrika e kadi-fesë dhe ajo e qelqit në Tiranë, e likusit në Elbasan, Kombinati i konservave «E. Telman» në Vlorë, tri fabrikat e konservimit të frutave e perimeve në Korçë, Shkodër, Elbasan; përfundoi bonifikimi i fushave të Zadrimës, të Mursisë, pjesërisht të Myzeqesë, të Vurgut, të Thumanës e të Roskovecit. U vunë në përdorim ujësje-llësi i Durrësit, i Fierit, i Beratit dhe i Lushnjës, dy hotele turistike në Durrës, teatri në Shkodër, Korçë e Vlorë, me dhjetëra shkolla, spitale etj. Kanë hyrë në fazën përfundimtare edhe një sërë ve-prash të tjera të mëdha, si Fabrika e pasurimit të bakrit në Kur-bnesh, fabrikat e tullave në Lushnjë, Vlorë e Shkodër, Kombinati ushqimor në Tiranë etj. Janë ndërtuar gjithsej 569 mijë metra katrore shtëpi banimi, duke tejkalluar detyrën e vënë nga kongresi dhe Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror.

Të metat kryesore në sektorin e ndërtimit kanë qenë dhe mbe-ten zvarritjet në dorëzimin e veprave, si rrjedhim i shpërndarjes së forcave në të njëjtën kohë në shumë objekte, gabimet në pre-ventimin e objekteve, përpjekjet e pamjaftueshme për shfrytëzi-min e rezervave të mëdha për uljen e kostos.

4. — Transporti automobilistik parashikohet të realizojë pla-nin e zmadhuar të katër vjetëve 1956-1959 në masën 105 për qind

për transportin e mallrave, nga i cili Ministria e Komunikacionit 104 për qind, transporti hekurudhor i mallrave 110 për qind, ndërsa transporti detar e tejkallon detyrën e kongresit 17 për qind. Me gjithë përmirësimet e dukshme, të metat kryesore në transport janë: mosarritja e koeficientit të përdorimit të automjeteve, si rezultat i dobësive në mirëmbajtjen e tyre, në kryerjen jo në kohë të ripari-meve dhe në përdorimin fare të paktë të rimorkiove. Veçanërisht i dobët është shfrytëzimi i automjeteve që administrohen nga dikas-teret dhe ndërmarrjet e ndryshme.

5. — Treguesit kryesorë që karakterizojnë përmirësimin e mëtejshëm të nivelit material e kultural të popullit janë rritur në mënyrë të kënaqshme. Të ardhurat kombëtare në vitin 1959, në krahasim me vitin 1955, rriten 46 për qind. Paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve rritet 29 për qind më shumë se në vitin 1955, baras me detyrën e caktuar nga Plenumi i shkurtit 1958 i Komi-tetit Qendror.

Vëllimi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave parashikohet të realizohet 114 për qind kundrejt detyrës së caktuar nga Kongresi III i Partisë, dhe 100 për qind kundrejt detyrës së caktuar nga Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror. Në tregëtinë shtetë-rore shpenzimet e qarkullimit në vitin 1959, në krahasim me vitin 1955, ulen 22,4 për qind, kundrejt 18,6 për qind të planit të zma-dhuar, dhe në kooperativat e konsumit 18 për qind, kundrejt 15,4 për qind. Shtimi i prodhimit industrial e bujqësor, heqja e plotë e sistemit të triskëtimit, zbritja nga viti në vit e çmimeve të shitjes me pakicë të mallrave të konsumit të gjerë si dhe masat e tjera që u muarën nga Partia dhe qeveria kanë përmirësuar në mënyrë të dukshme furnizimin e popullit me artikuj industrialë e ush-qimorë.

Me gjithë përmirësimet e arritura, në sferën e qarkullimit vër-tetohen një sërë të metash. Organet e tregëtisë nuk thellohen në studimin e gustos së konsumatorëve, nuk luftojnë si duhet për uljen e shpenzimeve të panevojshme, shërbimi në rrjetin tregëtar bëhet me të meta të mëdha.

Suksese të mëdha janë arritur edhe në sektorin social-kultural. U hap për të parën herë Universiteti shtetëror, është zgjeruar rrjeti i shkollave, i vatrave dhe i shtëpive të kulturës, është përmirësuar shërbimi shëndetësor i popullit.

6. — Gjatë kësaj periudhe buxheti i shtetit parashikohet të realizohet 101 për qind për të ardhurat dhe 96 për qind për shpen-zimet. Është siguruar financimi i rregullt i ekonomisë dhe i kul-turës dhe janë përballuar me sukses masa shumë të rëndësishme ekonomike të ndërmarra nga Partia dhe qeveria për ngritjen e pa-gave dhe të pensioneve të ulëta, për ngritjen e çmimeve të grumbu-llimit të detyrueshëm, për heqjen e detyrimeve për disa artikuj

bujqësorë e blegtoralë etj. Sektori socialist i ekonomisë në vitin 1959 siguron rreth 84 për qind të të ardhurave kundrejt 72 për qind që ishte në vitin 1956. Të ardhurat e buxhetit për vitin 1959 parashikohet të plotësohen 99 për qind dhe shpenzimet 96 për qind.

Rezultatet e realizimit të planit të katër vjetëve 1956-1959 dëshmojnë, në radhë të parë, se shtesat që ju bënë planit të dytë pesëvjeçar nga Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror kanë qenë të drejta.

Sukseset e arritura janë një bazë e shëndoshë materiale për realizimin e planit të vitit të fundit të pesëvjeçarit të dytë si dhe për të filluar mbarë punën për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar.

Megjithatë, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH vëren se këto rezultate do të ishin edhe më të mëdha, në qoftë se detyrat e planit do të ishin realizuar plotësisht edhe në degët e tjera me rëndësi shumë të madhe për ekonominë popullore. Në punën e organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë për drejtimin e industrisë dhe të degëve të tjera të ekonomisë popullore kanë ekzistuar të meta të theksuara në këto drejtime kryesore:

a) Në prirjen e dëmshme antiekonomike, që synon në realizimin e planit në vleftë, prodhim global, duke shkelur pa të keq nomenklaturën e planifikuar.

b) Në cilësinë e dobët të prodhimit. Shumë drejtues të ekonomisë, duke rendur pas sasisë, kanë lënë pas dore problemin shumë të rëndësishëm të cilësisë së prodhimit.

c) Në mungesën e një regjimi të rreptë kursimi. Nuk është luftuar kudo dhe kurdoherë prirja shumë e dëmshme antishtetërore e planifikimit të shpenzimeve të fryra dhe e të ardhurave minimale. Organizatat e Partisë nuk kanë luftuar me forcë për të ngjallur tek çdo punonjës ndjenjën e kursimit dhe të përdorimit racional të fondeve materiale dhe monetare të shtetit.

Të pamjaftueshme kanë qenë përpjekjet për të shkurtuar importin dhe për të tejkaluar planin e eksportit në sasi, cilësi, asortiment dhe në kohën e duhur.

Organet qendrore të drejtimit të ekonomisë nuk kanë siguruar zbatimin në kohë të masave të caktuara nga Komiteti Qendror dhe nuk kanë ushtruar kontroll të rreptë e sistematik për realizimin e detyrave të planit.

Të pamjaftueshme kanë qenë përpjekjet për shfrytëzimin e kapaciteteve ekzistuese, si dhe të rezervave të tjera të brendshme. Puna organizative dhe politike nuk i përgjigjet sa duhet nivelit të sotëm të detyrave ekonomike. Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë me ngadalësi e realizojnë kthesën që kërkohet për t'u hyrë në thellësi problemeve ekonomike për të kaluar nga drejtimi në disa raste «në përgjithësi» në drejtimin e vazhdueshëm konkret të tyre.

Mbështetur në direktivat e Kongresit III të Partisë dhe në shtesat e aprovuara nga Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror, në rezultatet e arritura gjatë këtyre katër vjetëve të pesëvjeçarit të dytë... Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH,

Vendosi:

1. — Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial për vitin 1960 të arrijë në 34 miliard e 214 milion lekë, ose 11 për qind më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 1959, dhe sipas degëve të arrihet kjo rritje: industria e naftës 18 për qind, qymyrgurit 3 për qind, e nxjerrjes së kromit 17 për qind, e nxjerrjes së hekur-nikelit 47 për qind, e energjisë elektrike 17 për qind, e industrisë mekanike dhe e përpunimit të metaleve 18 për qind, e materialeve të ndërtimit 34 për qind, e lëndës së drurit 12 për qind, e qelqit dhe e qeramikës 19 për qind, industria e lehtë 6 për qind, industria ushqimore 39 për qind etj. Rendimenti i punës për prodhimin e përgjithshëm industrial të rritet 12 për qind, ndërsa kostua të ulet 5 për qind, duke realizuar një kursim prej 905 milion lekësh.

Për realizimin e këtyre detyrave dhe për të zvogëluar diferencën midis nivelit të prodhimit të përgjithshëm industrial të aprovuar në Plenumin e shkurtit 1958 të Komitetit Qendror dhe detyrës së caktuar për vitin 1960, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH e quan të nevojshme:

a) Organizatat e Partisë, drejtorja e Kombinatit të naftës dhe Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë të analizojnë në frymën e një kritike dhe autokritike të shëndoshë partie punën e kryer, t'u japin fund të metave dhe dobësive të mëdha dhe të marrin masa energjike për të nxjerrë njëherë e mirë nga prapambetja industrinë e naftës, këtë degë shumë të rëndësishme të ekonomisë popullore. Përmirësimi rrënjësor i gjendjes në industrinë e naftës kërkon nga organizatat e Partisë një punë këmbëngulëse për vendosjen e një disipline të fortë në administrimin e pasurisë, në ngritjen e përgjegjësisë personale të çdo punonjësi për zbatimin e detyrave. Të respektohen me rreptësinë më të madhe rregullat teknike të shpimit, me qëllim që të mënjanohej avaritë dhe të papriturat, si dhe të përmirësohen treguesit tekniko-ekonomikë, duke përgjithësuar eksperiencën e brigadave të përparuara.

Realizimi i kthesës rrënjësore në industrinë e naftës të konsiderohet detyra më e rëndësishme e ditës në sektorin e prodhimit industrial.

b) Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë të marrë masa efektive për realizimin e detyrave të planit. Të bëhet rregullat që plani

në gjeologji të vlerësohet jo me vëllimin e punimeve të kryera, por me sasinë dhe cilësinë e rezervave që vihen në dobi të ekonomisë.

c) Ministria e Industrisë, komitetet ekzekutive dhe organizatat e Partisë të konsiderojnë detyrë të kohës nxjerrjen nga prapambetja të industrisë ushqimore, të sektorit të prodhimit të tullave dhe të industrisë së lëndë-drurit.

Kujdes i posaçëm t'i kushtohet nxjerrjes nga prapambetja të sektorit të peshkimit, i cili për shkak të të metave dhe dobësive serioze vite me radhë nuk po realizon detyrat e planit. Komitetet e Partisë të rretheve Durrës, Vlorë, Lezhë Sarandë, Shkodër, Korçë, Pogradec dhe Lushnjë, duke mos nxjerrë mësim nga e kaluara, nuk kanë ndihmuar organizatat bazë të Partisë në ndërmarrjet dhe kooperativat e peshkimit për t'i dhënë fund njëherë e mirë të metave serioze dhe shthurjeve që vërtetohen në organizimin e punës.

Të merren të gjitha masat për të përmirësuar punën në industrinë e konservimit të frutave e të perimeve. Organet lokale të pushtetit të sigurojnë furnizimin pa ndërprerje të fabrikave me lëndë të parë. Të përfundojë brenda afatit rikonstruksioni dhe ndërtimi i fabrikave të reja dhe të merren në kohë masat për përgatitjen e kuadrit të nevojshëm për vënjen e tyre në shfrytëzim.

ç) Në sektorin e artizanatit të merren të gjitha masat për të përballoar plotësisht kërkesat e përditshme të popullit për riparime, shërbime e shërbim ndërtim, të zgjerohet sa më shumë prodhimi i vogël e artizan dhe i artikujve artistikë mbi bazën e lëndës së parë lokale. Kooperativat e artizanatit të punojnë seriozisht për përgatitjen e kuadrove të kualifikuar për rrobaqepësinë, qëndisjet artistike, argjendarinë etj., që janë profesione të rralla dhe shumë të vështira për t'u përvetësuar.

d) Organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë të marrin të gjitha masat për të forcuar drejtimin e prodhimit; të ngrejnë në një shkallë më të lartë organizimin e punës dhe të përmirësojnë më tej ndihmën dhe kontrollin për bazën.

Plenumi porositi qeverinë t'i paraqesë Presidiumit të Kuvendit Popullor propozimet përkatëse për ndarjen e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave në Ministrinë e Minierave dhe të Gjeologjisë dhe në Ministrinë e Industrisë. Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë të përfshijë minierat, industrinë e naftës dhe gjeologjinë, duke suprimuar Komitetin shtetëror të gjeologjisë, ndërsa Ministria e Industrisë të përfshijë të gjitha aktivitetet e tjera industriale që kishte gjer tani Ministria e Industrisë dhe e Minierave.

2. — Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor për vitin 1960 të arrijë në 35,1 miliard lekë, ose 33 për qind më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 1959. Sipërfaqet nën kulturë të rriten 11 për qind, ndërsa mbjelljet e dyta të arrijnë 108 mijë ha. Prodhimi i drithërave të bukës të rritet 28 për qind, i pambukut 42 për qind

dhe i duhanit 21 për qind. Në vitin 1960 të hapen 33.800 ha tokë të reja për ara dhe kultura drurore.

Rendimenti i kulturave kryesore bujqësore për vitin 1960 të jetë: për grurin 14 kv/ha, për misrin 16 kv/ha, për pambukun 11,2 kv/ha, për duhanin 8,3 kv/ha, për panxhar sheqerin 237,6 kv/ha, për orizin 32,5 kv/ha.

Mekanizimi i proceseve të punimeve bujqësore të arrijë: në plugime 80 për qind, në prashitje 35 për qind, në mbjelljet e pranverës 60 për qind, të vjeshtës 60 për qind, në korrjet 40 për qind dhe në shirjet 70 për qind. Rendimenti i qumështit të lopëve të rritet për të gjithë republikën nga 550 në 830 kg. mesatarisht për çdo lopë. Numri i dhenve të rritet 4,3 për qind, i dhive 9,2 për qind, i dosave 39,1 për qind dhe i shpendëve 27,9 për qind. Mbajlljet e vreshtave të shtohen 15 për qind dhe të pjergullave 9 për qind.

Në vitin 1960 të grumbullohen më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 1959: drithëra buke 35 për qind, fasule 67 për qind, pambuk 47 për qind, panxhar sheqeri 13 për qind, duhan 24 për qind, perime 39 për qind, patate 59 për qind, fruta 62 për qind, rrush 200 për qind, qumësht 52 për qind, mish 24 për qind, lesh 40 për qind.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH tërheq vëmendjen e organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë për faktin se detyrat e planit të vitit 1960 në lëmin e prodhimit bujqësor e blegtoral janë të rënda. Realizimi i këtyre detyrave kërkon me doemos një drejtim më konkret dhe të vazhdueshëm të problemeve të bujqësisë dhe një luftë më të vendosur kundër mbeturinave të theksuara si vetëkënaqësia, pjesëmarrja e paktë e krahëve të punës në kooperativat bujqësore në punët bujqësore dhe të tjera dobësi që vërtetohen në fshat. Duhet të arrijmë me çdo kusht që udhëheqësit e kooperativave bujqësore dhe masa e kooperativistëve të zbatojnë pa u lëkundur detyrat që i ngarkojnë vetes si dhe metodat e përparuara në bujqësi, duke e përqëndruar vëmendjen në zgjidhjen e këtyre detyrave:

a) Me qëllim që të përballohet pengesa objektive e lagështirës së madhe në kohën e mbjelljeve të pranverës dhe të vjeshtës si dhe thatësitrat e mëdha në kohën e verës, është e nevojshme dhe detyrë imediate për Partinë dhe për organet ekonomike shtetërore që mbjelljet si në pranverë ashtu dhe në vjeshtë të përfundojnë në kondita optimale agroteknike. Përfundimi në këto kushte i mbjelljeve është kyçi kryesor për rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore.

Për të përmirësuar agroteknikën, organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë duhet të marrin masa për plehërimin e tokës, për sigurimin e farës së nevojshme në sasi dhe cilësi të mirë, për kryerjen në kohë të shërbimeve kulture.

Për zbatimin e këtyre detyrave kërkohet mobilizimi i plotë i fshatarësisë që në stinën e dimrit.

b) Të shfrytëzohet plotësisht fuqia e SMT-ve dhe e mekanikës bujqësore për të kryer me sukses mbjelljet. Riparimi i traktorëve dhe i maqinave të tjera bujqësore të bëhet kryesisht në stinën e dimrit. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të ndjekin dhe të kontrollojnë zbatimin e grafikut dhe cilësinë e riparimeve në SMT-të dhe NBSH-të.

Kujdes i posaçëm t'i kushtohet shfrytëzimit të forcës tërheqëse të kafshëve, të arrihet që për shumicën e pendëve në fushë si në kooperativat, ashtu edhe në NBSH-të të sigurohet qerrja për transport.

c) Në sektorin e bujqësisë duhet të përdoret në mënyrë racionale forca e krahut të punës. Organizatat e Partisë, kryesitë e kooperativave bujqësore dhe organet lokale të pushtetit ta kuptojnë drejt se mobilizimi i të gjithë krahëve të aftë për punë është rezervë e madhe për shtimin e prodhimit bujqësor. Nga ana tjetër, ata duhet të mobilizojnë fshatarësinë në punimet e bonifikimit, ku pjesëmarrja është jashtëzakonisht e pakët.

ç) Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH tërheq vëmendjen e organizatave të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë për faktin se detyrat e Plenumit të nëntorit 1958 të Komitetit Qendror mbi shtimin e qumështit dhe të mishit nuk po gjejnë zbatim të plotë. Organet e ngarkuara me zbatimin e detyrave të këtij vendimi i kanë trajtuar ato si çështje të rëndomta, nuk i kanë vlerësuar në tërë përmbytjen e tyre.

Për zbatimin e detyrave të shtimit të qumështit dhe të mishit duhet të merren masat për sigurimin e bazës ushqimore dhe për strehimin e blegtorisë, duke përhapur eksperiencën e kooperativës bujqësore të përparuar të Ajazmës, si dhe të kooperativave të tjera.

d) Për të përballuar detyrat e caktuara të planit të vitit 1960 për fruti-vitikulturën, është e nevojshme të kuptohet një herë e mirë se realizimi i planit të fruti-vitikulturës duhet vlerësuar jo me mbjelljen, por me numrin e pemëve dhe të hardhive që kanë zënë.

dh) Plenumi e quan të nevojshme të vejë në dukje se plani i grumbullimeve, dhe sidomos i tepricave të drithit për vitin 1960, rritet në mënyrë të konsiderueshme. Janë të gjitha mundësitë që ai të realizohet me sukses, në qoftë se organet e grumbullimit do të përmirësojnë rrënjësisht punën e tyre, në qoftë se organizatat e Partisë dhe organet lokale të pushtetit do t'i japin fund neglijencave që janë vërtetuar në punën e tyre, sidomos në këta dy vjetët e fundit. Plotësimi i planit të grumbullimit të detyrueshëm dhe të tepricave duhet të merret si bazë për vlerësimin e punës së organeve të grumbullimit, të pushtetit lokal, të organizatave të Partisë dhe të ekonomive bujqësore.

e) T'i kushtohet vëmendje e posaçme përmirësimit rrënjësor të cilësisë së duhanit.

Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive dhe të Partisë në rrethe të ndihmojnë konkretisht fshatarësinë për ngritjen e hangareve, ta mobilizojnë atë për kryerjen e të gjitha shërbimeve teknike dhe agroteknike dhe të drejtojnë nga afër manipulimin e duhanit për të përmirësuar cilësinë e tij, masë kjo që do të sigurojë të ardhura më të mëdha për kooperativat bujqësore dhe për ekonominë tonë në përgjithësi.

3. — Vëllimi i përgjithshëm i investimeve për vitin 1960 të arrijë 12 miliard e 440 milion lekë, ose 2 për qind më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 1959, me këtë peshë specifike: në miniera 21.4 për qind, në industri 22,0 për qind, në bujqësi 16,5 për qind, Ndërtimet të arrijnë në 5 miliard e 864 milion lekë, me këtë peshë specifike: në sektorin prodhues 68,7 për qind dhe në sektorët jo-prodhues 31,3 për qind. Të vazhdojnë punimet për rindërtimin dhe zgjerimin e Uzinës së përpunimit të naftës në Cerrik, të Fabrikës së çimentos «V.I. Lenin» në Vlorë, të Fabrikës së sheqerit «8 Nëntori» në Maliq, për ndërtimin e hidrocentraleve të Bistricës dhe të Shkopetit, të Kombinatit ushqimor në Tiranë, të Fabrikës së mobiljeve të përkulura në Elbasan, të frigoriferëve në Tiranë, në Korçë dhe në plazhin e Durrësit, të Kombinatit të mishit në Tiranë; për bonifikimin e fushave të Myzeqesë, të Vurgut, të Thumanës, të Roskovecit, për rindërtimin dhe zgjerimin e portit të Durrësit, për asfaltimin e rrugëve Milot Klos, Fier-Ura vajgurore, Pishkash-Qafa e Thanës etj. Të fillojnë punimet për ndërtimin e filaturës në Korçë, të Fabrikës së briketit të gymyrit në Tiranë, të Fabrikës së gozhdëve, të fabrikave të përpunimit të rushtit dhe të frutave, në Elbasan, në Shkodër, në Berat, në Bilisht, në Pogradec, të Fabrikës së bukës në Tiranë etj. Të ndërtohen banesa për punonjësit me një sipërfaqe të përgjithshme rreth 224 mijë metra katrore, ose 4 për qind më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 1959. Rendimenti i punës në ndërtim dhe montim të rritet 10 për qind dhe kostua të ulet 14.3 për qind kundrejt preventivave me çmimet e vitit 1958.

Për realizimin e këtyre detyrave Plenumi i Komitetit Qendror e quan të nevojshme të merren këto masa:

a) Të sigurohen me kohë projektet dhe preventivat dhe të mos lejohet fillimi i punimeve të ndërtimit në veprat që nuk janë pajisur me projekte. Në projektim të përhapet gjerësisht tipizimi dhe standardizimi, të synohet në kursimin maksimal të fondeve e të materialeve pa prekur në asnjë mënyrë cilësinë.

Të rritet kujdesi dhe kontrolli i punëdhënësve në hartimin, zbatimin dhe dorëzimin në afat të veprave.

b) Përfundimi në kohë i veprave të konsiderohet detyrë kryesore në ndërtim. Për këtë t'i kushtohet kujdes hartimit dhe zbatimit.

mit të grafikëve: t'i jepet fund shpërndarjes së forcave të ndërtimit në sa më shumë vepra.

4. — Vëllimi i punës së transportit të mallrave me automjete për të gjithë republikën të arrijë në rreth 350 milion ton/km., ose 18 për qind më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 1959, nga i cili Ministria e Komunikacionit 214,3 milion ton/km., ose 12 për qind më shumë. Në transportin hekurudhor të mallrave vëllimi i punës të arrijë në 57,2 milion, ose 22 për qind më shumë, dhe në transportin detar 173,6 milion ton/mila, ose afro njëherë më shumë. Në transportin e udhëtarëve vëllimi i punës të arrijë në 310 milion e 800 mijë udhëtarë/km., ose 2 për qind më shumë. Rendimenti i punës në transportin automobilistik të rritet 7 për qind, në transportin hekurudhor 6 për qind, ndërsa kostoja të ulet 6,5 për qind, duke realizuar një kursim prej 106 milion lekë.

Për t'ju përgjegjur më shpejt nevojave të qarkullimit të mallrave, në sektorin e komunikacioneve u duhet dhënë fund të metave të vërtetuara. Të merren masa konkrete për të rritur koeficientin e përdorimit të automjeteve me anën e përmirësimit të shërbimit të mirëmbajtjes dhe të riparimit të tyre, duke e konsideruar këtë si rezervë më të madhe në transport. Të merren masat e duhura për përdorimin sa më të gjerë të rimorkiove.

Një kujdes i posaçëm t'i kushtohet përhapjes së eksperiencës së përparuar midis shoferëve, lëvizjes për të bërë 100-600 mijë km. pa riparim kapital të automjetit.

Për të shpejtuar qarkullimin e shpejtë të mjeteve nga ana e organeve të transportit dhe e punëdhënësve të organizohet më mirë shërbimi i ngarkim shkarkimit.

5. — Komiteti Qendror i PPSH gjithnjë ka berë të ditur se përmirësimi i mirëqënjes materiale dhe ngritja e nivelit kultural të masave punonjëse është ligji më i lartë i Partisë.

Mbi bazën e rritjes së prodhimit industrial e bujqësor, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH cakton këto detyra për ngritjen e nivelit ekonomik dhe kultural të masave punonjëse për vitin 1960: vëllimi i të ardhurave kombëtare, në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 1959, të rritet 18 për qind më shumë, paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve 6 për qind.

Në vitin 1960 vëllimi i përgjithshëm i qarkullimit të mallrave të arrijë në 25 miliard e 500 milion lekë, ose 12 për qind më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 1959. Shitja e mallrave të konsumit të gjerë të rritet mesatarisht për çdo frymë të popullsisë në këtë masë: sheqer 23 për qind, oriz 9 për qind, sapun 24 për qind, tekstile të pambukta 7 për qind, të leshta 8 për qind, këpucë gjithsejt 33 për qind. Shitja mesatare për çdo frymë të popullsisë së qytetit të rritet: në yndyrna 12 për qind, në fasule 5 për qind, në mish 42 për qind, në peshk 8 për qind, në djathë 47 për qind, në qumësht 55 për qind, në birrë 44 për qind etj.

Numri i nxënësve në shkollat fillore, shtatëvjeçare dhe të mesme për vitin shkollor 1960-1961 të jetë 8 për qind më i madh se në vitin shkollor të mëparshëm, ndërsa numri i studentëve në shkollat e larta të jetë 12 për qind më i madh. T'i kushtohet kujdes i posaçëm nga organet ekonomike dhe shtetërore ngritjes së nivelit arësor e profesional të punëtorëve, duke e konsideruar këtë pjesë të pandarë të planit ekonomik. Të hapen 68 kopshte të reja dhe numri i përgjithshëm i fëmijëve me ushqim të rritet 19 për qind.

Institucionet e mjekimit të rriten 2 për qind kundrejt vitit 1959 dhe numri i shtretërve 5 për qind, numri i fëmijëve në çerdhe të jetë 13 për qind më shumë se në vitin 1959.

a) Për realizimin e këtyre detyrave organet e tregëtisë të përmirësojnë rrënjësisht punën, t'i shërbejnë më mirë popullit, të ndjekin dhe të kënaqin në kohën e duhur guston e konsumatorëve.

Kooperativat e konsumit të kujdesen në mënyrë të posaçme për shtrirjen e rrjetit në fshat, të marrin masa për centralizimin e qendrave të grumbullimit dhe të përpunimit të qumështit.

Organet e tregëtisë shtetërore dhe kooperativiste, të grumbullimit dhe organizatat e Partisë të mos lejojnë shpërdorimin e bukës dhe të marrin masa për kursimin e mëtejshëm të saj.

b) Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së mësimit dhe forcimi i lidhjes së teorisë me praktikën të konsiderohen e vetmja metodë e drejtë e punës mësimore. Të forcohet disiplina e mësimit sidomos në arësimitarët e fshatit.

Të përmirësohet patronazhi i shkollave të qyteteve nga ana e ndërmarrjeve, të shtrihet ai edhe në shkollat e fshatrave.

Për të përmirësuar punën në shkollat e fshatit, komitetet ekzekutive dhe të Partisë të mobilizojnë kooperativat bujqësore, këshillin popullor dhe organizatat bazë të Partisë në fshat për sigurimin e bazës materiale. Të përhapet iniciativa e arësimitarëve dhe e kooperativës së Bishqemit, për pajisjen e nxënësve me uniformë, e kooperativës së Konispolit për ndërtimin e internatit dhe e kooperativës së Pojanit për ndërtimin e shkollës shtatëvjeçare me shpenzimet e veta.

Bursat për përgatitjen e specialistëve dhe të teknikëve të mësim dhe të ulët, që u nevojiten kooperativave bujqësore, të përballohen nga shpenzimet e vetë kooperativave.

c) Organet e shëndetësisë duhet të marrin masa për përmirësimin e shërbimit të tyre, në radhë të parë të përmirësojnë marrjen e masave profilaktike, higjienën e popullit.

ç) Ndërmarrjet komunale të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve për popullin, të plotësojnë në kohë nevojat e tij për dru zjarrri, të marrin masa serioze për mirëmbajtjen dhe zbukurimin e banesave dhe të qyteteve.

6. — Vëllimi i përgjithshëm i importit për vitin 1960 të jetë

5,3 për qind më pak dhe ai i eksportit 33,5 për qind më shumë se në vitin 1959.

Organet përkatëse të prodhimit dhe të tregëtisë të jenë plotësisht të ndërgjegjshme për rëndësinë e këtyre detyrave kaq të mëdha, sidomos për eksportin. Organet e tregëtisë të përmirësojnë punën për sigurimin e tregut të jashtëm, të bëhen nxitës dhe të kontrollojnë organet përkatëse të prodhimit për zbatimin e kontratave për eksportimin e mallrave.

I rekomandohet Këshillit të Ministrave që të mbajë qëndrim për të gjithë ato dikastere dhe organizata ekonomike, të cilat nuk realizojnë detyrimet që kanë për eksportin. Të ngarkojë Ministrinë e Tregëtisë që në fund të çdo tremujori të shqyrtojë bilancin e import-eksportit, dhe ndërmarrjeve dhe organizatave, të cilat nuk kanë realizuar detyrimet për eksportin, t'u blokojë materialet e importit në masë të barabartë me mosrealizimin e planit të eksportit.

Të bëhet rregull që në çdo tremujor detyrat e eksportit dhe të importit të shqyrtohen në mbledhjet e kolegjumeve të dikastereve, të këshillave teknike të ndërmarrjeve, dhe në kryesitë e komiteve ekzekutive. Plani i import-eksportit të shqyrtohet gjithashtu në mbledhjet e byrove të komiteteve të Partisë.

T'u pritet rruga porosive të fryra për import, të dënohet si prirje e dëmshme antishtetërore porositja e materialeve mbi nevojat.

7. — Të ardhurat e buxhetit të jenë 27,6 miliard lekë nga këto rreth 87,3 për qind të sigurohen nga sektori socialist i ekonomisë. Shpenzimet për vitin 1960 të jenë 26,5 miliard lekë.

Të ardhurat e buxhetit lokal të jenë 1,1 miliard lekë dhe shpenzimet 4, 7 miliard lekë.

Të plotësohen detyrimet ndaj buxhetit për të ardhurat dhe të vendoset një regjim i fortë kursimi në shpenzimet, sidomos në sektorin social-kultural.

Organet e financës, të bankës dhe të kontrollit të shtetit të rishikojnë fund e krye punën e tyre, të mbyllin të gjitha shtigjet që lejojnë shpërdorimin e lekut të popullit.

— III —

Për realizimin e detyrave të planit dhe të buxhetit të shtetit të vitit 1960, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH e quan të domosdoshme që të përqëndrohet vëmendja e organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë në këto çështje themelore.

1. — Të merren të gjitha masat për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit.

Marksizëm-leninizmi mëson se forcimi i regjimit të kursimit nuk është fushatë e përkohshme, por metodë e përhershme socialiste e drejtimit të ekonomisë. Lufta për vendosjen dhe forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit është e lidhur ngushtë me ngritjen e ndërgjegjes socialiste të çdo punonjësi për ruajtjen e pronës socialiste. Partia duhet të punojë shumë për të edukuar punonjësit dhe për të rrënjosur tek ata kuptimin se pasuria e shtetit është pasuri e të gjithë popullit, se interesat materiale dhe politike të shtetit janë interesa materiale dhe politike të popullit. Ai që dëmton ose prek pasurinë e shtetit ka prekur interesat e popullit. Dëmtimi i pasurisë shtetërore, administrimi i keq i saj, sikurse burokracia ose shthurja e disiplinës shtetërore, duhen konsideruar si refleksi i luftës së klasave në aparatet që administrojnë shtetin tonë. Prandaj të ngrihet në një nivel më të lartë puna edukative dhe ideologjike e Partisë dhe të forcohet vigjilencia revolucionare e punonjësve për zbulimin dhe demaskimin e ashpër të keqbërësve dhe të armiqve të popullit.

Lufta kundër burokracisë, tarafeve, dembellëkut, dëmtimit dhe vjedhjeve të pasurisë socialiste të konsiderohet nga organizatat e Partisë si luftë kundër ideologjisë borgjeze.

Organizatat e Partisë të punojnë për të brumosur tek çdo punonjës ndjenjën e kursimit, për të rrënjosur tiparet e ndërgjegjes socialiste. Vendosja dhe forcimi i mëtejshëm i regjimit të kursimit të bëhet çështje e vetë masave punonjëse dhe t'i nënshtrohet kontrollit të masave. Veçanërisht rëndësi e posaçme i duhet kushtuar forcimit të regjimit të kursimit në industrinë e naftës, në gjeologji, në ndërtim etj.

Organet qendrore të planifikimit dhe të financave, dikastret, komitetet ekzekutive dhe të Partisë të jenë shumë rigorozë në planifikimin e shpenzimeve, që leku i popullit të përdoret me niqorillëkun më të madh.

2. — Të kthehet fytyra nga treguesit cilësorë të prodhimit.

Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë të marrin të gjitha masat për të ngritur punën e tyre në nivelin e detyrave të reja ekonomike, për të shpejtuar kalimin e industrisë dhe të degëve të tjera të ekonomisë popullore nga realizimi i planit në sasi në realizimin e tij medoemos edhe në treguesit cilësorë, në realizimin e detyrës për ngritjen e rendimentit të punës, për uljen e kostos, për përmirësimin e cilësisë dhe për zgjerimin e asortimenteve të prodhimit.

a) Të përmirësohet rrënjësisht cilësia e prodhimit dhe e ndërtimit.

Përmirësimi i cilësisë së prodhimit dhe të ndërtimit të konsiderohet nga organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë si çështje kryesore dhe e pandarë nga realizimi i planit në sasi. T'i jepet fund praktikës së dëmshme të rendjes vetëm pas sasisë; të ruhet medoemos parimi socialist i shpërblimit sipas sasisë dhe cilësisë së punës. Ky parim bazë të respektohet rigorozisht nga organet ekonomike dhe komisionet e emulacionit socialist.

b) Të forcohet kontrolli teknik mbi cilësinë e prodhimit dhe të ndërtimit, duke ngritur në një shkallë më të lartë kontrollin paraprak nga ana e organeve qendrore ekonomike dhe të gjallërohet kontrolli i pandërprerë teknik nga vetë ndërmarrjet. Të përmirësohet rrënjësisht përbërja e kontrollorëve teknikë. Ata të kenë kompetenca të plota deri në pezullimin e prodhimit për të gjitha rastet kur konstatojnë shkeljen e procesit teknologjik dhe të mos lejojnë në asnjë mënyrë tejkalimin e normave në dëm të cilësisë. Zyrat e kontrollit teknik të varen nga ministritë përkatëse. Në vlerësimin e realizimit të planit të prodhimit industrial dhe të ndërtimit, elementi «cilësi» të zërë një peshë specifike të barabartë me elementin «sasi» dhe njëkohësisht të mbahet parasysh edhe asortimenti.

Organet e tregëtisë të mos pranojnë asnjë mall që është prodhuar në kundërshtim me standardet dhe specifikimet e dhëna; të rritet përgjegjësia e komisioneve për marrjen në dorëzim të veprave të përfunduara të ndërtimit dhe të forcohet kontrolli mbi zbatimin e dokumentacionit teknik. Një kujdes i posaçëm i duhet kushtuar përmirësimit rrënjësor të cilësisë së mallrave për eksport, në mënyrë që ato të zënë një vend të merituar në tregun ndërkombëtar.

Partia duhet të udhëheqë dhe të organizojë kontrollin shoqëror mbi cilësinë e prodhimeve, duke bërë që kjo çështje të konsiderohet si detyrë e rëndësishme e punonjësve dhe e organizatave bazë.

c) T'u jepet fund qëndrimeve të njëanshme, prirjeve lokale dhe dikasteriale në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin në punë e sipër midis ndërmarrjeve prodhuese dhe porositësve. Ato të zgjidhen në frymën e bashkëpunimit dhe të partishmërisë.

3. — Të merren të gjitha masat për rritjen e mëtejshme të rendimentit të punës.

a) Të sigurohet me çdo kusht realizimi ritmik i planit. Të luftohet me rreptësinë më të madhe fryma e vetëkënaqjes dhe mendimi se «ka kohë për realizimin e planeve». Organet e Partisë, të

shtetit dhe të ekonomisë të marrin masa që plani të realizohet në mënyrë ritmike çdo ditë, çdo dhjetëditor, çdo muaj dhe çdo tremujor. Të zbatohen vendimet e Komitetit Qendror për të siguruar në kohën e duhur dhe në sasi të mjaftueshme rezervat materiale dhe lëndën e parë.

b) Të shfrytëzohet plotësisht koha e punës. Shfrytëzimi i plotë i kohës së punës të konsiderohet një rezervë e madhe për rritjen e rendimentit dhe realizimin e planit. Organizimi dhe normimi i punës të trajtohen si probleme me rëndësi të madhe ekonomike, politike dhe shoqërore. Të mënjanoen ndërprerjet për çorganizim dhe mungesë materiale brenda dhe gjatë turnit.

c) Të merren masa rigorozë për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e maqinerisë. Organizatat e Partisë, organet e shtetit dhe të ekonomisë duhet të rritin përpjekjet për shfrytëzimin maksimal të të gjitha kapaciteteve prodhuese ekzistuese, duke organizuar në një shkallë të gjerë zbulimin e rezervave të mëdha që fsheh mosshfrytëzimi në gjerësi dhe në thellësi i maqinerisë. Lufta për mirëmbajtjen e maqinerive duhet të mos shkëputet nga puna e organizuar për riparimin dhe remontin e tyre me cilësi të lartë dhe në kohë.

4. — Forcimi organizativ i kooperativave bujqësore është detyra kryesore sot në bujqësi.

Kooperativat bujqësore në vendin tonë janë të reja, prandaj ato duhet të ndihmohen konkretisht për të njohur mënyrën socialiste të organizimit të punës dhe të shpërndarjes. Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë ta konsiderojnë si detyrën e tyre kryesore në bujqësi, ndihmën që duhet t'u japin kooperativave për t'i forcuar nga pikëpamja organizative dhe ekonomike, për forcimin e llogarisë dhe të planifikimit. Veçanërisht rëndësi e posaçme i duhet kushtuar zbatimit të dy dokumentave bazë, që shprehin parimet socialiste organizative dhe ekonomike të kooperativave bujqësore: të statutit të kooperativave bujqësore dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave mbi organizimin dhe shpërblimin e punës në kooperativat bujqësore.

5. — Të merren masa për forcimin e mëtejshëm të disiplinës në punë, të ndjenjës së përgjegjësisë personale dhe të kontrollit të zbatimit të vendimeve.

Për të arritur një zhvillim më të lartë ekonomik dhe kultural të vendit, është e domosdoshme që organizatat e Partisë të zhvillojnë një luftë të vazhdueshme sistematike dhe këmbëngulëse

kundër mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve për të farkëtuar një disiplinë të fortë në punë; të shtojnë punën edukative me punonjësit për forcimin e ndjenjës së përgjegjësisë personale në zbatimin e detyrave të ngarkuara. Organizatat e Partisë me punën e tyre të arrijnë që disiplina e fortë, e ndërgjegjshme, disiplina socialiste të përshkojë të gjithë veprimtarinë e përditshme, punën praktike. Çdo punonjës të jetë i ndershëm përpara Partisë, shtetit dhe popullit dhe luftëtar aktiv për plotësimin e detyrave, të rritë kërkesat ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve.

Thyerjet, sado të vogla, të disiplinës në punë, moskryerja në rregull e detyrave të ngarkuara të konsiderohen shkelje të rënda të disiplinës shtetërore dhe të Partisë dhe të dënohen si të tilla.

Të bëhet një luftë e vendosur kundër burokracisë, dembelllëkut, tendencës së rehatllëkut, tarafit e hatërit, këtyre mbeturinave të ideologjisë borgjeze.

Kryeministria, ministritë dhe organet e tjera qendrore në asnjë mënyrë të mos i lënë vend thyerjes së disiplinës. Duhet të studjojnë me shumë kujdes urdhëresat, vendimet dhe grafiket dhe mbasi t'i kenë lëshuar këto, të luftojnë deri në fund për zbatimin e tyre, duke forcuar kontrollin dhe rikontrollin për të evituar zvarritjen ose lënjen në harresë të detyrave të caktuara.

Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, të tërheqin më me guxim punonjësit në kontrollin shoqëror.

6. — Të luftohen të gjitha shfaqjet e huaja që prishin ndërgjegjen e njerëzve.

Partia dhe qeveria gjithnjë kanë vlerësuar dhe kanë përkrahur përpjekjet e drejta të masave punonjëse për ngritjen e mirëqenjes së tyre, në bazë të shtimit të prodhimit të të mirave materiale, të rritjes së rendimentit të punës, në rrugën e kombinimit të drejtë të interesit personal me interesin e përgjithshëm shtetëror.

Por në periudhën kalimtare nga kapitalizmi në socializëm zhvillimi i vrullshëm i forcave prodhuese duhet të shoqërohet me një luftë këmbëngulëse, sistematike dhe konsekuente kundër shfaqjeve të huaja, mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve, të cilat e kanë burimin në influencën e ideologjisë borgjeze si aspekt i luftës së klasave. Prandaj organizatat e Partisë e kanë për detyrë që të bëjnë një punë të madhe politike dhe edukative, të çrrënjosin shfaqjet e dëmshme në disa punonjës, të brumosin ata ndërgjegjen socialiste, normat e moralit socialist, që interesin personal t'ja nënshtrojnë interesit të përgjithshëm, çështjes së madhe të ndërtimit të socializmit.

Të luftohen me ashpërsinë më të madhe, si veprime antishtetërore të gjitha rastet e falsifikimit të shifrave të realizimit të pla-

nit, prirjet për të hartuar plane të ulëta, për të përfituar shpërblime në rrugë të shtrembër.

T'i jepet fund praktikës së përfitimit të shpërblimeve në formën e racionalizimeve ose modifikimeve për çështjet që kanë të bëjnë me detyrat direkte të personelit drejtues administrativ dhe inxhiniero-teknik.

T'u vihet fre dhe t'u mbyllen të gjitha shtigjet shpenzimeve të panevojshme, shpërdorimit të lekut të popullit.

Plenumi i Komitetit Qendror porositi Këshillin e Ministrave që brenda tremujorit të parë të vitit 1960 të përfundojë së rishikuari dispozitat në fuqi që lenë shtigje për shpërblime të pamërituara.

7. — Të përmirësohet metoda e punës së organizatave të Partisë për drejtimin e ekonomisë.

Realizimi i këtyre detyrave të mëdha kërkon përmirësimin e mëtejshëm të punës së organizatave të Partisë dhe të organeve ekonomike shtetërore për drejtimin e ekonomisë. Partia të kryejë udhëheqjen e përditshme të ekonomisë nëpërmjet organeve ekonomike shtetërore; të mos i spostojë ato, por të ndihmojë në përmirësimin e metodës së punës së tyre. Komitetet ekzekutive të drejtojnë më mirë dhe të mbajnë përgjegjësi të plotë për veprimtarinë e ndërmarrjeve lokale dhe të shtrijnë kontrollin e tyre edhe në ndërmarrjet nacionale.

Organizatat e Partisë të zbatojnë drejt parimin leninist të kombinimit të punës organizative dhe politike me detyrat e planit. Të aktivizohen organizatat e Bashkimeve Profesionale, të rinisë, të gruas, të Frontit, të përdoren ato si leva të fuqishme për mobilizimin e punonjësve për realizimin e planit, për pjesëmarrjen sa më të gjerë të tyre në drejtimin e prodhimit. Të ngrihet roli dhe autoriteti i Bashkimeve Profesionale për përhapjen e iniciativave të përparuara, për marrjen dhe ndjekjen e zotimeve. Kujdes i veçantë t'u kushtohet brigadave që kanë luftuar dhe merituar titullin e lartë të pesëmbëdhjetëvjetorit të çlirimit të atdheut, që ato të shndërrohen në brigada të punës socialiste nën parullën «*të punojmë në mënyrë socialiste, të mësojmë në mënyrë socialiste, të jetojmë në mënyrë socialiste*».

Rëndësi e posaçme i duhet kushtuar gjallërimit të mbledhjeve të prodhimit. Ato të bëhen shkolla dhe tribuna të vërteta të socializmit, me anën e të cilave klasa punëtore të ushtrorë plotësisht të drejtën për drejtimin e prodhimit.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH tërheq vëmendjen e organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë se detyrat e planit të vitit 1960 janë të mëdha dhe vendimtare për realizimin përfun-

dimtar të planit të dytë pesëvjeçar. Niveli që do të arrihet vitin e ardhshëm në prodhimin e vlerave materiale do të jetë një mbështetje e sigurt për t'i shtruar ekonomisë popullore detyra të reja, më të rritura.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH është i ndërgjegjshëm se detyrat e planit të vitit 1960 janë plotësisht të realizueshme. Plenumi shpreh bindjen se klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia popullore, nën udhëheqjen e Partisë, do të mobilizojnë të gjitha energjitë dhe do t'i përvishen betejës së madhe për të realizuar detyrat e planit dhe të buxhetit për vitin 1960, për të mbyllur me sukses të plotë periudhën e planit të dytë pesëvjeçar, për ta pritur Kongresin IV të Partisë sonë, ku do të aprovohet plani i tretë pesëvjeçar, me ballë hapët, me duar plot, me plan të realizuar.

**Botohet sipas origjinalit
që ndodhet në Arkivin
Qendror të Partisë.**

PLENUMI XVI I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Tiranë, 25-26 maj 1960

KOMUNIKATË E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më datën 25 dhe 26 maj 1960, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shokut Enver Hoxha, zhvilloi punimet Plenumi i zgjeruar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili dëgjoji dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Për një zhvillim të mëtejshëm të ndërtimeve, për ngritjen, e tyre në një shkallë më të lartë teknike, që t'u përgjigjen në kohë dhe si duhet kërkesave gjithmonë në rritje që shtron ndërtimi i vrullshëm i socializmit në vendin tonë», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror, shoku Spiro Koleka, dhe mori njëzëri vendimin përkatës.

Plenumi i Komitetit Qendror mori gjithashtu vendimin për thirrjen e Kongresit IV të Partisë së Punës të Shqipërisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Nr, 118

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË NDËRTIMEVE»

26 maj 1960

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur më datën 25-26 maj 1960 nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, dëgjoji dhe aprovoi raportin e

Byrosë Politike mbajtur nga anëtarë të Byrosë Politike të Komitetit Qendror shoku Spiro Koleka, «Për një zhvillim të mëtejshëm të ndërtimeve, për ngritjen e tyre në një shkallë më të lartë teknike, që t'u përgjigjen në kohë dhe si duhet kërkesave gjithmonë në rritje që shtrihen ndërtimi i vullshëm i socializmit në vendin tonë».

Nën udhëheqjen e ndritur të Partisë sonë heroike të Punës, me ndihmën vëllazërore dhe pa interes të Bashkimit Sovjetik në radhë të parë, dhe të vendeve të tjera të kampit socialist, populli ynë ka arritur suksese të mëdha në zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë popullore, të arësimit dhe të kulturës. Po zhvillohen në mënyrë të pandërprerë industria dhe transporti, u krye me sukses riorganizimi mbi baza socialiste i bujqësisë dhe, si rrjedhim, po përmirësohet nga viti në vit mirëqenja materiale dhe niveli kultural i masave punonjëse.

Në programin e Partisë për ndërtimin socialist të vendit, nga që ne trashëguam një prapambetje të theksuar tekniko-ekonomike nga e kaluara, një vend të rëndësishëm zënë ndërtimet, të cilat gjatë këtyre 15 vjetëve të çlirimit kanë marrë përpjesëtime shumë të gjëra. Atdheu ynë është kthyer në një kantier ku zihen puna ndërtimore. Janë vënë dhe nga koha në kohë vihen në shfrytëzim vepra të reja industriale, bujqësore, të komunikacionit, socialo-kulturale, etj., që janë mburrja dhe krenaria e popullit tonë paqdashës. . .

Politika e Partisë sonë në lëmin e ndërtimeve ka qenë e qartë që në fillim. Ndërtimet janë bërë dhe bëhen, në radhë të parë, për zhvillimin e forcave prodhuese, në sektorin social-kultural dhe për ngritjen e banesave. Ndërtimet kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e bazës materialo-prodhuese të socializmit.

Duke analizuar përfundimet e arritura në lëmin e ndërtimeve, Plenumi i Komitetit Qendror i PPSH konstatoi:

Ndërtimet në krahasim me të kaluarën, si edhe ritmet e zhvillimit të tyre gjatë viteve të pushtetit popullor, kanë qenë shumë të larta, të papara në historinë e vendit. Vëllimi i ndërtimeve shtetërore në vitin 1959 është rritur 39 herë më shumë se në vitin 1938.

Detyrat e caktuara nga Kongresi III i Partisë në lëmin e ndërtimeve së bashku me shtesat e Plenumit të shkurtit 1958 të Komitetit Qendror në përgjithësi janë duke u zbatuar me sukses. Gjatë katër vjetëve (1956-1959) plani i zmadhuar i ndërtimeve u plotësua 104 për qind, nga i cili Ministria e Ndërtimit 107 për qind.

Kanë përfunduar së ndërtuari dhe janë vënë në shfrytëzim vepra me rëndësi të madhe, si hidrocentralet «Karl Marks» dhe «Lenin» së bashku me ujësjellësin e Tiranës dhe linjën e tensionit të lartë për shpërndarjen e energjisë elektrike Ulëz-Tiranë-Elbasan-Qyteti Stalin-Patos-Memaliaj, centrale elektrike termike të fuqishme, Kombinati i tekstilit «Stalin», Fabrika e sheqerit «8 Nën-

tori» në Maliq, Uzina e përpunimit të naftës në Cërrik me vajgur-sjellësin, Kombinati i konservave «E. Telman» në Vlorë, fabrikat e konservimit të frutave e perimeve, fabrikat e fermentimit të duhanit, fabrika e qelqit dhe e ekstraktanit, etj.

Janë në përfundim e sipër dhe po punohet në një sërë veprash të tjera të mëdha, si hidrocentralet në Shkopet e Bisticë, Fabrika e pasurimit të bakrit në Kurbnesh, Kombinati ushqimor «A. Kelmendi», frigoriferi, Fabrika e bukës dhe Kombinati i mishit në Tiranë, fabrikat e përpunimit të frutave e të rrushit në Shkodër, Milot, Librazhd, Çorovodë, Ballsh, Këlcyrë e Përmet si dhe rindërtimi dhe zgjerimi i shumë veprave industriale në shfrytëzim.

U kryen vepra të mëdha bonifikimi, si ajo e Maliqit dhe e fushës së Korçës, e fushës së Kavajës, të Zadrimës dhe po kryhen ato të Myzeqesë, të Thumanës, të Roskovecit, të Vurgut etj. Janë bërë me dhjetëra kilometra kanale ujitëse, si kanali i Çernicës, ai «Naum Panxhi» në Elbasan, ai Vjosë-Levan-Fier, ai Peqin-Kavajë. Po ngrihen liqenet artificiale të Tiranës dhe të Kurjanit.

Janë ndërtuar me qindra kilometra hekurudha dhe rrugë automobilistike të reja, rrjeti i të cilave është shtrirë edhe në thellësi, në krahinat malore të vendit.

Të shumta janë gjithashtu veprat që janë ndërtuar për zhvillimin e arësimit, të kulturës dhe të shëndetësisë, si Kinostudioja «Shqipëria e Re» në Tiranë, Teatri i Shkodrës; janë bërë dhe po bëhen punime të mëdha për ngritjen e shkollave, të kopshteve dhe të çerdheve për fëmijë, të spitaleve e sanatoriumeve, pallateve të mëdha të turizmit dhe për pushimin e punonjësve, si dhe për ngritjen e veprave të tjera social-kulturale.

Deri në fund të vitit të kaluar u ndërtuan nga shteti rreth 1 milion e 200 mijë metra katrore ndërtesa banimi, ose 1,5 herë më shumë se sipërfaqja e banesave të kryeqytetit. Atje ku në të kaluarën ishin moçale dhe vende të shkreta, sot janë ngritur qendra të reja banimi, si në Maliq, në Yzberish, në Patos, në Memaliaj, në Pishkash, në Kurbnesh etj. Është bërë dhe po bëhet një punë e madhe për rregullimin, ndërtimin dhe zbukurimin e qyteteve. Në këtë drejtim shprehja më tipike është kryeqyteti i republikës sonë. Ndërtesat e banimit, parqet dhe lulishtet, si edhe veprat e tjera të ndërtuara gjatë pushtetit popullor e kanë bërë Tiranën qytetin më të dashur dhe më të bukur të atdheut tonë.

Ndërtime gjithashtu të shumta janë bërë dhe po bëhen në fshatin tonë socialist dhe nga vetë qytetarët me ndihmë në kredi dhe materiale të shtetit.

Përfundime të mira janë arritur në përgatitjen dhe në aftësimin e mijëra specialistëve dhe të një numri të mirë kuadrosh inxhiniero-teknikë, të cilët kanë fituar eksperiencë në punë. Këto kuadro drejtuan dhe drejtojnë zbatimin e punimeve në shumë ve-

pra të mëdha. Nga duart e këtyre inxhinierëve kanë dalë projektet e shumicës së veprave që janë ndërtuar.

Është punuar për krijimin e bazës tekniko-materiale të ndërtimeve, për ngritjen e shkallës së mekanizimit, për zhvillimin e industrisë së prodhimit të materialeve të ndërtimit dhe të lëndës së drurit. Për këtë qëllim janë vënë në shfrytëzim Kombinati i drurit «Nako Spiro» në Elbansan, Fabrika e çimentos «V. I. Lenin» në Vlorë, është në përfundim e sipër rindërtimi i fabrikave në shfrytëzim si edhe ndërtimi i fabrikave të reja të tullave në Shkodër, në Elbansan, në Lushnjë dhe në Vlorë. Po zhvillohet prodhimi i pjesëve të parafabrikuara. Ndërmarrjet dhe kantieret e ndërtimit janë pajisur me mekanizma dhe maqineri moderne, të cilat kanë lehtësuar shumë punën e punëtorëve dhe kanë rritur rendimentin e punës. Ka përmirësim në organizimin e punimeve dhe në teknologjinë e ndërtimit.

Këto janë fitore të shkëlqyera të klasës sonë punëtore, e cila ka trashëguar veti të çmuara për të ndërtuar mirë e bukur dhe me duart e saj të arta, duke mos ju shmangur vështirësive e sakrificave, ka kthyer në vepra programin madhështor të Partisë. Në këtë punë kaq të madhe inteligjencia jonë teknike ka ecur, ka punuar dhe ka jetuar me vrullin revolucionar të klasës punëtore, ashtu siç e ka edukuar dhe e edukon Partia.

Por megjithkëtë Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH vëren se në ndërtim ka ende të meta e dobësi, të cilat bëhen pengesë për të vënë plotësisht në jetë parullën e partisë «Të ndërtojmë më shpejt, më mirë dhe më lirë».

Të metat kryesore në sektorin e ndërtimit janë zvarritjet në dorëzimin e veprave, gabimet në preventivin, përpjekjet e pamjaftueshme për përmirësimin e cilësisë, për vendosjen e një regjimi rigoroz kursimi, për shfrytëzimin e rezervave të mëdha për uljen e kostos.

Mungesa e studimeve të kujdesshme paraprake ka bërë që të mos hartohen më parë detyra të projektimit me zgjidhje të ndryshme dhe pastaj të vendoset ajo më e leverdishmja dhe këtej të kalohet në projektin. Kjo ka shkaktuar që parashikimet në fondet e investimeve për ndërtimin e veprave të mos jenë të sakta (zakonisht kanë qenë më të ulëta), që afatet e projektimit të zgjaten dhe kështu të krijohen pengesa dhe vonesa në zbatim.

Me gjithë përparimet, aftësitë projektuese të vendit janë ende të pakta për të përballuar nevojat. Veprat që ndërtohen nuk janë pajisur në kohë me projekte dhe preventive. Në preventivimin e punimeve të ndërtim-montimit ka ende analiza të fryra që lënë shteg për të vjelë të ardhura të mëdha jo për meritë të përpjekjeve që bëjnë ndërmarrjet e zbatimit.

Masat e marrura dhe përfundimet e arritura në tipizimin e projekteve dhe në standartizimin e pjesëve të ndërtimit cilësohen

si të pamjaftueshme për të siguruar me kohë ndërtimet me projekte e preventive dhe për të industrializuar prodhimin në seri të pjesëve të parafabrikuara të ndërtimit. Duke përdorur projektet tip pa kriter arkitektonik dhe urbanistik e pa marrë parasysh kushtet topografike dhe klimaterike, aty-këtu i është lënë vend monotonisë dhe uniformizimit në disa qytete. Nuk është vendosur disiplina e duhur në përdorimin e projekteve tip në gjithë vendin.

Vërehen ende raste të shkeljes së planeve rregulluese dhe rregullores mbi urbanistikën; problemi i urbanistikës në fshat nuk është kapur akoma sa duhet.

Të meta të tjera vërtetohen në organizimin e zbatimit të punimeve të ndërtimit. Si rrjedhim i shpërndarjes së forcave në të njëjtën kohë në shumë vepra, shkelen afatet e parashikuara në plan, gjë që sjell ribërjen e grafikeve dhe zgjatjen e kohës për vënjen e tyre në shfrytëzim. Përpjekje të pamjaftueshme janë bërë për sigurimin e frontit të punës, për kryerjen e sa më shumë punimeve ndërtimi e montimi në kohën e dimrit për të pakësuar karakterin stinor që vihet re në ndërtim.

Kuadrot inxhiniero-teknikë të zbatimit pak merren me studimin e thelluar dhe të gjithanshëm të projekteve dhe preventiveve, gjë që pengon marrjen e masave të nevojshme për vazhdimin e punimeve në bazë të planit të organizimit.

Nuk është treguar kujdesi i duhur për racionalizimin e fuqisë punëtore dhe për organizimin e mirë të brigadave, gjë që ka shkaktuar humbje të mëdha kohe. E pamjaftueshme është puna për grumbullimin, përgjithësimin dhe përhapjen e eksperiencës së përparuar dhe nuk është plotësuar detyra e caktuar nga Plenumi i shkurtit 1958 i Komitetit Qendror të Partisë për rritjen e rendimentit të punës dhe uljen e kostos.

Të meta vërtetohen gjithashtu në mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin ende të dobët të transportit dhe të maqinerisë së ndërtimit, në ruajtjen e materialeve deficitare të ndërtimit, si të hekurit, të çimentos, të lëndës së drurit. Është nënvleftësuar në përgjithësi rëndësia e përdorimit të materialeve të vendit, si guri, qerpiçi, kalla-mi, kashta, etj.

Industria e materialeve të ndërtimit ka mbetur prapa në krahasim me ritmet që kanë ndjekur ndërtimet dhe kjo ka krijuar vështirësi serioze në punën e ndërtimit.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH tërheq vëmendjen e organizatave të Partisë, të Ministrisë së Ndërtimit, të ndërmarrjeve dhe kantierëve të saj mvartëse, të organeve ekonomike shtetërore, që kryejnë punime ndërtimi në ekonomi, gjithë personelit inxhiniero-teknik dhe ndërmarrjeve industriale për rastet e palejueshme në kryerjen e punimeve dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit me cilësi të dobët.

Duke u nisur nga të metat, dobësitë dhe mungesat që vërtohen ende në ndërtim, nga nevoja e mënjanimit sa më parë të tyre për të kapërcyer më me lehtësi vështirësitë e rritjes dhe sidomos detyrat shumë të mëdha që shtron pesëvjeçari i tretë në lëmin e ndërtimeve për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, me qëllim që të vihet plotësisht në jetë parulla e partisë «Të ndërtojmë më shpejt, më mirë dhe më lirë», që të ngrihet më lart niveli teknik dhe ekonomik i ndërtimit, Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

V E N D O S I :

— I —

NË LËMIN E STUDIMEVE DHE TË PROJEKTIMIT

1. — T'u kushtohet kujdes i posaçëm studimeve të nevojshme paraprahe tekniko-ekonomike të veprave që do të ndërtohen, me qëllim që të përcaktohet mbi këtë bazë leverdishmëria dhe efektiviteti i investimeve, të mënjanohen gabimet në parashikimin e aftësive prodhuese të veprave, në përcaktimin e vëllimit të ndërtimeve dhe të fondeve.

Organet ekonomike shtetërore, e në radhë të parë investitorët dhe Komisioni i Planit të Shtetit, të shqyrtojnë me syrin kritik dhe në frymë partie punën e bërë deri më sot në këtë drejtim dhe të marrin masat e duhura për përmirësimin rrënjësor të punës së studimeve.

Për ndërtimet e rëndësishme organet qendrore duhet të kryejnë studime të thelluara të mbështetura mirë me të dhëna bindëse tekniko-ekonomike mbi domosdoshmërinë dhe leverdinë e ndërtimit të veprës. Pa të tilla studime të mos i paraqiten Komitetit Qendror të PPSH dhe qeverisë kërkesa për ndërtime.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të studjojë mundësinë e krijimit ose të forcimit të grupeve për studime paraprahe të investimeve dhe të ndërtimeve kapitale.

Organet qendrore të shtetit dhe Komisioni i Planit në veçanti të mendojnë kryesisht për ndërtimin e veprave që rritin forcat prodhuese dhe t'u vënë fre kërkesave për punime të vogla, nën kufi, të cilat i pengojnë ato.

2. — Ngritja e çështjes së studimit dhe të projektimit në lartësinë e detyrave që shtrohen përbën një nga detyrat kyçe në lëmin e ndërtimeve. Duke marrë parasysh se bërthama projektimi

ka edhe në dikastere të tjera, si në Ministrinë e Minierave dhe të Gjeologjisë, të Bujqësisë, të Komunikacionit, të Shëndetësisë, në Kombinatin e naftës, në Universitetin shtetëror etj., ngarkohet Këshilli i Ministrave të studjojë, brenda vitit në vazhdim, organizimin më të përshtatshëm të veprimtarisë së tyre.

3. — Studimet në lëmin e ndërtimeve dhe të materialeve të ndërtimit të orientohen në këto drejtime kryesore: në tipizimin e projekteve; në parafabrikimin e pjesëve prej betonarmeje të zakonshme dhe të paratensionuar; në kërkimin për materialet e ndërtimit, e sidomos të gurit, të argjileve, të rërave me përmbajtje kuarci për prodhimin e tullave silikat etj. si edhe në mekanizimin e punimeve të ndërtimit.

Në përputhje me këtë, si edhe me planin e aprovuar më parë, Universiteti shtetëror të marrë masa për organizimin e punës shkencore dhe për zbatimin e detyrave të ngarkuara në këtë drejtim.

Gjatë punës shkencore të mbahen parasysh eksperiencia dhe përfundimet e arritura në lëmin e teknikës së ndërtimeve në Bashkimin Sovjetik, në vendet e tjera të kampit socialist, si edhe përfundimet e teknikës dhe të eksperiencës së përparuar botërore.

4. — Të përmirësohet në mënyrë rrënjësore puna në projektim; të bëhen përpjekje që të sigurohen në kohë veprat me projekte dhe preventive me cilësi të lartë. Të kalohet më me guxim në tipizimin e projekteve si edhe në përdorimin e tyre me kriter në përshatje me arkitekturën, urbanistikën dhe me kushtet topografike dhe klimaterike të vendit. Në projektim të mënjanohen teprimet që rritin vleftën e ndërtimit. Projektuesit dhe preventuesit t'u përmbahen me përpikmëri fondeve të planifikuara dhe të mos fillohet ndërtimi i veprave që nuk kanë projekte dhe preventive pa aprovimin e Këshillit të Ministrave.

a) Që të plotësohen më mirë dhe me kohë detyrat në projektimet dhe preventivimin, është e domosdoshme të caktohen për këtë punë kuadro të aftë dhe me perspektivë. Për të plotësuar boshllëqet me kuadro të tërhiqen në punën e projektimit dhe të preventivimit sa më shumë inxhinierë e teknikë të jashtëm e sidomos ata të Universitetit, të teknikumeve etj.

Studentët e fakultetit të inxhinierisë të Universitetit shtetëror, që kanë më shumë prirje për studime e projekte, të kryejnë praktikën në projektim në Ministrinë e Ndërtimit, në mënyrë që të përgatiten më mirë për këtë punë të rëndësishme. Në shpërndarjen e tyre të mbahet parasysh që këta t'i jepen në radhë të parë Ministrisë së Ndërtimit, e cila t'i vendosë në projektim vetëm pas tre vjetësh pune në zbatim.

b) Të rritet kujdesi dhe aftësia e inxhinierëve dhe e teknikëve për të projektuar sa më mirë, me kosto të ulët, pa çenuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e veprës, si edhe kushtet e shfrytëzimit të

mirë të saj. Në projektimin e tyre të mbahen mirë parasysh kushtet sizmike të vendit tonë.

... c) Të zgjerohet tipizimi sidomos në projektimin e ndërtesave të banimit, social-kulturale, bujqësore, të qytetit e të fshatit, nga 25 për qind që është sot, në 50 për qind brenda vitit 1965. Arkitektët, inxhinierët dhe teknikët e projektimit dhe të urbanistikës të tregojnë kujdesin e duhur që në pamjet e jashtme të ndërtesave të mos shkaktohet monotonia që mund t'u sjellin projektet — tip kur këto hartohen dhe zbatohen në mënyrë të pastudjuar dhe pa ato variacione të thjeshta që mund t'u bëhen pamjeve të jashtme, duke lëvizur në lartësi, në mënyrën e vendosjes dhe të formave të ballkoneve etj.

Të ruhen karakteristikat e veçanta të qyteteve, sidomos ato të Beratit, të Gjirokastrës e të Krujës.

Me qëllim që të mënjanohej gabimet e vërtetuara në përdorimin e projekteve-tip, Këshilli i Ministrave të lëshojë, brenda vitit në vazhdim, udhëzime të veçanta.

ç) Ngarkohet Këshilli i Ministrave të studjojë forma më të përshtatshme e më të thjeshta të preventivimit dhe të financimit të ndërtimeve pa prekur kontrollin financiar mbi kushtimin e veprës.

Të rishqyrtohen gjithashtu manualët e preventivimit që përdoren sot, me qëllim që të hidhen baza më të shëndosha të preventivimit për pesëvjeçarin e tretë.

Me qëllim që në planifikimin e fondeve për ndërtimin e veprave të mënjanohej sa më shumë ndryshimet e mëdha që janë vërtetuar deri më sot, Këshilli i Ministrave të nxjerrë normativa planifikimi të fondeve.

d) Për të mënjanohej vonesat në hartimin e projekteve dhe për t'u siguruar me kohë ndërmarrjeve të ndërtimit vendin e punës, porositen investitorët dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve që të marrin masa të shpejta për të siguruar detyrat e projektimit, të dhënat dhe karakteristikat e nevojshme për projektim, për caktimin e vendeve të ndërtimit.

5. — Urbanistika të ngrihet në një nivel më të lartë për të përballuar detyrat e shumta e të rëndësishme që shtrohen sot si në qytete e qendra industriale, ashtu dhe në fshatin tonë socialist. Të fuqizohet edhe më shumë sektori i urbanistikës, për të rritur dhe për të përmirësuar punën, për të zbatuar me përpikmëri planet rregulluese dhe ligjin mbi urbanistikën, për të disiplinuar marrëdhënjet ndërmjet investitorëve, ndërmarrjeve zbatuese të ndërtimit dhe këshillave popullore të pushtetit.

Këshilli i Ministrave të marrë masa për zbatimin e detyrës së matjeve aerofotogrametrike të qyteteve dhe për shpejtimin e përfundimit të hartave përkatëse për hartimin e planeve rregulluese të atyre qyteteve që nuk i kanë deri më sot. Atje ku nuk ka plane rregulluese të aprovuara, të ndërtohet me plane të pjesshme, ose

në bazë të disa studimeve paraprake, që duhen kryer dhe aprovuar nga organet lokale të pushtetit.

Të fillojë menjëherë studimi dhe përfundimi i planit të rrjetit të kanalizimeve, të ujësjellësit, të ndriçimit etj. në ato qytete që kanë plane rregulluese të aprovuara dhe brenda vitit 1965 të kenë përfunduar. Për qytetet e tjera, që nuk i kanë këto plane të aprovuara, studimet të përfundojnë brenda vitit 1970.

Kooperativat bujqësore të zmadhuara, sipas mundësive, të paktën për qendrën, ku ato janë vendosur, të kenë planin rregullues, qoftë edhe në formë të thjeshtë, skica, dhe pa harta topografike. Brenda vitit 1962 të jenë hartuar projektet — tip për ndërtesat e banimit, të prodhimit dhe social-kulturale që do të ndërtohen në fshat. Ndërkaq, komitetet ekzekutive të tregojnë më shumë kujdes për vënjen në jetë të orientimeve që kanë dhënë Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria për ndërtimet në fshat.

6. — Në projektimin dhe në zbatimin e ndërtimit të veprave të ndryshme të kursehet sa të jetë e mundur më shumë toka e punëshme.

— II —

NË LËMIN E ORGANIZIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË PËRMIRËSIMIT TË TREGUESVE TEKNIKO-EKONOMIKË

Shkurtimi i afateve të ndërtimit, vënja me kohë në shfrytëzim e veprave, përmirësimi rrënjësor i cilësisë së punimeve dhe ulja e kostos të konsiderohen nga organizatat e Partisë, organet ekonomike shtetërore, ndërmarrjet dhe kantieret e ndërtimit, nga personeli inxhiniero-teknik dhe gjithë punonjësit e ndërtimit si detyrat më të rëndësishme.

1. — Të përmirësohet në mënyrë rrënjësore organizimi i punimeve të ndërtimit, të ngrihet rendimenti i punës, të zbulohen dhe të vihen në shfrytëzim rezervat e brendshme që fshihen në gjirin e ndërmarrjeve dhe të kantierëve të ndërtimit, të tregohet më shumë kujdes për sigurimin teknik në punë, të përhapet eksperiencia e përparuar dhe të rehat e shkencës e të teknikës, duke patur parasysh sidomos:

a) Ndërmarrjet shtetërore të ndërtimit të bëjnë çmos për të kufizuar përhapjen e forcave dhe të mjeteve në të njëjtën kohë në shumë vepra për të plotësuar planin në vleftë, t'i përqëndrojnë ato në përfundimin e veprave të filluara, në mënyrë të veçantë të atyre që duhet të vihen në shfrytëzim brenda afateve të planifikuara. Të pakësohet vëllimi i ndërtimeve të papërfunduara. Në veprat e ndërtimit në përgjithësi, dhe sidomos në ato më të rëndësishme, të mos fillohet nga puna pa patur më parë planin e organizimit të pu-

nimeve, qoftë edhe me ato të dhëna fillestare që mund të sigurohen në mungesë të projekteve dhe të preventivave të plota.

b) Organet e planifikimit të ndërtimit dhe investitorët të përqëndrojnë në veprat kryesore mjete të mjaftueshme për përfundimin dhe vënjen e tyre në shfrytëzim në afatet e parashikuara në planin e shtetit dhe organet e tregëtisë së jashtme të sigurojnë me kohë maqineritë dhe pajisjet teknologjike. Në caktimin e afateve të përfundimit të veprave të mos nisen nga dëshira, por nga mundësitë reale. Mbi këto baza duhet të hartohen edhe grafikët e punimeve të ndërtimit.

c) Për të përmirësuar organizimin e ndërtimit është e nevojshme të sigurohet puna ritmike gjatë gjithë vitit. T'i jepet fund praktikës që vihet re në disa ndërmarrje dhe kantiere ndërtimi, të cilat, si rrjedhim i mosmarrjes në kohë të masave tekniko-organizative, nuk krijojnë punë për stinën e dimrit, ulin ritmin e ndërtimeve të ndërtim-montimit, duke i dhënë atij karakter stinor. Një praktikë e tillë krijon kushte të vështira për punëtorin, keqëson shfrytëzimin e maqinerisë dhe nuk lejon përdorimin racional të punëtorëve të kualifikuar.

ç) Të merren të gjitha masat për rritjen e rendimentit të punës, për përgjithësimin dhe përhapjen e eksperiencës dhe të metodave të përparuara. Të punohet për vënjen në jetë të propozimeve racionalizuese të punëtorëve dhe të teknikëve novatorë, për shfrytëzimin e plotë të kohës së punës, për përvetësimin e teknikës së ndërtimit etj.

Të organizohet sa më mirë puna në sheshin e ndërtimit, të bëhen të gjitha përpjekjet për sigurimin pa ndërprerje të materialeve sa më afër veprës dhe të veglave të punës.

Të përfitohet sa më shumë nga eksperiencia e punëtorëve dhe e teknikëve të përparuar, të cilët, duke marrë pjesë gjallërisht në emulacionin socialist të organizuar në brigadat e përziara dhe në brigadat e punës socialiste, kanë arritur të përvetësojnë teknikën, punojnë në bazë të metodave të reja, plotësojnë dhe tejkalojnë normat, janë shembull i qëndrimit socialist ndaj punës.

Kujdes i posaçëm u duhet kushtuar propozimeve që bëjnë punonjësit e ndërtimit, të cilat duhet të studjohen me vëmendje nga ana e organeve drejtuese dhe e personelit inxhiniero-teknik.

d) Të mekanizohen sa më gjerësisht punimet, pa lënë pas dore mekanizimin e thjeshtë. Të mirëmbahen dhe të shfrytëzohen më mirë maqineritë dhe automjetet. Duke filluar që nga viti 1961, të organizohet në vend prodhimi i mekanizmave të thjeshta.

2. — Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH porositi organet e Partisë, organet ekonomike shtetërore, ndërmarrjet dhe kantieret si edhe gjithë punonjësit e ndërtimit, që në frymën e vendimit të Plenumit të dhjetorit 1959 të Komitetit Qendror, të marrin masa për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së punimeve të ndërtim-monti-

mit, për të mos lejuar punime të papërfunduara në veprat që vihen në shfrytëzim. Për këtë të ngulet këmbë që:

a) Të kuptohet drejt se lufta për përmirësimin rrënjësor të cilësisë është detyra kryesore e ndërtuesve dhe e punonjësve të industrisë së materialeve të ndërtimit.

Partia gjithnjë ka bërë të ditur se lufta për përmirësimin e cilësisë nuk ka karakterin e një fushate të përkohshme; përkundrazi ajo duhet të ndihet dhe të kuptohet si thelbi i çdo pune dhe i teknikës në përgjithësi. Prandaj çështja kryesore është ngritja dhe ushtrimi i kontrollit teknik në kohën dhe në lartësinë e duhur. Krahas kësaj të bëhet një punë e vazhdueshme, e durueshme dhe këmbëngulëse për të ngritur teknikisht punëtorët dhe personelin inxhiniero-teknik, duke vënë në dukje punën e pastër dhe duke qortuar e mësuar ata që nuk punojnë mirë. Të bëhet një punë e gjerë nga inxhinierët, teknikët, mjeshtërit dhe punëtorët më të mirë për njohjen nga të tjerët të kushteve e të rregullave teknike dhe të standardeve etj., në mënyrë që të mbahet qëndrim nga çdo punonjës kur shkelen rregullat teknike, kur punohen dhe përdoren materiale që nuk u përgjigjen standardeve shtetërore. Laboratorët e ministrisë dhe të fakultetit të inxhinierisë të ndihmojnë më shumë kantieret dhe veprat e ndërtimit qoftë me provat që ata duhet të bëjnë drejtpërdrejt me cilësinë e materialeve, të llaçeve etj., qoftë duke ndihmuar për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e laboratorëve të thjeshtë fushorë pranë veprave më të rëndësishme.

b) Komisionet e kolaudimit të veprave të jenë më të përpiktë në punën e tyre, të mos kalojnë përciptazi, të kujdesen më shumë për cilësinë e punimeve të mbuluara, si vendosja e hekurave në betonarme, vendosja e themeleve, izolimet e ndërtesave në përgjithësi etj. dhe të kërkojnë dokumentacion të rregullt për punimet e kryera.

c) Projektuesit të ushtrojnë kontrollin që u takon me ligje dhe të ndihmojnë më shumë përgjegjësit teknikë e punëtorët e veprës në punë e sipër. Personeli inxhiniero-teknik i zbatimit të forcojë më shumë bashkëpunimin me projektuesit.

ç) Rëndësi e posaçme i duhet dhënë organizimit të kontrollit nga ana e organeve qendrore; po ashtu edhe kontrollit shoqëror. Përmirësimi i cilësisë së ndërtimit të bëhet çështje e vetë masave punonjëse, e organizatave të Bashkimeve Profesionale, të rinisë etj, të cilat, nën udhëheqjen e organizatave të Partisë, të organizojnë shqyrtime shoqërore të cilësisë së ndërtimit, të ngrënë grupe kontrolli, të organizojnë konsulta. Çështjet e përmirësimit të cilësisë të jenë në qendrën e vëmendjes së punës të agjitorëve e të propagandistëve, të diskutohen gjallërisht dhe vazhdimisht në mbledhjet e prodhimit, të pasqyrohen në agjitacionin figurativ dhe në shtypin e ndërmarrjes.

Të vendoset kontroll i rreptë në plotësimin e normave të punës dhe të mos lejohet tejkalimi i tyre në dëm të cilësisë.

3. — Të bëhet një luftë e vazhdueshme për uljen e kostos. Të vendoset një regjim i rreptë kursimi në përdorimin e lekut të popullit, të forcohet hozrashoti i brendshëm në kantieret e ndërtimit, të shkurtohen shpenzimet e panevojshme administrative. Për të zbatuar këtë detyrë të rëndësishme të mbahen parasysht:

a) Në vleftën e ndërtimit materialet zënë vendin kryesor, prandaj organizatat e Partisë, ndërmarrjet dhe kantieret e ndërtimit si edhe organet ekonomike shtetërore duhet të shtojnë përpjekjet për përdorimin sa më me kursim të tyre, të bëhet luftë e vendosur kundër shpërdorimit të tyre në kantier dhe në vepër. Të mënjahen humbjet gjatë transportit, dëmtimit në ngarkim-shkarkim dhe të vendoset rregull në magazinat.

b) T'i kushtohet rëndësi e posaçme përdorimit me nikoqirllëk të materialeve deficitare, si të hekurit, të çimentos, të lëndës së drurit. Të kursehen skelat dhe kallëpët, të pregatiten ato duke përdorur sa më shumë mbeturinat e lëndës së drurit dhe të përfshihen në të ardhshmen në inventarin e ndërmarrjes ose të kantierit.

Organizatave të Bashkimeve Profesionale e të rinisë të organizojnë herë pas here grumbullimin dhe rregullimin e materialeve, gjë që nuk mund të arrihet me fushatë, por me edukimin e punonjësve për të ruajtur nga çdo dëmtim pasurinë socialiste.

Të bëhen të gjitha përpjekjet për t'ju përmbajtur normativave të aprovuara të përdorimit të materialeve, të firove legale dhe, aty ku ka mundësi, të ulen ato. Të mos lejohet asnjë shkelje në dozaturat e prodhimit të betonit dhe të llaçeve, duke përdorur për këtë qëllim materiale inerte të pastra dhe me granulometri të caktuar, ashtu siç përshkruan teknologjia përkatëse.

4. — Investitorët të forcojnë bashkëpunimin me ndërmarrjet dhe Ministrinë e Ndërtimit, të kujdesen më shumë për ndërtimin me kohë të veprave dhe vënjen e tyre në shfrytëzim, të kryejnë plotësisht detyrat që u takojnë gjatë gjithë kohës së ndërtimit, që nga hartimi i detyrave të projektimit, nga caktimi i vendeve të ndërtimit, nga projektimi, nga ndihma e vazhdueshme që duhet t'u japin ndërmarrjeve të ndërtimit për problemet e ndryshme që lindin gjatë zbatimit, deri në përfundimin e plotë të veprave. T'u përmbahen me përpikmëri kontratave të lidhura me ndërmarrjet e ndërtimit, të mos bëhen pengesë për financimin e punimeve. Të kontrollojnë mirë situacionet dhe cilësinë e punimeve të ndërtim-montimeve.

5. — Këshilli i Ministrave të ngarkojë organet përkatëse për të studjuar dhe për të aprovuar gjatë vitit në vazhdim masat për përmirësimin e mënyrës së planifikimit të rendimentit të punës dhe të uljes së kostos në punimet e ndërtimit.

NË LËMIN E MATERIALEVE TË NDËRTIMIT

Plotësimi me sukses i detyrave të mëdha në sektorin e ndërtimit varet shumë nga mbarëvajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i prodhimit të materialeve të ndërtimit, si nga ndërmarrjet industriale, ashtu edhe nga vetë ndërmarrjet e ndërtimit.

Detyrat e mëdha të pesëvjeçarit të tretë nuk mund të plotësohen pa bërë një kthesë rrënjësore në zhvillimin e industrisë së materialeve të ndërtimit dhe pa siguruar furnizimin ritmik të punimeve të ndërtimit me këto materiale dhe me ato që importohen.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH e sheh të domosdoshme të tërheqë vëmendjen e organeve ekonomike e shtetërore dhe të organizatave të Partisë në industrinë e material-ndërtimit që të sigurohet medoemos, brenda një periudhe sa më të shkurtër, nxjerrja nga prapambetja e kësaj dege të industrisë, si dhe të shpejtohen ritmet e zhvillimit të saj, në mënyrë që gjatë viteve të para të pesëvjeçarit të tretë ajo t'i përgjigjet ritmit të ndërtimeve, që të sigurojë plotësimin e të gjitha nevojave të tyre dhe të krijohen kapacitete rezervë prodhimi, të mjaftueshme për rritjen e mëtejshme të ndërtimeve.

1. — Punonjësve të industrisë së çimentos u shtrohet si detyrë që të rritin prodhimin e çimentos. Kjo ka rëndësi shumë të madhe për zgjidhjen me sukses të detyrave të ndërtimit, e në mënyrë të veçantë për industrializimin e punimeve të ndërtimit. Të përfundojë rindërtimi i Fabrikës së çimentos «V. I. Lenin», në Vlorë. Gjatë pesëvjeçarit të tretë të zgjerohet industria e çimentos me anën e vënjes në shfrytëzim të një fabrike të madhe çimentoje.

Krahas kësaj, të shtohet kujdesi për të prodhuar çimento të markave të larta.

2. — Që të sigurohet furnizimi i ndërtimit me tulla e tjegulla, është e domosdoshme të përmirësohet rrënjësisht puna në fabrikat, të përfundojnë së ndërtuari dhe të vihen në shfrytëzim fabrikat e reja në Shkodër, në Elbasan, në Lushnjë dhe në Vlorë, si edhe punimet për zgjerimin e fabrikave në shfrytëzim.

Ministria e Industrisë të marrë masa të veçanta për përgatitjen dhe vendosjen e kuadrit teknik specialist, si edhe për përvetësimin e shpejtë të teknikës së prodhimit.

Të merren gjithashtu të gjitha masat për të shtuar prodhimin e tullave dhe të tjegullave nga ndërmarrjet lokale të industrisë si edhe nga vetë ndërmarrjet e ndërtimit, duke shtuar kumitë, me qëllim që të mbulohen deficitet e krijuara nga fillimi me vonesë i prodhimit të tyre për shkak të kohës së keqe.

Të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për arritjen dhe tejkalimin e treguesve të nxjerrjes së tullave nga 1 m³ e furrës dhe të

tregohet kujdes i posaçëm për përmirësimin e cilësisë së prodhimit të tullave e të tjegullave.

Të merren masa për të ndërtuar gjatë pesëvjeçarit të tretë fabrika tullash me kapacitet më të madh, për të prodhuar tulla me bira, tjegulla marsejeze dhe lloje të tjera të nevojshme për ndërtimin. Gjithashtu, të studjohet mundësia e prodhimit në vend të tullave silikat dhe ngritja e një fabrike eterniti.

3. — Të zhvillohet prodhimi i gëlqeres në mënyrë industriale. Për këtë qëllim të merren masa që brenda vitit 1962 të prodhohet jo më pak se 80 për qind e sasisë së gëlqeres në furra të përhershme.

Të zgjerohet nxjerrja dhe të përmirësohet cilësia e materialeve inerte të ndërtimit.

Ngarkohet Ministria e Ndërtimit që brenda vitit 1961 të mekanizojë nxjerrjen e gurit, të zhavorit dhe të rërës jo më pak se 60 për qind, larjen e rërës dhe të zhavorit për beton 90 për qind.

Të mekanizohet ngarkimi në guroret e përhershme dhe në ato me prodhim të madh.

4. — T'i jepet fund nënvleftësimit të materialeve të thjeshta të ndërtimit, si të gurit, të qerpiçit, të kallamit, të thuprave etj. Të nxitet dhe të përhapet përdorimi i këtyre lloj materialeve, sidomos ndërtimi me qerpiç në kooperativat, në fermat shtetërore dhe në SMT-të. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda muajit qershor 1960 të përcaktojë llojet e materialeve që do të përdoren në vende të ndryshme dhe për ndërtesat e ndryshme.

5. — Me qëllim që të përballohen nevojat e ndërtimit me prodhime prej materialesh vendi dhe të shkurtohet importi i tyre, Këshilli i Ministrave të studjojë mundësinë e zgjerimit të prodhimit të llojeve të tjera të materialeve të ndërtimit, si të allçiuat të rafinuar, të pllakave të presuara prej tallashi dhe të mbeturinave të lëndës së drurit, të materialeve hidrosanitare prej porcelani etj.

Krahas kësaj, të studjohet edhe mundësia e prodhimit në vend të hekurishteve për dyer e dritare, të veglave të punës etj.

6. — Ritmet e mëdha të ndërtimit... në vendin tonë shtrojnë me forcë industrializimin e prodhimit të pjesëve të ndërtimit. Për kushtet e vendit tonë është e domosdoshme, sidomos për ndërtimin e banesave në kryeqytet dhe në disa qytete kryesore, të kalohet në industrializimin e prodhimit të pjesëve të ndërtesave. Për ndërtimet e tjera është mirë të zhvillohet atje ku është e leverdishme prodhimi i pjesëve të ndërtimit me anë të poligoneve të ngritura për këto qëllime. Për këtë, brenda pesëvjeçarit të tretë, krahas shtimit të prodhimit të çimentos, të mendohet për ngritjen e poligoneve të fuqishme për prodhimin e paneleve të parafabrikuara prej betonarmeje. Të studjohet ngritja në Tiranë e një fabrike për pregatitjen e paneleve për ndërtesa të parafabrikuara.

7. — Ndërtimet në përgjithësi dhe ato industriale, të komunikacionit, ndërtesat e banimit në veçanti kërkojnë shumë hekurbeton, i cili është material shumë deficitar. Vendi ynë ka importuar dhe do të importojë sasi të mëdha hekurbetoni. Është e domosdoshme të zhduket përdorimi i tij pa vend, sidomos në ato ndërtime që mund të bëhen edhe pa betonarme, por me beton ose gurë, siç janë urat me qemer, shtyllat me tulla ose gurë, qemeret në përgjithësi, arhitrarët e dyerve e të dritareve etj. Ministria e Ndërtimit të ushtrojë vazhdimisht kontroll mbi projektuesit që të mos shpërdorjnë hekurin. Ministria e Tregëtisë të sigurojë hekurbeton të markave të larta, që është më ekonomik.

8. — Me qëllim që të përmirësohen kushtet e strehimit të punonjësve në qytetet kryesore, ngarkohet Këshilli i Ministrave ta studjojë hollësisht këtë problem dhe t'i paraqesë Komitetit Qendror një plan perspektiv për ndërtimin e banesave.

9. — Punonjësit e ndërtimit duhet të konsiderojnë si detyrë shumë të rëndësishme përdorimin me vend të lëndës së drurit, e cila është nga materialet më deficitare të ndërtimit dhe nevojat duhet të plotësohen vetëm me atë sasi që prodhohet në vend. Prandaj të merren masat e duhura për t'ju përmbajtur kërkesave të projektit, të rritin sa më shumë qarkullimin e përdorimit të kallëpeve e të skelave, të vënë rregull në kantieret dhe në çdo vepër për ta ruajtur lëndën e drurit nga çdo dëmtim. Projektuesit duhet të parashikojnë përdorimin e lëndës së drurit vetëm ku është e domosdoshme dhe të studjojnë në mënyrë të vazhdueshme zëvendësimin e leverdishëm të saj me lëndë të tjera.

Për kursimin e lëndës së drurit të shqetësohen vazhdimisht jo vetëm përdoruesit dhe projektuesit, por edhe ndërmarrjet e prodhimit dhe ato të transportit.

10. — Për zhvillimin e ritmit të punimeve të ndërtimit, ngarkohet Këshilli i Ministrave të marrë masa për të siguruar brenda vitit 1962 një rezervë materiale në tulla, tjegulla, çimento, hekur, lëndë druri dhe materiale të tjera të paktën për 3 muaj.

— IV —

NË LËMIN E PREGATITJES DHE TË KUALIFIKIMIT TË KUADRIT

Përmirësimi rrenjësor i punës në ndërtim varet në radhë të parë nga njerëzit, nga energjia, iniciativa dhe aftësia e tyre. Kujdesi për pregatitjen e kuadrove të përhershëm të kualifikuar është detyrë shumë e rëndësishme e organizatave bazë të Partisë, e ndërmarrjeve dhe e kantierëve të ndërtimit. Shoku Enver Hoxha,

duke folur në konferencën e 6-të të organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës në mars të vitit 1959., midis të tjerash ka thënë:

«Duhet të kemi parasysh se këtë vit dhe vitin që vjen do të bëjmë ndërtime të mëdha, kurse në pesëvjeçarin e ardhshëm do të bëjmë ndërtime edhe më të mëdha, kolosale. Prandaj jo vetëm të përpiqemi për realizimin e planit të ndërtimeve aktuale sa më shpejt, më mirë dhe më lirë, por duhet të përgatitim jo batalione, por divizione të tërë ndërtuesish, njerëz të kualifikuar, dhe këta njerëz do t'i nxjerrë ndërtimi».³⁸

Duke ndjekur porositë e vazhdueshme të Partisë, në ndërtim është bërë punë e mirë për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit.

Megjithatë, masat për përgatitjen e kuadrit inxhiniero-teknik dhe të punëtorëve të kualifikuar janë të pamjaftueshme për të përballuar nevojat e mëdha dhe gjithmonë në rritje të ndërtimit si në projektim, ashtu dhe në zbatim; nuk i kushtohet kujdesi i duhur përgatitjes së kuadrove të përhershëm të kualifikuar, fluktuacioni i tyre në disa raste është akoma i lartë.

Është e nevojshme të mënjanohen këto të meta dhe të shtohet kujdesi për ngrijten e nivelit kulturalo-teknik dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës së ndërtuesve. Për këtë:

1. — T'i kushtohet kujdes edhe më i madh përgatitjes në përgjithësi të kuadrit inxhiniero-teknik dhe të punëtorëve të kualifikuar, qoftë nga numri, qoftë nga aftësitë e duhura profesionale, në të gjitha format e përgatitjes së kuadrit, në kurset e kualifikimit dhe të përfeksionimit me ndërprerje dhe pa ndërprerje nga puna, në shkollat e rezervave të punës, në shkollën dyvjeçare të punëtorëve, në teknikumat si dhe në shkollat e larta.

a) Të tregohet kujdesi i duhur për mbarëvajtjen e kurseve dhe të formave të tjera të përgatitjes së punëtorëve pranë ndërmarrjeve pa ndërprerje nga puna, e në mënyrë të veçantë për përgatitjen me anë të marrjes në kujdestari të tyre. Të përhapet sa më gjerë iniciativa «1+2» e Ndërmarrjes «21 Dhjetori» për ngritjen profesionale të kuadrove.

Porositet Ministria e Ndërtimit që në veprat më të rëndësishme, si në pallatin e kulturës që do të ngrihet në Tiranë, në kombinatin kimiko-metalurgjik, në hidrocentralet e Shkopetit e të Bisticës, si edhe në veprat e tjera, të përgatisë pa ndërprerje nga puna sa më shumë specialistë, duke përfshirë këtu edhe ato zanate që po zhduken, si për gurgdhendës, drugdhendës, etj.

Në shkollat e rezervave të punës të përgatiten më shumë muratorë, karpentierë dhe montatorë.

Të synohet në përgatitjen e punëtorëve të kualifikuar me më shumë se dy zanate, si muratorë-karpentierë-suvaxhinj, mekanik-kovaç-hekurthyes, ekskavatorist-buldozerist-skreperistë etj., dhe të arrihet kështu që me më pak specialistë të vazhdohet puna pa ndërprerje në çdo stinë, duke u siguruar në këtë mënyrë edhe punëtorëve punë për të gjithë vitin.

Komitetet ekzekutive të rretheve, e në mënyrë të veçantë ato të zonave të Veriut, të plotësojnë numrin e nxënësve sipas planit në këto shkolla.

b) Të tregohet kujdesi i duhur për mbarëvajtjen e Teknikumit të ndërtimit, dhe në veçanti të shkollave dyvjeçare të punëtorëve. Të shtohet sa më shumë numri i pjesëmarrësve në to. Për ndjekjen e këtyre shkollave të zgjidhen punëtorët më të aftë dhe më me perspektivë.

Plenumi e sheh të nevojshme që nga radhët e mjeshtëreve dhe të teknikëve më të mirë, të cilët kanë grumbulluar aftësi të mëdha profesionale dhe organizative, të krijohet detyra e asistent-inxhinierit. Ky do të jetë krahu i djathtë i inxhinierit në zbatim. Këshilli i Ministrave të shqyrtojë kategorizimin dhe pagat e tyre.

Për të disiplinuar lëvizjet e tepërta të teknikëve të mesëm, porositet komitetet e Partisë që të jenë shumë të kujdesshëm në këtë drejtim.

2. — Duke marrë parasysh mungesat e mëdha për kuadro inxhiniero-teknikë, si edhe për të plotësuar detyrat e mëdha që i ngarkohen ndërtimit në planin e tretë pesëvjeçar, është e domosdoshme të racionalizohet shpërndarja e tyre. T'i jepen Ministrisë së Ndërtimit një pjesë e kuadrove inxhiniero-teknikë që sot janë në degë të tjera, por që nuk janë të domosdoshëm.

3. — Për të përmirësuar në mënyrë rrënjësore punën në ndërtim, është e domosdoshme të ngrihet niveli i drejtimit tekniko-organizativ dhe, krahas me këtë, të shpërndahen drejt kuadrot. Të mos ngarkohen inxhinierët dhe teknikët me punë administrative dhe të furnizimit, por t'u krijojnë të gjitha mundësitë që ata të merren vetëm me punë teknike dhe tekniko-ekonomike. Inxhinierët dhe teknikët ta quajnë si detyrë nderi që të punojnë atje ku zgjidhet fati i ndërtimit, në ndërmarrjet, në kantieret dhe në veprat e ndërtimit. Ata të shqetësohen vazhdimisht dhe të punojnë me të gjitha forcat për ngritjen tekniko-profesionale të punëtorëve në përgjithësi dhe të specialistëve në veçanti. Kuadrot drejtues të ndërmarrjeve dhe të kantierëve të ndërtimit të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për përvetësimin e teknikës dhe të ekonomisë së ndërtimit, të mbështeten në eksperiencën e përparuar, në vrullin revolucionar dhe në entuziazmin që lind në procesin e punës krijuese të masave punonjëse.

4. — Krahas me përpjekjet për të siguruar ndërtimet me spe-

cialistë dhe punëtorë, organet e Partisë dhe ato shtetërore të marrin masa për të rritur pjesëmarrjen e gruas në ndërtim.

5. — T'i kushtohet kujdes i posaçëm trajtimit të fuqisë punëtore në ndërtim dhe kushteve të jetesës. Organet e Partisë dhe të pushtetit të kujdesen në mënyrë të posaçme për të plotësuar nevojat e strehimit për punonjësit e përhershëm të ndërtimit në qytetet.

Organizatat e Partisë, të Bashkimeve Profesionale dhe drejtuesit e ndërmarrjeve të kujdesen vazhdimisht për kushtet e jetesës së ndërtuesve, për argëtimin e tyre.

6. — I rekomandohet Komitetit Qendror të BRPSH-së që, në gjurmat e traditave të shkëlqyera të periudhës së mëkëmbjes së ekonomisë së shkatërruar nga lufta dhe të zhvillimit të saj në rrugën drejt socializmit, të pjesëmarrjes së rinisë sonë heroike në ndërtimin e hekurudhave, të rrugëve, të Hidrocentralit «Karl Marks» dhe të shumë veprave të tjera, të verë në lëvizje të gjithë të rinjtë dhe të rejat e vendit për aksione të reja, për pjesëmarrjen e tyre në ngritjen e veprave të tjera më të mëdha, që do të ndërtohen gjatë pesëvjeçarit të tretë.

— V —

MBI NDËRTIMET NË PESËVJEÇARIN E TRETË DHE MBI NEVOJËN E NJË RIORGANIZIMI MË TË PËRPARUAR

Rruga që ka përshkuar populli ynë në këto vjet çlirim nën udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë sonë karakterizohet nga fitore të papara në historinë e vendit. Me përfundimin e planit të dytë pesëvjeçar vendi ynë futet në një etapë të re zhvillimi. Pesëvjeçari i tretë do të jetë në këtë drejtim një hallkë shumë e rëndësishme, shprehja e një programi më madhështor e më të guximshëm në rrugën e ndritur të ndërtimit të socializmit.

Në programin e Partisë për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist, ashtu si edhe në të kaluarën, një rol të rëndësishëm do të luajnë ndërtimet. Do të ngrihen uzina dhe kombinatet të fuqishme me teknologji të ndërlikuar, degë të reja të industrisë, si metalurgjia me ngjyra, industria kimike për prodhimin në vend të plehërave azotike dhe fosfatike për bujqësinë, do të bëhen përgatitje për ngritjen e metalurgjisë së zezë etj. Punimet për bonifikimin e fushave do të hyjnë në fazën përfundimtare, do të ndërtohen hekurudha të reja, shkolla, spitale dhe shumë vepra të tjera me karakter social-kultural.

Me anën e ndërtimeve, do të vihen në shfrytëzim aftësi të reja prodhuese, që do të zgjerojnë dhe do të fuqizojnë edhe më

shumë bazën materialo-prodhuese të nevojshme për fitoren e socializmit në vendin tonë.

Plotësimi me sukses i këtyre detyrave të mëdha kërkon jo vetëm mobilizimin e të gjitha fuqive krijuese të punonjësve të ndërtimit, por edhe ngritjen e rolit të drejtimit teknik dhe organizativ të kësaj dege në nivelin e detyrave të reja.

Ngarkohet Ministria e Ndërtimit që, brenda gjashtë mujorit të parë 1961, të marrë në shqyrtim të veçantë një nga veprat më të rëndësishme dhe, duke u mbështetur në projekt-idetë, për ato që i kanë, dhe në skicë-idetë për të tjerat, të hartojë një plan të hollësishëm për masat organizative, për përgatitjen e kuadrit të nevojshëm, për caktimin e kuadrove drejtuese për nevojat në inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë, mjete, materiale etj.

Për të përballuar vëllimin e madh të ndërtim-montimeve që do të zbatohet në të ardhmen, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH e quan të nevojshme të merren masat paraprake për forcimin e ndërmarjeve dhe të vetë Ministrisë së Ndërtimit, e cila do të mbajë barrën më të madhe të këtij plani, si edhe ngritjen e ndërmarrjeve të specializuara të ndërtimit për veprat kryesore të pesëvjeçarit.

MBI PUNËN E PARTISË NË NDËRTIM

Si në të gjitha fushat e jetës së vendit, ashtu edhe sukseset madhështore që janë arritur në zhvillimin e ndërtimeve e kanë burimin, para së gjithash, në punën e madhe udhëheqëse dhe mobilizuese të Partisë sonë. Duke u vënë në krye të kolektivave punonjëse, organizatat e Partisë, me punën e tyre organizative dhe ideo-politike, kanë mundur të drejtojnë hovin dhe vrullin revolucionar të punëtorëve, të inxhinierëve dhe të teknikëve në kryerjen e detyrave të mëdha që shtrouan ndërtimi socialist i vendit.

Zhvillimi i mëtejshëm i ndërtimeve, natyra e vështirë e punës, lëvizjet e shpeshta të kantierëve, shtrirja e tyre në thellësi të vendit, në mjaft raste larg qendrave të banuara, nevojat gjithmonë e më të mëdha për plotësimin e ndërtimeve me punëtorë shtrojnë përpara organizatave të Partisë detyra të rëndësishme. Përmirësimi i punës organizative, ideo-politike dhe edukative të Partisë është kyç i zgjidhjes me sukses të detyrave që i shtrohen kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë popullore. Për mbarëvajtjen e punës së Partisë është e nevojshme të shtohet dhe të forcohet përbërja e Partisë, të gjallërohen organizatat bazë, organizatat e sektorit dhe grupet e Partisë në ndërtim, që ato të jenë më vetëvepruese, më me iniciativë, të mobilizojnë komunistët dhe punëtorët e përparuar, të cilët të tërheqin pas vetes gjithë kolektivin punonjës për zbatimin e detyrave të planit të shtetit.

Organizatat e Partisë t'i kushtojnë kujdes të posaçëm punës agjitative dhe propagandistike me punonjësit, t'u bëjnë të qartë atyre programin madhështor të Partisë për ndërtimin e jetës së re e të begatshme, se me duart e tyre ata ngrenë veprat e para në ndërtesën e madhe të socializmit që do të jenë trashëgim për brezat e ardhshëm.

Organizatat e Bashkimeve Profesionale dhe të rinisë të kujdesen më shumë për organizimin dhe zhvillimin e emulacionit socialist, për trajtimin e fuqisë punëtore, për rritjen e ndërgjegjes socialiste ndaj punës, me qëllim që të mënjanohej mungesat dhe dobësitë që vihen re në disa raste në ndërtim.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë është i bindur se organizatat e Partisë, të Bashkimeve Profesionale, të rinisë, drejtuesit e ndërmarjeve dhe punonjësit e ndërtimit do të rritin përpjekjet për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të planit të shtetit për vitin 1960, viti i fundit dhe vendimtar për plotësimin me sukses të planit të dytë pesëvjeçar.

* * *

Komiteti Qendror i PPSH ka besim, si kurdoherë, se punëtorët, teknikët, inxhinierët dhe gjithë punonjësit e tjerë të ndërtimit, në frymën e këtij vendimi, do t'i përvishen më me vrull, entuziazëm dhe vetëmohim punës së madhe ndërtimore dhe paqësore për të kthyer në vepra programin madhështor të Partisë për ndërtimin socialist të vendit, se me duart e tyre të arta dhe njohuritë e tyre teknike do të ngrenë gjithmonë e më shumë vepra madhështore për lumturinë dhe begatinë e popullit. Në këtë punë fisnike ata do të kenë kurdoherë ndihmën, përkrahjen dhe kujdesin e vazhdueshëm e të gjithanshëm të Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

**Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
128, datë 29 maj 1960.**

Nr. 119

V E N D I M

I PLENUMIT TË KQ TË PPSH «MBI THIRRJEN E KONGRESIT IV TË ZAKONSHËM TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË»

26 maj 1960

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të datës 26 maj 1960

V E N D O S I :

I. — Të thirret Kongresi IV i zakonshëm i Partisë së Punës të Shqipërisë në muajin nëntor 1960.

II. — Të aprovohet rendi i ditës i Kongresit IV të Partisë së Punës të Shqipërisë si vijon:

1) Raporti mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Referon Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha.

2) Raporti mbi aktivitetin e Komisionit Qendror të Revizionimit...

3) Mbi direktivat e Kongresit IV të PPSH për planin e tretë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kultural të Republikës Popullore të Shqipërisë. Referon anëtari i Byrosë Politike dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Mehmet Shehu.

4) Zgjedhjet për organet qendrore të Partisë.

III. — Normativa e përfaqësimit për në kongres të jetë: në çdo 65 anëtarë partie — një delegat me votë deliberative dhe në çdo 65 kandidatë për anëtarë partie — një delegat me votë konsultative.

IV. — Zhvillimi i zgjedhjeve për në kongres të ndjekë këtë procedurë:

a) Mbledhjet e organizatave bazë për zgjedhjen e delegatëve

për konferencat e Partisë të rretheve ose të qyteteve të zhvillohen brenda muajit shtator 1960.

b) Konferencat e Partisë të rretheve dhe të qyteteve për zgjedhjen e delegatëve për kongresin e Partisë të zhvillohen brenda datës 30 tetor 1960.

c) Organizatat e Partisë të Ushtrisë Popullore dhe të repar-teve ushtarake të Ministrisë së Punëve të Brendshme do t'i zgjedhin delegatët për në kongres tok me organizatat e terrenit në konferencat e Partisë të rretheve ose të qyteteve ku ndodhen.

V. — Gjatë muajit shtator 1960 të botohen në shtyp projekt-direktivat e planit të tretë pesëvjeçar, të cilat të diskutohen gjerësisht në organizatat e Partisë dhe me masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
126, datë 27 maj 1960

Nr. 120

Teza të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH*)

«PËR LIDHJEN E NGUSHTË TË SHKOLLËS ME JETËN DHE ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË SISTEMIT TË ARËSIMIT POPULLOR»

14 qershor 1960

I. — DETYRAT E SHKOLLËS PËR NDËRTIMIN E MËTEJSHËM TË SOCIALIZMIT

Vendi ynë ka korrur fitore të mëdha në rrugën e ndërtimit të socializmit nën udhëheqjen e drejtë të Partisë sonë të Punës dhe me ndihmën vëllazërore të Bashkimit Sovjetik e vendeve të tjera të kampit socialist.

Kongresi IV i PPSH, që do të shqyrtojë dhe do të aprovojë direktivat e planit të tretë pesëvjeçar, do të shënojë një hap të ri të rëndësishëm në ndërtimin e socializmit: Shqipëria do të hyjë në rrugën e shndërrimit nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar. Do të krijohen degë të reja të industrisë — industria metalurgjike e kimike, do të zgjerohet shumë baza energjetike e vendit, industria mekanike, e materialeve të ndërtimit, industria e lehtë, ushqimore dhe e veshmbathjes; do të zhvillohet transporti; do të rriten ndërtimet e shkalla e mekanizimit të tyre. Do të rritet shumë mekanizimi e karakteri intensiv i bujqësisë. Në saje edhe të

* Më 22 qershor 1960 u botuan në shtyp tezat e Komitetit Qendror të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH «Për lidhjen e ngushtë të shkollës me jetën dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të arësimit popullor».

Tezat ju nënshtuan një diskutimi të gjerë popullor.

Plenumi i Komitetit Qendror i 7-8 tetorit 1960, pasi diskutoi raportin e Byrosë Politike të KQ «Mbi riorganizimin e shkollës dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit arësitor» dhe duke patur parasysh konkluzionet e diskutimit popullor, vendosi riorganizimin e shkollës e të sistemit arësitor në bazën e parimeve të shprehura në tezat e KQ të PPSH e të Këshillit të Ministrave të RPSH.

ndihmës së lartë teknike që vendi ynë merr nga Bashkimi Sovjetik e vendet e tjera të kampit socialist, gjithmonë e më gjerë do të futet në prodhim teknika e re e përparuar.

Ndërtimi i mëtejshëm i shoqërisë socialiste e komuniste kërkon ngritjen e nivelit arësimit të të gjitha masave punonjëse dhe përgatitjen e kuadrit për degët e ndryshme të ekonomisë e të kulturës në nivelin e kërkesave të shkencës e të teknikës së re.

Ndërtuesi i socializmit dhe i komunizmit duhet të jetë i pajisur me arësim, të zotërojë teknikën e re, të jetë i përgatitur e i aftë për punë prodhuese, i edukuar me idetë e marksizëm-leninizmit, me shpirtin e kolektivitetit, me idetë e patriotizmit e të internacionalizmit proletar, të jetë luftëtar i vendosur për çështjen e socializmit e të komunizmit. Prandaj në këtë etapë roli i shkollës, si hallka kryesore për edukimin komunist të brezit të ri dhe për përgatitjen e kuadrove, rritet edhe më shumë.

Edukimi komunist i brezit të ri mund të bëhet vetëm në qoftë se lidhet me punën e gjithë popullit, me praktikën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Për këtë arsye qysh në shkollë duhet që mësimi dhe edukimi të lidhen ngushtë me punën.

«Vetëm duke punuar bashkë me punëtorët dhe fshatarët, — ka thënë Lenini, — mund të bëhesh komunist i vërtetë»³⁹.

Lidhjen e të mësuarit me punën prodhuese marksizëm-leninizmi e konsideron si parimin themelor të arësimit e të edukimit të brezit të ri në shoqërinë socialiste e komuniste. Marksist shkruante se në edukimin e fëmijëve është e nevojshme që, duke filluar nga një moshë e caktuar, puna prodhuese të lidhet me të mësuarit.

«... kjo do të jetë vetëm një metodë për rritjen e prodhimit shoqëror, por edhe e vetmja metodë për krijimin e njerëzve me një zhvillim të gjithanshëm»⁴⁰

«Nuk mund të përfytyrohet ideali i një shoqërie të ardhshme, — ka shkruar Lenini, — pa e bashkuar arësimin me punën prodhuese të brezit të ri: arësimi dhe edukimi pa një punë prodhuese as puna prodhuese pa arësimin dhe edukimin nuk do të mund të viheshin në atë lartësi që kërkohet nga shkolla e sotme e teknikës dhe nga gjendja e dijeve shkencore»⁴¹

Ndarja e punës mendore nga puna fizike është një fenomen negativ i shoqërisë së vjetër shfrytëzuese, të cilën kapitalizmi e ka thelluar më shumë. Në shoqërinë kapitaliste arësimi dhe kultura janë një monopol i klasave të pasura. Këto klasa i përgatisin fëmijët e tyre vetëm për punë mendore, vetëm për të udhëhequr.

Kurse masave të popullit u janë mbyllur dyert e arësimit dhe ato duhet vetëm të punojnë.

Në shoqërinë socialiste krijohen kushte të reja, zhduken kontradiktat midis njerëzve të punës mendore e të punës fizike, fillon procesi i zhdukjes graduale të ndryshimeve rrënjësore të këtyre dy llojeve të punës. Në socializëm puna ndryshon karakter: nga një barrë e rëndë ajo shndërrohet në një çeshtje nderi dhe lavdie. Shteti socialist e vë sistemin e arësimit në shërbim të njerëzve të punës dhe u krijon atyre kushte për t'u pajisur me dituri dhe kulturë. Gjatë kalimit gradual në komunizëm, në shoqërinë socialiste punohet për ngritjen e punonjësve të industrisë dhe të bujqësisë deri në nivelin e personelit inxhinierio-teknik dhe agronomo-zooteknik. Shkolla ku edukohet e mëson rinia jonë duhet ta ketë parasysh me kohë këtë prirje të zhvillimit dhe të ndihmojë për zhdukjen e ndryshimit midis punës mendore e fizike, të sigurojë përgatitjen dhe edukimin komunist të rinisë.

II. — GJENDJA E SHKOLLËS SONË DHE NEVOJA E RIORGANIZIMIT TË SISTEMIT ARËSIMOR

Gjatë 15 vjetëve të pushtetit popullor, nën udhëheqjen e PPSH, janë realizuar suksese shumë të mëdha në zhvillimin e shkollës dhe në edukimin e brezit të ri.

Reforma arësimore, që u bë në vitin 1946, krijoi shkollën e re me karakter thellësisht demokratik. Shkolla nga privilegj i bijve të klasave sunduese u bë pronë e masave punonjëse, i hapi dyert gjerësisht për të gjithë bijtë e bijat e popullit. Përmbytja e arësimit dhe e edukimit të brezit të ri u vu në baza të drejta ideologjike e shkencore. Arësimi fillor, që më parë përfshinte jo më shumë se një të tretën e fëmijëve të moshës shkollë, u bë i detyrueshëm e i përgjithshëm dhe tani kemi kaluar në arësimin shtatëvjeçar të detyrueshëm, i cili përfshin rreth 70 për qind të atyre që mbarojnë shkollën fillore. Është zgjeruar mjaft rrjeti i shkollave të mesme të arësimit të përgjithshëm e profesional dhe është krijuar për herë të parë arësimi i lartë. Ka ndryshuar në shkolla përbërja sociale e nxënësve; pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë bijtë e punëtorëve dhe të fshatarëve. Në arritjen e sukseseve të shkollës sonë, një rol të rëndësishëm ka luajtur eksperiencia e çmuar e shkollës sovjetike.

Në vitin shkollor 1960-1961 në të gjitha kategoritë e shkollave do të mësojnë rreth 300 000 vetë, d.m.th. në çdo 5 banorë 1 do të ndjekë shkollën. Në këtë mënyrë vendi ynë, dikur i prapambetur, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, në bazë të këtij treguesi, ka kaluar vendet fqinjë e shumë vende kapitaliste të zhvilluara.

Sistemi arësimor në vendin tonë i ka shërbyer ndërtimit të socializmit, duke përgatitur rreth 15.000 kuadro të mesëm dhe rreth 3.500 kuadro të lartë për degët e ndryshme të ekonomisë dhe të kulturës, veç dhjetëra mijëra punëtorëve të kualifikuar për industrinë, bujqësinë, ndërtimin, transportin etj. Është krijuar kështu inteligjencia e re, e dalë nga gjiri i popullit, besnike ndaj çështjes së Partisë dhe të popullit.

Suksese të tilla flasin qartë për karakterin me të vërtetë popullor të arësimit në vendin tonë, për kujdesin e madh e të vazhdueshëm që kanë treguar e tregojnë Partia e shteti ynë për edukimin e punonjësve dhe për përgatitjen e kuadrove.

Me gjithë këto suksese të mëdha, shkolla jonë nuk u përgjigjet ende siç duhet nevojave gjithnjë më të mëdha të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe të kulturës për kuadro, si dhe kërkesave gjithnjë në rritje të popullsisë për arësim. Rrjeti i shkollave shtatëvjeçare, si dhe i shkollave të mesme, veçanërisht i atyre të arësimit të përgjithshëm, është ende i kufizuar. Në punën mësimore-edukative të shkollave ka të meta të mëdha, cilësia e mësimit nuk është në nivelin e duhur dhe përparimi i nxënësve është i ulët.

Por e meta më e rëndësishme e shkollës është mungesa e lidhjes së shëndoshë të saj me jetën, një farë shkëputje e saj nga jeta.

Shkolla e arësimit të përgjithshëm sot ja kushton vëmendjen kryesisht përgatitjes së rinisë me kulturë të përgjithshme për të ndjekur shkollat më lart. Duke patur këtë qëllim puna e saj është kufizuar në zhvillimin mendor të rinisë dhe nuk i kushton kujdesin e duhur përgatitjes për jetën, për veprimtarinë e ardhshme praktike, edukimit dhe mësimit të rinisë për punë. Kjo ka bërë që mësimi dhe edukimi në shkollë të marrë karakter të njëanshëm, që të mësuarit të jetë i shkëputur nga jeta e gjallë dhe mjaft abstrakt e verbal.

Në bazë të direktivave të Kongresit III të PPSH, u muarën disa masa për të kapërcyer shkëputjen e shkollës nga jeta, për të lidhur më ngushtë teorinë me praktikën, për të futur gradualisht elementët e arësimit politeknik dhe për të edukuar te nxënësit dashurinë për punë. Këto masa janë zbatuar në një pjesë shkollash, e sidomos në shkollat e mesme eksperimentale. Por ato janë të pamjaftueshme dhe nuk arrijnë të zhdukin shkëputjen e madhe të shkollës nga jeta, nuk arrijnë ta përgatisin rininë shkollë nga pikëpamja psikologjike, praktike e teknike për të marrë pjesë në prodhimin shoqëror.

Nevojat e shoqërisë sonë dhe perspektivat e zhvillimit të saj kërkojnë që të ndryshojë koncepti mbi arësimin, mbi karakterin, detyrat dhe përmbajtjen e shkollës. Përpara së gjithash duhet çrrënjësuar pikëpamja që e ndan shkollën nga jeta, që e ndan arësimin nga puna fizike. Pikëpamja se shkolla e arësimit të për-

gjithshëm duhet ta përgatisë rininë vetëm për punë mendore nuk pajtohet me karakterin e gjerë që merr arësimi në shoqërinë socialiste dhe me nevojën e përgatitjes së rinisë për jetën, për veprimtarinë e ardhshme praktike.

Në edukimin e arësimit e brezit të ri ne nuk duhet të udhëhiqemi vetëm nga gjendja e nga nevojat e sotme, por të shikojmë të ardhshmen. Ndërtuesi i nesërm i shoqërisë së re duhet të ketë jo vetëm kulturë të përgjithshme, por të njohë bazat shkencore të degëve kryesore të prodhimit, teknologjinë e organizimin e tij, teknikën e re, të fitojë aftësi pune dhe përgatitje profesionale për punë në njërin nga sektorët e ekonomisë e të kulturës kombëtare.

Prandaj Komiteti Qendror e Këshilli i Ministrave, duke u nisur nga mësimet e marksizëm-leninizmit, duke u mbështetur në eksperiencën e shkollës sonë dhe në eksperiencën e shkollës sovjetike, e quajnë të nevojshme të riorganizohet sistemi i arësimit në Shqipëri mbi bazën e parimit të bashkimit të mësimit me punën prodhuese.

III. — SISTEMI I RI I ARËSIMIT POPULLOR

Shkolla e mesme e arësimit të përgjithshëm, politeknik dhe e punës.

Parimi themelor i riorganizimit të shkollës sonë është lidhja organike e mësimit dhe e edukimit me punën prodhuese. Shkolla e re duhet t'i përgatitë nxënësit për të marrë pjesë në punë prodhuese në një moshë të caktuar dhe t'u sigurojë atyre përgatitjen e nevojshme të përgjithshme për të vazhduar shkollat e larta.

Në bazë të këtij parimi duhet të përcaktohen drejt përpjesëtimet midis arësimit të përgjithshëm, politeknik e profesional, duke kombinuar të mësuarit dhe punën me shlodhjen dhe zhvillimin fizik normal të fëmijëve e të të rinjve.

Lidhja e ngushtë e mësimit me jetën, me prodhimin, me praktikën e ndërtimit të socializmit duhet të përcaktojë përmbajtjen, organizimin dhe metodat e dhënjes së mësimit.

Lidhja e mësimit dhe e edukimit me punën prodhuese duhet të bëhet duke marrë parasysh moshën e nxënësve. Të rinjtë duhet të mësohen me punë që në moshë të vogël. Është e arësyeshme që në moshën 15-16 vjeç rinia të marrë pjesë në punë të dobishme shoqërore. Prandaj arësimi i mesëm ndahet në dy etapa.

1) Etapa e parë e arësimit të mesëm do të jetë shkolla *tetëvjeçare e detyruar*, në vend të shkollës së sotme shtatëvjeçare. Shkolla tetëvjeçare është shkolla e mesme jo e plotë e arësimit të përgjithshëm politeknik dhe e punës, ku do të kalojë i gjithë brezi i ri nga moshë 7-15 vjeç. Detyra e saj është të sigurojë një

pregatitje më të mirë me kulturë të përgjithshme e politeknike, t'i pregatisë të rinjtë psikologjikisht e praktikisht, për punë, për të vazhduar etapën e dytë të shkollës së mesme ose për t'u futur në prodhim, t'i ndihmë të rinjtë për të zgjedhur më drejt profesionin e tyre të ardhshëm dhe të sigurojë më mirë edukimin e tyre moral, estetik e fizik.

Në këtë etapë arësimi politeknik do të merret nëpërmjet mësimin të bazave të shkencave dhe mësimin të punës. Mësimi i punës organizohet në punishte e parcela bujqësore mësimore të shkollës. Në përgatitjen për punë të vazhduara duhet të merren parasysh veçoritë e punës së gruas.

Shtimi i një viti në etapën e parë të shkollës së mesme do të japë mundësi të hiqet ngarkesa e tepërt mësimore e nxënësve që ka sot shkolla shtatëvjeçare.

Vendosja e arësimit tetëvjeçar të detyrueshëm është një hap i madh përpara në zhvillimin e arësimit popullor dhe një faktor me rëndësi shumë të madhe për ngritjen e nivelit kultural e arësimor të të gjithë popullit.

2) Arësimin e mesëm të plotë rinia do ta marrë në *etapën e dytë të shkollës së mesme*, pas mbarimit të shkollës tetëvjeçare, në këto tri rrugë:

a) Në shkollat e mesme të arësimit të përgjithshëm politeknik e të punës me mësimin e prodhimit.

b) Në shkollat e mesme të arësimit të përgjithshëm të mbrëmjes, me turne, sezonale e me korrespondencë.

c) Në shkollat e mesme profesionale (technikume, pedagogjike, shkolla të tjera speciale) të ditës, të mbrëmjes dhe me korrespondencë.

3) Shkolla e mesme e arësimit të përgjithshëm jep arësim të mesëm të plotë. Karakteristika e kësaj shkolle është kombinimi i arësimit të përgjithshëm, politeknik e profesional. Në etapën e dytë të kësaj shkolle plotësohet studimi i bazave të shkencave, zgjerohet horizonti politeknik i nxënësve dhe, nëpërmjet mësimin të prodhimit dhe punës në prodhim, ata marrin një profesion nga më masivët. Me mbarimin e kësaj shkolle nxënësit fitojnë të drejtën për të vazhduar studimet në shkollën e lartë, ose mund të punojnë në profesionin që kanë fituar.

Puna e nxënësve në prodhim organizohet në reparte të prodhimit të ndërmarrjeve ekonomike dhe në institucione të shërbimit shoqëror. Sipas mundësive të vendit ku gjendet shkolla dhe nevojave të ekonomisë socialiste, nxënësit mund të punojnë në ndërmarrje industriale e të ndërtimit, në kooperativa bujqësore, ferma, SMT, në sektorë të ndryshëm të shërbimit social. Në çdo shkollë mund të jepen një ose më shumë specialitete. Shkollat me profil bujqësor punojnë sipas planeve mësimore që kanë parasysh karakterin stinor të punëve bujqësore.

4) Riorganizimi i shkollës kërkon ngritjen e nivelit të arësimit të përgjithshëm e politeknik. Për këtë është e nevojshme t'i jepet rëndësi e madhe përvetësimin të shëndoshë të bazave të shkencave matematike, fizike, kimike, biologjike, të ngrihet cilësia e mësimin dhe t'i jepet rëndësi zhvillimit të punëve praktike-laboratorike. Gjithashtu duhet të forcohet e të ngrihet niveli i mësimin të lëndëve humanitare që kanë një rëndësi të madhe për formimin e botëkuptimit komunist të nxënësve. Rëndësi e dorës së parë duhet t'i jepet mësimin të gjuhës shqipe, që është bazë për të gjitha mësimet e tjera. Duhet të përmirësohet në mënyrë rrënjësore dhënja e mësimin të gjuhës ruse. T'i jepet fund nënvleftësimin të edukatës fizike dhe estetike, të cilat luajnë një rol të madh në zhvillimin e gjithanshëm të të rinjve. Riorganizimi gjithashtu kërkon ndryshimin e metodave të të mësuarit. Duhet të rritet efikasiteti i orës së mësimin, të luftohet verbalizmi, të përdoret në shkallë të gjerë konkretizimi i mësimin, të zhvillohet puna e paruar e nxënësve dhe iniciativa e tyre.

5) Shkollat e mesme të arësimit të përgjithshëm të mbrëmjes, me turne, sezonale e me korrespondencë organizohen pranë qendrave të mëdha të punës dhe në qytete e në fshatra, për t'u dhënë mundësi të rinjve që punojnë të marrin arësimin e mesëm të plotë. Ato duhet të japin arësim të përgjithshëm e politeknik si dhe, kur është e mundur, të ndihmojnë për ngritjen profesionale të punonjësve.

6) Etapa e dytë e shkollës së mesme të arësimit të përgjithshëm mund të jetë tri ose katërvjeçare. Prandaj është e nevojshme të diskutohet se cili afat është më i përshtatshëm për kushtet tona. Në diskutimin e kësaj çështjeje duhet të nisemi nga interesi i përgjithshëm shtetëror e shoqëror, nga nevojat e forcimit të shkollës, nga përcaktimi i drejtë i ngarkesës së nxënësve, nga leverdishmëria ekonomike për shtetin dhe për familjen, nga nevoja për të plotësuar me kuadro të mesëm e të lartë sektorët e ndryshëm të ekonomisë e të kulturës popullore.

Sipas kushteve, nevojave dhe mundësive konkrete, shkolla e arësimit të përgjithshëm mund të hapet me klasa nga I-IV, nga I-VIII dhe nga I-XI ose XII.

7) Riorganizimi i shkollës sonë duhet të realizohet në mënyrë të planifikuar e të organizuar, duke filluar nga viti 1963. Në këtë vit shkollor planet e programet e reja shkollore do të zbatohen nga klasa I deri në klasën V. Pastaj çdo vit do të zbatohen nga klasa në klasë. Në këtë mënyrë nxënësit do të mbarojnë klasën e re të VIII në vitin 1967 dhe klasën e re të XI më 1970, ose të XII më 1971.

Por krahas zbatimit gradual nga viti në vit të planeve e programeve të reja, puna prodhuese mund të futet në shkolla brenda një kohe më të shkurtër, duke ruajtur programet ekzistuese. Për këtë qëllim deri në vitin 1963 Ministria e Arësimit dhe e Kulturës

të organizojë disa shkolla eksperimentale në qytet e në fshat. Njëkohësisht, duhet të merren masa që tani për të forcuar edukatën dhe mësimin e punës në shkolla.

Shkollat e ulëta tekniko-profesionale

Shkollat e ulëta tekniko-profesionale do të ngrihen në vend të shkollave të sotme të rezervave të punës. Detyra e tyre është të pregatisin punëtorë të kualifikuar, për sektorët e ndryshëm të ekonomisë, në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e teknikës së re, rritjes së prodhimit, uljes së kostos, përmirësimit të cilësisë, dhe në radhë të parë rritjes së rendimentit të punës.

Sistemi i sotëm i shkollave të rezervave të punës është i kufizuar dhe përgatitja e punëtorëve të kualifikuar nuk është në nivelin e duhur. Në këtë sistem nuk përfshihet rinia e fshatit dhe një pjesë e madhe e të rinjve të qytetit.

Shkollat e ulëta tekniko-profesionale duhet të ngrihen në qytet e në fshat. Shkollat e qytetit do të jenë 1-2-3-vjeçare, ato të fshatit 1-2-vjeçare mbi shkollën tetëvjeçare. Përkohësisht ato do të ngrihen, sipas nevojave, edhe mbi shkollën fillore.

Ato duhet të pregatisin punëtorë me kualifikim të plotë dhe të pajisur me njohuri teorike mbi prodhimin në profilin, për të cilin përgatiten. Vëllimi i kulturës së përgjithshme do të jetë më i madh se ai që jepet sot në shkollat e rezervave të punës dhe do të përcaktohet konkretisht në bazë të specialitetit.

Shkollat e ulëta tekniko-profesionale duhet të pajisen me punishte mësimore e bazë materiale të përshtatshme për përvetësimin e mjeshtërisë profesionale dhe njëkohësisht ta lidhin punën e tyre mësimore me ndërmarrjet ekonomike të profilit të tyre. Duhet synuar që këto shkolla, në bazë të punës së tyre prodhuese, të ulin shpenzimet që bëhen për mbajtjen e tyre. Këto shkolla nuk japin arësim të mesëm të plotë. Rinia mund ta plotësojë arësimin e mesëm duke ndjekur shkollat e mbrëmjes, me turne, sezonale dhe me korrespondencë.

Shkollat e mesme profesionale

Zhvillimi i vazhdueshëm i prodhimit dhe futja e teknikës së re të përparuar gjithnjë e më shumë në sektorët e ndryshëm të ekonomisë kërkojnë që teknikët e mesëm të kenë përgatitje më të lartë teorike dhe praktike. Për këtë arsye duhet të merren masa të reja për të përmirësuar punën mësimore në shkollat e mesme profesionale, në mënyrë që ato të pregatisin specialistë të mesëm të kualifikuar të profilit të gjerë, që të zotërojnë njohuri

të shëndosha teorike dhe teknike, të njohin mirë prodhimin dhe të kenë shprehje të mjaftueshme për punë praktike.

Shkollat e mesme profesionale do të jenë katërvjeçare dhe do të ngrihen mbi shkollën tetëvjeçare. Ato krahas specialitetit, duhet t'u japin nxënësve kulturë të përgjithshme në vëllimin e shkollës së mesme. Nxënësit që mbarojnë shkollat e mesme teknike industriale duhet të kenë fituar, përveç specialitetit të teknikut të mesëm, edhe kategorinë e punëtorit të kualifikuar në njerin prej specialiteteve të profesionit të tij. Përgatitja teorike e nxënësve duhet të lidhet me punën prodhuese në punishten ose parcelën e shkollës dhe pastaj në ndërmarrjet ekonomike. Nxënësit e shkollave të mesme profesionale duhet të kryejnë gjatë praktikave mësimore dhe punës në prodhim të gjitha proceset kryesore të prodhimit në degën, për të cilën përgatiten.

Shkollat e larta

1) Specialisti i lartë duhet të zotërojë degët përkatëse të shkencës e të teknikës së sotme, të njohë teknologjinë dhe organizimin e prodhimit, të jetë i përgatitur për veprimtari të parvarur drejtuese. Prandaj në shkollën e lartë duhet të përmirësohet riorganizimi që ka filluar, duke e lidhur më ngushtë punën mësimore e shkencore të saj me prodhimin. Format konkrete të lidhjes së mësimit me praktikën dhe me punën në prodhim duhet të caktohen sipas profilit të fakultetit.

Në degët e inxhinierisë studentët duhet të punojnë për një kohë, deri në një vit, në ndërmarrje të prodhimit. Gjatë kësaj kohe ata do të mësojnë sipas sistemit të shkollave të mbrëmjes. Në institutin bujqësor lidhja e të mësuarit me punën prodhuese duhet të bëhet duke marrë parasysh karakterin stinor të prodhimit. Studentët duhet të kujdesen vetë për kafshët, të mbjellin e të mbledhin prodhimet.

Në mënyrë të veçantë duhet të merren masa për të përmirësuar përgatitjen teorike e praktike të specialistëve të shkencave të natyrës: matematikës, fizikës, kimisë, biologjisë.

Në fakultetin e mjekësisë mësimi duhet të shoqërohet me praktikën e vazhdueshme në institucionet mjekuese-profilaktike, duke filluar nga shërbimet më të thjeshta.

Në mënyrë të veçantë duhet forcuar lidhja e mësimit me jetën në fakultetet humanitare, duke i kushtuar kujdes të veçantë praktikës së profesionit dhe pjesëmarrjes së studentëve në punë të dobishme shoqërore.

2) Riorganizimi i sistemit të arësimit të përgjithshëm dhe ngritja e cilësisë së punës mësimore në shkollat tona kërkon përmirësimin rrënjësor të përgatitjes së mësuesve. Masa të rëndësi-

shme në këtë drejtim duhet të marrin institutet pedagogjike dyvjeçare dhe sidomos fakultetet e universitetit, që pregatisin mësues, të cilat deri tani në një farë shkalle e kanë nënvleftësuar pajisjen e shëndoshë të specialistëve të rinj me shprehinë e aftësitë në punë që i nevojiten mësuesit. Për këtë qëllim në institutet pedagogjike dyvjeçare dhe në fakultetet e universitetit që pregatisin mësues duhet të ngrihet niveli shkencor-teorik i dhënjes së leksioneve, të shtohet e të forcohet në mënyrë të veçantë praktika pedagogjike pranë shkollave, për të cilat përgatiten mësuesit, dhe të forcohen lidhjet e tyre me shkollën.

3) Në pranimet në shkollat e larta të preferohen gjithnjë e më shumë të rinj e të reja që vijnë nga prodhimi, duke i ndihmuar ata më parë në lëndët kryesore që i nevojiten specialitetit që do të ndjekin, me qëllim që të jenë të përgatitur si duhet për të vazhduar mësimet. Për këtë qëllim me njerëzit e prodhimit që do të vazhdojnë shkollat e larta duhet të organizohen kurse përgatitore gjashtë ose nëntëmujore, pa shkëputje nga puna, pranë shkollave të larta ose pranë shkollave të mesme.

4) Shkollat e larta duhet ta zhvillojnë punën e tyre shkencore në lidhje të ngushtë me problemet e ndërtimit ekonomik e kultural të vendit. Pedagogët duhet të marrin pjesë në përpunimin dhe zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që preokupojnë sektorët e ndryshëm të ekonomisë, si edhe në përpunimin e zgjidhjen e problemeve të shkencave shoqërore. Lidhja e punës shkencore me prodhimin do të ndihmojë zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë e të kulturës, do të sigurojë një zhvillim më të madh të punës shkencore. Ajo është e vetmja rrugë për ngritjen e punës shkencore në një nivel më të lartë, si dhe për përgatitjen e kualifikuar të specialistëve të rinj.

Instituti i Lartë Bujqësor duhet të ndihmojë kooperativat bujqësore dhe fermat për ngritjen e rendimenteve të prodhimit bujqësor e blegtoral, si dhe për kualifikimin, me anë kursesh e formash të tjera, të specialistëve të ndryshëm të bujqësisë.

5) Përgatitja e shëndoshë e specialistëve të rinj është e lidhur ngushtë edhe me vetë punën këmbëngulëse të studentëve për të përvetësuar shkencën, si dhe me kushtet që u krijohen të rinjve që ndjekin studimet e larta për të bërë një punë të pavarur. Për këtë duhet të rritet gradualisht puna e pavarur e studentëve dhe të tërhiqen ata më aktivisht në punë shkencore-kërkimore. T'i kushtohet kujdes i posaçëm forcimit të mësimin të gjuhës ruse, me qëllim që studentët të jenë në gjendje të shfrytëzojnë lirisht literaturën e specialitetit të tyre.

6) Njohja e bazave të marksizëm-leninizmit është e domosdoshme për specialistët e të gjithë sektorëve. Dhënja e mësimeve të marksizëm-leninizmit duhet të jetë krijuese dhe luftarake. Rinia jonë duhet të edukohet me tiparet e moralit komunist, me fry-

mën e papajtueshmërisë me ideologjinë borgjeze dhe me çfarëdo shfaqje të revizionizmit. Dhënja e mësimeve në shkencat shoqërore duhet të bëhet në lidhje të ngushtë me studimin e shkencave natyrore, me kushtet konkrete të praktikës së ndërtimit të socializmit, të ndihmojë për të formuar te studentët metodën shkencore të njohjes.

Arësimi pa shkëputje nga puna

Çdo vit në shkollat e mbrëmjes e në ato me korrespondencë vazhdojnë studimet dhjetëra mijëra punonjës të sektorëve të ndryshëm dhe në të ardhmen numri i tyre do të vijë duke u rritur. Punonjësit gjithnjë e më shumë do të ndjejnë nevojën për kulturë e arësim. Mësimi i punonjësve pa u shkëputur nga prodhimi është e do të bëhet vazhdimisht një formë shumë e rëndësishme e rritjes së nivelit arësimitor të masave dhe e përgatitjes së kuadrit për sektorët e ndryshëm të ekonomisë e të kulturës. Prandaj është e nevojshme t'i kushtohet kujdes zgjerimit të të gjitha formave të shkollave për të rriturit: të mbrëmjes, me turne, sezonale e me korrespondencë. Në këto shkolla duhet të përmirësohet puna mësimore, metoda e dhënjes së mësimin, duke mbajtur parasysh moshën e rritur të pjesëmarrësve dhe duke caktuar në to nga pedagogët më të mirë.

Për zhvillimin e mëtejshëm të arësimit për të rriturit duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë, veç organeve të arësimit, ministritë, institucionet e ndryshme qendrore, drejtoritë e ndërmarrjeve dhe organizatat e masave, organizatat dhe komitetet e Partisë duhet të forcojnë kontrollin e tyre për të siguruar mbarëvajtjen e arësimit për të rriturit.

IV. — TË NGRIHET MË LART PUNA E MËSUESIT

Në zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të arësimit rolin kryesor do ta luajë kuadri arësimitor, ushtria e mësuesve tanë të popullit. Asnjë nga këto probleme nuk mund të zgjidhet pa një mobilizim të madh të mësuesve, pa rritjen e ndërgjegjes dhe të disiplinës së tyre në punë, pa rritjen e përgjegjësisë së tyre për rezultatet e punës.

Mësuesit tanë përfaqësojnë një repart luftarak të inteligjencies sonë popullore të bashkuar rreth Partisë, të kalitur politikisht dhe ideologjikisht, të lidhur ngushtë me popullin. Ata kanë punuar dhe punojnë pa u lodhur për zhvillimin e arësimit tonë, për edukimin komunist të brezit të ri. Arësimitari ynë kryen një detyrë të shenjtë dhe fisnike. Partia dhe populli i kanë besuar atij arësimin dhe edukimin e brezit të ri. Në shoqërinë tonë ai është i rrethuar me një respekt dhe nderim të veçantë.

Një rol shumë të madh duhet të lozin mësuesit për ngritjen e përparimit në mësim, që është një problem shumë i rëndësishëm dhe aktual i shkollës sonë. Përparimi i nxënësve tanë në mësim është ende i ulët. Në këtë mënyrë krijohen deficite të ndijshme në pregtatitjen e kuadrit dhe përhapet një frymë pajtimi me të metat në vetë punën dhe jetën e shkollës. Sigurisht, përparimi i ulët i nxënësve, në një farë shkalle, pasqyron vështirësitë tona të zgjerimit dhe të rritjes së madhe të arësimit. Por shkaqet kryesore duhen gjetur në punën e shkollës. Prandaj në radhë të parë duhet përmirësuar puna e mësuesit.

Çdo mësues duhet të punojë me këmbëngulje për ta çuar përpara gjithë klasën, duhet të luftojë me ndërjegje për të siguruar përparimin e çdo nxënësi. Për këtë është e nevojshme që çdo mësues dhe i gjithë kolektivi pedagogjik të luftojnë për të ngritur në një shkallë më të lartë cilësinë e mësimit, për të siguruar njohuri të thella e të qëndrueshme të nxënësit.

Problemet që shtrohen para shkollës sonë kërkojnë një punë më të kualifikuar nga ana e mësuesve, kërkojnë pregtatitje më të lartë kulturele e profesionale të tyre.

Por në shkollat tona ka ende një numër të madh arësimitarësh që nuk kanë arësimin përkatës, që nuk bëjnë përpjekjet e duhura për të plotësuar kulturën e tyre dhe për të rritur kualifikimin. Prandaj është e nevojshme që mësuesit e të gjitha kategorive të shkollave të punojnë vazhdimisht për të ngritur aftësitë e tyre pedagogjike, duke përvetësuar të rejtat në fushën e shkencës e të pedagogjisë dhe të plotësojnë kulturën përkatëse me anën e mësimit me korrespondencë. Pa këtë nuk mund të plotësohen si duhet kërkesat e shkollës sonë.

Veç kësaj, ka arësimitarë që nuk kryejnë si duhet detyrën, bëjnë lëshime dhe janë indiferentë ndaj rezultateve të dobëta të punës së tyre. Duhet të tregohet kujdes i veçantë për t'u prerë rrugën këtyre të metave si dhe shfaqjeve të tjera negative që nuk pajtohen me moralin e pedagogut të shkollës sonë.

Puna për kualifikimin e arësimitarëve ka mjaft të meta. Në punën mësimore-edukative caktohen rregulla të ngurta, që ndrydhin iniciativën e pedagogut.

Duhet të përmirësohet e të forcohet puna për kualifikimin e mësuesve nga ana ideo-teorike e metodike. Gjithë masa e arësimitarëve duhet të ndihmohet që të vërë në jetë kërkesat e reja të shkollës, të planeve e programeve të reja mësimore dhe të zbatojë me sukses metodat dhe format e reja të punës mësimore-edukative. Për këtë Instituti i perfeksionimit të mësuesve dhe kabinetet pedagogjike duhet të organizojnë kurse dhe seminare të ndryshme, ekskursione, punë praktike në prodhim, etj. Një punë e veçantë duhet bërë sidomos me mësuesit e matematikës, të fizikës, të kimit, të biologjisë. Me kualifikimin e mësuesve duhet

të ngarkohen edhe fakultetet e Universitetit shtetëror të Tiranës që pregatisin mësues. Për ngritjen e kualifikimit të arësimitarëve, ngritjen e ndërjegjes së tyre në punë, rritjen e cilësisë së punës mësimore-edukative të shkollës, detyra të mëdha kanë gjithashtu këshillat pedagogjike dhe rrethet metodike.

Kuadri i ri arësimitar duhet të pregtatet në mënyrë të tillë që t'u përgjigjet detyrave të reja që shtron riorganizimi i shkollës. Shkollës gjithnjë e më shumë do t'i nevojiten mësues që të drejtojnë punën në punishtet dhe të japin lëndët e reja me karakter teknik. Për këtë duhet të bëhen ndryshimet përkatëse në planet dhe programet mësimore të shkollave dhe instituteve pedagogjike, si dhe të fakulteteve të universitetit që pregatisin mësues. Gjithashtu, është e nevojshme që arësimit t'i jepen mjeshtrë e teknikë nga industria e bujqësia për mësimin e prodhimit dhe të punës.

Rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të arësimit, për përmirësimin e punës mësimore-edukative ka ngritja e punës shkencore pedagogjike. Ka ardhur koha që të hidhen baza të shëndosha në këtë drejtim. Shkolla jonë nuk mund të ecë përpara pa shkencën pedagogjike. Puna shkencore në fushën e pedagogjisë duhet të përqëndrohet në studimin dhe përpunimin e problemeve të përmbajtes dhe metodave të mësimit në shkollë. Në këtë drejtim, ashtu si në gjithë punën e shkollës sonë, organet e arësimit popullor si dhe gjithë mësuesit duhet të studjojnë me vëmendje eksperiencën e vlefshme të pedagogjisë dhe të shkollës sovjetike si dhe të vendeve të tjera socialiste.

Për të organizuar punën shkencore në këto drejtime duhet të ngarkohen Institutit i perfeksionimit të kuadrit dhe katedrat e fakulteteve të Universitetit shtetëror të Tiranës që pregtatin mësues, duke tërhequr mësuesit më të mirë, ata që dallohen për cilësi të lartë në punën mësimore dhe duke u krijuar atyre mundësitë për ta kryer si duhet këtë detyrë.

Një ndihmë të madhe në këtë drejtim duhet të japin kabinetet pedagogjike, të cilat duhet të organizojnë përhapjen e eksperiencës më të mirë dhe të nxisin pedagogët më të dalluar për të marrë pjesë në punë shkencore pedagogjike.

V. — TË PËRMIRËSOHET EDUKIMI KOMUNIST I NXËNËSVE DHE I STUDENTËVE

Shkolla duhet të pregatisë jo vetëm njerëz me kulturë të gjërë, por edhe të pajisur me vetitë e moralit komunist. Edukimi komunist, edukimi i njeriut të ri kërkon një luftë të papajteshme kundër ideologjisë borgjeze, kundër mbeturinave mikroborgjeze, kërkon që nxënësi e studenti të çlirohen nga tiparet ne-

gative të trashëguara nga shoqëria e kaluar si egoizmi, individualizmi, ndjenja e pronës private, nga paragjykimet fetare etj. Të rinjtë tanë duhet të jenë të papajtueshëm me këto shfaqje. Shkolla duhet të edukojë brezin e ri me frymën e devocionit për çështjen e socializmit e të komunizmit, me dashuri të pakufishme për popullin, për atdheun, për Partinë tonë të lavdishme të Punës, organizatoren e të gjitha fitoreve të popullit tonë, me dashuri... për Bashkimin Sovjetik, ... për vendet e kampit tonë të socializmit dhe për gjithë punonjësit e botës.

Të rinjtë tanë duhet të jenë luftëtarë aktivë kundër ideologjisë borgjeze, kundër çdo shfaqjeje të revizionizmit, luftëtarë aktivë për fitoren e ideve të marksizëm-leninizmit.

Rëndësi kryesore për edukimin komunist të brezit të ri ka përvetësimi i teorisë marksiste-leniniste. Prandaj është e nevojshme që edhe nxënësit e shkollave të mesme të pajisen me njohuri fillestare politike e ideologjike.

Me kujdes duhet të punohet për edukimin e të rinjve me sjellje të hijshme në shkollë, në familje, në rrugë e në vende publike.

Shkolla duhet të kujdeset në mënyrë të veçantë për organizimin e aktiviteteve jashtëshkollore, për edukimin dhe çlodhjen e fëmijëve dhe të të rinjve.

Nëpërmjet veprimtarisë së rretheve të ndryshme mësimore, teknike, artistike e sportive të zbulohen e të zhvillohen më tej aftësitë individuale të fëmijëve dhe të të rinjve. Këto detyra shkolla duhet t'i kryejë në bashkëpunim të ngushtë me familjen dhe organizatat e rinisë e të pionierëve.

VI. — ARËSIMI DHE EDUKIMI I BREZIT TË RI ËSHTË ÇËSHTJE E GJITHË POPULLIT

Krahas riorganizimit të sistemit arësimor do të bëhet një punë e madhe për zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit të shkollave. Me ritme të shpejta do të vazhdojë të zhvillohet arësimi shtatëvjeçar dhe më vonë ai tetëvjeçar. Në fund të pesëvjeçarit të tretë në shkollat tetëvjeçare do të shkojnë rreth 80 për qind e fëmijëve që mbarojnë shkollën fillore.

Do të zgjerohet shumë edhe arësimi i mesëm, në mënyrë të veçantë arësimi i mesëm i përgjithshëm. Në krahasim me vitin 1960, në fund të pesëvjeçarit të tretë numri i nxënësve e studentëve në shkollat e mesme e të larta do të dyfishohet. Arësimi shtatëvjeçar (më vonë tetëvjeçar) dhe i mesëm do të zgjerohet si nëpërmjet hapjes së shkollave të reja, ashtu edhe të çeljes së konvikteve.

Zgjerimi i mëtejshëm i rrjetit shkollor dhe riorganizimi i

shkollës kërkojnë shtimin dhe forcimin e bazës mësimore-materiale të shkollës, ndërtesa shkollore, punishte, mjete laboratorike, mjete dhe materiale për punë etj.

Detyrat e reja që i vihen shkollës nuk mund të zgjidhen vetëm me punën dhe përpjekjet e punonjësve të arësimit e të mësuesve, pa pjesëmarrjen aktive të organeve të pushtetit dhe të partisë, organizatave të masave, ndërmarrjeve ekonomike, të gjithë prindërve, pra të gjithë shoqërisë.

1. Zhvillimi i shkollës sonë është i lidhur ngushtë me jetën dhe interesat e çdo familjeje. Familja e re socialiste, ashtu si edhe shkolla, është e interesuar drejt për së drejti për edukimin komunist të brezit të ri, për përparimin e lartë të nxënësve në mësim, për edukimin e fëmijëve në punë dhe me sjellje të hijshme në shtëpi, në shkollë e në vende publike. Ajo duhet të bëhet ndihmëse aktive dhe e drejtpërdrejtë e shkollës për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Prandaj duhet të ngrihet edhe më shumë përgjegjësia e prindërve para shoqërisë dhe shtetit për edukimin e fëmijëve.

Për t'ja arritur këtij qëllimi është e nevojshme që mësuesit, organizatat shoqërore dhe shtypi të zhvillojnë një propagandë të gjerë pedagogjike për prindërit.

2. Ndërmarrjet ekonomike, të cilat janë të interesuara drejt për së drejti për edukimin dhe përgatitjen e rinisë për punë, kanë detyra të përbashkëta me shkollën në këtë drejtim. Prandaj ato, si dhe kooperativat bujqësore e institucionet e shërbimit social, duhet të zgjerojnë e të forcojnë kujdestarinë mbi shkollat. Për të realizuar me sukses lidhjen më të ngushtë të mësimi me jetën, ndërmarrjet ekonomike duhet t'i ndihmojnë shkollat me material, mjete e maqina për mësimin e punës. Futja e mësimi të prodhimit dhe e punës në prodhim në klasat e larta të shkollës së mesme kërkon sigurimin e fronteve të punës për nxënësit, të personelit teknik që do t'i drejtojnë ata dhe të kushteve të përshtatshme për punë. Të gjitha këto detyra duhet të zgjidhen nga ndërmarrjet ekonomike dhe kooperativat bujqësore, në bashkëpunim me shkollat përkatëse.

Kooperativat bujqësore duhet të marrin masa për të ndërtuar shkollat e fshatit dhe për t'i pajisur ato me orëditë e nevojshme. Ato gjithashtu duhet të ndihmojnë për hapjen dhe mbajtjen e konvikteve për realizimin e arësimit tetëvjeçar të detyrueshëm.

3. Detyra shumë të mëdha kanë organizatat e rinisë në shkollë. Ato duhet të ndihmojnë më shumë shkollën për edukimin komunist të rinisë, për ngritjen e nivelit ideo-politik të nxënësve e studentëve, për të ngjallur te të rinjtë dëshirën për të mësuar e për të siguruar një përparim më të mirë, për t'i edukuar ata me dëshirën për punë dhe me dashurinë për njerëzit e punës, për të realizuar lidhjen e mësimi me punën prodhuese. Organizata

e rinisë duhet të punojë më shumë për t'i afruar nxënësit dhe studentët me rininë punonjëse, jo vetëm gjatë kohës së punës në prodhim, por edhe nëpërmjet punës politike, kulturele, artistike e sportive, duke organizuar aksione të përbashkëta.

Në shkollat shtatëvjeçare (më vonë tetëvjeçare) duhet të forcohet e të përmirësohet puna e organizatës së pionierit.

4. Organizatat e Bashkimeve Profesionale duhet të ndihmojnë që në ndërmarrje të krijohen kushte që rinia jonë të plotësojë edukimin e saj, të nxisin dhe të përkrahin interesimin e punonjësve për arësim e kualifikim, të sigurojnë mobilizimin e arësimitarëve dhe të gjithë punonjësve të arësimit për të realizuar me sukses detyrën e madhe të riorganizimit të shkollës dhe të ngritjes së cilësisë së mësimi.

5. Komitetet ekzekutive, këshillat popullore dhe organet e tjera të pushtetit lokal duhet të merren më shumë me punën e arësimit, të marrin masa me kohë për riorganizimin e shkollës, për kalimin nga arësimi shtatëvjeçar në arësimin tetëvjeçar.

Kalimi nga shkolla shtatëvjeçare në tetëvjeçare shtron me forcë edhe më të madhe nevojën e një lufte të vendosur për zbatimin e arësimit të përgjithshëm të detyrueshëm, sidomos në disa krahina që në të kaluarën kanë qenë më të prapambetura, dhe në mënyrë të veçantë për vajzat. Organet e pushtetit dhe të arësimit duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë për zgjidhjen e kësaj çështjeje, për zbatimin e arësimit të detyrueshëm. Ato duhet të bashkëpunojnë me organizatat e Partisë, të Frontit, të rinisë dhe të gruas për të zhvilluar një punë të gjerë sqaruese.

6. Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, e cila ka përgjegjësinë kryesore për riorganizimin e shkollës, duhet të marrë masa për përgatitjen me kohë të planeve e programeve mësimore dhe të teksteve, të forcojë e të përmirësojë punën e saj ideo-metodike dhe organizativo-pedagogjike, të përmirësojë drejtimin e saj për forcimin e gjithanshëm të shkollës dhe për zhvillimin e mëtejshëm të punës shkencore-pedagogjike.

7. Detyra të mëdha kanë të gjitha ministratë e institucionet shtetërore qendrore, të cilat duhet të sigurojnë me kohë për shkollat e tyre mjetet mësimore, tekstet dhe kuadrin e nevojshëm nga radhët e specialistëve më të aftë të tyre.

8. Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të sigurojnë udhëheqjen e gjithanshme të punës për riorganizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të arësimit popullor. Ato të kenë në qendër të vëmendjes përmirësimin e punës mësimore — edukative në shkolla, përparimin e nxënësve e të studentëve në mësim dhe edukimin komunist të tyre. Në mënyrë të veçantë duhet të kujdesen për ngritjen ideologjike e profesionale të arësimitarëve, për aktivizimin e tyre në punën politiko-kulturale me masat, si dhe për t'i adihmuar për krijimin e kushteve të mira të punës dhe të jetesës.

* * *

Duke u nisur nga rëndësia e përgjithshme shtetërore dhe shoqërore e problemeve të mësipërme, Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH i parashetrojnë këto teza për një diskutim të gjerë popullor dhe ftojnë të gjithë mësuesit, prindërit, drejtuesit dhe punonjësit e prodhimit, aktivistët dhe gjithë qytetarët që të shfaqin mendimet e tyre me gojë ose me shkrim për këto çështje.

Komiteti Qendror dhe Këshilli i Ministrave kanë besim të plotë se ky diskutim i përgjithshëm popullor do t'i shërbejë zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të shkollës sonë, zhvillimit të arësimit tonë popullor.

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr.
148, datë 22 qershor
1960